BANKA E SHQIPËRISË

ARTIKUJ TË BOTUAR NË BULETININ EKONOMIK TË BANKËS SË SHQIPËRISË GJATË NJË DEKADE

Vëllimi III

Periudha

2005 - 2007

Dhjetor 2007

Artikujt e paraqitur në këtë botim, nuk shprehin gjithmonë opinionin zyrtar të Bankës së Shqipërisë. Këtyre artikujve lutemi t'u referoheni si mendime personale të autorëve.

Të nderuar lexues,

Buletini Ekonomik i Bankës së Shqipërisë ka 10 vjet që botohet, për një auditor profesionistësh, si në fushën e biznesit, në atë të bankingut, për akademikët dhe për publikun e thjeshtë. Në përmbajtjen e tij, më të shumtën e rasteve kanë zënë vend artikuj, vrojtime dhe analiza të ndryshme të punonjësve të Bankës. Nisur nga dëshira e mirë që këto punime të mund të përdoren apo të gjenden lehtësisht edhe pas një periudhe relativisht të gjatë kohore, nga botimi i parë zyrtar, menduam të publikojmë këtë përmbledhje të tyre në një format të vetëm.

Duam me këtë rast, të tërheqim vëmendjen tuaj, që këto punime, përveç faktit që shprehin opinione dhe përfundime të autorëve, duhen parë edhe të vendosura në kuadrin kohor kur janë shkruar, të lidhura me ngjarjet të cilave u referohen apo me fenomenet që marrin në shqyrtim.

PËRMBAJTJA

2005

Një rishikim i regjimit të targetimit monetar në Shqipëri me disa orientime për të ardhmen 9
Fatos Ibrahimi
Erjon Luçi

Sinjalet e Bankës së Shqipërisë, inflacioni i pritur nga publiku përballë atij të faktuar për vitin 2004 29
Evelina Çeliku
Rezarta Nasto

Vlerësimi i standardeve të shpërndarjes së statistikave në Bankën e Shqipërisë 43
Kliti Ceca
Hilda Shijaku
Endrita Xhaferaj

Banka e Shqipërisë dhe angazhimi i saj në kuadër të Procesit të Stabilizim-Asociimit 69
Ina Kraja
Niuton Mulleti

Indeksi i Aftësisë së Shërbimit të Borxhit Sovran: A ka ardhur koha që Shqipëria ta sigurojë atë? 79
Laert Dogjani

Dy fjalë mbi sigurimin e depozitave 89
Silva Seiko

Krahasimi i standardeve të statistikave në Bankën e Shqipërisë me standardet e projektit SDDS të Fondit Monetar Ndërkombëtar 107
Kliti Ceca
Edmond Thanati
Hilda Shijaku
Endrita Xhaferaj

Një vështrim analizues i serive kohore të depozitave, kredive dhe mjeteve valutore neto të Bankës së Shqipërisë 149
Refika Fejzo

Elemente të rëndësishme të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar 183
Ibrahim Buharaja

2006

Investime të huaja direkte. Shënime metodologjike 217
Argita Frashëri
Anjeza Hobdari

Vlerësimi i investimeve të huaja direkte në vendet me ekonomi në zhvillim të Evropës Lindore: Rasti i Shqipërisë 243
Endrita Xhaferaj

Roli i Bankës së Shqipërisë në procesin e integrimit evropian 267
Elvis Çibuku

Investimet e Huaja Direkte në Shqipëri (viti fiskal 2004) 285
Argita Frashëri

Çështje të Bashkimit Monetar Evropian dhe Kriteret e Paktit të Stabilitetit dhe Rritjes 311
Bledar Hoda

Mbi gjetjet e misionit ROSC për shpërndarjen e të dhënave statistikore mars – prill 2006 325
Hilda Shijaku
Kliti Ceca

Vendet në tranzicion dhe Shqipëria 361
Elvana Troqe

2007

Informacion mbi modulin e rezervës ndërkombëtare dhe likuiditetit në valutë të huaj 373
Hilda Shijaku

Tendenca e çmimeve në Shqipëri në krahasim me Greqinë dhe Italinë. Çfarë mund të themi për konvergjencën? 391
Elvana Troqe
Valentina Semi

Ligji i ri "Për bankat në Republikën e Shqipërisë"dhe përputhshmëria e tij me kuadrin rregullativ mbikëqyrës. Detyrimet për ndryshime rregullative në zbatim të Direktivave të Bashkimit Evropian. 419
Juna Bozdo
Irini Kalluci

Aktiviteti kreditues: Mungesa dhe prurjet e një faktori të rëndësishëm zhvillimi 447
Elona Bollano
Gerond Ziu

Informacion mbi rezultatet e vrojtimit pranë familjeve 477
Argita Frashëri

Çmimet e pasurive të paluajtshme dhe stabiliteti financiar 503
Juna Bozdo

Produktiviteti i punës në Shqipëri: Procesi i konvergimit sektorial 531
Vasilika Kota

Metodat kryesore të disagregimit të përkohshëm 553
Elona Dushku

Një rishikim i regjimit të targetimit monetar në Shqipëri me disa orientime për të ardhmen
Fatos Ibrahimi
Erjon Luçi
Mars 2005

Sinjalet e Bankës së Shqipërisë, inflacioni i pritur nga publiku përballë atij të faktuar për vitin 2004
Evelina Çeliku
Rezarta Nasto
Mars 2005

Vlerësimi i standardeve të shpërndarjes së statistikave në Bankën e Shqipërisë
Kliti Ceca
Hilda Shijaku
Endrita Xhaferaj
Qershor 2005

Banka e Shqipërisë dhe angazhimi i saj në kuadër të Procesit të Stabilizim-Asociimit
Ina Kraja
Niuton Mulleti
Qershor 2005

Indeksi i Aftësisë së Shërbimit të Borxhit Sovran: A ka ardhur koha që Shqipëria ta sigurojë atë?
Laert Dogjani
Qershor 2005

Dy fjalë mbi sigurimin e depozitave
Silva Seiko
Shtator 2005

2005

Krahasimi i standardeve të statistikave në Bankën e Shqipërisë me standardet e projektit SDDS të Fondit Monetar Ndërkombëtar
Kliti Ceca
Edmond Thanati
Hilda Shijaku
Endrita Xhaferaj
Shtator 2005

Një vështrim analizues i serive kohore të depozitave, kredive dhe mjeteve valutore neto të Bankës së Shqipërisë
Refika Fejzo
Dhjetor 2005

Elemente të rëndësishme të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
Ibrahim Buharaja
Dhjetor 2005

NJË RISHIKIM I REGJIMIT TË TARGETIMIT MONETAR NË SHQIPËRI ME DISA ORIENTIME PËR TË ARDHMEN

*Fatos Ibrahimi**
Erjon Luçi

Fjalë kyçe
- Kontroll monetar - Shënjestrim inflacioni - Regjime alternative - Politikë monetare -

Në këtë punim jemi përpjekur të analizojmë përshtatshmërinë e regjimit të targetimit monetar të zbatuar aktualisht në Shqipëri, nën dritën e zhvillimeve të fundit ekonomike. Edhe pse performanca e tij e deritanishme ka qenë e kënaqshme, regjime alternative si ai i inflacionit të shënjestruar (inflation targeting) mund të jenë më efikase për të ruajtur stabilitetin e çmimeve në të ardhmen. Më pas, jemi përqendruar gjithashtu dhe në kërkesat, në problemet dhe në mundësinë e kalimit nga regjimi aktual në regjimin formal të inflacionit të shënjestruar.

1. HYRJE

Një objektiv i ndërmjetëm efikas duhet të përfshijë të gjithë informacionin e nevojshëm për parashikimin e inflacionit. Agregatët monetarë mund të mos e përmbushin një kusht të tillë. Për këtë arsye, Shqipëria si dhe shumë vende të tjera, po konsideron të kalojë nga regjimi i kontrollit monetar drejt regjimit të shënjestrimit të inflacionit për të drejtuar politikën e saj monetare. Banka e Shqipërisë tashmë ka filluar t'i bëjë të njohur publikut objektivin për inflacionin e fundvitit. Por, siç argumenton Mishkin (2002), raportimi i një objektivi për inflacionin mund të mos jetë i mjaftueshëm për të klasifikuar një vend si shënjestrues

inflacioni. Kalimi nga ky regjim i nënkuptuar i shënjestrimit të inflacionit drejt regjimit formal të shënjestrimit të inflacionit kërkon elemente të tjera, të cilat mbartin rreziqe në rast se më parë nuk përmbushen disa kushte të caktuara.

Në këtë material jemi përpjekur të shqyrtojmë mundësinë e zbatueshmërisë të regjimit të shënjestrimit të inflacionit (*inflation targeting, IT*) në periudhën afatmesme, duke përshkruar problemet potenciale që mund të lindin me adoptimin e tij në Shqipëri. Materiali është organizuar si më poshtë. Në pjesën e dytë jepet një përshkrim i përgjithshëm i politikës monetare në Shqipëri. Pjesa e tretë analizon vështirësitë potenciale të komunikimit që mund të ketë regjimi aktual i targetimit monetar në zbatimin e politikës monetare. Pjesa e katërt përmbledh disa nga përparësitë dhe problemet që karakterizojnë regjimin e IT. Në pjesën e pestë përqendrohemi në mënyrë më të detajuar në problemet që lidhen kryesisht me aftësinë e Bankës së Shqipërisë për të adoptuar regjimin e IT. Pjesa e gjashtë trajton disa probleme të tjera të regjimit të IT që janë përtej kontrollit të Bankës së Shqipërisë. Në pjesën e shtatë trajtojmë shkurtimisht disa regjime alternative. Pjesa e tetë konkludon.

2. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I POLITIKËS MONETARE NË SHQIPËRI GJATË TRANZICIONIT

Shqipëria ka qenë mjaft e suksesshme në uljen e inflacionit. Nga 237 për qind që ishte në vitin 1992, inflacioni u ul në 6 për qind në vitin 1996. Inflacioni i shkaktuar nga pasiguria pas rënies së skemave piramidale u ul gjithashtu, me shpejtësi. McNeilly etj. (1998) suksesin e Shqipërisë në arritjen e inflacionit të ulët ia atribuon liberalizimit të hershëm të çmimeve, shoqëruar me politikat mbështetëse për rritjen e konkurrencës dhe rritjes së hershme të ofertës agregate të mallrave dhe shërbimeve, krahas një politike monetare kufizuese të ndjekur nga Banka e Shqipërisë (Banka e Shqipërisë).

Fillimisht Banka e Shqipërisë është mbështetur në instrumente direkte për drejtimin e politikës monetare. Para mesit të vitit 1995

oferta e parasë gjithsej (M3) kontrollohej nëpërmjet vendosjes së tavaneve për zgjerimin e kredisë së brendshme të sistemit bankar. Tavanet e kredisë, në përputhje me normën e synuar të inflacionit dhe me rritjen e prodhimit, vendoseshin për kredinë e bankave për ekonominë - përfshirë dhe kredinë për qeverinë.

Tabelë 1. Treguesit kryesorë ekonomikë të Shqipërisë.

	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004
Rritja reale e PBB (%)	12.7	8.9	7.7	6.5	4.7	6.0	6.0
PBB për frymë (usd)	842	1,052	1,086	1,329	1,460	1,833	2,434
Norma e papunësisë	17.8	18.0	16.9	14.6	15.8	15.0	14.5
Norma e inflacionit (fund viti)	8.7	-1.0	4.2	3.5	2.1	3.3	2.2
Bilanci i përgjithshëm i qeverisë (% e PBB, përjashtuar grantet)	-11.4	-12.1	-9.2	-8.2	-6.9	-4.5	-6.5
Bilanci i përgjithshëm i qeverisë (% e PBB, përfshirë grantet)	-10.9	-9.3	-8.2	-7.6	-6.3	-4.1	-5.85
Borxhi i brendshëm (% e PBB)	36.2	37.4	42.6	39.5	38.8	38.0	37.2
Bilanci tregtar (% e PBB)	-22.8	-19.3	-22.3	-24.2	-23.9	-22.8	-21.5
Bilanci i llogarisë korente (% e PBB përjashtuar grantet)	-7.1	-7.9	-7.4	-6.2	-9.0	-7.6	-7.5
Bilanci i llogarisë korente (% e PBB përfshirë grantet)	-3.9	-3.9	-4.4	-3.2	-6.5	-5.1	-5.5
Borxhi i jashtëm (% e PBB)	36.9	32.3	31.8	28.2	24.4	20.2	21.0
Kursi i këmbimit lek/usd (mesat.)	150.6	137.7	143.7	143.5	140.1	121.9	102.8
Kursi i këmbimit lek/euro (mesat.)	-	146.9	132.6	128.5	132.4	137.5	127.7
Investimet e huaja direkte (% e PBB)	1.5	1.4	3.7	4.8	2.6	2.7	5.0

Burimi: Ministria e Financave, INSTAT, Banka e Shqipërisë.

Pasi zbritej tavani i kredisë së bankës qendrore ndaj qeverisë nga kufiri total, shuma e mbetur ndahej midis bankave tregtare, duke vendosur tavane të veçanta për secilën bankë. Prej vitit 1995, Banka e Shqipërisë u përpoq të rrisë kontrollin e M3 nëpërmjet

Grafik 1. Normat reale të interesit.



rregullimit të normave të interesit të depozitave bankare. Në lidhje me politikën e normave të interesit, Banka e Shqipërisë synonte mbajtjen e normave reale të interesit të vendosura për depozitat e bankave shtetërore në nivele pozitive, me qëllim që të evitohej rrjedhja e mjeteve monetare vendase dhe të evitohej keqndërmjetësimi bankar (Grafik 1). Në vitin 1999, Banka e Shqipërisë hoqi tavanet e kredisë për bankat e nivelit të dytë, ndërkohë që nxori rregullin që bankat me një raport të kredive të këqija ndaj totalit të kredisë, mbi 20 për qind, ndaloheshin të jepnin kredi të reja. Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2000, Banka e Shqipërisë gjithashtu, hoqi plotësisht kontrollin direkt mbi normat e interesit të depozitave, duke kaluar në përdorimin e instrumenteve indirekte për zbatimin e politikës monetare. Aktualisht, Banka e Shqipërisë përpiqet të ndikojë normat e interesit nëpërmjet operacioneve të tregut të hapur në bono thesari (repo).

Deri më sot ky regjim ka treguar rezultate mbresëlënëse lidhur me stabilitetin e çmimeve. Inflacioni është stabilizuar në nivele të moderuara sipas shifrave të fundvitit dhe mesatares vjetore, ndonëse ndonjëherë janë vërejtur devijime nga objektivi, për shkak të goditjeve të paparashikuara dhe faktorëve spekulativë, që kanë qenë kryesisht përtej kontrollit të bankës qendrore (për shembull, çmimet më të larta të bukës, ndryshimi i tarifave të elektricitetit dhe të telekomunikacionit). Politika monetare do të vazhdojë të synojë mbajtjen e inflacionit brenda objektivit prej 2-4 për qind. Megjithatë, banka po bën përpjekje të paraprijë rreziqet që mund të pengojnë atë në arritjen e objektivit në

Grafik 2. Inflacioni i çmimeve të konsumit dhe inflacioni bazë.



Burimi: Çeliku, 2004.

të ardhmen dhe përshtatjen e strategjisë së politikës së saj monetare në përputhje me realitetin. Këto rreziqe mund të lidhen me efektivitetin e regjimit aktual të politikës monetare dhe/apo me rreziqe të jashtme. Më poshtë do të përpiqemi t'i analizojmë këto dy çështje më hollësisht.

3. PROBLEMI I KOMUNIKIMIT ME REGJIMIN AKTUAL TË TARGETIMIT MONETAR

Sipas Estrella dhe Mishkin (1997), kur inflacioni sillet nën kontroll, roli informues i agregatëve monetarë zvogëlohet pasi "zhurmat" relative të goditjeve (*shock*) të shpejtësisë së parasë rriten. Kjo, sipas tyre, mund të jetë një arsye e rëndësishme pse vendet e industrializuara dhe shumë nga ato në zhvillim, gjatë periudhës së stabilitetit të çmimeve, nuk mbështeten në kontrollin monetar. Ndryshueshmëria e shpejtësisë së qarkullimit të parasë mund t'i atribuohet kryesisht paqëndrueshmërisë së kërkesës për para, që është rritur sidomos me përparimet dhe me ndryshimet strukturore të sistemeve financiare.

Rasti i Shqipërisë është përmendur shpesh si një rast i suksesshëm i përdorimit të kontrollit monetar në uljen e inflacionit. Megjithatë, nuk është e qartë nëse ky sukses mund t'i atribuohet vetëm ose në një shkallë të lartë, kësaj strategjie dhe nëse ky regjim do të mbetet i suksesshëm edhe në të ardhmen, duke konsideruar të metën e përmendur nga Estrella dhe Mishkin (1997).

Banka e Shqipërisë ka ndjekur disa objektiva gjatë viteve në tranzicion si, uljen e inflacionit, rritjen e rezervave të saj valutore, zbutjen e luhatshmërisë së kursit të këmbimit, përmirësimin e stabilitetit financiar si dhe nxitjen e zhvillimit ekonomik. Përsa i përket objektivit të saj kryesor të përcaktuar në ligj, stabilitetit të çmimeve, komunikimi me publikun është realizuar duke shpallur normën e rritjes vjetore të parasë gjithsej (M3), bazuar në programin monetar të përpiluar çdo fillim viti dhe të përditësuar çdo tremujor. Rritja e parasë matet bazuar në një ekuacion sasior të parasë në përputhje me një nivel të caktuar inflacioni, dhe projeksione të rritjes së mundshme të prodhimit dhe shpejtësisë së parasë.

Ky lloj shënjestrimi monetar është i ngjashëm me shënjestrimin e PPB nominale. Disa autorë (Taylor, 1985), argumentojnë se ky regjim funksionon më mirë për zbutjen e goditjeve të ofertës sepse një rënie e PPB-së reale automatikisht çon në një politikë monetare lehtësuese.

Gjithashtu, vitet e fundit Banka e Shqipërisë ka bërë publik nivelin e objektivit zyrtar për inflacionin, gjë e cila ka shtyrë Stone (2003) ta klasifikojë Shqipërinë si një vend me shënjestrim inflacioni të pjesshëm (të butë), në krahasim me vendet me IT të plotë.

Siç mund të shihet nga tabela 2, strategjia e shënjestrimit të agregatëve monetarë, në pamje të parë, ka funksionuar jo keq po të konsiderohet fakti që niveli i inflacionit të fundvitit është sjellë dy herë nën kontroll, pas 1992 dhe pas 1997. Megjithatë, mund të bëhen edhe disa vërejtje të tjera. Së pari, norma aktuale e rritjes së M3 deri në vitin 2000 është shmangur ndjeshëm nga objektivi i planifikuar. Në kontrast me këtë, objektivi i inflacionit zyrtar gjatë të njëjtës periudhë ka qenë në shumicën e kohës nën nivelin e planifikuar. Ky fakt ngre dyshime rreth rëndësisë relative të ankorimit nominal të përdorur për arritjen e niveleve të ulëta të inflacionit.

Tabelë 2. Agregatët monetarë të planifikuar kundrejt atyre faktikë dhe inflacioni (fund i vitit, ndryshimi në %).

Viti	Baza Monetare		M3		Inflacioni	
	Projeksioni	Aktuale	Projeksioni	Aktuale	Niveli i dëshiruar	Niveli aktual
1993	-	-5.9	44.1	74.4	-	30.9
1994	-	-2.0	29.0	41.0	24.0	15.8
1995	-	-1.1	23.0	51.8	10.0	6.1
1996	-	2.6	22.0	43.8	12.0	17.4
1997	-	12.0	-	28.5	53.0	44.6
1998	-	14.1	23.0	20.6	10.0	8.7
1999	-	21.6	15.0	22.2	7.0	-1.0
2000	-	24.1	12.1	12.8	2-4	4.2
2001	11.4	18.1	15.4	19.9	2-4	3.5
2002	10.8	11.2	6.2	5.1	2-4	1.7
2003	-0.6	-1.9	9.5	8.3	2-4	3.3
2004	7.9	11.2	10.6	13.5	2-4	2.2
2005	5.7	-	8.3	-	2-4	-

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Së dyti, ndonëse prej vitit 2000 rritja e M3 ka qenë shumë afër objektivit të saj, normat e rritjes kanë ndryshuar gjerësisht, nga 5 në 13 për qind, krahasuar me normat relativisht të qëndrueshme të inflacionit. Kjo e bën të vështirë për publikun

që të kuptojë synimin e saktë të Bankës së Shqipërisë, duke u mbështetur thjesht në objektivat e shpallur të rritjes së M3. Për shembull, objektivi 3 për qind i nivelit të inflacionit mund të lidhet me një shtrirje të gjerë të normave të rritjes së M3, nga 9 deri 15 për qind. Kjo mbështet argumentin e Estrella dhe Mishkin (1997), që agregatët monetarë e humbasin funksionin e tyre informativ për nivele të ulëta inflacioni.

Banka e Shqipërisë e ka njohur problemin e mësipërm për sa kohë që vendimet për ndryshimet e pozicionit të politikës monetare, janë bazuar në një gamë më të gjerë informacioni se sa thjesht norma e rritjes së M3. Veçanërisht, prej disa kohësh, Banka e Shqipërisë i ka kushtuar vëmendje të veçantë parashikimit të inflacionit, i cili përfshin disa informacione shtesë si: presionet inflacioniste të ardhura nga luhatjet e kursit të këmbimit, ndryshimet e çmimeve në tregje të ndryshme, përfshirë dhe tregjet e huaja, goditjet e ofertës etj.. Kjo mënyrë drejtimi e politikës monetare përngjason shumë me regjimin e shënjestrimit të inflacionit. Megjithatë, ka dy elemente të rëndësishme që e dallojnë Shqipërinë nga vendet e tjera me regjim IT formal. Këto janë komunikimi i strategjisë së politikës monetare përfshirë publikimin dhe shpjegimin e parashikimit të inflacionit, si dhe ngritja e një mekanizmi formal që e bën Bankën e Shqipërisë të përgjegjshme për objektivin e shpallur të inflacionit.

Megjithëse mund të duket i drejtpërdrejtë, zbatimi i IT ka dhe disa probleme, sidomos për ekonomitë në zhvillim. Në seksionin tjetër do të përpiqemi të analizojmë më hollësisht disa nga përparësitë dhe problemet që mund të hasë Banka e Shqipërisë në kalimin në një regjim formal IT.

4. REGJIMI I SHËNJESTRIMIT TË INFLACIONIT: ARGUMENTET PRO DHE KUNDËR TIJ PËR SHQIPËRINË

Përderisa agregatët monetarë nuk përmbajnë gjithë informacionin e mjaftueshëm për parashikimin e inflacionit,

mbështetja në regjimin e kontrollit monetar mund të jetë jo optimale. Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë është duke shqyrtuar kalimin në një regjim formal IT në një periudhë afatmesme. IT bazohet në idenë se objektivi më i mirë i ndërmjetëm i politikës monetare që synon kontrollin e inflacionit është parashikimi i vetë inflacionit (Cukierman and Liviatan, 1992; Svensson, 1997). Parashikimi i inflacionit, në dallim nga agregatët monetarë, është i pakufizuar në informacionin që mbulon. Çdo informacion i rëndësishëm për inflacionin e ardhshëm mund të merret parasysh.

Në dekadën e fundit një literaturë e gjerë ka argumentuar përparësitë e regjimit IT krahasuar me regjimet e tjera, të përmbledhura në një seri studimesh nga Mishkin etj. (1997, 2000, 2002). Ndër përparësitë më të rëndësishme të IT mund të përmendim: bazën më të gjerë të informacionit në të cilin bazohet, fleksibilitetin relativisht më të lartë në lidhje me goditjet e ofertës, faktin që është lehtësisht i kuptueshëm nga publiku etj..

Megjithatë, adoptimi i një regjimi IT paraqet edhe probleme. Problemi kryesor për Shqipërinë lidhet me rrezikun më të lartë që ai mbart për reputacionin e Bankës së Shqipërisë krahasuar me regjimin aktual të kontrollit të parasë. Siç u përmend më lart, megjithëse objektivat për M3 nuk janë arritur në mënyrë të vazhdueshme deri në vitin 2001 (shih tabelën 2) inflacioni është zvogëluar, gjë që tregon se reputacioni i Bankës së Shqipërisë të paktën nuk është përkeqësuar, ndërkohë që dhe mund të jetë përmirësuar. Kjo ndoshta është e lidhur me nivelin e ulët të njohjes së saktë të lidhjes midis M3 dhe inflacionit nga ana e publikut, gjë që i jep bankës më shumë hapësirë të shpjegojë mosarritjen e objektivit. Në rastin e regjimit IT mosarritja e objektivit mund të jetë më e kushtueshme përsa i përket reputacionit të bankës.

Vitet e fundit, reputacioni i BANKËS SË SHQIPËRISË përsa i përket objektivit të inflacionit rreth nivelit 3 për qind, pa dyshim që është forcuar. Sidoqoftë, pretendimi që niveli aktual i reputacionit është i kënaqshëm për të adoptuar një regjim të shënjestrimit të inflacionit do të ishte i parakohshëm. Ekzistojnë disa probleme që mund të kufizojnë konfidencën e Bankës së Shqipërisë në përmbushjen e objektivit të inflacionit të ulët, që

mund të rrezikojnë reputacionin e saj në të ardhmen në arritjen e shënjestrimit të inflacionit. Një pjesë e këtyre problemeve ka të bëjë me vetë Bankën e Shqipërisë, ndërkohë që ka dhe faktorë jashtë kontrollit të Bankës së Shqipërisë. Le të përqendrohemi më hollësisht në disa nga këto probleme.

5. PENGESAT NË BANKËN E SHQIPËRISË

Problemet që lidhen me Bankën e Shqipërisë për adoptimin e IT janë më tepër teknike e disi më pak institucionale. Banka e Shqipërisë gëzon një nivel relativisht të lartë pavarësie dhe me ligj ka si objektiv të saj kryesor ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Megjithatë, shkalla e lartë e pavarësisë ligjore të Bankës së Shqipërisë nuk tranformohet plotësisht në pavarësi reale, e cila akoma mendohet të jetë më e ulët se ajo e përcaktuar me ligj. Disa të dhëna empirike (Luçi 1999) sugjerojnë që Banka e Shqipërisë përpiqet të ruajë pavarësinë e saj nga qeveria edhe pse mungesa e instrumenteve dhe pasiguria e mekanizmit të transmetimit e bën të vështirë arritjen gjithmonë të objektivave. Një hap i rëndësishëm në përmirësimin e pavarësisë reale të Bankës së Shqipërisë do të ishte eliminimi i plotë i mundësisë së financimit të qeverisë, e cila për momentin është 5 për qind (e të ardhurave mesatare të 3 viteve të fundit). Kjo do të ndihmonte Bankën e Shqipërisë për të shmangur akoma më shumë ndërhyrjet e qeverisë në politikën e saj monetare dhe do të rriste presionet ndaj kësaj të fundit për të konsoliduar më tej politikën e saj fiskale; ose nëpërmjet rritjes së të ardhurave të saj ose nëpërmjet uljes së shpenzimeve.

Adoptimi i regjimit IT mund të kërkojë disa përmirësime të mëtejshme të ligjit, por për momentin nuk parashikohet ndonjë pengesë e veçantë në lidhje me këtë pikë. Përsa i përket anës teknike, një regjim IT i suksesshëm kërkon një kuptim të mirë të mekanizmit të transmetimit të politikës monetare, një model të mirë për parashikimin e inflacionit dhe një kuadër komunikimi eficient me publikun. Megjithëse nga ana e Bankës së Shqipërisë janë bërë përpjekje pozitive në të gjitha këto drejtime, përsëri mbetet shumë për t'u bërë, sidomos në lidhje me dy pikat e para.

Departamenti i Kërkimeve në bashkëpunim me Departamentin e Politikës Monetare dhe me Departamentin e Operacioneve Monetare kanë përpiluar një listë të problemeve teknike që duhen përballur, e cila përgjithësisht ka për qëllim përmirësimin e të kuptuarit tonë të mekanizmit të transmetimit të politikës monetare, të burimeve të inflacionit dhe të funksionimit të ekonomisë shqiptare në tërësi.

Puna mbi këto probleme mund të kërkojë kohë, përpara se të shihen rezultate konkrete. Në veçanti dy janë problemet që duhen adresuar sa më herët, për të përshpejtuar progresin. Ato janë: ekspertiza e pamjaftueshme teknike për të siguruar instrumentet e nevojshme për implementimin e regjimit të IT dhe gjendja e rënduar e statistikave kombëtare ekonomike. Problemi i parë është adresuar nëpërmjet ekspertizës teknike të institucioneve ndërkombëtare si FMN. Megjithatë, për të siguruar një progres të qëndrueshëm në kohë, po merret në shqyrtim dhe një strategji për zhvillimin e kapitalit njerëzor brenda bankës. Përsa i përket pengesave lidhur me të dhënat statistikore, janë ndërmarrë disa hapa për të përmirësuar burimet e këtyre të dhënave si: kryerja e vrojtimeve, intervistave si dhe ndihmesa dhënë INSTAT-it për të përmirësuar frekuencën dhe cilësinë e statistikave të llogarive kombëtare.

6. RREZIQE TË TJERA NË ADOPTIMIN E REGJIMIT TË IT

Edhe sikur Banka e Shqipërisë të arrijë ta vërë veten në pozita për ta adoptuar në mënyrë eficiente regjimin e IT, ekzistojnë probleme të tjera jashtë kontrollit të saj që mund të pengojnë arritjen e objektivit [të inflacionit]. Këtu mund të përfshihen ndryshimet e çmimeve administrative dhe reformat strukturore në përgjithësi, mungesa e disiplinës fiskale, dollarizimi, ulja e të ardhurave nga emigrantët si dhe luhatshmëria e mundshme e kursit të këmbimit, zhvillimi dhe stabiliteti i sistemit financiar etj..

Çmimet e kontrolluara nga qeveria mund të përbëjnë një kërcënim për arritjen e objektivit të inflacionit të shpallur. Ky

fenomen ka shkaktuar probleme për Bankën e Shqipërisë edhe në të kaluarën. Një zgjidhje e këtij problemi mund të jetë shënjestrimi i inflacionit, bazuar në një shportë që lë jashtë çmimet administrative. Megjithatë, kjo e bën objektivin më pak të qartë për publikun. Një zgjidhje tjetër mund të kërkojë që qeveria të ketë një plan më të saktë për liberalizimin e çmimeve në mënyrë që BANKA E SHQIPËRISË të përshtasë më mirë objektivin final në përputhje me këtë plan.

Autorë të ndryshëm (Masson et al., 1997; Stone, 2003) kanë theksuar rëndësinë e disiplinës fiskale në suksesin e regjimit IT. Edhe pse disiplina fiskale, deri më tani, ka ndihmuar në uljen e inflacionit në Shqipëri, në të ardhmen probleme të ndryshme, sidomos ato që lidhen me disa reforma strukturore, mund të detyrojnë qeverinë ta zbusi disi këtë disiplinë. Ndërmjet këtyre problemeve vlen të përmendet mënyra se si do të zbatohet ligji i kompensimit të pronarëve të tokave. Në qoftë se qeveria do të mbulojë shumicën e shpenzimeve të kompensimit nga buxheti i saj, kjo do të krijojë presione jo të vogla inflacioniste.

Një shkallë e lartë e zëvendësimit të monedhës (euroizim, dollarizim) mund të shkaktojë probleme serioze për IT (Mishkin, 2000). Dollarizimi i pjesshëm mund ta bëjë regjimin e IT-së, që kërkon zbatimin e një kursi këmbimi të luhatshëm, të cënueshëm ndaj paqëndrueshmërisë financiare (Mishkin dhe Sevastano, 2002). Në Shqipëri shkalla e dollarizimit, e llogaritur si raport i depozitave në valutë ndaj aktiveve gjithsej të sistemit bankar, është rreth 20-30 për qind. Problemet lidhur me dollarizimin duhet të trajtohen me kujdes, duke konsideruar dhe mundësinë e rënies së të ardhurave nga emigrantët. Këto të fundit, deri tani kanë krijuar një shtresë mbrojtëse ndaj ndikimit të përkeqësimit të deficitit të llogarisë korente si dhe kanë siguruar një kurs këmbimi relativisht të qëndrueshëm. Një sistem financiar i shëndoshë është i rëndësishëm për suksesin e IT, për disa arsye. Një sistem financiar i shëndoshë mund të përballojë më lehtë ndikimet negative të luhatshmërive të mundshme të kursit të këmbimit, që mund të vijnë si pasojë e euroizimit/dollarizimit të lartë.

Gjithashtu, duke marrë parasysh objektivat e ndryshëm të ndjekur nga Banka e Shqipërisë, është e rëndësishme të shqyrtohet nëse Banka e Shqipërisë rrezikon ta respektojë objektivin e inflacionit në rast se ai konflikton me arritjen e objektivave të tjerë si stabiliteti financiar. Një sistem financiar i shëndoshë do ta vinte Bankën e Shqipërisë nën një presion më të vogël për të sakrifikuar njërin objektiv për tjetrin.

Zhvillimi i sistemit financiar është gjithashtu një faktor kryesor për drejtimin e politikës monetare. Niveli aktual i zhvillimit të sistemit financiar në Shqipëri është i pamjaftueshëm për të realizuar një politikë monetare efektive. Aktualisht, shkalla e konkurrencës midis bankave është mjaft e ulët, ndërkohë që tregjet e parasë dhe bursat janë praktikisht joekzistente. Kështu që, mbetet shumë për t'u bërë për të rritur thellësinë e sistemit financiar veçanërisht atë të bursave dhe të tregjeve të parasë.

Privatizimi i kohëve të fundit i Bankës së Kursimeve pritet të nxisë konkurrencën e sistemit bankar shqiptar dhe të zgjerojë kredinë për ekonominë. Megjithatë, ekziston një shqetësim rreth mundësisë së një zgjerimi "të tepruar" të kredisë, duke parë përvojën e disa vendeve të tjera në tranzicion (Cottarelli etj., 2004). Kjo është një çështje shumë kritike e cila meriton vëmendje të veçantë dhe shqyrtim të mëtejshëm (shiko box 1).

Megjithëse Mishkin dhe Sevastano (2002) argumentojnë se problemet e sipërpërmendura janë të rëndësishme edhe për regjimet e tjera të politikave monetare, nën një regjim IT kostoja e lidhur me vënien në rrezik të reputacionit të bankës qendrore mund të jetë shumë më e lartë.

Box 1: Rritja e mundshme e kreditimit.

Rritja e shpejtë e kreditimit, i cili jo shumë kohë më parë konsiderohej si një arritje e madhe, sot është kthyer në një shqetësim për vendet në tranzicion, përfshirë Shqipërinë e cila deri më sot ka mbetur mbrapa. Vëllimi i kredisë për sektorin privat në Shqipëri në përqindje të PBB-së ka mbetur pothuajse i pandryshuar që nga fillimi i tranzicionit deri kohët

e fundit, në nivelin prej rreth 6 për qind. Kultura e pazhvilluar e biznesit dhe transparenca e ulët e ndërmarrjeve private të sapongritura, duket se kanë qenë pengesë kryesore për zgjerimin e aktiviteteve kredituese të bankave. Probleme të tjera që lidhen me të drejtat e pronësisë, me zbatimin e ligjit dhe me infrastrukturën e dobët në Shqipëri kanë ndikuar gjithashtu, në këtë rezultat. Mangësitë që karakterizuan bankat shtetërore çuan në akumulimin e një sasie të madhe të kredive me probleme të dhëna nga këto banka. Kjo detyroi autoritetet rregullatore të marrin fillimisht masa shtrënguese dhe pastaj të bllokojnë plotësisht aktivitetet e tyre kredituese. Në pamje të parë, vonesa e krijuar në privatizimin e bankave shtetërore, që mund të ketë mundësuar lirimin e fondeve të tyre për kreditim, duket se ka qenë arsyeja kryesore e nivelit të ulët të kreditimit në Shqipëri. Megjithatë, bankat private që nuk u kufizuan nga autoritetet rregullatore nuk i kanë kanalizuar një pjesë të mirë të fondeve të tyre në kredi tregtare.

	2002	2003	2004 –T1	2004 –T2	2004 –T3	2004 –T4
Kredia e brendshme ndaj M3 (%)	70.8	71.5	71.6	69.5	67.4	68.7
- për qeverinë	61.5	60.2	59.9	57.1	54.9	55.0
- për ekonominë	9.3	11.3	11.7	12.3	12.5	13.7
Kredia për ekonominë si % ndaj totalit të aktiveve	11.5	13.7	13.7	14.6	14.7	16.6
Raporti kredi/depozita (%)	13.5	15.7	15.8	16.6	16.8	18.8
Kredia për ekonominë (% ndaj PBB)	5.7	6.8	6.3	6.7	7.2	8.2

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të rritur nivelin e ndërmjetësimit në sistemin bankar. Kjo ka konsistuar në sqarimin e kuadrit rregullator, që rregullon aktivitetin kreditues të bankave dhe në disa masa që janë marrë tashmë në lidhje me heqjen e shumave fikse të detyrueshme të kolateralit për kredinë. Tani, është përgjegjësi e bankës për të gjykuar lidhur me nevojën e kolateralit dhe për t'u siguruar që vlera e tij të jetë e përshtatshme për të mbuluar shumën e kredisë dhe çdo kosto tjetër që lidhet me ekzekutimin e saj. Megjithatë, në çdo rast, ne do të këmbëngulim që bankat t'i ruajnë në nivele të larta dhe t'i forcojnë proceset e tyre të administrimit të kredisë, në mënyrë që të sigurohet një rritje e balancuar dhe e shëndoshë e aktivitetit. Nisur nga përbërja e portofolit të huave, që kryesisht janë akorduar në valutë, bankat janë të detyruara t'i kushtojnë vëmendje të veçantë fluksit të parasë së huamarrësve të tyre, meqë ai mund të mos shprehet në të njëjtën monedhë me atë të kredisë. Çdo ndryshim i disfavorshëm dhe i papritur në kursin e këmbimit mund të sjellë vështirësi, nëse nuk parashikohet në kohë.

Nga ana tjetër, Banka e Shqipërisë është përpjekur të nxisë kreditimin në monedhën vendase. Midis të tjerash, ajo do të përmirësojë efektivitetin e mekanizmit të transmetimit të politikës monetare. Duke parë në një këndvështrim mikrofinanciar më të gjerë, Banka e Shqipërisë ka kontribuar për këtë qëllim duke e ulur normën e repos në nivele të ulëta historike dhe duke e ngushtuar diferencën e normave të interesit të kredive në lekë me atë në valutë.

Megjithë zbutjen e politikës monetare dhe uljen e normës zyrtare të interesit (norma e repos është ulur me 3.25 pikë përqindjeje gjatë dy viteve të fundit), spread-i i normave të interesit të kredive në lek/valutë, mbetet i dukshëm. Një faktor tjetër që mbështet interesin për kredinë në valutë është natyra e aktivitetit të biznesit. Sipas statistikave, sektorët më të kredituar operojnë në shumicën e rasteve në valutë. Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të mbështesë rritjen e kreditimit në lekë të ekonomisë. Parashikojmë që Banka Raiffeisen të kontribuojë në një zgjerim më të madh të kreditimit në lekë duke ditur se ajo zotëron 67 për qind të depozitave në lekë të sistemit bankar. Me një fjalë, 86 për qind e depozitave në këtë bankë janë në lekë.

Lidhur me rritjen e kreditimit për periudhën afatmesme, Banka e Shqipërisë do të vazhdojë përpjekjet për ta nxitur atë akoma më shumë edhe gjatë vitit 2005, meqë Banka Raiffeisen filloi aktivitetin e saj kredites dhe i shton tregut më tepër shërbime. Megjithatë, ndikimi i këtij ndryshimi në kreditimin e përgjithshëm bankar në sektorin privat është i kushtëzuar nga pasiguri të ndryshme, që kanë të bëjnë me evoluimin e mjedisit institucional dhe ligjor në të cilin zhvillohet aktiviteti kredites. Probleme në rregulloret dhe praktikat që prekin të drejtat e kreditorëve, përkeqësojnë kushtet e rrezikut në ekonomi, duke e bërë të vështirë vlerësimin e shpejtësinë me të cilën përhapet shtrirja e kreditimit.

Disa vlerësime paraprake, të bazuara në ecurinë e rritjes së kreditimit gjatë tre viteve të fundit dhe në parashikimet e rritjes së kreditimit të bëra nga Banka Raiffeisen, si dhe në njëfarë shkalle, zëvendësimi me rritjen e kreditimit të bankave të tjera, tregojnë një rritje vjetore të kreditimit në sektorin privat në shumën prej rreth 30-35 miliardë lekësh ose 45-50 për qind, për vitin 2005.

Rritja e kreditimit në periudhën afatmesme mendohet të stabilizohet me rreth 3-4 pikë përqindjeje të PBB-së në nivel vjetor. Kjo është nën

kufirin kritik prej 5 për qind. Megjithatë, ne marrim parasysh gjithashtu edhe mundësinë e asaj që ka ndodhur në vendet e tjera të rajonit. Për këtë qëllim, janë marrë disa masa për të depërtuar më thellë në tregun e strehimit, i cili ka njohur një rritje të konsiderueshme të çmimeve dy vitet e fundit. Nëse kreditimi bankar zgjerohet me shpejtësi drejt kredive për strehim, rreziku është se kjo mund të çojë në një skemë spekulative të rrezikshme.

Nga njëra anë, nëse pjesa më e madhe e kredisë jepet në valutë të huaj, për bankën tonë do të jetë e vështirë të tkurrë zgjerimin e kësaj kredie, dhe ndoshta do të aplikojë disa lloje masash direkte, që do të thotë një hap mbrapa për politikën monetare. Nga ana tjetër, ajo do të aplikojë shtrëngime ndaj mbikëqyrjes bankare për të siguruar qëndrueshmërinë e sektorit bankar në rast se do të ketë një rënie të mundshme të çmimeve të strehimit.

(Bazuar në materiale të ndryshme të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe të Departamentit të Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë.)

7. REGJIMET ALTERNATIVE

Alternativat e tjera ndaj targetimit të inflacionit dhe atij monetar janë fiksimi i kursit të këmbimit dhe e ashtuquajtura politika *just to do it* që zbaton Rezerva Federale - FED (Mishkin, 2002). Efekti përçues i kursit të këmbimit në Shqipëri mendohet të jetë i lartë, ndonëse asimetrik, duke patur parasysh pjesën e konsiderueshme që zënë mallrat e importit në shportën e konsumatorit (afërsisht 70%). Kjo të bën të mendosh që ky regjim mund të jetë një mënyrë efektive për të drejtuar politikën monetare. Megjithatë, fiksimi i kursit të këmbimit deri më sot është hedhur poshtë si një strategji e përshtatshme për Shqipërinë, për një sërë arsyesh. Fillimisht, për shkak të rezervave ndërkombëtare të pamjaftueshme, dhe më vonë prej rrezikut të mbiçmimit të kursit real të këmbimit, sidomos kur faktorët bazë të përcaktimit të tij janë ende të panjohur. Megjithëse mendojmë se lënia e përcaktimit të kursit të këmbimit nga forcat e lira të tregut është strategjia më e mirë për t'u ndjekur, në rrethana të caktuara ndërhyrja mund të jetë një mënyrë efektive për të frenuar

inflacionin, sidomos kur vërehen spirale midis zhvlerësimit të kursit të këmbimit dhe pritshmërive të pabazuara inflacioniste. Megjithatë, në rastet kur burimi i presionit inflacionist është i natyrës strukturore, një strategji e tillë mund të shkaktojë më shumë probleme sesa përfitime.

Megjithatë, shumica e diskutimeve mbi kursin e këmbimit i referohen skenarëve për të kontrolluar zhvlerësimin, me qëllim frenimin e inflacionit të lartë. Por, prej kohësh Shqipëria ashtu si disa nga vendet e tjera të tranzicionit po vëren një vlerësim të monedhës së saj. Ndërkohë që kjo ka ndihmuar në zbutjen e presioneve inflacioniste, shqetësimi për uljen e aftësisë konkurruese të jashtme ka ardhur duke u rritur. Kjo ka bërë që Banka e Shqipërisë të ndërhyjë herë pas here në treg dhe të ulë normat e interesit në monedhën vendase, për të parandaluar mbiçmimin "e tepruar" të lekut në terma nominalë, kundrejt euros. Megjithatë, mbetet e paqartë nëse ky mbiçmim është një kthim në një ekuilibër afatgjatë të mbështetur në faktorë bazë. Diskutimi i mësipërm tregon se zhvillimet e kursit të këmbimit nuk mund të injorohen kaq lehtë në vendimmarrjen e politikës monetare, edhe në kushtet e ndjekjes së regjimit të luhatjes së lirë.

Strategjia tjetër *"just do it"* mund ta karakterizojë jo keq politikën aktuale monetare të ndjekur në Shqipëri. Megjithëse Banka e Shqipërisë ka një objektiv monetar të deklaruar dhe

një objektiv inflacioni të nënkuptuar, siç u përmend dhe më lart, mënyra e drejtimit të politikës monetare ka shumë elemente diskrete brenda saj për të arritur objektivin kryesor të inflacionit të ulët, duke lënë mundësinë e përshtatjeve ndaj goditjeve të ofertës. Përkrahësit e këtij regjimi kundërshtojnë kalimin e ShBA nga ky regjim drejt një regjimi formal IT duke argumentuar që, "përsa kohë që funksionon s'ke pse rregullon". Megjithatë, në rastin e Shqipërisë ruajtja e efektivitetit të kësaj strategjie për një kohë të gjatë mund të jetë e dyshimtë, nëse konsiderojmë faktin që Banka e Shqipërisë nuk gëzon të njëjtën shkallë reputacioni si dhe FED. Sipas Stone (2003) në këtë regjim mund të kalohet vetëm pasi është zbatuar një regjim formal IT dhe është shumë e vështirë dhe e rrezikshme për një vend në zhvillim të kalojë direkt në këtë regjim.

8. KONKLUZIONE

Mbështetja e Shqipërisë në regjimin e kontrollit monetar, edhe pse deri më sot duket të mos ketë përjetuar ndonjë problem serioz, mund jetë e pamjaftueshme për të ruajtur inflacionin e ulët në të ardhmen. Veçanërisht, fuqia sinjalizuese e agregatëve monetarë të targetuar nga Banka e Shqipërisë mund të fillojë të hasë vështirësi. Ndaj duhen konsideruar regjime alternative si ai IT, të cilët mund të transmetojnë më mirë sinjalet e bankës qendrore. Megjithatë, edhe regjimet alternative nuk janë pa probleme. Në rastin e regjimit IT, për shkak të rritjes së shkallës së qartësisë dhe të të kuptuarit të objektivit të synuar, ekziston një rrezik më i lartë që reputacioni i bankës qendrore të dëmtohet në rastin e mosarritjes së objektivit, krahasuar me regjimet e tjera. Për këtë arsye, zbatimi i tij duhet të mbajë parasysh të gjitha kërkesat e nevojshme teknike si dhe skenarët e pafavorshëm, që mund të vënë në rrezik suksesin e këtij regjimi.

Nga analiza jonë e shkurtër konkludohet se megjithë problemet që Banka e Shqipërisë mund të ndeshë në plotësimin e kërkesave të regjimit të ri, në periudhën afatmesme implementimi i tij mbetet i mundshëm, me kushtin që ndërkohë puna në këtë drejtim të intensifikohet.

SHËNIME

* Fatos Ibrahimi, Zëvendësguvernator i Parë, Banka e Shqipërisë.
Erjon Luçi, Drejtor, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë.
Pikëpamjet e shprehura në këtë kumtesë janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.

BIBLIOGRAFIA

Bernake, S. B. dhe Mishkin, F. (1997) "Inflation Targeting: A New Framework for Monetary Policy?" (Targetimi i inflacionit: Një kuadër i ri për politikën monetare?), Journal of Economic Perspective, Vol. 11, No. 2, pp. 97-116.

Cukierman, A. dhe Liviatan, N. (1992) "The Dynamics of Optimal Gradual Stabilisation." (Dinamikat e stabilizimit gradual optimal), World Bank Economic Review, Vol. 6, pp. 439-58.

Cotarrelli, C., Dell' Ariccia, G. dhe Vladkova-Hollar, I. (2004) "Early Birds, Late Risers, and Sleeping Beauties: Bank Credit Growth to Private Sector in Central and Eastern Europe and the Balkans." IMF Working Paper, No. 03/313, International Monetary Fund, Washington DC.

Çeliku, E. (2005), "Inflacioni bazë: matja dhe lidhja e tij me agregatët monetarë", Material Diskutimi, Banka e Shqipërisë.

Estrella, A. dhe Mishkin, F. (1997) "Is there a role for monetary aggregates in the conduct of monetary policy?" (A ekziston një rol për agregatët monetarë në drejtimin e politikës monetare?) Journal of Monetary Economics, Vol. 40, pp. 279-304.

Luçi, E. (1999) "Central bank independence of the transition economies", dissertation MA Economics, Staffs. Uni. UK.

Masson, P. R., Sevastano, M. A. dhe Sharma, S. (1997) "The Scope of Inflation Targeting in Developing Countries" (Sfera e targetimit të inflacionit në vendet e zhvilluara), IMF Working Paper No. WP/97/130, International Monetary Fund, Washington DC.

Mishkin, F. (2000) "Inflation Targeting in Emerging-Market Countries" (Targetimi i inflacionit në vendet me tregje në zhvillim), American Economic Review, Paper and Proceedings, Vol. 90, No. 2, pp. 105-109.

Mishkin, F. dhe Sevastano, M. A. (2002) "Monetary Policy Strategies For Emerging Market Countries: Lessons From Latin America" (Strategjitë e politikës monetare për vendet me tregje në zhvillim), Comparative Economic Studies, Vol. 54, No. 2, pp. 45-82.

Mishkin, F. S. (2002) "Monetary Policy" (Politika monetare), NBER Reporter Winter.

Sojli, E. (2004) "An evaluation of currency substitution in the Albanian economy" (Një vlerësim i zëvendësimit të monedhës në ekonominë shqiptare), forthcoming, Bank of Albania, Working Paper.

Stone M. R. (2003) "Inflation Targeting Lite" (Pikëpamje mbi targetimin e inflacionit), IMF Working Paper No. WP/03/12, International Monetary Fund, Washington DC.

Svenson L. E. O. (1997) "Inflation Forecast Targeting: Implementing and Monitoring Inflation Targets." (Targetimi i parashikimit të inflacionit: Implementimi dhe monitorimi i objektivave të inflacionit), NBER Working Paper No. 5797.

Taylor, J. (1985) "What Would Nominal GDP Targeting do to the Business Cycle?" (Çfarë do t'i sillte targetimi i PBB-së nominale ciklit të biznesit?), In Carnegie-Rochester Conference series on Public Policy. Vol. 22, North-Holland, Amsterdam. pp. 61-84.

SINJALET E BANKËS SË SHQIPËRISË, INFLACIONI I PRITUR NGA PUBLIKU PËRBALLË ATIJ TË FAKTUAR PËR VITIN 2004

*Evelina Çeliku**
Rezarta Nasto

Fjalë kyçe
- Inflacioni i perceptuar - Pritjet e bizneseve - Pritjet e konsumatorëve - Indeksim i pagave -

1. HYRJE

Një nga çështjet e rëndësishme për të cilën politika monetare e një banke qendrore duhet të jetë e qartë para dhe gjatë aplikimit të vendimeve të marra për shqyrtimin e qëndrimit të saj, lidhet me faktin se si dhe sa agjentët ekonomikë, biznesi dhe popullata në përgjithësi, i thith dhe i kupton sinjalet që ajo "lëshon" gjatë procesit të vendimmarrjes.

Eficienca e politikës monetare, sidomos në kushtet e regjimit të "Inflacionit të Synuar" *(Inflation Targeting)*, lidhet ngushtë me kanalin e komunikimit me publikun. Publiku dhe bizneset jo vetëm i thithin sinjalet duke i përdorur ato për të parashikuar situatën financiare në vijim, por nga ana tjetër, me sjelljen apo perceptimet e tyre në treg, krijojnë disa inerci apo nxitje që ndikojnë mbi politikën monetare dhe aspekte të tjera të jetës ekonomike të vendit, për të ardhmen.

Sa e lartë është shkalla e kuptueshmërisë së këtyre sinjaleve nga ana e biznesit që ushtron veprimtari ekonomike në fushat e prodhimit, të ndërtimit dhe shërbimeve apo edhe nga ana e publikut shqiptar në rolin e thjeshtë të konsumatorit? Për t'i dhënë përgjigje një pyetjeje të tillë do të mbështetemi

tek analiza e disa informacioneve të marra gjatë vrojtimit të bizneseve dhe konsumatorëve, në rubrikën e veçantë të ngritur për këtë qëllim në pyetësorët përkatës të indekseve të besimit (IBB dhe IBK). Informacioni i marrë nga rreth 540 biznese dhe nga rreth 1200 konsumatorë, përqendrohet në opinionet e tyre në lidhje me pyetje të tilla si: "si perceptohen informacionet e Bankës së Shqipërisë nga publiku?"; "a ndikojnë informacionet e publikuara për inflacionin në nivelin e pritjeve të ardhshme inflacioniste?"; "çfarë sugjerojnë vrojtimet në lidhje me mënyrën e formimit dhe përdorimin e pritjeve të agjentëve në vendimet e tyre financiare?".

Me këtë përpjekje do të donim të kuptonim nëse historia e inflacionit të viteve të fundit, e cila dëshmon për një normë vjetore të ulët dhe të qëndrueshme të tij (grafik 1), është përçuar dhe në pritjet e biznesit dhe publikut.

Pra, në njëfarë mënyre do të donim të gjykonim mbi shkallën e besimit të publikut dhe të bizneseve ndaj vendimeve që merr banka qendrore. Nëse situata do të rezultonte pozitive (pra që Banka gëzon besim të kënaqshëm), a i mbështesin aktorët e tregut (bizneset dhe konsumatorët) këto vendime duke i asimiluar në drejtimin e duhur efektet ekonomike të tyre?

Grafik 1. Ecuria e inflacionit në Shqipëri (1995-2004).



2. ANALIZA E REZULTATEVE

Rezultatet e vrojtimit karakterizohen nga një asimetri midis pritjeve mbi inflacionin, bazuar në masën e pritur të rritjes së pagave që këto dy grupe të publikut shqiptar parashikonin të kishin gjatë vitit 2004 (pyetje 3, tabelë 1). Deri-diku, kjo është e pritshme, për sa kohë që konsumatorët dhe bizneset përbëjnë dy grupe të ndryshme interesi ekonomik në treg.

Për vitin 2004, konsumatorët prisnin një rritje mesatare të pagave në masën rreth 7.9 për qind, ndërkohë që bizneset arsyetonin se kjo rritje mund të shkonte rreth 4.2 për qind. Nëse krahasohen shpërndarjet e pritjeve (grafik 2) ndërmjet këtyre dy grupeve ekonomike, bie në sy përqendrimi i tyre drejt intervaleve skajore, ndërkohë që pritjet e bizneseve gjenden të grumbulluara në intervalin 1-5 për qind. Këtë e dëshmojnë edhe vlerat e devijimeve standarde për grupet përkatëse.

Grafik 2. Rritja e parashikuar e pagave (2004)
Konsumatorët, Bizneset.



Megjithatë, nëse gjykojmë mbi shkallën e variacionit, ajo paraqitet pothuaj e njëjtë, madje në nivele të larta, si te konsumatorët ashtu edhe tek bizneset (rreth 46 për qind). Kjo do të thotë që pritjet mesatare për rritje të mundshme të pagave gjatë vitit 2004 duhen konsideruar me rezerva, nisur nga gjykimi i këtyre aktorëve.

Tabelë 1. Rezultatet e përpunimit të përgjigjeve.

PYETJET E RUBRIKËS SË VEÇANTË	PËRGJIGJET E KONSUMATORËVE	PËRGJIGJET E BIZNESEVE
1 Frekuenca e rishikimit të pagave		
a. Çdo vit	65.4%	24.4
b. Çdo 2 vjet	3.8%	7.14
c. Mbi çdo 2 vjet	1.1%	12.6
d. Nuk ka një politikë të përcaktuar	29.7%	56.0
2 Faktorët nxitës për rritjen e pagave	(shkalla mesatare e rëndësisë)*	(shkalla mesatare e rëndësisë)
a. Rritja e parashikuar e çmimeve	4.3	2.6
b. Rritja e çmimeve në të kaluarën	3.9	2.3
c. Vjetërsia në punë	3.2	3.2
d. Nxitja e përkushtimit në punë	3.7	3.7
e. Rritja e pagave nga konkurrentët	N/A	3.1
f. Rritja e pagave në sektorin publik	N/A	2.6
3 Rritja aktuale e parashikuar për vitin 2004		
a. 0%	29.2 (0.0)** %	31.8 (0.0) %
b. 1 - 5%	18.6 (26.3) %	50.4 (73.9) %
c. 5 - 10%	29.8 (42.1) %	17.8 (26.1) % (Mbi 5%)
Mbi 10%	22.4 (31.6) %	N/A
Tregues statistikorë të shpërndarjes***		
Rritja mesatare e parashikuar	7.89 %	4.17 %
Devijimi standard i rritjes mesatare	3.61	1.97
Koeficienti i variancës (në %)	45.7 (%)	47.19 %
4 Informacionet më të ndjekura të Bankës së Shqipërisë	(shkalla mesatare e rëndësisë)	(shkalla mesatare e rëndësisë)
a. Rritja e çmimeve	4.0	3.3
b. Normat e interesit	2.6	3.2
c. Kursi i këmbimit	2.7	3.9

Shënim:
*Sa më e lartë shkalla mesatare e rëndësisë, aq më i rëndësishëm është faktori në raport me faktorët e tjerë të listuar. Shkalla mesatare e rëndësisë është matur si mesatare e ponderuar e vlerës së shkallës me frekuencën përkatëse (numri i personave që e kanë zgjedhur atë).
**Në kllapa janë vendosur peshat në për qind të normalizuara, pas përjashtimit të grupit (a).
***Në llogaritjen e treguesve statistikorë mbi pritjet për rritje pagash, janë marrë parasysh vetëm alternativat që janë shprehur për rritje pagash, sepse grupi që shprehet për një rritje zero për qind është një grup cilësisht i ndryshëm nga të tjerët.

Nëse do t'i referoheshim vlerësimeve për prirjen historike të rritjes së pagave në sektorin privat, duket qartë që pas vitit 1999, bizneset private kanë aplikuar rritje mesatare vjetore që luhaten rreth vlerës 10 për qind. Po të supozonim se kjo rritje do të vijonte me të njëjtat ritme edhe për periudhën 2003-2004, duket se pritjet për rritje pagash, për të dyja grupet, gjenden brenda vlerave historike.

Tabelë 2. Pagat sipas sektorëve.

Aktiviteti ekonomik	Viti					
	1997	1998	1999	2000	2001	2002
Industri	9411	10792	12203	13230	14839	15882
Ndërtim	8340	10617	10936	12489	13416	15014
Transport e komunikacion	9350	11744	14503	16225	18124	23434
Tregti	8819	9653	10901	10889	12856	13924
Shërbime	7814	11856	10718	13012	13140	14453
Gjithsej	9063	10894	12118	13355	14820	16541
Rritja (në %)		20.2	11.2	10.2	11.0	11.6

Burimi:www.instat.gov.al, ASN 1997-2002.

Analiza e renditjes së faktorëve që do të ndikonin në një rritje potenciale të pagave tregon se:

- "inflacioni i perceptuar", është faktori parësor, sipas konsumatorëve, që do të shtynte këtë rritje. Ky është një fakt që përputhet edhe me teorinë ekonomike të ngritur mbi sjelljen konsumatore. Prania e inflacionit të perceptuar tregon se ekziston njëfarë inercie nxitëse në rritje në shifrat e inflacionit, për shkak të rritjes së pritjeve të konsumatorit;

- rritja e çmimeve në periudhat e kaluara, pa dyshim duhet të reflektohet në treguesin aktual të inflacionit dhe që sipas konsumatorëve duhet të pasqyrohet në rritjen e pagave;

- përdorimi i rritjes së pagës mbetet element nxitës në punë apo si vlerësues i punës nga ana e konsumatorëve;

- rritja e pagës për shkak të vjetërsisë në punë, përsëri konsiderohet nga konsumatorët, si element që duhet të shoqërojë skemën e pagave, në të dy sektorët, publik dhe privat.

Nëse dy faktorët e parë do të kishin një peshë disi më të ulët se sa pesha e vlerës aktuale (përkatësisht 0.3 dhe 0.15) atëherë rritja e pagave për shkak të inflacionit të pritshëm do të ishte rreth 1.88 për qind. Ndërkohë, për shkak të inflacionit aktual (nëntor 2003 = 3.4 për qind), i ponderuar me (0.55), inflacioni do të rezultonte në rreth 1.87 për qind. Pra në total, inflacioni i perceptuar nga konsumatori pritej të ishte rreth vlerës 3.7 për qind për vitin 2004. Kjo tregoi se pritjet e konsumatorëve për të rezultuan brenda bandës së dëshiruar nga banka qendrore.

Duket se perceptimi i inflacionit të lartë, i konsumatorëve ra disi ndesh përballë opinionit të bizneseve. Bizneset rritjen e pagave, e shihnin më shumë të lidhur me faktin që kjo e fundit shton nxitjen në punë. Nga ana tjetër, edhe bizneset (të gjitha të sektorit privat të ekonomisë) mbajnë parasysh që një rritje page i adresohet më shumë një përvoje më të lartë në punë. Konkurrenca dhe rritjet e pagave në sektorin publik, u listuan gjithashtu ndër faktorët që do ta ndikonin rritjen e pagave nga ana e bizneseve. Kjo politikë rezultoi të jetë larg problemit të indeksimit të pagave për efekt të rritjes së kaluar dhe të pritshme të çmimeve. Ajo deri-diku, reflektoi mungesën e rolit real të sindikatave në tregun e punës në Shqipëri. Pra, e drejta e negocimit dhe e rinegocimit u evidentua si mjaft e zbehtë dhe e pafuqishme.

Megjithatë, nëse do t'i ktheheshim, një llogaritjeje të ponderuar të rritjes së pagave për shkak të rritjes së çmimeve, do të vinim re që edhe vetë bizneset kanë patur një inflacion të perceptuar, për vitin 2004, ndonëse më të ulët se sa konsumatorët. Nëse faktorët ponderues për rritjet e pritshme (të inflacionit dhe të pagave në sektorin publik) dhe të kaluara të çmimeve do të ishin përkatësisht 0.2, 0.2 dhe 0.1 (sepse janë në fund të renditjes), atëherë inflacioni i perceptuar për grupin e bizneseve do të ishte rreth 1.27 për qind. Ndërkohë, për shkak të inflacionit aktual (nëntor 2003 = 3.4 për qind), i ponderuar me (0.5), ai do të rezultonte në rreth 1.7 për qind. Në total, inflacioni i pritur për vitin 2004, nga ana e bizneseve do të vlerësohej rreth 2.97 për qind.

Për të dyja grupet së bashku, duke ponderuar opinionet e tyre në lidhje me pritjet për inflacionin[2], inflacioni i pritshëm për vitin 2004, do të rezultonte rreth 3.4 për qind. Sinjal ky që tregonte se, ndonëse kjo kategori e inflacionit rezultonte brenda bandës 2-4 për qind, politika monetare gjatë vitit 2004, nuk duhej ta anashkalonte atë. Në fakt, duket qartë që gjatë procesit parashikues, ato janë konsideruar me shumë kujdes. Duke reflektuar mbi shifrën e faktuar të normës vjetore të inflacionit, e cila rezultoi në dhjetor 2004 vetëm 2.2 për qind, mund të vlerësojmë, rreth një vit më pas, se inflacioni rezultoi më i ulët

se sa pritej nga publiku dhe jo vetëm nga ky i fundit, por edhe nga parashikimet e fillimvitit (janar 2004), të vetë bankierëve qendrorë për të.

E rëndësishme është të verifikohet fakti se sa pritjet e publikut (konsumatorëve dhe bizneseve), do të gjejnë pasqyrim në inflacionin e vitit në vijim. Nisur nga prania e një fuqie të ulët negociuese gjatë vendosjes së pagave, mund të konkludojmë se kanali i transmetimit të pritjeve inflacioniste të publikut në nivelin e pagave e më pas të çmimeve, nuk është i plotë. Këtu mund të gjejë shpjegim edhe fakti që niveli i pritjeve nuk pasqyrohet plotësisht në nivelin aktual të inflacionit, pra që pritjet për inflacion më të rritur nga ana e publikut ekzitojnë në nivele relativisht të larta, por që ato nuk do të përcillen plotësisht nëpërmjet kanalit të të ardhurave.

Shpallja e një objektivi sasior mbi inflacionin nga ana e një banke qendrore, ndihmon në përmirësimin e konvergimit të pritjeve (Castelnuovo, Altimari & Palenzuela 2003)[3]. Kjo do të thotë, që në një të ardhme të afërt edhe publiku shqiptar, do të jetë më i orientuar në pritjet e tij për inflacionin, ndonëse kjo është pjesë e një procesi që në bazë ka besueshmërinë e tij ndaj Bankës së Shqipërisë, si edhe transparencën që kjo e fundit ka ndaj publikut.

Box 1: Vrojtimet e IBB dhe IBK dhe pritjet për inflacionin.

Grafiku 3 paraqet një përpjekje për shfrytëzimin e vrojtimeve të IBK dhe IBB për matjen e pritjeve inflacioniste të publikut. Nga grafiku vihet re një sfazim në tendencat e inflacionit të pritur dhe të atij faktik. Modifikimi i pyetësorit për inflacionin pritet të sjellë një pamje më të qartë të inflacionit të pritur nëpërmjet vrojtimeve[4]. Po kështu, rritja e numrit të vrojtimeve, do të mundësojë zbatimin e metodologjisë së kuantifikimit të pritjeve, mbi seri më të plota kohore duke i bërë ato më të besueshme.



Më tepër informacion lidhur me politikat e pagave në vendin tonë na ofron pyetja 1 mbi frekuencën e rishikimit të pagave. Nga rezultatet e vrojtimit del se përgjithësisht firmat nuk zbatojnë politika të përcaktuara indeksimi, dhe kjo është veçanërisht e theksuar në industrinë e ndërtimit, ku 70 për qind e bizneseve raportojnë mungesën e politikave të rishikimit. Edhe këtu vërehet një asimetri ndërmjet konsumatorëve dhe punëdhënësve. Kështu, konsumatorët në masën 65.4 për qind shprehen për nevojën e indeksimit me bazë vjetore, ndërkohë që mesatarisht 56 për qind e bizneseve raportojnë mungesën në realitet të politikave të indeksimit.

Zgjedhja e indeksimit me bazë vjetore nga ana e konsumatorëve mund të jetë shprehje e një lloj pasigurie për të ardhmen apo e njohjes së praktikave vjetore të indeksimit në sektorin publik. Mospërputhja me opinionin e bizneseve dëshmon edhe një herë për forcën e ulët negociuese në tregun e punës.

Opinionet e publikut (konsumatorëve dhe bizneseve) sugjerojnë se në mungesë të politikave të indeksimit apo në praninë e politikave me bazë vjetore, ekziston një shkallë e lartë fleksibiliteti pagash. Ky fakt mund të përbëjë njëfarë interesi për

politikën monetare të Bankës së Shqipërisë, meqënëse në kushtet e pritjeve të ankoruara, efektet e politikës së saj monetare do të mund të transmetoheshin më shpejt në nivelin e pagave dhe për rrjedhojë, në nivelin e çmimeve.

Duket një sinjal pozitiv fakti që del nga pyetja 4, se inflacioni i publikuar është një informacion, i cili ndiqet rregullisht nga konsumatorët. Ai renditet i pari ndër treguesit për të cilët konsumatori shqiptar është më i interesuar. Ky informacion mbështet faktin se nga njëra anë, aspekti edukativ i Bankës së Shqipërisë ka ardhur duke u rritur nga njëri vit në tjetrin dhe nga ana tjetër, duket se do të jetë, pikërisht, ky publik i përgatitur në të ardhmen e afërt që do të mund të bëhet pjesë aktive në kuptimin e sinjaleve që politika monetare "do të lëshojë".

Megjithëse edhe nga bizneset treguesi i inflacionit është mjaft i ndjekur, ai renditet pas kursit të këmbimit. Interesimi i lartë i bizneseve në drejtim të kursit të këmbimit është i shpjegueshëm me rëndësinë e tij në përcaktimin e kostove, sidomos për bizneset që kanë aktivitet importi. Ndërkohë që informacioni mbi normat e interesit është me interes për faktin e ndikimit që ato kanë në nivelin e kredimarrjes për biznesin.

Përsa i takon informacionit mbi normat e interesit duket se konsumatorët janë ende larg tij. Familjariteti i kufizuar i publikut shqiptar me këto norma gjykohet se është i lidhur me kreditimin aktualisht të kufizuar në ekonominë shqiptare dhe me mungesën e një tregu aktiv financiar.

3. KONKLUZIONE

Në këtë analizë janë trajtuar disa ide paraprake mbi pritjet për inflacionin dhe perceptimet e publikut në lidhje me këtë tregues. Sugjerojmë se ato mund të shërbejnë si pikë krahasimi për studime të mëtejshme në këtë drejtim.

Asimetria ndërmjet pritjeve të konsumatorëve dhe atyre të bizneseve, lidhet me interesat e ndryshëm që këto grupe kanë

në treg. Nga ana tjetër, analiza verifikon se tregu i kontratave të punës është në favor të punëdhënësve, duke evidentuar aspektin krejtësisht të zbehtë të sindikatave. Problemi i indeksimit të pagave përballë rritjes së pritshme të çmimeve nuk mbështetet nga bizneset, ndërkohë që kërkohet nga konsumatorët.

Kjo bën që kanali i transmetimit të pritjeve inflacioniste të publikut në nivelin e pagave e më pas të çmimeve, të mos jetë i plotë.

Inflacioni i pritshëm i perceptuar për vitin 2004, do të rezultonte rreth 3.4 për qind, brenda kufijve të parashikuar nga banka qendrore. Krahasuar me inflacionin e faktuar, në fund të vitit 2004 (2.2 për qind), duket se pritjet rezultuan më të forta, fakt që verifikon deri-diku, mbivlerësimin e këtij treguesi nga ana e publikut.

Për Bankën e Shqipërisë si institucion përgjegjës i politikës monetare, është e rëndësishme njohja e nivelit të pritjeve inflacioniste dhe efektet e tyre në nivelin e çmimeve ose ndryshe, njohja e elementeve të spiralit pritje-pagë-çmime.

Ndërkohë që ky material sjell disa përfundime mbi hallkën e parë të këtij spirali, do të ishte me interes të çohej më tej studimi i hallkës së dytë, dhe më konkretisht, konsideratat mbi të cilat bazohet sjellja çmim-vendosëse e bizneseve, për të identifikuar rreziqet e mundshme me të cilat përballet ruajtja e stabilitetit të çmimeve në Shqipëri.

Është me interes për Bankën e Shqipërisë që ndjekja nga ana e publikut e treguesit të inflacionit, jep një sinjal shumë pozitiv për shkallën në rritje të njohjes së tij. Ndoshta, politika monetare e Bankës së Shqipërisë do të ishte në të njëjtën shkallë e interesuar edhe për njohjen nga ana e publikut të normave të interesit, fakt që nuk dëshmohet nga informacioni i sjellë nga kjo analizë. Janë sinjalet e dhëna nëpërmjet normave të interesit, të cilat përcjellin mesazhe për mbajtjen e inflacionit në nivelet e parashikuara.

Do të rekomandonim, që një pyetësor i tillë të aplikohej jo vetëm çdo tremujor për të evidentuar prirjet dhe për t'i vlerësuar ato nga pikëpamja sasiore, siç edhe realisht veprohet në vrojtimet e IBB dhe IBK, duke krijuar kështu hap pas hapi një seri pritjesh për inflacionin, por ai të ishte në fund të vitit, më sasior, për të marrë informacion specifik, vetëm për pritjet dhe burimet që do t'i krijonin ato gjatë vitit të ardhshëm. Vlerësime të tilla, do të ndihmonin në pasurimin e skenarëve parashikues për inflacionin duke qartësuar kanalin e pritjeve në skemën e transmetimit të politikës monetare.

SHËNIME

* Evelina Çeliku, Zëvendësdrejtore, Departamenti i Kërkimeve.
Rezarta Nasto, specialiste, Departamenti i Kërkimeve.
Në këtë analizë janë bërë përpjekjet e para për të vlerësuar nga pikëpamja sasiore pritjet për inflacionin si edhe janë evidentuar disa nga burimet kryesore të krijimit të tyre. Analiza është një reflektim mbi rezultate e përpunime treguesish për pritjet inflacioniste për vitin 2004, të rreth 1200 konsumatorëve dhe të 540 bizneseve[1] duke i krahasuar ato me shifrën e faktuar të inflacionit gjatë këtij viti.

[1] Vrojtimi i muajit dhjetor 2003 për indeksin e besimit të biznesit dhe të konsumatorit (IBB dhe IBK).

[2] Elementet ponderuese janë 0.3 për bizneset dhe 0.7 për konsumatorët (pesha e secilit grup ndaj totalit).

[3] Autorët e mbështetin këtë përfundim, për një numër vendesh të industrializuara.

[4] Detaje mbi metodën e përdorur për matjen e pritjeve nëpërmjet vrojtimeve, si dhe modifikimet e pritshme në zbatimin e saj mund të gjenden në materialin e brendshëm "Matja e pritjeve" (R.Nasto, DK).

LITERATURA

Banka e Shqipërisë, "Treguesit e besimit të biznesit dhe të konsumatorit", IBB dhe IBK, (2002-2004). Materiale të papublikuara.

Banka e Shqipërisë, Raport Statistikor, dhjetor 2004, www.bankofalbania.org.

Castelnuovo E., Nicoletti S., Rodriguez-Palenzuela R. (2003), "Definition of Price stability, range and point inflation targets: The anchoring of long term inflation expectations" ECB Working paper.273.

Nasto R., "Matja e Pritjeve" (2005), Material diskutimi në proces, Banka e Shqipërisë.

VLERËSIMI I STANDARDEVE TË SHPËRNDARJES SË STATISTIKAVE NË BANKËN E SHQIPËRISË

*Kliti Ceca**
Hilda Shijaku
Endrita Xhaferaj

Fjalë kyçe
- Statistika - GDDS - SDDS - Shpërndarje e të dhënave -

HYRJE

Kompilimi dhe shpërndarja e të dhënave ekonomike është bërë gjithnjë e më shumë një faktor përcaktues në vendimmarrjen ekonomike. Për më tepër, vendet që kërkojnë të hyjnë në tregjet ndërkombëtare të kapitaleve këshillohen të përmirësojnë shpërndarjen e të dhënave statistikore, pasi nëpërmjet tyre krijojnë siguri tek investitorët. Për rëndësinë që paraqet, procesi i shpërndarjes së të dhënave është bërë objekt vëmendjeje nga organizatat ndërkombëtare, të cilat kanë ndërtuar standarde bazuar në praktikat më të mira të vendeve lidhur me këtë proces.

Fondi Monetar Ndërkombëtar, në tetor të vitit 1995 filloi punën mbi ngritjen e standardeve lidhur me shpërndarjen e të dhënave ekonomike dhe financiare. Këto standarde konsistojnë në dy nivele: standardet e GDDS-it (Sistemi i Përgjithshëm i Shpërndarjes së të Dhënave)[1], në të cilin mund të merrnin pjesë të gjitha vendet anëtare të FMN-së dhe standardet e SDDS-it (Standardet Speciale të Shpërndarjes së të Dhënave)[2], për ato vende që operojnë ose që kërkojnë të hyjnë në tregjet ndërkombëtare të kapitalit. Të dyja standardet synojnë të përmirësojnë shpërndarjen e të dhënave të plota statistikore në

kohën e duhur dhe kështu të nxisin ndjekjen e politikave të mira makroekonomike. Përveç kësaj, standardet e SDDS-it pritet të nxisin një përmirësim në funksionimin e tregjeve financiare.

Shqipëria është anëtare e Projektit të GDDS-it që prej vitit 1999, duke u klasifikuar si vend pilot në këtë projekt. Nëpërmjet këtij sistemi është arritur përmirësimi i transparencës së institucioneve që prodhojnë statistika (ku përfshihen Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe INSTAT), janë vendosur përparësitë dhe planet për përmirësim lidhur me mangësitë që ekzistonin si dhe është përftuar asistenca e nevojshme në këtë drejtim. Për të vlerësuar praktikat lidhur me shpërndarjen e të dhënave statistikore shërbyen misionet e ROSC[3] (Raporti mbi Standardet dhe Kodet), të cilat kanë vizituar Shqipërinë për herë të fundit në maj të vitit 2000. Përveç vlerësimeve pozitive, ndërtimi i një sistemi të llogarive kombëtare, përmirësimi i kuadrit ligjor dhe mbulimi i aktiviteteve ekonomike sidomos për statistikat e sektorit real dhe atij të jashtëm, si dhe përdorimi eficient i burimeve të informacionit ishin disa nga domosdoshmëritë që u evidentuan nga ky mision.

Ky material ka për qëllim të japë një vlerësim mbi cilësinë e praktikës së shpërndarjes së të dhënave duke përfshirë mbledhjen e të dhënave, përpunimin dhe shpërndarjen e statistikave monetare dhe të statistikave të bilancit të pagesave, nëpërmjet krahasimit të tyre me praktikat më të mira botërore.

Për këtë vlerësim janë përdorur standardet e Projektit DQAF[4] (Kuadri i Vlerësimit të Cilësisë së të Dhënave) të FMN-së, standarde të cilat mbulojnë mjedisin institucional, proceset statistikore dhe karakteristikat e produkteve statistikore. Një paraqitje e përmbledhur në formë tabelore e treguesve standardë të përdorur nga DQAF, jepet në aneksin bashkëlidhur.

Materiali është i ndarë në 6 pjesë të cilat përbëjnë dhe përmasat e vlerësuara në lidhje me shpërndarjen e të dhënave. Qëllimi i paraqitjes është vlerësimi i efektshmërisë së shpërndarjes së statistikave të sektorit financiar dhe të sektorit të jashtëm në Shqipëri.

1. KUSHTET PARAPRAKE TË CILËSISË SË TË DHËNAVE

Kushtet paraprake të shpërndarjes së të dhënave statistikore cilësore janë ekzistenca e një mjedisi ligjor dhe institucional që mbështet statistikat, ekzistenca e burimeve njerëzore dhe materiale të përshtatshme, dobishmëria e të dhënave që publikohen dhe administrimi i mirë i cilësisë së të dhënave.

1.1 EKZISTENCA E NJË MJEDISI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL QË MBËSHTET STATISTIKAT:

i) Së pari, një mjedis mbështetës për statistikat nënkupton që ligji të shprehet në mënyrë të qartë mbi përgjegjësinë për mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e një kategorie të dhënash.

Ligji "Për Bankën e Shqipërisë", i jep qartësisht të drejtën dhe përgjegjësinë Bankës së Shqipërisë për të prodhuar dhe shpërndarë statistikat e sektorit financiar dhe statistikat e bilancit të pagesave si dhe i detyron të gjitha bankat, institucionet, personat fizikë dhe juridikë të raportojnë të dhënat statistikore në Bankën e Shqipërisë. Në këtë kuadër përfshihet gjithashtu dhe ligji "Për statistikat zyrtare"[5].

ii) Së dyti, koordinimi dhe shkëmbimi i të dhënave ndërmjet agjencive që prodhojnë të dhënat duhet të jenë të përshtatshëm.

Ky tregues nënkupton si ekzistencën e procedurave të shkëmbimit të informacionit ashtu edhe mbajtjen e kontakteve të vazhdueshme (nëpërmjet takimeve të rregullta dhe seminareve) me agjencitë e tjera që prodhojnë statistika me qëllim njohjen e kërkesave të statistikave, shfrytëzimin e burimeve të përbashkëta dhe marrjen parasysh të kostos së raportimit. Në Bankën e Shqipërisë ekzistojnë procedura të tilla të përshkruara në rregulloret përkatëse të cilat mbulojnë, për momentin, fluksin e statistikave që janë subjekt i punës aktuale. Për të ulur koston e

raportimit të subjekteve është synuar koordinimi i raportimeve të bankave të nivelit të dytë dhe shoqërive të kursim - kreditit për qëllime të mbikëqyrjes, të statistikave të bilancit të pagesave dhe të statistikave financiare.

Aktualisht, Sektori i Statistikave Monetare dhe Financiare është në fazën e fundit të përfshirjes së "institucioneve të tjera financiare" në treguesit statistikorë. Për këtë, është synuar të shfrytëzohen të dhënat ekzistuese të institucioneve që mbikëqyrin apo licencojnë grupe institucionesh të tjera financiare, siç është për shembull Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve. Një përvojë e tillë pozitive është ndjekur dhe për raportimet nga ShKK-të, duke i marrë këto raportime nga unionet përkatëse (në të cilat ShKK-të janë anëtare). Njësoj po veprohet për grumbullimin e informacionit për nevoja të statistikave të bilancit të pagesave.

Vlen të theksohet që praktika të tilla pune për shkëmbim informacioni statistikor janë të vendosura në bashkëpunimin me INSTAT dhe me Ministrinë e Financave.

iii) Së treti, të dhënat individuale të raportuara duhet të jenë konfidenciale dhe të përdoren vetëm për qëllime statistikore.

Një pohim i tillë është veçanërisht i rëndësishëm për ato subjekte që nuk mbikëqyren apo licencohen nga Banka e Shqipërisë, të cilat nuk mund të jenë subjekt i penalizimeve për vonesat apo për mungesat në raportim. Banka e Shqipërisë siguron konfidencialitetin e të dhënave individuale në bazë të: ligjit "Për Bankën e Shqipërisë", "Kodit të etikës të Bankës së Shqipërisë" dhe rregullores "Për transparencën dhe konfidencialitetin në Bankën e Shqipërisë".

Krahas mbrojtjes nga ligji, ekzistojnë gjithashtu procedura që parandalojnë shpërndarjen e informacioneve individuale. Këta rregulla sigurojnë shpërndarjen jo të ligjshme të informacionit, si për shembull duke garantuar sigurinë e bazave të të dhënave, duke kufizuar numrin e personelit që konsulton të dhënat individuale etj.. Ndërkohë që është mbajtur parasysh mosshpërndarja indirekte e informacionit individual. Përsa

i përket mbrojtjes rregullative, ligji i Bankës së Shqipërisë si dhe rregulloret e përmendura më lart ruajnë konfidencialitetin e të dhënave individuale, duke i ndaluar punonjësit e Bankës së Shqipërisë të shpërndajnë apo të transferojnë të dhënat individuale një pale të tretë, për çdo qëllim. Megjithatë, në bazën rregullative duhet specifikuar dhe "parandalimi i shpërndarjes indirekte të informacionit konfidencial", si për shembull në rastin kur një bankë ose grup bankash ka një pozicion mbizotërues në një instrument të caktuar dhe që mundëson marrjen e këtij informacioni edhe kur të dhënat janë në nivel të agreguar.

iv) Së katërti, raportimi statistikor nga subjektet duhet mbështetur nga një mandat ligjor ose në masa të tjera që nxisin përgjigjen.

Raportimi statistikor mund të jetë i detyruar ose jo. Konkretisht, për statistikat monetare subjektet që raportojnë deri tani janë të detyruara me ligj të raportojnë në Bankën e Shqipërisë. Ndërkohë që aty përfshihen dhe penalitetet përkatëse në rast se evidentohen probleme. Në ligjin e Bankës së Shqipërisë parashikohet gjithashtu që çdo institucion, person fizik apo juridik është i detyruar të raportojë në Bankën e Shqipërisë (neni 27, ligji i Bankës së Shqipërisë), por nuk ekzistojnë cilësime se çfarë ndodh në të kundërtën (për shembull, penalizimi i atyre subjekteve që nuk plotësojnë këtë kërkesë).

Në rast se ligji nuk ka fuqi t'i detyrojë subjektet të raportojnë, atëherë agjencia është e detyruar të marrë një sërë masash për të bërë sa më të lehtë dhe me kosto të ulët raportimin nga subjektet. Konkretisht, me institucionet e tjera financiare (për pasqyrimin në statistikat financiare) po punohet për ngritjen e një sistemi raportues duke shfrytëzuar jo vetëm bazën ekzistuese ligjore, por edhe duke ofruar bashkëpunim me subjektet apo duke përshtatur nevojat e statistikave me sistemet ekzistuese kontabile të tyre.

1.2 BURIMET – BURIMET DUHET TË JENË TË MJAFTUESHME PËR PLOTËSIMIN E NEVOJAVE TË PROGRAMEVE STATISTIKORE.

i) Burimet njerëzore duhet të jenë në nivelin e duhur për të përmbushur detyrat në përputhje me programet statistikore.

Numri i punonjësve të statistikës dhe përgatitja e tyre janë në përputhje me detyrat aktuale që kanë njësitë e statistikës. Kualifikimi i tyre bazë është realizuar, kryesisht nëpërmjet bashkëpunimit me FMN-në (kurset e kualifikimit të organizuara prej tyre, misionet, asistenca në distancë), përvojës në punë, si dhe seminareve të ndryshme të organizuara nga institucione të tjera ndërkombëtare. Kjo ka bërë të mundur edhe krijimin e një personeli të aftë për të përballuar drejtimin e punës në njësitë e statistikës. Mbetet akoma për t'u bërë për forma trainimi më të organizuara, për të përballuar detyrat në të ardhmen.

Gjithashtu duhet menduar plotësimi i personelit për të përballuar plotësimin e spektrit të statistikave, bazuar në standardet ndërkombëtare, si pozicioni ndërkombëtar i investimeve, statistikat e borxhit të jashtëm, statistikat e tjera të ekonomisë.

Njësitë e statistikës kanë një numër të kufizuar individësh me edukim të mirëfilltë statistikor. Duhen sqaruar idetë që lidhen me zhvillimet cilësore të burimeve njerëzore në të ardhmen.

Ndërkohë, pagat për këta specialistë për momentin, mendohet që janë të një niveli të krahasueshëm me administratën në përgjithësi.

Rivlerësime që lidhen me forma të strukturës së statistikave dhe plotësime të saj mund të merren në konsideratë.

ii) Teknologjia – niveli i saj për të përmbushur detyrat në përputhje me programet statistikore.

Në zhvillimin e teknologjisë që lidhet me statistikat, këto vitet e fundit janë realizuar projekte për implementimin e zgjidhjeve për informacionin statistikor. Aktualisht, teknologjia në dispozicion është ajo e nevojshme për kërkesat e statistikës (përfshirë këtu kompjuterat, programet dhe ruajtjen e informacionit) dhe në nivelet e duhura deri tani për kërkesat që shtrojnë programet statistikore[6]. Ndërkohë, duhet vazhduar më tej puna për zhvillimin e teknologjisë, në arritjen e standardeve të zhvilluara[7].

iii) Lehtësitë fizike dhe burimet e tjera, si transporti, komunikimi etj. – niveli i tyre për të përmbushur detyrat në përputhje me programet statistikore.

Gjykohet që për momentin kushtet fizike të punës, lënë për të dëshiruar si për sa i përket gjendjes fizike të zyrave, ashtu dhe përsa i përket vendosjes së punonjësve nëpër zyra në bazë të funksionit që ata kryejnë. Përmirësimi i tyre pa dyshim që do të sjellë mundësi më të mira për cilësinë e punës me statistikat. Ndërkohë, ekzistojnë kushte normale të komunikimit dhe të transportit për realizimin e detyrave.

iv) Financimi për kompilimin e statistikave – plotësimi i kërkesave për të përmbushur detyrat në përputhje me programet statistikore.

Financimi për statistikat është realizuar sipas kërkesës së bërë dhe detyrave të shtruara. Ka ide të qarta lidhur me buxhetet e nevojshme për mbështetjen e statistikave, në një periudhë afatmesme.

v) Vendosja e mekanizmave për një përdorim eficient të burimeve.

Janë vendosur mekanizma për matjen në mënyrë periodike dhe me disa mënyra vlerësimi të cilësisë së punës së personelit të statistikave. Nga ana tjetër, janë marrë një sërë masash për të përmirësuar aspektet organizative të personelit të statistikave, si bashkimi i këtyre njësive në të njëjtin department, përmirësimi i dokumentacionit rregullativ etj.. Në kuadrin e përdorimit më efektiv të burimeve të informacionit, po bashkëpunohet më ngushtë me INSTAT për rritjen e cilësisë së vrojtimeve statistikore. Në nivel kombëtar mbetet akoma shumë për të bërë, për t'i siguruar vendimmarrjes informacion statistikor efektiv dhe të mjaftueshëm[8].

Nga ana tjetër, për detyra të veçanta është bashkëpunuar me ekspertë të huaj, si specialistë të FMN dhe të FSVC-së.

1.3 DOBISHMËRIA E TË DHËNAVE:

i) Dobishmëria praktike e statistikave ekzistuese duhet të monitorohet.

Në prodhimin dhe shpërndarjen e të dhënave, çdo agjenci statistikore duhet të marrë parasysh kërkesat e përdoruesve dhe për këtë duhen gjetur mënyrat dhe rrugët përkatëse (për shembull, nëpërmjet vrojtimeve, seminareve ose të vlerësojë reagimin e publikut nëpërmjet personave të kontaktit). Në këtë kuadër, statistikat në Bankën e Shqipërisë u përgjigjen nevojave të përdoruesve të brendshëm, FMN-së dhe në mungesë të një reagimi aktiv nga publiku, synojnë t'u përmbahen standardeve ndërkombëtare të prodhimit dhe të shpërndarjes së tyre. Kështu, punonjësit e statistikave në Bankën e Shqipërisë marrin pjesë në takimet statistikore dhe në seminaret e organizuara nga institucionet ndërkombëtare si dhe janë aktivë në kërkimin e eksperiencave të vendeve të tjera për karakteristikat e statistikave që kompilohen.

Nga ana tjetër, organizimi i takimeve periodike me përdorues të jashtëm si institucionet akademike, mediat dhe sektorin privat, vlerësojmë se do të ishte një test i mirë për dobishmërinë e statistikave të publikuara. Me krijimin e kësaj përvoje, gradualisht do të ishte i nevojshëm dhe përcaktimi i disa procedurave përkatëse për realizimin e një procesi periodik dhe të strukturuar për konsultimin me përdorues të ndryshëm (përfshi këtu organizata rajonale dhe ndërkombëtare).

1.4 CILËSI TË TJERA TË ADMINISTRIMIT – CILËSIA E INFORMACIONIT, SI NJË MOMENT THEMELOR NË PUNËN ME STATISTIKAT.

Së pari, në Bankën e Shqipërisë ekziston një mendësi tashmë e formuar për administrimin e statistikave, në faktin që "cilësia krijon besimin" dhe që kjo është një moment themelor në ndërtimin e punës me statistikat. Kështu, Banka e Shqipërisë është e ndjeshme ndaj cilësisë së informacionit dhe është kërkuese për një administrim më të mirë të tij. Njësitë e statistikës

së Bankës së Shqipërisë kanë në përdorim dokumentacion dhe informacion për përmirësimin e cilësisë së statistikave. Gjithashtu, ka procedura rishikimi të informacionit, duke marrë konsideratat nga përdoruesit[9] ose dhe rishikime të parashkruara nga burimet e informacionit.

2. INTEGRITETI I TË DHËNAVE

Për të siguruar integritetin e të dhënave të shpërndara, agjencia që publikon të dhënat duhet të garantojë profesionalizëm, transparencë dhe ndjekjen e standardeve të etikës.

2.1. PROFESIONALIZMI:

i) Statistikat prodhohen në mënyrë të paanshme:

Së pari, termat dhe kushtet në të cilat prodhohen dhe shpërndahen statistikat duhet të jenë në përputhje me pavarësinë profesionale. Një gjë e tillë duhet garantuar me ligj ose në mungesë të tij duhet të ekzistojë një traditë e njohur në respektimin e pavarësisë profesionale (shembull tipik në këto raste përmendet fakti që institucionet qeveritare të kuptojnë rëndësinë e mosndërhyrjes në pavarësinë e agjencisë që prodhon statistika). Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë me ligj gëzon të drejtën e prodhimit dhe të shpërndarjes së statistikave monetare dhe financiare dhe të statistikave të bilancit të pagesave. Pra, ajo garanton pavarësinë profesionale, si dhe parandalon ndërhyrjen nga palë të tjera, përfshirë institucionet qeveritare.

Së dyti, profesionalizmi duhet promovuar dhe mbështetur brenda agjencisë që prodhon statistika.

Në këtë kriter përfshihet fillimisht zhvillimi profesional i punonjësve të statistikave të Bankës së Shqipërisë. Kjo është realizuar nëpërmjet trajnimeve gjatë procesit të punës ose nëpërmjet seminareve të organizuara nga FMN-ja për çështje të metodologjisë së kompilimit të treguesve statistikorë, si dhe për shumë aspekte të tjera që lidhen me statistikat. Bashkëpunimi

i vazhdueshëm me specialistë të statistikave të FMN-së ka bërë të mundur sigurimin e literaturës më të fundit në lidhje me standardet bashkëkohore. Në këtë kuadër, është dhe mbështetja e specialistëve të FMN-së për disa nga planet e sektorit të statistikave si arritja e standardeve të SDDS, përfshirja e institucioneve të tjera financiare në statistikat financiare, përshtatja e metodologjisë së re për të dhënat financiare të Shqipërisë të publikuara në FMN etj..

Gjithashtu, lidhur me promovimin dhe mbështetjen për punonjësit e statistikës, njësitë e statistikës janë klasifikuar në kategorinë e dytë të strukturës së pagave, ndryshe nga disa vite më parë (që shpreh dhe shkallën e rëndësisë që i ka kushtuar Banka e Shqipërisë). Vlen të theksohet që punësimi i specialistëve si dhe ngritja e tyre në përgjegjësi në strukturat e statistikës është bazuar në kurrikulën e tyre në fushat e statistikës. Gjithashtu, janë mbështetur iniciativat për kërkim, analizë dhe zgjedhje të metodologjive të përshtatshme.

ii) Përzgjedhja e burimeve dhe e teknikave statistikore duhet të bazohet vetëm në konsiderata statistikore. Pavarësisht nevojave të vendimmarrjes, njësia që prodhon dhe shpërndan statistikat duhet të gëzojë pavarësi në ndjekjen e standardeve të veta në metodologjinë që përdor, në periodicitet dhe në mënyrën e shpërndarjes.

Njësitë statistikore në Bankën e Shqipërisë gëzojnë pavarësi pothuaj të mjaftueshme në këtë drejtim. Përgjithësisht edhe këtu synohet të ndiqen standardet e pranuara gjerësisht, të cilat kanë hapësira për të kënaqur nevojat e përdoruesve.

Rivlerësime që lidhen me forma të strukturës dhe plotësime të saj mund të merren në konsideratë. Vendimet mbi shpërndarjen e statistikave, kohën dhe tipin e shpërndarjes janë bazuar vetëm mbi konsiderata statistikore dhe mbi përvojën ndërkombëtare.

iii) Së treti, kriter tjetër i profesionalizmit është mundësia e institucionit për të reaguar ndaj keqinterpretimit të të dhënave dhe keqpërdorimit të tyre.

Për këtë qëllim, të dhënave u bashkangjitet gjithnjë një komentar orientues (metodologji, metadata) gjë që përgjithësisht aplikohet në publikimet e Bankës së Shqipërisë. Keqinterpretimi i të dhënave të publikuara mund të mënjanohet gjithashtu, nëpërmjet kontakteve me grupe të përzgjedhura të publikut si për shembull mediat, institucionet akademike dhe shkencore etj.. Megjithëse në vitet e fundit është rritur ndjeshëm prania e Bankës së Shqipërisë në publik, proceset statistikore në Bankën e Shqipërisë njihen pak, duke patur parasysh këtu edhe kulturën e pakët të publikut në përgjithësi për statistikat.

Në kushtet e ndryshimeve të shpeshta të metodologjisë statistikore, të ndërtimit të historisë së të dhënave dhe të rishikimit të vazhdueshëm të tyre është shumë e lehtë të keqinterpretohen treguesit statistikorë. Ndër iniciativat e rëndësishme që janë marrë në këtë drejtim mund të përmenden: seminaret me gazetarët, programet e ndryshme në bashkëpunim me median dhe sidomos, Konferenca e Parë "Informacioni statistikor në Shqipëri"[10].

Banka e Shqipërisë monitoron në mënyrë të vazhdueshme përdorimin e publikimeve të saj në media. Në përgjigje të shkrimeve publike, sipas problematikës së ngritur janë përgatitur artikuj shpjegues dhe informues për veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë, artikuj sqarues kur ka keqkuptime, pjesëmarrje në debate për çështje ekonomike e financiare etj..

2.2 TRANSPARENCA E PROCESEVE STATISTIKORE:

i) Së pari, kushtet dhe termat në të cilat të dhënat statistikore mblidhen, përpunohen dhe shpërndahen duhet të publikohen.

Aktualisht, në faqen internetit të Bankës së Shqipërisë ekziston një informacion i plotë mbi bazën rregullative mbi të cilën kryhet i tërë procesi statistikor. Për më tepër, përgatitja për SDDS kërkon jo vetëm listimin dhe publikimin e këtyre rregulloreve, por ndoshta edhe rishikimin në këtë këndvështrim të tyre.

ii) Së dyti, publiku duhet të njoftohet paraprakisht mbi

njësitë qeveritare që kanë të drejta përdorimi mbi informacionin para se ai të bëhet publik.

Për statistikat monetare dhe statistikat e bilancit të pagesave njësitë qeveritare nuk kanë të drejta përdorimi paraprak në të dhënat që publikohen.

iii) Së treti, agjencia duhet të identifikojë të dhënat statistikore që prodhon dhe shpërndan, në mënyrë që publiku të ketë të qartë se për çfarë mban përgjegjësi agjencia.

Të dhënat statistikore në Bankën e Shqipërisë mbajnë emrin (logon) e Bankës së Shqipërisë kur shpërndahen. Veçanërisht, në rast publikimesh të përbashkëta duhet identifikuar në mënyrë të qartë ajo pjesë që i takon statistikave të Bankës.

iv) Ndryshimet kryesore në metodologji, në burim të dhënash dhe në teknikat statistikore duhet të njoftohen paraprakisht.

Aktualisht, për statistikat në Bankën e Shqipërisë nuk ekziston një praktikë e tillë. Përdoruesve u lajmërohen dhe u shpjegohen ndryshimet në statistikat e shpërndara në publikimin e rradhës.

2.3. STANDARDET E ETIKËS – POLITIKAT DHE PRAKTIKAT JANË TË UDHËHEQURA NGA STANDARDET ETIKE

i) Së pari, çdo agjenci që përgatit dhe shpërndan informacion statistikor, ka standarde të plota etike, të miratuara nga institucioni. Në Bankën e Shqipërisë ekziston një rregullore etike sipas standardeve. Nga ana tjetër, nga punonjësit kërkohet një nivel i plotë formimi në ruajtjen e standardeve të etikës dhe në shmangien e interferencave politike.

ii) Gjithashtu, këto standarde etike duhet të njihen mirë nga drejtuesit dhe punonjësit e institucionit.

3. METODOLOGJIA

Ky dimension në statistikat monetare dhe financiare vlerësohet nëpërmjet krahasimit të praktikave të vendit me praktikat më të mira ndërkombëtare. Së pari, përmenden metodologjitë e shpërndara nga FMN[11]. Megjithatë, përmenden dhe standarde të tjera të praktikës më të mirë botërore[12]. Kriteret e krahasimit përfshijnë konceptet dhe përkufizimet, mbulimin, sektorizimin dhe klasifikimin e instrumenteve financiare dhe rregullat e kontabilizimit. Në mbështeteje të standardeve të FMN-së, Banka e Shqipërisë miratoi "Metodikën e statistikave monetare dhe financiare, BSH, Korrik 2003". Bazuar në këto standarde, që nga dhjetori i vitit 2002 ka filluar kompilimi i statistikave monetare sipas standardit të ri. Aktualisht, po punohet për publikimin në internet të këtyre statistikave si dhe për krijimin e tabelave "urë", për të mundësuar lidhjen e standardit të vjetër me atë të ri. Nga ana tjetër në bashkëpunim me FMN, janë përgatitur tabelat për t'u publikuar në IFS[13] sipas standardit të ri[14]. Së fundi, vlen të përmendet që megjithëse sistemi i vlerësimit DQAF, si dhe standardet e SDDS dhe GDDS mjaftohen vetëm me mbulimin e sektorit të "Korporatave depozituese", po punohet për përfshirjen e "Institucioneve të tjera financiare" në statistikat monetare dhe financiare.

Bilanci i pagesave hartohet sipas kuadrit metodologjik të përcaktuar në standardet ndërkombëtare të FMN-së në manualin e bilancit të pagesave BPM5. Në këtë kuadër, komponentet standarde të bilancit të pagesave janë klasifikuar dhe sektorizuar në përputhje me ato të rekomanduara në manual. Tabela statistikore e bilancit të pagesave bazohet në parimin e regjistrimit të dyfishtë duke respektuar, për të gjitha rastet, konceptin e rezidencës. Parime uniforme përdoren edhe për vlerësimin dhe kohën e regjistrimit të transaksioneve që regjistrohen në këtë bilanc si dhe përfshirjen e të gjitha transaksioneve (shkëmbimeve e transfertave pa shpërblim). Megjithatë, në praktikë, si pasojë e kufizimeve në burimet e informacionit, regjistrimi i transaksioneve në vlerën dhe në kohën e duhur nuk është gjithmonë i mundur. Edhe devijimet nga kategorizimet më të detajuara të manualit, janë gjithmonë

subjekt revizionimi e përmirësimi. Në këtë kuadër, përmendim futjen e formës së re të raportimit të bankave, si rrjedhim detajimin e zërave të bilancit të pagesave dhe plane të sektorit për detajime shtesë dhe përditësim të formularit të raportimit në të ardhmen.

Bilanci i pagesave të Shqipërisë mbulon në parim të gjitha transaksionet mes rezidentëve e jorezidentëve, por disa aktivitete ilegale mbeten të pambuluara. Për importet joformale të të mirave (kontrabandë) në Shqipëri bëhen vlerësime.

4. BESUESHMËRIA DHE KORREKTËSIA

Ky dimension ka të bëjë me vlerësimin e besueshmërisë dhe korrektësisë së burimit të të dhënave dhe teknikave statistikore të përdorura.

4.1. BURIMI I TË DHËNAVE:

i) Të dhënat duhet të merren nëpërmjet programeve gjithëpërfshirëse që marrin parasysh kushtet specifike të vendit.

Ekzistenca e një numri relativisht të vogël bankash dhe grupimi i ShKK-ve në dy unione[15], ka mundësuar një kontroll të mirë të statistikave monetare mbi burimet e informacionit. Si të tilla për statistikat monetare shërbejnë regjistrimet kontabile (në formën e bilancit kontabël) të bankave të nivelit të dytë, Bankës së Shqipërisë dhe ShKK- ve. Në krijimin e këtyre pasqyrave janë marrë parasysh kërkesat kryesore të statistikave monetare dhe financiare që kanë të bëjnë me sektorizimin dhe me klasifikimin e instrumenteve financiare. Në lidhje me institucionet e tjera financiare, është synuar që raportimi të ketë detajet e nevojshme për t'iu përgjigjur nevojave të statistikave, por njëkohësisht të jetë brenda mundësive aktuale të raportimit të institucioneve.

Ekzistenca e një zyre që administron raportimet dhe që i kontrollon ato në bazë të një dokumentacioni të plotë të miratuar dhe përdorimi i të njëjtit informacion edhe për mbikëqyrjen

bankare, jo vetëm mundëson konsistencën në raportim, por edhe krijon hapësirë për sinjalizimin në kohë të statistikave monetare qoftë për saktësinë e raportimeve, qoftë për situata të reja të shfaqura në bilancet e bankave.

Përsa i përket statistikave të bilancit të pagesave nuk ka një rregull të ngurtë që përcakton qartë burimet nga të cilat duhet të rrjedhë informacioni statistikor për mbushjen e tabelës së bilancit të pagesave. Burimet variojnë nga një vend në tjetrin në varësi të veçorive të secilës ekonomi dhe kuadrit ligjor e rregullator të përshtatur nga vende të ndryshme. Aktualisht, Zyra e Bilancit të Pagesave mbledh informacion nga doganat për import – eksportin e mallrave, nga KESH për atë të energjisë elektrike, nga disa forma raportimi nga bankat për zëra të ndryshëm si shërbimet, të ardhurat, transfertat private e llogaria financiare, plotësuar këto nga raportime të disa agjencive publike e private. Gjithashtu, informacion merret nga Ministria e Financave për transfertat shtetërore e borxhin e qeverisë, nga Ministria e Ekonomisë për grantet etj.. Vrojtimet statistikore janë burimi më i gjerë i informacionit dhe si të tilla ato kryhen në përputhje me praktikat më të mira. Përgjithësisht, synohet që zgjedhja e marrë për të kryer vrojtimin të jetë përfaqësuese e popullsisë së synuar dhe sa më e përditësuar.

i) Të dhënat përafrojnë në mënyrë të arsyeshme përkufizimet, mbulimin, klasifikimin, vlerësimin dhe kohën e regjistrimit të kërkuar për statistikat.

Përgjithësisht për statistikat monetare të dhënat janë të përshtatshme në lidhje me kriteret e përmendura më sipër. Duke qenë se për institucionet e tjera financiare po shfrytëzohen të dhënat ekzistuese të këtyre institucioneve (pra pa kërkuar ndryshime në rregullat e kontabilizimit apo të vlerësimit), rëndësi i është kushtuar identifikimit të ndryshimeve nga standardi dhe përdorimit të teknikave alternative statistikore për rregullimin e tyre.

Përsa i përket statistikave të bilancit të pagesave, megjithëse metodat e grumbullimit të të dhënave që përdoren (si ato bazuar

në forma raportimi ashtu dhe vrojtimet), janë në përputhje me udhëzimet e manualit BPM5 të FMN-së, të dhënat që ato sigurojnë nuk janë gjithmonë të mjaftueshme për të përballuar një mbulim më të madh. Kështu, mbetet gjithmonë problem grumbullimi i informacionit për sektorin privat për sa i përket një pjese të shërbimeve, flukseve të detyrimeve, të ardhurave nga emigrantët, investimit të huaj direkt etj..

ii) Të dhënat duhet të raportohen në kohë.

Vendosja e afateve të raportimit për subjektet që raportojnë në Bankën e Shqipërisë, bëhet duke marrë parasysh mundësitë reale të tyre si dhe kërkesat e standardeve statistikore për shpërndarjen në kohë të statistikave. Në statistikat monetare kjo realizohet pothuajse plotësisht për të dhënat e bankës qendrore (bilanci kontabël), por herë pas here ka vështirësi në arritjen e afatit nga bankat e nivelit të dytë, sidomos për fundin e vitit. Gjithashtu, nga SHKK-të kërkohet të raportojnë në Bankën e Shqipërisë çdo tremujor. Duke u nisur nga pesha e tyre në aktivitetin kredidhënës dhe depozitues, është gjykuar se periodiciteti aktual është i mjaftueshëm si për qëllimet statistikore edhe për ato mbikëqyrëse.

4.2. VLERËSIMI I BURIMIT TË TË DHËNAVE:

i) Të dhënat që raportohen nga subjektet duhet të kontrollohen në mënyrë të vazhdueshme dhe rezultatet e këtij kontrolli monitorohen për të drejtuar proceset statistikore.

Për statistikat monetare një gjë e tillë realizohet nëpërmjet Zyrës së Administrimit të Raportimeve. Gjithashtu, nëpërmjet bazës së të dhënave SARS realizohet kontrolli automatik i konsistencës së raportimeve individuale. Dokumentacioni i kontrollit mbahet në mënyrë të rregullt nga kjo zyrë dhe i vihet në dispozicion çdo muaj Departamentit të Mbikëqyrjes.

Gjithashtu, çdo tremujor monitorohet nga Departamenti i Kontrollit kompilimi i të dhënave mujore të autoritetit monetar.

5. DOBISHMËRIA

5.1. PERIODICITETI DHE AFATI I PUBLIKIMIT TË TË DHËNAVE NGA DATA E REFERENCËS:

i) Periodiciteti.

Periodiciteti i pranimit të raportimeve për bankat dhe ShKK-të dhe shpërndarja e tyre është mujore dhe përputhet me standardet e shpërndarjes së të dhënave SDDS dhe GDDS të FMN-së. Ndërkohë, ShKK-të raportojnë me periodicitet tremujor. Statistikat e bilancit të pagesave shpërndahen në bazë tremujore dhe ky periodicitet është në përputhje me standardet e GDDS dhe SDDS.

ii) Afati i publikimit të të dhënave nga data e referencës[16].

Përsa i përket kohës ndërmjet datës së referencës dhe datës së publikimit, të dhënat për sistemin bankar raportohen si rregull 40 ditë kalendarike nga data e fundit të muajit. Megjithëse brenda standardeve të GDDS (2-3 muaj), akoma nuk është arritur koha sipas standardit SDDS (një muaj) sidomos për të dhënat e muajit dhjetor, ndërkohë që të dhënat mbi bankën qendrore shpërndahen në kohë. Vlen të përmendet se nëpërmjet përdorimit të faqes së internetit si mjet publikimi është arritur shkurtimi i kohës së shpërndarjes së treguesve statistikorë. Të dhënat e bilancit të pagesave, si rregull raportohen në rreth 2 muaj nga data e referencës, duke qenë kështu brenda standardeve GDDS dhe SDDS.

5.2. INTEGRITETI:

Integriteti i treguesve të statistikave monetare dhe financiare dhe statistikave të bilancit të pagesave, vlerësohet brenda një grupi treguesish të statistikave në një moment të caktuar, brenda një periudhe kohe ose ndërmjet burimeve të ndryshme, si për shembull ndërmjet treguesve të bilancit të pagesave, të qeverisë apo të statistikave monetare dhe financiare.

i) Statistikat duhet të kenë integritet brenda grupit.

Në statistikat monetare, duke qenë se ende nuk kompilohen të dhëna për sektorin financiar në lidhje me kontrollin e integritetit brenda një grupi treguesish, kontrolli i integritetit kufizohet vetëm në krahasimin e të dhënave të bankave të nivelit të dytë me të dhënat e Bankës së Shqipërisë.

Përsa i përket bilancit të pagesave konceptet, përkufizimet e klasifikimet janë të njëjta si në kompilimin e statistikave tremujore dhe të atyre vjetore. Një kriter i mirë kontrolli do të ishte krahasimi i flukseve të bilancit me ndryshimet e gjendjeve në "Pozicionin Ndërkombëtar të Investimit", i cili akoma nuk kompilohet në Bankën e Shqipërisë.

ii) Statistikat duhet të kenë integritet brenda një periudhe të arsyeshme kohe (si rregull pesë vjet).

Konsistenca brenda një periudhe kohore nënkupton shtrirjen mbrapa në kohë të ndryshimeve në metodologji apo në burimin e të dhënave, shpjegimin e detajuar të këputjeve kryesore të serive kohore, duke përfshirë shkaqet e tyre dhe axhustimet e nevojshme që duhen bërë, për të siguruar konsistencën në kohë dhe shpjegimin e ndryshimeve të pazakonta në prirjen e treguesve statistikorë. Duke qenë se është e pamundur të ndërtohen seritë e reja për periudha më të hershme, është në proces puna për ndërtimin e tabelave "urë" të detajuara, të cilat do të mundësojnë vazhdueshmërinë e treguesve pas ndryshimeve metodologjike. Për treguesit e statistikave monetare dhe financiare ka përfunduar një analizë e parë, e cila ka qëllim të përshkruajë prirjen e treguesve, të kapë "ngjarjet" në vite etj..

5.3. EKZISTENCA E NJË POLITIKE PËR RISHIKIMIN E TË DHËNAVE SI DHE PUBLIKIMI I SAJ:

i) Rishikimet duhet të ndjekin një kalendar të rregullt dhe të jenë transparente.

Përdoruesit e statistikave duhet të njohin praktikat e rishikimit të të dhënave. Gjithashtu duhet ditur nëse të dhënat janë paraprake apo përfundimtare. Rishikimet në statistikat monetare dhe financiare si rregull, ndodhin për arsye të rishikimit të bilanceve të bankave të nivelit të dytë pas kontrollit nga kontrollorët e jashtëm ose nga mbikëqyrja (on site) e Bankës së Shqipërisë. Në statistikat monetare ndryshimet përfshihen në publikimin e rradhës. Për rrjedhojë, të dhënat quhen përfundimtare në momentin e parë që publikohen dhe rishikohen nëse është e nevojshme. Meqë akoma nuk ekziston një metodologji e qartë dhe e miratuar për rishikimin e të dhënave nuk mund të dihet paraprakisht se kur pritet rishikimi i tyre. Dokumentacioni i rishikimeve, që përfshin arsyet e ndryshimit, masën e ndryshimit etj., megjithëse mbahet rregullisht nga Zyra e Statistikave Monetare dhe Financiare nuk publikohet bashkë me të dhënat. Për statistikat e bilancit të pagesave, revizionime bëhen në mënyrë të rregullt në lidhje me vlerësime paraprake, përditësime, ndryshime metodologjie etj.. Tabelat e revizionuara publikohen, por jo dokumentacioni i revizionimeve përkatëse.

Në këtë kuadër, do të ishte i nevojshëm publikimi i një kalendari që do të mbulojë ndryshimet dhe arsyet përkatëse.

6. E DREJTA E PËRDORIMIT TË TË DHËNAVE.

Ky dimension nënkupton që të dhënat dhe shpjegimet për to (metadatat) të mund të gjenden lehtësisht nga përdoruesi.

6.1. E DREJTA E PËRDORIMIT TË TË DHËNAVE.

i) Statistikat duhet të prezantohen në mënyrë që të interpretohen dhe të krahasohen lehtësisht (nëpërmjet tabelave, grafikëve etj.).

Përgjithësisht, statistikat e publikuara nga Banka e Shqipërisë tashmë shpërndahen në mënyrë të qartë dhe në nivele të ndryshme agregimi për t'iu përgjigjur kategorive të ndryshme të përdoruesve. Buletinet statistikore gjithashtu përmbajnë komente mbi zhvillimet e periudhave korente.

ii) Mjetet dhe format e shpërndarjes duhet të jenë të përshtatshme.

Statistikat e prodhuara në Bankën e Shqipërisë shpërndahen nëpërmjet internetit dhe në letër. Ato mund t'i përdorë çdo i interesuar, pa asnjë dallim. Mënyra aktuale e shpërndarjes si dhe nivelet e ndryshme të detajimit të treguesve statistikorë të publikuar në internet, janë lehtësisht të përdorshme për grupe të ndryshme përdoruesish.

iii) Statistikat duhen shpërndarë sipas një kalendari të paracaktuar.

Për statistikat e publikuara nga Banka e Shqipërisë ekziston një kalendar që tregon paraprakisht datat e publikimit të treguesve. Si kërkesë e SDDS është që një kalendar i tillë t'i bëhet i ditur përdoresve, si rregull, tre muaj para datës së shpërndarjes së të dhënave.

iv) Statistikat u duhen shpërndarë të gjithë përdoruesve[17] në të njëjtën kohë.

Nëpërmjet publikimit në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë, që është dhe mënyra më e hershme e publikimit të të dhënave statistikore, realizohet dhe shpërndarja e njëkohshme e statistikave tek të gjithë përdoruesit e interesuar.

6.2. E DREJTA E PËRDORIMIT TË METODOLOGJISË SË INFORMACIONIT (METADATAT):

i) Dokumentacioni mbi konceptet, mbulimin, klasifikimin, metodat e regjistrimit, burimet e informacionit dhe teknikat statistikore duhet të publikohet. Po njësoj duhet të publikohen dhe ndryshimet nga standardet ndërkombëtare.

Për statistikat monetare dhe financiare mund të thuhet se ekziston një informacion i plotë mbi mënyrën e kompilimit të treguesve statistikorë. "Metodika e statistikave monetare dhe financiare, BSh, Korrik 2003", që përbën bazën e punës

metodologjike të statistikave monetare dhe financiare dhe metadatat analitike për kompilimin e treguesve është e publikuar në internet. Në lidhje me statistikat e bilancit të pagesave, metodologjia e kompilimit të statistikave – një përshtatje e manualit BPM5 të FMN-së - ekziston për përdorim të sektorit; ajo nuk është e publikuar në internet.

ii) Nivelet e detajimit u duhen përshtatur nevojave të auditorit të synuar.

Krahas "Metodikës së statistikave monetare dhe financiare, BSh, Korrik 2003", në bazën e të dhënave "Seri kohore", për çdo tabelë dhe tregues jepet përmbajtja dhe domethënia e tyre. Këto metadata janë të përshtatura për një kategori më të gjerë përdoruesish. Përshkrime (metadata) analoge ekzistojnë edhe për statistikat e bilancit të pagesave.

6.3. NDIHMA NDAJ PËRDORUESVE:

Duhen vendosur persona kontakti për çdo fushë dhe duhet të ekzistojnë katalogë të publikimeve dhe të shërbimeve të tjera për përdoruesit e statistikave.

Në lidhje me statistikat që shpërndan Banka e Shqipërisë, ekzistojnë persona kontakti për çdo grup statistikash. Gjithashtu, nëpërmjet faqes së internetit të Bankës së Shqipërisë publikohet lista e të gjitha publikimeve periodike dhe joperiodike të Bankës së Shqipërisë, përfshirë dhe ato që kanë lidhje me statistikat. Duhet vlerësuar ndihma që ka dhënë përfshirja në Projektin GDDS të Fondit në këtë drejtim, që ka rritur numrin e konsultuesve për statistikat shqiptare, si dhe për faktin që në standardet publikuese përkatëse kërkohet publikimi i personave të kontaktit sipas sektorëve të statistikës.

Në tabelën e dhënë në aneksin bashkëngjitur jepen treguesit e cilësisë së të dhënave sipas standardeve të Projektit DQAF të Fondit.

ANEKS: TREGUESIT E CILËSISË SË TË DHËNAVE:

Dimensionet:	Elementët e dimensioneve:	Kriteret:
1. Kushtet paraprake të cilësisë së të dhënave	1.1. Ekzistenca e një mjedisi ligjor dhe institucional që mbështet statistikat	i) Ligji shprehet në mënyrë të qartë mbi përgjegjësinë për mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e një kategorie të dhënash.
		ii) Koordinimi dhe shkëmbimi i të dhënave ndërmjet agjencive që prodhojnë të dhënat duhet të jenë të përshtashme.
		iii) Të dhënat individuale të raportuara duhet të jenë konfidenciale dhe të përdoren vetëm për qëllime statistikore.
		iv) Raportimi statistikor nga subjektet duhet mbështetur nga një mandat ligjor ose masa të tjera që nxisin përgjigjen.
	1.2. Burimet – burimet duhet të jenë të mjaftueshme për plotësimin e nevojave të programeve statistikore	i) Burimet njerëzore duhet të jenë në nivelin e duhur për të përmbushur detyrat në përputhje me programet statistikore.
		ii) Niveli i teknologjisë të jetë i mjaftueshëm për të përmbushur detyrat në përputhje me programet statistikore.
		iii) Lehtësirat fizike dhe burimet e tjera, si transporti, komunikimi etj. duhet të jenë në nivelin e duhur për të përmbushur detyrat në përputhje me programet statistikore.
		iv) Financimi për kompilimin e statistikave – përmbushja e kërkesave për të plotësuar detyrat në përputhje me programet statistikore.
		v) Vendosja e mekanizmave për një përdorim eficient të burimeve.
	1.3. Dobishmëria e të dhënave	i) Dobishmëria praktike e statistikave ekzistuese duhet të monitorohet.
	1.4. Cilësi të tjera të administrimit – cilësia e informacionit, si një moment themelor në punën me statistikat	
2. Integriteti i të dhënave	2.1. Profesionalizmi	i) Statistikat prodhohen në mënyrë të paanshme.
		ii) Përzgjedhja e burimeve dhe e teknikave statistikore duhet të bazohet vetëm në konsiderata statistikore.
		iii) Mundësia e institucionit për të reaguar ndaj keqinterpretimit të të dhënave dhe keqpërdorimit të tyre.
	2.2. Transparenca e proceseve statistikore	i) Kushtet dhe termat në të cilat të dhënat statistikore mblidhen përpunohen dhe shpërndahen duhet të publikohen.
		ii) Publiku duhet të njoftohet paraprakisht mbi njësitë qeveritare që kanë të drejta përdorimi mbi informacionin para se ai të bëhet publik.
		iii) Agjencia duhet të identifikojë të dhënat statistikore që prodhon dhe shpërndan, në mënyrë që publiku të ketë të qartë se për çfarë mban përgjegjësi agjencia.
		iv) Ndryshimet kryesore në metodologji, në burimin e të dhënave dhe në teknikat statistikore duhet të njoftohen paraprakisht.
	2.3. Standardet e etikës – politikat dhe praktikat janë të udhëhequra nga standardet etike.	i) Ekzistojnë standarde të plota etike, të miratuara nga institucioni.
		ii) Gjithashtu, këto standarde etike duhet të njihen mirë nga drejtuesit dhe punonjësit e institucionit.

3. Metodologjia		
4. Besueshmëria dhe korrektësia	4.1. Burimi i të dhënave:	i) Të dhënat duhet të merren nëpërmjet programeve gjithëpërfshirëse që marrin parasysh kushtet specifike të vendit.
		ii) Të dhënat përafrojnë në mënyrë të arsyeshme përkufizimet, mbulimin, klasifikimin, vlerësimin dhe kohën e regjistrimit të kërkuar për statistikat.
		iii) Të dhënat duhet të raportohen në kohë.
	4.2. Vlerësimi i burimit të të dhënave:	iv) Të dhënat që raportohen nga subjektet duhet të kontrollohen në mënyrë të vazhdueshme dhe rezultatet e këtij kontrolli monitorohen për të drejtuar proceset statistikore.
5. Dobishmëria	5.1. Periodiciteti dhe afati i publikimit të dhënave nga data e referencës	i) Periodiciteti.
		ii) Afati i publikimit së të dhënave nga data e referencës.
	5.2. Integriteti	i) Statistikat duhet të kenë integritet brenda grupit.
		ii) Statistikat duhet të kenë integritet brenda një periudhe të arsyeshme kohe (si rregull pesë vjet).
	5.3. Ekzistenca e një politike për rishikimin e të dhënave si dhe publikimi i saj	i) Rishikimet duhet të ndjekin një kalendar të rregullt dhe të jenë transparente.
6. E drejta e përdorimit të të dhënave	6.1. E drejta e përdorimit të të dhënave	i) Statistikat duhet të prezantohen në mënyrë që të interpretohen dhe të krahasohen lehtësisht (nëpërmjet tabelave, grafikëve etj.).
		ii) Mjetet dhe format e shpërndarjes duhet të jenë të përshtatshme.
		iii) Statistikat duhen shpërndarë sipas një kalendari të paracaktuar.
		iv) Statistikat u duhen shpërndarë të gjithë përdoruesve në të njëjtën kohë.
	6.2. E drejta e përdorimit të metodologjisë së informacionit (metadatat)	i) Dokumentacioni mbi konceptet, mbulimin, klasifikimin, metodat e regjistrimit, burimet e informacionit dhe teknikat statistikore duhet të publikohet. Po njësoj duhet të publikohen dhe ndryshimet nga standardet ndërkombëtare.
		ii) Nivelet e detajimit u duhen përshtatur nevojave të auditorit të synuar.
	6.3. Ndihma ndaj përdoruesve	i) Vendosen persona kontakti për çdo fushë dhe ekzistojnë katalogë të publikimeve dhe shërbimeve të tjera për përdoruesit e statistikave.

SHËNIME

* Kliti Ceca, Hilda Shijaku, Endrita Xhaferaj, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikës, Banka e Shqipërisë.
Artikujt e paraqitur në këtë botim, nuk shprehin gjithmonë opinionin zyrtar të Bankës së Shqipërisë. Këtyre artikujve lutemi t'u referoheni si mendime personale të autorëve.
Ky material ka për qëllim të japë një vlerësim mbi cilësinë e praktikës së shpërndarjes së të dhënave statistikore duke përfshirë mbledhjen e të dhënave, përpunimin dhe shpërndarjen e statistikave financiare dhe të bilancit të pagesave, nëpërmjet krahasimit të tyre me standardet e Fondit Monetar Ndërkombëtar.
[1] Referenca përkatëse jepet në: http://dsbb.imf.org/Applications/web/gdds/gddshome/
[2] Referenca përkatëse jepet në: http://dsbb.imf.org/Applications/web/sddshome/
[3] ROCS – Reports on the Observance of Standards and Codes.
[4] DQAF – Data Quality Assessment Framework. DQAF siguron një strukturë fleksibël për vlerësimin cilësor të shpërndarjes së statistikave dhe mund të përdoret në kontekste të ndryshme, përfshirë dhe vetëvlerësimin nga agjencitë kombëtare statistikore.
[5] Ligji nr.9180, datë 05.02.2004.
[6] Këtu përmendim zgjidhjet: SARS – Sistemi Automatik i Raportimit Statistikor dhe "Seritë kohore".
[7] Për referencë përmendim standardet e Projektit SDDS; për hollësi shiko: http://dsbb.imf.org
[8] Si objektiv për këtë në nivel ndërkombëtar merren standardet e SDDS-it; për hollësi shiko: http://dsbb.imf.org
[9] Normalisht merren vlerësime apo kërkesa nga përdoruesit kryesorë të informacionit, siç janë: Departamenti i Politikës Monetare, Departamenti i Mbikëqyrjes, Departamenti i Kërkimeve dhe FMN-ja. Në disa raste të tjera vlerësime apo kërkesa janë bërë dhe nga përdorues të tjerë jashtë institucionit.
[10] Konferenca I, "Informacioni statistikor në Shqipëri", organizuar nga Banka e Shqipërisë dhe INSTAT, është mbajtur në Tiranë, në 2-3 nëntor, 2000. Për hollësi shiko: www.bankofalbania.org
[11] Këtu kryesisht përfshihen "Monetary and financial statistics manual, IMF" botime të viteve 1984, 2000, "Balance of Payments Manual, IMF. Fifth edition, 1993" si dhe dokumentacion tjetër plotësues.
[12] Këtu përfshihen standarde si: "Europian system of accounts 1995 (1995 ESA).
[13] International Financial Statistics, publikime të FMN-së.
[14] Shtojmë se në këtë bashkëpunim Shqipëria është zgjedhur si vend pilot, vlerësuar për punën cilësore të realizuar.
[15] Sipas raportimit të fundvitit 2004, në Bankën e Shqipërisë janë të licencuara dy unione. Unioni "Jehona", me 42 ShKK anëtarë dhe "Unioni shqiptar i kursim

– kreditit" me 90 ShKK anëtarë.

[16] Në origjinal: timeliness.

[17] Këtu bëhet fjalë për përdoruesit e jashtëm, të cilët mund të përdorin informacionin për qëllime biznesi. Ky kriter synon parandalimin e favorizimit të një përdoruesi (ose grupi përdoruesish) të veçantë nëpërmjet dhënies së përparësisë në kohë.

REFERENCA

Kuvendi Popullor, (1997). Ligji "Për Bankën e Shqipërisë", nr. 8296, datë 23.12.1997.

Kuvendi Popullor, (2004). Ligji "Për Statistikat Zyrtare", nr.9180, datë 5.2.2004.

Banka e Shqipërisë, (2003). "Metodika e Statistikave Monetare dhe Financiare, Korrik 2003".

Banka e Shqipërisë, 2000, rregullorja"Për transparencën dhe konfidencialitetin në Bankën e Shqipërisë" nr. 53, datë 21.06.2000.

Banka e Shqipërisë, (2003) "Kodi i Etikës së Bankës së Shqipërisë", nr.46, datë 25.06.2003.

Banka e Shqipërisë, rregullorja "Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë" (së bashku me ndryshimet përkatëse).

Banka e Shqipërisë, rregullorja "Për licencimin e shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre".

IMF, (Korrik 2003). "Data Quality Assessment Framework".

IMF, (2000). "Manual of Montary and Financial Statistics, IMF".

IMF, (1993). "Balance of Payments Manual, 5th edition, IMF".

IMF, (1999). "Special Data Dissemination Standards, IMF".

IMF, (1999). "General Data Dissemination System, IMF".

BANKA E SHQIPËRISË DHE ANGAZHIMI I SAJ NË KUADËR TË PROCESIT TË STABILIZIM-ASOCIIMIT

*Ina Kraja**
Niuton Mulleti

Fjalë kyçe
- Integrimi evropian - MSA - Bashkim Evropian - Acquis communautaire -

"Integrimi evropian", "procesi i Stabilizim-Asociimit", "negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit": këta janë vetëm disa nga termat me të cilët qytetarët shqiptarë përballen çdo ditë, jo vetëm në median e shkruar dhe në atë vizive, por edhe në fjalorin e politikanëve dhe pse jo, edhe në bisedat e përditshme. Qëllimi i këtij artikulli të shkurtër është që të japë një informacion të përgjithshëm dhe sa më të kuptueshëm për lexuesin e thjeshtë, në lidhje me rolin e Bankës së Shqipërisë, si një institucion mjaft i rëndësishëm monetar dhe financiar në Republikën e Shqipërisë, i cili ka detyrimet e veta në kuadër të procesit të integrimit evropian në përgjithësi, dhe në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit në veçanti.

HAPI I PARË DREJT NJË BALLKANI PERËNDIMOR EVROPIAN: PROCESI I STABILIZIM-ASOCIIMIT

Vitet '90 shënuan një periudhë të konflikteve të dhunshme etnike dhe të një paqëndrueshmërie të theksuar politike pothuajse në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Në këto kushte, Komisioni Evropian ra dakord në muajin maj të vitit 1999, për parimet kryesore që do të udhëhiqnin një strategji më

ambicioze të Bashkimit Evropian (BE) në marrëdhëniet e kësaj organizate me vendet e rajonit. Këto parime konsistonin në:

- mendimin e Komisionit Evropian se motivimin kryesor për kryerjen e reformave në këto vende – duke përfshirë vendosjen e sundimit të ligjit, të institucioneve të qëndrueshme demokratike dhe të një ekonomie të lirë dhe të hapur tregu – do ta përbënte ofrimi i një perspektive të besueshme për anëtarësim të vendeve të rajonit në Bashkimin Evropian sapo që të përmbusheshin kushtet e vendosura nga kjo organizatë. Kjo perspektivë e qartë për anëtarësim në të ardhmen e vendeve të Ballkanit Perëndimor, u ofrua për herë të parë në Samitin e Feiras në qershor 2000 dhe u rikonfirmua më me shumë forcë në Samitin e Selanikut, të mbajtur në qershor 2003;
- nevojën për vendosjen e marrëdhënieve dypalëshe ndërmjet vendeve të rajonit, gjë që do të krijonte mundësi për më shumë qëndrueshmëri politike dhe ekonomike në Ballkanin Perëndimor;
- nevojën për një përqasje më fleksibël, e cila do të lejonte çdo vend që të ecte në rrugën e tij drejt Bashkimit Evropian në mënyrë të pavarur, edhe pse do të ekzistonte një grup i kushteve ekonomike dhe politike, që do të zbatohej për të gjitha këto vende. Në të njëjtën kohë, programet e asistencës financiare dhe teknike do të duhet të hartoheshin në bazë të nevojave specifike të secilit vend.

Të gjitha këto parime të vendosura nga Komisioni Evropian u konkretizuan në Samitin e Zagrebit të datës 24 nëntor 2000, ku u paraqitën edhe elementet përbërëse të Procesit të Stabilizim-Asociimit (PSA). Në këmbim të perspektivës së qartë për anëtarësim në Bashkimin Evropian, bazuar në Traktatin e Mastrihtit dhe kriteret e Kopenhagenit si dhe në përgjigje të asistencës të ofruar nga Bashkimi Evropian, vendet e rajonit u angazhuan që të përmbushnin kushtet e vendosura nga kjo organizatë dhe të përdornin Procesin e Stabilizim-Asociimit e në veçanti Marrëveshjet e Stabilizim-Asociimit (MSA), në mënyrë që të përgatiteshin për një anëtarësim të ardhshëm në Bashkimin Evropian.

Procesi i Stabilizim-Asociimit konsiston në këto elemente të mëposhtme:

a) Marrëveshjet e Stabilizim-Asociimit: Këto marrëveshje përbëjnë si thelbin e PSA-së, ashtu edhe një hap mjaft të rëndësishëm drejt realizimit të plotë të këtij procesi. Nënshkrimi i MSA-ve përfaqëson angazhimin dhe vullnetin e palëve nënshkruese për të përfunduar brenda një periudhe kalimtare një asociim formal me BE-në. MSA-të ofrojnë mekanizmat formalë dhe pikat e referimit, që e lejojnë BE-në të punojë me secilin vend në mënyrë që t'i sjellë ato më afër standardeve të BE-së.

MSA-të përqendrohen në respektimin e parimeve themelore demokratike si dhe të elementeve bazë të tregut unik të BE-së. Përmes krijimit të një zone të tregtisë së lirë me BE-në, shoqëruar edhe me fushat (rregullat e konkurrencës dhe të ndihmës shtetërore, pronësia intelektuale etj.) dhe përfitimet (për shembull, e drejta e vendosjes në vendet e BE-së) e lidhura me këtë treg, ky proces do të lejojë ekonomitë e gjithë rajonit që të fillojnë të integrohen gradualisht me atë të BE-së. Për ato fusha ku marrëveshjet nuk vendosin detyrime specifike në lidhje me *acquis communautaire* (legjislacioni komunitar) të BE-së, ekzistojnë dispozita që kanë të bëjnë me bashkëpunimin e detajuar me BE-në, me synim kryesor dhënien e ndihmës këtyre vendeve për t`u afruar me standardet e BE-së.

MSA-të janë të përgatitura sipas rrethanave specifike të secilit vend. Sidoqoftë, siç u tha më sipër, synimi i çdo MSA-je është arritja e një asociimi zyrtar ndërmjet çdo vendi të Ballkanit Perëndimor dhe BE-së, dhe ky asociim do të realizohet përmes zbatimit të një sërë detyrimesh, të cilat janë të njëjta për secilin vend.

Vetë mekanizmat e krijuar nga këto marrëveshje, duke filluar nga nënkomitetet e specialistëve dhe teknicienëve e deri tek organet e nivelit politik, siç është Këshilli i Stabilizim-Asociimit, do të lejojnë që BE t'i kushtojë rëndësi reformave sipas përparësive që ato paraqesin si dhe t'i formësojë ato sipas modeleve të BE-

së, të zgjidhë problemet e mundshme dhe të mbikëqyrë zbatimin e tyre nga vendet nënshkruese. Zbatimi i plotë i MSA-ve është një parakusht për vlerësimin e mundësisë që një vend ka për t'u anëtarësuar në BE.

b) Asistenca e BE-së: Programi i BE-së CARDS (Asistenca Komunitare për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilizim) i ka shtuar asistencës për vendet e PSA-së një përbërës që synon lehtësimin e rrugës së tyre drejt BE-së. Kjo asistencë përdoret kryesisht për të mbështetur financiarisht dhe teknikisht kryerjen e reformave dhe ndërtimin e kapaciteteve institucionale që parashikohen në MSA.

c) Dimensioni rajonal: PSA nuk është thjesht një proces dypalësh ndërmjet BE-së dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor, por në të njëjtën kohë, ai i jep një rëndësi të veçantë bashkëpunimit rajonal. MSA-të përmbajnë dispozita të posaçme, që parashikojnë një angazhim të qartë të secilit vend për të bashkëpunuar nga afër me vendet e tjera të përfshira në PSA. Në të njëjtën kohë, edhe CARDS ka një përbërës të rëndësishëm rajonal.

Më konkretisht, dimensioni rajonal i PSA-së parashikon që vendet e rajonit të firmosin me njëri-tjetrin konventa të bashkëpunimit rajonal si dhe të krijojnë një rrjet të marrëveshjeve dypalëshe të tregtisë së lirë (si pjesë e konventave të mësipërme). Kjo do të thotë që nuk do të ekzistojnë më pengesa për lëvizjen e lirë të mallrave ndërmjet vendeve të rajonit ashtu si edhe me BE-në. Edhe integrimi i vendeve të Ballkanit Perëndimor me rrjetet evropiane të infrastrukturës (transporti, energjia, administrimi i kufijve) përbëjnë një tjetër element të rëndësishëm të dimensionit rajonal të PSA-së.

SHQIPËRIA DHE PROCESI I STABILIZIM-ASOCIIMIT

Marrëdhëniet e para kontraktuale midis Shqipërisë dhe BE-së u vendosën në vitin 1992, nëpërmjet nënshkrimit të Marrëveshjes së Tregtisë dhe Bashkëpunimit. Menjëherë pas adoptimit të PSA-

së, në vitin 2001, Komisioni Evropian vendosi që të procedonte me negociatat për nënshkrimin e MSA-së me Shqipërinë, ndërsa direktivat për negociatat me vendin tonë u miratuan nga BE, në tetor 2002. Këto negociata u hapën më 31 janar 2003 dhe deri më tani janë zhvilluar 6 raunde zyrtare dhe 9 raunde teknike, ku edhe janë negociuar dhe mbyllur pjesa më e madhe e neneve të marrëveshjes.

Në të njëjtën kohë, në vitin 2004, ashtu si edhe për të gjitha vendet e rajonit, Komisioni Evropian paraqiti Dokumentin e Partneritetit Evropian për Shqipërinë. Ky dokument përcaktonte konkretisht fushat në të cilat duhet të kryheshin reforma, shoqëruar kjo edhe me afatet përkatëse. Në përgjigje të këtij dokumenti, Qeveria Shqiptare miratoi në shtator 2004 Planin e Veprimit për Zbatimin e Përparësive të Partneritetit Evropian. Ky Plan i Veprimit përmbante, në formë tabelore, të gjitha masat që institucionet shqiptare (përshirë edhe Bankën e Shqipërisë) do të duhet të ndërmerrnin në kuadër të detyrimeve që rridhnin nga Dokumenti i Partneritetit Evropian. Sidoqoftë, megjithë miratimin e këtij Plani të Veprimit, bazuar edhe në rekomandimet e Komisionit Evropian dhe në përvojën e vendeve që kanë kaluar më parë përmes një procesi të ngjashëm, Qeveria Shqiptare vazhdoi punën për hartimin dhe adoptimin e Planit Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit Vendas me atë të BE-së dhe zbatimit të angazhimeve që rrjedhin nga MSA, i cili do të plotësonte dhe do të përmirësonte angazhimet e ndërmarra në Planin e Veprimit.

Ky Plan Kombëtar i Përafrimit të Legjislacionit (PKPL), i cili u miratua në maj të vitit 2005, ka si pikësynim kryesor sigurimin e përshtatjes dhe përafrimit të legjislacionit vendas me atë komunitar si dhe zbatimin rigoroz të tij. Në të njëjtën kohë, ky Plan ofron një kalendar të qartë, me afate të përcaktuara (në periudhë afatshkurtër, afatmesme ose afatgjatë), mbi të cilin çdo institucion përgjegjës do të mbështesë punën e tij në të ardhmen, në kuadër të detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integrimit evropian.

BANKA E SHQIPËRISË DHE MARRËVESHJA E STABILIZIM-ASOCIIMIT

Që nga fillimi i negociatave për nënshkrimin e MSA-së në janar 2003, Banka e Shqipërisë ka qenë e përfaqësuar në grupin negociator shqiptar, duke marrë pjesë në të gjitha raundet zyrtare dhe teknike të negociatave, të cilat janë zhvilluar deri tani. Banka e Shqipërisë ka qenë sidomos e angazhuar në negocimin e periudhave tranzitore të disa neneve të marrëveshjes, prej të cilëve dy janë të një rëndësie të veçantë: nenet 57 dhe 61.[1]

Neni 57, i cili mbulon fushën e ofrimit të shërbimeve, parashikon që palët nënshkruese do të marrin masat e nevojshme që të lejojnë progresivisht ofrimin e shërbimeve nga kompani ose shtetas të BE-së ose të Shqipërisë në vendet përkatëse. Në të njëjtën kohë, ky nen parashikon që duke filluar nga viti i tretë pas hyrjes në fuqi të MSA-së, Këshilli i Stabilizim-Asociimit do të marrë masat e nevojshme për të zbatuar progresivisht detyrimet e ndërmarra si më sipër.

Për sa i përket ofrimit të shërbimeve bankare në Shqipëri nga operatorët komunitarë, fushë kjo ku sipas këtij neni Banka e Shqipërisë është drejtpërdrejt përgjegjëse, duhet theksuar që mbështetur në legjislacionin ekzistues vendas, nuk ka asnjë pengesë, kufizim apo diskriminim në lidhje me ofrimin e këtyre shërbimeve në territorin e Shqipërisë. Për këtë arsye, zbatimi i këtij neni nuk pritet të paraqesë ndonjë problem të madh për Bankën e Shqipërisë.

Neni 61, i cili mbulon liberalizimin e llogarisë kapitale dhe financiare të bilancit të pagesave mbart një rëndësi mjaft të madhe.

Bazuar në këtë nen:

- duke filluar nga hyrja në fuqi e MSA-së, palët do të sigurojnë lëvizjen e lirë të kapitalit lidhur me investimet direkte të bëra nga kompani, që janë themeluar në përputhje me ligjet e vendit pritës së bashku me likuidimin apo riatdhesimin e këtyre

investimeve si dhe të çdo fitimi që rrjedh nga këto investime.

- duke filluar nga hyrja në fuqi e MSA-së, palët do të sigurojnë lëvizjen e lirë të kapitalit lidhur me kreditë e lidhura me transaksionet tregtare apo ofrimin e shërbimeve, si dhe të huave dhe kredive financiare me maturitet më të madh se një vit.
- duke filluar nga fillimi i periudhës së dytë kalimtare (pesë vjet pas hyrjes në fuqi të MSA-së), palët do të sigurojnë lëvizjen e lirë të kapitalit lidhur me investimet e portofolit si dhe të huave dhe kredive financiare me maturitet më të vogël se një vit.
- për sa i përket blerjes së pasurive të paluajtshme nga shtetas të BE-së, Shqipëria është e detyruar që brenda një periudhe dhjetëvjeçare nga hyrja në fuqi e MSA-së, të sigurojë progresivisht blerjen e tokës bujqësore, të kullotave, të tokës bregdetare dhe pyjeve nga shtetasit e huaj, sipas të njëjtave kushte dhe procedura që zbatohen edhe për shtetasit shqiptarë.

Legjislacioni shqiptar në fushën e lëvizjeve të kapitalit përfaqësohet nga rregullorja "Për veprimtarinë valutore", miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë në korrik 2003. Sipas kësaj rregulloreje, flukset hyrëse të kapitalit në Shqipëri janë tërësisht të liberalizuara, ndërsa për sa i përket daljes së kapitalit, ky proces nuk kërkon më autorizim nga Banka e Shqipërisë, por ky transferim kryhet nga subjekte të licencuara nga Banka e Shqipërisë, pra banka dhe jobanka, pas plotësimit të dokumentacionit të kërkuar. Me qëllim liberalizimin total të këtij procesi dhe përputhjen e plotë me *acquis*-in e BE-së, si dhe të faktit që transaksionet e llogarisë kapitale nuk janë në varësi të drejtpërdrejtë vetëm të Bankës së Shqipërisë, por ekzistojnë edhe institucione të tjera që kanë detyrimet e tyre si lidhur me shitblerjen e tokës, veprimet e lëvizjes fizike të kapitalit, investimet direkte etj., është gjykuar i nevojshëm nga Banka e Shqipërisë hartimi i ligjit "Për regjimin e këmbimeve valutore", i cili do të pasqyrojë *acquis*-in e BE-së në këtë fushë.

Hartimi dhe miratimi i këtij ligji kaq të rëndësishëm sigurisht që është përfshirë në Planin Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit

(PKPL), së bashku edhe me një sërë ligjesh (si për shembull, ligji "Për bankat në Republikën e Shqipërisë") dhe aktesh normative (kryesisht në fushën e mbikëqyrjes bankare dhe të sistemit të pagesave), të cilat do të duhet të amendohen nga Banka e Shqipërisë dhe të përshtaten me *acquis*-in, brenda afateve të përcaktuara në këtë Plan.

RRUGA DREJT BE-SË: ÇFARË NA PRET NË TË ARDHMEN?

Siç e thamë edhe më lart, me nënshkrimin e MSA-së ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së, midis palëve do të jetë krijuar një asociim formal, i cili sigurisht që do të përbëjë një rritje në nivelin e marrëdhënieve dypalëshe. Pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, fokusi do të jetë mbi zbatimin e saj në praktikë. Banka e Shqipërisë, ashtu si edhe institucionet e tjera përgjegjëse, detyrimet e saj për zbatimin e dispozitave përkatëse do t'i kryejë bazuar në Planin Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit.

Në të njëjtën kohë, duhet përmendur një zhvillim i ri që ka të bëjë me përgatitjen e Instrumentit për Para-Anëtarësim *(Instrument for Pre-Accession)* nga ana e Komisionit Evropian. Pika më e rëndësishme dhe domethënëse e këtij instrumenti është konsiderimi i Shqipërisë (së bashku me Bosnjë-Hercegovinën, Maqedoninë dhe Serbinë-Malin e Zi) si një "kandidat potencial për anëtarësim", një status ky që konfirmon dhe përforcon perspektivën e qartë për anëtarësim, që iu ofrua vendeve të rajonit tonë në Samitin e Feiras dhe sidomos në atë të Selanikut, në vitin 2003.

Duke u bazuar edhe në përvojën e deritanishme të vendeve të rajonit (Bullgari, Rumani dhe Kroaci), të cilat ose pritet të anëtarësohen së shpejti në BE ose të fillojnë negociatat për anëtarësim, mund të parashikojmë edhe serinë e ngjarjeve që do të pasojnë hyrjen në fuqi të MSA-së. Vijimi i hapave të mëtejshëm të procesit të integrimit do të jetë i tillë: aplikimi për statusin e vendit kandidat për anëtarësim, pranimi i këtij statusi nga ana e BE-së, fillimi i negociatave për anëtarësim, negocimi

dhe mbyllja e të 31 kapitujve të *acquis*-it, mbyllja zyrtare e negociatave për anëtarësim, nënshkrimi i traktatit të anëtarësimit të vendit në BE, ratifikimi i këtij traktati nga të gjitha vendet e BE-së dhe së fundmi, anëtarësimi i mundshëm në BE. Kohëzgjatja e këtij procesi varet, në masën më të madhe, nga ritmi i kryerjes së reformave prej vendit që aspiron për anëtarësim, por në të njëjtën kohë, edhe vendimi i vendeve anëtare të BE-së se me çfarë shpejtësie do të mundësojnë pranimin e vendeve të reja anëtare në gjirin e organizatës, është një faktor me ndikim të konsiderueshëm.

Sidoqoftë, ajo çfarë mund të themi si përfundim është fakti që procesi i integrimit evropian kërkon një angazhim mjaft të madh nga vendi aspirues për anëtarësim, i cili jo vetëm që duhet të ketë dëshirë dhe të tregojë vullnet për anëtarësim në BE, por në të njëjtën kohë duhet të zotërojë aftësi të mjaftueshme institucionale, financiare dhe profesionale për të realizuar reformat rrënjësore të nevojshme për një anëtarësim me të drejta të plota në BE. Në këtë kuadër, edhe Banka e Shqipërisë me siguri që do të jetë e angazhuar në përmirësimin e vazhdueshëm të kuadrit të saj institucional, operacional dhe ligjor, gjë që do të mundësonte një përafrim dhe përputhshmëri me sa më pak probleme të Bankës së Shqipërisë me standardet, me modelet dhe me praktikat më të mira të Bashkimit Evropian, në përgjithësi dhe të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore, në veçanti.

SHËNIME

*Ina Kraja, Drejtore, Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun. Niuton Mulleti, Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun, Banka e Shqipërisë.
Artikujt e paraqitur në këtë botim, nuk shprehin gjithmonë opinionin zyrtar të Bankës së Shqipërisë. Këtyre artikujve lutemi t'u referoheni si mendime personale të autorëve.
[1] Duke qenë se MSA nuk është nënshkruar ende, duhet patur parasysh që dispozitat e këtyre neneve që do të diskutohen më poshtë përfaqësojnë versionin më të fundit dhe jo domosdoshmërisht atë përfundimtar.

INDEKSI I AFTËSISË SË SHËRBIMIT TË BORXHIT SOVRAN: A KA ARDHUR KOHA QË SHQIPËRIA TA SIGUROJË ATË? (SOVEREIGN CREDIT RATING)

*Laert Dogjani**

Fjalë kyçe
- Indeksi i Aftësisë së Shërbimit të Borxhit Sovran - Kompani Indeksimi - Rreziku i borxhit -

Shqipëria është i vetmi vend në Evropë i cili nuk ka një Indeks të Aftësisë së Shërbimit të Borxhit Sovran (IASHBS). Megjithëse ka pasur disa përpjekje për të siguruar një indeks të tillë, për shkak të një numri faktorësh, analiza e të cilëve nuk është objekt i këtij shkrimi, vendi ynë ende nuk ka lëvizur konkretisht në këtë drejtim. Ndërkohë, sektori privat tashmë ka një institucion në sistemin bankar, i cili ka siguruar këtë indeks (megjithëse nëpërmjet grupit qendror). Banka Procredit në Shqipëri e ka siguruar këtë indeks që nga data 15 dhjetor 2004.

ÇFARË ËSHTË IASHBS?

Ky indeks është një vlerësim mbi aftësinë e kredimarrësit për ta shërbyer dhe kthyer përfundimisht borxhin ose mbi mundësinë e falimentimit. Në rastet kur borxhi merret nga qeveritë e shteteve atëherë i gjithë procesi i indeksimit është më i gjerë se sa për një kompani të caktuar, private apo shtetërore. Kompanitë kryesore në botë të cilat ofrojnë shërbimin e indeksimit janë, Standard & Poors, Moody's dhe Fitch Ratings. Këto kompani e ofrojnë këtë shërbim kundrejt një pagese dhe indeksi i përcaktuar prej tyre njihet botërisht nga investitorët për shkak se puna e tyre gëzon, thjeshtësi dhe krahasueshmëri, besueshmëri,

transparencë dhe pavarësi. Për këtë arsye, ky indeks luan një rol mjaft të rëndësishëm nga pikëpamja e reklamës për tërheqjen e investimeve të huaja direkte.

Ja si e përkufizojnë këto firma këtë indeks:

S&P- "Vlerësim i aftësisë dhe dëshirës së një qeverie për të shërbyer borxhin e saj në vlerë dhe në kohë."

FITCH- "Opinion mbi besueshmërinë e një borxhi të emetuar…Nuk është një rekomandim për të blerë apo për të shitur një letër me vlerë…"

Moody's…"Deklarime opinioni dhe jo deklarime faktesh…"

Pra, indeksi nuk duhet marrë si rekomandim në lidhje me aftësinë e një vendi për të shërbyer borxhin në të ardhmen, por vetëm si një nga treguesit që një investitor duhet të ketë parasysh para se të marrë një vendim në lidhje me një investim të mundshëm në një letër me vlerë të një vendi të caktuar, të emetuar në tregjet ndërkombëtare të parasë.

VLERAT E INDEKSIT

Secila prej kompanive ka mënyrën e saj për të shprehur vlerën e indeksit. Ai paraqitet në trajtën e shkronjave duke filluar nga A e deri në shkronjën D. Konkretisht, vlerësimi më i lartë për Standard & Poors shprehet në trajtën AAA. Kjo trajtë paraqet mundësinë më të vogël të emetuesit të borxhit për të falimentuar. Megjithëse caktimi i shkronjave është i ndryshëm për të treja kompanitë, fare thjesht mund të bëhen paralelizma të këtyre indekseve si në tabelën më poshtë:

Fitch	Standard & Poor's	Moody's
AAA	AAA	Aaa
AA+	AA+	Aa1
AA	AA	Aa2
AA-	AA-	Aa3
A+	A+	A1
A	A	A2

A-	A-	A3
BBB+	BBB+	Baa1
BBB	BBB	Baa2
BBB-	BBB-	Baa3
BB+	BB+	Ba1
BB	BB	Ba2
BB-	BB-	Ba3
B+	B+	B1
B	B	B2
B-	B-	B3
CCC	CCC	Caa
CC	CC	Ca
C	C	C
D	D	D
NR	NR	NR

Indeksi NR (not rated) do të thotë që kompania apo vendi nuk është indeksuar.

KUR DUHET SIGURUAR NJË INDEKS I TILLË?

Në Memorandumin Shtesë të Politikave Ekonomike dhe Financiare, janar 2004, Qeveria Shqiptare i premton Fondit Monetar Ndërkombëtar se, "ne do të kërkojmë zyrtarisht një *sovereign rating* përpara fundit të vitit 2004." Në fakt është e vështirë të argumentosh se në ditët e sotme të globalizimit dhe të integrimit një vend të mund të plotësojë nevojat e tij për kredi pa iu drejtuar tregjeve financiare ndërkombëtare. Edhe debati në lidhje me kohën se kur një vend duhet të fillojë të tërheqë fonde nga tregjet ndërkombëtare nuk është shumë i gjerë, por për shkak se Qeveria Shqiptare e ka tejkaluar premtimin e dhënë ndaj FMN-së le të ndalojmë pak te kjo pikë.

Sigurisht, përgjigjja e pyetjes është fare e thjeshtë, indeksi duhet siguruar atëherë kur të jetë i nevojshëm. Por, të thuash se indeksi nuk është i nevojshëm për sa kohë që Shqipëria mund të sigurojë fonde nga burime të tjera (FMN, BB, BERZH, grante të qeverive të ndryshme) me kosto më të ulët se ajo e tregjeve ndërkombëtare, nuk është tërësisht e vërtetë. Vlera e indeksit ka lidhje direkte me normën e interesit që kërkohet nga investitorët e huaj mbi një borxh të emetuar pasi ai tregon mundësinë e mosshërbimit të borxhit (riskun e kreditit) të një vendi të caktuar. Edhe në qoftë se një vend kërkon që t'i caktohet një indeks

përpara kohës kur do të fillojë emetime të letrave me vlerë në tregjet ndërkombëtare, kosto e vetme për t'u përballuar është pagesa vjetore ndaj kompanisë që e ofron shërbimin. Në rastin kur ky shërbim do të kërkohej pranë njërës prej këtyre kompanive (siç ndodh në vendet fqinje) kostoja nuk do ta kalonte vlerën e 50 mijë dollarëve amerikanë në vit. Ndërkohë, Qeveria Shqiptare do të dinte saktësisht vlerën e indeksit, do të kishte mjaft të qartë hapat që duhen ndërmarrë për ta përmirësuar atë, në mënyrë që kur të vijë koha për të emetuar borxh në tregjet ndërkombëtare të parasë norma e interesit që do të duhej të paguanim të ishte sa më e ulët. Në të vërtetë, parametrat që duhen përmirësuar në mënyrë që të përmirësohet indeksi janë të shumtë.

PARAMETRAT QË VLERËSOHEN (RIVLERËSOHEN) GJATË PROCESIT TË CAKTIMIT TË INDEKSIT

Kompanitë mbledhin të dhëna dhe zhvillojnë takime me një numër të konsiderueshëm institucionesh shtetërore dhe institucione joqeveritare. Të dhënat që kërkohen prej tyre gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut të borxhit sovran mund të grupohen si më poshtë:

- Rreziku politik.
- Të ardhurat dhe struktura ekonomike.
- Parashikimet për rritje ekonomike.
- Fleksibiliteti fiskal.
- Borxhi i përgjithshëm i qeverisë.
- Detyrimet dhe shëndeti i sektorit financiar.
- Fleksibiliteti monetar.
- Likuiditeti i jashtëm.
- Borxhi i jashtëm i sektorit publik.
- Borxhi i jashtëm i sektorit privat.

Kompanitë e listimit dhe të renditjes së borxhit, secilën prej këtyre fushave e ndajnë në nëngrupe gjatë analizës së tyre. Sa më të mirë të jenë parametrat në secilën prej këtyre fushave aq më e lartë do të jetë edhe vlera e indeksit dhe, si rrjedhim aq më e ulët norma e interesit që do të duhej të paguanim

ndaj investitorëve të huaj, të cilët do të investonin në borxhin e emetuar prej qeverisë tonë.

Shteti Shqiptar deri tani ka plotësuar nevojat për fonde në valutë të huaj për të kryer investime (kryesisht në infrastrukturë rrugore dhe energjitikë) nëpërmjet granteve të ndryshme dhe kredive me terma të zbutur nga institucione të ndryshme ndërkombëtare dhe qeveri të huaja. Por për herë të parë, në fund të qershorit të këtij viti Qeveria Shqiptare miratoi financimin nëpërmjet një kredie bankare me terma tregtarë të hekurudhës së re Tiranë-Durrës. Pa dashur të argumentojmë mbi kthimin e këtij investimi (megjithëse kredia ka terma tregtarë libor +5 dhe është kundërshtuar nga FMN dhe BB) apo nëse këto para mund të siguroheshin nga BERZH, BEI apo ndonjë institucion tjetër me terma më të ulët, le ta marrim këtë fakt si dëshmi se Shqipëria tashmë nuk mund të marrë më kredi (ose nuk mund t'i plotësojë të gjitha nevojat) me terma të zbutur.

Sidoqoftë, edhe në qoftë se vendi ynë ka mundësi që për një periudhë të shkurtër të vazhdojë të sigurojë kredi me terma të zbutur, IASHBS duhet të ishte porositur pranë një ose dy kompanive që e ofrojnë këtë shërbim. Arsyet po i radhisim më poshtë:

1) EFEKTI MARKETING

Eshtë arsyeja kryesore për të siguruar IASHBS edhe në qoftë se një vend i caktuar mund të sigurojë financime me terma jotregtarë. Aktualisht, Shqipëria është vendi i fundit në Evropë i cili nuk ka një IASHBS. Vendet e rajonit e kanë siguruar një indeks të tillë gjatë 2 viteve të fundit megjithëse edhe ato vazhdojnë të marrin grante dhe kredi me terma të zbutur. Edhe Moldavia, vendi më i varfër në Evropë, ka një IASHBS të cilin e ka siguruar vite më parë. Një reklamë çerek faqe në gazetën "Financial Times" kushton 15,456£, ndërkohë që sigurimi i indeksit kushton rreth 50,000 usd në vit, në varësi të specifikave të porosisë. Duket qartë që nga pikëpamja reklamuese kostoja e sigurimit të këtij indeksi është mjaft e justifikueshme. Në qoftë se do të shtojmë këtu edhe problemet në besueshmërinë e të dhënave dhe kohëzgjatjen e shkurtër të serive kohore

ekonomiko-financiare shqiptare, një indeks i tillë i besueshëm dhe i pavarur do të shtonte praninë e Shqipërisë në analizat ekonomike e financiare të institucioneve të huaja. Me pak fjalë, do të shtohej një tregues në sytë e investitorëve të huaj dhe do të hidhej hapi i parë drejt pranisë tonë në tregjet ndërkombëtarë të fondeve.

Pas sigurimit fillestar të indeksit, rregullisht çdo vit ose edhe më shpesh me kërkesë të qeverisë bëhet një rivlerësim i tij. Tashmë, vlera e indeksit do të shtohej pasi duke pasur parasysh reformat pozitive të kryera në Shqipëri, indeksi gjatë këtyre viteve do të kishte shënuar rritje dhe të paktën një herë në vit do t'i kishte siguruar Shqipërisë prani në rrjetet globale të lajmeve ekonomiko-financiare të tipit "Moody's rrit indeksin e borxhit të Shqipërisë me një pikë." Pavarësisht faktit nëse Shqipëria të kishte shitur ose jo letra me vlerë në tregjet ndërkombëtare, kjo prani apo reklamë e justifikon mjaft mirë koston e saj.

Për më tepër, do të kishim një tregues të pavarur e të besueshëm nga kompani të huaja private të vlerësimit të punës së qeverisë, në drejtim të besueshmërisë dhe aftësisë financiare të Shtetit Shqiptar për të marrë dhe për të shërbyer kredi të huaja. Një numër institucionesh ndërkombëtare nxjerrin renditje të ndryshme të vendeve në këtë fushë (BERZH dhe banka të tjera investimi) por indeksi i këtyre kompanive (Moody's, Standard & Poors dhe Fitch) është indeksi kryesor për tregjet e huaja ndërkombëtare të fondeve. Puna në drejtim të përmirësimit të këtij indeksi kryesor (reformat në fushat e përrmendura më sipër) do të reflektohej menjëherë edhe në indekset e institucioneve të tjera, pasi nuk është indeksi qëllim në vetvete por reformat të cilat e përmirësojnë atë dhe si rrjedhojë aftësinë e vërtetë të shtetit tonë për të marrë fonde në tregjet e huaja ndërkombëtare, për t'i përdorur ato në fusha me interes drejt zhvillimit afatgjatë e të qëndrueshëm sidomos në infrastrukturë e më tej.

2) EKSPERIENCA E PËRFITUAR GJATË PROCESIT TË LLOGARITJES SË INDEKSIT

Prania në tregje të huaja ndërkombëtare të parasë sjell nevojën

për një grup ekspertësh lokalë. Këta specialistë përfshihen gjatë gjithë vitit në analizat dhe sigurimin e informacioneve për agjencitë e listimit si dhe në një të ardhme të afërt, në procesin e emetimit të borxhit (letrave me vlerë) në tregjet e huaja ndërkombëtare, kryesisht nëpërmjet një konsulenti të specializuar në këtë fushë.

3) HISTORIKU I BESUESHMËRISË NË SHLYERJEN E KREDIVE (CREDIT WORTHINESS)

Duhet theksuar se indeksi përbën vetëm njërin prej faktorëve që analizohet nga investitorët e huaj gjatë procesit të blerjes së borxhit të një vendi të caktuar. Një faktor tjetër mjaft i rëndësishëm është historiku i shlyerjes së borxheve të vendit. Në rastin kur një vend i caktuar tregohet mjaft i rregullt në shërbimin e borxhit, ai mund të përfitojë kredi me norma më të ulëta se sa normalisht duke konsideruar IASHBS. Paralelizmi më i thjeshtë që mund të bëhet në këtë rast është ai i kartave të kreditit në nivel mikro. Kështu, pas vlerësimit të parë të besueshmërisë së individit në kthimin e borxhit, kompanitë e kartave të kreditit në rast se borxhet shlyhen në kohë rrisin shumën që një individ mund të shpenzojë dhe ulin interesin apo pagesat mbi këtë borxh.

MANGËSITË E INDEKSIT

- Indeksi përcakton vetëm mundësinë e mosshërbimit të borxhit (*probability of default*). Konkretisht, AAA 5-vjet 0.10 për qind, BBB- 5-vjet 3.02 për qind, B 5-vjet 30.23 për qind.
- Testimet e deritanishme statistikore janë të pamjaftueshme (mungesë të dhënash në kohë).
- Nuk është në gjendje të parashikojë kriza (1997-2002, Pakistani, Rusia, Ekuadori, Ukraina, Moldavia dhe Argjentina, kriza në Azi (mosshërbim i borxhit në monedhë vendase).

Si përfundim, analiza e mësipërme mbështet tezën se vendi ynë është mjaft prapa në kohë drejt sigurimit të Indeksit të

Aftësisë së Shërbimit të Borxhit Sovran. Në qoftë se Shqipëria do ta siguronte tani indeksin, ai do të ishte në bandën Ba2 – B2 (sipas Moody's). Procesi për sigurimin e këtij indeksi zgjat rreth 3 muaj. Ndërkohë, populli shqiptar ka filluar të shërbejë kredinë e parë me terma tregtarë.

BURIME TË KONSULTUARA:

1) www.fitchratings.com
2) www.moodys.com
3) www.stadardandpoors.com
4) www.bis.org
5) Ashok Vir Bhatia - IMF working papers (WP/02/170)
6) Postë elektronike me personelin e kompanive të përmendura më sipër
7) www.biznesi.com.al
8) www.setimes.com
9) Memorandumi Shtesë i Politikave Ekonomike dhe Financiare

SHËNIME

* Laert Dogjani, specialist, Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun, Banka e Shqipërisë.
Artikujt e paraqitur në këtë botim, nuk shprehin gjithmonë opinionin zyrtar të Bankës së Shqipërisë. Këtyre artikujve lutemi t'u referoheni si mendime personale të autorëve.

DY FJALË MBI SIGURIMIN E DEPOZITAVE

*Silva Seiko**

Fjalë kyçe
- Sigurim i depozitave - Skemë sigurimi - ASD - Falimentim - Kompensim -

Çfarë është sigurimi i depozitave? I shprehur thjesht është mbrojtja e depozitorëve kur banka nuk është më në gjendje të paguajë.

Në raste të tilla sistemi i sigurimit të depozitave, nëse ekziston dhe është institucionalizuar më parë dëmshpërblen depozitorët. Masa e dëmshpërblimit apo e sigurimit është e ndryshme nga shteti në shtet. Në shumë shtete, në fakt në pjesën më të madhe të shteteve të zhvilluara, sigurimi i depozitave është një aktor i rëndësishëm dhe i domosdoshëm i rrjetit të sigurimit financiar (*safety net player*) - i cili mbështet stabilitetin e sistemit financiar.

Lidhjet parësore të këtij rrjeti sigurimi janë sistemi rregullativ ligjor, sistemi strikt i mbikëqyrjes dhe autoriteteve të vendimmarrjeve të brendshme si dhe mekanizmi i kontrollit të bankave të ushtruara kryesisht nga bankat qendrore.

Ministria e Financave mund të ofrojë ndihmën e saj gjithashtu në pozicionin e huadhënësit të radhës së fundit.

Nëse lidhjet e mësipërme të rrjetit të sigurimit financiar nuk janë në gjendje të parandalojnë që një bankë të bëhet e paaftë për të paguar (insolvent), - që në fakt është një ngjarje e rrallë

në një sistem bankar të shëndoshë,- atëherë sistemi i sigurimit të depozitave hyn në skenë si burimi i fundit për depozitorët. Sistemet e sigurimit të depozitave në përgjithësi, e përqendrojnë vëmendjen në mbrojtjen maksimale të depozituesve. Kjo ndodh meqenëse këta depozitues nuk janë në gjendje, që në çdo kohë të vlerësojnë bankën ku kanë investuar ose duan të investojnë kursimet e tyre, pasi kanë njohuri të kufizuara për aktivitetin financiar dhe për operacionet financiare dhe bankare.

Qëllimi parësor i skemës së sigurimit është të mbrojë depozitorët e vegjël. Bankat janë të detyruara të jenë anëtare të skemës së sigurimit të depozitave, të paguajnë primin e sigurimit sipas ligjit të çdo vendi. Kështu që nëse një bankë bëhet (insolvente) e paaftë për të paguar të kemi fonde të mjaftueshme, të vlefshme për të dëmshpërblyer depozitorët. Si rrjedhim, skema e sigurimit financohet nga vetë banka dhe përfituesi është depozituesi (klienti i saj).

Për pjesën më të madhe të depozituesve, shuma e mbulimit e njohur me ligj, mbulon pothuajse të gjitha fondet e depozituara gjithnjë sipas kufizimeve aktuale të kufirit të shumës së mbulimit. Kështu që, nëse ndonjë bankë nuk është në gjendje të paguajë, sigurimi i depozitës është në gjendje të parandalojë trazirën e panikut ose të paktën efektin e tronditjes, kështu në këtë mënyrë kontribuon në ruajtjen e stabilitetit të sistemit financiar. Në vendin tonë, shuma e mbulimit është deri në 700.000 lekë apo ekuivalenten në monedhë të huaj. Karakteristikë bazë është që ky kufi llogaritet mbi shumën e agreguar të totalit të depozitave për çdo depozitues.

Administruesi ligjor i sigurimit të depozitave në Shqipëri është Agjencia e Sigurimit të Depozitave, ASD.

PAK HISTORI BOTËRORE

Qysh prej shekullit XIX zhvillimet apo luhatjet ekonomike shumë shpesh janë shoqëruar nga krizat, tronditja apo kolapsi i sistemeve bankare ose i disa bankave të mëdha.

Falimentimet dhe veçanërisht humbjet e depozituesve të vegjël që lidhen me to në mënyrë të dukshme, shtrojnë nevojën për parandalimin e humbjeve të tilla apo për lehtësimin e pasojave të kolapseve kur ato ndodhin.

Si rezultat i sa më sipër, nevoja e rregullimit dhe e mbikëqyrjes së institucioneve financiare të depozitave dhe kreditit, bëhet gjithnjë e më e domosdoshme.

Në gjysmën e dytë të shekullit XX u kuptua se bankat e veçanta dhe sistemi bankar botëror janë ngushtësisht të ndërlidhur e të ndërvarur, kështu që kontrolli i tyre nuk mund të kufizohej në kufijtë shtetërorë kombëtarë. Për këtë arsye, u krijua marrëveshja e njohur si Marrëveshja e Bazelit, që përfaqëson marrëveshjen e parë mbi rregullat dhe parimet e bankingut ndërkombëtar.

Përpjekja e dytë ishte ajo e krijimit të institucioneve ligjore financiare për të lehtësuar dëmet fillimisht në disa shtete e më pastaj, nga fundi i shekullit XX, në shumicën e shteteve.

Në dritën e fakteve, pavarësisht iniciativave ligjore nga shtete të veçanta për të hartuar rregullore të nevojshme për sigurimin e depozitave të kursimit, është një çudi që ngritja e skemave të sigurimit të depozitave që mbaheshin nëpër banka, u realizua vetëm pas një kohe relativisht më të gjatë. Ishte pikërisht kriza bankare në SHBA, e cila arriti përmasa katastrofike duke çuar drejt falimentimit më shumë se 10.000 banka, ajo që minimizoi besimin në sistemin bankar dhe krijoi panik, duke sjellë largimin nga bankat të një mase të madhe njerëzish.

Pikërisht në këtë kohë, janë SHBA që marrin iniciativën për mbrojtjen e depozituesve në nivel institucional ligjor, duke e bërë të detyruar sigurimin e depozitave, nëpërmjet krijimit të një institucioni për të mundësuar sigurimin e depozitave të quajtur FDIC (Federal Deposit Insurance Coorporation).

Më vonë, u krijuan me radhë në vende të ndryshme të Evropës skemat e sigurimit të depozitave dhe institucionet e tyre. Në vitet 1974 në Gjermani, në Spanjë në vitin 1977, në Francë dhe në

Hollandë në vitin 1980, në Britaninë e Madhe në vitin 1982, në Belgjikë në vitin 1985. Megjithatë, këto sisteme ndyshonin shumë nga njëri-tjetri. Në disa prej tyre skema ishte shtetërore, në disa private, anëtarësimi ishte mandator ose vullnetar. Ajo që vihet re është se ka një ndryshueshmëri të madhe midis skemave lidhur me produktet, llogaritjen dhe pagesën e primit në skemën e sigurimit. Në mes të viteve 1990, pas një pune përgatitore të gjatë, Evropa Perëndimore mori hapa të tjerë në lidhje me sigurimin e depozitave. Direktivat no 94/95 EEC hynë në fuqi në 01 korrik 1995. Direktiva e re bëri që mbledhja e depozitave të kushtëzohet me sigurimin e tyre. Ajo përcaktoi se duhet të ketë të paktën një sigurues depozitash në çdo vend. Në fund të vitit 1995 vendet e fundit të Evropës Lindore, Hungaria, Republika Çeke dhe Polonia themeluan institutet e tyre të sigurimit të depozitave.

Kjo periudhë përkon edhe me kohën kur me rekomandimin e institucioneve financiare ndërkombëtare si Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar edhe në Shqipëri filloi puna përgatitore për ngritjen e institucionit të sigurimit të depozitave, e cila u finalizua në 29 mars 2002 kur Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 8873 "Për sigurimin e depozitave".

Ç`ËSHTË AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE DHE AMBIENTI NË TË CILIN U KRIJUA

Agjencia e Sigurimit të Depozitave në Shqipëri si një institucion me karakter tërësisht publik, u krijua në tetor të vitit 2002 në zbatim të ligjit nr. 8873, datë 29.03.2002 "Për sigurimin e depozitave" të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë dhe dekretuar nga Presidenti i Shqipërisë, në një atmosferë ekonomike dhe bankare me rrezik minimal për fondin e sigurimit. Megjithatë, ndryshimet e mundshme në sektorin bankar të kombinuara me disa dobësi në sistemin rregullativ krijonin një ambient më pak të sigurt në terma mesatarë. Anëtare e organizmave prestigjozë ndërkombëtarë si IADI, Shoqata Ndërkombëtare e Siguruesve të Depozitave me qendër në Bazel dhe seli pranë BIS (Bank of International Settlements) si dhe EFDI Forumi

Evropian i Siguruesve të Depozitave, agjencia po intensifikon përpjekjet e saj për të zhvilluar e ngritur në nivele bashkëkohore ndërkombëtare, veprimtarinë e sigurimit të depozitave. Natyra relativisht konservatore e administrimit të fondeve, investimi i kapitalit themeltar nga buxheti i shtetit dhe bankat për ngritjen e fondit të sigurimit të depozitave si dhe arkëtimi i primit të sigurimit nga bankat, të gjithë këta janë faktorë që ndikojnë në minimizimin e rrezikut dhe në stabilitetin e sistemit financiar të vendit. Mbështetja e stabilitetit të sistemit financiar dhe administrimi i periudhave të vështira janë përgjegjësi e institucioneve të ndryshme, të cilat janë aktorë të rrjetit të sigurisë së sitemit financiar. ASD luan rolin e vet si një aktor i rëndësishëm në këtë rrjet.

Misioni i saj është të mbrojë depozituesit nga falimentimi i bankës ku kanë vendosur depozitat, të kompensojë depozitat deri në nivelin e caktuar dhe sipas dispozitave të ligjit të ndihmojë në qëndrueshmërinë e sistemit financiar të vendit.

Vizioni i saj është të krijojë dhe të forcojë besimin e publikut të gjerë në sistemin bankar në veçanti dhe në sistemin financiar kombëtar në përgjithësi.

Qëllimi i saj është përqendrimi i vëmendjes në mbrojtjen maksimale të depozituesve nëpërmjet ofrimit të skemës së sigurimit të depozitave të qytetarëve, për të realizuar sigurimin e kursimeve të tyre.

Objektivat

- Përmirësimi dhe përsosja e skemës së sigurimit të depozitave të sistemit bankar.
- Përmirësimi dhe përsosja e bazës ligjore ekzistuese.
- Përmirësimi dhe përsosja e procedurave të kompensimit të depozitave.
- Krijimi i një programi të kompjuterizuar për pagesën e depozitave të siguruara. Në funksion të tij, studimi i fizibilitetit për projektin e për blerjen e programit për të lehtësuar procedurat e pagesës në fazën e kompensimit.

- Ky soft kërkon zhvillimin e një sistemi të aftë për të administruar fazat individuale të procesit të kompensimit në mënyrë të ndarë dhe të lehtë për t`u përdorur e modifikuar.

ANËTARËSIMI

Anëtare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave janë të gjitha bankat, që aktualisht janë licencuar nga Banka e Shqipërisë dhe që kryejnë veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë. Këto janë Banka Raiffeisen, Banka Kombëtare Tregtare, Banka Italo-Shqiptare, Banka Dardania, Banka Amerikane e Shqipërisë, Banka ProCredit, Banka Tirana, Dega e Bankës Kombëtare Greke, Dega e Bankës Alfa, Banka Tregtare e Greqisë, Banka Ndërkombëtare Tregtare, Banka e Bashkuar e Shqipërisë, Banka e Parë e Investimeve, Banka e Kreditit e Shqipërisë.

Në rast se një bankë e re ose një degë banke e huaj do të kërkojë në të ardhmen licencë nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar aktivitet në territorin e Shqipërisë, do të kërkojë njëkohësisht edhe sigurimin e depozitave. Me fillimin e aktivitetit të saj, depozitat e vendosura në të, do të jenë të siguruara sipas ligjit përkatës.



MJETET FINANCIARE TË AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE DHE ADMINISTRIMI I TYRE

Në administrimin e portofolit të saj të investimeve Agjencia e Sigurimit të Depozitave si institucion publik udhëhiqet nga parimet e përgjegjshmërisë dhe transparencës.

Mjete financiare të ASD janë:

- kontributi i buxhetit të shtetit prej 400.000.000 lekësh;
- kontributet fillestare të bankave të porsalicencuara;
- primet e bankave të siguruara; si dhe
- fitimet e realizuara nga investimi i tyre.

Agjencia përgjigjet për administrimin e fondeve me efektivitet dhe në përputhje me standardet e pranuara të administrimit të rrezikut.

Grafik 2. Ndryshimet në kapital dhe në fitimet e ASD në lekë.



Kjo realizohet duke investuar mjetet financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave në letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare, si dhe të qeverive dhe institucioneve të vendeve të tjera, monedha e të cilave është e depozituar në bankat e siguruara.

Mjetet financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave në dhjetorin e vitit 2004, krahasuar me dhjetorin e vitit 2003, janë rritur me 58 për qind. Në qershor të vitit 2005, mjetet financiare

të ASD arritën në vlerën 2.480.000.000 lekë dhe fitimi i realizuar prej saj në të njëjtën periudhë është 439,918,794.65 lekë, duke shënuar një rritje prej 47 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Objektivat e politikës së administrimit të mjeteve financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave janë që të ndërtojë një portofol me kushtet e mëposhtme:

- rrezik zero;
- afat maturimi, që nga momenti i blerjes, jo më shumë se një vit;
- likuiditet i lartë.



ECURIA E DEPOZITAVE TË SIGURUARA

Totali i depozitave të sistemit bankar në fundin e qershorit të vitit 2005 ishte 414 miliardë lekë, i cili krahasuar me fundin e qershorit të vitit 2004 ka shënuar një rritje prej 20 për qind. Në këtë total depozitash 81 për qind zënë depozitat e individëve, me shumën përkatëse prej 336 miliardë lekësh, kurse depozitat e siguruara arrijnë shifrën prej 178 miliardë lekësh, të cilat të shprehura në përqindje përfaqësojnë rreth 53 për qind të depozitave të individëve. Pjesën më të madhe të depozitave të individëve e zënë depozitat në lekë dhe vetëm 29 për qind e tyre

janë depozita në valutë. Për periudhën njëvjeçare qershor 2004 – qershor 2005, vërehet një rritje prej 7 për qind e depozitave në valutë dhe një rënie prej 3 për qind e depozitave në lekë. Kjo mund të shpjegohet me uljen e normave të interesit për depozitat në lekë.

Depozitat e individëve gjatë kësaj periudhe njëvjeçare kanë shënuar një rritje prej 16 për qind, dhe ato të siguruara një rritje prej 14 për qind. Depozitat mbi 700 mijë lekë, mbizotërojnë duke zënë rreth 75 për qind të totalit të depozitave të individëve.

Kurse depozituesit, të cilët kanë depozita deri në 700 mijë lekë, dominojnë duke zënë 82 për qind të totalit të numrit të depozituesve, duke shënuar një rritje prej 9 për qind krahasuar me qershorin 2004. Në prirjen rritëse të numrit të depozituesve të vegjël, një ndikim mund të ketë ekzistenca e skemës së sigurimit të depozitave.

Në tregun bankar, Banka Raiffeisen vazhdon të ketë një rol dominant, duke zotëruar 64 për qind të depozitave të siguruara të sistemit.

Emërtimi	Dhjetor 2004	Qershor 2005
Totali i depozitave të sistemit (1)	375,843,000	414,000,000
Totali i depozitave të individëve të sistemit (2)	309,871,406	336,436,214
Totali i depozitave të siguruara të sistemit (3)	167,250,478	177,508,204
Raporti (3)/(2) në përqindje	54	53

Grafik 4. Ndarja e depozitave të siguruara në %.





STRUKTURA E DEPOZITAVE TË SIGURUARA

Në strukturën e depozitave të siguruara të sistemit bankar, si edhe në strukturën e totalit të depozitave, peshën kryesore vazhdon ta zërë Banka Raiffeisen. Kjo bankë zotëron 64 për qind të totalit të depozitave.

Në ligjin "Për sigurimin e depozitave", janë përcaktuar nivelet për kompensimin e depozitave, me nivel maksimal 700 mijë lekë, duke siguruar:

100 për qind të depozitës deri në 350,000 lekë dhe 85 për qind të pjesës mbi 350,000 lekë.

Duke parë strukturën e depozitave sipas niveleve të kompensimit të përcaktuara në ligj, bie në sy dominimi i depozitave mbi 700,000 (shtatëqind mijë) lekë, shuma e të cilave zë rreth 74 për qind të shumës totale të depozitave të individëve.

Duke qenë se Agjencia e Sigurimit të Depozitave është në vitin e tretë të aktivitetit të saj, dhe njohja me skemën e sigurimit nga ana e depozituesve nuk është në nivel të lartë, vihet re mungesa e shpërndarjes së portofolit të depozitave të tyre. E kundërta e këtij fenomeni është e pranishme në vendet me një praktikë të gjatë të skemave të sigurimit. Analiza e numrit të depozitave të

individëve, sipas strukturës së kompensimit, tregon që peshën më të madhe e zë numri i depozituesve të vegjël, depozitat e të cilëve arrijnë deri në 700,000 (shtatëqind mijë) lekë, me 77 për qind të totalit të numrit të depozituesve. Kjo gjë shkon në të njëjtin drejtim me qëllimin e ligjit, për të marrë në mbrojtje në radhë të parë pjesën e depozituesve të vegjël, të cilët janë më të ekspozuar kundrejt rrezikut të mungesës së informacionit ekonomik.

Grafik 6. Struktura e depozitave të individëve sipas shumës në përqindje.



KARAKTERISTIKAT E NORMËS SË PRIMIT

Duke u bazuar në nenin 24 të ligjit "Për sigurimin e depozitave", për çdo bankë të siguruar, norma vjetore e primit të sigurimit është 0.5 për qind e mesatares aritmetike të shumës së depozitave të siguruara, të regjistruara në fund të çdo dite pune për tre muajt e fundit të vitit.

Agjencisë së Sigurimit të Depozitave i lind e drejta e uljes së normës së primit deri në 0.1 për qind, vetëm nëse mjetet financiare të saj, janë jo më pak se 5 për qind të mesatares së këtyre depozitave (aktualisht, ky raport është 1.4 për qind). Njëkohësisht me politikat e saj të sigurimit, Agjencia e Sigurimit të Depozitave mund të rrisë normën e primit deri në 0.7 për qind, kur gjykohet se është rritur rreziku i ndërmarrë nga bankat. Në të dyja rastet kjo realizohet duke propozuar akte nënligjore, të cilat miratohen nga Autoriteti Mbikëqyrës.

Aplikohet norma e primit prej 0.5 për qind, e cila nuk është e bazuar në rrezik dhe është e njëjtë për të gjitha bankat e siguruara.

RAPORTI I MBULIMIT NË FUND TË VITIT 2004 DHE AFTËSIA PAGUESE PËR BANKA TË VEÇANTA

Norma e mbulimit është një tregues i rëndësishëm për skemën e sigurimit të depozitave. Ky tregues është i ngjashëm me fondet e provigjoneve që krijohen për të përballuar rrezikun dhe llogaritet si raport i mjeteve financiare të agjencisë ndaj totalit të depozitave. Ky tregues ka përparësi pasi është një tregues i lehtë për t`u llogaritur dhe është mjaft kuptimplotë në shkallën e ekspozimit të fondit ndaj rrezikut, por ky tregues nuk jep informacion lidhur me rrezikun që përballon agjencia nga përqendrimi në sektorin bankar ose kapacitete krediduese të bankave anëtare.

Agjencia e Sigurimit të Depozitave gjatë vitit 2005 ka rritur të ardhurat e saj nëpërmjet kontributit të bankave të reja, të primeve vjetore të sigurimit të depozitës, si dhe me anë të politikave të saj të investimit (në përputhje me dispozitat e ligjit "Për sigurimin e depozitave"), rritje e cila ka sjellë si rrjedhim edhe rritjen e raportit të mbulimit. Ky raport shpreh raportin e mjeteve financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave me totalin e depozitave të siguruara.

Raporti i mbulimit në dhjetor 2004 është 1.2 për qind kundrejt 0.9 për qind që ishte në fund të vitit 2003.

Ky raport mbulimi në qershor të vitit 2005 ka arritur normën 1.4 për qind kundrejt 1.1 për qind të së njëjtës periudhë të vitit të kaluar.

Gjendja financiare që Agjencia e Sigurimit të Depozitave ka aktualisht, lejon të mbulohen në rast falimentimi secila nga bankat e sistemit, sipas paraqitjes në grafikun përbri.



Agjencia e Sigurimit të Depozitave në vitin e tretë të punës së saj, është në gjendje të kompensojë tërësisht depozituesit e siguruar për 8 bankat e mësipërme nga 16 që ka sistemi.

KOMPENSIMI SI PËRPARËSI E OBJEKTIVAVE TË ASD

Një nga detyrimet e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave është kompensimi i depozitave të siguruara deri në nivelin dhe sipas procedurave të përcaktuara nga ligji, jo më vonë se tre muaj nga dita e ndërhyrjes nga Autoriteti Mbikëqyrës në bankën e siguruar.

Në funksion të këtij procesi janë miratuar nga Autoriteti Mbikëqyrës, Banka e Shqipërisë dy udhëzime të propozuara nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave. Udhëzimi "Mbi procedurat e pranimit të bankave në skemën e sigurimit të depozitave" si dhe udhëzimi "Mbi marrëdhëniet e ASD me bankat e siguruara". Këto dy udhëzime së bashku me anekset përkatëse u janë shpërndarë të gjitha bankave të siguruara.

Anekset e udhëzimit "Mbi marrëdhëniet e ASD me bankat e siguruara" përmbajnë të dhënat për depozitën dhe depozituesin, të dhëna të cilat do të shërbejnë për një kompensim të shpejtë dhe pa probleme në rast të një falimentimi të mundshëm të ndonjë apo disa bankave.

Në funksion të realizimit të procesit të kompensimit, lind domosdoshmëria e hartimit të një programi informatik për realizimin e procesit të kompensimit në përputhje me dispozitat e ligjit "Për sigurimin e depozitave", duke përcakuar kështu edhe prioritetin e objektivave të institucionit tonë. Kështu, programi i informatizuar i procesit të kompensimit do të përmbushë me lehtësi realizimin e të gjitha pikave të nenit 6 "Kompensimi i depozitës së siguruar", duke filluar që nga:

- agregimi i të gjitha depozitave të klientit në një të vetme;
- përcaktimi i tepricës kreditore dhe i interesit të llogaritur deri në ditën e ndërhyrjes;
- këmbimi në lekë i depozitave të siguruara në monedhë të huaj, sipas kursit zyrtar të këmbimit të përcaktuar nga Autoriteti Mbikëqyrës në ditën e ndërhyrjes;
- mbajtja e të dhënave të detajuara për çdo depozitues, me qëllim shmangien e të dhënave të pavërteta dhe mashtruese.

Në lidhje me nenin 7, kompensimi i depozitave të siguruara kryhet nga Agjencia sa më shpejt të jetë e mundur, por në çdo rast jo më vonë se tre muaj nga dita e ndërhyrjes. Agjencia kompenson depozitën e siguruar duke njohur të drejtën e pronësisë mbi të, si dhe sipas niveleve të kompensimit.

Programi i informatizuar që ne synojmë të aplikojmë do të kontrollojë gjithë të dhënat e marra nga bankat, në mënyrë të tillë që të plotësojnë kërkesat për depozitë dhe depozitues. Do të bëjë të mundur ndërhyrjen në rast ndryshimi të mëvonshëm të disa neneve të ligjit, për shembull, mbi procedurat e llogaritjes së primit të sigurimit apo ndryshimi në rritje i shumës së sigurimit. Mbrojtja e interesave të depozituesve si qëllim final i veprimtarisë së institucionit tonë, zhvillimet e sistemit bankar e financiar në Shqipëri, marrja në konsideratë e praktikave të vendeve perëndimore me synim integrimin e vendit në bashkësinë evropiane, bën akoma më të domosdoshëm aplikimin e procedurave e teknikave moderne dhe lehtësisht të zbatueshme.

INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

ÇFARË SIGURON AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

Agjencia e Sigurimit të Depozitave në vendin tonë, realizon sigurimin e kursimeve të qytetarëve apo të depozituesve të vegjël. Agjencia siguron depozitat e kursimit në lekë dhe në valutë, ato depozita të cilat nuk përdoren për qëllime tregtare.

Kështu, janë të siguruara sipas ligjit kursimet e vendosura nga qytetarët në një bankë të siguruar në formën e:

depozitave me afat në lekë;
depozitave me afat në valutë;
depozitave pa afat në lekë;
depozitave pa afat në valutë;
çertifikatave të depozitave në lekë;
çertifikatave të depozitave në valutë.

Llojet e depozitave të mësipërme sigurohen si në rastin kur depozituesi është rezident ashtu edhe në rastin kur nuk është rezident. Rezident quhet një individ që ka jetuar të paktën 6 muaj në Shqipëri.

ÇFARË NUK SIGURON ASD ?

Depozitat e pasiguruara janë përgjithësisht ato depozita që kanë karakter tregtar dhe funksioni kryesor i tyre është kryerja e pagesave, e transfertave etj.. Më konkretisht, janë depozitat e kompanive dhe të bizneseve, llogaritë e të cilave i përgjigjen aktivitetit prodhues, tregtar, shërbimit, organizatave qeveritare dhe joqeveritare, pjesa e depozitave mbi 700,000 lekë, depozitat që përdoren për qëllime kriminale, zotëruesve të aksioneve të bankës së siguruar, administratorëve të bankës, të kontrollorëve dhe ekspertëve kontabël të bankës së siguruar, depozitat e çdo depozituesi me interesa preferencialë, personave që kanë detyrime ndaj saj, depozitat në degën e bankës së siguruar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, depozitat që vendosen në ditën e vendosjes së likuidimit të bankës etj. të ngjashme me to.

KUSH E MBAN KOSTON E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE?

Klienti apo depozituesi nuk paguan për sigurimin e depozitave. Shpenzimet e Agjencisë për kompensimin, paguhen kryesisht nga bankat. Agjencia për të përballuar shpenzimet mund të marrë kredi apo të financohet nga buxheti i shtetit.

Ç`ËSHTË SHUMA E MBULIMIT ?

Sipas ligjit agjencia paguan principalin e depozitës dhe interesat e rrjedhur (të mbledhur) nga kjo depozitë për çdo depozitues, deri në ditën e ndërhyrjes, deri në 700.000 lekë.

A MUND TË RRITET SHUMA E MBULIMIT?

Kjo shumë mund të rritet sipas parimit që sigurimi zbatohet për çdo depozitues dhe çdo bankë, pra janë dy mundësi, mund të përdoren më shumë banka ose mund të rritet numri i mbajtësve (zotëruesve) të depozitave. Nëse një individ depoziton paratë e tij në më shumë se një bankë, shuma e mbuluar mund të rritet deri në maksimumin e kufirit për çdo bankë. Nëse një depozitues/

familjar i shpërndan paratë e tij në depozita të ndryshme të zotëruara nga secili anëtar i familjes, atëherë totali i depozitave të siguruara për çdo familje do të rritet.

*Silva Seiko, Drejtore e ASD.

Artikujt e paraqitur në këtë botim, nuk shprehin gjithmonë opinionin zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

KRAHASIMI I STANDARDEVE TË STATISTIKAVE NË BANKËN E SHQIPËRISË ME STANDARDET E PROJEKTIT SDDS TË FONDIT MONETAR NDËRKOMBËTAR

*Kliti Ceca**
Edmond Thanati
Hilda Shijaku
Endrita Xhaferaj

Fjalë kyçe
- Statistika - SDDS - Metodologjia e kompilimit - Shpërndarja e të dhënave -

ABSTRAKT

Ky material ka për qëllim të krahasojë praktikën ekzistuese të shpërndarjes së statistikave në Bankën e Shqipërisë me standardet e SDDS-it, si dhe të identifikojë shmangiet nga standardi. Vlerësimet e shprehura në këtë material janë vlerësime të specialistëve të statistikave të Bankës së Shqipërisë dhe të specialistit përkatës të SDDS-it pranë Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe nuk përbëjnë një vlerësim përfundimtar.

Seksioni i parë i materialit hedh një vështrim mbi punën e Fondit për shpërndarjen e të dhënave dhe përshkruan kërkesat e standardit të SDDS-it. Seksioni i dytë përshkruan praktikat ekzistuese të shpërndarjes së të dhënave në Bankën e Shqipërisë, i krahason ato me standardin dhe identifikon shmangiet e mundshme. Në vazhdim, seksioni 3 liston një sërë detyrash që dalin për njësitë që prodhojnë statistika në Bankën e Shqipërisë në kuadër të anëtarësimit të Shqipërisë në SDDS.

Shkurtime:

SDDS (Special Data Dissemination Standards) – Standardet Speciale të Shpërndarjes së të Dhënave.

GDDS (General Data Dissemination System) – Sistemi i Përgjithshëm i Shpërndarjes së të Dhënave.
DQAF (Data Quality Assesment Framework) – Kuadri i Vlerësimit të Cilësisë së të Dhënave.
DSBB (Dissemination Standards Bulletin Board) – Bordi i Buletinit të Standardeve të Shpërndarjes.
NSDP (National Summary Data Page) – Faqja e të Dhënave Përmbledhëse Kombëtare.
ROSC (Report on Observance of Standards and Codes) – Raporti i Ndjekjes së Standardeve dhe Kodeve.
BoP – Bilanci i Pagesave.
IIP (International Investment Position) – Pozicioni Ndërkombëtar i Investimeve – PNI.

1. ÇFARË ËSHTË SDDS-I?

1.1 NJË KUADËR I PËRGJITHSHËM PËR ZHVILLIMIN E SHPËRNDARJES SË TË DHËNAVE STATISTIKORE

Standardet speciale të shpërndarjes[1] së të dhënave (SDDS), bazuar në praktikat më të mira të vendeve, u krijuan nga Fondi Monetar Ndërkombëtar që në vitin 1996, për ato vende që merrnin pjesë në tregjet financiare ndërkombëtare dhe për vendet që kërkonin të merrnin pjesë në to. Duke qenë se ekzistenca e standardeve të njëjta në kompilimin e të dhënave statistikore rrit transparencën dhe lehtëson monitorimin e politikave makroekonomike, zbatimi i SDDS-it mendohet të përmirësojë funksionimin e tregjeve financiare. Nëpërmjet SDDS-it investitorëve u jepen instrumente kontrolli mbi të gjitha hallkat e shpërndarjes së të dhënave statistikore dhe mundësohet monitorimi i cilësisë së tyre nga FMN, si rrjedhim, besueshmëria e investitorëve rritet dhe po ashtu interesi i tyre për vendin, i cili zbaton SDDS-in. Studime të ndryshme empirike tregojnë se pjesëmarrja në SDDS, ul koston e huamarrjes së një vendi dhe ndikon pozitivisht vlerësimin e vendit nga agjencitë listuese të kreditit. Allum dhe Agca (2001), duke vrojtuar përmbushjen e aspekteve të veçanta të standardeve të SDDS-it nga vendet anëtare, arritën në përfundimin që përmirësimi në kompilimin

e të dhënave statistikore ndikon pozitivisht në vendimmarrjen e autoriteteve dhe debatin publik mbi to.

Nënshkrimi i një vendi në SDDS bëhet mbi baza vullnetare, por kërkon një angazhim të tij për të përmbushur standardet dhe për të vënë në dispozicion të FMN-së informacionin në lidhje me shpërndarjen e të dhënave. Vendet anëtare të SDDS-it e publikojnë këtë informacion në faqen e internetit të FMN-së, në buletinin elektronik të Fondit (DSBB) si dhe krijojnë një lidhje interneti me vetë të dhënat, të quajtur "Faqja e të dhënave përmbledhëse kombëtare" (NSDP). SDDS-i sot përfshin 61 anëtarë nga të cilët rreth 17 janë vendet në tranzicion[2] dhe ato që e kanë kaluar atë fazë.

Krahas SDDS-it, Fondi Monetar Ndërkombëtar ka krijuar një tjetër grup standardesh, Sistemin e Përgjithshëm të Shpërndarjes së të Dhënave (GDDS), me qëllim zhvillimin e sistemeve statistikore si bazë për shpërndarjen e të dhënave. Në rishikimin e pestë të iniciativave të Fondit mbi standardet e të dhënave, qëllimi i GDDS përcaktohet:

(1) të inkurajojë vendet anëtare të përmirësojnë cilësinë e të dhënave;
(2) të krijojë një kuadër për vlerësimin e nevojave për përmirësimin e të dhënave, të vendosë përparësi në këtë drejtim si dhe të mobilizojë asistencën teknike; dhe
(3) të udhëheqë vendet në shpërndarjen e të dhënave statistikore ekonomike, financiare dhe demografike të besueshme, lehtësisht të përdorshme, në mënyrë të plotë e në kohën e duhur[3].

GDDS-i fokusohet në përmirësimin e sistemeve statistikore, ndërsa SDDS-i në shpërndarjen e atyre të dhënave që përdoren nga tregjet financiare. Në dallim nga SDDS-i, GDDS-i mund të zbatohet për të gjitha vendet pa përjashtim, dhe shihet si një hallkë ndërmjetëse për anëtarësimin në SDDS, duke qenë se në bazë të tij qëndrojnë rritja e transparencës për praktikat ekzistuese të vendit anëtar dhe përgatitja e strategjive për përmirësimin e tyre me qëllim arritjen e standardeve të SDDS-it.

Deri më sot katër[4] nga vendet që merrnin pjesë në GDDS, janë anëtarësuar në SDDS.

Për monitorimin e praktikave të këtyre vendeve shërbejnë raportet mbi ndjekjen e standardeve dhe të kodeve (raportet ROSC), të cilat realizohen për vendet anëtare të SDDS-it dhe GDDS-it dhe që vlerësojnë ndjekjen prej tyre të standardeve në lidhje me SDDS/GDDS-in, si dhe të gjitha praktikat statistikore në prodhimin e të dhënave specifike makroekonomike.

Në lidhje me vlerësimin e praktikave të vendeve për shpërndarjen e të dhënave statistikore është krijuar sistemi DQAF (kuadri i vlerësimit të cilësisë së të dhënave), i cili mbulon të gjitha aspektet e ciklit të prodhimit të të dhënave. Krahas funksionit të tij si bazë për raportet ROSC, DQAF-i mund të përdoret lehtësisht nga vetë agjencitë kombëtare që shpërndajnë të dhëna statistikore për të vlerësuar performancën e tyre në krahasim me standardet dhe për të identifikuar dobësitë që ekzistojnë[5].

1.2 ÇFARË PËRMBAN SDDS-I?

SDDS-i përmban katër përmasa të shpërndarjes së të dhënave dhe për secilën prej tyre mund të monitorohen elementet e përshkruara në tabelën 1.

Tabelë 1. Përmasat e SDDS dhe elementet e monitorueshme të tyre.

Përmasat:	Elementet e përmasave:
1. Të dhënat	1.1. Mbulimi
	1.2. Vonesa[6]
	1.3. Periodiciteti
2. E drejta e përdorimit nga publiku	2.1. Publikimi paraprak i një kalendari për shpërndarjen e të dhënave.
	2.2. Shpërndarje e njëkohshme për të gjitha palët e interesuara.
3. Integriteti i të dhënave	3.1. Publikimi i termave dhe i kushteve në të cilat prodhohen statistikat zyrtare, përfshirë ato mbi konfidencialitetin e informacioneve individuale.
	3.2. Identifikimi i të drejtës së përdorimit nga qeveria para publikimit të të dhënave.
	3.3. Identifikimi i komenteve (nga qeveria) për të dhënat statistikore.
	3.4. Publikimi i informacionit mbi rishikimet dhe njoftimi paraprak i ndryshimeve në metodologji.

4. Cilësia e të dhënave	4.1.	Publikimi i dokumentacionit mbi metodologjinë dhe burimet e përdorura në prodhimin e statistikave.
	4.2.	Publikimi i të dhënave të detajuara, pajtueshmëria me të dhëna të lidhura me to dhe ekzistenca e një kuadri statistikor të tillë që të mundësojë kontrollet statistikore e të sigurojë besueshmërinë dhe korrektësinë e të dhënave.

SDDS-i përfshin të dhënat më të rëndësishme në vlerësimin e politikave makroekonomike. Kategoritë e të dhënave përfshijnë katër sektorë të ekonomisë: sektorin fiskal, sektorin real, sektorin financiar dhe sektorin e jashtëm. Për secilin nga këta sektorë përdoret një kuadër i plotë statistikor, përkatësisht:

- llogaritë kombëtare për sektorin real, ku si pikë referimi merret "Sistemi i llogarive kombëtare", FMN, 1993,
- llogaritë e qeverisë për sektorin fiskal, ku si pikë referimi merret "Manuali i statistikave financiare të qeverisë", FMN 2002,
- të dhënat analitike për sistemin bankar për sektorin financiar, ku si pikë referimi shërben "Manuali i statistikave monetare dhe financiare", FMN 2000,
- të dhënat e bilancit të pagesave për sektorin e jashtëm, ku si pikë referimi shërben edicioni i pestë i "Manualit të bilancit të pagesave", FMN 1993.

Në secilin prej këtyre sektorëve identifikohen dy kategori të dhënash; kategori të dhënash bazë dhe kategori të dhënash të inkurajuara, të cilat vendi anëtar nuk është i detyruar t'i zbatojë për të përmbushur standardet e SDDS-it. Për të monitoruar ndjekjen e standardeve të SDDS-it analizohen kategoritë e të dhënave bazë nën dritën e përmasave të përshkruara në tabelën 1.

Një tjetër karakteristikë e SDDS-it që vlen të përmendet është mundësia e një vendi për të mos përmbushur për disa kohë një nga standardet si për shembull në lidhje me vonesën apo me periodicitetin për kategori të caktuara të dhënash (mundësi tolerimi). Nëpërmjet kësaj mundësie, një vendi anëtar i jepet kohë të përshtasë praktikat e veta duke qenë brenda SDDS-it.

2. STANDARDET E STATISTIKAVE TË BANKËS SË SHQIPËRISË NË KRAHASIM ME SDDS-IN

Shqipëria është anëtare e Projektit të GDDS-it që prej vitit 1999, duke qenë vend pilot në këtë projekt. Gjatë gjithë kësaj kohe proceset statistikore në Bankën e Shqipërisë, në Ministrinë e Financave dhe në INSTAT kanë njohur zhvillime të rëndësishme në drejtim të transparencës dhe cilësisë, kualifikimit të burimeve njerëzore dhe të ndihmës ndaj përdoruesve. Lidhur me shpërndarjen e të dhënave, misioni ROSC vizitoi Shqipërinë në maj të vitit 2000 dhe la një sërë detyrash, duke përfshirë ndërtimin e një sistemi të llogarive kombëtare, përmirësimin e kuadrit ligjor dhe mbulimin e aktiviteteve ekonomike sidomos për statistikat e sektorit real dhe atij të jashtëm, si dhe përdorimin eficient të burimeve të informacionit.

Megjithatë, gjatë periudhës në vazhdim, në sajë edhe të mbështetjes e bashkëpunimit të vazhdueshëm me specialistë të FMN-së, për përmirësimin e statistikave në Bankën e Shqipërisë janë bërë hapa të rëndësishëm. Në vazhdim do të vlerësohen praktikat e shpërndarjes së të dhënave për sektorin financiar dhe për atë të jashtëm, në bazë të elementeve të paraqitura në tabelën 1, si dhe do të evidentohen hapësirat për përmirësim.

2.1 STATISTIKAT E SEKTORIT FINANCIAR

Kategoritë bazë të të dhënave në këtë sektor janë të dhënat analitike për sistemin bankar, të dhënat analitike për bankën qendrore dhe normat e interesit. Në aneksin 1 jepen në mënyrë të përmbledhur përmasat e SDDS-it në lidhje me këto kategori, elementet e monitorueshme të tyre sipas kërkesave të standardit SDDS (në të majtë të tabelës) dhe praktika aktuale në Bankën e Shqipërisë.

i) Të dhënat

Statistikat monetare dhe financiare në Shqipëri mbulojnë korporatat e tjera depozituese (ku përfshihen shoqëritë e kursim-kreditit dhe bankat e nivelit të dytë) dhe Bankën e Shqipërisë. Të

dhënat për sistemin bankar shpërndahen në periudhë mujore, si rregull 40 ditë nga data e fundit e referencës për 11 muajt e parë të vitit dhe brenda dy muajve nga data e referencës për muajin dhjetor. Të dhënat për shoqëritë e kursim-kredititit rifreskohen çdo tremujor.

Të dhënat për bankën qendrore shpërndahen gjithashtu, në periudhë mujore dhe si rregull, brenda 10 ditëve nga data e referencës.

Normat e interesit të publikuara nga Banka e Shqipërisë përfshijnë normat e interesit për instrumentet indirekte të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë, normat e interesave të letrave me vlerë të qeverisë në treg primar si dhe normat e interesit për kreditë dhe depozitat e reja të sistemit bankar në lekë, në usd dhe në euro për çdo maturim dhe në total. Normat e interesit të instrumenteve indirekte si dhe të letrave me vlerë të qeverisë në tregun primar, publikohen që në ditën e ndryshimit ose emisionit të tyre, ndërsa normat e interesit për kreditë dhe depozitat e sistemit bankar publikohen çdo muaj, me 40 ditë vonesë nga fundi i muajit të referencës.

Së pari, në lidhje me mbulimin dhe periodicitetin mund të themi se për të gjitha kategoritë praktika jonë është në përputhje me standardet e SDDS-it. Gjithashtu, rifreskimi çdo tremujor i të dhënave për shoqëritë e kursim-kredititit për të dhënat analitike të sistemit bankar, nuk përbën shmangie për standardin SDDS duke qenë se standardi mjaftohet vetëm me mbulimin e bankave tregtare.

Shmangie përsa i përket kësaj përmase përbën vonesa në kompilimin e treguesve për sektorin bankar. Kjo vonesë rrjedh nga pamundësia e bankave për të raportuar më parë, gjë që theksohet sidomos për fundin e vitit. Megjithatë, në këtë rast mund të përdoret mundësia e tolerimit e përmendur më sipër, për aq kohë sa të shkurtohet koha e raportimit nga bankat e nivelit të dytë. Në lidhje me llogaritë e bankës qendrore kompilimi bëhet dhe shpërndahet në kohë.

ii) E drejta e përdorimit nga publiku

Elementet e monitorueshme në lidhje me këtë përmasë janë e drejta e informimit paraprak dhe të njëkohshëm të të gjitha palëve.

Elementi i parë i monitorueshëm i kësaj përmase ka të bëjë me publikimin paraprak të një kalendari që specifikon datën (fikse ose në trajtë intervali) në të cilën do të publikohen të dhënat statistikore. Një kalendar i tillë është i domosdoshëm për përdoruesit jashtë institucionit, pasi i mundëson ata të planifikojnë kohën dhe aktivitetet e tyre. Standardi parashikon që kalendari të botohet të paktën një tremujor përpara datës së publikimit të të dhënave dhe specifikon intervalin (brenda pesë ditësh) në të cilin do të publikohen të dhënat ose afatin e fundit të tij. Në një hap të dytë, një javë përpara datës së publikimit të të dhënave duhet shpallur data fikse e publikimit.

Botimi i një kalendari të tillë aktualisht nuk është praktikë për asnjë nga kategoritë e të dhënave të sektorit financiar. Kalendari mund të publikohet në faqen e Bankës së Shqipërisë ose në DSBB, si dhe në një nga botimet periodike të Bankës së Shqipërisë si për shembull raporti (buletini) mujor.

Elementi tjetër i monitorueshëm ka të bëjë me shpërndarjen e njëkohshme të statistikave të të gjitha palëve[7] të interesuara. Shpërndarja në këtë rast i referohet publikimit të parë të të dhënave pavarësisht prej mënyrës në të cilën bëhet publikimi. Ky element është i domosdoshëm në ato raste kur e drejta e përdorimit e një informacioni statistikor të dhënë përpara kohe, mund t'i krijojë kësaj pale përfitime në kurriz të palëve të tjera duke i dëmtuar ato. Për statistikat monetare dhe financiare dhe normat e interesit, kjo gjë realizohet nëpërmjet postimit në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë të treguesve statistikorë.

iii) Integriteti i të dhënave

Në lidhje me këtë përmasë udhëzuesi mbi SDDS-in[8] shprehet:

"Për t'i siguruar informacion publikut, agjencitë statistikore duhet të kenë besimin e përdoruesve të tyre. Nga ana tjetër, besimi në statistikat bëhet një çështje besimi në objektivitetin dhe profesionalizmin e agjencisë që prodhon statistikat. Transparenca e praktikave dhe e procedurave të agjencisë është një faktor kyç në krijimin e këtij besimi".

Kjo përmasë ka të bëjë pikërisht me transparencën përsa i përket procedurave dhe praktikave për shpërndarjen e të dhënave.

Elementi i parë lidhet me publikimin e kushteve dhe të termave në të cilat prodhohen statistikat, përfshirë ato që kanë të bëjnë me mbrojtjen e informacionit individual. Konkretisht, për statistikat e sektorit financiar ekziston një bazë rregullative e plotë që rregullon mbledhjen e informacionit, përpunimin, shpërndarjen dhe ruajtjen e tij. Përgjithësisht, ligjet dhe rregulloret në lidhje me këtë gjë mund të përdoren nëpërmjet faqes së internetit të Bankës së Shqipërisë.

Ligji "Për Bankën e Shqipërisë", i jep qartësisht mandatin Bankës së Shqipërisë për të prodhuar dhe për të shpërndarë statistikat e sektorit financiar. Gjithashtu, ligji për bankat e nivelit të dytë dhe ai për shoqëritë e kursim-kreditit i detyron ato të raportojnë të dhënat statistikore në Bankën e Shqipërisë. Në ligjin e Bankës së Shqipërisë parashikohet gjithashtu, që çdo institucion, person fizik apo juridik është i detyruar të raportojë në Bankën e Shqipërisë (neni 27, ligji i Bankës së Shqipërisë), por nuk ekzistojnë cilësime se çfarë ndodh në të kundërtën (për shembull, penalizimi i atyre subjekteve që nuk plotësojnë këtë kërkesë).

Banka e Shqipërisë siguron konfidencialitetin e të dhënave individuale në bazë të: ligjit "Për Bankën e Shqipërisë", "Kodit të etikës të Bankës së Shqipërisë" dhe "Rregullores për transparencën dhe konfidencialitetin në Bankën e Shqipërisë".

Krahas mbrojtjes nga ligji, ekzistojnë gjithashtu procedura që parandalojnë shpërndarjen e informacioneve idividuale.

Këta rregulla parandalojnë shpërndarjen e paligjshme të informacionit, si për shembull duke siguruar bazën e të dhënave, duke kufizuar numrin e personelit që konsulton të dhënat individuale etj.. Ndërkohë duhet patur parasysh shpërndarja indirekte e informacionit individual. Përsa i përket mbrojtjes rregullatore, ligji i Bankës së Shqipërisë si dhe rregulloret e përmendura më lart ruajnë konfidencialitetin e të dhënave individuale, duke i ndaluar punonjësit e Bankës së Shqipërisë të shpërndajnë apo të transferojnë të dhënat individuale një pale të tretë, për çdo qëllim. Megjithatë, në bazën rregullative duhet specifikuar dhe "parandalimi i shpërndarjes indirekte të informacionit konfidencial" (si shembull mund të përmendet rasti kur një bankë ka një pozicion mbizotërues në një instument të caktuar dhe mundëson marrjen e këtij informacioni edhe kur të dhënat janë në nivel të agreguar).

Elementi i dytë ka të bëjë me identifikimin e të drejtës së përdorimit nga qeveria[9] të të dhënave statistikore para publikimit të tyre. Nëpërmjet këtij elementi synohet mbrojtja e të dhënave statistikore nga ndikimi i qeverisë, duke qenë plotësisht transparent me publikun për listën e njësive, që gëzojnë të drejtën e përdorimit të të dhënave para publikimit. Për statistikat monetare dhe financiare, askush jashtë agjencisë hartuese – Bankës së Shqipërisë nuk e gëzon këtë të drejtë.

Elementi i tretë lidhet me identifikimin e komenteve mbi të dhënat nga qeveria. Duke qenë se qeveria mund të mos vlerësojë objektivisht të dhënat statistikore sidomos në ato raste kur ato lidhen direkt me përgjegjësitë e saj, standardi parashikon identifikimin e burimit të komenteve mbi të dhënat. Për statistikat monetare dhe financiare nuk bëhet ndonjë koment nga qeveria për të dhënat e publikuara.

Elementi i fundit i kësaj përmase ka të bëjë me publikimin e informacionit mbi rishikimet dhe njoftimin paraprak të ndryshimeve kryesore metodologjike. Përdoruesit e statistikave duhet të njohin praktikat e rishikimit të të dhënave. Gjithashtu, duhet ditur nëse të dhënat janë paraprake apo përfundimtare.

Rishikimet në statistikat monetare dhe financiare si rregull, ndodhin për arsye të rishikimit të bilanceve të bankave të nivelit të dytë pas kontrollit nga kontrollorët e jashtëm ose nga mbikëqyrja (on site) e Bankës së Shqipërisë. Në statistikat monetare, ndryshimet përfshihen në publikimin e rradhës. Për rrjedhojë, të dhënat quhen përfundimtare në momentin e parë që publikohen dhe rishikohen nëse është e nevojshme. Meqënëse akoma nuk ekziston një politikë e miratuar për rishikimin e të dhënave, nuk mund të dihet paraprakisht se kur pritet rishikimi i tyre. Dokumentacioni i rishikimeve, që përfshin arsyet e ndryshimit, masën e ndryshimit etj., megjithëse mbahet rregullisht nga Zyra e Statistikave Monetare dhe Financiare nuk publikohet bashkë me të dhënat.

iv) Cilësia e të dhënave

Cilësia e të dhënave është përmasa më e vështirë për t'u matur, pasi shpesh presioni për të përmbushur një element tjetër si mbulimi apo vonesa, ka pasoja mbi cilësinë e të dhënave.

Së pari, dokumentacioni mbi konceptet, mbulimin, klasifikimin, metodat e regjistrimit, burimet e informacionit dhe teknikat statistikore, duhet të publikohet. Gjithashtu, duhet të publikohen dhe ndryshimet nga standardet ndërkombëtare.

Për statistikat monetare dhe financiare mund të thuhet se ekziston një informacion i plotë mbi mënyrën e kompilimit të treguesve statistikorë. "Metodika e statistikave monetare dhe financiare, BSH, Korrik 2003", që përbën bazën metodologjike të punës për kompilimin e statistikave monetare dhe financiare, si dhe metadatat analitike për kompilimin e treguesve janë të publikuara në internet dhe mund të thuhet se nuk ka devijime nga standardi ndërkombëtar[10].

Në lidhje me normat e interesit, metodologjia e llogaritjes së tyre është në përputhje me rregulloren "Për instrumentet indirekte të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë" miratuar me vendim nr. 08, datë 07.02.2001, e cila gjendet e publikuar në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë.

Përsa i përket normave të interesit të letrave me vlerë të qeverisë, metodologjia e llogaritjes përcaktohet në marrëveshjet mbi "Emetimin e obligacioneve afatgjata të qeverisë në formë regjistrimi", datë 25.09.2002 dhe mbi "Emetimin e bonove të thesarit në formë regjistrimi", datë 08. 07. 2002.

Elementi i dytë ka të bëjë me publikimin e të dhënave të detajuara, me pajtueshmërinë e tyre me të dhëna të lidhura me to dhe ekzistencën e një kuadri statistikor të tillë, që të mundësojë kontrollet statistikore e të sigurojë besueshmërinë dhe korrektësinë e të dhënave.

Publikimi i treguesve të statistikave monetare dhe financiare bëhet sipas kuadrit të përcaktuar në "Manualin e statistikave monetare dhe financiare, FMN, 2000". Sipas këtij të fundit sigurohen dhe kriteret e kontrollit për statistikat monetare dhe financiare brenda një periudhe kohe. Seritë për të dhënat e Bankës së Shqipërisë gjithashtu publikohen në "Raportin statistikor mujor".

2.2 STATISTIKAT E SEKTORIT TË JASHTËM

Sipas manualit dhe modulit fillestar[11] të SDDS-it, hartuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar në vitin 1996, kategoritë kryesore të statistikave të sektorit të jashtëm ishin: bilanci i pagesave, rezervat ndërkombëtare, tregtia e jashtme, pozicioni ndërkombetar i investimeve dhe kurset e këmbimeve.

Në rishikimin e dytë të këtij standardi, në dhjetor 1998, u mbështet propozimi për shtimin e borxhit të jashtëm si kategori statistikash për t'u kompiluar brenda kuadrit të sektorit të jashtëm. Më pas, në rishikimin e tretë në mars të vitit 2000, Fondi Monetar Ndërkombëtar vendosi një periudhë tranzicioni trevjeçare (deri në fund të marsit 2003) për raportimin tremujor të statistikave të borxhit të jashtëm, si një kategori e detyrueshme e standardit të SDDS-it. Këto statistika duhet të publikohen me një vonesë prej jo më shumë se një tremujori dhe të mbulojnë borxhin e jashtëm të qeverisë së përgjithshme, autoritetit monetar, sistemit bankar, sektorit privat e sektorëve të tjerë.

Aktualisht, Banka e Shqipërisë kompilon dhe shpërndan të dhëna për këto kategori: bilancin e pagesave, tregtinë e jashtme, kurset e këmbimit dhe rezervat ndërkombëtare, ndërkohë që është larg plotësimit të kërkesave të SDDS-it për kompilimin e statistikave të pozicionit ndëkombëtar dhe borxhit të jashtëm.

Përsa i përket statistikave të rezervave ndërkombëtare, në Bankën e Shqipërisë shpërndahen vetëm të dhënat mujore për mjetet e huaja neto të cilat përfshijnë mjetet dhe detyrimet e autoritetit monetar, publikuar nga Sektori i Statistikave Monetare e Financiare dhe ndryshimi i mjeteve të huaja neto në kuadrin e statistikave të bilancit të pagesave, publikuar nga Sektori i Bilancit të Pagesave.

Ndërkohë, FMN, gjatë rishikimit të dytë të SDDS-it, në mars 1999, miratoi përfshirjen e një moduli të ri shpërndarjeje për statistikat e rezervës ndërkombëtare - moduli i të dhënave mbi rezervën ndërkombëtare dhe likuiditetin në valutë të huaj, si dhe përcaktoi një periudhë tranzitore që mbaronte në fund të marsit 2000, pas të cilës vendet anëtare kompilonin të dhënat sipas këtij moduli. Kjo bazë të dhënash u bë operative në tetor 2000 dhe përfshin të dhëna jo vetëm nga autoriteti monetar, por edhe nga qeveria.

Në kuadrin e anëtarësimit në SDDS, për Bankën e Shqipërisë del si detyrë kompilimi i këtij moduli si dhe vendosja e kontakteve përkatëse ndërinstitucionale (me Ministrinë e Financave), për arritjen e këtij misioni.

Në aneksin 2 paraqiten në mënyrë të përmbledhur përmasat e SDDS-it në lidhje me 3 kategoritë e sektorit të jashtëm, që janë më afër kërkesave të këtij standardi: bilancin e pagesave, tregtinë e jashtme dhe kurset e këmbimeve.

i) Të dhënat

Bilanci i Pagesave të Shqipërisë mbulon në parim, të gjitha transaksionet mes rezidentëve e jorezidentëve, megjithëse disa aktivitete ilegale mbeten të pambuluara. Të dhënat e bilancit

të pagesave hartohen në milionë usd dhe klasifikohen sipas strukturës së tabelës së bilancit të pagesave dhe përkufizimeve të komponentëve standardë, të listuar në manualin e bilancit të pagesave të FMN, BPM5[12]. Këta komponentë klasifikohen në tre kategori kryesore: i - Llogaria korente ku dallohen mallrat, shërbimet, të ardhurat dhe transfertat korente; II – Llogaria kapitale që përmban transfertat kapitale ku dallohen borxhi i falur dhe transferta të tjera; III - Llogaria financiare me pretendimet dhe detyrimet financiare të Shqipërisë ndaj jorezidentëve, të ndara në rezervat ndërkombëtare dhe transaksionet financiare.

Bilanci i llogarisë korente barazohet nga bilanci neto i llogarisë kapitale e financiare. Tabela statistikore e bilancit të pagesave bazohet në parimin e regjistrimit të dyfishtë dhe mbetjet përfshihen në zërin "Gabime dhe Harresa", sipas rekomandimeve të Manualit të Bilancit të Pagesave të FMN, BPM5. Gjithashtu, respektohet frekuenca (çdo tremujor) dhe vonesat (jo më shumë se një tremujor nga periudha e referimit) për publikimin e shpërndarjen e të dhënave.

Për shkak të burimeve jo të plota ose të dobëta të të dhënave, bëhen vlerësime për disa njësi të sektorit të jashtëm. Për bilancin e pagesave, rregullime bëhen në të dhënat e doganave për importin dhe eksportin, për vlerësimin e importit të mallrave kontrabandë dhe energjisë elektrike, si edhe për vlerësimin e importeve në bazë f.o.b.. Gjithashtu, vlerësime bëhen edhe për kompilimin e disa lloj shërbimesh, të ardhurat nga emigrantët dhe investimet e huaja direkte. Megjithatë, nuk bëhen rregullime sezonale për të dhënat financiare.

Aktualisht, po punohet në disa drejtime për të përmirësuar burimet e të dhënave në mënyrë që të sigurohet një mbulim sa më i gjerë i statistikave të bilancit të pagesave.

Kurset e këmbimit në Bankën e Shqipërisë shpërndahen në përputhje me kërkesat e SDDS-it në lidhje me përmasën e të dhënave. Metodologjia aktuale e llogaritjes së kursit zyrtar të këmbimit zbatohet që prej datës 31 maj 2003, me miratimin e udhëzimit "Mbi mënyrën e llogaritjes së kursit të këmbimit në

Bankën e Shqipërisë". Për llogaritjen e kursit të këmbimit, sipas kësaj metode llogaritet mesatarja e kuotimeve të 6 bankave dhe 4 zyrave të këmbimit, ndërsa ajo e mëparshmja llogariste kursin mesatar të transaksioneve të kryera nga 6 banka dhe 4 zyra të këmbimit valutor. Rritja e vëllimeve të veprimeve të operatorëve dhe ngushtimi i *spread*-it në kuotime, bëri që metoda e dytë të sillte një kurs këmbimi real, me më pak kosto dhe në përshtatje me praktikën botërore.

Kursi i këmbimit të dollarit amerikan në raport me lekun llogaritet nga kuotimet e sipërpërshkruara, ndërsa kursi i këmbimit të monedhave të tjera llogaritet si kurs *cross* i kursit të këmbimit usd/lek me kursin e këmbimit të këtyre monedhave kundrejt dollarit amerikan, në orën 12.00 të ditës përkatëse.

Tregtia e jashtme, në formën e statistikave e pasqyrave në lidhje me tregtinë e mallrave, hartohet dhe shpërndahet nga Banka e Shqipërisë dhe Instituti i Statistikave (INSTAT) në bazë të informacionit mujor të marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, e cila raporton totalin e deklaratave doganore të periudhës. Të dhënat regjistrohen në momentin e plotësimit të deklaratës doganore. Burimi i informacionit është i njëjtë për të dyja agjencitë e kompilimit të këtyre të dhënave. INSTAT publikon të dhëna mujore të tregtisë së jashtme në lekë, sipas 21 grupmallrave të Sistemit të Harmonizuar[13] dhe sipas 30 shteteve. Importet publikohen në vlerën c.i.f. dhe eksportet në vlerën f.o.b.. Ndërkohë, Banka e Shqipërisë i përmbahet metodologjisë së bilancit të pagesave duke publikuar importet dhe eksportet e mallrave në vlerën f.o.b. në milionë dollarë. Në lidhje me tipin e mallrave për t'u përfshirë apo për t'u përjashtuar nga importi dhe eksporti tregtar, Banka e Shqipërisë ndjek standardet metodologjike, të përcaktuara nga Eurostat, OKB si dhe FMN.

Për vlerësimin e importeve në vlerën f.o.b., importet në vlerë c.i.f. zhvishen nga kostoja e sigurimit dhe e transportit. Koeficientët për kostot e sigurimit dhe të transportit të mallrave sigurohen nëpërmjet vrojtimeve të tregtisë së jashtme. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë përdor një vlerësim për importet kontrabandë apo ato të nënregjistruara.

ii) E drejta e përdorimit nga publiku

Për bilancin e pagesave nuk ekziston aktualisht një kalendar paraprak publikimesh. Mbetet si detyrë hartimi i një politike për krijimin e një kalendari të tillë, si dhe publikimi i tij.

Momenti i parë i njohjes së publikut me të dhënat e bilancit të pagesave si edhe me statistikat e tregtisë së jashtme, është publikimi i deklaratës tremujore për shtyp bashkë me tabelat përmbledhëse. Publikimi i statistikave të tregtisë sipas 21 grupmallrave dhe shteteve bëhet çdo muaj, dy muaj pas muajit të referencës. Brenda tre javëve nga dalja e deklaratës për shtyp bëhet shpërndarja në formë elektronike dhe publikimi në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë, në bazën e të dhënave dhe në raportin statistikor, i cili shpërndahet në formë të printuar sipas listës së përdoruesve. Në bazë të kërkesave (gjithmonë pas datës së publikimit të statistikave) përdoruesve mund t'iu dorëzohen elektronikisht apo në kopje të printuara, të dhëna të publikuara sipas formatit standard. Praktikisht, të dhënat e bilancit të pagesave dhe tregtisë së jashtme bëhen të përdorshme nga të gjitha palët në të njëjtën kohë.

Në lidhje me kurset e këmbimit, kërkesa për shpërndarjen e njëkohshme të të dhënave plotësohet nëpërmjet publikimit të kursit të këmbimit në faqen e Bankës së Shqipërisë dhe në faqen e Reuters (NBAL) të institucionit. Ndërkohë që, ashtu si dhe për statistikat e tjera, nuk ekziston praktika e kalendarit paraprak të publikimeve.

iii) Integriteti i të dhënave

Kompilimi i të dhënave të bilancit të pagesave bëhet në bazë të nenit 27 të ligjit "Për Bankën e Shqipërisë", sipas të cilit Banka e Shqipërisë harton bilancin e pagesave të Shtetit Shqiptar, si dhe organizon dhe drejton sistemin e statistikave të këtij bilanci pagesash. Në këtë kuadër, kompilimi i statistikave të tregtisë së jashtme nga ana e Bankës së Shqipërisë rrjedh nga detyrimi i saj për hartimin e bilancit të pagesave të Shtetit Shqiptar. Për mbledhjen e informacionit në kompilimin e BP-

së dhe statistikave të tregtisë së jashtme, si dhe përsa i përket konfidencialitetit në shpërndarjen e të dhënave, baza ligjore e rregullative ku mbështetet sektori është e njëjtë me atë të përdorur për statistikat financiare dhe është e publikuar në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë.

Mbi këto statistika njësitë qeveritare nuk kanë të drejta përdorimi paraprak në të dhënat që publikohen e nuk ka as komente të këtyre njësive në lidhje me to.

Përsa i përket rregullimeve në statistikat e bilancit të pagesave, megjithëse përfundimtare në momentin kur publikohen, ato rregullohen vazhdimisht për shkak të ndryshimeve në lidhje me vlerësime paraprake, ndryshimeve të metodologjisë, shtimit të burimeve të reja të informacionit ose përmirësimeve të atyre ekzistuese. Në të njëjtën mënyrë e për të njëjtat arsye mund të ketë rregullime e rishikime edhe në statistikat e tregtisë së jashtme. Tabelat e rregulluara publikohen, por jo dokumentacioni i historisë së rregullimeve përkatëse.

Gjithashtu, nuk ekziston një politikë e mirëfilltë rregullimesh që të përcaktojë një kalendar të saktë të rishikimeve, si dhe informimin e përdoruesve të statistikave të sektorit të jashtëm në lidhje me këto rishikime. Hartimi dhe zbatimi i kësaj politike, mbetet detyrë, në kuadrin e përmirësimit të shpërndarjes së statistikave të bilancit të pagesave.

Ligji "Për Bankën e Shqipërisë" i jep asaj të drejtën për llogaritjen dhe publikimin e kursit të këmbimit zyrtar të vendit. Për këtë të dhënë statistikore, njësitë qeveritare nuk kanë të drejtën e përdorimit para publikimit. Gjithashtu, në lidhje me rregullimet për këtë kategori të dhënash, shpërndarja e tyre është përfundimtare në momentin e parë të publikimit.

iv) Cilësia e të dhënave

Bilanci i pagesave të Shqipërisë hartohet në bazë të "Metodologjisë së bilancit të pagesave", e cila mbështetet në standardet e "Manualit të Statistikave të Bilancit të Pagesave,

FMN, Edicioni i Pestë, 1993". Ajo përmban detaje teknike të kompilimit të statistikave të bilancit të pagesave, konceptet e përkufizimet themelore të zërave të bilancit të pagesave si edhe orientime mbi burimet e informacionit që përdoren. Kjo metodologji përdoret gjerësisht nga sektori, por nuk publikohet.

Në këtë kuadër, për të plotësuar kërkesat e standardit të SDDS-it, duhet bërë publike metodologjia pasi të jenë pasqyruar në të ndryshimet e përmirësimet e bëra në vite, si dhe të jenë lënë hapësira për ndryshime në të ardhmen. Gjithashtu, rekomandohet edhe publikimi i shmangieve të kësaj metodologjie nga standardet ndërkombëtare në lidhje me këto statistika.

Përsa i përket publikimit të të dhënave të detajuara, statistikat e bilancit të pagesave janë të detajuara deri në pikën ku i lejon tërësia e burimeve të informacionit. Me zgjerimin e tyre pritet të ketë detajime të mëtejshme. Në Buletinin Statistikor të Bilancit të Pagesave dhe në seritë e agreguara, të publikuara në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë përfshihen të dhëna e seri kohore të detajuara për katër tremujorët e fundit dhe për të paktën 10 vitet e fundit.

Statistikat e tregtisë së jashtme hartohen në bazë të rekomandimeve të paraqitura në "Manualin e Statistikave të Bilancit të Pagesave, FMN, Edicioni i Pestë, 1993", si edhe në bazë të detajimeve të "Udhëzuesit të Kompilimit të Bilancit të Pagesave, FMN, 1995". Kompilimi i të dhënave ndjek metodologjinë e përcaktuar në "Statistikat e Tregtisë Ndërkombëtare: Koncepte dhe përkufizime" (1998).

Metodologjia e llogaritjes së kurseve të këmbimit është aktualisht e publikuar në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë. Përsa i përket procedurave të punës, po punohet për të mundësuar hedhjen dhe përpilimin elektronik të kuotimeve të bankave të nivelit të dytë dhe kurseve në tregun ndërkombëtar, që në momentin e përllogaritjes. Prania e serive kohore të kursit të këmbimit në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë, në "Raportin Mujor Statistikor ", mundëson kontrollin e tyre.

3. DETYRAT QË DALIN DHE ÇËSHTJE PËR T'U ZGJIDHUR

Duke pasur si qëllim përmirësimin e shpërndarjes së të dhënave për të arritur standardet e SDDS-it, më poshtë jepet një listë detyrash që buron nga shmangiet ekzistuese:

- Plotësimi i ligjit me penalizimet në rast mosraportimi të subjekteve për qëllime statistikore.
- Pasurimi i rregulloreve për parandalimin e shpërndarjes indirekte të të dhënave dhe kufizimin e të drejtës së përdorimit të të dhënave individuale. Njohja e personelit me rregullat e transparencës.
- Krijimi i kushteve për kompilimin e statistikave të IIP-së e borxhit të jashtëm.
- Kompilimi i statistikave të rezervës ndërkombëtare sipas modulit "International Reserves and Foreign Currency Liquidity".
- Rifreskimi i metodologjisë së kompilimit të bilancit të pagesave, miratimi e publikimi i saj.
- Listimi, publikimi dhe rishikimi i rregulloreve lidhur me kushtet dhe termat në të cilat mblidhen, përpunohen dhe shpërndahen të dhënat statistikore.
- Shkurtimi i kohës së raportimit të bankave të nivelit të dytë, vendosja e afateve për fundin e vitit.
- Rritja e transparencës për revizionimin e statistikave me anë të publikimit të kalendarëve, komenteve e dokumentacionit që shoqëron rregullimin.
- Shtrirja e mbulimit me institucionet e tjera financiare në statistikat monetare e financiare.
- Publikimi paraprak i kalendareve të botimeve të statistikave që prodhon Banka e Shqipërisë.

ANEKS 1: SEKTORI FINANCIAR

SHËNIME:

1. Tabelat janë të ndërtuara sipas ndarjeve të tabelës 1.

2. Vlerësimet e dhëna në të janë realizuar nga autorët; nga njësia e SDDS-it të Fondit Monetar Ndërkombëtar janë marrë konsiderata paraprake. Për të marrë vlerësimet reale, duhet kontaktuar me specialistët e Fondit Monetar Ndërkombëtar.

3. Në kolonën e tretë të tabelave më poshtë, simboli "√" tregon që praktika ekzistuese është në përputhje me standardin e SDDS-it, ndërsa simboli "X" tregon që praktika ekzistuese nuk është në përputhje me standardin e SDDS-it.

I) LLOGARITË ANALITIKE TË SEKTORIT BANKAR

Të dhënat: mbulimi, periodiciteti dhe vonesa		
Kërkesat e SDDS	Praktika jonë	
Karakteristikat e mbulimit: Standardi kërkon si minimum përfshirjen e: agregatëve monetarë; kredinë e brendshme të ndarë në qeveri e përgjithshme/ pjesa tjetër e sektorëve rezidentë ose qeveri e përgjithshme/ ndërmarrje jofinanciare publike/ sektori privat ose sektori publik/ sektori privat; dhe pozicionin e jashtëm të sektorit bankar në bazë bruto ose neto.	Llogaritë analitike të sektorit bankar shpërndahen me anë te "Gjendjes monetare", në milionë lekë. Të dhënat mbulojnë bankat tregtare që veprojnë në territorin e Shqipërisë dhe Bankën e Shqipërisë Të dhënat përfshijnë: (1) Agregatët monetarë: (a) M1, që përfshin paranë në qarkullim dhe depozitat e kërkueshme (llogaritë rrjedhëse dhe depozitat pa afat) të sektorëve rezidentë jobanka, (qeveria lokale, ndërmarrjet jofinanciare publike, ndërmarrjet e tjera jofinanciare, institucionet e tjera financiare dhe sektorë të tjerë rezidentë); (b) M2, që përfshin M1 dhe depozitat me afat të sektorëve rezidentë jobanka; dhe (c) M3, që përfshin M2 dhe depozitat në valutë të sektorëve rezidentë jobanka. (2) Pretendimet neto ndaj qeverisë qendrore (përfshirë pretendimet ndaj qeverisë si huatë, letrat me vlerë dhe llogari të tjera; dhe detyrimet ndaj qeverisë si depozita hua dhe llogari të tjera). (3) Kredinë e brendshme ndaj sektorëve rezidentë të ndarë në pretendime ndaj qeverisë lokale, pretendime ndaj ndërmarrjeve jofinanciare publike, pretendime ndaj ndërmarrjeve të tjera jofinanciare, pretendime ndaj institucioneve të tjera financiare dhe pretendime ndaj sektorëve të tjerë rezidentë. (4) Pozicioni i jashtëm i sektorit bankar në bazë bruto (duke përfshirë arin monetar dhe mjetet e detyrimet e Bankës së Shqipërisë ndaj FMN-së).	√
Periodiciteti: Mujor.	Mujor	√

Vonesa: Një muaj.	Jo më vonë se 40 ditë pas fundit të muajit të referencës për të dhënat e njëmbëdhjetë muajve të parë të vitit dhe brenda 2 muajve nga data e referencës për muajin dhjetor.	X
E drejta e përdorimit nga publiku		
Kërkesat e SDDS	Praktika jonë	
Publikimi paraprak i kalendarit të botimeve: Të paktën një tremujor përpara anëtarët pjesëmarrës duhet të deklarojnë ditën e publikimit ose afatin e fundit të tij. Mund të identifikohet një periudhë deri në 5 ditë pune, gjatë të cilave mund të kryhet publikimi, me kusht që një javë përpara datës së publikimit të deklarohet data e saktë.	Nuk ka	X
Shpërndarje e njëkohshme e të gjitha palëve: Standardi rekomandon që të dhënat t'u shpërndahen njëkohësisht të gjitha palëve të interesuara. Në këtë rast, publikimi nuk i referohet ministrive apo agjencive qeveritare. Publikimi i njëkohshëm i referohet momentit të parë kur të dhënat janë të gatshme për të gjithë përdoruesit në çdo lloj formati (dokument, disketë, formë elektronike etj..)	Të dhënat u shpërndahen në të njëjtën kohë të gjitha palëve të interesuara në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë. Për këtë gjë, jepet një informacion edhe në buletinin mujor të Bankës së Shqipërisë.	√
Integriteti i të dhënave		
Kërkesat e SDDS	Praktika jonë	
Publikimi i termave dhe kushteve në të cilat prodhohen dhe shpërndahen statistikat, përfshirë mbrojtjen e informacionit individual: Termat dhe kushtet mund t'u referohen çështjeve si për shembull marrëdhëniet e njësisë statistikore me një departament ose ministri në të cilën ajo bën pjesë. Për shembull ato mund të kenë të bëjnë me varësinë (në aspektin buxhetor apo të burimeve njerëzore) e agjencisë që prodhon statistikat me një autoritet të jashtëm, me pavarësinë (në zgjedhjen e metodologjisë së statistikave dhe vendime për të publikuar rezultatet statistikore). Gjithashtu termat dhe kushtet, mund t'i referohen kërkesës ndaj agjencisë për të publikuar të dhënat që mblidhen si mbrojtje ndaj presionit politik për të fshehur rezultate të caktuara, kualifikimin dhe termat e referencës së drejtorit të statistikave, dhe rishikimin e programeve statistikore nga grupe të pavaruara ekspertësh. Një tjetër çështje e kushteve në të cilat veprojnë agjencitë statistikore, i referohet procedurave dhe proceseve të lidhura me konfidencialitetin e të dhënave individuale. Këto procedura mbulojnë çështje të ndryshme, që nga siguria e kompjuterave deri tek shkëmbimi i informacionit midis agjencive statistikore.	Kompilimi i statistikave monetare dhe financiare është në përputhje me "Metodikën e statistikave monetare dhe financiare, Banka e Shqipërisë, Korrik 2003". Konfidencialiteti i të dhënave individuale mbulohet nga neni 58 i ligjit nr. 8269 "Për Bankën e Shqipërisë" i vitit 1997, ku specifikohet se administratorët, punonjësit dhe agjentët ndalohen t'u shpërndajnë ose t'u transferojnë informacionin e marrë gjatë punës së tyre në Bankën e Shqipërisë ndonjë pale të tretë ose të përdorin dhe të lejojnë të përdoret ky informacion për qëllime perfitimi personal. Konfidencialiteti i të dhënave individuale gjithashtu, mbulohet nga rregullorja "Mbi transparencën dhe konfidencialitetin në Bankën e Shqiperisë', miratuar me vendim nr. 53, datë 21.06.2000, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Ligjet dhe rregulloret janë publikuar në faqen web të Bankës së Shqipërisë.	√

Identifikimi i të drejtës së përdorimit nga qeveria para publikimit të të dhënave: Në interes të mbrojtjes nga ndikimet nga autoritete jashtë agjencisë që publikon të dhënat, standardi rekomandon listimin e personave apo të zyrtarëve me pozicione të caktuara në qeveri, por jashtë agjencive të kompilimit të të dhënave, të cilët kanë akses në të dhënat para publikimit, si dhe raportimin e një kalendari sipas të cilit ata kanë akses. Kjo praktikë rekomandohet për t'i dhënë transparencë të plotë çdo të drejte përdorimi paraprak të qeverisë, që gjykohet e nevojshme.	Askush jashtë Bankës së Shqipërisë nuk ka të drejtën e përdorimit të treguesve të statistikave monetare dhe financiare para se të publikohen.	√
Identifikimi i komenteve (nga qeveria) për të dhënat statistikore: Duke qenë se qeveria mund të mos vlerësojë objektivisht të dhënat statistikore sidomos në ato raste kur ato lidhen direkt me përgjegjësitë e saj, standardi parashikon identifikimin e burimit të komenteve mbi të dhënat.	Për treguesit e statistikave monetare dhe financiare nuk ka asnjë komentar nga zyrtarë jashtë Bankës së Shqipërisë që bashkëshoqëron të dhënat.	√
Publikimi i informacionit mbi rishikimet dhe njoftimi paraprak i ndryshimeve në metodologji: Informacion i rëndësishëm në lidhje me rishikimet e të dhënave mund të jetë ai në lidhje me politikat e ndjekura dhe masën e rishikimeve të mëparshme. Rregullimet bëhen për të pasqyruar përmirësime ose ndryshime që kanë të bëjnë me aspekte të ndryshme të metodologjisë statistikore si: konceptet e përkufizimet themelore; burimet e informacionit; metodat e vlerësimit. Politikat e rregullimit që i referohen këtyre ndryshimeve, duhet të përcaktojnë edhe frekuencat e procedurat përkatëse që duhet të ndjekin këto rregullime e duhet të bëhen publike. Njoftimet për ndryshimet si më sipër mund të marrin forma të ndryshme që variojnë nga deklarata të shkurtra për shtyp deri te prezantime e materiale në formë publike. Anëtarët inkurajohen gjithashtu të sigurojnë informacion më të shpejtë për rishikimet pasi ato janë kryer (për shembull me telefon, faks ose internet nga një person kontakti që t'u përgjigjet pyetjeve në lidhje me rregullimet).	Të dhënat janë përfundimtare në momentin e parë që publikohen. Megjithatë, të dhënat mund të rishikohen për shkak të ndryshimeve nga raportet e bankave të nivelit të dytë pas auditimit nga auditët e tyre të jashtëm. Të dhënat e rishikuara jepen në publikimin e rradhës, ndërsa shkaqet për ndryshimet nuk publikohen. Përsa i përket ndryshimeve në metodologji, ato njoftohen në momentin kur shpërndahen të dhënat dhe jo paraprakisht.	X

Cilësia e të dhënave		
Kërkesat e SDDS	Praktika jonë	
Publikimi i dokumentacionit mbi metodologjinë dhe burimet e përdorura për statistikat: Publikimi i dokumentacionit mbi metodologjinë dhe burimet e përdorura është çelësi për ndërgjegjësimin e përdoruesve për përparësitë a dobësitë e statistikave. Dokumentacioni i rekomanduar mund të marrë forma të ndryshme, duke përfshirë edhe shënime përmbledhëse që shoqërojnë publikimin e të dhënave, publikime të veçanta ose materiale të gatshme për t'u shpërndarë sipas kërkesës. Anëtarët inkurajohen të përfshijnë aty e të nënvizojnë deklarata mbi karakteristikat më të rëndësishme të cilësisë. Këto mund të bëjnë të qarta tipet e gabimeve, subjekt i të cilave mund të jenë të dhënat, arsyet e moskrahasueshmërisë së të dhënave në kohë ose gabimet e zgjedhjes në rastet e vrojtimeve etj..	Metodologjia e përdorur për kompilimin e statistikave monetare dhe financiare përshkruhet në "Metodikën e statistikave monetare dhe finanicare, Banka e Shqipërisë, Korrik 2003", e cila është e publikuar në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë.	√
Publikimi i të dhënave të detajuara, pajtueshmëria me të dhëna të lidhura me to dhe prania e një kuadri statistikor të tillë, që të mundësojë kontrollet statistikore e të sigurojë besueshmërinë dhe korrektësinë e të dhënave: Ky element rekomandon publikimin e detajuar të përbërësve, duke nënvizuar shpërndarjen brenda një kuadri statistikor dhe/ose publikimin e krahasimit dhe të pajtueshmërisë me të dhëna të tjera të lidhura me to. Detajimi i përbërësve duhet të jetë i tillë, që të mos ketë konflikt me elementet e tjera si dhe me besueshmërinë e konfidencialitetit të informacioneve individuale.	Të dhënat publikohen sipas kuadrit statistikor të paraqitjes monetare, i cili siguron identitetin bazë kontabël: mjetet e huaja neto plus mjetet e brendshme, barazon detyrimet totale plus llogarinë kapitale. Gjithashtu, të dhënat e veçanta për autoritetin monetar dhe për bankat e nivelit të dytë publikohen në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë dhe në "Raportin mujor statistikor" të Bankës së Shqipërisë, duke lejuar kështu një kontroll të këtyre të dhënave.	√

II) LLOGARITË ANALITIKE TË BANKËS QENDRORE

Të dhënat: mbulimi, periodiciteti dhe vonesa		
Kërkesat e SDDS	Praktika jonë	
Karakteristikat e mbulimit: SDDS kërkon përfshirjen e këtyre përbërësve: i) Baza monetare (rezerva monetare) sipas konceptit që përdoret në vend. ii) Krediti i brendshëm i ndarë në sektor publik ose qeveri qendrore (në varësi të kuadrit statistikor të statistikave fiskale) dhe sektor privat; dhe, iii) Pozicioni i huaj i bankës qendrore, në bazë bruto ose neto.	Të dhënat analitike të bankës qendrore jepen në milionë lekë dhe bazohen në regjistrimet kontabël të Bankës së Shqipërisë. Të dhënat shpërndahen sipas këtyre përbërësve: 1) Mjetet e huaja neto të bankës qendrore, të ndara në mjete ndaj jorezidentëve dhe detyrime ndaj jorezidentëve. 2) Pretendime neto ndaj qeverisë qendrore, të ndara në pretendime ndaj qeverisë qendrore dhe detyrime ndaj qeverisë qendrore. 3) Mjete të brendshme ndaj pjesës tjetër të ekonomisë (përfshirë pretendime ndaj individëve, pretendime ndaj njësive jofinanciare publike, njësive të tjera jofinanciare, institucioneve të tjera financiare dhe pretendime ndaj korporatave të tjera depozituese). 4) Baza monetare, që përfshin paranë në qarkullim, rezervat e bankave të nivelit të dytë në bankën qendrore dhe depozitat e përfshira në paranë e gjerë. 5) Depozita të përjashtuara nga paraja e gjerë, si depozita të bllokuara të sektorëve rezidentë, përveç qeverisë qendrore. 6) Hua të bankës qendrore në formën e marrëveshjeve të riblerjes. 7) Llogari të tjera të pagueshme ndaj sektorëve të tjerë rezidentë përveç qeverisë qendrore. 8) Të tjera neto. 9) Llogaritë kapitale.	√
Periodiciteti: Mujor, inkurajohet javor.	Mujor.	
Vonesa: Dy javë.	Jo më shumë se dhjetë ditë pas ditës së fundit të muajit të referencës.	
E drejta e përdorimit nga publiku		
Kërkesat e SDDS	Praktika jonë	
Publikimi paraprak i kalendarit të botimeve: Të paktën një tremujor përpara, anëtarët pjesëmarrës duhet të deklarojnë ditën e publikimit ose afatin e fundit të tij. Mund të identifikohet një periudhë deri në 5 ditë pune, gjatë të cilave mund të kryhet publikimi, me kusht që një javë përpara datës së publikimit të deklarohet data e saktë.	Nuk ka.	X
Shpërndarje e njëkohshme e të gjitha palëve: Standardi rekomandon që të dhënat t'u shpërndahen njëkohësisht të gjitha palëve të interesuara. Në këtë rast, publikimi nuk i referohet ministrive apo agjencive qeveritare. Publikimi i njëkohshëm i referohet momentit të parë kur të dhënat janë të gatshme për të gjithë përdoruesit, në çdo lloj formati (në letër, disketë, formë elektronike etj.).	Të dhënat u shpërndahen në të njëjtën kohë të gjitha palëve të interesuara nëpërmjet faqes së internetit të Bankës së Shqipërisë. Për këtë gjë jepet një informacion edhe në Raportin Mujor Statistikor të Bankës së Shqipërisë.	√
Integriteti i të dhënave		
Kërkesat e SDDS	Praktika jonë	

Publikimi i termave dhe i kushteve në të cilat prodhohen dhe shpërndahen statistikat, përfshirë mbrojtjen e informacionit individual: Termat dhe kushtet mund t'u referohen çështjeve si për shembull, marrëdhëniet e njësisë statistikore me një departament ose ministri në të cilën ajo bën pjesë. Për shembull, ato mund të kenë të bëjnë me varësinë (në aspektin buxhetor apo të burimeve njerëzore) e agjencisë që prodhon statistikat nga një autoritet i jashtëm, me pavarësinë në zgjedhjen e metodologjisë së statistikave dhe vendime për të publikuar rezultatet statistikore. Gjithashtu, termat dhe kushtet mund t'i referohen kërkesës ndaj agjencisë për të publikuar të dhënat që mblidhen si mbrojtje ndaj presionit politik për të fshehur rezultate të caktuara, kulifikimin dhe termat e referencës së drejtorit të statistikave dhe rishikimin e programeve statistikore nga grupe të pavaruara ekspertësh. Një tjetër çështje e kushteve në të cilat veprojnë agjencitë statistikore i referohet procedurave dhe proceseve të lidhura me konfidencialitetin e të dhënave individuale. Këto procedura mbulojnë çështje të ndryshme, që nga siguria e kompjuterave deri tek shkëmbimi i informacionit midis agjencive statistikore.	Të dhënat kompilohen në përputhje më ligjin nr. 8269 "Për Bankën e Shqipërisë" i vitit 1997, (neni 24) ku përshkruhet detyrimi i Bankës së Shqipërisë për të përgatitur analizat periodike mbi çështjet ekonomike dhe monetare, të publikojë rezultatet dhe t'i bëjë propozime qeverisë. Kompilimi i statistikave monetare dhe financiare është në përputhje me "Metodikën e statistikave monetare dhe financiare, Banka e Shqipërisë, Korrik 2003". Konfidencialiteti i të dhënave individuale mbulohet nga neni 58 i ligjit nr. 8269 "Për Bankën e Shqipërisë" i vitit 1997, ku specifikohet se administratorët, punonjësit dhe agjentët ndalohen të shpërndajnë ose t'u transferojnë informacionin e marrë gjatë punës së tyre në Bankën e Shqipërisë ndonjë pale të tretë, ose të përdorin dhe të lejojnë të përdoret ky informacion për qëllime përfitimi personal. Konfidencialiteti i të dhënave individuale gjithashtu, mbulohet nga rregullorja "Mbi transparencën dhe konfidencialitetin në Bankën e Shqipërisë", miratuar me vendim nr. 53 datë 21.06.2000, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Ligjet dhe rregulloret janë publikuar në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë.	√
Identifikimi i të drejtës së përdorimit nga qeveria para publikimit të të dhënave: Në interes të mbrojtjes nga ndikimet nga autoritete jashtë agjencisë që publikon të dhënat, standardi rekomandon listimin e personave apo të zyrtarëve me pozicione të caktuara në qeveri, por jashtë agjencive të kompilimit të të dhënave, të cilët kanë të drejta në të dhënat statistikore para publikimit, si dhe raportimin e një kalendari të këtyre të drejtave. Kjo praktikë rekomandohet për t'i dhënë transparencë të plotë çdo të drejte përdorimi paraprake të qeverisë, që gjykohet e nevojshme.	Askush jashtë Bankës së Shqipërisë nuk ka të drejtën e përdorimit të treguesve të statistikave monetare dhe financiare para se të publikohen.	√
Identifikimi i komenteve (nga qeveria) për të dhënat statistikore: Duke qenë se qeveria mund të mos vlerësojë objektivisht të dhënat statistikore sidomos në ato raste kur ato lidhen direkt me përgjegjësitë e saj, standardi parashikon identifikimin e burimit të komenteve mbi të dhënat.	Për treguesit e statistikave monetare dhe financiare nuk ka asnjë komentar nga zyrtarë jashtë Bankës së Shqipërisë që bashkëshoqëron të dhënat.	√

Publikimi i informacionit mbi rishikimet dhe njoftimi paraprak i ndryshimeve në metodologji: Informacion i rëndësishëm në lidhje me rishikimin e të dhënave mund të jetë ai në lidhje me politikat e ndjekura dhe masën e rishikimeve të mëparshme. Rishikimet bëhen për të pasqyruar përmirësime ose ndryshime që kanë të bëjnë me aspekte të ndryshme të metodologjisë statistikore si: konceptet e përkufizimet themelore; burimet e informacionit; metodat e vlerësimit. Politikat e rishikimit që i referohen këtyre ndryshimeve duhet të përcaktojnë edhe frekuencat e procedurat përkatëse që duhet të ndjekin këto rishikime. Politikat e rishikimit duhet të bëhen publike. Njoftimet për ndryshimet si më sipër mund të marrin forma të ndryshme që variojnë nga deklarata të shkurtra për shtyp deri tek prezantime e materiale në formë publike. Anëtarët inkurajohen gjithashtu të sigurojnë informacion më të shpejtë për revizionimet pasi ato janë kryer (për shembull me telefon, faks ose internet nga një person kontakti që t'u përgjigjet pyetjeve në lidhje me rishikimet).	Të dhënat janë përfundimtare në momentin e parë që publikohen.	√
Cilësia e të dhënave		
Kërkesat e SDDS	Praktika jonë	
Publikimi i dokumentacionit mbi metodologjinë dhe burimet e përdorura për statistikat: Publikimi i dokumentacionit mbi metodologjinë dhe burimet e përdorura është çelësi për ndërgjegjësimin e përdoruesve për përparësitë a dobësitë e statistikave. Dokumentacioni i rekomanduar mund të marrë forma të ndryshme, duke përfshirë edhe shënime përmbledhëse që shoqërojnë publikimin e të dhënave, publikime të veçanta ose materiale të gatshme për t'u shpërndarë sipas kërkesës. Anëtarët inkurajohen të përfshijnë aty e të nënvizojnë deklarata mbi karakteristikat më të rëndësishme të cilësisë. Këto mund të bëjnë të qarta tipet e gabimeve subjekt i të cilave mund të jenë të dhënat, arsyet e moskrahasueshmërisë së të dhënave në kohë ose gabimet e zgjedhjes në rastet e vrojtimeve etj..	Metodologjia e përdorur për kompilimin e statistikave monetare dhe financiare përshkruhet në "Metodikën e statistikave monetare dhe financiare, Banka e Shqipërisë, Korrik 2003", e cila është e pulikuar në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë.	√

Publikimi të dhënave të detajuara, pajtueshmëria me të dhëna të lidhura me to dhe prania e një kuadri statistikor të tillë, që të mundësojë kontrollet statistikore e të sigurojë besueshmërinë dhe korrektësinë e të dhënave: Ky element rekomandon publikimin e datajuar të përbërësve, duke nënvizuar shpërndarjen brenda një kuadri statistikor dhe/ose publikimin e krahasimit dhe pajtueshmërisë me të dhëna të tjera të lidhura me to. Detajimi i përbërësve duhet të jetë i tillë që të mos ketë konflikt me elementët e tjerë, si dhe besueshmërinë e konfidencialitetit të informacioneve individuale.	Të dhënat publikohen sipas kuadrit statistikor të paraqitjes monetare të bankës qendrore, e cila siguron identitetin bazë kontabël: mjetet e huaja neto plus mjetet e brendshme, barazojnë detyrimet totale plus llogarinë kapitale. Gjithashtu, të dhënat e detajuara për autoritetin monetar publikohen në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë dhe në "Raportin mujor statistikor" të Bankës së Shqipërisë, duke lejuar kështu një kontroll të këtyre të dhënave.	√

I) NORMAT E INTERESIT

Të dhënat: Mbulimi, Periodiciteti dhe Vonesa		
Kërkesat e SDDS	Praktika jonë	
Karakteristikat e mbulimit: SDDS kërkon shpërndarjen e normave të interesit për letrat me vlerë afatshkurtër dhe afatgjatë të qeverisë. Gjithashtu SDDS kërkon shpërndarjen e një norme interesi bazë si për shembull një normë huaje të bankës qendrore apo një normë skontimi. SDDS inkurajon shpërndarjen e normave të interesit mbi kreditë dhe depozitat.	Banka e Shqipërisë publikon të dhëna për: (1) normat vjetore të bonove të thesarit 3, 6 dhe 12-mujore dhe të obligacioneve qeveritare 2-vjeçare; (2) normat mesatare të ponderuara mujore të interesave për kreditë e reja të bankave tregtare në lekë, usd dhe euro, për çdo maturim si dhe në total; (3) normat mesatare të ponderuara mujore të interesave për depozitat e reja të bankave tregtare në lekë, usd dhe euro për çdo maturim si dhe në total; dhe (4) normat e interesit të instrumenteve indirekte të politikës monetare Bankës së Shqipërisë ku përfshihen: • Norma e interesit të marrëveshjes së riblerjes, e cila është norma bazë e përdorur nga Banka e Shqipërisë. • Depozita njëditore norma e interesit të së cilës është 3.0 për qind nën normën e interesit të deklaruar nga Banka e Shqipërisë për marrëveshjet e riblerjes. • Kredia njëditore norma e interesit të së cilës është 2.5 për qind mbi normën e interesit të marrëveshjes së riblerjes. • Kredia Lombard norma e interesit të së cilës llogaritet si 6 për qind mbi normën e marrëveshjeve të riblerjes, të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.	√
Periodiciteti: Ditor.	Për normën e marrëveshjeve të riblerjes dhe normat e interesit të Bankës së Shqipërisë periodiciteti është ditor. Për bonot e thesarit të tregut primar periodiciteti është javor (sa herë emetohen). Për obligacionet qeveritare të tregut primar periodiciteti është çdo muaj (sa herë emetohen). Për normat e interesit për kreditë dhe depozitat e bankave tregtare periodiciteti është mujor.	√

Vonesa: Nuk specifikohet.	Norma e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe normat e interesit të Bankës së Shqipërisë publikohen në ditën e ndryshimit të tyre. Normat e interesit për obligacionet qeveritare dhe bonot e thesarit publikohet në ditën e emetimit të tyre. Normat e interesit për kreditë dhe depozitat e sistemit bankar publikohen në jo më shumë se 40 ditë nga fundi i muajit të referencës.	√
E drejta e përdorimit nga publiku		
Kërkesat e SDDS	Praktika jonë	
Publikimi paraprak i kalendarit të botimeve: Të paktën një tremujor përpara anëtarët pjesëmarrës duhet të deklarojnë ditën e publikimit ose afatin e fundit të tij. Mund të identifikohet një periudhë deri në 5 ditë pune, gjatë të cilave mund të kryhet publikimi, me kusht që një javë përpara datës së publikimit të deklarohet data e saktë.	Nuk ka.	X
Shpërndarje e njëkohshme e të gjitha palëve: Standardi rekomandon që të dhënat t'u shpërndahen njëkohësisht të gjitha palëve të interesuara. Në këtë rast, publikimi nuk i referohet ministrive apo agjencive qeveritare. Publikimi i njëkohshëm i referohet momentit të parë kur të dhënat janë të gatshme për të gjithë përdoruesit në çdo lloj formati (në letër, disketë, formë elektronike etj..)	Të dhënat u shpërndahen në të njëjtën kohë të gjitha palëve të interesuara në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë. Për këtë gjë, jepet një informacion edhe në "Raportin mujor statistikor" të Bankës së Shqipërisë.	√
Integriteti i të dhënave		
Kërkesat e SDDS	Praktika jonë	
Publikimi i termave dhe i kushteve në të cilat prodhohen dhe shpërndahen statistikat, përfshirë mbrojtjen e informacionit individual: Termat dhe kushtet mund t'u referohen çështjeve si për shembull marrëdhëniet e njësisë statistikore me një departament ose ministri në të cilën ajo bën pjesë. Për shembull ato mund të kenë të bëjnë me varësinë (në aspektin buxhetor apo të burimeve njerëzore) të agjencisë që prodhon statistikat me një autoritet të jashtëm ose me pavarësinë në zgjedhjen e metodologjisë së statistikave dhe vendimeve për të publikuar rezultatet statistikore. Gjithashtu, termat dhe kushtet mund t'i referohen kërkesës ndaj agjencisë për të publikuar të dhënat që mblidhen si mbrojtje ndaj presionit politik për të fshehur rezultate të caktuara, dhe rishikimin e programeve statistikore nga grupe të pavaruara ekspertësh. Një tjetër çështje e kushteve në të cilat veprojnë agjencitë statistikore, i referohet procedurave dhe proceseve të lidhura me konfidencialitetin e të dhënave individuale. Këto procedura mbulojnë çështje të ndryshme, që nga siguria e kompjuterave deri tek shkëmbimi i informacionit midis agjencive statistikore.	Të dhënat kompilohen në përputhje me ligjin nr. 8269 "Për Bankën e Shqipërisë" i vitit 1997 (neni 24), ku përshkruhet detyrimi i Bankës së Shqipërisë për të përgatitur analizat periodike mbi çështjet ekonomike dhe monetare, të publikojë rezultatet dhe t'i bëjë propozime qeverisë. Konfidencialiteti i të dhënave individuale mbulohet nga neni 58 i ligjit nr. 8269 "Për Bankën e Shqipërisë" i vitit 1997, ku specifikohet se administratorët, punonjësit, dhe agjentët ndalohet të shpërndajnë ose t'u transferojnë informacionin e marrë gjatë punës së tyre në Bankën e Shqipërisë, ndonjë palë të tretë ose të përdorin dhe të lejojnë të përdoret ky informacion për qëllime përfitimi personal. Konfidencialiteti i të dhënave individuale gjithashtu mbulohet nga rregullorja "Mbi transparencën dhe konfidencialitetin në Bankën e Shqipërisë", miratuar me vendim nr. 53, datë 21.06.2000, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Ligjet dhe rregulloret janë publikuar në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë.	√

Identifikimi i të drejtës së përdorimit nga qeveria para publikimit të të dhënave: Në interes të mbrojtjes nga ndikimet nga autoritete jashtë agjencisë që publikon të dhënat, standardi rekomandon listimin e personave apo të zyrtarëve me pozicione të caktuara në qeveri, por jashtë agjencive të kompilimit të të dhënave, të cilët kanë të drejta mbi të dhënat statistkore para publikimit, si dhe raportimin e një kalendari të këtyre të drejtave. Kjo praktikë rekomandohet për t'i dhënë transparencë të plotë çdo të drejte përdorimi paraprak të qeverisë, që gjykohet e nevojshme.	Askush jashtë Bankës së Shqipërisë nuk ka të drejtën e përdorimit të treguesve para se të publikohen.	√
Identifikimi i komenteve (nga qeveria) për të dhënat statistikore: Duke qenë se qeveria mund të mos vlerësojë objektivisht të dhënat statistikore sidomos në ato raste kur ato lidhen drejtpërdrejt me përgjegjësitë e saj, standardi parashikon identifikimin e burimit të komenteve mbi të dhënat.	Për normat e interesit nuk ka asnjë komentar nga zyrtarë jashtë Bankës së Shqipërisë që bashkëshoqëron të dhënat.	√
Publikimi i informacionit mbi rishikimet dhe njoftimi paraprak i ndryshimeve në metodologji: Informacion i rëndësishëm në lidhje me rishikimin e të dhënave mund të jetë ai në lidhje me politikat e ndjekura dhe masën e rishikimeve të mëparshme. Rishikimet bëhen për të pasqyruar përmirësime ose ndryshime që kanë të bëjnë me aspekte të ndryshme të metodologjisë statistikore si: konceptet e përkufizimet themelore; burimet e informacionit; metodat e vlerësimit. Politikat e rishikimit që i referohen këtyre ndryshimeve duhet të përcaktojnë edhe frekuencat e procedurat përkatëse që duhet të ndjekin këto rishikime e duhet të bëhen publike. Njoftimet për ndryshimet si më sipër mund të marrin forma të ndryshme që variojnë nga deklarata të shkurtra për shtyp deri te prezantime e materiale në formë publike. Anëtarët inkurajohen gjithashtu të sigurojnë informacion më të shpejtë për rishikimet pasi ato janë kryer (për shembull me telefon, faks ose internet nga një person kontakti që t'u përgjigjet pyetjeve në lidhje me rishikimet).	Të dhënat janë përfundimtare në momentin e parë që publikohen.	√

Cilësia e të dhënave		
Kërkesat e SDDS	Praktika jonë	
Publikimi i dokumentacionit mbi metodologjinë dhe burimet e përdorura për statistikat: Publikimi i dokumentacionit mbi metodologjinë dhe burimet e përdorura është çelësi për ndërgjegjësimin e përdoruesve për përparësitë a dobësitë e statistikave. Dokumentacioni i rekomanduar mund të marrë forma të ndryshme, duke përfshirë edhe shënime përmbledhëse që shoqërojnë publikimin e të dhënave, publikime të veçanta ose materiale të gatshme për t'u shpërndarë sipas kërkesës. Anëtarët inkurajohen të përfshijnë aty e të nënvizojnë deklarata mbi karakteristikat më të rëndësishme të cilësisë. Këto mund të bëjnë të qarta tipet e gabimeve subjekt i të cilave mund të jenë të dhënat, arsyet e moskrahasueshmërisë së të dhënave në kohë ose gabimet e zgjedhjes në rastet e vrojtimeve etj..	Metodologjia e përdorur për llogaritjen e normave të interesit të repove dhe instrumenteve të tjera të Bankës së Shqipërisë gjendet në rregulloren "Për instrumentet indirekte të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë", miratuar me vendim nr. 08, datë 07.02.2001 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Metodologjia për llogaritjen e normës së interesit të obligacioneve të thesarit në tregun primar, përcaktohet në marrëveshjen midis Bankës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë mbi "Emetimin e obligacioneve afatgjata të qeverisë në formë regjistrimi" datë 25.09.2002, por nuk publikohet. Metodologjia për llogaritjen e normës së interesit të bonove të thesarit në tregun primar, përcaktohet në marrëveshjen midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave "Mbi emetimin e bonove të thesarit në formë regjistrimi" datë 08. 07. 2002, por nuk publikohet. Për normat e interesit mbi depozitat dhe kreditë e sistemit bankar jepen shpjegimet përkatëse në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë bashkë me të dhënat.	X
Publikimi i të dhënave të detajuara, pajtueshmëria me të dhëna të lidhura me to dhe prania e një kuadri statistikor të tillë, që të mundësojë kontrollet statistikore e të sigurojë besueshmërinë dhe korrektësinë e të dhënave: Ky element rekomandon publikimin e detajuar të përbërësve, duke nënvizuar shpërndarjen brenda një kuadri statistikor, dhe/ose publikimin e krahasimit dhe të pajtueshmërisë me të dhëna të tjera të lidhura me to. Detajimi i përbërësve duhet të jetë i tillë që të mos ketë konflikt me elementet e tjera si dhe besueshmërinë e konfidencialitetit të informacioneve individuale.	Të dhënat publikohen në Reuters, në "Raportin mujor statistikor" nëpërmjet një serie prej 6 vitesh dhe në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë.	√

ANEKS 2: SEKTORI I JASHTËM

I) BILANCI I PAGESAVE

Të dhënat: Mbulimi, Frekuenca dhe Vonesat		
Kërkesat e SDDS	Praktika jonë	
Karakteristikat e mbulimit: Për llogarinë korente, SDDS rekomandon: mbulimin e importeve dhe eksporteve të mallrave e shërbimeve, të ardhurat neto dhe transfertat korente neto. Për llogarinë kapitale e financiare elementet përbërëse që rekomandohen përfshijnë rezervën ndërkombëtare dhe transaksione të tjera financiare. Inkurajohet një nëndarje e transaksioneve financiare në investime direkte dhe investime portofoli. Rekomandohen klasifikimet sipas Manualit të FMN-së, BPM5, si dhe ai për ndarjen veçmas të derivativëve financiarë.	Bilanci i Pagesave të Shqipërisë mbulon në parim të gjitha transaksionet mes rezidentëve e jorezidentëve, megjithëse disa aktivitete ilegale mbeten të pambuluara. Të dhënat e bilancit të pagesave kompliohen në milionë usd dhe klasifikohen sipas strukturës së tabelës së bilancit të pagesave dhe përkufizimeve të komponentëve standard të listuar në manualin e bilancit të pagesave të FMN-së, BPM5. Këto komponentë klasifikohen në tre kategori kryesore: I - llogaria korente ku dallohen mallrat, shërbimet, të ardhurat dhe transfertat korente. (a) Mallrat - mbulon mallrat e lëvizshëm, pronësia e të cilëve kalon nga rezidentët tek jorezidentët (eksportet) dhe anasjelltas, nga jorezidentët tek rezidentët (importet).(b) Shërbimet - mbulojnë shërbimet e kryera nga rezidentët për jorezidentët (kredi) dhe nga jorezidentët për rezidentët (debi). Shërbimet më tej ndahen në grupet e mëposhtme: • shërbime transporti; • shërbime sigurimi; • udhëtim; • shërbime të tjera. (c) Të ardhurat - mbulojnë të ardhurat që rezidentët fitojnë nga jorezidentët (kredi) ose që jorezidentët fitojnë nga rezidentët (debi) e ndahen më tej në: 1. të ardhura nga puna; 2. të ardhura nga investimet. (d) - Transfertat korente janë regjistrime balancuese që zbatohen në rastet e ndryshimeve të pronësisë së vlerave reale (mallra apo shërbime) nga rezidentët tek jorezidentët (debi) ose nga jorezidentët tek rezidentët (kredi), të cilat nuk shoqërohen me shpërblim nga pala tjetër. Transfertat korente në bilancin shqiptar të pagesave klasifikohen në: 1. ndihma shtetërore nga jashtë; 2. dërgesa nga të çatdhesuarit; 3. të tjera. II – Llogaria kapitale - transfertat kapitale ndahen në nënkomponentë: (a) borxhi i falur; dhe (b) transferta të tjera. Transferta të tjera kapitale lidhen kryesisht me investimet ndihma me qëllim shtesën ose e financimin e formimit të kapitalit fiks të ekonomisë përfituese. III - Llogaria financiare, pretendimet dhe detyrimet financiare të Shqipërisë ndaj jorezidentëve. Ndarja kryesore në llogarinë financiare është si më poshtë: (a) Rezervat ndërkombëtare - mjete të huaja financiare që kontrollohen dhe janë të gatshme për t'u përdorur nga Banka e Shqipërisë, për financimin e çbalancimeve të pagesave ndërkombëtare, për ndërhyrje në tregjet valutore etj.. (b) Transaksionet financiare që klasifikohen në mjete e detyrime sipas zërave: 1. investime direkte; 2. investime portofoli; 3. investime të tjera. Bilanci i llogarisë korente barazohet nga bilanci neto i llogarisë kapitale e financiare. Tabela statistikore e bilancit të pagesave bazohet në parimin e regjistrimit të dyfishtë dhe mbetjet përfshihen në zërin "Gabime dhe Harresa". Burime kryesore të dhënash janë statistikat e doganave, të dhënat për këmbimet valutore, raportimet nga bankat e ndërmarrje të mbledhura nga Banka e Shqipërisë, dhe informacioni i marrë nga qeveria.	√

Frekuenca : Çdo tremujor.	Statistikat e Bilancit të Pagesave prodhohen në bazë tremujore dhe vjetore.	√
Vonesat: Një tremujor.	Statistikat e Bilancit të Pagesave publikohen pothuajse 2 muaj pas periudhës së referimit	√
E drejta e përdorimit të të dhënave		
Kërkesat e SDDS	Praktika jonë	
Publikimi paraprak i kalendarit të botimeve: Të paktën një tremujor përpara, anëtarët pjesëmarrës duhet të deklarojnë ditën e publikimit ose një ditë të fundit para së cilës duhet të bëhet publikimi. Mund edhe të identifikohet një periudhë fillestare deri në 5 ditë pune gjatë të cilave mund të kryhet publikimi.	Nuk ka	X
Shpërndarje e njëkohshme e të gjitha palëve: Standardi rekomandon që të dhënat t'u shpërndahen njëkohësisht të gjitha palëve të interesuara. Në këtë rast publikimi nuk i referohet ministrive apo agjencive qeveritare. Publikimi i njëkohshëm i referohet momentit të parë kur të dhënat janë të gatshme për të gjithë përdoruesit në çdo lloj formati (në letër, disketë, formë elektronike etj..)	Momenti i parë i njohjes së publikut me të dhënat e bilancit të pagesave është publikimi i deklaratës tremujore për shtyp (që shpërndahet në letër), që jepet bashkë me tabelën përmbledhëse. Pas jo më shumë se tre javësh bëhet shpërndarja në formë elekronike dhe publikimi në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë, në bazën e të dhënave "Seri Kohore" dhe në "Raportin mujor statistikor", i cili shpërndahet në letër sipas listës së përdoruesve. Në bazë të kërkesave (gjithmonë pas datës së publikimit të statistikave) të përdoruesve, mund t'iu dorëzohen elektronikisht apo në kopje të printuar të dhëna të publikuara sipas formatit standard.	√
Integriteti i të dhënave		
Kërkesat e SDDS	Praktika jonë	
Publikimi i termave dhe i kushteve në të cilat prodhohen dhe shpërndahen statistikat, përfshirë mbrojtjen e informacionit individual: Termat dhe kushtet mund t'u referohen çështjeve si për shembull mardhëniet e njësisë statistikore me një departament ose ministri në të cilën ajo bën pjesë. Për shembull ato mund të kenë të bëjnë me varësinë (në aspektin buxhetor apo të burimeve njerëzore) të agjencisë që prodhon statistikat me një autoritet të jashtëm ose me pavarësinë në zgjedhjen e metodologjisë së statistikave dhe vendime për të publikuar rezultatet statistikore. Gjithashtu termat dhe kushtet mund t'i referohen kërkesës ndaj agjencisë për të publikuar të dhënat që mblidhen si mbrojtje ndaj presionit politik për të fshehur rezultate të caktuara, dhe rishikimin e programeve statistikore nga grupe të pavaruara ekspertësh. Një tjetër çështje e kushteve në të cilat veprojnë agjencitë statistikore i referohet procedurave dhe proceseve të lidhura me konfidencialitetin e të dhënave individuale. Këto procedura mbulojnë çështje të ndryshme, që nga siguria e kompjuterave deri tek shkëmbimi i informacionit midis agjencive statistikore.	Kompilimi i të dhënave të bilancit të pagesave bëhet në bazë të nenit 27 të ligjit "Për Bankën e Shqipërisë", sipas të cilit Banka e Shqipërisë harton bilancin e pagesave të Shqipërisë, si dhe organizon e drejton sistemin e statistikave të këtij bilanci pagesash. Bankat, institucionet dhe personat e tjerë juridikë dhe fizikë detyrohen të dërgojnë të dhënat statistikore të kërkuara, në përputhje me sistemin raportues të miratuar nga Banka e Shqipërisë dhe të përdorin kriteret e vlerësimit, të evidencimit dhe emërtimet e klasifikimet e paraqitura në të. Mbledhja e të dhënave nga sistemi bankar bazohet në: • Nenin 27 të ligjit nr. 8269 "Për Bankën e Shqipërisë", datë 23.12.1997 • Nenin 40 të ligjit nr. 8365 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", datë 02.07.1998 Konfidencialiteti i përgjigjeve individuale sigurohet nga neni 58 i ligjit nr. 8269 "Për Bankën e Shqipërisë", datë 23.12.1997, ku specifikohet qartë që administratorëve, punonjësve apo agjentëve u ndalohet të zbulojnë apo t'u japin të tretëve informacione që i kanë siguruar gjatë kryerjes së detyrave të tyre në Bankën e Shqipërisë, si dhe ta përdorin apo të lejojnë që të përdoret ky informacion për përfitime personale. Konfidencialiteti i përgjigjeve individuale sigurohet gjithashtu, edhe nga rregullorja e "Transparencës dhe e konfidencialitetit në Bankën e Shqipërisë", miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 53, datë 21.06.2000 me gjithë amendamentet përkatëse. Ligjet dhe rregulloret e përmendura janë të publikuara në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë.	√

Identifikimi i të drejtës së përdorimit nga qeveria para publikimit të të dhënave: Në interes të mbrojtjes nga ndikimet nga autoritete jashtë agjencisë që publikon të dhënat, standardi rekomandon listimin e personave apo të zyrtarëve me pozicione të caktuara në qeveri, por jashtë agjencive të kompilimit të të dhënave, të cilët kanë të drejta mbi të dhënat statistikore para publikimit, si dhe raportimin e një kalendari të këtyre të drejtave. Kjo praktikë rekomandohet për t'i dhënë transparencë të plotë çdo të drejte përdorimi paraprak të qeverisë, që gjykohet e nevojshme.	Për statistikat e bilancit të pagesave njësitë qeveritare nuk kanë të drejta përdorimi paraprak në të dhënat që publikohen.	√
Identifikimi i komenteve (nga qeveria) për të dhënat statistikore: Duke qenë se qeveria mund të mos vlerësojë objektivisht të dhënat statistikore sidomos në ato raste kur ato lidhen drejtpërdrejt me përgjegjësitë e saj, standardi parashikon identifikimin e burimit të komenteve mbi të dhënat.	Nuk ka asnjë komentar që i bashkëngjitet të dhënave të publikuara.	√
Publikimi i informacionit mbi rishikimet dhe njoftimi paraprak i ndryshimeve në metodologji: Informacion i rëndësishëm në lidhje me rishikimin e të dhënave mund të jetë ai në lidhje me politikat e ndjekura dhe masën e rishikimeve të mëparshme. Rishikimet bëhen për të pasqyruar përmirësime ose ndryshime që kanë të bëjnë me aspekte të ndryshme të metodologjisë statistikore si: konceptet e përkufizimet themelore; burimet e informacionit; metodat e vlerësimit. Politikat e rishikimit që i referohen këtyre ndryshimeve duhet të përcaktojnë edhe frekuencat e procedurat përkatëse që duhet të ndjekin këto rishikime e duhet të bëhen publike. Njoftimet për ndryshimet si më sipër mund të marrin forma të ndryshme që variojnë nga deklarata të shkurtra për shtyp deri te prezantime e materiale në formë publike. Anëtarët inkurajohen gjithashtu të sigurojnë informacion më të shpejtë për rishikimet pasi ato janë kryer (për shembull me telefon, faks ose internet nga një person kontakti që t'u përgjigjet pyetjeve në lidhje me rishikimet).	Statistikat e bilancit të pagesave janë përfundimtare në momentin kur ato publikohen. Megjithatë ato rishikohen në mënyrë të rregullt për shkak të ndryshimeve në lidhje me vlerësime paraprake, ndryshimeve në metodologji, shtimit të burimeve të reja të informacionit ose përmirësimeve të atyre ekzistuese. Tabelat e rishikuara publikohen, por jo dokumentacioni i revizionimeve përkatëse. Gjithashtu, nuk ekziston një politikë e mirëfilltë rishikimesh.	X

Cilësia e të dhënave		
Kërkesat e SDDS	Praktika jonë	
Publikimi i dokumentacionit mbi metodologjinë dhe burimet e përdorura për statistikat: Publikimi i dokumentacionit mbi metodologjinë dhe burimet e përdorura është çelësi për ndërgjegjësimin e përdoruesve për përparësitë a dobësitë e statistikave. Dokumentacioni i rekomanduar mund të marrë forma të ndryshme, duke përfshirë edhe shënime përmbledhëse që shoqërojnë publikimin e të dhënave, publikime të veçanta ose materiale të gatshme për t'u shpërndarë sipas kërkesës. Anëtarët inkurajohen të përfshijnë aty e të nënvizojnë deklarata mbi karakteristikat më të rëndësishme të cilësisë. Këto mund të bëjnë të qarta tipet e gabimeve subjekt i të cilave mund të jenë të dhënat, arsyet e moskrahasueshmërisë së të dhënave në kohë ose gabimet e zgjedhjes në rastet e vrojtimeve etj..	Bilanci i pagesave të Shqipërisë hartohet në bazë të "Metodologjisë së bilancit të pagesave", e cila mbështetet në standardet e "Manualit të Statistikave të Bilancit të Pagesave, FMN, Edicioni i Pestë". Ajo përmban detaje teknike të kompilimit të statistikave të bilancit të pagesave, konceptet e përkufizimet themelore të zërave të bilancit të pagesave si edhe burimet e informacionit që përdoren. Kjo metodologji përdoret gjerësisht nga Sektori i Bilancit të Pagesave dhe Vrojtimeve, por nuk ka marrë formë zyrtare e as nuk publikohet. Gjithashtu, mbeten akoma për t'u pasqyruar në të ndryshimet dhe përmirësimet e bëra në vite.	X
Publikimi i të dhënave të detajuara, pajtueshmëria me të dhëna të lidhura me to dhe prania e një kuadri statistikor të tillë që të mundësojë kontrollet statistikore e të sigurojë besueshmërinë dhe korrektësinë e të dhënave: Ky element rekomandon publikimin e detajuar të përbërësve, duke nënvizuar shpërndarjen brenda një kuadri statistikor, dhe/ose publikimin e krahasimit dhe pajtueshmërisë me të dhëna të tjera të lidhura me to. Detajimi i përbërësve duhet të jetë i tillë që të mos ketë konflikt me elementet e tjera si dhe besueshmërinë e konfidencialitetit të informacioneve individuale.	Në Buletinin Statistikor të Bilancit të Pagesave, dhe në seritë e agreguara të publikuara në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë, përfshihen të dhëna e seri kohore të detajuara për katër tremujorët e fundit dhe për të paktën 10 vitet e fundit.	√

I) KURSET E KËMBIMIT

Të dhënat: mbulimi, frekuenca dhe vonesat		
Kërkesat e SDDS	Praktika jonë	
Karakteristikat e mbulimit: SDDS kërkon shpërndarjen e kursit të këmbimit spot të monedhës kombëtare me monedhat kryesore të huaja. SDDS gjithashtu, kërkon shpërndarjen e kurseve me afat 3 dhe 6-mujor kur një treg i tillë ekziston.	Banka e Shqipërisë, banka qendrore e vendit, llogarit kursin zyrtar të këmbimit për 13 valuta kryesore, metale të cmuara dhe monedhën e Fondit Monetar Ndërkombëtar, SDR si dhe për 9 monedha të vendeve të Evropës Qendrore/Lindore dhe Azisë. Kurset e këmbimit llogariten si mesatare arithmetike e kuotimeve të 6 bankave të nivelit të dytë dhe 4 zyrave të këmbimit në orën 12.00. Kurset zyrtare të këmbimit përdoren për qëllime jotregtare dhe nuk janë detyruese për operatorët e tregut të këmbimeve valutore, ndërkohë që, Banka e Shqipërisë i kërkon bankave të nivelit të dytë përdorimin e tyre në vlerësimin e pozicioneve valutore. Ndër përdorimet kryesore të këtyre kurseve mund të përmendim vlerësimin e detyrimeve doganore nga administrata doganore, vlerësimi i bilanceve të kompanive nga organet tatimore si dhe vlerësimi i mjeteve valutore të vetë Bankës së Shqipërisë.	√
Frekuenca : Ditore.	Çdo ditë, kurset e këmbimit të 13 valutave kryesore ku përfshihen edhe ari, argjendi dhe sdr. Kurset e këmbimit të 9 monedhave të vendeve të Evropës Lindore e Qendrore llogariten një herë në dy javë.	√
Vonesa: Nuk percaktohet.	Në orën 12.00 dhe ka efekt për ditën në të cilën publikohet.	√
E drejta e përdorimit të të dhënave		
Kërkesat e SDDS	Praktika jonë	
Publikimi paraprak i kalendarit të botimeve: Të paktën një tremujor përpara, anëtarët pjesëmarrës duhet të deklarojnë ditën e publikimit ose një ditë të fundit para së cilës duhet të bëhet publikimi. Mund edhe të identifikohet një periudhë fillestare deri në 5 ditë pune, gjatë të cilave mund të kryhet publikimi.	Nuk ka.	X
Shpërndarje e njëkohshme e të gjitha palëve: Standardi rekomandon që të dhënat t'u shpërndahen njëkohësisht të gjitha palëve të interesuara. Në këtë rast, publikimi nuk i referohet ministrive apo agjencive qeveritare. Publikimi i njëkohshëm i referohet momentit të parë kur të dhënat janë të gatshme për të gjithë përdoruesit në çdo lloj formati (në letër, disketë, formë elektronike etj..)	Kursi i këmbimit pas llogaritjeve publikohet në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë dhe në faqen e Reuters (NBAL) të institucionit, duke u bërë i vlefshëm për të interesuarit në të njëjtën kohë.	√

II) TREGTIA E JASHTME

Integriteti i të dhënave		
Kërkesat e SDDS	Praktika jonë	
Publikimi i termave dhe i kushteve në të cilat prodhohen dhe shpërndahen statistikat, përfshirë mbrojtjen e informacionit individual: Termat dhe kushtet mund t'u referohen çështjeve si për shembull marrëdhëniet e njësisë statistikore me një departament ose ministri në të cilën ajo bën pjesë. Për shembull ato mund të kenë të bëjnë me varësinë (në aspektin buxhetor apo të burimeve njerëzore) e agjencisë që prodhon statistikat me një autoritet të jashtëm ose me pavarësinë në zgjedhjen e metodologjisë së statistikave dhe vendime për të publikuar rezultatet statistikore. Gjithashtu, termat dhe kushtet mund t'i referohen kërkesës ndaj agjencisë për të publikuar të dhënat që mblidhen si mbrojtje ndaj presionit politik për të fshehur rezultate të caktuara, dhe rishikimin e programeve statistikore nga grupe të pavaruara ekspertësh. Një tjetër çështje e kushteve në të cilat veprojnë agjencitë statistikore i referohet procedurave dhe proceseve të lidhura me konfidencialitetin e të dhënave individuale. Këto procedura mbulojnë çështje të ndryshme, që nga siguria e kompjuterave deri tek shkëmbimi i informacionit midis agjencive statistikore.	Publikimi i kursit zyrtar të këmbimit bëhet në bazë të ligjit nr. 8269 "Për Bankën e Shqipërisë", neni nr. 59 dhe neni nr. 60, i cili autorizon Bankën e Shqipërisë si institucioni përgjegjës për llogaritjen dhe publikimin e kursit zyrtar të këmbimit.	√
Identifikimi i të drejtës së përdorimit nga qeveria para publikimit të të dhënave: Në interes të mbrojtjes nga ndikimet nga autoritete jashtë agjencisë që publikon të dhënat, standardi rekomandon listimin e personave apo të zyrtarëve me pozicione të caktuara në qeveri, por jashtë agjencive të kompilimit të të dhënave, të cilët kanë të drejta mbi të dhënat statistikore para publikimit, si dhe raportimin e një kalendari të këtyre të drejtave. Kjo praktikë rekomandohet për t'i dhënë transparencë të plotë çdo të drejte përdorimi paraprak të qeverisë që gjykohet e nevojshme.	Njësitë qeveritare nuk kanë të drejta përdorimi paraprak në të dhënat që publikohen.	√
Identifikimi i komenteve (nga qeveria) për të dhënat statistikore: Duke qenë se qeveria mund të mos vlerësojë objektivisht të dhënat statistikore sidomos në ato raste kur ato lidhen drejtpërdrejt me përgjegjësitë e saj, standardi parashikon identifikimin e burimit të komenteve mbi të dhënat.	Nuk ka asnjë komentar që i bashkangjitet të dhënave të publikuara.	√

Publikimi i informacionit mbi rishikimet dhe njoftimi paraprak i ndryshimeve në metodologji: Informacion i rëndësishëm në lidhje me rishikimin e të dhënave mund të jetë ai në lidhje me politikat e ndjekura dhe masën e rishikimeve të mëparshme. Rishikimet bëhen për të pasqyruar përmirësime ose ndryshime që kanë të bëjnë me aspekte të ndryshme të metodologjisë statistikore si: konceptet e përkufizimet themelore; burimet e informacionit; metodat e vlerësimit. Politikat e rishikimit që i referohen këtyre ndryshimeve duhet të përcaktojnë edhe frekuencat e procedurat përkatëse që duhet të ndjekin këto rishikime. Politikat e rishikimit duhet të bëhen publike. Njoftimet për ndryshimet si më sipër mund të marrin forma të ndryshme që variojnë nga deklarata të shkurtra për shtyp deri tek prezantime e materiale në formë publike. Anëtarët inkurajohen gjithashtu, të sigurojnë informacion më të shpejtë për rishikimet pasi ato janë kryer (për shembull me telefon, faks ose internet nga një person kontakti që t'u pergjigjet pyetjeve në lidhje me rishikimet).	Të dhënat e publikuara janë përfundimtare dhe nuk janë objekt i rishikimit.	√
Cilësia e të dhënave		
Kërkesat e SDDS	Praktika jonë	
Publikimi i dokumentacionit mbi metodologjinë dhe burimet e përdorura për statistikat: Publikimi i dokumentacionit mbi metodologjinë dhe burimet e përdorura është celësi për ndërgjegjësimin e përdoruesve për përparësitë a dobësitë e statistikave. Dokumentacioni i rekomanduar mund të marrë forma të ndryshme, duke përfshirë edhe shënime përmbledhëse që shoqërojnë publikimin e të dhënave, publikime të veçanta ose materiale të gatshme për t'u shpërndarë sipas kërkesës. Anëtarët inkurajohen të përfshijnë aty e të nënvizojnë deklarata mbi karakteristikat më të rëndësishme të cilësisë. Këto mund të bëjnë të qarta tipet e gabimeve subjekt i të cilave mund të jenë të dhënat, arsyet e moskrahasueshmërisë së të dhënave në kohë ose gabimet e zgjedhjes në rastet e vrojtimeve etj..	Procedura e përllogaritjes së kursit zyrtar të këmbimit është publike në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë nën rubrikën kurset.	√

Publikimi të dhënave të detajuara, pajtueshmëria me të dhëna të lidhura me to dhe dhe prania e një kuadri statistikor të tillë që të mundësojë kontrollet statistikore e të sigurojë besueshmërinë dhe korrektësinë e të dhënave: Ky element rekomandon publikimin e datajuar të përbërësve, duke nënvizuar shpërndarjen brenda një kuadri statistikor dhe/ose publikimin e krahasimit dhe të pajtueshmërisë me të dhëna të tjera të lidhura me to. Detajimi i përbërësve duhet të jetë i tillë që të mos ketë konflikt me elementet e tjera si dhe besueshmërinë e konfidencialitetit të informacioneve individuale.	Seria e kurseve ditore të këmbimit ka qenë e pranishme në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë dhe me rikonfigurimin e kësaj faqeje ka lindur nevoja e rihedhjes së tyre. Çdo person i interesuar mund të përfitojë shpejt dhe pa kosto kursin e këmbimit të çdo dite nëpërmjet një kërkese të dërguar në adresën e postës elektronike: public@bankofalbania.org. Të dhënat mesatare mujore të kursit të këmbimit publikohen në Raportin Mujor Statistikor të Bankës së Shqipërisë. Seria e kurseve mesatare të këmbimit publikohet në "Raportin Mujor Statistikor " dhe në "Buletinin Ekonomik".	√

SHËNIME

* Materiali u punua nga: Kliti Ceca, Zëvendësdrejtor, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikës, Edmond Thanati, Zëvendësdrejtor, Departamenti i Operacioneve Monetare, Hilda Shijaku, Kryespecialiste, Sektori i Statistikave Monetare dhe Financiare dhe Endrita Xhaferaj specialiste në Sektorin e Statistikave të Bilancit të Pagesave dhe Vrojtimeve. Falenderojmë për bashkëpunimin Zj. Yin-Fun LUM Senior Economist në Divizionin e Standardeve të Shpërndarjes së të Dhënave, Departamenti i Statistikës, FMN.
Artikujt e paraqitur në këtë botim, nuk shprehin gjithmonë opinionin zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

[1] Shpërndarja e të dhënave në kuptimin me të cilin do të përdoret në këtë material, përfshin të gjithë zinxhirin e veprimeve nga mbledhja e të dhënave në burim deri tek vënia e tyre në dispozicion të publikut jashtë agjencisë që prodhon të dhënat.

[2] Allum dhe Agca (2001) tregojnë për një "efekt pozitiv të tranzicionit" në vlerësimin e shpërndarjes së të dhënave. Kjo gjë tregon për angazhimin serioz të autoriteteve për rritjen e cilësisë së shpërndarjes së të dhënave, gjë që lidhet me interesin e tyre për pjesëmarrjen në tregjet financiare ndërkombëtare.

[3] "Fifth Review of the Fund's Data Standards Initiatives", faqe 9.

[4] Gjithsej GDDS përfshin 83 vende anëtare. Prej tyre, vendet që tashmë janë anëtarësuar në SDDS janë Kazakistani, Kyrgyzstani, Armenia, Bullgaria dhe Rumania.

[5] Misioni ROSC ka vizituar Shqipërinë gjithsej dy herë, në maj të vitit 2000 për shpërndarjen e të dhënave dhe në korrik të vitit 2003 për transparencën fiskale. Për më shumë informacion shiko http://www.imf.org/external/np/rosc/rosc.asp.

[6] Me termin "vonesë" në këtë material do të kuptojmë periudhën kohore nga data e referencës së treguesit statistikor deri në publikimin e tij.

[7] Këtu bëhet fjalë për mediat dhe përdoruesit privatë dhe jo për njësitë qeveritare.

[8] IMF (1996), Guide to the data dissemination standards, faqe 39.

[9] Këtu bëhet fjalë për njësi qeveritare jashtë agjencisë që prodhon të dhënat.

[10] Manual on monetary and financial statistics, IMF (2000).

[11] Guide to the Data Dissemination Standards, Module 1: The Special Data Dissemination Standard, May 1996.

[12] Balance of Payments Manual, fifth edition, 1993.

[13] Sistem klasifikimi i grupmallrave sipas manualit të statistikave të tregtisë ndërkombëtare "International merchandise trade statistics: concepts and definitions", United Nations, 1998.

REFERENCA

Allum, P. Agca, M., (2001), Economic Data Dissemination: What Influences Country Performance On Frequency and Timiliness? Middle Eastern Department, IMF Working Paper No. 01/173.

Banka e Shqipërisë (2000), Rregullore "Mbi transparencën dhe konfidencialitetin në Bankën e Shqipërisë", miratuar me vendim nr. 53, datë 21.06.2000, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë (2001), Rregullore "Për instrumentet indirekte të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë", miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 08, datë 07.02.2001.

Banka e Shqipërisë (2003), Metodika e Statistikave Monetare dhe Financiare, Korrik 2003.

Banka e Shqipërisë (2003), Udhëzim "Mbi mënyrën e llogaritjes së "fiksit" të kursit të këmbimit të lekut, në Bankën e Shqipërisë", miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës, nr.36, datë 30.04.2003.

Banka e Shqipërisë (2004), Vlerësimi i Standardeve të Shpërndarjes së Statistikave në Bankën e Shqipërisë.

IMF (1993), Balance of Payments Manual, fifth edition, International Monetary Fund.

IMF (1995), Balance of Payments Compilation Guide, International Monetary Fund.

IMF (1996), Guide to the data dissemination standards, Module 1: The SDDS –Provisional, International Monetary Fund.

IMF (1998), Guide to the General Data Dissemination System, International Monetary Fund.

IMF (1998), The Special Data Dissemination Standards (Updated Guidance), International Monetary Fund.

IMF (2000), Manual on monetary and financial statistics, International Monetary Fund.

IMF Statistics Department (2003), Data Quality Assessment Framework (DQAF) for Monetary Statistics, International Monetary Fund.

IMF Statistics Department (2003), Fifth Review of the Fund's Data Standards Initiatives, International Monetary Fund.

IMF Statistics Department and the Policy Development and Review Department, (1996), Standards for the Dissemination of Economic and Financial Statistics to the Public by Member Countries: Progress Report and Implementation of the Special Data Dissemination Standards, International Monetary Fund.

IMF Statistics Department and the Policy Development and Review Department, (1998), Second Review of the Fund's Data Standards'

Initiatives, International Monetary Fund.
IMF Statistics Department and the Policy Development and Review Department, (2000), Third Review of the Fund's Data Standards' Initiatives, International Monetary Fund.
IMF Statistics Department and the Policy Development and Review Department, (2001), Fourth Review of the Fund's Data Standards' Initiatives, International Monetary Fund.
Kester, A. (2001) International Reserves and Foreign Currency Liquidity – Guidelines for a data template, International Monetary Fund.
Kuvendi Popullor (1997), Ligji "Për bankat në republikën e Shqipërisë" nr. 8365, datë 02.07.1998.
Kuvendi Popullor (1997), Ligji "Për Bankën e Shqipërisë" nr. 8296, datë 23.12.1997.
Marrëveshja midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave "Mbi emetimin e bonove të thesarit në formë regjistrimi", datë 08. 07. 2002.
Marrëveshja midis Bankës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë "Mbi emetimin e obligacioneve afatgjata të qeverisë në formë regjistrimi" datë 25.09.2002.
United Nations (1998), International merchandise trade statistics: concepts and definitions, United Nations.

NJË VËSHTRIM ANALIZUES I SERIVE KOHORE TË DEPOZITAVE, KREDIVE DHE MJETEVE VALUTORE NETO TË BANKËS SË SHQIPËRISË

*Refika Fejzo**

Fjalë kyçe
- Seri kohore - Tregues monetarë - Depozita - Kredi - Mjete valutore neto -

HYRJE

Ky material ka për qëllim të informojë përdoruesit e serive kohore të disa prej treguesve monetarë mbi disa veçori të tyre, si metodologjia e llogaritjes dhe ndryshimet metodologjike në kohë, riklasifikimet, përdorimi i instrumenteve të reja, ngjarjet e veçanta që kanë ndikuar ecurinë e tyre etj.. Materiali trajton treguesit e depozitave të rezidentëve, treguesit e kredisë për ekonominë dhe mjetet valutore neto të Bankës së Shqipërisë, si disa prej treguesve më të përdorshëm për politikëbërësit e Bankës së Shqipërisë dhe kërkuesit shkencorë të brendshëm e të jashtëm.

Duke qenë se një analizë e plotë e këtyre treguesve shkon përtej qëllimeve të këtij materiali, informacioni i dhënë është mbështetur kryesisht në analizën e tabelave dhe grafikëve të serive kohore. Gjithashtu, janë konsultuar Raportet Vjetore të Bankës së Shqipërisë, analiza dhe vrojtime të kryera nga Departamenti i Politikës Monetare, Departamenti i Kërkimeve, Departamenti i Mbikëqyrjes, si dhe analiza të tjera të kryera nga specialistë të Bankës së Shqipërisë. Për secilin nga treguesit është përshkruar metodologjia e llogaritjes dhe tendenca e tij, dhe më pas janë evidentuar dhe shpjeguar "këputjet". Si të tilla janë marrë

ndryshimet e dukshme në nivelin e treguesve brenda një ose dy periudhave kohore, ndryshimet metodologjike dhe riklasifikimet për të cilat specialistët e statistikave kanë informacion, që mund të jenë më pak të dallueshme për të dhënat e agreguara.

Si burim të dhënash janë përdorur kryesisht të dhënat e publikuara në bazën e të dhënave "Seri kohore" që publikohet në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë. Në rastet kur të dhënat e treguesit nuk gjenden të publikuara në këtë bazë të dhënash, janë përdorur të dhënat e botuara në raportet statistikore dhe raportet vjetore të Bankës së Shqipërisë. Në çdo rast që të dhënat nuk janë marrë në bazën e të dhënave "Seri kohore", është cituar burimi përkatës. Periudha e marrë në shqyrtim është periudha dhjetor 1992 – qershor 2005. Në rastet që nuk ka qenë e mundur të sigurohen të dhënat përkatëse, është analizuar periudha për të cilën ekzistojnë të dhëna të publikuara.

1. DEPOZITAT DHE PESHA E TYRE NË AGREGATËT MONETARË

1.1. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I ECURISË SË DEPOZITAVE GJATË PERIUDHËS DHJETOR 1992 – QERSHOR 2005.

Gjatë dekadës së kaluar struktura e depozitave të sistemit bankar ka pësuar ndryshime të rëndësishme, të cilat përgjithësisht kanë qenë funksion i zhvillimit ekonomik të vendit, por edhe i dukurive dhe zhvillimit të vetë sistemit bankar. Prirja e përgjithshme e depozitave të sistemit ka qenë pozitive dhe grafikët e tabelat e serive kohore tregojnë për tendencën në rritje të tyre. Megjithatë, brishtësia dhe problemet e dekadës së parë të krijimit të një sistemi bankar janë pasqyruar në kriza dhe probleme të strukturës dhe të nivelit të depozitave të sistemit bankar.

Në vitet 1993 – 1995, ekonomia shqiptare sapo kishte hyrë në ekonominë e lirë prandaj edhe pjesën më të madhe në totalin e depozitave e përbënin depozitat e sektorit publik.

Proceset e privatizimit bënë që tendenca e përgjithshme të ishte rritja e nivelit të depozitave të sektorit privat dhe të individëve (përkatësisht rreth 68 për qind, 62 për qind dhe 50 për qind), duke zvogëluar peshën e depozitave të sektorit publik. Kontributin kryesor në rritjen e nivelit të përgjithshëm të depozitave e kanë dhënë depozitat me afat të individëve, kjo për shkak të mungesës së alternativave të investimit si edhe të rritjes së normës reale të interesit dhe të stabilitetit të lekut në tregun e brendshëm[1].

Gjatë viteve 1993 – 1995, depozitat me afat në lekë përbënin mesatarisht 27.5 për qind të parasë gjithsej, ndërkohë që 37 për qind e zinte paraja jashtë bankave, 16 për qind depozitat pa afat në lekë dhe 19.5 për qind depozitat në valutë (grafiku 1). Shtimi i numrit të firmave të vogla e të mesme tregtare apo prodhuese, përdorimi relativisht i ulët i shërbimeve bankare, si dhe ndërgjegjësimi i publikut për rënien e inflacionit, bënë që paraja jashtë bankave të ishte përbërësi kryesor i parasë gjithsej. Ndikim negativ ka patur edhe një sistem pagesash dhe shërbimesh bankare akoma joefektiv.

Grafik 1. Përbërësit e parasë gjithsej (në përqindje).
Periudha: dhjetor 1993 – qershor 2005.



Viti 1996 shënon një ndryshim në peshën e përbërësve të parasë gjithsej dhe në ritmin e rritjes së këtyre përbërësve. Lindja dhe zhvillimi i skemave piramidale, shkaktuan ulje në ritmin e rritjes së parasë jashtë bankave dhe të depozitave me afat në favor të ritmit të rritjes së depozitave pa afat, duke qenë se publiku nisi të tërhiqte paratë nga depozitat me afat dhe skemat

i vendosnin ato në depozita pa afat në banka. Kjo gjë u bë akoma më e dukshme sidomos gjatë muajve tetor – nëntor kur aktiviteti i firmave piramidale arriti kulmin e vet. Në periudhën shtator – dhjetor paraja gjithsej u ul mesatarisht 7 për qind, depozitat me afat në lekë u ulën 14 për qind, ndërkohë që depozitat pa afat në lekë u rritën me 104 për qind. Ky ndryshim në strukturën e depozitave të sistemit bankar uli kostot për bankat, por nga ana tjetër krijoi problemin e administrimit të likuiditetit. Duke patur si burim kryesor depozitat pa afat, bankat nuk mund të investonin në instrumente afatgjata.

Rënia e firmave piramidale në vitin 1997 dëmtoi rëndë besimin e publikut në sistemin bankar. Kjo u shoqërua me ulje të konsiderueshme të depozitave në favor të parasë jashtë bankave, gjë që shkaktoi probleme likuiditeti në sistemin bankar. Për të ndalur rrjedhjen e depozitave nga sistemi bankar u rritën normat e interesit. Kështu për shembull, normat e interesit për depozitat tremujore u rritën nga 27 për qind që ishin në mars të vitit 1997 në 37 për qind, në korrik të po këtij viti.

Rritja pozitive e normave të interesit dhe masat e tjera që u morën për të rritur besimin e publikut në sistemin bankar, bënë që në gjysmën e dytë të vitit 1997 dhe duke vazhduar në vitin 1998 të rriten në mënyrë pozitive depozitat (akoma më shumë ato me afat në lekë) si dhe të ulet ndjeshëm paraja jashtë bankave (grafiku 1).

Kriza kosovare në vitin 1999 shkaktoi rritje të parasë jashtë bankave dhe të depozitave në valutë. Kjo, sepse hyrjet nga organizatat joqeveritare dhe humanitare në ndihmë të qytetarëve kosovarë të vendosur në vendin tonë, ishin kryesisht në valutë[2].

Edhe gjatë viteve 2000 – 2001 kontributin kryesor në rritjen e parasë githsej e kanë dhënë depozitat në valutë dhe paraja jashtë bankave. Gjatë vitit 2000, depozitat në lekë pësuan rënie në vëllim ose në ritmin e rritjes si pasojë e uljes së normave të interesit të depozitave. Interesi mesatar i ponderuar i depozitave me afat tremujor për sistemin bankar, u reduktua nga 9.5 për qind (në dhjetor 1999) në 6.9 për qind në fund të vitit 2001.

Pas tetorit të vitit 2000, niveli i interesave të depozitave me afat në lekë nuk u përcaktua më administrativisht nga Banka e Shqipërisë. Si referencë për normat e interesave të tregut u përcaktua norma e interesit të marrëveshjeve të riblerjes.

Pikërisht kur vlerësohej se situata financiare e sistemit bankar ishte më e mira e dhjetë viteve të fundit, një krizë tjetër goditi sistemin bankar. Në muajt mars – prill 2002, sistemi bankar u karakterizua nga një tërheqje masive në depozitat me afat të individëve, kryesisht në dy bankat më të mëdha të vendit Banka e Kursimeve (sot Raiffeisen) dhe Banka Kombëtare Tregtare, si pasojë e së cilës brenda dy muajve u tërhoqën afërsisht 21.4 miliardë lekë nga sistemi bankar. Fillimi i procedurave të privatizimit të Bankës së Kursimeve, problemet financiare të pronarit të Bankës Kombëtare Tregtare, keqinterpretimi i ligjit lidhur me sigurimin e depozitave etj., shkaktuan tronditje të besimit të publikut në sistemin bankar[3]. Tërheqjet e depozitave sollën probleme likuiditeti për bankat e nivelit të dytë. Në përgjigje të situatës së krijuar, Banka e Shqipërisë e ndryshoi kursin e politikës monetare dhe injektoi likuiditet në treg.

Gjysma e dytë e vitit 2002 dhe viti 2003 u karakterizuan nga kthimi i parasë në sistem. Ky kthim uli nivelin e parasë jashtë bankave (me rreth 5.6 miliardë lekë ose 4.3 për qind në dhjetor 2003) dhe raportin e saj ndaj ofertës monetare. Paraja u rikthye në sistem në formën e depozitave me afat në lekë. Diferenca e normave të interesit ndërmjet atyre në lekë dhe atyre në valutë si dhe mbiçmimi i lekut, bënë që depozitat me afat në lekë të ishin më të preferuara nga individët. E njëjta prirje vazhdoi edhe gjatë vitit 2004.

Paraja gjithsej ka vazhduar të rritet me ritme edhe më të larta në gjashtëmujorin e parë të vitit 2005. Në muajin qershor të vitit 2005 paraja gjithsej u rrit me një normë vjetore 18.3 për qind krahasuar me 13.1 për qind që ishte rritja vjetore në dhjetor 2004. Rritja e parasë gjithsej në këtë periudhë erdhi kryesisht nga rritja e depozitave valutore. Norma e rritjes vjetore të tyre, në qershor të vitit 2005 ishte 30.2 për qind, krahasuar me 17.1 për qind që ishte në dhjetor të vitit 2004. Gjatë kësaj

periudhe, ndërsa u rrit pesha e depozitave në valutë, u ul pesha që zinte paraja jashtë bankave në paranë gjithsej. Në uljen e parasë jashtë bankave ndikoi rritja e besimit të publikut ndaj sistemit bankar (kjo u shpreh në rritjen e investimeve të individëve në banka si depozita me afat në lekë dhe në valutë) si edhe rritja e efikasitetit të sistemit të pagesave[4]. Në rritjen e depozitave në valutë kanë ndikuar edhe nënçmimi i kursit të këmbimit të lekut ndaj dollarit amerikan, gjatë periudhës janar – qershor 2005, dhe normat më të favorshme të interesit në dollarë amerikanë.

1.2. PROBLEMATIKA NË LIDHJE ME SERITË KOHORE TË DEPOZITAVE SIPAS STRUKTURËS NË BAZËN E TË DHËNAVE "SERI KOHORE".

1.2.1. Depozitat pa afat në lekë të rezidentëve.

Treguesit:

Depozitat pa afat në lekë të rezidentëve
- Autoritetet vendore[5]
- Ndërmarrjet jofinanciare publike
- Institucionet e tjera financiare
- Sektori privat
- Individët

Depozitat pa afat në lekë përfaqësojnë llogaritë rrjedhëse dhe depozitat pa afat në lekë të vendosura nga autoritetet vendore, ndërmarrjet jofinanciare publike, institucionet e tjera financiare, sektori privat dhe individët, në bankat që pranojnë depozita dhe në Bankën e Shqipërisë.

Duke përjashtuar paranë jashtë bankave, depozitat pa afat në lekë janë instrumenti më likuid i parasë gjithsej. Së bashku me paranë jashtë bankave depozitat pa afat në lekë formojnë paranë e ngushtë ose agregatin M1.



Në treguesin depozita pa afat në lekë janë përfshirë:

Llogaritë rrjedhëse në lekë, të cilat përfshijnë llogaritë në lekë që janë të këmbyeshme me kërkesë, në vlerë nominale, pa asnjë penalitet apo kufizim, të transferueshme lirisht me çek, urdhërpagesë, të përdorura gjerësisht si mjete pagese.

Llogari depozitash pa afat në lekë të cilat janë të këmbyeshme me kërkesë, në vlerë nominale, pa asnjë kufizim apo penalitet, por që nuk mund të përdoren si mjete pagese.

Në treguesin depozita pa afat në lekë janë përfshirë gjithashtu, edhe depozitat e garancive në lekë dhe depozitat e bllokuara në lekë (si për shembull depozitat për mbulimin e çeqeve, për mbulimin e letërkredive etj.,) të cilat kanë kufizime përsa i përket likuiditetit dhe transferueshmërisë së tyre. Bazuar në metodologjinë e re të statistikave monetare, këto llogari nuk duhet të përfshihen në agregatin e parasë së ngushtë.

Prirja e përgjithshme e nivelit të depozitave pa afat në lekë ka qenë rritëse, por me luhatje të shpeshta. Meqënëse depozitat pa afat në lekë janë mjete me likuiditet të lartë që përdoren për transaksione, kërcimet e mëdha në vlerën e tyre në një moment të caktuar nuk tregojnë domosdoshmërisht rënie apo rritje të preferencës së agjentëve ekonomikë për këto instrumente.

Grafiku 3, që pasqyron raportin e depozitave pa afat në lekë (DD[6]) ndaj parasë së ngushtë (M1), ka një prirje rënëse për periudhën dhjetor 1993 – dhjetor 2003, gjë që tregon se në këtë periudhë në ekonominë shqiptare kanë mbizotëruar transaksionet në *cash*.

Grafik 3. Raporti DD/ M1 (në përqindje).
Periudha: dhjetor 1993 – qershor 2005.



Gjatë vitit 2004 dhe fillimit të vitit 2005 vihet re një prirje rritëse e raportit DD/M1, e cila tregon për arritje pozitive në lidhje me efikasitetin e shërbimeve bankare si dhe në marrëdhënien e bizneseve e individëve me bankat. Përpjekjet e bëra për të luftuar ekonominë *cash*, si për shembull nëpërmjet programit "Përtej Parasë"[7] kanë dhënë rezultate pozitive.

Problematika dhe shpjegimet

Korrik 1996 – dhjetor 1996: Rriten depozitat pa afat në lekë.

Është periudha në të cilën depozitat pa afat në lekë pësuan rritjen më të madhe. Kjo është periudha gjatë së cilës skemat piramidale ishin në kulmin e zhvillimit të tyre dhe firmat, të cilat mblidhnin paratë e publikut, i investonin ato në banka si depozita pa afat në lekë.

Janar 1997 – dhjetor 1997: Rënie e depozitave pa afat në lekë nga muaji në muaj.

Në këtë periudhë, depozitat pa afat në lekë janë zvogëluar nga muaji në muaj. Firmat piramidale falimentuan dhe nuk investonin më në depozita pa afat.

Në muajin janar 1997 depozitat pa afat në lekë u zvogëluan 40 për qind, krahasuar me muajin dhjetor 1996. Fondet e firmave piramidale të investuara si depozita pa afat në lekë në Bankën Kombëtare Tregtare u bllokuan dhe u klasifikuan si depozita me afat në lekë të sektorit privat. Në muajin shkurt fondet e bllokuara nga firmat piramidale u kaluan në Bankën e Kursimeve dhe u riklasifikuan nga kjo bankë përsëri si depozita pa afat në lekë të sektorit privat.

Qershor 2003: Riklasifikim i depozitave pa afat.

Në qershor 2003 depozitat pa afat të sektorit privat janë ulur 27 për qind (afërsisht 4 miliardë lekë në vlerë absolute) me bazë mujore. Në këtë muaj, Banka e Kursimeve bazuar mbi sugjerimet e auditorëve të saj ka riklasifikuar një pjesë të depozitave të bllokuara të firmave piramidale si depozita me afat të sektorit publik.

Dhjetor 2004: Rritje e depozitave pa afat.

Shkak për rritjen e depozitave pa afat në dhjetor 2004 ishte klasifikimi i depozitave me afat të maturuara të një banke, në pritje të rinovimit të kontratës si depozita pa afat. Është për t'u theksuar se një zhvendosje e tillë e depozitave me afat në depozita pa afat nuk përbën një ndryshim themelor, por vetëm një riklasifikim të përkohshëm.

1.2.2. Depozitat me afat në lekë të rezidentëve

Treguesit:

Depozitat me afat të rezidentëve në lekë
- Autoritetet vendore
- Ndërmarrjet jofinanciare publike
- Institucionet e tjera financiare

- Sektori privat
- Individët



Depozitat me afat në lekë përfaqësojnë depozitat me afat të mbajtura në lekë nga autoritetet vendore, ndërmarrjet jofinanciare publike, institucionet e tjera financiare, sektori privat dhe individët, në bankat që pranojnë depozita dhe në Bankën e Shqipërisë.

Në depozitat me afat përfshihen depozitat, të cilat mund të tërhiqen vetëm pas një periudhe të caktuar kohe dhe që mund të kenë kufizime që i bëjnë ato më të përshtashme për kursim sesa për transaksione tregtare. Gjithashtu, në treguesin depozita me afat përfshihen edhe çertifikatat e depozitave, të cilat përfaqësojnë një formë të caktuar të depozitave me afat.

Depozitat me afat kanë pasur një prirje rritëse (grafiku 4). Kjo ka qenë rezultat i stabilitetit të lekut në tregun e brendshëm, i normave reale pozitive të interesit si dhe i rritjes së besimit të publikut në sistemin bankar.

Pjesa më e madhe e depozitave me afat në lekë janë depozita të individëve, të cilët nuk kanë shumë alternativa për të investuar kursimet e tyre.

Problematika dhe shpjegimet

Maj 1996 – dhjetor 1996: Zvogëlim në nivelin e depozitave me afat të individëve.

Gjatë kësaj periudhe nga muaji në muaj ka pasur një ulje të nivelit të depozitave me afat të individëve. Kjo është periudha e zhvillimit të skemave piramidale, që thithnin paratë e individëve. Individët tërhiqnin depozitat nga bankat për t'i investuar fondet në këto firma. Në këtë periudhë, janë rritur depozitat me afat në lekë të sektorit privat.

Janar 1997: Ka një kërcim në totalin e depozitave me afat në lekë prej 43 për qind në bazë mujore.

Totali i depozitave me afat në lekë është ndikuar nga rritja prej 432 për qind në bazë mujore e depozitave me afat në lekë të sektorit privat. Kjo këputje në serinë e depozitave me afat në lekë të sektorit privat, ka qenë pasojë e riklasifikimit të përkohshëm të depozitave pa afat të firmave që falimentuan, e shpjeguar në paragrafët më sipër. Në muajin shkurt, këto depozita u riklasifikuan si depozita pa afat.

Mars – prill 2002: Ka një kërcim negativ të nivelit të depozitave me afat në lekë.

Kjo periudhë përkon me tronditjen e besimit të publikut në sistemin bankar. Individët u drejtuan pranë sporteleve të bankave (kryesisht në Bankën e Kursimeve dhe në Bankën Kombëtare Tregtare) dhe tërhoqën depozitat e tyre. Për 2 muaj u tërhoqën afërsisht 21.4 miliardë lekë nga sistemi bankar.

Qershor 2003: Ka një kërcim në nivelin e depozitave me afat në lekë të sektorit publik.

Në qershor 2003 depozitat me afat të sektorit publik janë rritur afërsisht 400 për qind. Kjo këputje në serinë e depozitave me afat të sektorit publik ka qenë pasojë e riklasifikimit të fondeve të firmave piramidale të shpjeguar më sipër.

Shkurt – mars 2005: Ka pasur riklasifikim të depozitave me afat në lekë të sektorit publik.

Gjatë këtyre dy muajve ka pasur një rënie prej afërsisht 4 miliardë lekë të depozitave me afat të sektorit publik. Fondet e skemave piramidale të klasifikuara si depozita me afat të sektorit publik, u riklasifikuan si llogari rrjedhëse të individëve me qëllim shpërndarjen e mëtejshme të tyre te kreditorët.

1.2.3. Depozitat në valutë të rezidentëve

Treguesit:

Depozitat në valutë të rezidentëve
- Autoritetet vendore.
- Ndërmarrjet jofinanciare publike.
- Institucionet e tjera financiare.
- Sektori privat.
- Individët.

Depozitat në valutë përfaqësojnë llogaritë rrjedhëse, depozitat pa afat, depozitat me afat, çertifikatat e depozitave dhe depozitat e bllokuara dhe të garancive të mbajtura në valuta të huaja nga autoritetet vendore, ndërmarrjet jofinanciare publike, institucionet e tjera financiare, sektori privat dhe individët, në bankat që pranojnë depozita dhe në Bankën e Shqipërisë.

Grafik 5. Depozitat në valutë të rezidentëve (në milionë lekë).
Periudha: dhjetor 1992 – qershor 2005.



Depozitat në valutë kanë pasur një prirje rritëse gjatë periudhës. Depozitat në valutë janë lloji i depozitave, të cilat kanë pasur më pak kërcime vlere krahasuar me depozitat në lekë. Kështu për shembull, momenti i krizës së sistemit bankar në vitin 1997 ka pasur një ndikim më të vogël në totalin e depozitave në valutë të individëve në krahasim me luhatjet që kanë pasur depozitat në lekë të individëve, duke shprehur në këtë mënyrë përveç të tjerash, një besim më të madh të publikut në monedhën e huaj në krahasim me lekun. Edhe grafiku 1, i cili paraqet përbërësit e parasë gjithsej, tregon se pesha e depozitave në valutë në paranë e gjerë paraqet prirjen më të qëndrueshme në krahasim me përbërësit e tjerë të parasë gjithsej.

Pas vitit 1996, depozitat e individëve përbëjnë pjesën më të madhe të depozitave në valutë. Remitancat nga emigrantët kanë qenë burimi kryesor i depozitave në valutë[8].

Problematika dhe shpjegimet

Qershor 1996 – dhjetor 1996: Rritje e depozitave në valutë të sektorit privat.

Gjatë periudhës qershor 1996 – dhjetor 1996 depozitat në valutë u rritën afërsisht 280 për qind. Kjo rritje i dedikohet investimit të valutës së huaj, të mbledhur nga firmat piramidale në depozita pa afat në valutë në banka.

Janar 1999 – qershor 1999: Rritje e depozitave pa afat në valutë.

Viti 1999 i cili përkon me periudhën e krizës në Kosovë, është karakterizuar nga prirja e qëndrueshme në rritjen e depozitave në valutë. Më e madhe kjo rritje ka qenë në gjashtëmujorin e parë të vitit. Hyrjet kryesore ishin depozita pa afat në valutë (llogari rrjedhëse të organizatave joqeveritare, ndihma për të ardhurit nga Kosova etj.).

Mars 2002 – prill 2002: Ka një kërcim negativ të nivelit të depozitave në valutë.

Tronditja e besimit të publikut në sistemin bankar gjatë muajve mars 2002 – prill 2002, ndikoi edhe në nivelin e depozitave në valutë. Rënia në këta tregues erdhi kryesisht si pasojë e rënies së depozitave në valutë të individëve.

2. KREDIA PËR EKONOMINË

2.1 PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I ECURISË SË KREDISË

Kredia është një instrument i rëndësishëm në përkrahjen e zhvillimit të një vendi. Ai mbështet investimet e reja prodhuese në ekonomi duke ndikuar në rritjen e aktivitetit të prodhimit, të tregtisë, të shërbimeve etj..

Gjatë dymbëdhjetë viteve të fundit aktiviteti i kredisë në vendin tonë është vlerësuar se mbart shumë rreziqe si ai i kredive të pakthyera, i rendit dhe i sigurisë në vend etj.. Kjo ka bërë që për një kohë të gjatë bankat të tregohen të kujdesshme në dhënien e kredive. Kjo gjë mund të shihet edhe në grafikun 6, i cili paraqet ecurinë e totalit të kredisë për ekonominë si edhe kredinë dhënë sektorit shtetëror dhe atij privat. Megjithëse prirja e përgjithshme e kredisë gjatë viteve ka qenë gjithmonë rritëse, deri në vitin 1999 ajo është rritur me një ritëm tepër të ulët.

Grafik 6. Kredia për ekonominë sipas sektorëve (në milionë lekë).
Periudha: dhjetor 1992 – qershor 2005[7].



Vitet 1992 – 1996 ishin vitet e para të daljes nga sistemi socialist. Në këtë periudhë bankat, për shkak të ekspertizës së pakët në biznesin bankar, nuk arritën të aplikojnë me rigorozitet kushtet e dhënies së kredive. Kjo bëri që të rritej shumë numri i kredive me probleme[10]. Për të ulur numrin e madh të kredive me probleme, Banka e Shqipërisë ka përdorur një politikë të shtrënguar rifinancimi duke përdorur kufirin e kredisë si instrument kryesor të politikës monetare. Gjithashtu edhe bankave me kapital tërësisht shtetëror iu ishte ndaluar që të jepnin kredi. Në nëntor të vitit 1999 Banka e Shqipërisë vendosi që të heqë kufirin e kredisë gjë që ndikoi që në vitet në vazhdim kredia të rritet me një shpejtësi më të madhe. Kështu, vetëm në vitin 2000 kredia u rrit afërsisht 3 herë në krahasim me vitin 1999.

Nga një vrojtim[11] i bërë në vitin 2000 ka rezultuar se në kreditimin e ulët të biznesit shqiptar, përveç kufizimit të ofertës së kredisë nga ana e bankave, ka ndikuar dhe fakti që vetë bizneset kanë ngurruar që të drejtohen në sistemin bankar për të plotësuar nevojat e tyre për kapital. Kredia bankare u vlerësua të përdorej në nivel mjaft të ulët nga vetëm 10.5 për qind e bizneseve. Për këtë ndikonin normat e larta të interesave të kredive si edhe mungesa e traditës dhe e kulturës në marrëdhënien bankë – biznes.

Për të rritur kredinë Banka e Shqipërisë ka ndjekur një politikë lehtësuese, duke ulur herë pas here normën bazë të interesit. Në fillim të vitit 2005 kjo normë është ulur në 5 për qind, ndërsa në dhjetor 1999, që ishte edhe momenti i parë që u hoq kufiri i kredisë, kjo normë ishte 18.5 për qind.

Për sa i përket sektorëve të mbështetur me kredi (grafiku 6), gjatë gjithë kësaj periudhe, mesatarisht 95 për qind e kredisë është dhënë për sektorin privat (70 për qind për ndërmarrjet dhe 25 për qind për individët) dhe vetëm 5 për qind e kredisë është dhënë për sektorin publik. Kredia për sektorin publik ka një prirje negative dhe ka ardhur duke u zhdukur pothuajse fare nga bilancet e bankave. Kjo mund të kuptohet edhe me faktin se nëpërmjet kredisë për sektorin privat është mbështetur privatizimi i ndërmarrjeve shtetërore, gjë që ka sjellë si rezultat

zvogëlimin e numrit të ndërmarrjeve shtetërore si dhe të kredisë së akorduar atyre.

Pjesa më e madhe e kredisë dhënë nga sistemi bankar shqiptar është kredi në valutë. Si edhe për depozitat, niveli i kreditimit është karakterizuar nga mbizotërimi i një ose dy bankave në treg, si për kredinë në lekë ashtu dhe për kredinë në valutë[12]. Megjithatë, është për t'u theksuar fakti se pas vitit 1999, këto banka nuk vazhdojnë të mbajnë akoma pozita sunduese në aktivitetin kreditues. Zhvillimet dinamike në sistemin bankar shqiptar të tilla si rritja e numrit të bankave që operojnë në treg, zgjerimi i rrjetit bankar në zona të ndryshme të vendit, transferimi i plotë i kapitalit të Bankës së Kursimeve tek Raiffeissen Zentral Bank, kanë rritur konkurrencën ndërmjet bankave si edhe kanë bërë që përqindja e kredisë së akorduar të jetë më e diversifikuar midis bankave.

Tabela 1 tregon totalin e kredisë së re të dhënë gjatë secilit vit. Edhe pse pjesa më e madhe e kredisë së re të akorduar deri tani është kredi afatshkurtër, të dhënat tregojnë se bankat po orientohen drejt investimeve me afate më të gjata maturimi. Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2005, bankat janë angazhuar rreth 60 për qind më shumë në kredinë me afat maturimi mbi 1 vit, duke ulur ndjeshëm financimin e ekonomisë me kredi afatshkurtër[13].

Tabelë 1. Kredia e re[14] (në miliardë lekë).

Viti	2000	2001	2002	2003	2004	2005 Gjashtëmujori I
Totali i kredisë	24.2	40.6	94.3	183.0	88.1	57.5
Lekë	4.4	10.0	18.1	27.6	30.9	17.4
Valutë	19.8	30.6	76.2	155.4	57.2	40.1
Afatshkurtër	12.9	27.6	80.7	157.8	54.4	27.0
Afatmesme	10.0	10.7	7.1	7.9	13.0	12.2
Afatgjatë	1.3	2.6	6.5	17.3	20.7	18.3

Një aspekt tepër i rëndësishëm në lidhje me kredinë është cilësia e portofolit të kredisë. Grafiku 7 tregon përqindjen e kredisë me probleme ndaj totalit të kredisë së akorduar, ndërsa grafiku 8 tregon vlerën e totalit të kredisë me probleme.

Grafik 7. Cilësia e kredisë (në përqindje).
Periudha: dhjetor 2001 – qershor 2005.



Grafik 8. Totali i kredisë me probleme (në milionë lekë).
Periudha: dhjetor 2001 – qershor 2005.



Megjithëse pesha e kredisë me probleme ka një prirje rënëse, totali i kredisë me probleme është rritur. Ritmet e larta të rritjes së kredisë diktojnë nevojën për të qenë të kujdesshëm në lidhje me cilësinë e portofolit[15]. Rreziku i kredisë reflekton problemet e shumta në drejtim të rregullave dhe praktikave që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të kreditorëve. Zgjidhja e këtyre problemeve në të ardhmen do të jetë një faktor-kyç, që do të mbështesë rritjen e shpejtë të kredisë për ekonominë.

2.2 PROBLEMATIKA NË LIDHJE ME SERITË KOHORE TË KREDIVE SIPAS STRUKTURËS NË BAZËN E TË DHËNAVE "SERI KOHORE"

2.2.1 Kredia për ekonominë.

Treguesit:

Totali i kredisë

- Pretendime ndaj sektorit publik.
- Pretendime ndaj sektorit privat.
- Ndërmarrjet private.
- Individët.
- Pretendime ndaj institucioneve të tjera financiare.



Kredia për ekonominë përfshin të gjitha pretendimet e bankave ndaj sektorit publik, ndërmarrjeve private, individëve dhe institucioneve të tjera financiare. Këto pretendime janë të shprehura në formën e kredive afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, kredive hipotekare, kontratave të qiradhënies financiare si dhe kreditimit nëpërmjet llogarive rrjedhëse debitore.

Ky tregues përfaqëson kreditimin total në lekë dhe në valutë të ekonomisë nga bankat që pranojnë depozita. Në këtë tregues janë përfshirë kreditë standarde, kreditë e pakthyera në afat, kreditë në ndjekje, kreditë nënstandarde, kreditë e dyshimta dhe kreditë e humbura.

Siç tregohet dhe në grafikun 9 totali i kredisë ka një pririje rritëse pozitive. Në periudhën pas vitit 1999, kredia për ekonominë është rritur me ritme më të larta. Licencimi i bankave të reja, liberalizimi i politikës së normave të interesit, heqja e kufirit të kredisë dhe stabilizimi i mjedisit politik kanë bërë që bankat të jenë më agresive në politikën e tyre për të rritur dhënien e kredisë. Në vitin 2004 dhe fillimin e vitit 2005 grafiku tregon për rritje me ritme edhe më të larta të kredisë. Në këtë periudhë ka ndikuar pozitivisht privatizimi i Bankës së Kursimeve (sot Banka Raiffesisen) dhe heqja e kufizimit për aktivitetin kreditues të kësaj banke, në dhjetor 2004.

Problematika dhe shpjegimet:

Maj 1993: Kredia për ekonominë pati një kërcim negativ prej - 21.5 për qind.

Ky zvogëlim në totalin e kredisë ka ardhur nga një ulje prej 30 për qind në kredinë e akorduar ndërmarrjeve shtetërore. Këtë ulje e shkaktoi vendimi i qeverisë për të falur kreditë e pakthyera në afat deri në 31 dhjetor 1992 të Bankës Bujqësore për Zhvillim, për një shumë prej 2.9 miliardë lekësh.

Dhjetor 1993: Kredia për ekonominë pati një kërcim negativ prej - 47 për qind.

Në fund të vitit 1993 qeveria pranoi që kompanive shtetërore t'u falej borxhi që kishin marrë para vitit 1992 në Bankën Kombëtare Tregtare, për një vlerë prej 4.3 miliardë lekësh. Ministria e Financave emetoi obligacione për të zëvendësuar kreditë pa shpresë arkëtimi, të cilat u falën.

Gusht 2001 – shtator 2001: Kredia për ekonominë pati një kërcim negativ prej -19 për qind.

Në shtator 2001 Banka e Kursimeve transferoi kreditë nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura pranë Agjencisë së Trajtimit të Kredive. Kredia për sektorin privat dhe për sektorin shtetëror pësoi ulje të ndjeshme përkatësisht me –17 për qind dhe –55 për qind ndryshim mujor.

2.2.2 Kredia për ekonominë në valutë.

Treguesit:

Totali i kredisë
- Pretendime ndaj sektorit publik.
- Pretendime ndaj sektorit privat.
- Ndërmarrjet private.
- Individët.
- Pretendime ndaj institucioneve të tjera financiare.

Grafik 10. Kredia për ekonominë në valutë (në milionë lekë). Periudha: shtator 1998 – qershor 2005.



Kredia për ekonominë në valutë të huaj përfshin të gjitha pretendimet në valutë të bankave ndaj sektorit publik, ndërmarrjeve private, individëve dhe institucioneve të tjera financiare. Këto pretendime janë të shprehura në formën e kredive afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, të kredive hipotekare, kontratave të qiradhënies financiare si dhe kreditimit nëpërmjet llogarive rrjedhëse debitore. Treguesi "Kredia në valutë" ka shfaqur një prirje rritëse përgjatë periudhës (grafiku 10). Ecuria e këtij



treguesi është ndikuar nga kredia në valutë dhënë sektorit privat dhe kryesisht nga ajo dhënë ndërmarrjeve private sepse pjesa më e madhe e kredisë në valutë është dhënë për këtë sektor.

Kredia në valutë për sektorin publik është zvogëluar vazhdimisht deri sa është bërë zero në janar 2001, edhe pse është shfaqur përsëri në vitin 2004, por me vlera tepër të vogla.

Kredia për institucionet e tjera financiare është një tregues që është shfaqur në vitin 2003 dhe përbën akoma një zë me peshë tepër të vogël në totalin e kredisë. Kredia në valutë është kredia që zë peshën më të madhe në totalin e kredisë. Duke filluar që nga muaji mars i vitit 2000 e në vazhdim, kredia në valutë ka qenë gjithmonë më e madhe se kredia në lekë (grafiku 10). Një nga shkaqet që ka nxitur kreditimin në valutë kanë qenë normat e interesave, të cilat ishin më të favorshme për kredinë në valutë. Kështu për shembull, në dhjetor 2003, për kredinë në lekë me afat maturimi 1 – 3 vjet norma e interesit ishte 20.33 për qind, kurse për kredinë në euro 11.04 për qind dhe për kredinë në dollarë amerikanë 9.34 për qind.

Tabelë 2. Kredia për ekonominë.

	Dhjetor 1998	Dhjetor 1999	Dhjetor 2000	Dhjetor 2001	Dhjetor 2002	Dhjetor 2003	Dhjetor 2004	Qershor 2005
Totali i kredisë (në milionë lekë)	17745	19890	23242	27941	38652	50683	69973	95892
Kredia në valutë	5627	9277	14827	22829	30519	41537	56312	73872
Kredia në lekë	12065	10613	8415	5112	8132	9146	13661	22020
Në përqindje ndaj totalit								
Kredia në valutë	32%	47%	64%	82%	79%	82%	80%	77%
Kredia në lekë	68%	53%	36%	18%	21%	18%	20%	23%

Arsye të tjera të rritjes së kredisë në valutë mund të jenë edhe problemet e administrimit të rrezikut të kurseve të këmbimit, ekzistenca e pasiveve (depozita e kapital) të bankave në valutë si dhe fakti që ekonomia në vendin tonë mbështetet kryesisht në importet e larta nga vendet e tjera, përmendim këtu importimin e makinerive dhe të lëndëve të para.

2.2.3 Kredia për ekonominë në lekë

Treguesit:

Totali i kredisë

- Pretendime ndaj sektorit publik.
- Pretendimet ndaj sektorit privat.
- Ndërmarrjet private.
- Individët.
- Pretendime ndaj institucioneve të tjera financiare.

Kredia për ekonominë në lekë përfshin të gjitha pretendimet në lekë të bankave ndaj sektorit publik, ndërmarrjeve private dhe individëve. Këto pretendime janë të shprehura në formën e kredive afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, të kredive hipotekare, kontratave të qiradhënies financiare si dhe kreditimit nëpërmjet llogarive rrjedhëse debitore.

Grafik 12. Kredia për ekonominë në lekë (në milionë lekë).
Periudha: shkurt 1999 – qershor 2005.



Kredia në lekë ka pasur prirje rënëse dhe me luhatje të shpeshta gjatë viteve 1999, 2000 dhe 2001 dhe vetëm pas vitit 2001 ka prirje më të rregullt rritëse, duke treguar se pas këtij momenti sistemi bankar po rrit rolin e kredidhënies në lekë si mënyrë financimi. Ritmi i rritjes së kredisë në lekë është rritur veçanërisht pas vitit 2004. Këto ritme pozitive, në pjesën më të madhe të tyre, i dedikohen angazhimit në rritje të bankave për të ofruar shërbime në plotësimin e kërkesave për kredi të individëve.

Problematika dhe shpjegimet:

Maj 1999: Ka ndodhur riklasifikim ndërmjet sektorëve për kredinë në lekë.

Në maj 1999 ka pasur një përmbysje të vlerave për kredinë ndaj ndërmarrjeve private me atë ndaj individëve, e cila ka vazhduar edhe në muajt që kanë pasuar deri në vitin 2000. Në këtë muaj, kredia për ndërmarrjet private është ulur për një vlerë prej 5033 milionë lekësh dhe është rritur me një vlerë prej 4601 milionë lekësh kredia për individët, por ndryshimi i kredisë së sektorit privat në total është i vogël. Ky ndryshim ka ndodhur në raportimin e Bankës së Kursimeve dhe duke ditur se kjo ka qenë një periudhë në të cilën kësaj banke i ishte ndaluar akordimi i kredisë së re, ky ndryshim ka ardhur nga riklasifikimet e mundshme në bilanc.

Dhjetor 2000: Kredia në lekë ka pasur një kërcim negativ prej -22 për qind.

Në dhjetor 2000 Banka Kombëtare Tregtare transferoi kreditë nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura pranë Agjencisë së Trajtimit të Kredive. Në këtë muaj kanë pësuar një ulje të ndjeshme si kredia ndaj sektorit privat, ashtu edhe ajo ndaj sektorit shtetëror.

Shtator 2001: Kredia në lekë ka pasur një kërcim negativ prej -61 për qind.

Kredia në lekë u zvogëlua sepse në këtë muaj Banka e Kursimeve ka kaluar për administrim në Agjencinë e Trajtimit të Kredive, kreditë me probleme për sektorin privat dhe atë shtetëror.

3. MJETET VALUTORE NETO TË BANKËS SË SHQIPËRISË

3.1 MJETET VALUTORE NETO TË BANKËS SË SHQIPËRISË.

Treguesit:

Mjetet Valutore Neto (MVN)
- Mjetet Valutore (MV)
- Detyrimet Valutore (DV)

Treguesi "Mjetet valutore neto të Bankës së Shqipërisë" paraqet të gjitha pretendimet që Banka e Shqipërisë ka ndaj jorezidentëve[16] minus detyrimet që autoriteti monetar ka ndaj të njëjtit sektor.

Treguesi "Mjetet valutore neto" llogaritet si diferencë e "Mjeteve valutore" me "Detyrimet valutore" si rrjedhim ecuria e tij ndikohet nga ecuria dhe ngjarjet e veçanta të ndeshura te këto të fundit.

Pretendimet ndaj jorezidentëve përfshijnë:

- Arin që Banka e Shqipërisë mban në depozitë në bankat e huaja;
- Depozitat me dhe pa afat në bankat e huaja;
- Investimet në letrat me vlerë të jorezidentëve;
- Monedhat dhe kartëmonedhat në valutë;
- Mbajtjet e sdr-ve;
- Pozicioni rezervë në Fond;
- Kuotat e Bankës Botërore dhe të Bankës Arabe të Zhvillimit.

Detyrimet ndaj jorezidentëve përfshijnë:

- Huatë e ndryshme nga jorezidentët (si për shembull, huaja greke për mbulimin e bilancit të pagesave, huaja nga Banka Evropiane e Investimit, huaja për zhvillimin e bujqësisë, industrisë dhe shërbimeve si dhe huatë e tjera të marra nga bankat tregtare për nevojat e tyre);
- Depozitat e bankave të huaja në Bankën e Shqipërisë;
- Programet ESAF të FMN-së;
- Llogaritë në lekë të Bankës Botërore dhe të Bankës Arabe të Zhvillimit në Bankën e Shqipërisë.

Tabela e mjeteve valutore hartohet me vlerat në lekë dhe në dollarë amerikanë. Ndryshimi ndërmjet MVN në dollarë amerikanë dhe MVN në lekë, qëndron në faktin se në MVN në dollarë përfshihen vetëm ato pretendime dhe detyrime të Bankës së Shqipërisë që janë në valutë, duke përjashtuar llogaritë e Bankës Botërore dhe të Bankës Arabe të Zhvillimit në lekë. MVN të Bankës së Shqipërisë në lekë përfshijnë të gjitha pretendimet dhe detyrimet ndaj jorezidentëve, në lekë dhe në valutë.

Grafik 13. Mjetet valutore neto të Bankës së Shqipërisë (në milionë lekë). Periudha: korrik 1994 – qershor 2005.



Mjetet valutore neto të Bankës së Shqipërisë kanë pasur një prirje rritëse, gjë që ka ardhur nga ndikimi i tre grupe faktorësh:

1. Nga transaksionet e realizuara

Në këtë grup përmblidhen të gjithë faktorët që ndikojnë në shtimin ose pakësimin e mjeteve valutore nëpërmjet hyrjes dhe daljes së fondeve të donatorëve, institucioneve financiare ndërkombëtare, fondacioneve, qeverive të huaja, projekteve të ndryshme etj..

2. Nga faktorë që ndikojnë në rivlerësimin e mjeteve valutore neto.

Në këtë grup do të veçojmë, ndikimin e ndryshimit të kursit të këmbimit të valutave në momente të ndryshme sipas situatave në tregun ndërkombëtar dhe në atë të brendshëm.

3. Ndryshime të ndodhura për shkak të ndryshimit të metodologjisë dhe të riklasifikimeve.

Rritja ose zvogëlimi në mjetet valutore neto të Bankës së Shqipërisë mund të vijë edhe si pasojë e ndryshimit në metodologji ose për shkak të rregullimeve në zërat e klasifikuar nën këtë tregues. Kështu për shembull, deri në dhjetor 2002, ari i mbajtur në kasafortat e Bankës së Shqipërisë ishte klasifikuar si një nga zërat përbërës të mjeteve valutore neto. Sipas metodologjisë për kompilimin e statistikave monetare[17], ari jostandard nuk duhet përfshirë në mjetet valutore. Pas sqarimeve në lidhje me karakteristikat e këtij ari dhe të udhëzimeve që jep metodologjia, ari në kasafortat e Bankës së Shqipërisë nuk u përfshi më në mjetet valutore të Bankës së Shqipërisë. Megjithatë, si pjesë e mjeteve valutore vazhdon të paraqitet ari jostandard që mbahet në Bankën e Anglisë.

Problematika dhe shpjegimet:

Korrik 1994 – gusht 1995: Mjetet valutore neto të Bankës së Shqipërisë patën vlera negative.

Në periudhën e viteve 1990 – 1994, deri në mesin e vitit 1995 treguesi "Mjetet valutore neto të autoritetit monetar" ka pasur vlera negative. Kjo për shkak se gjatë gjithë kësaj

periudhe, detyrimet e huaja të Bankës së Shqipërisë kanë qenë tepër të larta në krahasim me mjetet valutore (shih grafikun 13). Banka e Shqipërisë kishte të trashëguar në bilancin e saj një borxh të jashtëm relativisht të lartë dhe rezerva valutore të pakta, të cilat sollën si rrjedhojë që treguesi "Mjetet valutore neto" të ketë vlera negative.

Shtator 1995: Mjetet valutore neto të autoritetit monetar kanë kërcimin më të madh pozitiv prej +136.36 për qind.

Kjo rritje e menjëhershme e mjeteve valutore neto ka qenë rrjedhojë e zvogëlimit të detyrimeve të huaja të Bankës së Shqipërisë. Në shtator të vitit 1995 është zvogëluar borxhi afatshkurtër i prapambetur (*overdue short term obligations*)[18], që ka ardhur për shkak të ristrukturimit të borxhit që Shqipëria kishte ndaj bankave kreditore të huaja. Ky borxh u zgjidh me investimin në blerjen e obligacioneve me kupon zero të thesarit amerikan, me afat maturimi 30 vjet. Kështu në këtë muaj është shtuar zëri "Bono thesari të Shtetit Amerikan" (*US – TB collateral*) dhe në anën e pasivit është shtuar "Borxhi tridhjetëvjeçar për pretendimet e huaja" (*30 - year bonds for FX claims*) për të njëjtën vlerë.

Korrik 1997: Mjetet valutore neto kanë kërcimin më të madh negativ prej – 18.1 për qind.

Në muajin korrik 1997 "mjetet valutore neto – MVN" në lekë kanë pasur uljen më të madhe mujore. Ky përkeqësim i nivelit të MVN-së lidhet kryesisht me ecuritë e dollarit amerikan në tregun valutor ndërkombëtar dhe të lekut në tregun e brendshëm. Gjatë periudhës në fjalë, dollari amerikan ka fituar terren ndaj markës gjermane dhe gjithë valutave të tjera që kompozonin rezervën valutore të Bankës së Shqipërisë. Ky vlerësim pati një ndikim negativ duke zvogëluar shumë "mjetet valutore" në dollarë amerikanë. Gjithashtu, kujtojmë se kjo periudhë përkon me një periudhë të rënduar në sferën ekonomike dhe politike të vendit. Destabiliteti i vitit 1997 u reflektua edhe në çmimin e lekut kundrejt valutave në tregun valutor, shoqëruar me humbjen e besimit të njerëzve tek leku, si dhe me spekulime të ndryshme, gjë që solli

zhvlerësim të lekut. Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë ndërhyri disa herë në treg duke shitur dollarë e duke blerë lekë, veprim i cili rivlerësoi në mënyrë të menjëhershme lekun. Kështu për shembull, ndërsa në qershor të vitit 1997 kursi lek/usd ka qenë 178.74, në korrik të po këtij viti ai arriti në 145.17. Vlerësimi i lekut ndaj dollarit shkaktoi një ulje të vlerës së "mjeteve valutore neto" të vlerësuara në lekë.

Dhjetor 2003: Ka një ulje prej 38 për qind në detyrimet valutore.

Në muajin dhjetor 2003 është hequr nga bilanci i Bankës së Shqipërisë kredia për qeverinë, akorduar nga Qeveria Gjermane për programin KFW (hua zhvillimi për bujqësinë, industrinë, shërbimet etj.). Me vendim të Këshillit Mbikëqyrës ndjekja e kësaj kredie i kaloi qeverisë, prandaj ajo nuk u paraqit më në bilancin e Bankës së Shqipërisë.

4. Së fundi

Nëpërmjet këtij materiali është synuar t'u vihet në ndihmë analistëve të Bankës së Shqipërisë si dhe analistëve të tjerë të institucioneve brenda dhe jashtë vendit. Duke qenë se në formë të përmbledhur një informacion i tillë për seritë kohore të treguesve monetarë të publikuara nga Banka e Shqipërisë bëhet për herë të parë, është synuar të përzgjidhen treguesit statistikorë më të përdorshëm për vendimmarrjen ekonomike si dhe nga analistët e tjerë.

Duke përshkruar gjithashtu metodologjinë e serive kohore dhe ndryshimet kryesore në kohë, ky material përbën edhe një plotësim të dokumentacionit metodologjik të serive kohore, gjë që përbën një nga hapat e rëndësishëm në drejtim të rritjes së standardeve të shpërndarjes së të dhënave në Bankën e Shqipërisë. Kështu, në programin SDDS të Fondit Monetar Ndërkombëtar në të cilin Shqipëria synon të anëtarësohet, shoqërimi i të dhënave të publikuara me përshkrimin e hollësishëm metodologjik të tyre, përbën elementin kryesor të përmasës së cilësisë së të dhënave[19]. Nga ana tjetër, përshkrimi

i ndryshimeve kryesore metodologjike përbën një nga elementet e përmasës së integritetit të të dhënave. Ky material përbën një hap të parë në këtë drejtim dhe do të vazhdojë të plotësohet edhe në të ardhmen.

SHËNIME

Ky material jep një informacion të përgjithshëm për ecurinë e serive kohore të depozitave, të kredive dhe të mjeteve valutore neto të Bankës së Shqipërisë, pikat e këputjes në seritë përkatëse dhe shkaqet e këtyre këputjeve. Informacioni i dhënë është mbështetur në analizën e tabelave dhe grafikëve të serive kohore. Si burim të dhënash janë përdorur kryesisht të dhënat e publikuara në bazës së të dhënave "Seri kohore", që publikohet në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë. Periudha e marrë në shqyrtim është periudha dhjetor 1992 – qershor 2005.

* Refika Fejzo, specialiste, Sektori i Statistikave Financiare, Departamenti i Statistikës, Banka e Shqipërisë.
Bashkëpunuan: Kliti Ceca, Drejtor në Departamentin e Statistikës, Banka e Shqipërisë; Hilda Shijaku, Përgjegjëse e Sektorit të Statistikave Financiare, në Departamentin e Statistikës, Banka e Shqipërisë.
Autorja falenderon z. Kelmend Rexha për komentet në lidhje me artikullin.

[1] Shiko: Banka e Shqipërisë, Raporti Vjetor 1994, faqet 17 – 18.

[2] Shiko: Banka e Shqipërisë, Raporti Vjetor 1999.

[3] Shiko: Cani, Sh., dhe Vika, I., (2002), Kriza e konfidencës, shkaqet prapa hemorragjisë së depozitave bankare, Monitor, Nr.4.

[4] Shiko: Banka e Shqipërisë, Deklarata e politikës monetare për gjashtëmujorin e parë 2005, faqe 27.

[5]Depozitat e autoriteteve vendore janë paraqitur si sektor më vete duke filluar që nga muaji dhjetor i vitit 2001. Më parë ato paraqiteshin së bashku me ndërmarrjet jofinanciare publike.

[6] Me DD është shënuar "Demand Deposit" – depozita pa afat në lekë.

[7] "Përtej Parasë" është një program i Bankës së Shqipërisë në bashkëpunim me qeverinë dhe sistemin bankar për reduktimin e transaksioneve në *cash* në ekonomi. Disa nga arritjet e këtij programi në luftën anti*cash* janë realizimi i sistemit të pagesave në vlerë të madhe (RTGS), të kryqëzimit të pagesave me vlerë të vogël (AIPS), kalimi i pagesave të punonjësve të sistemit publik nëpërmjet bankave të nivelit të dytë etj..

[8] Shiko: Banka e Shqipërisë, Raporti Vjetor 2004, faqe 53.

[9] Burimi i të dhënave: dhjetor 1992 – dhjetor 1997, Raporti mujor statistikor. Janar 1999 – qershor 2005, baza e të dhënave "Seri kohore" në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë.

[10] Shiko: Çeliku, E., dhe Luçi, E., (2003), Ndikimi i qëndrueshmërisë së situatës makroekonomike në nivelin e kredive me probleme.

[11] Shiko: Cani, Sh., Muço, M., dhe Baleta, T., (2000), Sistemi bankar shqiptar, probleme të zhvillimit të tij.

[12] Shiko: Baleta, T., (2000), Dominimi i tregut bankar shqiptar.

[13] Shiko: Banka e Shqipërisë, Deklarata e politikës monetare për gjashtëmujorin e parë 2005, faqe 32 – 33.

[14]Burimi i të dhënave: vitet 2000 dhe 2001, Raporti Vjetor 2002. Vitet 2002,

2003, 2004 dhe gjashtëmujori i parë i vitit 2005, baza e të dhënave "Seri Kohore" në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë.

[15] Shiko: Fullani, A., (2005), Fjala përshëndetëse në Forumin Ndërballkanik të Shoqatave të Bankave, Buletini Ekonomik, vëllimi 8, Nr.2.

[16] Koncepti i jorezidentëve është bazuar në "Metodikën e statistikave monetare dhe financiare, Banka e Shqipërisë, korrik 2003".

[17] IMF, Guide to international monetary and financial statistics, 1997.

[18] Shiko: Taçi, S., (2004), Borxhi i jashtëm i Shqipërisë dhe shërbimi i tij.

[19] SDDS – Special Data Dissemination Standards. Këto standarde bazohen mbi praktikat më të mira ndërkombëtare në shpërndarjen e të dhënave statistikore dhe janë mandatore për vendet, të cilat anëtarësohen në projektin e SDDS-it. Përmasat e monitorueshme të këtyre standardeve lidhen me karakteristikat e të dhënave (mbulimi, periodiciteti, koha e publikimit të të dhënave), e drejta e përdorimit të të dhënave, integriteti i të dhënave dhe cilësia e të dhënave. Për më tepër, shiko referenën 20. Referencat të tjera: 18, 19, 21, 22, 23, 24, 25.

REFERENCAT

1. *Banka e Shqipërisë, "Raporti Vjetor", 1993 – 2004.*
2. *Banka e Shqipërisë, "Raporti mujor", janar 2000 – qershor 2005.*
3. *Banka e Shqipërisë,"Raporti Statistikor", dhjetor 1993-qershor 2005.*
4. *Banka e Shqipërisë, "Buletini ekonomik", 2001-2005.*
5. *Banka e Shqipërisë, Aktiviteti kreditues dhe depozitues për bankat e nivelit të dytë, Analizë Vrojtimi, 2001-2005.*
6. *Banka e Shqipërisë, Këshilli Mbikëqyrës, (2001) udhëzim "Për çertifikatat e depozitave".*
7. *Banka e Shqipërisë, (2003), "Metodika e Statistikave Monetare dhe Financiare, korrik 2003".*
8. *Banka e Shqipërisë, (2003) "Ekonomia shqiptare: ecuria dhe sfidat e politikave ekonomike", Konferenca IV.*
9. *Baleta, T., Kallfa, N., etj., (2000), Dominimi i tregut bankar shqiptar, Material Diskutimi, Banka e Shqipërisë.*
10. *Cani, Sh., Vika, I., (2002), Kriza e konfidencës, shkaqet prapa hemorragjisë së depozitave bankare, Analizë, revista "Monitor", Nr.4.*
11. *Cani, Sh., Muço, M., dhe Baleta, T., (2000), Sistemi bankar shqiptar, probleme të zhvillimit të tij, Analizë Vrojtimi, Banka e Shqipërisë.*
12. *Ceca, K., Shijaku, H., Xhaferaj, E., (shtator 2005), Vlerësimi i standardeve të shpërndarjes së statistikave në Bankën e Shqipërisë, Buletini Ekonomik, Vëllimi 8, Nr. 2.*
13. *Ceca, K., Thanati, E., Shijaku, H., Xhaferaj, E., (qershor 2005) Krahasimi i standardeve të statistikave në Bankën e Shqipërisë me standardet e Projektit SDDS të Fondit Monetar Ndërkombëtar, Buletini Ekonomik, Vëllimi 8, Nr. 3.*
14. *Çeliku, E., dhe Luçi, E., (2003), Ndikimi i qëndrueshmërisë së situatës makroekonomike në nivelin e kredive me probleme, Material Diskutimi, Banka e Shqipërisë.*
15. *Fullani, A., (2005) Çështje kryesore lidhur me politikat e remitancave në ekonomitë në tranzicion: Pikëpamje nga një vend pritës, Banka e Shqipërisë. Buletini Ekonomik, Vëllimi 8, Nr.3.*
16. *Fullani, A., (2005), Fjala përshëndetëse në Forumin Ndërballkanik të Shoqatave të Bankave, Buletini Ekonomik, Vëllimi 8, Nr.2.*
17. *Fullani, A., (2005), Fjala përshëndetëse në seminarin "Testimi i sistemit bankar mbi situatat ekstreme të rrezikut", Buletini Ekonomik, Vëllimi 8, Nr.2.*

18. *Ibrahimi, F., (2004), Fjala në konferencën e përbashkët për shtyp në Ministrinë e Financave mbi programin "Përtej parasë".*
19. *IMF, (1997), Guide to international monetary and financial statistics.*
20. *Sheqeri, S., (2003), Tronditjet e sistemit bankar shqiptar dhe politikat e Bankës së Shqipërisë, Material Diskutimi, Banka e Shqipërisë.*
21. *IMF (1996), Guide to the data dissemination standards, Module 1: The SDDS –Provisional, International Monetary Fund.*
22. *IMF (1998), Guide to the General Data Dissemination System, International Monetary Fund.*
23. *MF (1998), The Special Data Dissemination Standards (Updated Guidance), International Monetary Fund.*
24. *IMF Statistics Department (2003), Data Quality Assessment Framework (DQAF) for Monetary Statistics, International Monetary Fund.*
25. *IMF Statistics Department (2003), Fifth Review of the Fund's Data Standards Initiatives, International Monetary Fund.*
26. *IMF Statistics Department and the Policy Development and Review Department, (1996), Standards for the Dissemination of Economic and Financial Statistics to the Public by Member Countries: Progress Report and Implementation of the Special Data Dissemination Standards, International Monetary Fund.*
27. *IMF Statistics Department and the Policy Development and Review Department, (2000), Third Review of the Fund's Data Standards' Initiatives, International Monetary Fund.*
28. *IMF Statistics Department and the Policy Development and Review Department, (2001), Fourth Review of the Fund's Data Standards' Initiatives, International Monetary Fund.*
29. *Taçi, S., (2004), Borxhi i jashtëm i Shqipërisë dhe shërbimi i tij, Material Diskutimi, Banka e Shqipërisë.*

ELEMENTE TË RËNDËSISHME TË STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR

*Ibrahim Buharaja**

Fjalë kyçe
- Standarde kontabël - Pasqyra financiare - GAAP - IFRS - Kuadër konceptual -

HYRJE

Zhvillimet ekonomike, sidomos globalizimi i ekonomisë, kanë bërë që vendimet ekonomike-financiare të marrin një rëndësi gjithnjë e më të madhe në rrafshin ndërkombëtar. Tashmë, faktorët kryesorë ndërkombëtarë kanë konverguar në të njëjtin qëndrim përsa i përket "gjuhës së përbashkët" të informacionit financiar që publikojnë nëpërmjet pasqyrave financiare, sipërmarrjet ekonomike të vendeve të ndryshme të botës. Kjo gjuhë do të jetë ajo e standardeve kontabël ndërkombëtare, zbatimi i të cilave është shpallur si detyrim të paktën për sipërmarrjet e kuotuara në tregjet financiare kombëtare e ndërkombëtare.

Në këtë kuadër shumë shtete, veç e veç apo të grupuara në organizma të caktuar, si për shembull Bashkimi Evropian, kanë ndërmarrë nisma reformuese në dispozitivin rregullator kontabël të tyre. Ky proces ka filluar tashmë edhe në shtetet e quajtura në tranzicion apo që kanë hyrë vonë në ekonominë e tregut si Polonia, Çekia, Rusia, Bullgaria etj..

Procesi reformues në kontabilitet nuk është as i lehtë dhe as pa probleme, për çdo shtet që nuk e ka zhvilluar dispozitivin e vet rregullator sipas praktikave dhe koncepteve anglo-saksione,

dhe veçanërisht për shtetet që kanë hyrë vonë në ekonominë e tregut. Në këtë proces, natyrisht është përfshirë dhe vendi ynë i cili synon hyrjen në Komunitetin Evropian, proces i cili është mishëruar edhe në ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Për të paraqitur sa më mirë të jetë e mundur natyrën dhe qëllimin e këtij procesi, vlerësuam si të nevojshme dhe të dobishme përgatitjen e këtij shkrimi duke ekspozuar fillimisht një historik të lindjes dhe të zhvillimit të standardeve kontabël ndërkombëtare.

1. HISTORIKU I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË KONTABILITETIT (IAS)

1.1 ZHVILLIMET GJATË VITEVE 1973-1998

1973: Krijimi i IASC

IAS-të e kanë fillesën në nevojën e harmonizimit të rregullave të përgatitjes e të paraqitjes së pasqyrave financiare, në nivel ndërkombëtar. Kërkesa për këtë harmonizim rridhte natyrshëm, për shkak të ndërkombëtarizimit të sipërmarrjeve dhe të tregjeve, veçanërisht të tregjeve të kapitalit. Nisma për arritjen e këtij harmonizimi u bë publike në korrik të vitit 1973, kur u krijua Komiteti i Standardeve Kontabël Ndërkombëtare (IASC). Nismëtarë ishin organizmat kontabël të 9 vendeve (Angli, Francë, Gjermani, Holandë, Japoni, Kanada, Meksikë, Australi dhe SHBA).

IASC shpalli në statutin e tij këta objektiva:

a. Të formulojë dhe të publikojë në interesin e përgjithshëm standardet kontabël për t'u respektuar në përgatitjen e pasqyrave financiare dhe të promovojë pranimin dhe zbatimin e tyre.
b. Të punojë në mënyrë të përgjithshme në përmirësimin dhe harmonizimin e rregullimeve, të standardeve

dhe të procedurave lidhur me paraqitjen e pasqyrave financiare.

Objektivat e IASC që në fillim, ishin në pajtim me ndërkombëtarizimin e tregjeve të kapitalit, sepse pikërisht këto tregje kërkojnë që pasqyrat financiare të mund të kuptohen e të krahasohen lehtësisht, pavarësisht vendit të origjinës së sipërmarrjeve që i paraqesin këto pasqyra. IASC, si një organizëm privat nuk mund të kishte një autoritet detyrues mbi asnjë shtet, prandaj ai do të punonte për arritjen e objektivave harmonizues; kryesisht në sajë të zhvillimit dhe të promovimit të standardeve të tij. Kjo ishte vërtet një detyrë ambicioze, e vështirë dhe që do të kërkonte një kohë të gjatë, ashtu siç u provua në realitet. Në nëntor të vitit 1974 u publikua IAS 1 (IAS1) i titulluar "Publikimi i metodave kontabël" dhe deri në vitin 1989 numri i standardeve të publikuara arriti në 31.

IASC, në vitin 1987, si rrjedhojë e kritikave që u bëheshin IAS-ve dhe rezistencës që bëhej për përshtatjen e këtyre standardeve nga shtetet e zhvilluara, ndërmori një program për rishikimin e standardeve. Si objektiv i këtij rishikimi u caktua përmirësimi cilësor dhe pakësimi i opsioneve.

Në qershor të vitit 1989 u publikua kuadri i përgatitjes dhe i paraqitjes së pasqyrave financiare, i cili shpesh quhet edhe kuadri konceptual.

1987: Hyrja e IOSCO në Grupin Konsultativ

IOSCO (Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Bursave të Letrave me Vlerë) i tregonte IASC që midis standardeve ekzistuese, një pjesë e madhe ishin të pranueshme me disa rezerva për pika jothelbësore (14 standarde), disa të tjera duhet të rishikoheshin (6 standarde) dhe disa të papranueshme (4 standarde).

Në dhjetor të vitit 1998, IASC mori një letër në emër të ministrave të financave të G7 dhe të guvernatorëve të bankave qendrore, përmes të cilës inkurajohej IASC në punët e tij lidhur me informacionin financiar dhe shprehej besimi që ky organizëm do të arrinte të plotësonte në afat programin e vet. Letra shprehte

vullnetin e G7 për të promovuar "parime, standarde dhe kode të sjelljes së mirë, të pranuara në nivel ndërkombëtar, më rigoroze dhe më të kuptueshme si dhe synimin për mbikëqyrjen më nga afër të zbatimit efektiv të tyre". Përveç G7 vijimi i punës nga ana e IASC inkurajohej gjithashtu, nga IOSCO, Komisioni Evropian, Banka Botërore etj..

Shtetet si Gjermania, Belgjika, Italia dhe Franca miratuan disa ligje apo vendime që u lejonin një pjese ose të gjitha sipërmarrjeve kombëtare, të adoptonin për pasqyrat financiare të konsoliduara IAS-et ose/dhe standardet amerikane. Shtete të tjera si Austria, Australia, Suedia, Zvicra etj., morën gjithashtu masa të brendshme për të inkurajuar harmonizimin kontabël ndërkombëtar, duke i autorizuar sipërmarrjet e tyre të unifikoheshin me standardet ndërkombëtare. Shumica e bursave evropiane kishin pranuar IAS-et dhe numri i sipërmarrjeve në botë që kishin vendosur për përdorimin e këtyre standardeve ishte rritur.

Duke i përmbledhur zhvillimet e 25 vjetëve (1973-1998) konstatohet se:

- gjatë 25 vjetëve të parë, roli i Komitetit të IAS-ve ka qenë kryesisht në harmonizimin e standardeve kontabël të vendeve kryesore që kishin përpunuar një referencial kontabël kombëtar;
- megjithë përparimet e shënuara në adoptimin apo pranimin e IAS-ve nga vende të tjera, ato nuk arritën të fitojnë zyrtarisht statusin e një referenciali kontabël ndërkombëtar;
- si pretendentë për t'u bërë organizma të standardizimit kontabël ndërkombëtar mbeten vetëm dy: Komiteti i IAS-ve dhe FASB-i amerikan.

1.2 ZHVILLIMET E KOHËVE TË FUNDIT

IAS-et, në fillimet e veta përmbanin shpesh opsione të diktuara nga synimi i gjetjes së një kompromisi sa më të mirë. Ekzistenca

e këtyre opsioneve i lejonte sipërmarrjet të gjenin një zgjidhje të përshtatshme sipas vështrimit të tyre. Por në anën tjetër, prania e opsioneve nuk shkonte në të njëjtin drejtim me objektivin e harmonizimit. Nën presionin e organeve rregullatore të bursave, Komiteti i IAS-ve ndërmori rishikimin e mjaft standardeve me synim pakësimin e opsioneve.

Kalimi nga objektivat për harmonizimin në objektiva për standardizimin, i diktuar nga kompleksiteti i mëtejshëm i transaksioneve tregtare dhe financiare (instrumentet financiare dhe ato derivative), si dhe synimet për t'u pranuar si i vetmi organizëm i standardizimit kontabël ndërkombëtar, ishin shkaku i riorganizimit të Komitetit të IAS-ve në vitin 2000. Kështu, më 24 maj të vitit 2000 në Edinburg (Skoci), anëtarët e Komitetit të IAS-ve miratuan statutin e ri.

Sipas këtij statuti, objektivat e Komitetit janë:

- përpunimi, në interes të përgjithshëm, i një pakete unike të standardeve kontabël të cilësisë së lartë, të kuptueshme dhe që mund të zbatohen në gjithë botën, që imponojnë dhënien në pasqyrat financiare të informacioneve të cilësisë së lartë, transparente dhe të krahasueshme, në mënyrë që të ndihmohen ndërhyrësit e ndryshëm në tregjet e kapitaleve në botë, si dhe përdoruesit e tjerë të pasqyrave financiare në marrjen prej tyre të vendimeve ekonomike;
- promovimi i përdorimit dhe aplikimit rigoroz të këtyre standardeve; dhe
- shtrirja drejt konvergimit e normave kontabël kombëtare dhe e standardeve kontabël ndërkombëtare për të bërë zgjidhje të cilësisë së lartë.

Realizimi i këtyre objektivave, të orientuar tashmë drejt një standardizimi (dhe jo harmonizimi) kontabël ndërkombëtar, diktoi nevojën që Komiteti i IAS-ve të punojë në lidhje të ngushtë me organizmat kontabël kombëtarë.

Pa hyrë në një analizë të statutit të ri, gjithsesi është e nevojshme që të përmenden disa emërtime dhe organe të këtij komiteti:

Komiteti i Standardeve Kontabël Ndërkombëtar (International Accounting Standards Committee, IASC).

Bordi i Standardeve Kontabël Ndërkombëtar (International Accounting Standards Board, IASB). Bordi i Standardeve Kontabël Ndërkombëtar (IASB), është organi i ngarkuar për të përgatitur dhe për të përshtatur standardet. Standardet e reja duke filluar nga viti 2002, do të emërtohen IFRS (International Financial Reporting Statement), ndërsa standardet ekzistuese, të pamodifikuara mbeten të emërtuara IAS. IASB-i në maj të vitit 2002, ka publikuar një ekspoze sondazh të titulluar "Përmirësimi i standardeve kontabël ndërkombëtare". Fjala është për një propozim për të ndryshuar 12 standarde nga 34 ekzistuese. Ky propozim është i pari në kuadrin e projektit "Përmirësim" të IASB, me objektiv rritjen e cilësisë dhe të koherencës së informacionit financiar. Këto standarde janë IAS 1, IAS 2, IAS 8, IAS 10, IAS 16, IAS 17, IAS 21, IAS 23, IAS 27, IAS 28 dhe IAS 33. Në të ardhmen mund të bëhen të tjetra propozime për rishikimin e IAS-ve.

Këshilli Konsultativ i Standardizimit (Standards Advisory Council International, SAC) ka për rol të këshillojë IASB mbi programin e punës dhe përparësitë e diskutimeve në mbledhjet dhe konsultat.

1.3 BASHKIMI EVROPIAN PËR ADOPTIMIN DHE ZBATIMIN E IAS-EVE

Vendet e Bashkimit Evropian e çmuan të nevojshëm përshpejtimin e procesit të harmonizimit ndërkombëtar të standardeve kontabël kjo, kryesisht për shkak të presionit të lartë që ushtronin tregjet ndërkombëtare të kapitalit dhe të nevojave në rritje të shumëkombsheve evropiane për t'iu drejtuar këtyre tregjeve të financimit, për të nxitur zhvillimin e tyre. Por, nga ana tjetër, debatet dhe veçanërisht ato pas vitit 1990, nxorën në pah vështirësitë për të arritur këtë harmonizim ndërkombëtar dhe e paraqitën procesin si afatgjatë.

Midis këtyre vështirësive mund të përmenden:

- në shumicën e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, traditat kontabël nuk gjenden të shprehura ose gjenden të shprehura keq në IAS. Këto të fundit shprehen hapur në favor të një preference që i jepet interesave të investitorëve, në mënyrën e ndërtimit të informacionit financiar. Interesat e kreditorëve shtyhen në nivel të dytë dhe rëndësia e pasqyrave financiare (PF), në kuadër të dhënies së llogarisë nga ana e administratorëve, del disi tërthorazi.
- IAS-et nuk bëjnë fjalë për lidhjen që ekziston midis kontabilitetit dhe fiskalitetit, në një kohë që në shumicën e shteteve anëtare, kjo çështje është e një rëndësie kapitale.
- IAS-et nuk bëjnë dallim midis pasqyrave financiare (PF) individuale dhe atyre të konsoliduara. Në nivel të Bashkimit Evropian ekzistojnë dy direktiva të veçanta dhe shoqëritë janë të detyruara të bëjnë publike të dyja tipet e këtyre pasqyrave.
- Disa nga IAS-et shkojnë përtej nevojave të sipërmarrjeve të mesme dhe të vogla. Numri i madh i informacioneve për t'u paraqitur në aneks, tejkalon atë që është realisht e nevojshme.

Krahas vështirësive të përmendura më sipër, konstatimi i përgjithshëm ishte që Direktivat Evropiane nuk mjaftonin më për pasqyrat financiare (PF) të sipërmarrjeve të mëdha evropiane që kërkonin të përftonin kapitale në tregje ndërkombëtare, veçanërisht në tregjet amerikane dhe se nuk duhej lënë që çështja të shkonte deri në një pikë, ku direktivat kontabël evropiane do të pengonin çdo zhvillim të ardhshëm. Nisur nga këto konstatime dhe duke ndjekur me kujdes hapat e ndërmarrë nga vetë komiteti i IAS-ve, nën nxitjen dhe mbështetjen e organizmave ndërkombëtarë të interesuar, Komisioni Evropian ndërmori veprimet e veta, që çuan në strategjinë e re evropiane për zbatimin e standardeve kontabël ndërkombëtare.

Strategjia e re evropiane u iniciua në mars të vitit 2000, por procesi juridik përfundoi në mes të vitit 2002 me miratimin

e "Rregullimit evropian mbi zbatimin e standardeve kontabël ndërkombëtare". Këto rregullime u votuan nga Parlamenti Evropian më 27 maj 2002.

Në nenin 1 të Rregullimit Evropian përcaktohen dy objektiva kryesorë:

- të garantohet një shkallë e lartë e transparencës dhe e krahasueshmërisë së pasqyrave financiare (PF);
- të garantohet një funksionim efikas i tregut komunitar të kapitaleve dhe i tregut të brendshëm.

Në nenin 4 të Rregullimit Evropian parashikohet që, - "për çdo ushtrim që nis nga 1 janari 2005, shoqëritë evropiane që i bëjnë ofertë publikut, duhet të paraqesin pasqyrat financiare (PF) të konsoliduara sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit (IAS)".

Për pasqyrat financiare të tjera, Rregullimi (neni 5) e lë në zgjedhjen e secilit shtet anëtar, që të parashikojë zbatimin e IAS/IFRS duke dalluar:

- rastin e pasqyrave financiare (PF) individuale të shoqërive me ofertë publike (shoqëritë që janë në fushën e zbatimit të IAS/IFRS për pasqyrat financiare të konsoliduara);
- rastin e pasqyrave financiare të konsoliduara dhe të pasqyrave financiare individuale të shoqërive të tjera të pakuotuara.

1.4 SHQIPËRIA PËR ZBATIMIN E STANDARDEVE KONTABËL

Në ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 4 përcaktohen standardet kontabël për hartimin e pasqyrave financiare si vijon:

a. Njësitë ekonomike që zbatojnë këtë ligj, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni,

zbatojnë standardet kontabël kombëtare për hartimin dhe publikimin e pasqyrave financiare. Standardet kontabël hartohen nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe brenda një muaji shpallen të detyrueshme për zbatim nga Ministri i Financave.

b. Ministri i Financave, pasi merr mendimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, shpall standardet kontabël të detyrueshme për zbatim për njësitë ekonomike publike, që nuk ndjekin qëllime fitimprurëse.

c. Standardet e hartuara nga Bordi i Standardeve Kontabël Ndërkombëtare dhe të përkthyera në shqip, nën përgjegjësinë e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, pa ndryshime nga teksti origjinal në gjuhën angleze, shpallen nga Ministri i Financave dhe zbatohen detyrimisht:

- nga shoqëritë e listuara në një bursë zyrtare letrash me vlerë dhe filialet e tyre, subjekt i konsolidimit të llogarive;
- nga bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare të ngjashme me bankat, shoqëritë e sigurimeve dhe të risigurimeve, fondet e letrave me vlerë dhe të gjitha shoqëritë e licencuara për të kryer veprimtari investimi në letrat me vlerë, edhe kur ato nuk janë të listuara në një bursë zyrtare letrash me vlerë;
- nga njësi ekonomike të tjera të mëdha, të palistuara në një bursë zyrtare letrash me vlerë, kur ato tejkalojnë kufijtë e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave për të ardhurat vjetore dhe numrin e të punësuarve.

2. KUADRI KONCEPTUAL

2.1 KUADRI KONCEPTUAL DHE NEVOJA E TIJ

Një kuadër konceptual në fushën e kontabilitetit është një pasqyrë e parimeve teorike përgjithësisht të pranuara, të cilat formojnë një kuadër referues për raportimin financiar.

Këto parime teorike janë të rëndësishme sepse sigurojnë bazat për zhvillimin e standardeve të reja të kontabilitetit dhe vlerësimin e atyre ekzistuese. Procesi i raportimit financiar lidhet

me sigurimin e informacionit që është i dobishëm në procesin e vendimmarrjes ekonomike. Megjithëse është teorik nga natyra, një kuadër konceptual për raportimin financiar ka qëllime përfundimtare mjaft të vlefshme në praktikë.

Nevoja e hartimit të një kuadri konceptual për përgatitjen e pasqyrave financiare, evidentohet nga rreziqet që mund të lindin nga mospërdorimi i tij për hartimin e rregullimit kontabël. Mungesa e një kuadri konceptual do të thotë që parimet themelore mund të përfshihen më shumë se një herë në standarde të ndryshme, duke sjellë në këtë mënyrë kontradikta dhe paqëndrueshmëri në konceptet bazë, siç janë ato të kujdesit dhe përputhjes. Kjo çon në pasiguri dhe ndikon mbi konceptin "e vërtetë dhe e saktë", të raportimit financiar.

2.2 PARIMET PËRGJITHËSISHT TË PRANUARA TË KONTABILITETIT (GAAP) DHE KUADRI KONCEPTUAL

Kuptimi: Me GAAP kuptohen të gjithë rregullat, pavarësisht nga burimi i tyre, të cilët shërbejnë për të udhëhequr kontabilitetin. Nisur nga ky përcaktim, për një vend të caktuar ata mund të thuhen se përbëhen kryesisht si një kombinim i:

- ligjit kombëtar të shoqërive;
- standardeve kombëtare të kontabilitetit;
- kërkesave të bursës vendase.

Pa mohuar tre burimet e mësipërme, baza e GAAP-it për çdo vend të veçantë është më e gjerë dhe përfshin gjithashtu edhe burime si:

- standardet ndërkombëtare të kontabilitetit;
- kërkesat statutore në shtetet e tjera.

Në Britaninë e Madhe, GAAP, i referohet praktikave të kontabilitetit, të cilat shikohen si të pranueshme nga profesioni i kontabilistit. Çdo praktikë kontabël, e cila është e legjitimuar në rrethana sipas të cilave ajo është zbatuar duhet të trajtohet

si GAAP. Vendimi nëse një praktikë kontabël është pranuar/ legjitimuar apo jo do të varet nga një ose më shumë faktorë të mëposhtëm:

- a i merr parasysh praktika standardet e kontabilitetit, statutin apo prononcimet e tjera zyrtare?
- a është praktika e pandryshueshme në lidhje me nevojat e përdoruesve dhe me objektivat e raportimit financiar?
- a ka mbështetje të rëndësishme praktika në literaturën kontabile? A është zbatuar praktika nga kompani të tjera në situata të ngjashme?
- a është praktika në përputhje me konceptin thelbësor "i vërtetë dhe i saktë"? [1]

Në SHBA, parimet e kontabilitetit të pranuara përgjithësisht (GAAP) janë përcaktuar si ato parime, të cilat kanë "mbështetje të rëndësishme autoritare". Prandaj, llogaritë vjetore dhe pasqyrat financiare (PF) të përgatitura në përputhje me parimet e kontabilitetit për të cilat nuk ekziston një mbështetje e rëndësishme autoritare, supozohen të jenë të papërshtatshme për vendimmarrjen e përdoruesve. Efekti këtu është që parimet "e reja" të kontabilitetit ose ato "të ndryshme" nuk janë të pranueshme po të mos jenë të përshtatura nga rryma e profesionit kontabël, dhe zakonisht nga organizmat hartues të standardeve dhe/ose nga organizmat profesionalë të kontabilitetit. Kjo pikëpamje është shumë më strikte sesa këndvështrimi i Britanisë së Madhe.

2.3 KUADRI KONCEPTUAL PËR PËRGATITJEN E PASQYRAVE FINANCIARE (PF)

Në rrafshin ndërkombëtar për të identifikuar diferencat e ndryshme që ekzistojnë në ndërtimin e pasqyrave financiare (PF) si dhe për të harmonizuar rregullimin, standardet kontabël dhe procedurat në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e PF, është ngarkuar IASC. Kuadri konceptual i IAS-ve i hartuar nga IASC, u miratua nga Bordi i IASC në prill të vitit 1989 dhe u publikua në qershor të po këtij viti. Ky kuadër paraqet një tërësi rregullash

e konceptesh bazë kontabël, marrëveshjesh e parimesh të tjera themelore, të cilat synojnë që të ndihmojnë në procesin e hartimit dhe rishikimit të standardeve kontabël, të ndërtimit dhe paraqitjes së pasqyrave financiare (PF) të publikueshme.

Qëllimi, statusi, objektivi, fusha e zbatimit të tij

Qëllimi:

Kuadri konceptual shërben për të përcaktuar konceptet bazë që duhet të mbahen parasysh për përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare (PF) për përdoruesit e jashtëm. Pra, ai merr në konsideratë vetëm pasqyrat financiare (PF) të publikueshme e nuk rregullon dhe as jep konceptet dhe rregullat për pasqyra financiare të tjera, të prodhuara nga sistemi i kontabilitetit për nevoja të drejtimit apo të tjera.

Sipas përcaktimit të bërë nga IASC rezulton se qëllimi i këtij kuadri është që:

- të ndihmojë bordin e IASC në rishikimin e IAS-ve ekzistuese dhe në zhvillimin e IFRS-ve të reja;
- të ndihmojë bordin e IASC në promovimin e harmonizimit të rregullimit të standardeve kontabël në lidhje me paraqitjen e pasqyrave financiare (PF), duke siguruar bazat për zvogëlimin e alternativave të trajtimit kontabël të lejuar nga një IAS;
- të ndihmojë përgatitësit e pasqyrave financiare (PF) në aplikimin e IAS;
- të ndihmojë audituesit në formimin e një opinioni nëse pasqyrat financiare (PF) janë ndërtuar konform me IAS;
- të ndihmojë përdoruesit e pasqyrave financiare (PF) që të interpretojnë informacionin që përmbajnë PF të përgatitura në përputhje me IAS.

Statusi:

Kuadri konceptual i përpunuar dhe emetuar nga IASC, megjithëse paraqitet e publikohet së bashku me IAS, nuk është një IAS, për rrjedhojë nuk përbën një standard për asnjë problem të veçantë të vlerësimit apo të paraqitjes së elementeve

në pasqyrat financiare (PF) të publikueshme. Asgjë nga trajtimet e këtij kuadri nuk del mbi asnjë nga IAS-të e veçanta. Kjo duhet të kuptohet që në ato raste, kur mund të ketë ndonjë konflikt midis trajtimit të bërë një problemi në IAS me trajtimin e po atij problemi në kuadrin konceptual, atëhere mbizotëron kërkesa dhe rregullimi i përcaktuar nga IAS.

Objektivi i Pasqyrave Financiare:

Objektivi i pasqyrave financiare (PF) është të sigurojnë informacionin mbi pozicionin financiar, performancën dhe ndryshimet në pozicionin financiar të ndërmarrjes, i cili është i dobishëm për një gamë të gjerë të përdoruesve në marrjen e vendimeve financiare.

Shtrirja dhe ristrukturimi:

Kuadri konceptual ka të bëjë me përcaktimin për:

- objektivat dhe përbërësit e pasqyrave financiare (PF);
- karakteristikat cilësore të pasqyrave financiare (PF);
- përkufizimet, kriteret e njohjes dhe të matjes së elementeve të pasqyrave financiare (PF);
- konceptet e kapitalit e të ruajtjes së tij.

2.3.1 Objektivat dhe përbërësit e pasqyrave financiare (PF)

Pasqyrat Financiare (PF) duhet të sigurojnë dhe të japin informacion për të plotësuar nevojat e përdoruesve të tyre në vendimmarrjen ekonomike. Këtë informacion pasqyrat financiare (PF) e japin nëpërmjet dhënies së informacionit për:

- pozicionin financiar;
- performancën; dhe
- ndryshimet në pozicionin financiar.

Sipas kuadrit konceptual, të gjitha pjesët përbërëse të pasqyrave financiare (PF) të treguara më sipër duhet të shihen të ndërlidhura midis tyre, sepse ato reflektojnë aspekte të ndryshme të transaksioneve të njëjta ose të ngjarjeve të tjera. Megjithëse çdo pasqyrë siguron informacion i cili është i ndryshëm nga

të tjerët, asnjëra prej tyre nuk duhet të shërbejë si një qëllim i vetëm ose të sigurojë të gjithë informacionin e nevojshëm për nevojat e veçanta të përdoruesve.

Pozicioni financiar paraqitet në pasqyrën e bilancit kontabël. Nëpërmjet pasqyrës së bilancit kontabël sigurohet informacion për gjendjen financiare të një shoqërie, gjendje e cila ndikohet nga:

- burimet ekonomike që ajo kontrollon;
- struktura e saj financiare;
- likuiditeti dhe aftësia e saj paguese;
- aftësia e saj për t'iu përshtatur ndryshimeve të ambientit ku ajo vepron.

Performanca paraqitet në pasqyrën e të ardhurave. Informacioni në lidhje me performancën e një shoqërie dhe në veçanti aftësia e saj për fitim, kërkohet me qëllim që të vlerësohen ndryshimet e mundshme në rezervat ekonomike që ajo ka mundësi të kontrollojë në të ardhmen.

Ndryshimet në pozicionin financiar paraqiten në pasqyrën e flukseve të parasë. Informacioni në lidhje me ndryshimet në gjendjen financiare të një shoqërie është i dobishëm, me qëllim që të vlerësohet aktiviteti i saj investues, financues dhe operativ gjatë periudhës raportuese.

2.3.2 Supozimet bazë dhe karakteristikat cilësore të Pasqyrave Financiare

Supozimet bazë

Në kuadrin konceptual, rregullat që duhet të mbahen parasysh për ndërtimin e pasqyrave financiare (PF) që të plotësojnë kërkesat e nevojat e përdoruesve të tyre, paraqiten në formën e dy supozimeve bazë për ndërtimin e pasqyrave financiare (PF) si dhe të katër cilësive kryesore që duhet të plotësojë informacioni i siguruar nga pasqyrat financiare (PF) vjetore, të publikueshme për këtë qëllim. Dy supozimet bazë shpesh njihen si parimet themelore që janë:

a. Kontabiliteti mbi baza rritëse *(Accrual basis)*.

Sipas këtij supozimi, efektet e transaksioneve dhe të ngjarjeve të tjera njihen kur ato ndodhin (dhe jo kur paratë apo ekuivalente të saj merren ose paguhen) dhe ato regjistrohen në regjistrimet kontabël, dhe pasqyrohen në pasqyrat financiare të periudhës me të cilën ato lidhen.

Pra, kuadri konceptual nuk mbulon rregullat e parimet e ndërtimit të pasqyrave financiare, të ndërtuara mbi baza monetare por vetëm të atyre të ndërtuara mbi baza rritëse.

b. Vijimësia *(Going concern)*.

Sipas kuadrit konceptual, pasqyrat financiare (PF) përgatiten mbi supozimin që njësia është në vijimësi dhe që do të vazhdojë operacionet e saj për një të ardhme të parashikueshme. Kuadri nuk përcakton zgjatjen e periudhës së "ardhme të parashikueshme". Ajo përcaktohet në IAS 1, sipas të cilit periudha optimale është 12 muaj nga data e ndërtimit të Pasqyrave Financiare.

Sipas këtij kuadri, vijimësia ka të bëjë me faktin që njësia nuk ka as qëllimin dhe as nevojën që të likuidojë ose të zvogëlojë materialisht shkallën e operacioneve të saj.

Karakteristikat cilësore të pasqyrave financiare (PF).

Në kuadrin konceptual të IAS, përcaktohen katër karakteristika cilësore bazë që janë: kuptueshmëria, rëndësia, besueshmëria dhe krahasueshmëria.

Në vijim jepet një trajtim shumë i shkurtër i këtyre karakteristikave cilësore:

a. Kuptueshmëria: Sipas kësaj cilësie informacioni i pasqyrave financiare (PF) duhet të jetë i kuptueshëm thjesht dhe shpejt nga përdoruesit. Kjo varet jo vetëm nga paraqitja thjesht dhe kuptueshëm e informacionit por edhe nga aftësitë e përdoruesve, nga njohja e biznesit dhe kontabilitetit

si dhe nga durimi e dëshira për të studiuar me kujdes informacionin. Por, fakti që një informacion nuk është i thjeshtë për t'u kuptuar nga përdoruesit, nuk do të thotë patjetër që ai të mos paraqitet automatikisht në pasqyrat financiare (PF). Nëse hartuesit e pasqyrave financiare (PF) e gjykojnë të rëndësishme që t`i ndihmojnë përdoruesit në vendimmarrje, ai duhet të paraqitet në pasqyrat financiare (PF) pavarësisht nga shkalla e vështirësisë.

b. Rëndësia: Informacioni i pasqyrave financiare (PF) ka cilësinë e të qenurit i rëndësishëm kur ai ndikon vendimet ekonomike të përdoruesve, duke i ndihmuar ata të vlerësojnë ngjarjet e kaluara, të tashme e të ardhme. Rëndësia e informacionit varet nga natyra e tij. Për shembull, ekspozimi i segmenteve të reja të prodhimit mund të ndihmojë në vlerësimin e rrezikut. Por, rëndësia e informacionit shpesh varet jo vetëm nga natyra por edhe nga shkalla e materialitetit të tij. Sipas kuadrit konceptual, një informacion është material në ato raste kur, nëse ai lihet pas dore apo paraqitet në mënyrë të shtrembëruar, atëhere mund të influencojë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të pasqyrave financiare.

c. Besueshmëria: Informacioni i pasqyrave financiare (PF) ka cilësinë e besueshmërisë, kur është i lirë nga gabimet materiale dhe paragjykimet e hartuesit të tij. Besueshmëria e informacionit, si karakteristikë cilësore e tij, varet nga zbatimi i parimeve që vijojnë:

- paraqitja e sinqertë;
- thelbi mbi formën;
- paanshmëria;
- kujdesi;
- plotësia.

Pa nënvlerësuar parimet e mësipërme, parimi i kujdesit është mjaft i rëndësishëm. Sipas kuadrit konceptual, zbatimi i kujdesit në ndërtimin e pasqyrave financiare (PF) nuk lejon krijimin e rezervave të fshehura ose provigjoneve të tepërta, nënvlerësimin e aktiveve dhe të të ardhurave apo mbivlerësimin e detyrimeve dhe të shpenzimeve.

d. Krahasueshmëria: Informacioni i pasqyrave financiare (PF) duhet të jetë i tillë që t'iu sigurojë përdoruesve mundësinë e krahasimit të tij në periudha të ndryshme. Kjo u shërben atyre që të identifikojnë tendencën në pozicionin e saj financiar dhe të performancës. Krahasueshmëria lidhet me qëndrueshmërinë e zbatimit të politikave e metodave kontabël në kohë të ndryshme, në ndërtimin e pasqyrave financiare (PF). Këto politika edhe mund të ndryshojnë nga shoqëria, por me kusht që ajo të japë shpjegimet e duhura në lidhje me politikat dhe metodat e reja të përdorura si dhe me efektin që ato kanë shkaktuar në pasqyrat financiare (PF). Për të siguruar krahasueshmërinë e informacionit është e domosdoshme që të jepen në anekset e Pasqyrave Financiare, politikat kontabile të përdorura nga shoqëria për ndërtimin e tyre.

2.3.3 Përkufizimet, kriteret e njohjes dhe vlerësimi i elementeve të pasqyrave financiare (PF).

Përkufizimet dhe kriteret e njohjes

Përkufizimet	Kriteri i njohjes
Aktivet	
Një aktiv është: • një burim i kontrolluar nga shoqëria; • si rezultat i ngjarjeve të shkuara; • nga të cilat priten të hyjnë në shoqëri përfitime të ardhme.	Një aktiv njihet në bilanc kur plotësohen kushtet: • është e mundur që përfitimi i ardhshëm ekonomik të hyjë në shoqëri; • ai ka një kosto ose vlerë që mund të matet me saktësi.
Detyrimet	
Një detyrim është: • një detyrim i tanishëm i shoqërisë; • i lindur nga ngjarje të kaluara; • shlyerja e të cilit do të sjellë si rezultat një dalje nga shoqëria, të burimeve që përmbajnë përfitime ekonomike.	Një detyrim njihet në bilanc kur plotësohen kushtet: • është e mundur që një dalje e burimeve të cilat mbartin përfitime ekonomike, do të rezultojë nga shlyerja e një detyrimi aktual; • shuma në të cilën shlyerja do të zërë vend mund të matet në mënyrë të besueshme.
Kapitali i vet	
Kapitali neto, është pjesa e mbetur e interesit në aktivet e shoqërisë pasi janë zbritur të gjitha detyrimet.	Aktivet – Detyrimet
Të ardhurat	
Të ardhurat janë: • rritje të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës kontabile në formën e: të hyrave; rritjeve të aktiveve; ose uljes së detyrimeve.	Të ardhurat njihen në pasqyrën e të ardhurave kur: • ka lindur një rritje në përfitimet ekonomike të ardhshme të cilat janë të lidhura me një rritje në aktive ose me një pakësim në detyrime; • rritja në përfitimet ekonomike të mund të matet në mënyrë të besueshme.

Shpenzimet	
Shpenzimet janë: • zvogëlimet në përfitimet ekonomike gjatë periudhës kontabile në formën e: daljes; konsumimit të aktiveve; ose lindjes së detyrimeve.	Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave kur: • shfaqet një rënie në përfitimet ekonomike të ardhme të lidhura me një rënie në një aktiv ose një rritje të një detyrimi; • kjo rënie në përfitimet ekonomike mund të matet në mënyrë të besueshme.

Vlerësimi i elementeve të pasqyrave financiare (PF)

Në kuadrin konceptual përcaktohet që vlerësimi (matja) është procesi i përcaktimit të shumave monetare me të cilat elementet e pasqyrave financiare duhet të njihen dhe të vendosen në bilanc ose në pasqyrën e të ardhurave.

Metodat bazë të vlerësimit që përcaktohen në kuadrin konceptual janë:

a. Kostoja historike. Sipas kësaj metode aktivet regjistrohen me shumën e parave dhe të ekuivalenteve të tyre të paguara ose vlerën e këmbimit (e besueshme) të konsideratës (kundërpartisë) së dhënë për të marrë aktivet në kohën e marrjes. Detyrimet regjistrohen me shumën e parave të marra në këmbim për detyrimin e tyre ose në disa rrethana (për shembull, tatimet e të ardhurave), me shumën e parave ose të ekuivalenteve të tyre, që pritet të paguhen për të plotësuar detyrimin gjatë ecurisë normale të biznesit.
b. Kostoja aktuale. Sipas të cilës aktivet mbarten në bilanc me shumën e parave ose të ekuivalenteve të tyre që do të duhej të paguheshin nëse një aktiv i njëjtë ose një ekuivalent i tij do të merrej aktualisht. Detyrimet mbarten në bilanc në një shumë të pazbritur të parave dhe të ekuivalenteve të tyre, që do të mund të kërkoheshin për të shlyer një detyrim aktual.
c. Vlera e realizueshme (e shlyerjes). Sipas kësaj metode kërkohet që aktivet të mbarten në bilanc me shumën e parave dhe të ekuivalenteve të tyre, që do të mund të merreshin nga shitja e aktiveve gjatë një procesi shitjeje normale. Detyrimet mbarten me vlerën e tyre të

shlyerjes, e cila është sa shumat e pazbritura të parave dhe, ekuivalenteve të tyre, që pritet të paguhen për të plotësuar detyrimet gjatë ecurisë normale të biznesit.

d. Vlera aktuale. Sipas kësaj metode aktivet mbarten në bilanc me vlerën aktuale të diskontuar të hyrjeve neto të ardhme të parave, të cilat pritet që të prodhohen nga elementi i aktivit gjatë ecurisë normale të biznesit. Detyrimet mbarten në bilanc me vlerën aktuale të daljeve neto të ardhme të parave, të cilat priten ose kërkohen për të shlyer detyrimet gjatë ecurisë normale të biznesit.

2.3.4 Koncepti i kapitalit dhe koncepti i mirëmbajtjes së kapitalit

Në kuadrin konceptual jepen dy koncepte bazë në lidhje me kapitalin:

- koncepti financiar i kapitalit;
- koncepti fizik i kapitalit.

Koncepti financiar i kapitalit si për shembull paratë e investuara ose fuqia blerëse e investuar, është sinonim me aktivet neto ose me kapitalin e vet të njësisë. Ky koncept përdoret nga shumica e njësive në procesin e përgatitjes së pasqyrave financiare.

Koncepti fizik i kapitalit si për shembull, aftësia operuese, përfshin mundësitë produktive ku bazohet njësia, për shembull në njësitë e produkteve të prodhuara për një ditë.

Koncepti i ruajtjes së kapitalit ka të bëjë me atë se si një njësi përcakton kapitalin, të cilin ajo kërkon që të mbajë. Kjo siguron lidhjen midis konceptit të kapitalit dhe konceptit të fitimit, sepse ajo siguron pikën e referimit nga e cila llogaritet fitimi. Ajo është një parakusht për dallimin midis kthimit nga kapitali të një njësie dhe kthimit të kapitalit të saj. Vetëm hyrjet e aktiveve më të larta sesa shuma e nevojshme për të ruajtur kapitalin mund të konsiderohen si fitim dhe kështu, edhe si një kthim nga kapitali. Pra, përfitimi është shuma që mbetet pas zbritjes së shpenzimeve nga të ardhurat.

Koncepti i ruajtjes së kapitalit kërkon përdorimin e konceptit të bazës së kostos aktuale të matjes. Koncepti financiar i ruajtjes megjithatë, nuk kërkon përdorim të ndonjë marrëveshjeje të veçantë të matjes.

Sipas konceptit të ruajtjes së kapitalit financiar, ku kapitali përcaktohet në termat e njësisë monetare nominale, fitimi paraqet rritjen e kapitalit në para nominale gjatë periudhës. Kështu, rritjet në çmimet e aktiveve të mbajtura gjatë periudhës të cilat i referohen në mënyrë konvencionale si rritje të mbajtura *(gains)*, janë në koncept fitime. Megjithatë, ato mund të mos njihen si të tilla derisa aktivet të jenë shitur në një transaksion këmbimi.

Sipas konceptit të ruajtjes së kapitalit fizik, ku kapitali përcaktohet në termat e kapacitetit prodhues fizik, fitimi përfaqëson rritjen në kapital gjatë periudhës. Të gjitha ndryshimet e çmimeve që ndikojnë në aktivet e detyrimet e njësisë shikohen si ndryshime në vlerësimin e kapacitetit prodhues fizik të saj; pra ato trajtohen si rregullime të ruajtjes së kapitalit, të cilat janë pjesë e kapitalit dhe jo si fitim.

Zgjedhja e metodës së matjes dhe koncepti i ruajtjes së kapitalit do të përcaktojnë modelin kontabël të përdorur në përgatitjen e pasqyrave financiare. Modele të ndryshme kontabël shfaqin shkallë të ndryshme të rëndësisë dhe të besueshmërisë prandaj, ashtu si në fusha të tjera, administrimi duhet të kërkojë që të gjejë një ekuilibër midis rëndësisë e besueshmërisë.

3. IFRS 1: "ADOPTIMI PËR HERË TË PARË I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR"

Objektivat

IFRS 1. Aplikimi për herë të parë i IFRS, përcakton procedurat që duhet të ndjekë një kompani kur zbaton për herë të parë IFRS për përgatitjen e pasqyrave të saj financiare.

Përkufizimi i "zbatimit për herë të parë"

Një zbatues për herë të parë është një kompani e cila, për herë të parë, shpreh në mënyrë të qartë dhe pa rezerva që pasqyrat financiare janë të përgatitura në përputhje të plotë me IFRS.

Një kompani zbaton për herë të parë IFRS nëse, në vitin paraardhës, ka përgatitur pasqyrat financiare sipas IFRS vetëm për qëllime të administrimit të brendshëm, për aq kohë sa këto pasqyra financiare nuk i janë prezantuar pronarëve apo palëve të treta si investitorë apo kreditues. Nëse, për arsye të ndryshme, kompania në vitet e kaluara ka prezantuar tek palët e interesuara jashtë kompanisë, pasqyra financiare në përputhje me IFRS, atëhere kompania konsiderohet si zbatuese e IFRS-ve dhe nuk aplikohet IFRS 1.

Një kompani, gjithashtu mund të quhet si zbatuese për herë të parë nëse, në vitet paraardhëse, pasqyrat financiare të publikuara shprehin:

- përputhje me disa por jo me të gjitha IFRS;
- një rakordim (rikonsilim) të të dhënave sipas GAAP të mëparshme dhe IFRS. (GAAP të mëparshme nënkuptojnë GAAP që një kompani ka ndjekur direkt para se të zbatonte IFRS.)

Gjithsesi, një kompani nuk konsiderohet se zbaton për herë të parë standardet nëse, në vitin paraardhës, pasqyrat e publikuara financiare shprehin:

- përputhje me IFRS, por raporti i auditorëve shpreh një opinion të kualifikuar në lidhje me përputhjen me IFRS;
- përputhje me GAAP dhe IFRS njëkohësisht.

Data efektive e IFRS 1

IFRS 1 aplikohet për përgatitjen e pasqyrave financiare për herë të parë sipas IFRS, për një periudhë që fillon me 1 janar 2004 apo pas kësaj periudhe. Rekomandohet edhe aplikim më i hershëm.

Një mbikëqyrje për kompanitë që zbatojnë për herë të parë IFRS-të në pasqyrat financiare vjetore për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2005.

1. Politikat kontabël. Zgjedh politikat kontabël bazuar në IFRS në fuqi në 31 dhjetor 2005. (Drafti I IFRS 1 propozon që një kompani mund të përdorë IFRS-të që ishin në fuqi gjatë periudhave të kaluara, sikur kompania të kishte përdorur gjithmonë IFRS. Ky opsion nuk është përfshirë në standardin përfundimtar.)
2. Periudhat e raportimit IFRS. Përgatiten pasqyrat financiare minimalisht për vitet 2005 dhe 2004, dhe ripasqyrohen në retrospektivë bilancet e fillimit të vitit (fillimi i periudhës së parë për të cilën janë prezantuar pasqyra financiare plotësisht të krahasueshme) duke zbatuar IFRS-të në fuqi në 31 dhjetor 2005.

a. Meqenëse IAS 1 kërkon që të prezantohen pasqyrat financiare në baza të krahasueshme për të paktën një vit paraardhës, atëhere bilanci i çeljes do të jetë të paktën 1 janar 2004, nëse jo edhe më parë.
b. Nëse një zbatues për herë të parë në 31 dhjetor 2005, raporton disa të dhëna financiare (por jo plotësisht pasqyrat financiare) në bazë të IFRS për periudha para vitit 2004, si plotësim të pasqyrave financiare për vitet 2004 dhe 2005, kjo nuk e ndryshon faktin që bilanci i hapjes sipas IFRS është 1 janar 2004.

Sistemime të domosdoshme për të lëvizur nga GAAP të mëparshme në IFRS, për shkak të zbatimit për herë të parë.

1. Nxjerrja jashtë bilancit e disa mjeteve dhe detyrimeve të vjetra. Kompania duhet të eliminojë nga bilanci i hapjes disa mjete dhe detyrime të mbajtura sipas GAAP të mëparshme, nëse ato nuk cilësohen si të tilla sipas IFRS. Për shembull:

a. AS 38 nuk lejon njohjen e shpenzimeve sa më poshtë nëse lidhen me një mjet të paprekshëm (*intangible asset*):

- faza e kërkimeve;
- faza e përgatitjes (*start-up*), si dhe kostot e shkaktuara

para fillimit të veprimit;
- trainimet;
- reklamat dhe promocionet;
- zhvendosjet dhe rishpërndarjet.

Nëse GAAP të mëparshme, të përdorura nga kompania i njihnin këta zëra si asete, ata duhet të eliminohen në bilancin e hapjes sipas IFRS.

b. Nëse GAAP të mëparshme, të përdorura nga kompania, lejonin rrjedhshmërinë (*accrual*) e detyrimeve në "rezerva të përgjithshme", ristrukturimi, humbjet operative të ardhshme apo zëra të ngjashëm, që nën IAS 37 nuk përmbushin kriteret për njohje si provigjone, këto eliminohen në bilancin e hapjes IFRS.
c. Nëse GAAP të mëparshme, të përdorura nga kompania lejonin njohjen e rimbursimeve dhe aktivet "me kusht" (*contingent*) që nuk janë të sigurta, këto eliminohen nga bilanci i hapjes IFRS.

2. Njohja e disa mjeteve dhe detyrimeve të reja. Në të kundërt, kompania duhet të njohë të gjitha mjetet dhe detyrimet që janë të domosdoshme të njihen në bazë të IFRS edhe nëse nuk janë njohur kurrë si të tilla në bazë të GAAP. Për shembull:
a. IAS 39 kërkon njohjen e të gjitha derivativeve si mjete dhe detyrime financiare, përfshirë dhe derivativet e ndërmjetme. Këto nuk njihen nga shumë GAAP të vendeve të ndryshme.
b. IAS 19 kërkon që kompania të njohë detyrimet e veta, që lindin si plane përfitimesh të caktuara. Këtu nuk përfshihen vetëm detyrimet për pensione por gjithashtu, detyrimet mjekësore dhe për jetën, për pushimet, për përfundimin e kontratës, si dhe për kompensime të ngjashme. Në rastin e një plani "*over-funded*", do të kemi të bëjmë me një aktiv përfitimesh të përcaktuara.
c. IAS 37 kërkon njohjen e provigjoneve si detyrime. Shembuj të tillë mund të jenë: detyrimet e një kompanie për ristrukturim, për kontrata me probleme, për

zhdëmtimet, për rialokime të pjesshme, për garancitë, si dhe për çështjet gjyqësore.

d. Aktivet dhe pasivet në lidhje me taksat e shtyra duhet të njihen në përputhje me IAS 12.

3. Riklasifikimi. Kompania duhet të riklasifikojë bilancin e hapjes për vitin e kaluar, të përgatitur në bazë të GAAP, sipas klasifikimeve përkatëse të IFRS. Shembuj:

a. IAS 10 nuk lejon klasifikimin e dividentëve të deklaruar apo të propozuar pas datës të bilancit si detyrime në datën e bilancit. Në bilancin e hapjes sipas IFRS ato do të riklasifikohen si një zë i fitimit të mbajtur (*ratained earnings*).

b. Nëse GAAP të përdorura nga kompania në të kaluarën lejonin që aksionet e thesarit (aksionet e vetë kompanisë që ajo i ka blerë) të raportohen si mjete, ato do të riklasifikohen si një përbërës i kapitalit sipas IFRS-ve.

c. Zërat e klasifikuar si mjete të paprekshme (të patrupëzuara) të përcaktuar në një kombinim biznesesh që raportojnë sipas GAAP të mëparshme, mund të kërkohet të klasifikohen si emër i mirë (*goodwill*) në përputhje me IAS 22, meqënëse ata nuk përmbushin kriteret për një mjet të paprekshëm në IAS 38. Por, gjithashtu e kundërta mund të jetë e vërtetë në disa raste. Këto objekte duhet të riklasifikohen.

d. IAS 32 ka disa kritere për klasifikimin e instrumenteve si detyrime apo kapital financiar. Kështu, aksionet e preferueshme të detyruara për t`u shkëmbyer si dhe aksionet e thirrshme që mund të jenë klasifikuar si kapital sipas GAAP, duhet të riklasifikohen si detyrime në bilancin e hapjes sipas IFRS.

- Vihet re që IFRS 1 bën një përjashtim nga provigjonet e "*split-accounting*" të IAS 32. Nëse pjesa e detyrimit të një instrumenti financiar të përbërë, nuk ekziston më në datën e bilancit të hapjes sipas IFRS, kompania nuk është e detyruar të riklasifikojë si kapitale të tjera (nga fitimi i mbajtur) pjesën fillestare të kapitalit të instrumentit të përbërë.

e. Parimi i riklasifikimit duhet të aplikohet për qëllime të

raportimit të segmentuar në IAS 14.

f. Qëllimi i konsolidimit mund të ndryshojë në varësi të përputhjes së kërkesave GAAP të mëparshme me ato të IAS 27. Në disa raste, IFRS do të kërkojnë pasqyra financiare të konsoliduara edhe nëse nuk ishin të nevojshme më parë.

g. Disa netime të mjeteve dhe detyrimeve apo të ardhurave dhe shpenzimeve që ishin të lejueshme nën GAAP të mëparshme, mund të mos lejohen më sipas IFRS.

4. Matja. Parimi kryesor i matjes - ekzistojnë disa përjashtime të rëndësishme të shprehura më poshtë - është aplikimi i IFRS në matjen e të gjitha mjeteve dhe detyrimeve të njohura. Pra, nëse një kompani zbaton për herë të parë IFRS në pasyrat financiare vjetore për fundvitin 31 dhjetor 2005, në përgjithësi duhet të përdorë parimet e matjes në fuqi sipas IFRS në datën 31 dhjetor 2005.

5. Rregullimet e nevojshme për të kaluar nga GAAP të mëparshme tek IFRS në momentin e zbatimit për herë të parë. Këto duhet të njihen direkt në fitimet e mbajtura apo në zëra të tjerë të përshtatshëm të kapitalit, në datën e transferimit tek IFRS.

Si të njohim këto sistemime të kërkuara për të kaluar nga GAAP tek IFRS?

Sistemimet e nevojshme për të kaluar nga GAAP tek IFRS në zbatimin për herë të parë të tyre, duhet të njihen direkt në fitimet e mbajtura ose nëse është e përshtatshme, në një kategori tjetër të kapitalit në datën e kalimit në IFRS.

Përjashtime nga parimi kryesor i matjes në IFRS 1

1. Përjashtime opsionale. Ekzistojnë disa përjashtime të rëndësishme në lidhje me parimet kryesore të pasqyrimit dhe matjes, të shprehura më poshtë. Këto përjashtime janë individualisht opsionale, jo të detyrueshme:

Kombinimet e biznesit që kanë ndodhur përpara datës së bilancit të hapjes.

a. Një kompani mund të mbajë kontabilitetin sipas GAAP të mëparshme, domethënë të mos ripasqyrojë:
- bashkimet e mëparshme apo emrin e mirë të zbritur nga rezervat;
- vlerën e mbartur të mjeteve dhe detyrimeve të njohura në datën e blerjes apo të bashkimit;
- si ishte përcaktuar fillimisht emri i mirë.

b. IFRS 1 përfshin një aneks që shpjegon se si një zbatues për herë të parë duhet të raportojë për bashkimin e biznesit që ka ndodhur para kalimit në IFRS.

c. Pavarësisht nëse dëshiron të realizojë apo jo, kompania mund të zgjedhë të ripasqyrojë të gjithë kombinimin e biznesit, duke filluar që nga data që zgjedh para datës së bilancit të hapjes.

d. Në çdo rast, kompania duhet të realizojë një test fillestar të aftësisë mospaguese sipas IAS 36, të emrit të mirë të mbetur në bilancin e hapjes sipas IFRS, pasi të ketë riklasifikuar mjetet e paprekshme tek emri i mirë (në rastet e nevojshme).

Pasuritë, toka dhe pajisjet, mjetet e paprekshme dhe pasuritë e investueshme të mbajtura me modelin e kostos.

a. Këto mjete mund të maten me "*fair value*" në datën e bilancit të hapjes sipas IFRS (ky opsion aplikohet për mjetet e paprekshme vetëm nëse ekziston një treg aktiv). Vlera e saktë (*fair value*) kthehet në "koston e besueshme", duke shkuar drejt modelit të kostos në IFRS. (Kosto e besueshme-*Deemed cost*, është një shumë e përdorur si një zëvendësuese për koston apo koston e zhvlerësuar në një datë të dhënë.)

b. Nëse, para datës së hartimit për herë të parë të bilancit sipas IFRS-ve, kompania ka bërë vlerësimin e ndonjë mjeti sipas GAAP të mëparshme, me vlerën e saktë (*fair value*) apo me koston e axhustuar sipas çmimit, atëherë kjo shumë e rivlerësuar do të përbëjë edhe koston e

besueshme të mjetit sipas IFRS.

c. Nëse, para datës së hartimit për herë të parë të bilancit sipas IFRS-ve, kompania ka bërë një rivlerësim të vetëm të mjeteve dhe detyrimeve me vlerën e saktë, për shkak të privatizimit apo fillimit të një oferte publike, dhe kjo shumë e rivlerësuar bëhet kosto e besueshme sipas GAAP të mëparshme, kjo shumë (e sistemuar për çdo zhvlerësim apo amortizim në vazhdim apo paaftësi kthimi) do të vazhdojë të përbëjë koston e besueshme edhe pas adoptimit të IFRS.

IAS 19 – Përfitimet e punonjësve: fitim – humbjet aktuariale

Një kompani mund të zgjedhë të njohë gjithë fitim - humbjet aktuariale progresive për të gjitha planet me përfitime të përcaktuara, në datën e hapjes së bilancit sipas IFRS (domethënë, të rivendosë çdo korridor të njohur sipas GAAP në zero), edhe nëse zgjedh të përdorë tek IAS 19 trajtimin sipas korridorit për fitim – humbjet aktuariale, që rrjedhin pas zbatimit për herë të parë të IFRS. Nëse një kompani nuk zgjedh të zbatojë këtë model, duhet të ripasqyrojë të gjitha planet me përfitime të përcaktuara sipas IAS 19, që nga krijimi i këtyre planeve (të cilat mund të ndryshojnë nga data efektive për IAS 19).

IAS 21 – Rezervat e këmbimit të akumuluara.

Një kompani mund të zgjedhë të njohë të gjitha rregullimet e këmbimit që rrjedhin nga konvertimi i pasqyrave financiare të kompanive të huaja, në fitim – humbje të akumuluar në datën e bilancit sipas IFRS-ve (domethënë, t`i ripasqyrojë rezervat nga këmbimi, të përfshira në zërin e kapitalit sipas GAAP të mëparshme, në nivelin zero). Nëse kompania zgjedh këtë model, fitimi apo humbja në vlerësimet e mëvonshme të njësisë së huaj do të sistemohen vetëm nëpërmjet sistemimeve të këmbimit të akumuluara, të krijuara pas hapjes së bilancit sipas IFRS. Nëse kompania nuk zgjedh të përdorë këtë model, duhet të ripasqyrojë rezervat nga këmbimet në valutë të huaj që nga momenti i blerjes apo i krijimit të tyre.

2. Përjashtime të detyrueshme. Ekzistojnë gjithashtu edhe tre përjashtime të rëndësishme përsa i përket parimeve të përgjithshme të matjes dhe ripasqyrimit, të cilat përshkruhen më poshtë, dhe që janë të detyrueshme për kompanitë dhe jo opsionale. Këto janë:

IAS 39 – Nxjerrja jashtë bilancit e instrumenteve financiare.

Një zbatues për herë të parë i IFRS-ve nuk është i lejuar të njohë mjetet apo detyrimet financiare që janë nxjerrë jashtë bilancit sipas GAAP të mëparshme, në një vit financiar që fillon para 1 janarit 2001 (data efektive e IAS 39). Ky përjashtim është në përputhje me IAS 39.172(a).

IAS 39 – Kontabiliteti i instrumenteve mbrojtëse (*Hedge accounting*)

Kushtet në IAS 39.122-152 që një marrëdhënie mbrojtjeje të kualifikohet si kontabilizim i instrumenteve mbrojtëse, aplikohen edhe në datën e hapjes së bilancit sipas IFRS. Praktikat ekzistuese "*hedge accounting*", nëse ka, të përdorura në periudhat para datës së hapjes së bilancit sipas IFRS, nuk duhet të ndryshohen në retrospektivë. Kjo është në përputhje me IAS 39.172(b). Disa sistemime mund të jenë të nevojshme për të përllogaritur marrëdhëniet ekzistuese *hedging*, të regjistruara sipas GAAP të mëparshme në datën e hapjes së bilancit sipas IFRS.

Informacioni që duhet përdorur në përgatitjen e parashikimeve IFRS në retrospektivë.

Në përgatitjen e parashikimeve në retrospektivë në përputhje me IFRS, kompania duhet të përdorë burimet dhe supozimet që janë përdorur në parashikimet sipas GAAP të mëparshme, në periudhat para kalimit tek IFRS, duke u siguruar që këto burime dhe supozime janë në përputhje me IFRS. Kompania nuk është e lejuar të përdorë informacione që janë siguruar pas parashikimeve të bëra sipas GAAP të mëparshme, përveçse për të korrigjuar ndonjë gabim.

Ndryshime në paraqitjen e shënimeve.

Për shumë kompani, do të shtohen shënime të reja për publikim, të cilat nuk ishin të domosdoshme sipas GAAP të mëparshme (ndoshta segmentimi i informacioneve, fitimet për aksion, angazhimet dhe vlera e saktë e të gjitha instrumenteve financiare) dhe disa publikime që kërkoheshin edhe nga GAAP të mëparshme, do të detajohen më shumë (për shembull, shënimet mbi palët e lidhura).

Prezantimi i disa të dhënave financiare për periudhat para bilancit të parë sipas IFRS.

IAS 1 kërkon vetëm një vit të plotë pasqyrash financiare të krahasueshme. Nëse një zbatues për herë të parë, dëshiron të prezantojë disa informacione financiare për periudha para datës së hapjes së bilancit sipas IFRS, nuk është e domosdoshme të përshtasë këto informacione me IFRS. Përputhja e informacioneve financiare të mëparshme me IFRS është fakultative.

Nëse kompania zgjedh të prezantojë disa informacione financiare të mëparshme, bazuar në GAAP të mëparshme dhe jo në IFRS, duhet të theksojë në prezantimin e tyre se nuk janë në përputhje me IFRS dhe, për më tepër, duhet të prezantojë natyrën e sistemimeve kryesore që do ta bënin këtë informacion të jetë në përputhje me IFRS. Këto shënime kanë natyrë përshkruese dhe jo sasiore.

Natyrisht, nëse kompania zgjedh të prezantojë më shumë se një vit krahasues për pasqyrat financiare në momentin e zbatimit të IFRS, kjo do ta ndryshojë datën e bilancit të hapjes sipas IFRS.

Prezantimet në paqyrat financiare për zbatuesit për herë të parë.

IFRS 1 kërkon prezantimin e shënimeve që shpjegojnë se si kalimi nga GAAP të mëparshme në IFRS, ka ndikuar në pozicionin financiar të kompanisë që raporton, në performancën financiare, si dhe në rrjedhën e *cash*-it. Kjo përfshin:

a. Rakordimin e kapitalit të raportuar sipas GAAP të mëparshëm me atë sipas IFRS njëkohësisht (a) në datën e hapjes së bilancit sipas IFRS; dhe (b) në datën e periudhës së fundit raportuese sipas GAAP të mëparshme. Për një kompani që zbaton IFRS për herë të parë në pasqyrat financiare të 31 dhjetorit 2005, rikonsilimi duhet të bëhet për 1 janarin 2004 dhe 31 dhjetorin 2004.
b. Rakordimin e fitim/humbjeve për periudhën e fundit raportuese sipas GAAP të mëparshme me fitim/humbjet sipas IFRS për të njëjtën periudhë.
c. Shpjegimin e sistemimeve materiale që janë bërë, në zbatimin për herë të parë të IFRS në bilanc, në pasqyrën e rezultatit dhe në pasqyrën *cash flow*.
d. Nëse evidentohen gabime në pasqyrat financiare sipas GAAP të mëparshme, për periudhën e kalimit nga GAAP në IFRS, këto gabime duhet të prezantohen në mënyrë të ndarë.

Prezantim të çdo ndryshimi të ardhshëm në IFRS

Nëse një kompani do të fillojë të zbatojë IFRS për herë të parë në pasqyrat financiare të fundvitit 31 dhjetor 2005, disa shënime janë të domosdoshme që në pasqyrat financiare të ndërmjetme para 31 dhjetor 2005, por vetëm në pasqyrat financiare të hartuara në përputhje me IAS 34. Pra, në raportet e ndërmjetme që paraprijnë pasqyrat financiare të vitit ku janë zbatuar për herë të parë IFRS, kërkohen informacione shpjeguese dhe një rikonsilim. Ky informacion përfshin ndryshimet në politikat kontabël krahasuar me ato sipas GAAP të mëparshme.

Përputhja në raportet e ndërmjetme në vitin e zbatimit për herë të parë të IFRS.

Një kompani që zbaton për herë të parë IFRS në pasqyrat financiare për fundvitin 31 dhjetor 2005, duhet të aplikojë IFRS 1 në raportet financiare të ndërmjetme në vitin që mbaron në 31 dhjetor 2005, nëse raportet e ndërmjetme janë përshkruar në përputhje me IFRS. Nuk është e domosdoshme të zbatohen IFRS 1, nëse këto raporte të ndërmjetme janë përshkruar në përputhje me GAAP të mëparshme.

Zbatimi i IFRS në data të ndryshme për investuesin dhe për kompaninë ku investohet.

Një kompani prind apo investuese mund të bëhet zbatuese për herë të parë, më parë në kohë apo pas filialeve, shoqërive apo kompanive me pjesëmarrje të përbashkët. Në këtë rast, IFRS 1 aplikohet si më poshtë:

a. Nëse filiali ka zbatuar IFRS në pasqyrat financiare të njësisë përpara se grupi të cilit i përket t`i zbatojë në konsolidimin e pasqyrave financiare, data e zbatimit për herë të parë të IFRS për filialin do të jetë data e zbatimit prej saj të IFRS dhe jo data kur kompania mëmë, konsolidon pasqyrat financiare sipas IFRS. Gjithsesi, grupi duhet të përdorë matjet sipas IFRS për mjetet dhe detyrimet.
b. Nëse grupi zbaton IFRS përpara se filialet të zbatojnë IFRS në pasqyrat e tyre financiare, filiali ka dy mundësi: të zgjedhë që data e zbatimit të IFRS nga grupi të jetë edhe data e zbatimit të IFRS për herë të parë; ose të zbatojë për herë të parë në pasqyrat e veta financiare IFRS.
c. Nëse grupi zbaton IFRS para se kompania-mëmë të zbatojë IFRS në pasqyrat e saja financiare, data e zbatimit për herë të parë të IFRS te kompania-mëmë, do të jetë dhe data në të cilën grupi zbaton IFRS për herë të parë.
d. Nëse grupi zbaton IFRS para se shoqëria apo bashkëpronësia (*associate or joint venture*) zbaton IFRS në pasqyrat e saja financiare, shoqëria apo bashkëpronësia duhet të ketë mundësinë të zgjedhë ose që data e zbatimit të IFRS nga grupi të jetë dhe data e tyre e transferimit, ose të zbatojë për herë të parë IFRS në pasqyrat e saj financiare.

Zbatimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit të pasqyrave financiare (të njohura ndryshe si IAS/IFRS) në sistemin bankar, dikton nevojën që bankat të ndërtojnë, të miratojnë dhe të zbatojnë politika të caktuara të cilat shërbejnë për t'i orientuar drejt përshtatjes me këto ndryshime. Këto politika

duhet të pasohen me procedura të shkruara për mënyrën se si banka dhe personeli i saj do të njihet me këto zhvillime, cilat do të jenë strukturat që do të evidentojnë ndryshimet e nevojshme që duhet të kryhen, si do të kryhen këto ndryshime, në çfarë periudhe kohore dhe cilat janë problemet që mund të dalin, cilat do të jenë strukturat që do të monitorojnë procesin etj.. E konsiderojmë të rëndësishme që banka të kalojë në zbatimin e këtyre standardeve, vetëm pasi të ketë vlerësuar dhe maksimizuar përparësitë që ofrojnë këto zhvillime, si edhe pasi të ketë marrë masat e nevojshme për të minimizuar disavantazhet e mundshme.

Është e rëndësishme që krahas vetë bankave dhe institucioneve të tjera financiare, të gjitha institucionet e tjera të vendit, të cilat kanë rol në zbatimin në praktikë të standardeve të përmendura në paragrafin e mësipërm, të kenë një strategji të qartë për mënyrën se si do të realizojnë këtë rol dhe objektivat e tyre. Krahas Bankës së Shqipërisë, këto institucione përfshijnë Ministrinë e Financave, Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit, Institutin e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar dhe kompanitë më kryesore në këtë fushë etj.. Në këtë kuadër, është i nevojshëm të institucionalizohet një proces i përbashkët diskutimi, ku institucionet të diskutojnë problemet që do të dalin në fazën e zbatimit të këtyre standardeve, në mënyrë që problemet të kuptohen dhe qëndrimi ndaj zgjidhjeve të tyre të jetë i harmonizuar dhe i qëndrueshëm në kohë.

---

* Përgatiti: Ibrahim Buharaja, specialist, Departamenti i Mbikëqyrjes.

[1] Marrë nga UK GAAP, Davies, Paterson & Wilson, Ernst & Young.

Investime të huaja direkte. Shënime metodologjike
Argita Frashëri
Anjeza Hobdari
Mars 2006

Vlerësimi i investimeve të huaja direkte në vendet me ekonomi në zhvillim të Evropës Lindore: rasti i Shqipërisë
Endrita Xhaferaj
Qershor 2006

Roli i Bankës së Shqipërisë në procesin e integrimit evropian
Elvis Çibuku
Qershor 2006

Investimet e huaja direkte në Shqipëri (viti fiskal 2004)
Argita Frashëri
Qershor 2006

2006

Çështje të Bashkimit Monetar Evropian dhe Kriteret e Paktit të Stabilitetit dhe Rritjes
Bledar Hoda
Shtator 2006

Mbi gjetjet e misionit ROSC për shpërndarjen e të dhënave statistikore mars – prill 2006
Hilda Shijaku
Kliti Ceca
Dhjetor 2006

Vendet në tranzicion dhe Shqipëria
Elvana Troqe
Dhjetor 2006

INVESTIME TË HUAJA DIREKTE. SHËNIME METODOLOGJIKE

*Argita Frashëri**
Anjeza Hobdari

Fjalë kyçe
- Investimet e Huaja Direkte - Transaksion - Pozicioni Ndërkombëtar i Investimeve -

ABSTRAKT

Njohja e vlerave të Investimeve të Huaja Direkte (IHD) si mjet për nxitjen e investimeve, nënvizon nevojën për matje të saktë dhe statistika të detajuara të IHD-ve për vlerësimin e lidhjes së tyre me rritjen ekonomike si dhe impaktin në sektorë të ndryshëm ekonomikë. Përmes një kuadri gjithëpërfshirës teorik ky material ofron njohjen me konceptet dhe përkufizimet e IHD-ve, përbërësit e tyre, format me të cilat prezantohen e deri tek burimet dhe metodat e mbledhjes së informacionit. Gjithashtu, në të diskutohen mekanizmat institucionalë lidhur me raportimin e të dhënave, të cilët janë thelbësorë në garantimin e cilësisë të të dhënave. Disa probleme në matje janë përmbledhur.

Matja dhe regjistrimi i IHD-ve në vendin tonë ka qenë dhe mbetet një sfidë në arritjen e niveleve bashkëkohore të vendeve të zhvilluara për ofrimin e statistikave cilësore dhe të krahasueshme.

AKRONIME DHE SHKURTIME

IHD	*Investim i Huaj Direkt*
OECD	*Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (Organisation for Economic Co-operation and Development)*
FMN	*Fondi Monetar Ndërkombëtar*

PNI	*Pozicioni Ndërkombëtar i Investimeve*
BP	*Bilanci i Pagesave*
SPK	*Sistemi Plotësisht i Konsoliduar*
M&A	*Shkrirje dhe Përvetësim (Mergers and Acquisitions)*
SPE	*Njësitë për Qëllime të Veçanta (Special Purpose Entities)*
ITRS	*Sistemi i Raportimit të Transaksioneve me Jashtë (International Transactions Reporting System)*
BSH	*Banka e Shqipërisë*

1. HYRJE

Roli i Investimeve të Huaja Direkte (IHD) në zhvillimin ekonomik të një vendi është debatuar gjerësisht, shoqëruar me qëndrime pro dhe kundër. Shumë vende i kanë mirëpritur IHD-të si një kontribut thelbësor në proceset e zhvillimit dhe të lehtësimit të hyrjes në ekonominë botërore, duke i vlerësuar në një kontekst të gjerë reformash strategjike për ristrukturim ekonomik dhe zhvillim.

Studime empirike pranojnë rolin e IHD-ve në rritjen ekonomike dhe zhvillimin e vendeve pritëse, sidomos për ekonomitë në zhvillim. Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, fluksi i investimeve të huaja direkte ka luajtur një rol të rëndësishëm në rritje të produktivitetit, të prodhimit, të punësimit dhe të eksporteve të ekonomive në tranzicion.

Edhe në kontekstin e ekonomive në tranzicion drejt një ekonomie tregu dhe në prirjet e integrimit ekonomik dhe globalizimit, zgjerimit të flukseve ndërkombëtare të kapitalit, lëvizjes së lirë të individëve, të mallrave e shërbimeve dhe të zhvendosjes së teknologjive, investimet e huaja janë parë me përparësi në të mirë të ekonomisë në tërësi.

Efekte të shumta pozitive lidhen me këto transferta të kapitalit, të cilat i dallojnë ato dukshëm nga forma të tjera të flukseve private të kapitalit. Importimi i teknologjive të reja dhe i strategjive të drejtimit, ofrimi i lehtësive hyrëse në tregjet financiare ndërkombëtare, janë ndër përparësitë gjerësisht

të pranuara lidhur me investimet e huaja direkte. Veç kësaj, IHD është gjithashtu i prirur të jetë relativisht një angazhim i qëndrueshëm afatgjatë në interes të kompanisë së huaj. Të gjitha këto së bashku janë të dobishme për rritjen ekonomike të vendeve pritëse dhe për pakësimin e rrezikut nga jashtë. Në këto kushte, deficitet e larta korente janë më të qëndrueshme për sa kohë ato financohen në masën më të madhe nga IHD, në vend të huamarrjes bankare ose investimeve të portofolit, të cilat së bashku njihen të jenë tepër të paqëndrueshme.

IHD janë një tregues kritik edhe për integrimin e Shqipërisë në ndarjen globale të punës si dhe për nivelin e përgjithshëm të zhvillimit. Megjithatë, analizat e procesit të integrimit kërkojnë procedura të harmonizuara në hartimin dhe shpërndarjen e tyre.

Në Shqipëri, përveç përparësisë për hartimin e një kuadri institucional për nxitjen e investimeve të huaja në vend, një domosdoshmëri e kohës është matja e saktë e tyre.

Në përputhje me standardet ndërkombëtare, IHD vlerësohen si për stokun ashtu edhe për flukset e kapitalit që sjellin në ekonomi. Ndërsa stoku jep informacion për shkallën e prezencës së një firme apo një vendi në një ekonomi të huaj, fluksi i IHD-ve përdoret për vlerësimin e qëndrueshmërisë së zhvillimeve të bilancit të pagesave.

Investimet e Huaja Direkte nga këndvështrimi i Bilancit të Pagesave dhe i Pozicionit Ndërkombëtar të Investimeve ndajnë të njëjtët kuadër konceptualë të përcaktuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar. Në këtë kontekst, Bilanci i Pagesave është një paraqitje statistikore e cila në mënyrë sistematike dhe për një periudhë të caktuar kohore, pasqyron transaksionet ekonomike të një ekonomie me pjesën tjetër të botës (transaksionet ndërmjet rezidentëve dhe jorezidentëve) dhe Pozicioni Ndërkombëtar i Investimeve përpilon për një ditë të caktuar, siç është dita e fundit e vitit, vlerën e stokut për secilin mjet dhe detyrim financiar të përcaktuar në përbërësit standardë të bilancit të pagesave.

Më poshtë, kemi një pamje të përgjithshme të bilancit të pagesave në nivel makroekonomik. IHD ndodhen në kategorinë e detyrimeve, meqë ato përfaqësojnë pronësinë e huaj në kontrollin e kompanisë, në një vend të caktuar. Në krahasim me huamarrjen bankare ose me investimet e portofolit jashtë, IHD janë përgjithësisht më të qëndrueshme.

Grafik 1. Bilanci i Pagesave dhe IHD.



Materiali është organizuar si në vazhdim: seksionet 2, 3 dhe 4 japin një përmbledhje të përkufizimeve, koncepteve dhe të rekomandimeve të pranuara nga FMN (në Manualin e Bilancit të Pagesave – Botimi i 5-të) dhe nga OECD – "*Benchmark Definition of Foreign Direct Investment* (1996)" mbi Investimin e Huaj Direkt. Të dyja këto botime ofrojnë një udhërrëfyes operacional si dhe standarde të detajuara për regjistrimin e flukseve dhe stokut që lidhen me IHD-të. Seksioni 5 trajton dhe përshkruan format e investimit direkt, të hasura më shpesh si dhe raste të veçanta, të cilat kërkojnë plotësimin e disa kushteve për t'u klasifikuar si IHD. Identifikimi dhe njohja e formave të IHD-ve janë të rëndësishme për hartimin e statistikave të investimeve të huaja direkte në përputhje me standardet. Në seksionin 6 përshkruhen mënyra të ndryshme të mbledhjes së të dhënave për statistikat e IHD-ve. Zgjedhja ndërmjet metodave të ndryshme për sigurimin e informacionit është vendimtare për shkallën e saktësisë të statistikave të IHD-ve si dhe në zbatimin e standardeve ndërkombëtare.

2. ÇFARË ËSHTË NJË INVESTIM I HUAJ DIREKT?

Koncepti i IHD ka pësuar ndryshime në vite. Historikisht, një kufi i caktuar pjesëmarrjeje me kapital dhe ideja që investitori planifikon të shfaqë influencë kontrolli në kompani, kanë qenë ngushtësisht të lidhura me kuptimin e IHD.

Me qëllim harmonizimin e dallimeve në konceptin e IHD-ve, OECD dhe FMN kanë zhvilluar një përcaktim të përbashkët: "...investimi i huaj direkt reflekton qëllimin e sigurimit të një interesi të qëndrueshëm nga një njësi rezidente e një ekonomie (investitor direkt) në një njësi rezidente të një tjetër ekonomie (ndërmarrje e investimit direkt)". "Interesi i qëndrueshëm" nënkupton ekzistencën e një marrëdhënieje afagjatë ndërmjet investitorit direkt dhe ndërmarrjes së investimit direkt si dhe një shkallë të rëndësishme influence në drejtimin e kësaj të fundit (OECD 1999, shtojca IV, fq.88).

Përkufizimi i mësipërm në vetvete nuk specifikon se çfarë përbën në të vërtetë një interes të qëndrueshëm. Megjithatë, ky i fundit vihet në dukje në zbatimin e rekomandimeve të OECD-së. OECD rekomandon "....një pjesëmarrje reale në drejtim, si tregues i pronësisë në të paktën 10%, nënkupton që investitori direkt ndikon ose merr pjesë në drejtimin e ndërmarrjes; ajo nuk kërkon kontroll absolut nga investitori i huaj[1]...". Në përputhje më këtë, marrëveshjet e pashoqëruara me zotërimin e të paktën 10%, por që lejojnë ushtrimin e kontrollit (si për shembull, nënkontraktimet, licencat dhe eskluzivitetet) nuk përfshihen në përkufizimin e OECD-së dhe FMN-së.

Investimi direkt përfshin së bashku transaksionin fillestar për vendosjen e marrëdhënies ndërmjet investitorit dhe ndërmarrjes, dhe të gjitha transaksionet kapitale pasuese ndërmjet tyre dhe ndërmjet filialeve, pavarësisht formës ligjore në të cilën janë regjistruar – si persona juridikë apo persona fizikë. Duhet patur parasysh që transaksionet kapitale të cilat nuk iniciojnë asnjë marrëveshje të mirëfilltë, për shembull, një ndërkëmbim i aksioneve ndërmjet kompanive simotra, duhet gjithashtu të regjistrohet në BP dhe PNI.

Botimi i Pestë i Manualit të Bilancit të Pagesave të FMN-së përcakton si investitor direkt pronarin e 10 për qind ose më shumë të kapitalit të një kompanie. FMN rekomandon përdorimin e kësaj përqindjeje si kufi ndarjeje ndërmjet investimit direkt dhe investimit të portofolit si pjesëmarrje në aksione. Kështu, kur një jorezident, i cili nuk ka pjesëmarrje të mëparshme në kapitalin e një ndërmarrjeje rezidente, blen 10% ose më shumë aksione të kësaj ndërmarrjeje, çmimi i aksioneve të siguruara duhet të regjistrohet si investim direkt. Nga ky moment, transaksionet e kapitalit të mëpastajme ndërmjet këtyre dy kompanive duhet të regjistrohen si investim direkt. Në rastet kur një jorezident zotëron më pak se 10% të aksioneve të një ndërmarrjeje si investim portofoli, dhe më pas siguron (blen) aksione shtesë duke kaluar kështu në një pozicion investimi direkt (10% ose më shumë), si investim direkt në bilancin e pagesave do të regjistrohet vetëm blerja e aksioneve shtesë. Në këtë rast, titujt e siguruar më parë nuk duhet të riklasifikohen nga investim portofoli në investim direkt në bilancin e pagesave, por për vlerën totale të titujve duhet të ketë një riklasifikim në Pozicionin Ndërkombëtar të Investimeve.

Termat "investitor direkt" dhe "ndërmarrje e investimit direkt", FMN-ja dhe OECD-ja i përkufizojnë kështu: Një investitor direkt mund të jetë individ, person juridik[2], person fizik[3], ndërmarrje publike, një qeveri, një grup individësh ose një grup personash juridikë dhe/ose personash fizikë, të cilët zotërojnë një ndërmarrje investimi direkt, me aktivitet në një vend jashtë vendit të rezidencës së investitorit direkt. Një ndërmarrje investimi direkt është një person juridik apo person fizik, në të cilën një investitor i huaj ka në pronësi 10% ose më shumë të aksioneve ose të fuqisë votuese të një shoqërie tregtare ose ekuivalentin te një ortakëri.

Ndërmarrjet e investimit direkt mund të jenë filiale[4], shoqëri simotra ose degë. Një filial është në vetvete një shoqëri tregtare në të cilën investitori i huaj kontrollon direkt ose indirekt (nëpërmjet një tjetër filiali), më shumë se 50% të fuqisë votuese në aksione. Një shoqëri simotër, është një kompani në të cilën investitori direkt dhe filialet e tij kontrollojnë ndërmjet 10-50% të fuqisë

votuese. Një degë (shoqëritë e kontrolluara) është një kompani me pronësi totale ose bashkërisht të huaj. Duhet theksuar që zgjedhja ndërmjet krijimit të një nga formave të lartpërmendura në një shtet të huaj, varet mbi të gjitha nga baza rregullative e vendit pritës (në disa raste edhe nga baza rregullative e vendit të origjinës).



Boks 1. Investimet e huaja direkte në legjislacionin shqiptar.

Bazuar në kuadrin ligjor shqiptar, ndërmarrje të investimit direkt mund të jenë personat juridikë (ligji nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare") dhe personat fizikë (neni 2 i ligjit nr. 7632, datë 4.11.1992 "Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të kodit tregtar)".

Personat juridikë janë në formën e përcaktuar në nenin 2 të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare": shoqëritë kolektive, shoqëritë komandite, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë anonime, të cilat fitojnë personalitet juridik me regjistrimin e tyre në gjykatë.

Një formë tjetër e këtyre ndërmarrjeve mund të konsiderohet edhe shoqëria e thjeshtë, forma e të cilës përcaktohet në nenin 1074 të Kodit Civil dhe në vazhdim. Në bazë të nenit 1075 të Kodit Civil, shoqëria është e thjeshtë kur nuk paraqitet në cilësitë dalluese të shoqërisë tregtare, të rregulluara në ligjin nr. 7638 të lartpërmendur. Dallimi kryesor ndërmjet tyre është se pavarësisht emërtimit të saj me termin

"shoqëri", ajo nuk ka personalitet juridik pasi është një kontratë me të cilën dy a më shumë persona merren vesh për të ushtruar aktivitet ekonomik, me qëllim që të ndajnë fitimet që rrjedhin prej tij.

Format e zotërimit të aksioneve në rastin e shoqërive tregtare janë filiali (neni 217), shoqëritë pjesëmarrëse apo simotra (neni 218) dhe shoqëritë e kontrolluara.

Investimi direkt i huaj në këto shoqëri në bazë të ligjit "Për shoqëritë tregtare" mund të kryhet:

- *me pjesëmarrje në kapitalin themeltar që në krijimin e shoqërisë;*
- *me transferim të pjesëve të kapitalit themeltar në përputhje me kërkesat e këtij ligji në rastin e çdo forme të shoqërive tregtare (për shembull, nenet 23, 33, 45, 47 etj.);*
- *me zmadhim të kapitalit;*
- *në raste të bashkimit ose të ndarjes (neni 243) dhe në vazhdim.*

Në rastet e shoqërive të thjeshta, bazuar në nenin 1076, investimi direkt mund të kryhet kur në kontratë parashikohet që anëtarët e saj do të kontribuojnë në pjesë jo të barabarta me para, sende apo shërbime (neni 1074).

Në rastin e shitblerjes së tokës nga rezidentët shqiptarë, bazuar në legjislacionin shqiptar dhe në kuptimin e investimit direkt të lartpërmendur, personat fizikë a juridikë të huaj që kryejnë ose kanë kryer investime në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjin nr.7764 , datë 2.11.1993 "Për investimet e huaja", kanë të drejtë të blejnë truall për investime, pronë shtetërore ose private, ose truallin e investimeve të kryera ose në kryerje e sipër. Personave fizikë a juridikë të huaj iu lind e drejta të blejnë truall pasi të kenë arritur kryerjen e investimit në përputhje me lejen e ndërtimit, deri në një vlerë jo më të vogël se tre herë vlera e truallit, sipas përcaktimit të Këshillit të Ministrave (Neni 5 i ligjit nr. 7980, datë 27.07.1995 "Për shitblerjen e trojeve".).

Pasi janë bërë pronarë të truallit sipas kushteve të mësipërme, atëherë kemi të bëjmë me transferimin e pronësisë një njësie rezidente imagjinare. Personi fizik a juridik i huaj (jorezidenti) si pasojë ka një investim financiar në këtë njësi rezidente (përveç investimit të kryer mbi truall), e cila presupozohet të jetë një ndërmarrje me investim direkt.

Duhet përmendur që në rastet e bankave filiale (institucione depozituese) dhe filialeve të ndërmjetësimeve financiare si agjentë të letrave me vlerë, transaksionet e regjistruara nën investime direkte, janë të shoqëruara me borxh të vazhdueshëm (dhënie hua e kapitalit duke përfaqësuar një interes të qëndrueshëm) dhe me investim kapital (kapitali aksionar) ose, në rastin e degëve, me mjete fikse. Depozitat, huatë dhe të tjera pretendime dhe detyrime të lidhura me transaksionet e zakonshme bankare të institucioneve depozituese dhe të të tjerëve ndërmjetësues financiarë, janë të klasifikuara nën zërat "investime portofoli" ose "investime të tjera", dhe jo si investim direkt. Gjendja (stoku) e mjeteve dhe e detyrimeve të huaja të bankave dhe ndërmjetësve të tjerë financiarë, duhen trajtuar paralelisht.

Për marrëdhëniet e investimit direkt, OECD rekomandon zbatimin e "sistemit plotësisht të konsoliduar" (shih boksin më poshtë). Me fjalë të tjera, kjo nënkupton përcaktimin e marrëdhënieve në rastet e një pjesëmarrjeje të përshkallëzuar. Kështu, ndërmarrjet e investimit direkt të cilat janë në një marrëdhënie investimi direkt me një investitor direkt gëzojnë, gjithashtu, një marrëdhënie të tillë me njëra - tjetrën (boks 2.) Ky kriter nuk korrespondon me konceptin e konsolidimit në bilancet kontabile.

Boks 2. Sistemi Plotësisht i Konsoliduar (Fully Consolidated System).

Sistemi Plotësisht i Konsoliduar (SPK) përfshin:

- *Degët.*
- *Filialet (më shumë se 50% pronësi direkte nga investitori direkt) për shembull, A dhe K.*
- *Shoqëritë simotra (10% - 50% pronësi direkte nga investitori direkt) për shembull, D dhe F.*
- *Filialet e filialeve për shembull, B dhe L.*
- *Filialet e shoqërive simotra për shembull, E.*
- *Shoqëritë simotra të filialeve për shembull, C.*



Në skemën e mësipërme, ndërmarrjet A, B, C, D, E, F, K dhe L janë të gjitha të ndërlidhura me ndërmarrjen N – edhe pse për shembull, kompania N zotëron në mënyrë indirekte vetëm 4% të kompanisë C.

SPK përjashton:

- *Ndërmarrjet në të cilat investitori direkt zotëron më pak se 10% për shembull, H.*
- *Ortakëritë e atyre ndërmarrjeve ku investitori direkt zotëron më pak se 10%, për shembull, J.*
- *Ortakëritë e ortakërive të investitorit direkt, për shembull, G.*

Në shembullin e mëposhtëm:

- *Ndërmarrjet H dhe J nuk janë në marrëdhënie investimi direkt me ndërmarrjen N, sepse kjo e fundit zotëron më pak se 10% të ndërmarrjes H.*
- *Ndërmarrja G nuk është marrëdhënie investimi direkt me ndërmarrjen N, sepse ndërmarrja G është ortake e ortakes së N.*

Kujtojmë se, nëse një ndërmarrje ka një marrëdhënie investimi direkt me N, ajo është gjithashtu, në marrëdhënie investimi direkt me të gjitha ndërmarrjet e tjera që kanë një lidhje të tillë me N. Për shembull, C ka marrëdhënie direkte me A, B, D, E, F, K, dhe L, ashtu si edhe me N.

Një përfundim i rëndësishëm i këtij rregulli është se të dhënat e IHD-ve duhet të përfshijnë të gjitha transaksionet/pozicionet direkte ndërmjet ndërmarrjeve në ekonomi të ndryshme, të cilat kanë marrëdhënie investimi direkt - duke përfshirë këtu edhe ndërmarrjet që kanë të njëjtin investitor direkt, por që nuk kanë lidhje pronësie me njëra-tjetrën.

3. KLASIFIKIMI I INVESTIMIT DIREKT, PËRBËRËSIT DHE SHPËRNDARJA SEKTORIALE

Klasifikimi i investimit direkt bazohet së pari, në drejtimin e investimit – si për mjetet ashtu edhe për detyrimet; së dyti, në instrumentet e përdorura për investimin (aksione, hua etj.) dhe së treti, në shpërndarjen sektoriale.

Sipas drejtimit, ai shqyrtohet nga këndvështrimi i vendit të origjinës dhe i vendit pritës. Nga këndvështrimi i vendit të origjinës, çdo financim jashtë kufijve i bërë nga kompania-mëmë rezidente për filialet e saj jorezidente, përfshihet si investim direkt jashtë. Në të kundërt, çdo financim jashtë kufijve nga filialet, shoqëritë simotra dhe degët jorezidente për kompaninë-mëmë rezidente, klasifikohet si një rënie në investimet direkte jashtë, dhe jo si një investim i huaj direkt. Nga këndvështrimi i vendit pritës, financimet e ndërmarra nga kompanitë mëma jorezidente për filialet, për shoqëritë simotra dhe për degët e tyre rezidente do të regjistrohen, në vendin e rezidencës së kompanisë së varur, nën zërin investime të huaja direkte dhe financimet e ndërmarra nga filialet, shoqëritë simotra dhe degët rezidente për kompanitë e tyre mëma jorezidente, do të klasifikohen si një zvogëlim i investimeve të huaja direkte dhe jo si një investim direkt jashtë.

Sipas instrumenteve, kapitali i investimit direkt përfshin kapitalin e siguruar (direkt ose nëpërmjet ndërmarrjeve të lidhura) nga një investitor direkt tek ndërmarrja e investimit direkt dhe kapitalin e pranuar nga një investitor direkt nga një sipërmarrje e investimit direkt. Në transaksionet e kapitalit të një investimi direkt dallojmë tre përbërës bazë: (i) Kapitali i themelimit: përfshirë kapitalin në degë, të gjitha aksionet në filiale dhe shoqëritë simotra, dhe të tjera kontribute kapitali si makineritë etj.. (ii) Fitimet e riinvestuara: përbëhen nga përqindja e investitorit direkt (proporcionalisht sipas pjesëmarrjes në kapitalin e nënshkruar) në fitimet e pashpërndara si dividentë, nga filialet, shoqëritë simotra dhe fitimet e degëve jo të dërguara tek investitori direkt. Nëse këto fitime nuk janë të identifikuara, me marrëveshje fitimi i të gjitha degëve do të konsiderohet si i shpërndarë. (iii)

Kapitale të tjera të investimit direkt (ose transaksionet e borxhit ndërmjet kompanive): mbulojnë huamarrjen dhe huadhënien e fondeve, duke përfshirë letrat e borxhit dhe kreditë tregtare, ndërmjet investitorit direkt dhe sipërmarrjes së investimit direkt si dhe ndërmjet dy ndërmarrjeve të investimit direkt që ndajnë të njëjtin investitor direkt. Siç është përmendur edhe më sipër, depozitat dhe huatë ndërmjet institucioneve të varura depozituese regjistrohen si investime të tjera dhe jo si investim direkt.

Një shpjegim më specifik lidhur me përkufizimin dhe përllogaritjen e flukseve të IHD-ve për bilancin e pagesave dhe stokut për PNI do ta gjeni në boksin bashkëngjitur (boks 3.).

Boks 3. Përkufizimi dhe përllogaritja e fluksit dhe stokut të IHD-ve.

Në përcaktimin e fluksit të investimeve të huaja direkte, për periudhë raportuese në bilancin e pagesave, përfshihen:

- *për filialet dhe kompanitë simotra:*

(i) pjesa e investitorit direkt në fitimet e riinvestuara (fitimet e mbartura për vitin pasardhës dhe fitimet e vitit ushtrimor – të cilat nuk janë ndarë si dividentë). Kjo pjesë përcaktohet proporcionalisht në bazë të aksioneve përkatëse të aksionerëve direktë individualë në kapitalin e nënshkruar (kapitali nominal);
(ii) plus blerjen neto të aksioneve të tjera shtesë, letra me vlerë të borxhit dhe huadhënie (përfshirë ato jomonetare, makineri, të drejta për prodhim etj.) për kompaninë nga investitori direkt;
(iii) minus blerjen neto të aksioneve, letra me vlerë të borxhit dhe huadhënie investitorit direkt nga kompania;
(iv) plus rritjen neto të kredisë tregtare dhe të tjera kredi afatshkurtra të dhëna nga investitori direkt për kompaninë.

- *për degët:*

(i) rritja në fitimet e riinvestuara;
(ii) plus rritja neto e fondeve të marra nga investitori direkt;
(iii) plus flukset monetare ndërmjet kompanive të varura, me përjashtim të disa flukseve ndërmjet bankave filiale, filialeve të ndërmjetësimit (për shembull, tregtuesit e letrave më vlerë) dhe Special Purpose Entities (SPE), të cilat kanë si objekt të vetëm ndërmjetësimin financiar.
Pozicionet ndërkombëtare të investimeve përcaktohen si më poshtë:

- *për filialet dhe kompanitë simotra:*

(i) vlera e tregut ose kontabile (në bilancin kontabël) e aksioneve dhe rezervës së detyruar atribut i investitorit direkt;
(ii) plus hua, kredi tregtare dhe letra me vlerë të borxhit të emetuara nga investitori direkt (përfshirë këtu dividentët e përcaktuar dhe jo të shpërndarë);
(iii) minus shlyerjen e huasë, kredisë tregtare dhe letrave me vlerë të borxhit.

- *për degët:*

(i) vlera e tregut ose kontabile e mjeteve fikse, e investimeve dhe e mjeteve qarkulluese, përjashtuar shumat për t'u paguar nga investitori direkt;
(ii) minus detyrimet e degëve ndaj të tretëve.

Regjistrimi i pozicioneve, sipas rekomandimeve të FMN-së duhet të kryhet bazuar në parimin e drejtimit (përkatësisht si mjet/detyrim), i cili merr parasysh statusin e ndërmarrjes. Në këtë kontekst, vendi (origjina) i investitorëve direktë regjistron të gjitha transaksionet kapitale me ndërmarrjet e investimit direkt nën "investime direkte jashtë", ndërsa vendi i ndërmarrjes së investimit direkt regjistron të gjitha transaksionet e kapitalit me investitorët e huaj nën "investime direkte në ekonominë raportuese".

Për më tepër FMN, rekomandon që pozicionet duhet të llogariten bazuar në çmimin e tregut të periudhës përkatëse të raportimit. Pozicionet e dala nga bilancet kontabile të investitorëve direktë dhe ndërmarrjeve të investimit direkt (vlera kontabile), përfaqësojnë një përafrim të kënaqshëm të vlerave të tregut. Kështu, në shumicën e rasteve këto dy grupe të dhënash (vlerat kontabile dhe vlerat e tregut) mund të jenë të përshtatshme.

Përfundimisht, ka disa mënyra të shpërndarjes sektoriale të flukseve të Investimit të Huaj Direkt dhe Pozicionit Ndërkombëtar të Investimeve. FMN ka zgjedhur paraqitjen sipas katër organizmave (shih tabelën 1 më poshtë), nisur nga sektori të cilit i takon grupi rezident. Megjithatë, raportimi sipas kësaj ndarjeje sektoriale nuk është i detyrueshëm në Manualin e 5 të FMN-së.

Ndryshe nga klasifikimi sipas organizmave sektoriale, OECD favorizon një shpërndarje sipas sektorëve "industrialë" (shih tabelën 1 më poshtë), e cila përfshin nëntë sektorë ekonomikë. Për këtë klasifikim, OECD rekomandon që IHD-të e ndërmarra nëpërmjet një kompanie rezidente të klasifikohen në atë sektor industrial në të cilin përfshihet kompania-mëmë. Sipas këtij kriteri, kur kompania-mëmë është një bankë, transaksionet e IHD-ve të ndërmarra nga kompani jobanka duhet t'u ngarkohen bankave.

Tabelë 1. Shpërndarja sektoriale e IHD-ve sipas FMN dhe OECD.

Klasifikimi sipas FMN	Klasifikimi sipas OECD
1. Autoriteti Monetar. 2. Bankat. 3. Qeveria e Përgjithshme. 4. Sektorë të tjerë.	1. Bujqësi, pyje, gjueti, peshkim. 2. Shfrytëzim minierash dhe guroresh. 3. Industri përpunuese. 4. Elektricitet, gaz dhe ujë. 5. Ndërtim. 6. Tregti me shumicë dhe pakicë, restorante dhe hotele. 7. Transport, magazinim dhe komunikim. 8. Financim, pasuri e patundshme dhe shërbime biznesi. 9. Bashkësi, shërbime sociale dhe personale.

4. VLERËSIMI I FLUKSEVE DHE I STOKUT TË IHD-VE DHE LIDHJA NDËRMJET TYRE.

Bilanci i pagesave dhe Pozicioni Ndërkombëtar i Investimeve hartohen bazuar në të njëjtin kuadër metodologjik rregullash, të përcaktuar në Botimin e 5-të të Manualit të Bilancit të Pagesave të FMN-së. Sipas këtij të fundit, transaksionet e IHD-ve duhet të regjistrohen në Bilancin e Pagesave në vlera të përllogaritura, "..transaksionet janë të regjistruara kur vlera ekonomike është krijuar, transformuar, këmbyer, transferuar ose fikur..". Në praktikë, është shumë i vështirë zbatimi i parimeve të përllogaritjes në të gjitha transaksionet dhe si pasojë, shumë nga to janë të regjistruara në kohën kur të ardhurat ose pagesat, janë gjeneruar.

Veç kësaj, FMN rekomandon përdorimin e çmimit të tregut si bazë për vlerësimin e flukseve dhe të stoqeve, ndonëse kjo nënkupton trajtime të ndryshme për të dy këto tipe të dhënash:

(i) për flukset, çmimi i tregut i referohet çmimit aktual të rënë dakord ndërmjet palëve në ditën e transaksionit dhe nuk duhet të reflektojë ndryshimet e mundshme, të krijuara nga luhatjet e kursit të këmbimit ose të çmimit të tregut të mjeteve dhe detyrimeve financiare në fjalë. (ii) Për stoqet, rekomandohet çmimi i tregut në kohën e përpilimit të stoqeve. Megjithatë, në praktikë është pranuar përdorimi i vlerave të marra nga bilancet kontabile të kompanive të investimit direkt, si një përafrim i çmimit të tregut për stokun e investimit direkt kur kjo kompani nuk ka një çmim tregu. Këto vlera nëse janë të regjistruara bazuar në vlerën korente të tregut, do të konsiderohen në përputhje me këtë parim. Nëse bazohen në kostot historike ose në rivlerësimin për një periudhë kohore, vlera të tilla kontabile nuk janë konform këtij parimi. Megjithatë, duhet thënë se vlerat kontabile përfaqësojnë burimin e vetëm të mundshëm për vlerësimin e mjeteve dhe detyrimeve në të shumtat e vendeve.

Diferenca ndërmjet stokut në fillim të vitit dhe vlerës së tij në ditën e fundit të vitit duhet të jetë e barabartë me fluksin e regjistruar në bilancin e pagesave, i cili reflekton transaksionet në këto mjete dhe detyrime të zhvilluara gjatë vitit; plus ndryshimet në vlerën e stokut si pasojë e lëkundjeve në kursin e këmbimit; plus ndryshimet e shkaktuara nga modifikimet në çmimet e mjeteve dhe detyrimeve; dhe plus të tjera ndryshime në vëllimin e mjeteve dhe detyrimeve financiare. Në mënyrë të përmbledhur:

Pozicioni në fund të periudhës = pozicioni në fillim të periudhës + flukset e IHD-ve + ndryshimet në çmime + ndryshimet nga kursi i këmbimit + axhustime të tjera.

Përsa i përket "axhustimeve të tjera", megjithëse disa nga ato mund të shpjegohen nga përdorimi i burimeve të ndryshme për përpilimin e këtyre statistikave, më kryesoret janë ato që lidhen me riklasifikimin në Pozicionin Ndërkombëtar të Investimeve (jo në bilancin e pagesave) për shembull, nga investim portofoli në investim direkt, siç u shpjegua në pjesën e dytë.

Megjithë zbatimin e një kuadri të përbashkët metodologjik në përcaktimin e këtyre flukseve, mospërputhjet në krahasimin

e të dhënave ndërkombëtare janë të konsiderueshme. Në fakt, në shkallë botërore mospërputhja ndërmjet flukseve hyrëse dhe dalëse të investimeve direkte duhet të jetë zero, nëse këto flukse janë regjistruar totalisht dhe në përputhje në të dyja krahët. Megjithatë, sipas Lipsey (2001) "asimetritë kanë qenë jo më të larta se 8% për çdo vit të studiuar nga viti 1993, në kontrast me 40 ose 50 për qind për investimet e portofolit".

Mospërputhjet lindin kryesisht nga kriteret e ndryshme të përdorura në vlerësimin e flukseve ose shpërndarjen gjeografike të transaksioneve.

Shmangiet më të shpeshta shkaktohen nga mungesa e informacionit për fitimet e riinvestuara. Këto të fundit, ndryshe nga flukset e njëanshme të kapitalit apo shpërndarja e dividentëve, nuk iniciojnë asnjë transaksion valutor, i cili mund të kanalizohet nëpërmjet sistemit bankar. Si pasojë, vendet të cilat përdorin si burim kryesor informacionin bankar dhe jo raportimet direkte nga kompanitë e investimit direkt dhe ndërmarrjet e tyre të varura, nuk kanë të dhëna mbi fitimin e riinvestuar.

Boks 4. Regjistrimi i fitimit të riinvestuar në bilancin e pagesave.

Rëndësia e identifikimit të fitimit të riinvestuar, theksohet nga fakti që kjo përbën mundësinë e vetme për regjistrimin e të ardhurave të kompanive në bilancin e pagesave si dhe në zërat përkatës në PNI. Nga këndvështrimi ekonomik, kontabilizimi i fitimeve të riinvestuara nuk ndikon zhvillimet aktuale dhe ekuilibrin e jashtëm të ekonomisë kombëtare. Megjithatë, ai siguron një kuadër më të detajuar të rolit që luajnë IHD në ekonomi, sasinë e të ardhurave si dhe mënyrën e shpërndarjes.

Standardet ndërkombëtare përkufizojnë dy trajtime të veçanta, duke u bazuar në mënyrën e matjes së të ardhurave të korporatave: të ardhurat mund të (i) përfshijnë të gjithë përbërësit e fitimit, si për shembull, fitimet ose humbjet nga kurset e këmbimit ose humbjet që lidhen me zbritjen e pretendimeve; (ii) përjashtojnë këto të fundit dhe mbështeten vetëm në fitimin e thjeshtë. Metodologjitë ndërkombëtare

rekomandojnë trajtimin e fundit.

Regjistrimi i të ardhurave ndaj kapitalit të investimit të huaj direkt në statistikat e bilancit të pagesave kërkon informacionin e mëposhtëm:

- vitin dhe fitimin (ose humbjen) neto të ndërmarrjes me investim të huaj direkt, pas tatimit;
- kohën e regjistrimit dhe dividentin e deklaruar të pagueshëm nga investitorët;
- tatimin e dividentit të pagueshëm;
- kohën e pagesës së dividentit aktual.

Përgjigjet ndaj pyetjeve mbi kohën e regjistrimit mund të ndihmojnë në identifikimin e periudhës së kontabilizimit për shembull, periudha në të cilën transaksioni në fjalë pasqyrohet në bilancin e pagesave.

Sipas kësaj:
-Fitimi (ose humbja) pas tatimit i investitorëve të huaj direktë mund të regjistrohet si fitim i riinvestuar në bilancin e pagesave për vitin në të cilin është fituar realisht.
-Dividentët duhet të regjistrohen si një komponent i të ardhurave në rastin kur ata deklarohen si të pagueshëm. Kur merren së bashku, bëhet një dallim i rëndësishëm ndërmjet fitimit si një përfitim nga aktiviteti i kompanisë dhe futjes së dividentit si rezultat i vendimit të pronarëve. Dividentët e deklaruar si të pagueshëm pakësojnë fitimet e riinvestuara për vitin në fjalë në llogarinë korente dhe atë kapitale. Dividentët e shpërndarë, por akoma të papaguar gjithashtu përfaqësojnë një detyrim afatshkurtër kundrejt investuesit; si rezultat, në llogarinë financiare të bilancit të pagesave ata regjistrohen në zërin "kapitale të tjera" brenda investimeve të huaja direkte.
- Pasi investitorët kanë shpërndarë fitimin pas tatimit, ata duhet të paguajnë taksën për dividentët e deklaruar të pagueshëm. Pas kësaj, pretendimi i qeverisë (zë i bilancit të pagesave) kundrejt investitorit, zëvendësohet me pretendimin e ndërmarrjes kundrejt investitorit në llogarinë financiare, si pasqyrim i të ardhurave (taksat) të regjistruara si transfertë korente.
- Në momentin kur dividentët paguhen, transferta barazon dividentin e deklaruar të pagueshëm neto. Pra, si detyrimi (i lindur si pasojë e dividentit të shpërndarë, por të papaguar) ashtu edhe pretendimi ndaj investitorit (për shembull, taksa e dividentit paguar qeverisë)

likuidohen. Me fjalë të tjera, në momentin kur kryhet pagesa nuk ekzistojnë më komponentë të llogarisë korente, të dyja anët e transfertës ndikojnë vetëm llogarinë financiare.

Regjistrimi i fitimit neto të ndërmarrjeve si fitim i riinvestuar, tregon se si ndikon investimi direkt në bilancin e llogarisë korente nëpërmjet llogarisë së të ardhurave. Megjithatë, vendimi i pronarëve në lidhje me shpërndarjen e të ardhurave (me përjashtim të efektit indirekt të taksës mbi dividentin) dhe pagesës së dividentëve, nuk ka efekt në bilancin e llogarisë korente, pra, nuk ndikon në marrëdhëniet kursime – investime në ekonominë kombëtare.

Statistikat e bazuara në rekomandimet metodologjike ndërkombëtare, mund të kompilohen në bazë vjetore pas përpunimit të pyetësorëve përkatës, të plotësuar nga bilancet kontabël dhe pasqyrat financiare fitim – humbje të ndërmarrjeve. Në këto statistika, të dhënat mbi fitimet e riinvestuara, dividentët dhe të ardhurat e tjera të shpërndara mbi kapitalin, janë vlerësime.

5. FORMAT E INVESTIMIT DIREKT

Përvetësimi nga investitori direkt i pjesës së kontrollit në një kompani të vendosur në një territor ekonomik të ndryshëm nga vendi i origjinës, mund të marrë forma të ndryshme.

Ka dallim ndërmjet sigurimit të një interesi të qëndrueshëm në një ndërmarrje ekzistuese në formën e shkrirjes apo të përvetësimit, të njohura si *Mergers & Acquisitions* – (M&A) dhe krijimit të një njësie të re prodhimi (investimet *greenfield*).

Në realitet, IHD është një fluks heterogjen mjetesh financiare që përfshin së bashku, investimet e reja ("investimet *greenfield*"), të cilat përfaqësojnë një shtim neto të stokut të kapitalit në vendin pritës dhe investimet direkte në formën e përvetësimit apo shkrirjes, të cilat përfaqësojnë një ndryshim në pronësinë e kapaciteteve ekzistuese të prodhimit në ekonominë pritëse.

Besohet që "investimet *greenfield*" janë më të dobishme për një ekonomi meqë sigurojnë mjete të reja. Megjithatë, në disa vende si për shembull, ekonomitë në tranzicion, "M&A" mund të jenë më të dëshirueshme. Një arsye për këtë mund të jetë që flukset e "M&A" në këto ekonomi janë të lidhura me programin e privatizimit.

Formë e investimit direkt janë edhe fitimet e riinvestuara nga investitorët ekzistues në fusha të ndryshme nga ajo e fitimeve (aktivitetit) të tyre. Megjithëse nuk përfaqësojnë një fluks të ri kapitali hyrës, kjo formë investimi rrit stokun e kapitalit dhe mjeteve në vend, si dhe rrit kapacitetin e prodhueshmërisë së tij. Huatë ndërmjet ndërmarrjeve janë një tjetër formë e IHD në një ekonomi. Zakonisht ato zëvendësojnë një fluks kapitali nga mëma (jashtë) tek bija. Ky "borxh" meqë ripaguhet nga kjo e fundit së bashku me interesin, përbën një fluks dalës më të madh se hyrësi. Kjo formë investimi nuk është me interes për vendet e ndryshme edhe pse ndihmon në financimin e biznesit të investitorit direkt, duke mundësuar vazhdimësinë e kontributit të tij në ekonominë vendase.

Ndërkohë që të njohura janë edhe format jokapitale të IHD-ve që përfshijnë licencat, marrëveshjet ekskluzive etj.. Këto forma nuk përmbajnë detyrimisht flukse kapitali nga jashtë, megjithatë kontributi i tyre në zhvillimin ekonomik është i rëndësishëm.

Përveç këtyre formave të investimit, ekzistojnë dhe raste të veçanta të cilat kërkojnë plotësimin e disa kushteve të veçanta për t'u klasifikuar si investime të huaja direkte. Identifikimi dhe njohja e tyre është shumë e rëndësishme për hartimin e statistikave të investimeve të huaja direkte në përputhje me standardet.

Boks 5. Raste të veçanta të Investimeve të Huaja Direkte.

-Offshore – Janë ndërmarrje që merren me montimin ose grumbullimin e artikujve të prodhuar jashtë vendit. Zakonisht ato përpunojnë mallra për eksporte, merren me aktivitet tregtar dhe me veprimtari financiare.

Këto kompani përqendrohen në "zona të veçanta tregtare", "zona të tregtisë së lirë" ose zona me "parajsë" fiskale (me një nivel shumë të ulët taksash, madje për disa biznese edhe pa taksa).

Në të dhënat e IHD-ve, rezidenca e ndërmarrjeve "offshore" lidhet me ekonomitë në të cilat veprojnë, pavarësisht nëse përfitojnë apo jo privilegje nga autoritetet vendore si për shembull, përjashtimi nga taksat, nga tarifat apo nga detyrimet doganore.

- Pothuajse - korporatat (Quasi – corporations) janë ndërmarrje të cilat ofrojnë mallra dhe shërbime në një vend tjetër, ku nuk kanë status ligjor të veçantë. Këto ndërmarrje të cilat kanë marrëdhënie investimi direkt me mëmën, do të quhen IHD nëse:

1. Prodhimi është i vazhdueshëm për më tepër se një vit.
2. Mbahet libër i veçantë llogarish për veprimtaritë lokale.
3. Taksa mbi të ardhurat paguhet në vendin pritës, jo në vendin e origjinës.

Shembuj për këtë tip ndërmarrjesh janë ato të ndërtimit[1] ose ndërmarrjet[2] e lëvizshme.

- Njësitë për Qëllime të Veçanta (Special Purpose Entities (SPE))[3], në përgjithësi janë të organizuara ose të vendosura jashtë ekonomive në të cilat janë rezidente ndërmarrjet mëmë. Ato merren kryesisht me transaksione ndërkombëtare, me pak ose aspak transaksione lokale. Special Purpose Entities emërohen ato struktura ligjore, të cilat kanë pak ose nuk kanë fuqi punëtore, aktivitete ose prezencë fizike në sistemin juridik të vendit, ku janë krijuar. Ato përdoren përgjithësisht si mekanizma për të zotëruar mjete dhe detyrime dhe nuk janë kompani prodhuese në vetvete. Si mekanizma ligjorë, SPE- të nuk kanë kosto të lartë në themelim, shfrytëzojnë financiarisht detyrimet rregullatore dhe privilegjet konfidenciale. Themelimi i tyre është shpesh i shoqëruar me qendra financiare "offshore" ose sipas rregullave ligjorë specifikë të ekonomisë në të cilën ndodhen.

SPE- të përcaktohen nga struktura (për shembull, kompani bazë, zyrat qendrore rajonale etj.) dhe qëllimi i tyre (për shembull, administrimi i shitjeve, administrimi i rrezikut valutor, ndihmë në financimin e investimit etj.).

SPE-të trajtohen si ndërmarrje me investim direkt dhe përfshihen në të dhënat e IHD, nëse plotësojnë kriterin e 10 përqindëshit të pronësisë.

- Ndërmjetësueset financiare që përkufizohen si: institucione të tjera depozituese (banka të nivelit të dytë); ndërmjetësuese të tjera financiare përveç kompanive të sigurimit dhe fondeve të pensionit; institucione të tjera financiare (për shembull, agjentë sigurimesh); SPE për qëllime ndërmjetësimi financiar dhe/ose për shërbime ndihmëse.

Transaksionet ndërmjet ndërmjetësueseve financiare (për shembull, ndërmjetësueset financiare të cilat janë në marrëdhënie investimi direkt) duhet të përjashtohen nga të dhënat e IHD-ve, përveç transaksioneve në formë kapitali ose borxhi të qëndrueshëm.

- Shitblerja e tokës nga rezidentët[4]. Me marrëveshje, në bilancin e pagesave të gjitha trojet brenda territorit të një ekonomie, përveç atyre të zotëruara nga qeveritë e huaja (si për shembull, ambasadat) konsiderohen si pronë e rezidentëve.

Nëse pronari aktual i një trualli është jorezident, presupozohet se pronësia i është transferuar një njësie institucionale rezidente imagjinare, e cila zotëron këtë truall dhe/ose ndërtesë.

Jorezidenti si pasojë, ka një investim financiar në këtë njësi rezidente imagjinare, e cila presupozohet të jetë një ndërmarrje me investim direkt.

Shitblerja e truallit (ose e një ndërtese mbi këtë truall) nga jorezidentët duhet të përfshihet në IHD si kapital themelimi.

- Eksplorimi i burimeve natyrore[5]. Shpenzimet për zbulime ose kërkime të burimeve natyrore (për shembull, naftës) nga jorezidentët duhet të regjistrohen në IHD si kapital i themelimit. Pagesat e një investitori direkt për të drejtën e eksplorimit të burimeve natyrore të një ekonomie, duhet të regjistrohen në IHD si kapital themelimi, nëse duket qartë synimi për të krijuar një ndërmarrje investimi direkt në këtë ekonomi.

Nëse kërkimet për burime natyrore rezultojnë të pasuksesshme

(për shembull, pus i tharë nafte etj.) dhe përfundojnë në mbylljen e ndërmarrjes atëherë:

-nuk duhet të regjistrohen hyrje të mëtejshme në të dhënat e IHD e BOP;
-duhet të bëhen rregullime negative (me shenjë të kundërt) në të dhënat e Pozicionit Ndërkombëtar të Investimeve (PNI) dhe IHD-ve për të dyja vendet.

---

[1] Paragrafet 545 – 548 të BOP Textbook dhe 712 – 717 të BOP Compilation Guide, japin shembuj për ndërmarrjet e ndërtimit. Paragrafi 545: Një punë e marrë përsipër nga një kompani ndërtimi në një ekonomi, mund të jetë (i) punë e kryer nga një ndërmarrje imagjinare rezidente dhe e angazhuar në marrëdhënie investimi direkt me kompaninë-mëmë ose; (ii) shërbim i importuar nga ekonomia vendase. Përcaktimi i ekonomisë të cilës i atribuohet prodhimi është shumë i rëndësishëm. Nëse një kompani ndodhet ose parashikon të jetë në një ekonomi për më shumë se një vit dhe regjistrimet e veprimtarisë së saj janë bërë në këtë ekonomi, atëhere edhe prodhimi i atribuohet po kësaj ekonomie. Pra në këtë rast, në këtë ekonomi krijohet një kompani e re me investim të huaj direkt. Në të kundërt, nuk kemi të bëjmë me ndërmarrje me investim direkt dhe në bilancin e pagesave të ekonomisë në fjalë, transaksionet e kompanisë do të prekin zërin importe në llogarinë korente.
[2] Paragrafet 552 – 554 në BOP Textbook japin shembuj për trajtimin e ndërmarrjeve lëvizëse në bilancin e pagesave.
[3] Paragrafet 542 – 544 në BOP Textbook, japin shembuj për trajtimin e SPE-ve në bilancin e pagesave.
[4] Paragrafet 550-551 nga BOP Textbook dhe 718-722 nga BOP Compilation Guide, japin shembuj për trajtimin e këtyre rasteve në bilancin e pagesave.
[5] Shih http://www.imf.org/external/np/sta/bop/biblio.htm

6. METODA TË MBLEDHJES SË TË DHËNAVE TË INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE

Matja e saktë e investimeve të huaja direkte është shumë e rëndësishme në përcaktimin e fluksit dhe të stokut të IHD-ve. Ka tri mënyra për mbledhjen e të dhënave: vrojtimi i ndërmarrjeve, sistemi ndërkombëtar i raportimit të transaksioneve (ku përfshihen transaksionet nëpërmjet sistemit bankar) si dhe të dhënat administrative. Zgjedhja ndërmjet mënyrave të ndryshme

të mbledhjes së informacionit, mund të jetë vendimtare për saktësinë e statistikave të IHD-ve dhe për aftësinë e hartuesve në zbatimin e standardeve ndërkombëtare. Çdo burim informacioni ka përparësitë dhe mangësitë e tij specifike.

Tabelë 2. Përparësitë dhe mangësitë e burimeve kryesore të informacionit për IHD.

Përparësitë	Mangësitë
Sistemi i Raportimit të Transaksioneve me Jashtë (ITRS)	
Normalisht ITRS përdoret në mbledhjen e informacionit për zëra të ndryshëm të BP-së si për shembull, import/eksport etj.. Në këtë mënyrë, arrihet shmangia e shpenzimeve për zhvillimin dhe zbatimin e sistemeve të tjera për mbledhjen e informacionit të duhur për hartimin e bilancit të pagesave.	Zakonisht, maten vetëm transaksionet në cash. Kjo nënkupton që pjesë nga komponentët e IHD (si për shembull, fitimi i riinvestuar ose borxhi ndërmjet kompanive) nuk përfshihen pa një marrëveshje të veçantë dhe duhen përdorur burime të tjera shtesë. Konceptet e IHD-ve janë të vështira për t'u sqaruar në sistemin e përgjithshëm të raportimit të bankave, sidomos konceptet që i përkasin klasifikimit. Matja e transaksioneve në monedhë vendase ose ndërmjet llogarive me banka jorezidente është e vështirë. Mund të jetë e vështirë për të marrë të dhëna për pozicionin ndërkombëtar të investimeve.
Vrojtimet e ndërmarrjeve	
Vrojtimi i ndërmarrjeve dizenjohet bazuar në kërkesat specifike të statistikave të IHD-ve. Ai siguron një regjistrim të plotë të transaksioneve dhe pozicionit të IHD-ve për secilën nga ndërmarrjet e vrojtuara, duke përfshirë fitimet e riinvestuara. Krijon mundësinë e shpjegimit të koncepteve dhe trajtimit të IHD-ve tek raportuesit e të dhënave. Mund të përfshijë informacion për faktorë të tjerë ndikues ekonomikë, si për shembull, numri i punonjësve, eksportet etj..	Mbajtja e një regjistri për ndërmarrjet me investim të huaj direkt, në të cilin pasqyrohen transaksionet / pozicioni i stokut, mund të jetë i vështirë. Zhvillimi dhe zbatimi i një vrojtimi të specializuar për IHD-të, nga vendet të cilat nuk përdorin vrojtimet për të dhënat e bilancit të pagesave krijon kosto shtesë. Në rastet e vrojtimit me zgjedhje ekstrapolimi mund të çojë në rezultate joreale.
Të dhënat "Administrative"	
Informacioni i nevojshëm mundësohet shpesh në procesin e miratimit të investimeve të reja.	Ky informacion rrallë herë është i hartuar për të përmbushur nevojat e bilancit të pagesave. Hapësira kohore ndërmjet miratimit dhe realizimit të investimeve (ekziston mundësia që investimi të mos realizohet). Mungon informacioni për fitimet e riinvestuara dhe dis-investimet. Nuk përfshin informacionin mbi stokun e investimeve vlerësuar në çmime tregu. Informacioni mbulon një numër të kufizuar industrish. Zakonisht mbulohen vetëm IHD-të hyrëse, jo ato dalëse.

Burimi: FMN (1995); OECD (1999), Bertrand (1999).

Shumë vende të botës bazohen dhe në të dhënat e ITRS-it për krijimin e bazës së të dhënave të IHD-ve. Banka e Shqipërisë siguron një informacion shumë të kufizuar nga raportimet e bankave. Ka shumë arsye për këtë, por më kryesorja është shkalla e lartë e përdorimit të *cash*-it në ekonomi.

Aktualisht, vrojtimi i ndërmarrjeve është metoda më e përdorshme. Ky vrojtim është ndërmarrë nga Banka e Shqipërisë si nismëtare e krijimit të regjistrit të plotë të ndërmarrjeve me kapital të huaj. Krijimi i këtij regjistri do të jetë baza për krijimin e serive kohore të vlefshme për bilancin e pagesave dhe për Pozicionin Ndërkombëtar të Investimeve. Deri tani janë realizuar dy vrojtime për IHD, përkatësisht në vitet 2003 dhe 2004 dhe kanë synuar intervistimin e të gjitha kompanive që investojnë direkt në Shqipëri. Banka e Shqipërisë ka planifikuar vrojtime vjetore, duke synuar anketimin në të gjithë popullatën e kompanive me kapital të huaj në Shqipëri.

Megjithëse konsiderohet një burim shumë i mirë informacioni, kryerja e vrojtimeve statistikore është proces shumë i vështirë dhe delikat. Ai kërkon përcaktimin e qartë të objektivave, pyetësorë të hartuar mirë, përzgjedhje të popullatës së vrojtimit sa më përfaqësuese, klasifikim dhe strukturë të mirëpërcaktuar të të dhënave statistikore, vlerësim të rezultateve dhe procedura agregimi efektive etj.. Për pasojë, një nga detyrat kryesore për hartuesit e bilancit të pagesave është përmirësimi i metodologjive përkatëse dhe studimi i vazhdueshëm për gjetjen e metodave statistikore dhe ekonometrike sa më të përshtatshme për përpunimin të dhënave përkatëse, pa harruar kërkimet për burime të tjera informacioni.

Krijimi i një historiku të dhënash për kapitalin e huaj të hyrë në Shqipëri në formën e investimeve direkte si dhe analizat studimore të rezultateve të vrojtimeve, do të japin një kuadër të qartë të origjinës së tij, sektorët e ekonomisë që kanë thithur më shumë atë, si dhe ndikimin në ekonomi. Analiza e karakteristikave të tregut të investimeve të huaja direkte si dhe produktivitetit të tyre, mund të shërbejë si një faktor nxitës në hapjen e kompanive të reja, me kapital të huaj në vend.

SHËNIME

*Argita Frashëri, Përgjegjëse zyre, Zyra e Bilancit të Pagesave;
Anjeza Hobdari, specialiste, Zyra e Bilancit të Pagesave
Falenderojmë Departamentin Juridik për sugjerimet dhe ndihmën e dhënë gjatë përgatitjes së këtij materiali.

[1] OECD (1996).

[2] Person juridik janë shoqëritë tregtare të regjistruara në regjistrin tregtar pranë gjykatës si shoqëri tregtare, në një nga format e njohura nga ligji (komandite, të thjeshtë, përgjegjësi të kufizuar apo anonime). Kanë statut dhe akt themelimi.

[3] Person fizik janë ortakëri të paregjistruara në regjistrin tregtar si shoqëri tregtare apo në ndonjë formë tjetër të njohur nga ligji. Pra, janë thjesht një formë bashkëpunimi ndërmjet tregtarëve, por pa një formë të njohur nga ligji, domethënë nuk dalin si palë më vete në marrëdhëniet juridike. Nuk kanë statut dhe akt themelimi.

[4] Filiali është një shoqëri tregtare më vete, e cila konsiderohet filial me shoqërinë tregtare-mëmë.

BIBLIOGRAFI

Bertrand, Ayse (1999): Foreign Direct Investment Data Sources and Reporting Systems: Main Issues in OECD: Workshop on Foreign Direct Investment Statistics in the Baltic States, Estonia November 16, 1999.

European Central Bank (2002): Accession Countries: Balance of Payments/International Investment Position Statistical Methods, February 2002, http://www.ecb.int/pub/pdf/bop02ac

Falzoni, Anna M. (2000) "Statistics on Foreign Direct Investment and Multinational Corporations: a Survey", University of Bergamo, Italy

International Monetary Fund (1993), Balance of Payment Manual.

International Monetary Fund (2001), A Practical Guide to Foreign Direct Investment Statistics.

International Monetary Fund (1995): Balance of Payments Compilation Guide,

Lipsey, R.E. (2001), "Foreign Direct Investment and the Operations of Multinational Firms: Concepts, History and Data," NBER WP No. 8665

OECD (1996), OECD Benchmark definition of FDI, 3rd Edition, Paris.

VLERËSIMI I INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE NË VENDET ME EKONOMI NË ZHVILLIM TË EVROPËS LINDORE: RASTI I SHQIPËRISË

*Endrita Xhaferaj**

Fjalë kyçe
- Investimet e Huaja Direkte - Ekonomi në zhvillim - Rritje ekonomike - Klimë biznesi -

ABSTRAKT

Investimet e huaja botërore janë rritur ndjeshëm gjatë viteve 1995-2000, ndërkohë që pas vitit 2000 kanë rënë me të njëjtin ritëm. Kjo tendencë është përcaktuar nga rënia e investimeve në vendet e zhvilluara, ndërkohë që vendet në zhvillim vazhdojnë të tërheqin më tepër flukse të kapitalit të huaj. Shpërndarja e investimeve të huaja brenda vendeve në zhvillim nuk është e njëjtë dhe disa prej tyre e kanë më të vështirë se disa vende të tjera që të tërheqin investitorë të huaj.

Ky material analizon zhvillimin dhe shpërndarjen e investimeve të huaja direkte në vendet e Evropës Juglindore, duke i krahasuar ato me vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, me fokus të veçantë zhvillimin dhe shpërndarjen e tyre në Shqipëri. Investimet e huaja luajnë një rol shumë të rëndësishëm në rindërtimin e ekonomive të këtyre vendeve, gjatë kalimit të tyre nga ekonomi të centralizuara në ekonomi tregu.

Në këtë material, analizohen burimet dhe mundësitë e Shqipërisë, bashkë me pikat e saj të dobëta, me qëllim përcaktimin e ndikimit të tyre në gjendjen aktuale të investimeve

të huaja hyrëse, si dhe dhënien e disa strategjive të mundshme që do të bëjnë të mundur përmirësimin e tyre në të ardhmen.

1. HYRJE

Gjatë dekadave të fundit, niveli i Investimeve të Huaja Direkte (IHD) në vendet me ekonomi në zhvillim, dhe që prej vitit 1989 në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, është rritur ndjeshëm. Kohët e fundit, janë bërë mjaft studime lidhur me IHD-të në vendet në tranzicion të Evropës Qendrore dhe Lindore, për shkak të risisë relative të këtyre tregjeve dhe të rëndësisë së IHD-ve për rritjen dhe zhvillimin e rajonit. Dihet se përfitimet e këtyre vendeve nga IHD-të janë të konsiderueshme, duke përfshirë dhënien e njohurisë dhe teknologjisë firmave vendore dhe forcës së punës, *spillovers* (rrjedhjet) e produktivitetit, përmirësimin e konkurrencës, si dhe rritjen e mundësisë së eksportimit në vendet e tjera. Gjithashtu, ato përfaqësojnë një metodë të parapëlqyer për financimin e deficiteve të llogarisë së jashtme korente (të cilat janë mjaft të larta në rastin e vendeve në tranzicion), duke qenë se flukset e IHD-ve nuk krijojnë borxh. Për këtë arsye, pavarësisht disa efekteve negative që IHD-të mund të kenë në vendet pritëse, ato konsiderohen një burim shumë i rëndësishëm për rindërtimin dhe kalimin e vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore në ekonomi tregu.

Investimet e huaja direkte në Shqipëri kanë qenë një faktor shumë i rëndësishëm për rritjen ekonomike të saj, duke ndryshuar gjatë viteve si në formë ashtu dhe në shifra. Megjithatë, Shqipëria është një ndër vendet më pak të zhvilluara të rajonit, duke shënuar tërheqjen më të vogël të IHD-ve gjatë viteve të tranzicionit.

Objektivi kryesor i këtij kërkimi është studimi dhe dhënia e përgjigjeve për pyetjet e mëposhtme:

- Si ka ndikuar ndryshimi i kushteve të tregut në investimet e huaja direkte të vendeve të Evropës Lindore?
- Cilat janë evidencat empirike të tendencave dhe zhvillimeve të IHD-ve në këto vende?

- Cili është rasti i Shqipërisë lidhur me investimet e huaja direkte në krahasim me vendet e tjera të rajonit?
- Çfarë kushtesh paraqet klima e investimeve në Shqipëri? Cilat janë përparësitë e saj konkurruese për thithjen e investimeve të huaja?
- Si mund të përdoren këto përparësi dhe çfarë nevojitet që Shqipëria të tërheqë më tepër investitorë të huaj?

2. TENDENCAT BOTËRORE

Sipas *World Investment Report 2004* (Raporti Botëror mbi Investimet), (UNCTAD, 2004a), nga një pikëpamje botërore, flukset hyrëse të investimeve të huaja direkte (IHD) pësuan një rënie në vitin 2003, për të tretin vit rradhazi.

Kjo tendencë u pasua nga një rënie me 25 për qind e flukseve të IHD-ve në vendet e zhvilluara. Ndërkohë, flukset në vendet në zhvillim u rritën në vitin 2003 me 9 për qind. Vendet në zhvillim jo vetëm që po thithin një pjesë të madhe të flukseve hyrëse të IHD-ve, por ato njëkohësisht kanë filluar të veprojnë në tregun ndërkombëtar si burime të investimeve të huaja dalëse. Tashmë, shoqëritë shumëkombëshe të vendeve në zhvillim po bëhen një faktor i rëndësishëm në tregun botëror të IHD-ve (UNCTAD, 2004a).

World Investment Report 2005 (Raporti Botëror mbi Investimet) (UNCTAD, 2005) tregon se përqindja e flukseve hyrëse globale të investimeve të huaja direkte (IHD) në vendet në zhvillim vijoi të rritet në vitin 2004 me 40 për qind, ndërkohë që IHD-të në vendet e zhvilluara u ulën me 14 për qind. Një rritje e tillë shënoi përqindjen më të madhe të IHD-ve për vendet në zhvillim, me 36 për qind që prej vitit 1997.

"*Prospect for Foreign Direct Investment*" (Perspektivat për Investimet e Huaja Direkte) përgatitur nga UNCTAD (2004b) parashikon rritjen e mundshme të flukseve botërore të IHD-ve gjatë viteve 2005-2007. Përsa i përket vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore, rezultatet e analizës së vrojtimit flasin për

një të ardhme të shkëlqyer të IHD-ve, në periudhën afatmesme (2006-2007).



3. IHD-TË DHE EVROPA LINDORE: KUADRI TEORIK

Ekziston literaturë mjaft e pasur mbi investimet e huaja direkte në vendet me ekonomi në tranzicion në përgjithësi, dhe mbi ato të Evropës Qendrore dhe Lindore, në veçanti. Vrojtuesit janë përqendruar në dy pika kryesore: analizën e përcaktuesve të investimeve të huaja direkte, duke përfshirë studimin e lidhjes ndërmjet klimës së investimeve dhe IHD-ve, dhe analizën e impaktit të IHD-ve në ekonominë e vendit.

3.1. IMPAKTI I IHD-VE NË EVROPËN LINDORE

Në përgjithësi, flukset hyrëse të kapitalit të huaj kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të rëndësishme për rindërtimin e rajonit të Evropës Qendrore dhe Lindore (veçanërisht për vendet e Evropës Juglindore), dhe për riintegrimin e saj në ekonominë botërore. "Kalimi i suksesshëm (nga ekonomi të planifikuara në ekonomi tregu) në Evropën Qendrore dhe Lindore nuk mund të realizohet pa ndihmën e flukseve të mëdha hyrëse të kapitalit të huaj" (Schmidt, 1995). Në një analizë vrojtimi ekonomike të Evropës

në vitin 2005, thuhet se ndër llojet e ndryshme të flukseve të kapitalit, investimet e huaja direkte përgjithësisht konsiderohen si më të dëshirueshmet. Një vend mund të përfitojë mjaft nga IHD-të, pa qenë i varur njëkohësisht nga flukset hyrëse neto të kapitalit ose pa nevojën e rritjes së borxhit të tij të jashtëm neto (UNECE, 2005).

Dihet se investimet e huaja direkte kanë një ndikim pozitiv mbi ecurinë ekonomike të një vendi. IHD-të kanë një ndikim të madh mbi treguesit kryesorë makroekonomikë si për shembull, mbi prodhimin e brendshëm bruto, bilancin e pagesave dhe mbi punësimin.

3.2. PËRCAKTUESIT E IHD-VE NË EVROPËN QENDRORE DHE LINDORE

Ekziston një marrëveshje e përgjithshme lidhur me përcaktuesit kryesorë të investimeve të huaja direkte në vendet me ekonomi në zhvillim të Evropës Qendrore dhe Lindore (Lankes dhe Venables, 1996; Resmini, 2000). Këta faktorë kryesisht përfshijnë: kosto e ulët me punë të kualifikuar, dhënia e burimeve natyrore, mundësitë afatgjata të tregut, progresi në reformat e tranzicionit, përmasa e tregut të vendit pritës, si dhe stabiliteti ekonomik dhe politik. Pa dyshim, mungesa ose ecuria e dobët e këtyre treguesve do të ishte pengesë për IHD-të në vendin përkatës.

London dhe Ross (1995) kanë adoptuar teorinë e kapitalizmit global, e cila shpreh se investitorët e vendeve të zhvilluara kanë për tendencë, të investojnë më tepër në vendet e Botës së Tretë, të cilat shfaqen të dobëta dhe ku kostoja e punës është më e vogël. Autorët e kësaj teorie mendojnë se kontrolli i punës dhe kostoja e saj janë përcaktorë kryesorë të IHD-ve, pavarësisht nga niveli i zhvillimit.

Studimet e botuara nga OECD (1994) dhe BERZH (1994) kanë sfiduar në mënyrë të konsiderueshme "teorinë e pagës së ulët". Përfundimi i përgjithshëm i BERZH-it (1994) ishte i drejtpërdrejtë: "Ndër faktorët kryesorë që ndikojnë në vendimmarrjen e investitorit, aksesi në treg është ndoshta më

kryesori [...] Ndërkohë që në të gjitha vrojtimet, përparësitë e faktorit të kostos renditen si më pak të rëndësishme sesa aksesi në treg...." Rezultatet e studimit të OECD (1994), i cili bëri një vlerësim të klimës së biznesit në Evropën Qendrore dhe Lindore dhe në shtetet e reja të pavarura të ish-Bashkimit Sovjetik, janë mjaft të ngjashme. Motivi kryesor për IHD-të ishte arritja e aksesit në treg (44%), ndërkohë që kostoja e punës u vlerësua me rëndësi dytësore (vetëm 9 për qind).

Klima e investimeve ka një impakt të madh mbi flukset hyrëse të investimeve të huaja direkte. Ky faktor theksohet veçanërisht në rastin e krahasimit të ecurisë së mirë të vendeve të zhvilluara e në tranzicion të Evropës Qendrore dhe ecurisë së dobët të shteteve të Ballkanit, të cilat janë më pak të zhvilluara përsa iu përket reformave të tranzicionit.

Politikat e investimeve të huaja mund të ndikojnë gjithashtu në tërheqjen ose pengimin e flukseve hyrëse të investimeve. Vendet në tranzicion të Evropës Qendrore dhe Lindore, të cilat ndjekin politika aktive kombëtare të IHD-ve, nxisin investimet e huaja përmes zbutjes së taksave, krijimit të zonave të lira ekonomike, si dhe përmes parandalimit të tatimit të dyfishtë. Në vendet, të cilat ndjekin politika pasive që lidhen me investimet, IHD-të dekurajohen përmes kërkesës së lejeve dhe regjistrimeve shtesë të investimeve, si dhe kufizimeve dhe barrierave të ndryshme. Megjithatë, Dunning (1994) argumenton se kjo nuk është thjesht një çështje liberalizimi të politikave të investimit apo e krijimit të nxitjeve fiskale tejet bujare për investitorët e huaj. Qeveritë e vendeve përkatëse duhet të krijojnë e mbështesin një mjedis ekonomik e shoqëror, ku firmat vendore dhe të huaja të mund të konkurrojnë në mënyrë efektive.

4. VENDET DHE SFONDI HISTORIK

Sipas fjalorit të politikave moderne (Robertson, 1993), deri në rënien e pushtetit sovjetik, Evropa Qendrore përkufizohej politikisht dhe jo gjeografikisht. Evropa Qendrore përbëhej kryesisht nga ato vende, të cilat pas Luftës së Dytë Botërore ranë

nën regjimin komunist (Shqipëria, Bullgaria, Çekosllovakia, Gjermania Lindore, Hungaria, Polonia, Rumania dhe Jugosllavia). Pas pesëmbëdhjetë vitesh nga rënia e regjimit komunist, në studime dhe materiale diskutimi Evropa ende përshkruhet me të njëjtat ndarje gjeografike si në kohën e Luftës së Ftohtë. Shpesh, vendet me ekonomi në tranzicion të Evropës Lindore ndahen në dy grupe: vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, të cilat (pa përfshirë shtetet balltike) përbëhen nga: Republika Çeke, Hungaria, Polonia, Republika Sllovake dhe nga Sllovenia; dhe vendet e Evropës Juglindore, të cilat përfshijnë: Shqipërinë, Bosnje dhe Hercegovinën, Bullgarinë, Kroacinë, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Rumaninë, Serbinë dhe Malin e Zi. Ky kërkim i referohet klasifikimit të fundit.

Trashëgimia komuniste në Evropën Lindore dallohej për dy aspekte të rëndësishme. Së pari, struktura e pronësisë socialiste e vendosi industrinë, shërbimet dhe bujqësinë kryesisht në duart e shtetit. Së dyti, pas dyzet viteve, sistemi ekonomik komunist nuk arriti të mbajë veten e tij, duke lënë pas një kolaps të thellë industrial, kaos dhe gjendje të vështirë financiare, si dhe standarde shumë të ulëta jetese.

Kalimi nga ekonomi të centralizuara në ekonomi tregu filloi së pari në Poloni dhe Hungari, të cilat ishin vendet e para që prekën demokracinë dhe të parat që përfituan nga përfshirja e komunitetit ndërkombëtar në procesin e tyre të tranzicionit përmes asistencës dhe ekspertizës (Lavigne, 1995). Evropa Juglindore ka qenë rajoni më pak i zhvilluar në Evropë. Ekonomitë në rajon filluan procesin e tranzicionit nga një gjendje tejet e vështirë; pasiguria politike ishte në nivele të larta, institucionet të dobëta dhe shoqëritë civile të copëtuara. Ecuria makroekonomike ishte mjaft e paqëndrueshme, ndikuar thellë nga konfliktet dhe luftërat civile gjatë pjesës më të madhe të periudhës së tranzicionit. Këto vende kanë marrëdhënie më pak të ngushta me BE-në dhe mbeten prapa vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore përsa i përket progresit të arritur gjatë fazës së tranzicionit.

Pavarësisht nga kjo, Ballkani po ngushton këtë hendek në mënyrë të dukshme. Rajoni i Evropës Juglindore llogaritet në

pak më shumë se 2 për qind të prodhimit botëror të brendshëm bruto, sipas paritetit të fuqisë blerëse, shifër e njëjtë kjo me përqindjen sipas popullsisë botërore. Megjithatë, pavarësisht nga ngadalësimi i përgjithshëm botëror, ky rajon mbetet një nga rajonet me rritjen më të konsiderueshme të PBB-së, duke lënë pas rritjen botërore dhe të BE-së nga viti 1999 deri në vitin 2004.

Grafik 2. Norma mesatare rajonale e rritjes së PBB-së (2000-2004).



Burimi: Baza e të dhënave UNCTAD (Handbook of Statistics on-line).

5. ZHVILIMI I IHD-VE NË RAJON

Gjatë viteve 1990 – 2004, vendet e Evropës Juglindore, si grup, kanë tërhequr shumë më pak IHD sesa vendet në tranzicion të Evropës Qendrore.

Grafik 3. Flukset hyrëse rajonale të IHD-ve, 1991-2004 (në milionë dollarë).



Burimi: Baza e të dhënave UNCTAD (FDI statistics on-line).

Megjithatë, duket se vendet e Evropës Juglindore po iu afrohen niveleve të fqinjëve të tyre. Flukset hyrëse të IHD-ve në Evropën Juglindore filluan të rriten pas vitit 2002. Ndikuar nga procesi i privatizimit, këto flukse hyrëse pothuajse u trefishuan, duke arritur në vitin 2004 në 11 miliardë usd.

Brenda grupit të vendeve të Evropës Juglindore, Rumania, Kroacia dhe Bullgaria mbeten aktorët kryesorë në tërheqjen e flukseve të IHD-ve. Në fund të vitit 2004, ato thithën pjesën më të madhe të totalit të stokut të IHD-ve në Ballkan, duke i lënë vendet më pak të zhvilluara si Shqipëria, Bosnje dhe Hercegovina, Maqedonia, Serbia dhe Mali i Zi me një total prej rreth 20 për qind të stokut të IHD-ve. Megjithatë, gjatë katër viteve të fundit, në këto vende është vënë re tendenca rritëse e flukseve hyrëse të IHD-ve.

Grafik 4. Stoku i IHD-ve sipas vendeve pritëse
në Evropën Juglindore.



Burimi: Baza e të dhënave UNCTAD (FDI statistics on-line).

Hunya (2004) shpjegon tendencat e ndryshme të IHD-ve sipas natyrës së flukseve hyrëse të IHD-ve. Në Evropën Qendrore, IHD-të nga procesi i privatizimit, në parim kanë përfunduar dhe tregu vendor kontrollohet nga investitorët e huaj, të cilët kryesisht investojnë në projekte të orientuara drejt eksporteve, në kompani ekzistuese ose në impiante të reja. Tregu kryesor i eksporteve, grupi i BE-15, nuk është zgjeruar gjatë viteve të fundit dhe veprimtaria e përgjithshme e investimeve të ndërmarrjeve shumëkombëshe ka qenë e ulët. Ndërkohë, në vendet e Evropës Juglindore, IHD-të kanë ndjekur një model të ndryshëm. Progresi

i arritur gjatë viteve të fundit në transformimin ekonomik është përkthyer në rrezik më të ulët në investim dhe rritje të interesit nga ana e investitorëve të huaj. Vëllimet në rritje të IHD-ve në rajon kanë ardhur dhe si rezultat i përpjekjeve të vazhdueshme të qeverive përkatëse për privatizimin e kompanive të mëdha, shërbimeve publike dhe bankave, ndonëse ato rrallëherë janë përdorur për projekte të orientuara drejt eksporteve.

5.1. SEKTORËT, VENDET E ORIGJINËS DHE NXITJET PËR IHD-TË NË RAJON

Përsa i përket shpërndarjes së IHD-ve sipas sektorëve të ekonomisë, pjesa më e madhe e IHD-ve në vendet e Evropës Juglindore përqendrohen në industrinë përpunuese, shërbimet financiare, telekomunikacion dhe tregti. Analiza e të dhënave nga BERZH (2004) tregon se IHD-të në Evropën Juglindore përqendrohen në sektorin e industrisë përpunuese dhe veçanërisht në prodhimin e çelikut (Bevan dhe Estrin, 2000; Hunya, 2004).

Sektori financiar është një sektor tjetër i rëndësishëm në Evropën Juglindore, ku përfshirja e investimeve të huaja është rritur ndjeshëm gjatë viteve '90. Privatizimi i gjithë sektorit bankar të këtyre vendeve është kryer gjatë viteve të fundit. Sektori i turizmit ka tërhequr mjaft investime të huaja në Kroaci dhe Bullgari. Ndërkohë, mungesa e ristrukturimit, pasiguria lidhur me të drejtat pronësore dhe infrastruktura e dobët janë ndër pengesat kryesore të investimeve të huaja në këtë sektor (BERZH, 2004).

Përsa i përket vendeve të origjinës për IHD-të, si vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore ashtu dhe ato të Evropës Juglindore, kanë tërhequr më së shumti fqinjët e tyre evropiano-perëndimorë. Burimi kryesor i IHD-ve në rajon kanë qenë vendet e OECD-së, të cilat përbëjnë mbi 90 për qind të flukseve hyrëse të IHD-ve në Bullgari, Kroaci dhe Rumani (Broadman et al, 2004). Analiza gjeografike dhe sektoriale kryer nga BERZH (2004) gjithashtu, tregon se pjesa më e madhe e IHD-ve vjen

nga vendet e BE-së, si Italia, Gjermania, Austria dhe Greqia, me orientim veçanërisht drejt rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Përsa i përket mjedisit të politikës në mbështetjen e IHD-ve, vendet e Evropës Juglindore kanë një shkallë të caktuar të liberalizimit të tregtisë. Shqipëria, Kroacia dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë janë tashmë anëtare të OBT-së, ndërkohë që Bosnje dhe Hercegovina, Serbia dhe Mali i Zi janë në procesin e anëtarësimit. Gjithashtu, sipas Komisionit Evropian (2004), pesë shtetet e lartpërmendura gëzojnë hyrje pa doganë në tregun e BE-së, në sajë të Masave Asimetrike të Tregtisë, dhënë që prej fundit të vitit 2000.

Në aspektin e kuadrit rregullativ, të gjitha vendet e rajonit kanë legjislacionin e duhur të IHD-ve. Në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, dhe Kroaci janë krijuar Agjenci për Nxitjen e Investimeve të Huaja, ndërkohë që në të gjitha vendet e Evropës Juglindore janë ngritur Zona të Lira të brendshme Tregtare, të cilat iu ofrojnë investitorëve të huaj mjaft mundësi. Në këto vende, ekzistojnë kufizime që lidhen me pronësinë e huaj, në sektorë të ndjeshëm, si pronësia mbi tokën (për shembull në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë) ose pronësia mbi tokën bujqësore (për shembull në Shqipëri dhe Kroaci) (Komisioni Evropian, 2004).

6. SHQIPËRIA

6.1. ZHVILLIMI I IHD-VE NË SHQIPËRI

Flukset e IHD-ve vazhdojnë të jenë një përbërës i rëndësishëm i zhvillimit të sektorit privat dhe një kusht për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. Gjatë viteve të fundit, në krahasim me burimet e tjera, si për shembull borxhi i jashtëm, flukset e IHD-ve kanë qenë një burim i rëndësishëm i kapitalit të huaj për financimin e deficitit korent të Shqipërisë.

Ekonomia e Shqipërisë është bërë mjaft e hapur ndaj investimeve të huaja vitet e fundit. Nivelet e investimeve të huaja

në Shqipëri kanë pësuar luhatje në këtë periudhë. Megjithatë, ato mbeten përgjithësisht nën standardet rajonale, veçanërisht në krahasim me vendet e Evropës Juglindore, të cilat gjithashtu filluan nga niveli zero i IHD-ve në vitin 1990 dhe me pothuajse të njëjtat kushte politike dhe ekonomike.

Duke parë shifrat e flukseve të IHD-ve gjatë viteve të tranzicionit, është e qartë se që prej fillimit të tij e deri në vitin 1996, ka patur një tendencë rritëse të kapitalit të huaj në Shqipëri.

Vlen të theksohet se gjatë viteve 1995-1996, skemat piramindale ishin në *boom*-in e tyre dhe një faktor i tillë duket të ketë ndikuar mjaft në investimet e huaja. Menjëherë pas krizës së vitit 1997, investimet e huaja u ulën me 50 për qind, në krahasim me ecurinë e tyre më të mirë gjatë viteve 1995-1996. Imazhi i Shqipërisë pas kaosit institucional dhe shoqëror kishte mjaft për të rifituar. Kriza e Kosovës në vitin 1999 ishte një faktor tjetër (megjithëse rajonal, duke qenë se shkaktoi një rënie të flukseve të IHD-ve në mbarë rajonin), i cili pati një ndikim të madh në uljen e investimeve të huaja.

Kjo analizë e thjeshtë tregon se vështirësitë e Shqipërisë në ruajtjen e imazhit të një mjedisi të qëndrueshëm politik, kanë qenë një pengesë e madhe për shumë investitorë të huaj (për të cilët stabiliteti politik, që kryesisht nënkupton stabilitetin institucional, është parakushti kryesor për investimet) që të investojnë në Shqipëri. Paqëndrueshmëria dhe mungesa e zbatimit të ligjit, brenda vendit ose në nivel rajonal, kanë qenë barriera kryesore për investimet e huaja direkte në Shqipëri, pasi përsa i përket nivelit të liberalizimit të ekonomisë dhe kuadrit të duhur ligjor, Shqipëria ka bërë një përparim të ndjeshëm. Megjithatë, kjo nuk është e mjaftueshme kur institucionet janë të dobëta dhe të paqarta në rolin e tyre.

Gjatë këtyre viteve, privatizimet kanë luajtur rolin kryesor në rritjen e flukseve të IHD-ve. Një shembull i kësaj rritjeje ishte privatizimi i bankës më të madhe tregtare, Banka e Kursimeve në Shqipëri. Në mesin e muajit prill 2004, Austrian Raiffeisen Zentralbank (RZB) bleu 100 për qind të aksioneve në vlerën

126 milionë dollarë, që përfaqësonte 37 për qind të totalit të fluksit vjetor të IHD-ve për vitin 2004.

Deri në fund të vitit 2004 u privatizuan pothuajse të gjitha ndërmarrjet e vogla dhe të mesme shtetërore. Qeveria tani po punon për privatizimin e objekteve të tjera strategjike, siç janë AlbTelekomi (ofruesi i vetëm i shërbimit të telefonisë fikse në Shqipëri) dhe KESH-i (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare).

6.2. KLIMA E INVESTIMEVE

6.2.1. Mundësitë dhe stimujt për investitorët e huaj

Në një studim të kryer nga OECD (2003), bazuar në pyetësorët, takimet individuale, bisedat dhe shqyrtimin nga afër në vendet e Evropës Juglindore, materiali "Motivimet e investitorëve të huaj për të investuar në Shqipëri" citon:

"... pothuajse të gjithë të intervistuarit u përgjigjën se ata përpiqen të bëjnë një vlerësim dinamik të përparësive dhe mangësive të vendit. Ata mendojnë se përparësitë e Shqipërisë po rriten gjithnjë e më shumë. Ata besojnë se procesi i stabilizim-asociimit me Evropën dhe zbatimi i marrëveshjeve të lira të tregtisë do ta përmirësojnë situatën në mënyrë të ndjeshme." (OECD, 2003, faqe 51.)

Pavarësisht nga vështirësitë dhe sfidat e shumta, Shqipëria është një vend që ofron mjaft mundësi për investitorët e huaj. Ato janë:

Turizmi

Shqipëria është një vend i pasur me burime turistike, duke përfshirë malet, luginat, pyjet, lumenjtë dhe liqenet. Duke qenë një vend mesdhetar, ajo gëzon veçori si gjeografike ashtu dhe gjeologjike, me peisazhe të shumëllojshme, të cilat variojnë nga ato tipike mesdhetare në pjesën perëndimore dhe jugperëndimore, në të ndryshme në pjesën qendrore dhe në ato me male të thepisura në pjesën e brendshme të vendit.

Vija bregdetare e deteve Jon dhe Adriatik ofron plazhe mjaft të bukura. Shqipëria është e pasur me liqene, lugina, rezerva natyrore, vende për gjueti, si dhe me llixha. Ajo gjithashtu ka një histori dhe kulturë mjaft të lashtë. Në periudhën afatgjatë, turizmi mund të jetë një nga faktorët kryesorë për tërheqjen e investitorëve të huaj, megjithatë aktualisht Shqipëria ka një infrastrukturë të dobët për lehtësimin e investimeve të mëdha.

Nafta dhe mineralet

Shqipëria është mjaft e pasur me burime natyrore, duke përfshirë kromin, qymyrgurin, nikelin, bakrin, naftën dhe gazin natyror. Është i vetmi vend në Evropë me rezerva të konsiderueshme të kromit. Para vitit 1990 ajo renditej e treta në botë për nxjerrjen e tij. Si industria e naftës, ashtu dhe ajo e minierave janë të orientuara drejt eksportit.

Sipas INOGATE (Programi Ndërshtetëror i Transportit të Naftës dhe Gazit në Evropë, financuar nga BE), Shqipëria vlerësohet të ketë rreth 550 milionë ton rezerva të rekuperueshme nafte, duke ofruar në këtë mënyrë kapacitete të mëdha eksportuese. Sipas Agjencisë Shqiptare për Nxitjen e Investimeve të Huaja (2004) rezervat e gazit natyror të Shqipërisë vlerësohen të jenë rreth 3.316 miliardë metër kub. Industria e gazit në vend përqendrohet në 11 fusha, me një kapacitet vjetor prej 69 milionë metër kub. Megjithatë, kapaciteti i nxjerrjes së tij është shumë më i ulët dhe për përmbushjen e nevojave të vendit nevojitet importi i tij. Shqipëria është vendi i vetëm në Evropë që s'është i lidhur me një gazsjellës ndërkombëtar. Ekzistojnë mjaft alternativa për zgjidhjen e kësaj çështjeje, duke përfshirë mundësinë e lidhjes me Italinë, Greqinë apo me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë.

Industria përpunuese

Sektori i industrisë përpunuese ka tërhequr një numër të madh sipërmarrjesh të vogla në përpunimin e ushqimit, tekstileve, prodhimin e këpucëve, kryesisht me kompani greke dhe italiane. Industria e tekstileve ofron mundësi të shumta për investitorët e huaj, duke përbërë rreth 38 për qind të eksporteve, ku prodhimi i këpucëve llogaritet në më shumë se 21 për qind (fundi i vitit 2001). Pylltaria është një industri tradicionalisht e rëndësishme,

ku industritë lokale të përpunimit të drurit në mbarë vendin furnizohen me lëndë të parë relativisht të lirë. Ky sektor ofron mjaft mundësi në prerjen e drurit, prodhimin e kompensatës, paneleve, mobilieve si dhe të mjeteve të zdrukthtarisë. (EBRD, 2001.)

Bujqësia

Për vetë klimën dhe pozicionin e saj gjeografik, Shqipëria gëzon faktorë natyrorë të cilët mbështesin zhvillimin e bujqësisë. Prodhimet kryesore përfshijnë perimet, foragjeret, drithërat, frutat, vreshtat dhe ullinjtë. Shqipëria ka mundësi të mëdha në arritjen e një industrie konkurruese agropërpunuese. Prodhimet bujqësore shqiptare përfshijnë: hortikulturën (kryesisht domatet), ullinjtë, rrushin (i cili përdoret kryesisht për prodhimin e pijes alkolike vendore, rakisë), prodhimet blegtorale dhe bimët barishtore (veçanërisht sherbela, për të cilën Shqipëria konsiderohet si një prodhues i madh botëror).

Kostoja e ulët e krahut të punës

Sistemi arsimor në Shqipëri në mbarë vendin është i mirëkonsoliduar. Kohët e fundit janë zbatuar programe të mirënjohura pasuniversitare, si për shembull, programi i MBA-së, IFG-së dhe i Magjistraturës. Të dhënat statistikore mbi studentët, të cilët përfundojnë studimet e tyre jashtë vendit (veçanërisht në universitetet evropiane dhe amerikane) flasin për një përgatitje të mirë të tyre. Populli shqiptar dallohet për aftësinë e tij në studimin e gjuhëve të huaja, si për shembull të gjuhëve angleze, italiane, greke, franceze, gjermane dhe asaj spanjolle. Një nga përparësitë që Shqipëria ofron për tërheqjen e investimeve të huaja direkte është kostoja e ulët e krahut të punës. Studime të ndryshme kanë dëshmuar se pagat në Shqipëri janë sa një e dhjeta e pagave në Itali. Paga mesatare mujore në vendin tonë për vitin 2004 ishte pak më shumë se 114 euro në muaj (KPMG, 2005).

6.2.2. Pengesat lidhur me IHD-të

Pothuajse të gjitha vrojtimet e biznesit dhe punët kërkimore që lidhen me pengesat në zhvillimin e biznesit, kanë arritur në përfundimin se faktorët kryesorë që ndikojnë në mosthithjen e

investimeve të huaja direkte janë kuadri ligjor dhe rregullativ, si dhe infrastruktura. (Xhepa dhe Agolli, 2004.)

Infrastruktura

Infrastruktura e dobët, duke përfshirë transportin dhe komunikimin krijojnë barriera për zhvillimin e biznesit dhe të ekonomisë, në përgjithësi. Me gjithë hapat e fundit për përmirësimin e infrastrukturës së transportit, Shqipëria ka linja të kufizuara rrugore, në përgjithësi në kushte jo të mira, linja të pakta hekurudhore dhe shërbim të pazhvilluar të transportit publik. Megjithëse nuk ekzistojnë shërbime të rregullta të transportit ajror tregtar brenda vendit, është e mundur që ky lloj transporti të sigurohet përmes marrjes me qira të avionëve të vegjël ose helikopterëve.

Korrupsioni dhe mungesa e transparencës

Korrupsioni dhe mungesa e përgjithshme e transparencës mbeten sfida të vazhdueshme për demokracinë dhe për sipërmarrjet shumëkombëshe që mund të investojnë në Shqipëri. Megjithëse nuk është aq problematik sa shfaqej në vitet e mëparshme, korrupsioni vijon të jetë një pengesë për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit. Ai mund të ndikojë në zgjatjen e procedurave të marrjes së licencave, duke i bërë ato mjaft të kushtueshme. Mitmarrja është një praktikë e zakonshme. Sipas publikut, institucionet më të korruptuara në Shqipëri janë doganat, shërbimi policor dhe sistemi i shëndetit publik. Transparenca pengohet më tej dhe nga fakti se një pjesë e madhe e veprimtarisë tregtare në Shqipëri zhvillohet jashtë ekonomisë formale.

Sipas indeksit TI 2004 (i cili i rendit vendet sipas shkallës së korrupsionit ndërmjet zyrtarëve publikë dhe politikanëve), Shqipëria vlerësohet me 2.5 nga 10 pikë (10 nënkupton shumë e pastër dhe 0 shumë e korruptuar). Shqipëria është një nga 60 vendet (nga 146 vende) që është vlerësuar me më pak se 3 pikë nga 10 gjithsej, duke dëshmuar për një korrupsion në masë të madhe. (Transparency International, 2004.)

Ekonomia informale

Në një raport të përgatitur nga OECD - *Investment Compact for the Ministry of Economy of Albania* (Marrëveshja e Investimeve për Ministrinë e Ekonomisë së Shqipërisë), thuhet se: "Ekonomia informale jep një kontribut të madh në punësimin dhe prodhimin në Shqipëri, por gjithashtu ajo përfaqëson një evazion fiskal dhe rregullator dhe si e tillë, është një çështje mjaft e debatueshme." (OECD, 2004, faqe 9.) Megjithatë, ky "kontribut" ka një kosto të madhe përsa i përket të ardhurave të humbura nga taksat, mungesës së mbrojtjes së punonjësve dhe konkurrencës së pandershme ndërmjet ndërmarrjeve. Disa vlerësime optimiste shprehin se një e treta e totalit të veprimtarisë ekonomike është informale, ndërkohë që vlerësime të tjera e llogarisin këtë shifër në 50 deri në 60 për qind të ekonomisë. Vlerësimi i OECD-së në raportin e lartpërmendur ishte se prodhimi informal gjatë pesë viteve të fundit, ka kontribuar në totalin e vlerës së shtuar bruto me 24 - 28 për qind.

6.3. POLITIKAT E JASHTME DHE PËRFSHIRJA E QEVERISË

Ndër vendet në tranzicion, Shqipëria konsiderohet si një nga vendet më të hapura tregtare. Tarifat e importit janë ndër më të ulëtat në rajon, shoqëruar me barriera shumë të kufizuara jotarifore dhe me disa marrëveshje rajonale të tregtisë së lirë. (FMN, 2005.)

Promovimi i IHD-ve është një objektiv strategjik i Qeverisë. Në këtë kontekst, Qeveria ka arritur të realizojë:

- Përcaktimin e një kuadri ligjor dhe rregullativ me nxitje për investitorët e huaj (disa nga nxitjet ligjore përfshijnë: trajtimin e barabartë të investitorëve të huaj dhe të brendshëm; kthimin e fitimit dhe dividentit të plotë (pas taksës); kthimin në origjinë të fondeve në rast likuidimi të një kompanie). Përdorimi i arbitrazhit si mjet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare tregtare është i shprehur qartë në ligjin shqiptar dhe Shqipëria merr pjesë në Gjykatën Ndërkombëtare për Zgjidhjen e

Mosmarrëveshjeve të Investimeve (ICSID).

- Minimizimin e rrezikut të investimeve: Investimet e huaja në Shqipëri janë tërësisht të mbrojtura nga ligji. Ato nuk mund të nacionalizohen, shpronësohen ose t'u nënshtrohen masave të tjera të ngjashme, përveç rasteve të veçanta të parashikuara me ligj, si për shembull rasti i interesit publik etj.. Gjithashtu, Shqipëria ka nënshkruar Konventën e Agjencisë Shumëpalëshe të Garancisë të Investimeve (MIGA), Konventën e Nju Jorkut të vitit 1958 mbi Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve të Arbitrazhit të Huaj, si dhe Konventën e Gjenevës mbi Zbatimin e Vendimeve të Arbitrazhit të Huaj.
- Rritjen dhe përmirësimin e imazhit të Shqipërisë si një destinacion i besueshëm i IHD-ve.
- Krijimin e një institucioni të pavarur dhe të besueshëm për apelimin e çështjeve që lidhen me taksat dhe të ngjashme me to.

Shqipëria ka nënshkruar disa marrëveshje dypalëshe që lidhen me nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve të ndërsjella. Gjithashtu, ajo ka lidhur traktate dypalëshe me shumë vende, si dhe merr pjesë në disa organizata ekonomike ndërkombëtare. Me qëllim sigurimin financiar të entiteteve të sektorit privat që investojnë në Shqipëri, Banka Botërore ka dhënë asistencën e saj për Shqipërinë përmes krijimit të një *Political Risk Guarantee Facility* (PRGF). PRGF administrohet nga Agjencia Shqiptare e Garancisë (AGSH) dhe ndërmarrjet e përfshira në prodhim kanë të drejtën e aplikimit për dhënien e garancisë (me përjashtim të duhanit, alkolit dhe armëve).

Në gusht 1998, Qeveria Shqiptare krijoi Agjencinë Shqiptare për Zhvillimin Ekonomik (AEDA), me qëllim nxitjen e investimeve dhe të eksporteve. Ndërkohë që në vitin 2002, Qeveria Shqiptare ngriti një agjenci tjetër, Agjencinë Shqiptare për Nxitjen e Investimeve të Huaja (ANIH), misioni i së cilës është nxitja dhe rritja e investimeve të huaja direkte dhe krijimi i një mjedisi sa më të favorshëm biznesi në Shqipëri.

7. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

7.1. PËRMBLEDHJE E GJETJEVE

Të dhënat e analizuara tregojnë se gjatë viteve 1992-2004, vendet e Evropës Juglindore kanë përfituar nga flukset e kapitalit të huaj dhe ekspertizë në këtë fushë vetëm në mënyrë sporadike dhe mjaft të kufizuara. Flukset kryesore të IHD-ve në këto vende janë lidhur më së tepërmi me privatizimet. Kapitali i huaj është investuar kryesisht në industrinë përpunuese, shërbimet financiare, telekomunikacion dhe tregti, dhe në pjesën më të madhe e ka origjinën nga vendet e BE-së. I gjithë rajoni ofron burime të pasura në turizëm, ndonëse në këtë fushë IHD-të mbeten mjaft të kufizuara (me përjashtim të Kroacisë).

Përsa i përket Shqipërisë, 15 vitet e tranzicionit janë karakterizuar nga një numër krizash që kanë patur një ndikim të madh mbi ekonominë e vendit. Megjithatë, pavarësisht nga ky fakt, gjatë viteve të fundit, Shqipëria ka patur një rritje të konsiderueshme të PBB-së, inflacion të ulët dhe qëndrueshmëri të kursit të këmbimit.

Shqipëria gëzon mundësi të mëdha për tërheqjen e IHD-ve në sektorë të ndryshëm (si në industrinë përpunuese, agropërpunuese, bujqësi, turizëm dhe shërbime të tjera). Megjithatë, ajo renditet ndër vendet me tërheqjen më të ulët të kapitalit të huaj brenda rajonit, duke regjistruar nivele shumë më të ulëta të IHD-ve, sesa mundësitë e saj reale. Investimet e huaja gjatë këtyre viteve kanë ardhur kryesisht si rezultat i privatizimit të ndërmarrjeve të vogla, të mesme dhe të mëdha shtetërore, me përqëndrim më të madh në industritë e punës. Vendet me investim më të madh në Shqipëri, janë Greqia dhe Italia.

Niveli i ulët i flukseve hyrëse dhe *stock*-ut të IHD-ve në vend, dëshmon faktin se ende ekzistojnë barriera të mëdha për investimet, që lidhen me zhvillimet e përgjithshme politike dhe të sigurisë në vend; me paqëndrueshmërinë dhe progresin e pamjaftueshëm gjatë procesit të tranzicionit dhe reformave

strukturore; korrupsionin dhe praktikat e pandershme; kushtet jo të mira të infrastrukturës fizike; ndryshimet e shpeshta të kuadrit rregullativ; pengesat administrative; si dhe ekzistencën në masë të madhe të një ekonomie informale.

7.2. REKOMANDIME TË MUNDSHME DHE NDIKIMET E POLITIKËS

Autoritetet shqiptare duhet të bëjnë përpjekjet e tyre për përmirësimin e mjedisit të biznesit, me qëllim rritjen e flukseve hyrëse të IHD-ve. Një nga masat më të rëndësishme që mund të ndërmerret nga qeveria për nxitjen e investimeve të huaja, është heqja e barrierave që lidhen me IHD-të. Një masë e tillë do të bënte të mundur përmirësimin e klimës së investimeve në Shqipëri dhe të këndvështrimit të investitorëve të huaj.

Një problem kryesor që ndikon jo vetëm IHD-të është korrupsioni. Me qëllim lehtësimin e investimeve të huaja, një masë e rëndësishme do të ishte eliminimi i rregulloreve të panevojshme (të cilat krijojnë hapësira për mitmarrje dhe korrupsion). Rregulloret e tjera duhet të jenë më tepër transparente dhe të përgjegjshme.

Kuadri ligjor duhet të përforcohet, jo vetëm në aspektin e legjislacionit, por edhe të zbatimit të tij dhe transparencës që lidhet me të, me rregulloret dhe procedurat. Zvogëlimi i përmasave të ekonomisë informale do të ndihmonte jo vetëm në përmirësimin e ekonomisë në aspektin makro, por gjithashtu do të eliminonte pengesën më të madhe të biznesit të ligjshëm, që është konkurrenca e pandershme.

Infrastruktura (duke përfshirë energjinë elektrike dhe ujin) ka nevojë për një zgjidhje, me qëllim nxitjen e investimeve të huaja në të gjithë Shqipërinë. Rritja e investimeve publike në infrastrukturë nuk është zgjidhja e vetme; duhet të bëhen përpjekje për tërheqjen e projekteve të huaja në këtë fushë, përmes ofrimit të nxitjeve të veçanta.

Përsa u përket rregulloreve mbi taksat, Shqipëria tashmë ka lidhur marrëveshje dypalëshe me shumë vende në lidhje me taksat. Megjithatë, në rast se do të tërhiqen më tepër investime të huaja, këto marrëveshje duhet të zgjerohen dhe me vende të tjera, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në tregjet ndërkombëtare, si për shembull me vende të Evropës Perëndimore (siç është Mbretëria e Bashkuar) dhe me SHBA-në.

Në vend që të përpiqet që ta bëjë vendin më tërheqës, Qeveria Shqiptare duhet të inkurajojë zhvillimin e zonave të veçanta gjeografike brenda vendit, të cilat përfaqësojnë zona me mundësi të mëdha investimi. Zona të tilla janë ato industriale ose turistike (si për shembull, zonat bregdetare). Zhvillimi i këtyre zonave mund të kërkojë investime dhe burime të mëdha, megjithatë fillimisht mund të ndërmerren projekte pilote, të cilat mund të vihen në zbatim me funksionimin e tyre.

---

*Endrita Xhaferaj: Specialiste, Departamenti i Mbikëqyrjes (Sektori i Analizës dhe Inspektimeve).

REFERENCA

ANIH, (2004), An Investor's Guide to Albania, Albania: Albanian Foreign Investment Promotion Agency

Bevan, A. A. and Estrin, S., (2000), The Determinants of Foreign Direct Investment in Transition Economies, WDI Working Paper No. 342

Broadman, H. G., Anderson, J., Claessens, C. A., Ryterman, R., Slavova, S., Vagliasindi, M., and Vincelette, G. A., (2004), Building Market Institutions in South Eastern Europe: Comparative Prospects for Investment and Private Sector Development, Washington D.C.: The World Bank

EBRD, (1994), "Economic Transition in Eastern Europe and the Former Soviet Union", Transition Report, United Kingdom: EBRD Publication Desk

EBRD, (2001), Albania: Investment Profile 2001, [online], Available at: <http://www1.oecd.org/daf/SPAIcom/pdf/EBRD-InvestProfile-Alb-2001.pdf>

EBRD, (2004), Spotlight on south-eastern Europe: An overview of private sector activity and investment, London: EBRD

European Commission, (2004), The Western Balkans in transition, Occasional Paper no. 5 [online], Available at: <http://europa.eu.int/comm/economy_finance>

Hunya, G., (2004), Foreign Direct Investment in South-East Europe 2003-2004, Vienna (WIIW): Vienna Institute for International Economic Studies

IMF, (2005), Albania – IMF Country Report, No. 05/89, Washington D.C. IMF Publications

INOGATE, (no date), The Republic of Albania – Energy, [online], Available at: <http://www.inogate.org/html/countries/energy/albania_en.htm>

KPMG, (2005), Central and Eastern European Country Snapshots, 2005, KPMG Central and Eastern Europe Ltd

Lavigne, M., (1995), The Economic of Transition: From Socialist Economy to Market Economy, Hampshire and London: Macmillan Press Ltd

Lankes, H.P. and Venables, A.J., (1996), "Foreign direct investment in economic transition: The changing pattern of investments", The Economics of Transition, Vol. 4, Issue 2, page 331-47

London, B. and Ross, R. J.S., (1995), "The Political Sociology of Foreign Direct Investment: Global Capitalism and Capital Mobility, 1965-1980", International Journal of Comparative Sociology, Vol. 36, no. 4, pp. 198-219

OECD, (1994), Assessing Investment Opportunities in Economies in Transition, Paris: OECD

OECD, (2003), National Treatment of International Investment in South East European Countries: Measures Providing Exceptions, [online], Available at: <http://www.oecd.org/dataoecd/2/41/206372.pdf>
OECD - Investment Compact, (2004), The Informal Economy In Albania: Analysis And Policy Recommendations, OECD and CEI Publication
Resmini, L., (2000), "The determinants of foreign direct investment in the CEECs: New evidence from sectoral patterns", The Economics of Transition, Vol. 8, Issue 3, page 665-689
Robertson, D., (1993), A Dictionary of Modern Politics: A guide to the complex ideology and terminology which surrounds the world of politics, 2nd edition, London: Europa Publications Limited
Schmidt, K. D., (1995), "Foreign Direct Investment in Eastern Europe: State-of-the-art and Prospects." in Dobrinsky, R. and Landesmann, M. (eds.), Transforming Economies and European Integration, Aldershot, UK: Edward Elgar
Transparency International, (2004), Transparency International Corruption Perceptions Index 2004, [online], Available at: <http://www.transparency.org/cpi2004.html>
UNCTAD, (no date), Statistical Databases, [online], Available at: <http://www.unctad.org/Templates/Page.asp?intItemID=1888&lang=1>
UNCTAD, (2004a), World Investment Report 2004: The Shift towards Services, United Nations
UNCTAD, (2004b), Prospects for Foreign Direct Investment and the Strategies of Transnational Corporations 2004-2007, United Nations
UNECE, (2005), Economic Survey of Europe 2005, Geneva: United Nations Publications
Xhepa, S. dhe Agolli, M., (2004), Zhvillimi i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, Tiranë: Botimet ISB & ACIT

ROLI I BANKËS SË SHQIPËRISË NË PROCESIN E INTEGRIMIT EVROPIAN

*Elvis Çibuku**

Fjalë kyçe
- MSA - Integrimi evropian - Kriteret e Kopenhagenit - Tregu i Brendshëm - Acquis communautaire -

1. HYRJE

Më datë 12 qershor 2006 Republika e Shqipërisë nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) me Bashkimin Evropian, e cila do të hyjë në fuqi pas ratifikimit nga Kuvendi i Shqipërisë dhe parlamentet e Shteteve Anëtare. Marrëveshja ka për qëllim të afrojë Shqipërinë me BE, duke parashikuar të drejta dhe detyrime reciproke, duke krijuar mekanizma për bashkëpunim në fushat me interes të përbashkët, me qëllim përfundimtar anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit reflekton drejtimet kryesore politike, ekonomike dhe institucionale, të shprehura në të ashtuquajturat "Kritere të Kopenhagenit" për anëtarësimin e një vendi aspirant në Bashkimin Evropian[1]:

- Demokracia dhe shteti i së drejtës, përfshirë edhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e pakicave kombëtare.
- Krijimi i një ekonomie tregu funksionale, të aftë për të përballuar trysninë konkurruese.
- Aftësia për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit, që përfshin edhe adoptimin e *acquis communautaire* në

të drejtën e brendshme dhe zbatimin e saj, nëpërmjet strukturave të duhura administrative dhe gjyqësore.

Gjatë zbatimit të MSA, Republika e Shqipërisë duhet të provojë jo vetëm se ndan të njëjtat vlera me BE, por edhe se disponon kapacitetet e nevojshme për vënien në jetë të detyrimeve të rëna dakord në Marrëveshje.

Detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit për Bankën e Shqipërisë përfshijnë fushat e stabilitetit makroekonomik, lirinë e ofrimit të shërbimeve (shërbimet financiare), lëvizjet e kapitalit si dhe detyrimet në kuadër të përafrimit të legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Evropian.

2. STABILITETI MAKROEKONOMIK

Komisioni Evropian ka përcaktuar metodologjinë për vlerësimin e progresit të vendit të asociuar, në përmbushjen e kriterit ekonomik të Kopenhagenit në Raportet Vjetore[2]. Kriteri për ekzistencën e një ekonomie tregu funksionale duhet të jetë përmbushur, në rastin më të fundit, në momentin e nënshkrimit të traktatit të anëtarësimit. Ndërkohë që elementi i dytë i këtij kriteri – aftësia për t'u përballur me presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian – mund të realizohet pas anëtarësimit.

Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale, siç përcaktohet në Kriteret e Kopenhagenit, përfshin[3]:

- Arritjen e stabilitetit makroekonomik që përfshin stabilitetin e çmimeve, stabilitetin e financave publike si dhe një bilanc të qëndrueshëm pagesash.
- Ekuilibrin ndërmjet kërkesës dhe ofertës, të mbështetur në bashkëveprimin e lirë të forcave të tregut, liberalizimin e çmimeve dhe të tregtisë.
- Eliminimin e barrierave në treg (për sa i përket krijimit të sipërmarrjeve të reja dhe falimentimit të atyre ekzistuese).
- Ekzistencën e një sistemi ligjor, përfshirë edhe rregullimin e të drejtave të pronësisë, zbatimin e ligjeve dhe të kontratave.

- Mirëkuptim të gjerë mbi çështjet kryesore ekonomike.
- Një sektor financiar të zhvilluar, të aftë për shndërrimin e kursimeve në investime produktive.

Regjimi i Asociimit ndërmjet Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian, i parashikuar nga Marrëveshja, nënkupton bashkëpunimin e ngushtë në fushën ekonomike dhe monetare, që synon lehtësimin e reformave dhe të integrimit ekonomik në strukturat evropiane.

3. DETYRIMET QË RRJEDHIN NGA MSA NË FUSHËN E SHËRBIMEVE FINANCIARE

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit ka për qëllim krijimin e një hapësire të tregtisë së lirë ndërmjet Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian[4]. Për këtë arsye, Marrëveshja reflekton liritë e Tregut të Brendshëm, i cili konceptohet si një hapësirë pa kufij ku mallrat, shërbimet, personat dhe kapitali mund të lëvizin lirisht.

Krijimi i Tregut të Brendshëm në sektorin e shërbimeve financiare nënkupton heqjen e kufizimeve diskriminuese lidhur me krijimin ose ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve financiare, duke u krijuar atyre mundësinë e ofrimit të shërbimeve në të gjithë territorin e Komunitetit. Heqja e barrierave ligjore në Shtetet Anëtare, ka për qëllim të nxisë konkurrencën ndërmjet tregjeve kombëtare në shërbimet financiare dhe të ulë çmimet e këtyre shërbimeve për konsumatorët.

Në bazë të dispozitave përkatëse të MSA, institucionet bankare dhe financiare[5] mund të ushtrojnë veprimtari ekonomike në territorin e Shqipërisë ose të Komunitetit, nëpërmjet të drejtës për t'u vendosur dhe të drejtës për të ofruar shërbime.

3.1. VENDOSJA (NENI 50)

Vendosja nënkupton, të drejtën e bankave dhe të institucioneve të tjera financiare komunitare në territorin e Shqipërisë për të

ushtruar veprimtari ekonomike, duke ngritur filiale dhe degë (dhe anasjelltas).

Në bazë të nenit 50 të MSA: "Shqipëria lehtëson fillimin e veprimtarive në territorin e saj nga shoqëri dhe shtetas komunitarë. Për këtë qëllim, ajo garanton me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje: për sa i përket vendosjes së shoqërive komunitare, trajtim jo më pak të favorshëm se ai i akorduar shoqërive të saj ose shoqërive të një vendi të tretë, cilido qoftë më i mirë, dhe, për sa u përket veprimtarive të filialeve dhe degëve të shoqërive komunitare në Shqipëri, pas vendosjes së tyre, trajtim jo më pak të favorshëm se ai i akorduar degëve dhe shoqërive të saj ose të një filiali dhe dege të një shoqërie të një vendi të tretë, cilido qoftë më i mirë".

Në këtë mënyrë, shoqërive komunitare të vendosura në Shqipëri do t'u jepet "trajtim kombëtar" ose trajtim i "kombit më të favorizuar", cilido qoftë më i favorshëm. Dhënia e trajtimit kombëtar institucioneve bankare dhe financiare komunitare, do të thotë mosdiskriminim i tyre mbi baza të shtetësisë (vendit të krijimit) dhe krijim i kushteve të njëjta me institucionet vendase, për sa i përket ushtrimit të veprimtarisë[6]. Në këtë mënyrë, institucionet bankare dhe financiare komunitare janë objekt i të njëjtave ligje, rregullore dhe praktikave administrative si homologët e tyre vendas.

Gjithashtu, Palët në Marrëveshje angazhohen të mos miratojnë rregullime dhe masa të reja të cilat sjellin diskriminim për sa i përket vendosjes së shoqërive komunitare ose shqiptare në territorin e tyre, ose në lidhje me veprimtaritë e tyre, pas vendosjes, në krahasim me shoqëritë e tyre.

3.2. OFRIMI I SHËRBIMEVE (NENI 57)

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit garanton të drejtën e institucioneve bankare dhe financiare komunitare për të ushtruar veprimtarinë e tyre në Shqipëri, pa qenë nevoja për t'u vendosur. Në nenin 57 të saj "Palët angazhohen të ndërmarrin

hapat e nevojshëm për të lejuar në mënyrë progresive ofrimin e shërbimeve nga shoqëritë ose shtetasit komunitarë ose shqiptarë, të cilët janë vendosur në një Palë të ndryshme nga ajo e personit të cilit i drejtohet shërbimi".

Ndryshe nga e drejta për t'u vendosur, e cila garantohet me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes, liberalizimi i ofrimit të shërbimeve është konceptuar si një proces gradual. Në këtë drejtim, pesë vjet pas hyrjes në fuqi të MSA, Këshilli i Stabilizim-Asociimit[7] do të marrë masat e nevojshme për të zbatuar në mënyrë progresive procesin liberalizues, duke marrë parasysh progresin e arritur në përafrimin e legjislacionit në fushën e shërbimeve financiare.

Marrëveshja parashikon gjithashtu, vendosjen e bashkëpunimit ndërmjet Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian në fusha parësore, që lidhen me *acquis communautaire* në sektorët e veprimtarisë bankare dhe të shërbimeve financiare. Në këtë drejtim, Palët bashkëpunojnë me qëllim ngritjen dhe zhvillimin e një kuadri të përshtatshëm për nxitjen e këtyre sektorëve në Shqipëri. Ky bashkëpunim do të fokusohet si në aspektet operacionale të përmirësimit të sektorit financiar, ashtu edhe në përmirësimin e kuadrit mbikëqyrës dhe synon të përfshijë edhe ofrimin e asistencës teknike dhe trainimeve.

Dispozitat e Marrëveshjes për vendosjen dhe ofrimin e shërbimeve janë reflektuar plotësisht në projektligjin për bankat në Republikën e Shqipërisë. Sipas këtij projektligji, bankat komunitare mund të ushtrojnë veprimtari bankare në Shqipëri nëpërmjet një dege, për licencimin e së cilës zbatohen të njëjtat kushte si për bankat shqiptare. Për sa u përket filialeve të bankave komunitare, ato konsiderohen si banka shqiptare në të gjitha aspektet, prandaj asnjë dallim nuk parashikohet lidhur me krijimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së tyre.

3.3. PARANDALIMI I PASTRIMIT TË PARAVE DHE I FINANCIMIT TË TERRORIZMIT

Neni 82 i MSA përcakton: "Shqipëria dhe Komuniteti Evropian do të bashkëpunojnë në drejtim të parandalimit të përdorimit të

sistemeve të tyre financiare për qëllime të pastrimit të pasurive, që rrjedhin nga veprimtaritë kriminale në përgjithësi dhe nga trafiku i drogës në veçanti, si dhe për qëllime të financimit të terrorizmit".

Në këtë drejtim, roli i Bankës së Shqipërisë, si institucion rregullues dhe mbikëqyrës i sistemit bankar në Shqipëri, është të forcojë sistemin e mbikëqyrjes të veprimtarive ndërkombëtare të bankave si dhe bashkëpunimin me autoritetet mbikëqyrëse të degëve dhe të filialeve të bankave komunitare, të vendosura në Shqipëri. Si parakusht për funksionimin efektiv të këtij bashkëpunimi, shërben ndërtimi e një kuadri të plotë rregullues për shkëmbimin e të dhënave me autoritetet përgjegjëse Komunitare në fushën e mbikëqyrjes së veprimtarive bankare, në juridiksionet përkatëse.

Aktet që normojnë sekretin bankar mund të bëhen një pengesë për shkëmbimin e informacionit ndërmjet degëve dhe filialeve të bankave të vendosura në territorin e Shqipërisë apo të Komunitetit, Bankës së Shqipërisë dhe organeve mbikëqyrëse të Shteteve Anëtare. Për këtë arsye, është e nevojshme që rregulloret që normojnë sekretin bankar, të lehtësojnë shkëmbimin e lirë të këtij informacioni, duke garantuar në të njëjtën kohë edhe konfidencialitetin e të dhënave të transmetuara në këtë mënyrë.

4. LËVIZJA E KAPITALIT DHE PAGESAT RRJEDHËSE

Lëvizja e lirë e kapitalit në Bashkimin Evropian, përveç qëllimeve ekonomike, shërben si parakusht për funksionimin e lëvizjes së lirë të personave, të mallrave dhe të shërbimeve, duke realizuar në këtë mënyrë funksionimin efikas të Tregut të Brendshëm.

Nga pikëpamja e Komisionit Evropian, ekzistojnë tre kategori operacionesh të lidhura me liberalizimin progresiv të lëvizjeve të kapitalit[8]:

- operacionet kapitale: operacione të tilla si kreditë tregtare ose investimet direkte që janë të lidhura me ushtrimin e lirive të tjera themelore të Tregut të Brendshëm;
- operacionet në letrat me vlerë të tregut financiar: liberalizimi i letrave me vlerë si bonot e thesarit apo aksionet, kërkon ekzistencën e një tregu të vetëm financiar në nivel evropian;
- operacionet që përfshijnë kreditë financiare: liberalizimi i këtyre operacioneve, si dhe i operacioneve që lidhen me instrumentet e tregut të parasë është i nevojshëm për krijimin e një tregu financiar të unifikuar.

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, në nenin 61 të saj, parashikon vetëm liberalizimin e operacioneve kapitale, i cili përbën fazën e parë në drejtim të arritjes së lirisë së plotë të lëvizjeve të kapitalit ndërmjet Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian. Nga ana tjetër, liberalizimi i parashikuar në MSA përfshin vetëm dy prej kategorive të mësipërme, përkatësisht liberalizimin e operacioneve kapitale[9] dhe të operacioneve që lidhen me kreditë financiare[10].

Në dallim nga Traktati për krijimin e Komunitetit Evropian ku lëvizjet e kapitalit dhe pagesat rrjedhëse trajtohen në të njëjtën mënyrë, Marrëveshja e Stabilizim Asociimit garanton liberalizimin e plotë të pagesave rrjedhëse dhe liberalizim progresiv për lëvizjen e kapitalit[11]. Kjo do të thotë se të gjitha kufizimet mbi pagesat rrjedhëse ndërmjet Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian janë të ndaluara.

Një rregullim i tillë është mbështetur edhe nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë, sipas së cilës: "...jo të gjitha transferimet fizike të aseteve financiare përbëjnë lëvizje të kapitalit". Pas krahasimit të dispozitave përkatëse të Traktatit, Gjykata arriti në përfundimin se pagesat rrjedhëse janë trasferta të valutës së huaj të cilat përbëjnë shpërblim në kontekstin e një transaksioni të caktuar, ndërsa lëvizjet e kapitalit janë operacione financiare të lidhura ngushtësisht me investimin e fondeve[12].

Vlen për t'u theksuar fakti që *acquis communautaire* në fushën e lëvizjes së kapitalit nuk e merr parasysh një dallim të

tillë, duke i trajtuar lëvizjen e kapitalit dhe pagesat rrjedhëse në të njëjtën mënyrë. Për këtë arsye, adoptimi i plotë i *acquis* në këtë fushë, do ta bënte ta parëndësishëm dallimin e parashikuar nga MSA.

Si përfundim, mund të themi se zbatimi i detyrimeve të Marrëveshjes në fushën e lëvizjes së kapitalit dhe pagesave rrjedhëse, nënkupton eliminimin e pengesave administrative për kontrollin dhe autorizimin e lëvizjeve të kapitalit. Në këtë drejtim, Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me Këshillin e Ministrave, është përgjegjëse për krijimin e kuadrit ligjor dhe administrativ për zbatimin e normativës komunitare në këtë fushë, sidomos për sa i përket përjashtimeve nga liria e lëvizjes së kapitalit në rastin e vështirësive të rënda ekonomike dhe monetare.

5. PËRAFRIMI DHE ZBATIMI I LEGJISLACIONIT

Adoptimi dhe implementimi në mënyrën e duhur i *acquis communautaire* në sistemin vendas është kushti themelor për integrimin evropian të shteteve që aspirojnë asociimin dhe më pas anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Në bazë të nenit 70 të Marrëveshjes "Shqipëria duhet të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të përafrohen gradualisht me *acquis communautaire*, duke siguruar në të njëjtën kohë që legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm të zbatohet në mënyrën e duhur".

Në *acquis communautaire* që do të adoptohet në legjislacionin vendas, bën pjesë legjislacioni parësor i BE (Traktatet themeluese dhe marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Bashkimi është palë), legjislacioni dytësor (rregulloret, direktivat, vendimet dhe rekomandimet), vendimet e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë dhe të Gjykatës së Shkallës së Parë, si dhe politikat komunitare dhe parimet e përgjithshme të së drejtës në Bashkimin Evropian.

Përafrimi i legjislacionit fillon në datën e nënshkrimit të Marrëveshjes dhe shtrihet gradualisht në tërë elementet e *acquis communautaire*. Gjatë fazës së parë (5 vjet nga hyrja në fuqi

e MSA), përafrimi përqendrohet në elementet thelbësore të *acquis* së Tregut të Brendshëm ashtu si dhe në fusha të tjera të rëndësishme (ku bëjnë pjesë edhe shërbimet financiare). Gjatë fazës së dytë, përafrimi i legjislacionit do të shtrihet në fushat e tjera të Tregut të Brendshëm.

5.1. PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT NË SEKTORIN E SHËRBIMEVE FINANCIARE

Siç u përmend edhe më sipër, funksionimi i Tregut të Brendshëm në fushën e shërbimeve financiare, nënkupton lirinë e ofrimit ndërkufitar të shërbimeve financiare në të gjithë territorin e Komunitetit, si dhe eliminimin e të gjitha pengesave ligjore dhe administrative për krijimin e degëve dhe filialeve të institucioneve financiare komunitare.

Tregu i Brendshëm në shërbimet financiare mbështetet mbi këto parime themelore[13]:

- harmonizimi thelbësor i ligjeve dhe i praktikave të Shteteve Anëtare lidhur me krijimin dhe ushtrimin e veprimtarisë financiare;
- kontrolli nga ana e shtetit-mëmë, që do të thotë se një bankë mbikëqyret nga autoritetet përkatëse të shtetit të origjinës (shteti ku është licencuar dhe ku ndodhet qendra e saj), pavarësisht se veprimtarinë bankare mund ta ushtrojë në një shtet tjetër;
- njohjen reciproke nga autoritetet mbikëqyrëse kombëtare të ligjeve dhe rregulloreve të shtetit të origjinës së bankave, që ushtrojnë veprimtarinë në territorin e tij.

Nga ana tjetër, dispozitat e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit duken më kufizuese në këtë drejtim dhe garantojnë vetëm njohjen e "trajtimit kombëtar" (mosdiskriminimit) ndaj personave fizikë dhe juridikë të huaj, koncept i cili përbën vetëm një prej llojeve të kufizimeve në fushën e vendosjes apo të ofrimit të shërbimeve. Arsyeja e një rregullimi të tillë qëndron në faktin që MSA nuk ka për qëllim unifikimin e tregut shqiptar dhe atij

komunitar në një të vetëm, por thjesht krijimin e një hapësire të tregtisë së lirë ndërmjet këtyre dy subjekteve.

Për këtë arsye, përafrimi i legjislacionit vendas me atë të BE, në fushën e shërbimeve financiare, do të fokusohet në adoptimin e Direktivës së parë bankare 77/780/EEC (konsoliduar në Direktivën 2000/12/EC), e cila përcakton kushtet kryesore për autorizimin e institucioneve të kreditit, parimet e së drejtës për t'u vendosur dhe lirisë për të ofruar shërbime, si dhe të ngritjes së autoritetit mbikëqyrës.

Harmonizimi i plotë me *acquis* në fushën e shërbimeve financiare nënkupton adoptimin, nga ana e Bankës së Shqipërisë, e rregullave mbi instrumentet teknike të mbikëqyrjes së kujdesshme dhe konkretisht:

- Fondet e veta: Direktiva 2000/12/EC përcakton elementet e kapitalit që llogariten në kapitalin rregullator dhe i ndan ato në dy kategori: kapitalin bazë dhe kapitalin shtesë. Kapitali shtesë nuk mund të tejkalojë kapitalin bazë.
- Norma e pagueshmërisë: fondet e veta të çdo institucioni krediti përkufizohen si një raport i aktiveve me zërat jashtë bilancit, të ponderuara me rrezikun. Kjo ka të bëjë me rrezikun e kredisë që rrjedh në rastin e mospagimit nga një huamarrës dhe bën një dallim ndërmjet shkallëve të rrezikut të lidhur me aktivet individuale dhe zërat jashtë bilancit, dhe me disa kategori specifike huamarrësish. Norma minimale e pagueshmërisë për një institucion krediti është 8 për qind.
- Ekspozimet e mëdha: Direktiva 2000/12/EC e kufizon ekspozimin e bankës ndaj një klienti të vetëm, deri në një maksimum të barabartë me 25 për qind të fondeve të veta. Të gjitha ekspozimet e mëdha (të barabarta ose më shumë se 10 për qind e fondeve të veta) duhet t'i raportohen autoritetit mbikëqyrës dhe institucioni i kreditit nuk mund të marrë përsipër ekspozime, të cilat të marra së bashku tejkalojnë 800 për qind të kapitalit rregullator.

- Mbikëqyrja mbi një bazë të konsoliduar e institucioneve të kreditit, zbatohet mbi të gjitha grupet bankare përfshirë edhe ato, sipërmarrja-mëmë e të cilave nuk është bankë. Direktiva 2000/12/EC përmban dispozita mbi autoritetin ose autoritetet përgjegjëse për mbikëqyrjen e konsoliduar dhe për mënyrën e bashkëpunimit ndërmjet tyre. Autoritetet mbikëqyrëse duhet të kërkojnë konsolidimin e plotë të të gjitha institucioneve të kreditit ose financiare, të cilat janë filiale të një institucioni-mëmë.

Si përfundim, mund të themi se në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, Republika e Shqipërisë është angazhuar të adoptojë të gjithë legjislacionin evropian në fushën e shërbimeve financiare, por pa iu krijuar kushtet institucioneve financiare komunitare për t'u vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë pa qenë nevoja për t'u licencuar. Gjithashtu, veprimi i këtyre institucioneve në Republikën e Shqipërisë do të jetë objekt i rregullimit dhe i mbikëqyrjes nga ana e Bankës së Shqipërisë.

5.1. PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E LËVIZJES SË KAPITALIT DHE PAGESAVE

Lëvizja e lirë e kapitalit përbën një element thelbësor të Tregut të Brendshëm dhe shteti i asociuar mund të përfitojë nga kjo liri, në përputhje me zhvillimin e tij ekonomik. Sikurse në rastin e shërbimeve financiare, për lëvizjen e kapitalit Marrëveshja parashikon një liberalizim në dy faza. Në fazën e parë do të realizohen përmirësimet e nevojshme për hyrjen në treg, të cilat synojnë krijimin e kushteve për zbatimin e mëvonshëm të rregullave të Komunitetit në fushën e lëvizjes së lirë të kapitalit.

Legjislacioni i Bashkimit Evropian, në fushën e lëvizjes së lirë të kapitalit mbështetet në disa parime të përgjithshme[14]:

- Heqja e kontrolleve mbi kapitalin dhe pagesat nuk përfshin vetëm kufizimet mbi shkëmbimet e jashtme, por çdo rregullim administrativ i cili diskriminon mbi baza të

burimit ose destinacionit të kapitalit.

- Të drejtat që rrjedhin nga lëvizja e lirë e kapitalit janë të lidhura me konceptin e rezidencës së personave që kryejnë transfertat dhe jo me atë të kombësisë.
- Lëvizja e lirë e kapitalit prezumon heqjen, jo vetëm të ndalimeve të përgjithshme, por edhe të procedurave të hapura apo të heshtura të autorizimit.
- Disa kufizime të përgjithshme mbi këtë liri mund të vazhdojnë ende të zbatohen. Këto kufizime përfshijnë sigurinë kombëtare dhe politikën publike, por nuk shtrihen ndaj interesave më të gjerë ekonomikë, si për shembull: politika monetare[15].

Në fazën e dytë, palët angazhohen për zbatimin e plotë të rregullave komunitarë në këtë sektor[16]. Adoptimi i legjislacionit evropian në këtë fushë, nënkupton liberalizimin e plotë të lëvizjes së kapitalit. Sipas nenit 56 të Traktatit të krijimit të Komunitetit Evropian "ndalohen të gjitha kufizimet në lëvizjen e kapitalit dhe pagesave ndërmjet Shteteve Anëtare si dhe midis këtyre të fundit dhe vendeve të treta". Ky parim është zbërthyer në Direktivën 88/361/EEC për implementimin e nenit 67 të Traktatit, e cila shfuqizon të gjitha kufizimet e përgjithshme mbi lëvizjen e kapitalit ndërmjet personave rezidentë në Shtetet Anëtare[17].

Përvoja e Bashkimit Evropian tregon se nuk ekziston ndonjë parakusht ligjor apo administrativ për liberalizimin e lëvizjeve të kapitalit. Ndikimin e vet më të rëndësishëm heqja e kufizimeve të lëvizjeve të kapitalit nuk e ushtron mbi strukturat administrative, por në administrimin e politikave të shtetit të asociuar. Në mungesë të kontrolleve, hyrjet apo daljet e kapitalit në sasi të mëdha mund të ndërlikojnë ushtrimin e politikës monetare dhe atë të shkëmbimit valutor. Për këtë arsye, përafrimi i legjislacionit në këtë fushë presupozon një mjedis të përgjithshëm makroekonomik të qëndrueshëm.

Liberalizimi i lëvizjeve të kapitalit ka lehtësuar transfertat ndërkufitare të parave brenda Bashkimit Evropian, megjithatë ende ekzistojnë dallime ndërmjet legjislacioneve të Shteteve Anëtare lidhur me pagesat, dallime që mund të bëhen pengesë

për funksionimin e Tregut të Brendshëm në këtë fushë. Për këtë arsye, harmonizimi ligjor në Bashkimin Evropian në sektorin e lëvizjes së lirë të pagesave, synon standardizimin e metodave teknike dhe zbatimin e rregullave të njëjtë për transaksionet dhe pagesat e brendshme dhe ato ndërkufitare, të cilat lehtësojnë lëvizjen e lirë të kapitalit dhe forcojnë besimin e konsumatorëve në Tregun e Brendshëm.

Në funksion të krijimit të kushteve për zbatimin gradual të rregullave komunitarë mbi lëvizjen e lirë të kapitalit (detyrim që rrjedh nga neni 62 i MSA), veprimtaria normative e Bankës së Shqipërisë duhet të përqendrohet në adoptimin e akteve të mëposhtme të Bashkimit Evropian që rregullojnë sistemet e pagesave:

Direktiva 97/5/EC mbi transfertat ndërkufitare të kredisë, e cila përcakton informacionin minimal që duhet t'u jepet klientëve si dhe kushtet për transferimin e shpejtë, të lirë dhe të besueshëm të kredive (deri në 50 000 euro) brenda Komunitetit. Kjo Direktivë është plotësuar nga Rregullorja 2560/2001/EC mbi pagesat ndërkufitare në euro, e cila i shtrin efektet e Direktivës mbi të gjitha llojet e pagesave.

Direktiva 98/26/EC për finalitetin e transfertave në sistemet e transferimit të pagesave dhe letrave me vlerë, e cila synon të kontribuojë në funksionimin efikas dhe me kosto të ulët të pagesave ndërkufitare dhe letrave me vlerë në Komunitet, duke lehtësuar në këtë mënyrë lëvizjen e lirë të kapitalit.

Rekomandimi 97/489/EC lidhur me transaksionet me instrumentet e pagesave elektronike përcakton informacionin minimal që duhet t'i ofrohet konsumatorit gjatë transaksioneve me instrumente elektronike të pagesave (informacioni mbi tarifat, normat e shkëmbimit dhe normat e interesit) si dhe përgjegjësitë e palëve në transaksion.

Vlen për t'u theksuar se përafrimi i legjislacionit të BE është një kusht i panegociueshëm. Duke qenë se synimi përfundimtar i Republikës së Shqipërisë është anëtarësimi në Bashkimin

Evropian, i vetmi faktor i negociueshëm në procesin e përafrimit të legjislacionit është afati i përfundimit të këtij procesi si dhe periudhat e mundshme tranzitore.

6. PËRFUNDIME

Zbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit dhe përpjekjet për adoptimin e *acquis communautaire* në të drejtën e brendshme, nuk duhen konsideruar si një qëllim në vetvete. Standardet Evropiane në fushat e shërbimeve financiare dhe të lëvizjes së kapitalit, nga ana e tyre, reflektojnë parimet ndërkombëtare të adoptuara në kuadër të Organizatës Botërore të Tregtisë dhe Komitetit të Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare.

Duke adoptuar të drejtën e Bashkimit Evropian, Shqipëria jo vetëm që do të lehtësojë anëtarësimin e saj të ardhshëm në BE, por do të përshtatë kuadrin e saj ligjor dhe administrativ ndaj standardeve ndërkombëtare, duke promovuar integrimin e saj në komunitetin bankar ndërkombëtar.

Adoptimi i *acquis communautaire* në të drejtën e brendshme nuk duhet konsideruar si një proces formal dhe abstrakt i adoptimit të rregullave komunitarë në ligjet dhe rregulloret shqiptare. Kjo, pasi procesi i adoptimit të legjislacionit ekonomik dhe atij bankar në veçanti, duhet të jetë në përshtatje me kontekstin ekonomik dhe strukturën e tregut, në të cilin do të zbatohen. Siç përcaktohen nga Komisioni Evropian në Librin e Bardhë, tre elementet për funksionimin korrekt të sektorit financiar janë: a) personel i trainuar dhe me reputacion; b) legjislacion i përshtatshëm; dhe c) organe mbikëqyrëse efikase që garantojnë zbatimin e legjislacionit dhe të rregulloreve nga ana e institucioneve financiare.

SHËNIME

*Elvis Çibuku: Specialist, Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Evropian dhe Komunikimit. Tiranë, 11 korrik 2006.

[1] Përfundimet e Presidencës së Këshillit Evropian të Kopenhagenit (21-22 qershor 1993), faqe 13.

[2] Për më shumë informacion, shih: Raportin e fundit Vjetor të Komisionit Evropian për Shqipërinë; Bruksel, 9 nëntor 2005 {COM (2005) 561 final}.

[3] Shih: Progresi drejt përmbushjes së kriterit ekonomik të anëtarësimit; Nr. 26; Komisioni Evropian; nëntor 2005.

[4] Sipas nenit 1, paragrafi 2 të MSA, "Asociimi ka për qëllim (ndër të tjera) të mbështesë përpjekjet e Shqipërisë për të përfunduar kalimin në një ekonomi tregu funksionale, të promovojë marrëdhënie ekonomike harmonike dhe të zhvillojë gradualisht një zonë të tregtisë së lirë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë".

[5] Në legjislacionin e Bashkimit Evropian këto njihen me emrin e përbashkët "institucione krediti" dhe përfshijnë sipërmarrjet, veprimtaria e së cilave është mbledhja e depozitave ose e fondeve të tjera të ripagueshmme nga publiku, dhënia e kredive për llogari të vet si dhe institucionet e parasë elektronike (neni1/1 i Direktivës 2000/12/EC).

[6] Instrumenti i Trajtimit Kombëtar; Organizata për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillimin (2000).

[7] Në bazë të nenit 116 të MSA, Këshilli i Stabilizim-Asociimit është organi përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Marrëveshjes, i përbërë nga anëtarë të Këshillit të Bashkimit Evropian, Komisionit Evropian dhe Qeverisë Shqiptare.

[8] Komunikata e Komisionit në Këshill, 23 maj 1986, për programin e liberalizimit të lëvizjeve të kapitalit në Komunitet; COM(1986) 292.

[9] Sipas nenit 61/1 të MSA: "Në lidhje me transaksionet në llogarinë kapitale dhe atë financiare të bilancit të pagesave, me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes, Shqipëria dhe Komuniteti do të sigurojnë lëvizjen e lirë të kapitalit lidhur me investime direkte në shoqëritë e krijuara në përputhje me legjislacionin e vendit pritës, si dhe likuidimin ose riatdhesimin e këtyre investimeve dhe të çdo përfitimi që rrjedh prej tyre".

[10] Sipas nenit 61/2 të MSA: "Për sa u përket transaksioneve në llogarinë kapitale dhe financiare të bilancit të pagesave, me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes, Palët do të sigurojnë lëvizjen e lirë të kapitalit për sa u përket kredive që lidhen me transaksionet tregtare ose me ofrimin e shërbimeve ku merr pjesë një rezident i njërës prej Palëve, dhe huave financiare dhe kredive, me afat maturimi më të gjatë se një vit. Duke filluar nga viti i pestë i hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, do të garantohet lëvizja e lirë e kapitalit për investimet në letrat me vlerë dhe huatë financiare, dhe kreditë me një afat maturimi më të shkurtër se një vit".

[11] Në nenin 60 të Marrëveshjes, "Shqipëria dhe Komuniteti Evropian angazhohen të autorizojnë, në monedha të këmbyeshme lirisht, në përputhje me dispozitat e Nenit VIII të Neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar, çdo pagesë apo transfertë në llogarinë rrjedhëse të bilancit të pagesave ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë".

[12] Çështjet 286/82 dhe 26/82 Luisi dhe Carbone kundër Ministrisë së Thesarit (1984); ECR 377.
[13] Këto parime janë vendosur nga Direktiva e dytë bankare 89/646/EEC (konsoliduar në Direktivën 2000/12/EC), e cila përbën instrumentin kryesor për plotësimin e Tregut të Brendshëm në sektorin bankar. Direktiva prezanton parimin e licencës së vetme bankare ose autorizimin, i cili u njeh bankave të drejtën për të krijuar degë në shtete të tjera anëtare ose të ofrojnë shërbime bankare pa pasur nevojë për autorizim të ri në shtetin pritës (pas njoftimit të autoriteteve përkatëse të këtij të fundit).
[14] Aneksi i Librit të Bardhë për përgatitjen e vendeve të asociuara të Evropës Qendrore dhe Juglindore për integrim në Tregun e Brendshëm të Bashkimit; COM (95) 163, Bruksel, 10.05 1995.
[15] Një rregullim i tillë reflektohet edhe nenin 61/4 të MSA, sipas të cilit: "Në rrethana të jashtëzakonshme, kur lëvizjet e kapitalit ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë shkaktojnë ose kërcënojnë të shkaktojnë vështirësi serioze për funksionimin e politikave të kursit të këmbimit ose politikave monetare, Komuniteti dhe Shqipëria përkatësisht, mund të marrin masa mbrojtëse lidhur me lëvizjet e kapitalit ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë për një periudhë jo më të gjatë se një vit, në qoftë se masa të tilla janë më se të nevojshme".
[16] Sipas nenit 62 të MSA: "Gjatë tri viteve të para nga momenti i hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, Palët marrin masa që lejojnë krijimin e kushteve të nevojshme për zbatimin e mëtejshëm gradual të rregullave të Komunitetit për lëvizjen e lirë të kapitalit. Në përfundim të vitit të tretë nga momenti i hyrjes në fuqi, Këshilli i Stabilizim-Asociimit përcakton modalitetet për zbatimin e plotë të rregullave të Komunitetit për lëvizjen e kapitalit".
[17] Lëvizje të kapitalit, në kuptimin e Direktivës, konsiderohen investimet direkte, investimet në pasuritë e paluajtshme, veprimet me letrat me vlerë dhe në llogaritë rrjedhëse dhe ato të depozitave, si dhe huatë financiare dhe kreditë.

BIBLIOGRAFIA

Marrëveshjet e Evropës; Komunikatë e Komisionit në Këshill; COM (94) 320; Bruksel, 13.07.1994.

Marrëveshjet e Asociimit me vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore; COM (90) 398; Bruksel, 27.08.1990.

Libri i Bardhë për përgatitjen e vendeve të asociuara të Evropës Qendrore dhe Juglindore për integrim në Tregun e Brendshëm të Bashkimit; COM (95) 163, Bruksel, 10.05 1995.

Raporti i Komisionit mbi punën e Grupit të Nivelit të Lartë Drejtues mbi përgatitjen për negocimin e një Marrëveshjeje Stabilizim Asociimi me Shqipërinë; Bruksel, 06.06.2001.

Raporti Vjetor i Komisionit Evropian për Shqipërinë; COM (2005) 561, Bruksel, 09.11.2005.

INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË SHQIPËRI (VITI FISKAL 2004)

*Argita Frashëri**

Fjalë kyçe
- Investimet e huaja direkte - Kapital i huaj - Ndërmarrje -

HYRJE

Investimet e huaja direkte (IHD) zënë një vend të rëndësishëm në panoramën ekonomike të vendeve në zhvillim. Ato sigurojnë investime të nevojshme për rritjen ekonomike dhe zhvillimin e teknologjisë, kur kursimet e brendshme nuk mund t'i sigurojnë ato. Gjithashtu, flukset e kapitalit shërbejnë si sinjal që tregon se kushtet e ekonomisë së një vendi kanë ndryshuar, në raport me ato jashtë. Këto flukse ndikojnë mbi një sërë variablash ekonomikë të një vendi, si në deficitin e llogarisë korente, në kursin e këmbimit, në kursimet dhe investimet në vend, në punësimin etj..

Shumë vende në zhvillim kanë përfituar nga flukset e kapitalit në formën e IHD-ve. Duke luftuar mungesën e kapitalit nga e cila vuanin tregjet e mbyllura, ato kanë favorizuar përdorimin efikas të këtyre burimeve, si dhe kanë krijuar një mjedis konkurrues që u ofron investitorëve rendimente gjithnjë e më të larta.

Një efekt pozitiv afatgjatë i IHD është transferimi nga vendet e origjinës në vendet pritëse të tyre, i teknologjisë së prodhimit dhe i mënyrave më efikase të organizimit industrial. Në këtë vazhdë, IHD ka gjithashtu efekt pozitiv edhe mbi rendimentin e firmave

vendase. Në përgjithësi, marrëdhënia shkakësore e dyanshme ndërmjet IHD dhe stabilitetit ekonomik e politik ka qenë pozitive[1], pra stabiliteti ekonomik dhe politik ka nxitur nivele më të larta të IHD. Nga ana tjetër, përqendrimi i lartë i IHD në një vend ka ndikuar pozitivisht në stabilitetin e vendit. Një tjetër aspekt pozitiv është fakti që, megjithë tendencat e ciklikalitetit, kapitali i ardhur në formën e IHD nuk është lehtësisht i transferueshëm brenda një kohe të shkurtër, pra paraqet më pak rrezikshmëri se format e tjera të kapitalit financiar për stabilitetin monetar të një vendi.

Përveç përparësisë për hartimin e një kuadri institucional për nxitjen e investimeve të huaja në Shqipëri, një domosdoshmëri e kohës është matja e saktë e IHD-ve në vend. Për këtë qëllim, Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Institutin e Statistikave organizon anketime të përvitshme pranë ndërmarrjeve me pjesëmarrje të huaj në kapitalin themeltar të tyre. Qëllimi i këtyre vrojtimeve qëndron në evidentimin e investimeve të huaja në Shqipëri, nëpërmjet anketimit në shkallë kombëtare të ndërmarrjeve me kapital të huaj dhe të përbashkët, që zhvillojnë aktivitetin e tyre në Shqipëri.

Vrojtimi që po analizojmë është i dyti në rradhën e anketimeve të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë. Për monitorimin e kësaj baze të dhënash, Banka e Shqipërisë ka planifikuar organizimin e anketimeve vjetore. Këto anketime do të realizohen mbi një vëllim zgjedhjeje të nxjerrë nga popullata e ndërmarrjeve të investimit direkt në vend. Ndërkohë, anketimi gjithëpërfshirës i IHD-ve në Shqipëri do të kryhet me një frekuencë 3-vjeçare.

Për Bankën e Shqipërisë, suksesi i kësaj nisme është i një rëndësie të veçantë, jo vetëm për përllogaritjen e saktë të fluksit të investimeve të huaja në Shqipëri, por gjithashtu për llogaritjen e stokut të këtyre investimeve, që do të shërbejë si bazë për hartimin e pozicionit ndërkombëtar të investimeve (PNI) të Shqipërisë.

Kuadri ligjor dhe ekonomia informale bëjnë që të mos kemi një statistikë të plotë dhe afër realitetit mbi investimet e huaja direkte në Shqipëri.

Krijimi i një historiku të dhënash për kapitalin e huaj në formën e investimeve direkte si dhe analizat studimore të rezultateve të vrojtimeve, mundësojnë një kuadër të qartë të origjinës së kapitalit të huaj të hyrë në Shqipëri, sektorët e ekonomisë që kanë thithur më shumë kapitale të huaja, si dhe ndikimin e tyre në ekonominë vendase.

Analiza e karakteristikave të tregut të investimeve të huaja direkte në Shqipëri si dhe produktivitetit të tyre, mund të shërbejë si një faktor nxitës në hapjen e ndërmarrjeve të reja me kapital të huaj në vend.

Materiali vijon me përcaktime dhe metodologji të lidhura me konceptin e IHD-ve. Në këtë seksion përshkruhet metoda e ndjekur për vlerësimin e stokut të kapitalit të huaj. Analiza e rezultateve të vrojtimit është ndarë në dy seksione bazë. Seksioni i dytë, analizon karakteristikat numerike të ndërmarrjeve me kapital të huaj dhe të përbashkët që zhvillojnë aktivitet në Shqipëri (të tilla si shpërndarja sektoriale e ndërmarrjeve, origjina e tyre, shpërndarja zonale e ndërmarrjeve me kapital të huaj në vend, përqendrimi i fuqisë punëtore etj.).

Në seksionin e tretë, analizohen karakteristikat sasiore të IHD-ve, që kanë të bëjnë kryesisht me vlerësimin e stokut të kapitalit sipas vendit të origjinës dhe me shpërndarjen e tij sipas sektorëve të ekonomisë.

1. PËRCAKTIME DHE METODOLOGJI

Megjithëse përkufizimi i investimeve të huaja direkte ka pësuar ndryshime në vite, historikisht një kufi i caktuar pjesëmarrjeje me kapital dhe ideja që investitori planifikon të shfaqë influencë kontrolli në ndërmarrje, kanë qenë ngushtësisht të lidhura me kuptimin e IHD-ve. Në përpjekjet për harmonizim, FMN dhe OECD kanë zhvilluar një përkufizim të përbashkët: "...investimi i huaj direkt reflekton qëllimin e sigurimit të një interesi të qëndrueshëm nga një njësi rezidente e një ekonomie (investitor direkt) në një njësi rezidente të një tjetër ekonomie (ndërmarrje e investimit direkt)...".

Investimi i huaj direkt përfshin së bashku transaksionin fillestar për vendosjen e marrëdhënies ndërmjet investitorit dhe ndërmarrjes, dhe të gjitha transaksionet kapitale pasuese ndërmjet tyre dhe ndërmjet filialeve, pavarësisht formës ligjore në të cilën janë regjistruar – si persona juridikë apo persona fizikë.

Botimi i Pestë i Manualit të Bilancit të Pagesave të FMN-së (BPM5) përcakton si investitor direkt pronarin e 10 për qind ose më shumë të kapitalit të një ndërmarrjeje. Kjo përqindje përdoret si kufi ndarjeje ndërmjet investimit direkt dhe investimit të portofolit si pjesëmarrje në aksione. Kështu, kur një jorezident, i cili nuk ka pjesëmarrje të mëparshme në kapitalin e një ndërmarrjeje rezidente, blen 10 për qind ose më shumë aksione të kësaj ndërmarrjeje, çmimi i aksioneve të siguruara duhet të regjistrohet si investim direkt. Nga ky moment, transaksionet e kapitalit të mëpastajme ndërmjet këtyre dy ndërmarrjeve, duhet të regjistrohen si investim direkt.

Investitorët direktë mund të jenë individë, ndërmarrje publike ose private të korporuara ose jo, një grup individësh ose ndërmarrjesh, qeveri ose agjenci të ndryshme qeveritare.

Kapitali i investimit direkt është (i) kapital i siguruar (në mënyrë direkte ose jo) nga një investitor direkt tek ndërmarrja që e përfiton këtë investim, ose (ii) kapital i marrë nga ndërmarrja prej një investitori direkt.

Përbërësit e kapitalit të investuar direkt janë kapitali i vet, fitimi i riinvestuar dhe çdo kapital tjetër që shoqëron transaksione të tjera borxhi.

- Kapitali i vet përfshin kapitalin në degë, të gjitha aksionet në degë ose filiale si dhe kontribute të tjera kapitali.
- Fitimi i riinvestuar janë aksionet e investitorit (në raport me pjesëmarrjen e tij në kapitalin e vet) të fitimit të pashpërndarë në formë dividentësh ose fitimi i realizuar nga degët por që nuk i ka kaluar investitorit direkt.

1.1 LLOGARITJA E STOKUT TË INVESTIMEVE DIREKTE

Në paraqitjen e statistikave të investimeve direkte mbahet parasysh fakti, që investimet direkte konsistojnë në lidhjet e kapitalit të huaj direkt, të lindura si rrjedhim i interesave pjesëmarrës të njësive jorezidente në ndërmarrjet brenda vendit. Në stokun e IHD-ve përfshihen përbërësit e mëposhtëm:

1. aksionet në kapitalin nominal (kapitali i nënshkruar) të zotëruara direkt nga aksionerët e huaj;

plus

2. pjesa në rezerva e kapitalit të huaj (rezervat e domosdoshme ligjore), si dhe në fitimet e mbartura për vitin pasardhës dhe në fitimet e vitit ushtrimor, për t'iu atribuar aksionerëve direktë. Këto ndarje përcaktohen proporcionalisht në bazë të aksioneve respektive të aksionerëve direktë individualë në kapitalin nominal;

minus

3. pjesa në humbjet e mbartura për vitin pasardhës dhe humbjet nga viti ushtrimor që u atribuohen aksionerëve direktë.

Agregimi i përbërësve të mësipërm jep kapitalin e investuar direkt.

Veç kësaj kapitali i investuar direkt përfshin:

4. huamarrjet/huadhëniet direkte ose indirekte të aksionerëve në vend ose jashtë vendit;

plus

5. huatë direkte nga ndërmarrjet e lidhura, domethënë investimet direkte jashtë - huatë nga ndërmarrjet e bashkuara në vend – dhe në rastin e investimeve direkte në vend – huatë nga ndërmarrjet e bashkuara me qendër (rezidencë) jashtë vendit.

Në llogaritjen e stokut të IHD-ve për këtë analizë, për mungesë informacioni statistikor janë përfshirë tre hapat e parë të përshkrimit të mësipërm.

2. KARAKTERISTIKA NUMERIKE TË NDËRMARRJEVE ME KAPITAL TË HUAJ NË VEND

2.1 INVESTIMET E HUAJA DIREKTE (IHD) SIPAS VENDIT TË ORIGJINËS

Sipas vendit të origjinës Italia dhe Greqia ruajnë një pozicion mbizotërues në investimet e huaja direkte në Shqipëri. 51 për qind e ndërmarrjeve të investimit direkt janë me pjesëmarrje të kapitalit të huaj italian dhe 24 për qind me kapital të huaj grek. Ndjekësit më të afërt janë kapitali turk (4 për qind) dhe ai amerikan (3 për qind) (tabela 1). Ndërkohë, vërejmë një hapje drejt Kinës dhe Lindjes së Mesme, shoqëruar edhe me rritjen e flukseve të kapitalit nga këto vende.

Tabelë 1. Investimet e huaja direkte sipas vendit të origjinës.

Vendi i origjinës	Nr. i ndërmarrjeve	Përqindja
Bashkimi Evropian	434	82.5%
Angli	3	0.6%
Austri	3	0.6%
Belgjikë	1	0.2%
Bullgari	2	0.4%
Francë	4	0.8%
Greqi	128	24.3%
Gjermani	9	1.7%
Hollandë	2	0.4%
Hungari	7	1.3%
Itali	269	51.1%
Maltë	1	0.2%
Qipro	2	0.4%
Sllloveni	2	0.4%
Suedi	1	0.2%
Vendet e Rajonit	40	7.6%
Kroaci	4	0.8%
Kosovë	6	1.1%
Maqedoni	8	1.5%
Serbi dhe Mal i Zi	2	0.4%
Turqi	20	3.8%
Lindja e Mesme	15	2.9%
Arabi Saudite	3	0.6%
Egjipt	3	0.6%
Kuvajt	1	0.2%
Liban	6	1.1%
Izrael	1	0.2%
Siri	1	0.2%
Lindja e Largët	10	1.9%
Kinë	10	1.9%
Australi	1	0.2%
Shtetet e Bashkuara të Amerikës	14	2.7%

Kanada	2	0.4%
Institucione ndërkombëtare	2	0.4%
Zvicër	2	0.4%
Të tjera	6	1.1%
Totali	526	100.0%

Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.2 DINAMIKA E KRIJIMIT TË NDËRMARRJEVE TË REJA ME KAPITAL TË HUAJ

Frekuenca e hapjes së ndërmarrjeve të IHD në Shqipëri sikurse pritej, ka ndjekur prirjet e zhvillimit ekonomik të vendit që pas hapjes së tij për kapitalin e huaj. Kombet e Bashkuara[2] citojnë vitin 1990, si vit në të cilin legjislacioni shqiptar ka lejuar, për herë të parë, hapjen e vendit ndaj investimeve të huaja direkte. Krijimi i ndërmarrjeve të reja me pjesëmarrje të kapitalit të huaj në vend ka ardhur në rritje gjatë viteve të para të tranzicionit, duke pësuar tkurrje gjatë krizës social-ekonomike të vitit 1997 (grafik 1). Më pas, kjo prirje ka qenë më e moderuar, ndikuar gjithashtu nga situata përgjithësisht problematike në Ballkan. Viti 2004 shfaqet si një vit me tendenca pozitive në këtë drejtim.

Grafik 1. Frekuenca e hapjes së ndërmarrjeve në vite.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.3 SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE E INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE

Përsa i përket shpërndarjes gjeografike të IHD në Shqipëri, vihet re një përqendrim i tyre në Tiranë dhe në pjesën perëndimore të

vendit (grafiku 2 dhe tabela 1 në aneksin bashkëngjitur). Zonat ku janë përqëndruar IHD janë zona me të ardhura më të larta dhe infrastrukturë më të zhvilluar. Pjesa e brendshme qendrore si dhe verilindja e vendit, janë ndër zonat më pak të preferuara nga investitorët e huaj. Përveç infrastrukturës së pazhvilluar të këtyre zonave dhe marketingut të munguar, një rol të rëndësishëm mendohet të ketë luajtur migrimi i brendshëm dhe i jashtëm, i cili vështirëson gjetjen e fuqisë punëtore të kualifikuar në to. Megjithatë, një përqindje të konsiderueshme të IHD kemi në rrethe kufitare me Greqinë, si Korça dhe Gjirokastra.

2.4 PËRQENDRIMI I FUQISË PUNËTORE

Në aspektin e punësimit mund të flitet për shpërpjesëtim ndërmjet madhësisë së ndërmarrjeve dhe fuqisë punëtore, të punësuar në to. Kështu, ndërkohë që rreth 46 për qind e ndërmarrjeve (tabela 2) janë me nga 1-9 të punësuar, vetëm 4 për qind e punësimit realizohet nga këto ndërmarrje. Nga ana tjetër, ndërmarrjet me më tepër se 100 të punësuar përfaqësojnë vetëm 12 për qind të ndërmarrjeve IHD në Shqipëri, duke punësuar rreth 61 për qind të fuqisë punëtore në to. Kjo tregon se IHD në Shqipëri janë të përqëndruara më tepër, në sektorë me përdorim intensiv të fuqisë punëtore, gjë që shihet qartë edhe në përqendrimin e IHD sipas sektorëve.

Grafik 2. Shpërndarja zonale e IHD-ve në Shqipëri.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 2. Përqendrimi i fuqisë punëtore.

Ndërmarrje me nga:	Numri i ndërmarrjeve	%	Numri i të punësuarve	%
1-9 të punësuar	238	46	901	4
10-50 të punësuar	171	33	4274	19
51-100 të punësuar	50	10	3777	17
mbi 100 të punësuar	62	12	13723	61
Totali	521	100	22675	100

Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.5 PJESËMARRJA E KAPITALIT TË HUAJ

Në rreth 66 për qind të ndërmarrjeve, pjesëmarrja e kapitalit të huaj është në intervalin 75-100 për qind të kapitalit të nënshkruar (grafiku 3). Bie në sy prania relativisht më e lartë e kapitalit të huaj në ndërmarrjet me më tepër të punësuar. Ndërmarrjet e zotëruara totalisht nga investitorë të huaj përbëjnë 56 për qind të ndërmarrjeve të vrojtuara.

Grafik 3. Intervalet e pjesëmarrjes së kapitalit të huaj.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.6 INVESTIME TË HUAJA DIREKTE SIPAS SEKTORËVE TË EKONOMISË

Shpërndarja sektoriale e investimeve të huaja direkte në Shqipëri tregon një shkallë të lartë përqendrimi të tyre në industrinë përpunuese dhe fushat e tregtisë me shumicë (tabela 3).

Pra, investimet kanë qenë më të shpeshta në sektorë me prurje të shpejtë fitimi (shlyerje të shpejtë të investimit). Këto investime mund të konsiderohen të paqëndrueshme, të tilla që ndryshojnë shpejt vendndodhjen gjeografike dhe sektorin ku veprojnë.

Ndërkohë, investimet në industrinë përpunuese, e cila përfaqësohet me industritë tekstile të veshjeve dhe të këpucëve, synojnë sektorët me përqendrim të lartë të fuqisë punëtore dhe jo ato me përqendrim kapitali ose teknologjie. Kështu, roli i këtyre investimeve në përmirësimet teknologjike të prodhimit në vend, ka më pak efekte pozitive në sektorë të tjerë të prodhimit. Kjo e fundit shpjegohet edhe me kërkesën brendshme të rritur për mallra me cikël konsumi të shkurtër.

Duke kombinuar këto rezultate me ato të punësimit, arrijmë në përfundimin që investimet në industri kanë synuar sektorët me përqendrim të lartë të fuqisë punëtore dhe jo ata me përqendrim të kapitalit ose të teknologjisë. Kjo i lë pak hapësirë rolit të investimeve të huaja në transferimin e teknologjisë dhe rritjen e kapacitetit teknologjik të prodhimit në vend, duke minimizuar efektet pozitive anësore të këtyre investimeve në sektorët e tjerë të prodhimit.

(Shpërndarja analitike e klasifikimit të ndërmarrjeve sipas sektorëve ekonomikë jepet në tabelën 2, në aneksin bashkëngjitur.)

Tabelë 4. Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas sektorëve (bazuar në Nomeklaturën e Veprimeve Ekonomike Rev. 1.1 INSTAT).

Seksioni	Përshkrimi	Numër ndërmarrjesh	%
A	Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	3	1
B	Peshkimi	3	1
C	Industria nxjerrëse	12	2
D	Industria përpunuese	234	45
E	Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit, avullit dhe e ujit të ngrohtë	2	0
F	Ndërtimi	41	8
G	Tregtia me shumicë dhe me pakicë, riparimi i automobilave, motoçikletave, i sendeve personale dhe i pajisjeve shtëpiake	142	27
H	Hotele dhe restorante	7	1
I	Transporte, magazinimi dhe komunikacioni	24	5
J	Ndërmjetësimi monetar dhe financiar	4	1

K	Pasuritë e patundshme, dhënia me qira, informatika, puna kërkimore shkencore, të tjera aktivitete personale	24	5
L	Administrimi publik dhe i mbrojtjes, sigurimi shoqëror i detyruar	0	0
M	Arsimi	4	1
N	Shëndetësia dhe veprimtari të tjera sociale	5	1
O	Aktivitete të tjera të shërbimit social dhe individual	15	3
P	Shërbime në shtëpi	0	0
Q	Aktivitete të organizmave ndërkombëtarë	0	0
	n.a	1	0
	TOTALI	521	100

Burimi: Banka e Shqipërisë.

3. KARAKTERISTIKA SASIORE TË INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE

3.1 STOKU I KAPITALIT TË HUAJ

Nisur nga informacioni i disponueshëm si dhe bazuar në metodologjinë e shpjeguar më sipër stoku i kapitalit të huaj, në formën e investimeve direkte, për vitin 2004 vlerësohet në nivelin 38 miliardë lekë. Gjatë vitit 2004 kanë filluar aktivitetin rreth 48 ndërmarrje të reja të investimit direkt, duke sjellë një fluks të ri të kapitalit të huaj prej 28.6 milionë lekësh. Ky fluks kapitali është thithur kryesisht nga sektorët e fabrikimit të veshjeve, të tregtisë me shumicë të mallrave ushqimorë etj..

Gjithashtu, gjatë vitit 2004 në mëse 12 për qind të ndërmarrjeve të intervistuara, asambletë aksionere kanë marrë vendime për rritjen e kapitalit të nënshkruar, duke rritur kapitalin e huaj në Shqipëri me rreth 5 miliardë lekë. Duket se investitorët e huaj po vlerësojnë klimën e investimeve në vend. Fitimi i riinvestuar përgjatë vitit 2004 vlerësohet të jetë 10 miliardë lekë, konsiderueshëm në rritje përkundrejt një viti më parë dhe ruan nivelin më të lartë për periudhën që po analizojmë.

3.2 ORIGJINA E KAPITALIT TË HUAJ

Investitorët nga vendet e Bashkimit Evropian dominojnë investimet e huaja direkte në Shqipëri. Në fund të vitit 2004, jo

më pak se 82 për qind e stokut të investimeve të huaja ishte për llogari të vendeve të Bashkimit Evropian, me investitorë kryesorë Greqinë (me 48 për qind të stokut të kapitalit të huaj në fund të vitit 2004) dhe Italinë (me 30 për qind). (Grafiku 4 dhe tabela 3 në aneksin bashkëngjitur.) Investitorë domethënës, mes vendeve të tjera jashtë këtij grupi (BE), janë vetëm Turqia dhe Libani.

Grafik 4. Stoku i kapitalit të huaj në vite (në miliardë lekë).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Greqia dhe Italia kanë rritur ndjeshëm praninë e tyre në stokun e kapitalit të huaj në vend. Afërsia gjeografike e Shqipërisë me këto dy vende si dhe një bashkëpunim i fuqishëm ekonomik me BE, janë ndër arsyet kryesore për dominimin e investitorëve të huaj nga këto vende. Rritja e stokut të kapitalit të huaj në vite, vërehet të ketë qenë më e ndjeshme përsa i përket kapitalit grek. Ky i fundit, në fund të vitit 2004 vlerësohet në rreth 18 miliardë lekë nga 7 miliardë lekë vlerësuar në fund të vitit 2001. (Grafiku 5.) Kapitali grek është i përqëndruar kryesisht në sektorin e komunikacionit (68 për qind) ardhur si rezultat i përfshirjes në privatizime gjatë viteve 2000-2001 dhe tregtisë me shumicë (13 për qind). Përgjatë viteve të fundit është zbehur disi prania e tij në industrinë e veshjeve.

Kapitali italian për periudhën e vrojtuar (2001-2004), ka ruajtur rreth intervaleve 60-65 për qind përfaqësimin e tij me investime në industrinë përpunuese. Në fund të vitit 2004, stoku i kapitalit italian vlerësohet në rreth 11.3 miliardë lekë nga 3.8 miliardë lekë në vitin 2001.

Grafik 5. Stoku i kapitalit të huaj sipas origjinës për vitin 2004.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 6. Ecuria e stokut të kapitalit të huaj sipas origjinës (në miliardë lekë).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

3.3 SHPËRNDARJA SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK

Me rreth 36 për qind të stokut të IHD-ve në fund të vitit 2004 si dhe 45 për qind të numrit të ndërmarrjeve të huaja, industria përpunuese është sektori kryesor tërheqës i investimeve të huaja në Shqipëri (tabela 5.). Brenda saj, kapitali i huaj në mëse 65 për qind të tij, është me destinacion në industritë tekstile dhe të veshjeve, përpunimit ushqimor, fabrikimit të mobilieve etj.. Industritë përpunuese me përdorim të teknologjisë (si për shembull, mjekësore dhe farmaceutike, makineri e pajisje elektrike dhe elektronika) dhe ato me përdorim të kapitalit (si për shembull, rafineri nafte, materiale kimike) thuajse ndajnë pjesën e mbetur.

Kjo sugjeron që një motivim i rëndësishëm për kompanitë e huaja ka qenë përparësia e fuqisë së lirë punëtore.

Sektori i komunikacionit, me vetëm 5 subjekte, përfaqëson rreth 33 për qind të gjendjes së kapitalit të huaj në fund të vitit 2004. Privatizimet e viteve 2000-2001 kanë tërhequr investitorë potencialë në këtë fushë. Më pas, kapitali i huaj në këtë sektor ka shfaqur prirje në rritje, si në aspektin e kapitalit themeltar të kompanive ashtu edhe në atë të riinvestimit të fitimeve dhe investimeve të bëra gjatë vitit ushtrimor.

Zhvillimet e vrullshme në sektorin e ndërtimit, gjatë viteve të fundit, po tërheqin vëmendjen e investitorëve të huaj. Prania e kapitalit të huaj në këtë sektor është rritur ndjeshëm përgjatë dy viteve të fundit, duke sjellë me vete flukse të reja të kapitalit të huaj edhe në fusha të tjera mbështetëse të tij, si për shembull në aktivitete arkitektonike dhe inxhinierike (klasifikuar nën seksionin K në tabelën 5).

Tabelë 5. Shpërndarja e stokut të kapitalit të huaj sipas sektorëve (bazuar në Nomeklaturën e Veprimeve Ekonomike Rev. 1.1 INSTAT) në përqindje.

Seksioni	Përshkrimi	2001	2002	2003	2004
A	Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	0.8	0.6	0.4	0.5
B	Peshkimi	0.0	0.0	0.0	0.0
C	Industria nxjerrëse	3.0	1.9	1.2	1.2
D	Industria përpunuese	33.1	31.7	37.8	36.3
E	Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit, avullit dhe e ujit të ngrohtë	0.0	0.5	0.3	0.2
F	Ndërtimi	4.8	4.7	5.6	5.6
G	Tregtia me shumicë dhe me pakicë, riparimi i automobilave, motoçikletave, i sendeve personale dhe i pajisjeve shtëpiake	10.4	6.8	5.6	9.6
H	Hotele dhe restorante	6.7	5.5	3.4	3.0
I	Transporte, magazinimi dhe komunikacioni	35.8	43.0	38.9	36.9
J	Ndërmjetësimi monetar dhe financiar	4.4	3.8	2.7	2.4
K	Pasuritë e patundshme,dhënia me qira, informatika, puna kërkimore shkencore, të tjera aktivitete personale	0.2	1.0	2.7	3.3
L	Administrimi publik dhe i mbrojtjes, sigurimi shoqëror i detyruar	0.0	0.0	0.0	0.0
M	Arsimi	0.0	0.0	0.1	0.1
N	Shëndetësia dhe veprimtari të tjera sociale	0.0	0.0	0.0	0.1
O	Aktivitete të tjera të shërbimit social dhe individual	0.5	0.4	1.1	0.9
P	Shërbime në shtëpi	0.0	0.0	0.0	0.0
Q	Aktivitete të organizmave ndërkombëtarë	0.0	0.0	0.0	0.0
	n.a.	0.3	0.2	0.1	0.1
	TOTALI	100.0	100.0	100.0	100.0

Burimi: Banka e Shqipërisë.
(Shpërndarja analitike e stokut të kapitalit të huaj sipas sektorëve ekonomikë jepet në tabelën 4, në aneksin bashkëngjitur.)

3.4 INVESTIMET GJATË VITIT USHTRIMOR 2004

Nga të dhënat e disponueshme për ndërmarrjet që kanë raportuar lidhur me investimet e kryera gjatë vitit ushtrimor 2004, rezulton se rreth 100 për qind e fluksit të investimit ka shkuar për aktive të qëndrueshme.

Totali i investimeve të kryera kap shifrën 15 miliardë lekë nga ku investimet e lidhura me kuotën e investitorit të huaj vlerësohen në rreth 14 miliardë lekë. Më shumë se gjysma e totalit të investimeve të ushtrimit ka shkuar për instalime teknike, makineri dhe pajisje.

Tabelë 6. Struktura e investimeve të kryera gjatë vitit ushtrimor 2003.

Investime gjithsej (I+II)	100.0
I. Të patrupëzuara	0.1
II.Të trupëzuara	99.9
nga të cilat	
1. Për tokë, troje, terrene	1.7
2. Për ndërtesa	3.7
3. Ndërtime dhe instalime të përgjithshme	22.6
4. Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla	51.6
5. Mjete transporti	3.2
6. Pajisje zyre dhe informatike	2.5
7. Të tjera	14.7

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Industria përpunuese rezulton sektori me fluksin më të madh të investimeve gjatë vitit ushtrimor 2004, rreth 42 për qind të tyre, e ndjekur nga sektori i komunikacionit me rreth 39 për qind.

Tabelë 7. Shpërndarja strukturore e investimeve të kryera gjatë vitit ushtrimor 2004 sipas sektorëve të ekonomisë.

Seksioni	Përshkrimi	%
A	Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	0.2
B	Peshkimi	0.0
C	Industria nxjerrëse	2.0
D	Industria përpunuese	42.2
E	Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit, avullit dhe e ujit të ngrohtë	0.5
F	Ndërtimi	1.3
G	Tregtia me shumicë dhe me pakicë, riparimi i automobilave, motoçikletave, i sendeve personale dhe i pajisjeve shtëpiake	10.4
H	Hotele dhe restorante	0.5
I	Transporte, magazinimi dhe komunikacioni	38.5
J	Ndërmjetësimi monetar dhe financiar	0.0

K	Pasuritë e patundshme, dhënia me qira, informatika, puna kërkimore shkencore, të tjera aktivitete personale	2.9
L	Administrimi publik dhe i mbrojtjes, sigurimi shoqëror i detyruar	0.0
M	Arsimi	1.0
N	Shëndetësia dhe veprimtari të tjera sociale	0.2
O	Aktivitete të tjera të shërbimit social dhe individual	0.3
P	Shërbime në shtëpi	0.0
Q	Aktivitete të organizmave ndërkombëtarë	0.0
	TOTALI	0.0

Burimi: Banka e Shqipërisë.

ANEKS

Tabelë 1. Shpërndarja zonale e ndërmarrjeve të investimit direkt në Shqipëri.

Nr.	Qarqet	Nr.	Rrethet	Ndërmarrje të huaja aktive
	(Prefekturat)			
1	Berat			7
		1	Berat	7
		2	Kuçovë	
		3	Skrapar	
2	Dibër			0
		4	Dibër	
		5	Mat	
		6	Bulqizë	
3	Durrës			76
		7	Durrës	68
		8	Krujë	8
4	Elbasan			21
		9	Elbasan	20
		10	Peqin	
		11	Gramsh	
		12	Librazhd	1
5	Fier			24
		13	Fier	20
		14	Mallakastër	
		15	Lushnje	4
6	Gjirokastër			19
		16	Gjirokastër	18
		17	Tepelenë	
		18	Përmet	1
7	Korçë			52
		19	Korçë	48
		20	Devoll	1
		21	Kolonjë	1
		22	Pogradec	2
8	Kukës			0
		23	Kukës	
		24	Has	
		25	Tropojë	
9	Lezhë			5
		26	Lezhë	5
		27	Kurbin	
		28	Mirditë	
10	Shkodër			23
		29	Shkodër	23
		30	Malësi e Madhe	
		31	Pukë	
11	Tiranë			273
		32	Tiranë	271
		33	Kavajë	2
12	Vlorë			21
		34	Vlorë	17
		35	Sarandë	2
		36	Delvinë	2
	Gjithsej	36		521

Tabelë 2. Shpërndarja e kompanive sipas sektorëve (bazuar në Nomeklaturën e Veprimeve Ekonomike Rev. 1.1 INSTAT).

Ndarja /grupi	Përshkrimi	NR	%
A	Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	3	1
‘01	Bujqësia, gjuetia dhe shërbime plotësuese	2	0
‘02	Silvikultura,shfrytëzimi i pyjeve, shërbime plotësuese	1	0
B	Peshkimi	3	1
‘05	Peshkimi, kultivimi i peshkut dhe shërbimet në lidhje me peshkimin	3	1
C	Industria nxjerrëse	12	2
CA	Nxjerrja e mineraleve energjitike	3	1
‘10	Nxjerrja e qymyrgurit dhe e linjiteve;nxjerrja e torfës	0	-
‘11	Nxjerrja e naftës bruto, gazit natyror, shërbimeve plotësuese në nxjerrjen e naftës dhe të gazit, përveç studimeve gjeollogjike	3	1
‘12	Nxjerrja e mineralit të uraniumit dhe toriumit	0	-
CB	Nxjerrja e mineraleve joenergjitike	9	2
‘13	Nxjerrja e mineraleve metalike	0	-
‘14	Industri të tjera nxjerrëse	9	2
D	Industria përpunuese	234	45
DA	Industria ushqimore, e pijeve dhe e duhanit	14	3
‘15	Industria ushqimore dhe e pijeve	12	2
‘16	Industria e duhanit	2	0
DB	Industria tekstile dhe e veshjeve	92	18
‘17	Industria e tekstileve	3	1
‘18	Industria e veshjeve dhe e gëzofëve	89	17
DC	Industria e lëkurës dhe e këpucëve	29	6
‘19	Përgatitja, tanini i lëkurës, fabrikimi i artikujve të udhëtimit dhe të galanterisë, fabrikimi i pajimeve të kuajve dhe fabrikimi i këpucëve	29	6
DD	Punimet me dru dhe fabrikimi i artikujve prej druri	8	2
‘20	Industria e drurit dhe e artikujve me dru përveç fabrikimit të mobilieve, shporterisë dhe të xunkthit	8	2
DE	Fabrikimi i brumit të letrës, i letrës dhe artikujve prej letre; shtypshkronja dhe botimi	10	2
‘21	Fabrikimi i brumit të letrës, i letrës dhe artikujve prej letre dhe kartoni	4	1
‘22	Botimi, shtypshkronja dhe riprodhimi i suporteve të regjistruara	6	1
DF	Koksifikimi, rafinimi i naftës, industria bërthamore	0	-
‘23	Koksifikimi, rafinimi i naftës, industria bërthamore	0	-
DG	Industria kimike	7	1
‘24	Industria kimike	7	1
DH	Industria e gomës dhe e plastikës	12	2
‘25	Industria e gomës dhe e plastikës	12	2
DI	Fabrikimi i artikujve të tjerë mineralë jometalikë	20	4
‘26	Fabrikimi i artikujve të tjerë mineralë dhe jo metalikë	20	4
DJ	Metalurgjia dhe punimi i metaleve	14	3
‘27	Siderurgjia	2	0
‘28	Punime me metale	12	2
DK	Fabrikimi i makinave dhe pajisjeve përfshirë instalimin, montimin, riparimin dhe mirëmbajtjen	1	0
29	Fabrikimi i makinave dhe pajisjeve përfshirë instalimin, montimin, riparimin dhe mirëmbajtjen	1	0
DL	Fabrikimi i pajisjeve elektrike dhe optike	10	2
30	Fabrikimi i makinave të zyrave, të makinave llogaritëse dhe të pajisjeve të trajtimit të informacionit	0	-
31	Fabrikimi i makinave dhe pajisjeve elektrike	7	1

32	Fabrikimi i aparaturave radiotelevizive dhe i atyre të komunikacionit	1	0
33	Fabrikimi i pajisjeve mjekësore, të precizionit , instrumenteve optike dhe orëve	2	0
DH	Fabrikimi i mjeteve të transportit	1	0
34	Fabrikimi i automjeteve, rimorkiove dhe gjysmë rimorkiove	0	-
35	Fabrikimi i mjeteve të tjera të transportit	1	0
DN	Industri të tjera përpunuese	16	3
36	Fabrikimi i mobilieve, industri të ndryshme	16	3
37	Grumbullimi dhe përgatitja për riciklim	0	-
E	Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit, avullit dhe e ujit të ngrohtë	2	0
40	Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit, avullit dhe e ujit të ngrohtë	1	0
41	Depozitimi, pastrimi dhe shpërndarja e ujit	1	0
F	Ndërtimi	41	8
45	Ndërtimi	41	8
G	Tregtia me shumicë dhe me pakicë. Riparimi i automobilave, motoçikletave, i sendeve personale dhe i pajisjeve shtëpiake	142	27
50	Tregtimi, mirëmbajtja dhe riparimi i automobilave dhe motoçikletave	8	2
51	Tregtia me shumicë dhe ndërmjetësimi tregtar (përveç mjeteve të transportit automobilistik)	108	21
52	Tregtia me pakicë ; riparimi i artikujve personalë dhe shtëpiakë	26	5
H	Hotele dhe restorante	7	1
55	Hotele dhe restorante	7	1
I	Transporte, magazinimi dhe komunikacioni	24	5
60	Transporti tokësor; transporti nëpërmjet tubacioneve	4	1
61	Transporti ujor	2	0
62	Transporti ajror	3	1
63	Shërbime ndihmëse në transport; aktivitete të agjencive të udhëtimit	10	2
64	Postat dhe komunikacionet	5	1
J	Ndërmjetësimi monetar dhe financiar	4	1
65	Ndërmjetësimi monetar dhe financiar përveç aktiviteteve siguruese si dhe fondeve të pensioneve	2	0
66	Aktivitete siguruese dhe të fondeve të pensioneve, përveç sigurimeve shoqërore të detyrueshme	2	0
67	Aktivitete ndihmëse të ndërmjetësimit financiar dhe atyre siguruese		-
K	Pasuritë e patundshme, dhënia me qira, informatika, puna kërkimore shkencore, të tjera aktivitete personale	24	5
70	Aktivitete të pasurive të patundshme	9	2
71	Dhënia me qira e pajisjeve pa operator dhe e artikujve personalë dhe shtëpiakë	2	0
72	Aktivitete informatike dhe aktivitete të lidhura me to	2	0
73	Kërkime-aplikime eksperimentale	0	-
74	Aktivitete të tjera profesionale	11	2
L	Administrimi publik dhe i mbrojtjes, sigurimi shoqëror i detyruar	0	-
75	Administrimi publik dhe i mbrojtjes, sigurimi shoqëror i detyruar	0	-
M	Arsimi	4	1
80	Arsimi	4	1
N	Shëndetësia dhe veprimtari të tjera sociale	5	1
85	Shëndetësia dhe veprimtari të tjera sociale	5	1
O	Aktivitete të tjera të shërbimit social dhe individual	15	3

90	Pastrimi, heqja e mbeturinave, trajtimi i hedhurinave dhe aktivitete të tjera të ngjashme	2	0
91	Aktivitete të organizatave të ndryshme shoqërore	6	1
92	Aktivitete dëfrimi, kulturore dhe sportive	6	1
93	Aktivitete të shërbimeve personale	1	0
P	Shërbime në shtëpi	0	-
95	Shërbime në shtëpi	0	-
96	Aktivitete të prodhimit të mallrave të pandryshuar të familjeve private për përdorimin e vet	0	-
97	Aktivitete të prodhimit të shërbimeve të pandryshuara të familjeve private për përdorimin e vet	0	-
Q	Aktivitete të organizmave ndërkombëtarë	0	-
99	Aktivitete të organizmave ndërkombëtare	0	-
	Na	1	
Total		521	100

Tabelë 3. Origjina e kapitalit të huaj. (gjendja e stokut në fund të periudhës, në mijë lekë).

Vendi i origjinës	2001	%	2002	%	2003	%	2004	%
Bashkimi Evropian	12,197,774	77	15,119,893	79	25,641,738	82	31,085,736	82
nga të cilat								
Austri	873,285	5	873,390	5	874,102	3	874,117	2
Greqi	6,973,210	44	9,205,083	48	13,906,849	45	18,139,697	48
Gjermani	290,252	2	388,130	2	382,921	1	369,613	1
Itali	3,760,558	24	4,410,597	23	9,896,521	32	11,314,441	30
Të tjera	300,469	2	242,693	1	581,346	2	387,868	1
Vendet e Rajonit	1,210,619	8	1,251,390	6	2,048,256	7	3,152,459	8
nga të cilat								
Kroaci	178,110	1	178,110	1	281,907	1	325,792	1
Kosovë	51,243	0	77,060	0	92,608	0	115,890	0
Maqedoni	278,968	2	247,644	1	849,865	3	898,669	2
Turqi	702,246	4	748,523	4	816,074	3	1,803,815	5
Të tjera	53	0	53	0	7,801	0	8,292	0
Lindja e Mesme	1,521,447	10	1,932,085	10	1,882,647	6	1,972,923	5
nga të cilat								
Egjipt	527,980	3	528,674	3	529,955	2	543,731	1
Liban	991,429	6	1,401,013	7	1,350,110	4	1,354,149	4
Të tjera	2,039	0	2,398	0	2,582	0	75,043	0
Lindja e Largët	777	0	777	0	38,306	0	13,515	0
Kina	777	0	777	0	38,306	0	13,515	0
Shtetet e Bashkuara të Amerikës	278,441	2	327,376	2	890,437	3	757,264	2
Institucione ndërkombëtare	696,269	4	696,269	4	696,269	2	696,269	2
Të tjera	13,146	0	-72,784	0	12,804	0	29,994	0
Totali	15,918,473	100	19,255,005	100	31,210,458	100	37,708,160	100

Tabelë 4. Shpërndarja e kompanive sipas sektorëve (bazuar në Nomeklaturën e Veprimeve Ekonomike Rev. 1.1 INSTAT). (gjendja e stokut në fund të periudhës, në mijë lekë).

Ndarja /grupi	Përshkrimi	2001	2002	2003	2004
A	Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	122,599	123,642	122,187	177,435
‘01	Bujqësia, gjuetia dhe shërbime plotësuese	122,450	123,493	122,038	177,285
‘02	Silvikultura,shfrytëzimi i pyjeve, shërbime plotësuese	150	150	150	150
B	Peshkimi	3,871	5,400	5,301	5,157
‘05	Peshkimi, kultivimi i peshkut dhe shërbimet në lidhje me peshkimin	3,871	5,400	5,301	5,157
C	Industria nxjerrëse	478,818	367,904	369,849	446,866
CA	Nxjerrja e mineraleve energjitike	3,051	-78,139	-15,339	-3,072
‘10	Nxjerrja e qymyrgurit dhe e linjiteve;nxjerrja e torfës				
‘11	Nxjerrja e naftës bruto, gazit natyror, shërbimeve plotësuese në nxjerrjen e naftës dhe të gazit, përveç studimeve gjeologjike	3,051	-78,139	-15,339	-3,072
‘12	Nxjerrja e mineralit të uraniumit dhe toriumit				
CB	Nxjerrja e mineraleve joenergjitike	475,767	446,042	385,188	449,938
‘13	Nxjerrja e mineraleve metalike				
‘14	Industri të tjera nxjerrëse	475,767	446,042	385,188	449,938
D	Industria përpunuese	5,276,885	6,097,960	11805036.97	13,701,582
DA	Industria ushqimore, e pijeve dhe e duhanit	1,087,117	1,122,912	4,890,497	4,071,129
‘15	Industria ushqimore dhe e pijeve	898,688	928,740	4,704,788	3,884,379
‘16	Industria e duhanit	188,430	194,172	185,708	186,749
DB	Industria tekstile dhe e veshjeve	1,016,115	1,193,020	1,325,668	1,440,979
‘17	Industria e tekstileve	26,442	26,303	22,946	23,705
‘18	Industria e veshjeve dhe e gëzofëve	989,673	1,166,717	1,302,722	1,417,274
DC	Industria e lëkurës dhe e këpucëve	281,515	302,533	442,715	450,686
‘19	Përgatitja, tanini i lëkurës, fabrikimi i artikujve të udhëtimit dhe të galanterisë, fabrikimi i pajimeve të kuajve dhe fabrikimi i këpucëve	281,515	302,533	442,715	450,686
DD	Punimet me dru dhe fabrikimi i artikujve prej druri	183,867	184,927	306,678	280,800

‘20	Industria e drurit dhe i artikujve me dru përveç fabrikimit të mobilieve, shporterisë dhe të xunkthit	183,867	184,927	306,678	280,800
DE	Fabrikimi i brumit të letrës, i letrës dhe artikujve prej letre; shtypshkronja dhe botimi	10,673	7,491	16,082	53,428
‘21	Fabrikimi i brumit të letrës, i letrës dhe artikujve prej letre dhe kartoni	210	222	690	34,711
‘22	Botimi, shtypshkronja dhe riprodhimi i suporteve të regjistruara	10,463	7,269	15,392	18,717
DF	Koksifikimi, rafinimi i naftës, industria bërthamore	0	0	0	0
‘23	Koksifikimi, rafinimi i naftës, industria bërthamore				
DG	Industria kimike	68,158	70,855	73,613	85,881
‘24	Industria kimike	68,158	70,855	73,613	85,881
DH	Industria e gomës dhe e plastikës	136,086	139,851	289,950	278,368
‘25	Industria e gomës dhe e plastikës	136,086	139,851	289,950	278,368
DI	Fabrikimi i artikujve të tjerë mineralë jometalikë	1,447,380	1,940,798	2,804,110	3,678,295
‘26	Fabrikimi i artikujve të tjerë mineralë dhe jometalikë	1,447,380	1,940,798	2,804,110	3,678,295
DJ	Metalurgjia dhe punimi i metaleve	588,372	497,227	598,430	1,739,017
‘27	Siderurgjia	415,200	282,455	294,411	913,092
‘28	Punime me metale	173,172	214,772	304,019	825,925
DK	Fabrikimi i makinave dhe pajisjeve përfshirë instalimin, montimin, riparimin dhe mirëmbajtjen	105	371	105	1,266
29	Fabrikimi i makinave dhe pajisjeve përfshirë instalimin, montimin, riparimin dhe mirëmbajtjen	105	371	105	1,266
DL	Fabrikimi i pajisjeve elektrike dhe optike	8,143	8,008	382,507	913,872
30	Fabrikimi i makinave të zyrave, të makinave llogaritëse dhe të pajisjeve të trajtimit të informacionit				
31	Fabrikimi i makinave dhe pajisjeve elektrike	7,985	7,735	381,700	913,143
32	Fabrikimi i aparaturave radiotelevizive dhe i atyre të komunikacionit	105	105	105	105
33	Fabrikimi i pajisjeve mjekësore, të precizionit, instrumenteve optike dhe orëve	53	168	702	624
DH	Fabrikimi i mjeteve të transportit	372,795	548,024	586,110	610,119
34	Fabrikimi i automjeteve, rimorkiove dhe gjysmë rimorkiove				
35	Fabrikimi i mjeteve të tjera të transportit	372,795	548,024	586,110	610,119

DN	Industri të tjera përpunuese	76,560	81,944	88,572	97,743
36	Fabrikimi i mobilieve, industri të ndryshme	76,560	81,944	88,572	97,743
37	Grumbullimi dhe përgatitja për riciklim				
E	Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit, avullit dhe e ujit të ngrohtë	105	87,204	87,204	87,204
40	Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit, avullit dhe e ujit të ngrohtë	0	54	54	54
41	Depozitimi, pastrimi dhe shpërndarja e ujit	105	87,150	87,150	87,150
F	Ndërtimi	762,983	900,195	1,749,458	2,093,426
45	Ndërtimi	762,983	900,195	1,749,458	2,093,426
G	Tregtia me shumicë dhe me pakicë. Riparimi i automobilave, motoçikletave, i sendeve personale dhe i pajisjeve shtëpiake	1,659,806	1,300,980	1,743,499	3,609,569
50	Tregtimi, mirëmbajtja dhe riparimi i automobilëve dhe motoçikletave	83,675	70,782	85,795	95,081
51	Tregtia me shumicë dhe ndërmjetësimi tregtar(përveç mjeteve të transportit automobilistik)	1,549,288	1,202,486	1,567,595	3,409,868
52	Tregtia me pakicë; riparimi i artikujve personalë dhe shtëpiakë	26,843	27,712	90,109	104,621
H	Hotele dhe restorante	1,062,455	1,062,730	1,066,422	1,130,254
55	Hotele dhe restorante	1,062,455	1,062,730	1,066,422	1,130,254
I	Transporte, magazinimi dhe komunikacioni	5,692,778	8,278,967	12152996.8075	13,896,890
60	Transporti tokësor; transporti nëpërmjet tubacioneve	16,362	18,678	21,981	259,975
61	Transporti ujor	5,167	-14,078	5,357	-125,036
62	Transporti ajror	929,905	976,537	984,347	1,343,694
63	Shërbime ndihmëse në transport; aktivitete të agjencive të udhëtimit	11,692	12,309	21,778	16,181
64	Postat dhe komunikacionet	4,729,653	7,285,521	11,119,534	12,402,076
J	Ndërmjetësimi monetar dhe financiar	705,069	726,789	848,860	893,634
65	Ndërmjetësimi monetar dhe financiar përveç aktiviteteve siguruese si dhe fondeve të pensioneve	1,155	1,155	104,952	148,836
66	Aktivitete siguruese dhe të fondeve të pensioneve, përveç sigurimeve shoqërore të detyrueshme	703,914	725,634	743,908	744,797
67	Aktivitete ndihmëse të ndërmjetësimit financiar dhe atyre siguruese				

K	Pasuritë e patundshme, dhënia me qira, informatika, puna kërkimore shkencore, të tjera aktivitete personale	28,650	186,855	848,618	1,226,813
70	Aktivitete të pasurive të patundshme	21,567	42,678	678,499	713,149
71	Dhënia me qira e pajisjeve pa operator dhe e artikujve personalë dhe shtëpiakë	2,100	137,795	139,761	142,835
72	Aktivitete informatike dhe aktivitete të lidhura me to	0	0	0	210
73	Kërkime-aplikime eksperimentale				
74	Aktivitete të tjera profesionale	4,982	6,382	30,358	370,620
L	Administrimi publik dhe i mbrojtjes, sigurimi shoqëror i detyruar	0	0	0	0
75	Administrimi publik dhe i mbrojtjes, sigurimi shoqëror i detyruar				
M	Arsimi	210	289	21,253	23,598
80	Arsimi	210	289	21,253	23,598
N	Shëndetësia dhe veprimtari të tjera sociale	2,132	2,132	14,821	20,819
85	Shëndetësia dhe veprimtari të tjera sociale	2,132	2,132	14,821	20,819
O	Aktivitete të tjera të shërbimit social dhe individual	78,012	69,860	330,851	350,812
90	Pastrimi, heqja e mbeturinave, trajtimi i hedhurinave dhe aktivitete të tjera të ngjashme	200	1,318	200	1,834
91	Aktivitete të organizatave të ndryshme shoqërore	70,792	59,397	59,039	71,982
92	Aktivitete dëfrimi, kulturore dhe sportive	6,756	8,965	271,433	276,646
93	Aktivitete të shërbimeve personale	266	180	180	351
P	Shërbime në shtëpi	0	0	0	0
95	Shërbime në shtëpi				
96	Aktivitete të prodhimit të mallrave të pandryshuar të familieve private për përdorimin e vet				
97	Aktivitete të prodhimit të shërbimeve të pandryshuara të familieve private për përdorimin e vet				
Q	Aktivitete të organizmave ndërkombëtarë	0	0	0	0
99	Aktivitete të organizmave ndërkombëtarë				
	Na	44,100	44,100	44,100	44,100
Total		15918472.668058	19,255,005	31210457.555887	37,708,160

SHËNIME

*Argita Frashëri: Përgjegjëse e Zyrës së Bilancit të Pagesave, Departamenti i Statistikës.

[1] Razin, A. : FDI flows, a critical look, NBER Reporter Spring 2002.

[2] UNITED NATION, World Investment Report, 1992.

ÇËSHTJE TË BASHKIMIT MONETAR EVROPIAN DHE KRITERET E PAKTIT TË STABILITETIT DHE RRITJES

*Bledar Hoda**

Fjalë kyçe
- Bashkimi Monetar Evropian - Pakti i Stabilitetit dhe Rritjes - Euro - Banka Qendrore Evropiane -

ABSTRAKT

Kjo trajtesë fokusohet në një vlerësim të politikave të Bashkimit Monetar Evropian, veçanërisht kritereve të Paktit të Stabilitetit dhe Rritjes (Ekonomike), ndryshe SGP. Objekti i përcaktimit të një kornize koordinuese të politikave ekonomike në BE përbën një zhvillim pozitiv, ndonëse ekzistojnë debate mbi optimalitetin e tij. Kjo trajtesë, nuk merrr parasysh vështirësinë në hartimin rregullator të saj dhe kompromisin midis vendeve anëtare, por përqendrohet në hartimin optimal bazuar në arsyen ekonomike. Materiali shtjellohet si vijon: Së pari, vlerësohet racionaliteti i një monedhe të përbashkët. Më tej tentohet një përmbledhje e përfitimeve afatgjata ndërsa trajtohet kostoja afatshkurtër e politikës monetare të përbashkët. Në pjesën e tretë synohet mbështetja e nevojës së përfshirjes së dy treguesve thelbësorë makroekonomikë - rritjes ekonomike dhe nivelit të borxhit kombëtar- të çdo vendi në hartimin e këtij Pakti. Së fundi, një mbyllje vlerësuese.

I. HYRJE

Zona e Euros është zhvendosur në faza të avancuara të bashkëpunimit dhe të ribashkimit, gjatë gjysmës së dytë të

shekullit të shkuar. Statuskuoja ekonomike e kontinentit në çdo hap të saj është përcaktuar nga drejtimi i zhvillimeve dhe ritmi i realizimit të masave koordinuese të ndërmarra. Ky i fundit, ritmi i progresit të marrëdhënieve ndërmjet vendeve, është ndikuar nga interesat kombëtarë specifikë të vendeve anëtare. Evropa ka evidenca të plota me shembuj të qëndrimeve të kundërta. Megjithatë, perspektiva e kësaj lëvizjeje është përqasur shumë më herët nga ideatorët e së ardhmes së Evropës, të cilët e kanë parë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve politike dhe kulturore në terma të objektivave ekonomikë të përbashkët. Shumë prej tyre kanë argumentuar se vendosja e një perspektive të përbashkët të zhvillimit ekonomik si një objektiv afatgjatë, do të mbizotërojë marrëdhëniet dhe do të dobësojë mosmarrëveshjet afatshkurtra midis vendeve. Duke iu bashkuar këtij argumenti, përkufizoj më tej se objektivat e përbashkët ekonomikë përjashtojnë nga tryeza e vendimmarrjes alternativën e implementimit të konfliktit të forcës si, *një strategji me një përfundim neto zero*. Përmbushja e objektivit të përmirësimit të mirëqenies ekonomike nëpërmjet konfliktit të forcës, nuk plotëson kushtin e optimalitetit të Pareto, dhe rrjedhimisht rezulton një strategji me shumë neto zero të palëve të përfshira në konflikt[1].

II. POLITIKA MONETARE E UNIFIKUAR

Një nga mbështetësit origjinalë dhe me influencë të idesë së Evropës si një entitet shoqëror i vetëm, *Zhan Moné* (Jean Monnet) në vitet 1950, argumentoi se prania e një mjeti të përbashkët të mirëqenies ekonomike si paraja, do të nxiste shoqërinë evropiane dhe udhëheqësit e saj drejt të vetmes alternativë të kooperimit, si zgjidhje ndaj potencialit për konflikt. Sot pranohet gjerësisht se përveç shmangies së konfliktit, kooperimi ekonomik mbart ndikime pozitive ekstra në terma të produktivitetit dhe të mirëqenies së shtetasve të saj. Shoqëria evropiane ka shpenzuar mëse gjysmë shekulli kohë të ribashkohet dhe të arrijë të implementojë një strategji kooperative të plotë, të finalizuar në një monedhë të përbashkët "euro". Implementimi i monedhës së përbashkët e bën të domosdoshëm hartimin e një politike

monetare të vetme për vendet anëtare në Zonën e Euros, nëpërmjet institucionalizimit të Bankës Qendrore Evropiane. Politika monetare e përbashkët është pjesë e një kornize më të përgjithshme të kooperimit në terma të politikave ekonomike të Unionit Monetar dhe Ekonomik (EMU). Politika monetare e unifikuar dhe EMU është konsideruar si ngjarja e vetme më e rëndësishme në historinë monetare të pasluftës (*Danthine etj., 2000*).

Vendet anëtare përfitojnë nga impaktet pozitive të politikës monetare të unifikuar. Së pari, përftohen pritshmëri inflacioniste të qëndrueshme në terma afatgjatë për të gjitha vendet anëtare, në sajë të mungesës së ndikimeve politike dhe të trashëgimisë pozitive nga bankat qendrore të vendeve më të zhvilluara të bashkësisë, dhe të pavarësimit të Bankës Qendrore Evropiane (BQE) kundrejt qeverive të vendeve anëtare. Pritshmëri të qëndrueshme dhe të ulëta në terma afatgjatë përbëjnë një faktor të rëndësishëm në normën faktike të inflacionit. Së dyti, një politikë monetare e unifikuar i jep një shtysë të re integrimit financiar në Zonën e Euros, duke injektuar efekte pozitive në terma të ndërmjetësimit financiar të këtij sektori në ekonominë evropiane[2]. Gjithashtu, delegimi i objektivit të inflacionit të BQE, zhvendos fokusin e politikave ekonomike të vendeve anëtare ekskluzivisht drejt rritjes ekonomike në funksion të rritjes së mirëqenies së Komunitetit Evropian.

Disa nga aspektet jopozitive të unifikimit të politikës monetare qëndrojnë në impaktet e saj në periudhën afatshkurtër, ndërsa të tjerat në pamjaftueshmërinë e koordinimit të saj me politikat e tjera ekonomike në EMU. Asimetritë strukturore të ekonomive të Eurozonës, në mungesë të lëvzshmërisë së mjaftueshme të forcës punëtore, çojnë në divergjencë të stabilitetit ekonomik midis rajoneve të ndryshme të Zonës. Gjithashtu, një objektiv inflacioni i shprehur në formën "më pak por afër 2 për qind" mund të mos jetë optimal, veçanërisht për anëtarët e rinj të Bashkimit Monetar. Rritja ekonomike potenciale e vendeve në zhvillim mund të kërkojë një objektiv inflacioni disi më të lartë nga 2 për qind, në varësi të nivelit të zhvillimit ekonomik të rajoneve. Megjithatë, Mongelli (2006) argumenton se shenjat

e shtimit të divergjencave në treguesin e rritjes ekonomike midis vendeve janë të të kufizuara, dhe se devijimet e ritmeve të rritjes së PBB-ve reale midis vendeve të Eurozonës, kanë mbetur afër niveleve mesatare historike (*Mongelli etj., 2006*).

Për më tepër, politika monetare e përbashkët favorizon vendet më të mëdha të Eurozonës, për vetë faktin se normat e inflacionit të tyre janë më të korreluara me inflacionin total të Eurozonës, në sajë të koeficientëve të lartë të ponderimit. Kjo shkakton përkeqësim të mirëqenies ekonomike për ekonomitë e vogla, duke qenë se kostoja e inelasticitetit të çmimeve në kahun rënës në këto vende, është rreth katër herë më e lartë se në ekonomitë e zhvilluara (*Canzoneri, 2004*). Në këto kushte, efektet e politikës monetare të përbashkët të BQE nxisin, jo qëllimisht, implementimin e reformave strukturore të cilat rekomandohen me forcë nga ekonomistët. Canzoneri, në artikullin e tij, argumenton se vendet e Eurozonës, në tërësi pas lindjes së BQE, kanë ndërmarrë më tepër reforma, për të cilat nuk janë vlerësuar, duke qenë se këto reforma kërkojnë kohë të manifestojnë efektet e tyre pozitive.

Megjithatë, qëndrimet e akademikëve të ndryshëm shkojnë më tej në vlerësimet ndaj politikës monetare të përbashkët. Në praktikë, një politikë monetare e vetme, mund të mos ushtrojë të gjitha efektet pozitive që mbart në potencialin e saj, në prani të politikës fiskale dhe ekonomike të decentralizuar. Në këtë linjë, Pakti i Stabilitetit dhe Rritjes Ekonomike nuk merr parasysh strukturën e ndryshme midis vendeve anëtare dhe, rrjedhimisht, kufizon fleksibilitetin e nevojshëm për të implementuar politika fiskale të fokusuara në çështje specifike për çdo vend, si rritja ekonomike dhe inflacioni ulët apo deflacioni. Ndërsa ky shqetësim ishte i vlefshëm në Eurozonën me 15 anëtarë, është edhe më problematik në Eurozonën 25 anëtarëshe. Kjo lidhet me faktin se inflacioni, rritja potenciale dhe borxhi publik në vendet e reja, ndryshojnë dukshëm kundrejt anëtarëve të vjetër, si rezultat i nivelit të zhvillimit në të cilin çdo vend ndodhet dhe përpjekjeve për të arritur nivelin e mirëqenies të anëtarëve më të vjetër (Wenzel, 2004).

III. KOORDINIMI I POLITIKËS FISKALE DHE I POLITIKAVE TË TJERA EKONOMIKE

Politikat ekonomike kanë mbetur kryesisht përgjegjësi e shteteve anëtare në Eurozonë. Institucionet e Bashkimit Evropian, të përbëra nga përfaqësues të shteteve anëtare, kanë përcaktuar korniza udhëzuese dhe rregullative, të cilat duhet të ndiqen nga çdo vend anëtar. Ky rregullim synon koordinim optimal të politikave ekonomike individuale midis vendeve anëtare, sikurse edhe me politikën monetare të përbashkët evropiane. Këto korniza janë formalizuar nën një marrëveshje të pranuar nga vendet anëtare, të quajtur Pakti i Stabilitetit dhe Rritjes (ekonomike) miratuar në muajin qershor të vitit 1997 nga Këshilli Evropian në Amsterdam. Pakti i Stabilitetit dhe Rritjes vendos një kornizë për koordinimin e politikave ekonomike dhe monetare të përbashkëta, të përqendruar kryesisht në përmbushjen e objektivave të politikës monetare dhe të asaj fiskale. Kjo kornizë, në formën e saj të gjithëpranuar në vitin 1997, përmban katër kritere, ndër të cilat dy prej tyre janë të një rëndësie konkrete në gjendjen aktuale.

- *Stabiliteti i çmimeve*. Sipas këtij pakti, BE, nëpërmjet politikave dhe institucioneve të saj, përcakton ruajtjen e stabilitetit të çmimeve si një objektiv kryesor të politikave monetare të vendeve anëtare, në atë kohë. Koncepti i stabilitetit të çmimeve është përkufizuar si mesatare dymbëdhjetëmujore e normës së inflacionit nën 1.5 pikë përqindje nga mesatarja e tre ekonomive anëtare me performancën më të mirë. Me krijimin e Bankës Qendrore Evropiane në vitin 1999, objektivi i inflacionit për Eurozonën është përcaktuar në formën "nën por afër 2 për qind".
- *Financat publike*. Pozicion financiar i qëndrueshëm i vendeve anëtare:

1. deficiti buxhetor i përgjithshëm më i vogël ose i barabartë me 3 për qind të PBB-së;
2. borxhi total më i vogël ose i barabartë me 60 për qind të PBB-së ose t'i përafrohet me ritëm të kënaqshëm këtij niveli maksimal.

Pakti, në versionin e hartuar në vitin 1997, parashikon edhe stabilitet të normës së interesit, përkufizuar në formën e mesatares dymbëdhjetëmujore të *yield*-it të bonove të thesarit me maturitetin afatgjatë, brenda intervalit prej 2 pikë përqindjeje nga mesatarja e tre vendeve me normat më të ulëta të interesit. Gjithashtu, Pakti kushtëzon politikat e kursit të këmbimit të vendeve anëtare. Çdo vend u kufizua të respektojë hapësirat luhatëse të lejuara të "Mekanizmit të Kursit të Këmbimit" për të paktën 2 vjet pa zhvlerësime të monedhës vendase kundrejt monedhës së çdo vendi tjetër anëtar me nismë vetjake. Me hyrjen e euros si monedhë e përbashkët, në 1 janar 1999, këto dy kritere mbetën të paaplikueshme.

Kriteri i parë, ai i stabilitetit të çmimeve, është adresuar nëpërmjet një politike monetare të përbashkët. Kriteri i dytë, i cili prek çështjet fiskale, por lidhet me politika të tjera ekonomike, vendos një kusht rigoroz për politikat fiskale të vendeve anëtare. Ky kriter, duke mos iu përshtatur nevojave të vendeve anëtare, kufizon më tepër vendet që janë në një fazë zhvillimi, rritja ekonomike e të cilave mund të lejojë deficit më të lartë buxhetor se 3 për qind. Ndërsa, ai favorizon në mënyrë joeficiente ekonomitë e zhvilluara nëpërmjet efektit të inkonsistencës së këtij kriteri me rritjet ekonomike më të ulëta që kanë këto vende. Rezulton se kjo kornizë mund t'i vijë përshtat një numri të vogël vendesh anëtare, treguesit makro të të cilave përputhen me këtë kornizë. Në këtë mënyrë, SGP mund të përshtatet për vendet anëtare me tregues makro më të ndryshëm dhe të rritë fleksibilitetin e nevojshëm për të orientuar ekonominë drejt potencialit të saj, duke rritur eficiencën e politikave ekonomike specifike (*VVenzel et. al 2004*).

Çështja e kufizimit të potencialit ekonomik të ekonomive të reja dhe e favorizimit ekspansionist joeficient të ekonomive të vjetra, mund të përqaset me një këndvështrim teorik pa një model të aplikuar nga vende specifike. Në perspektivën e teksteve ekonomike, për një potencial relativisht më të lartë të rritjes ekonomike, rritet tavani i lejuar i deficitit fiskal, që mund të mbështesë ajo ekonomi pa shkaktuar pamundësi rishlyerjeje të borxhit ose kosto financiare në terma të kredibilitetit financiar

në tregje. Gjithashtu, një deficit fiskal i paqëndrueshëm në një vend, ka efekte anësore për vendet e tjera anëtare të një bashkimi monetar. *Calmfors* (1998) nënvizon se transmetimi ndërkombëtar i politikës fiskale ndërmjet vendeve ndodh, jo nëpërmjet deficitit kombëtar por, nëpërmjet eksporteve neto të një vendi. Nëse supozohet një lidhje hipotetike lineare midis rritjes ekonomike dhe deficitit fiskal të qëndrueshëm, mund të paraqitet në një formë të thjeshtë nëpërmjet grafikut të mëposhtëm.

Grafik 1. Potenciali i rritjes ekonomike dhe norma e qëndrueshme hipotetike e deficitit fiskal (majtas); borxhi kombëtar (% PBB-së) dhe norma e qëndrueshme hipotetike e deficitit fiskal.



Literatura akademike argumenton se për rritje me norma relativisht të larta të PBB-së nominale, deficiti fiskal i lejuar është më i lartë, pa cënuar raportin e borxhit total ndaj PBB-së, të vendeve që aspirojnë hyrjen në BE. Normat më të larta të rritjes ekonomike dhe ulja e primit të rrezikut në normat reale të interesit, rrisin kapacitetet e vendeve anëtare për të përballuar deficite fiskale më të larta (*Buiter etj., 2002*).

Kriteri i deficitit fiskal prej 3 për qind, mund të penalizojë vendet që kanë një potencial të lartë rritjeje ekonomike të kushtëzuar nga investimet publike. Kjo përbën një rezultat vetëpërmbushës, përderisa kufizimi i shpenzimeve publike të një shteti me potencial të lartë zhvillimi, ndërpret shpenzimet kapitale të domosdoshme për të arritur ritmet e larta të zhvillimit në përputhje me potencialin ekonomik të atij vendi. Nevoja për konvergjencë në fushën e infrastrukturës dhe standardeve

Grafik 2. Lidhje e anasjelltë midis potencialit të rritjes ekonomike dhe të ardhurave për frymë.

ambientale gjithashtu justifikon, edhe pse nën një mbikëqyrje të rreptë, rritjen e huamarrjes. Si rezultat, normat e zhvillimit të këtyre ekonomive mbeten nën potencialin e tyre, duke ngadalësuar kështu procesin e konvergjencës së të ardhurave për frymë kundrejt ekonomive të zhvilluara. Kanë qenë pikërisht vendet me potencial të lartë zhvillimi me të ardhurat për frymë më të ulëta në BE, veçanërisht ekonomitë ish-kandidate për t'u anëtarësuar.

Treguesi i dytë makroekonomik ndaj të cilit SGP mund të kalibrohet më tej është raporti i borxhit kombëtar ndaj PBB-së. Vendet me një raport borxh/PBB relativisht më të ulët se kriteri i borxhit, mund të lejojnë deficite fiskale më të larta për disa vite. Këto vende duke përmbushur kriterin e deficitit fiskal prej 3 për qind, mund të vërejnë ekonomitë e tyre të humbasin mundësi zhvillimi. Bashkimi në një monedhë të vetme për të gjithë Eurozonën, nënkupton minimizim të impakteve që deficitet fiskale të larta të një ekonomie të paanëtarësuar do të kishin për atë ekonomi. Në kushtet aktuale, minimizohet rritja e normës së interesit, ose ndryshimet potenciale në kursin e këmbimit, në atë ekonomi, fenomene të pritura në kushtet e qarkullimit të monedhave individuale të secilit vend. Aspektet negative të këtyre rrjedhimeve, qëndrojnë në argumentin se mungon një reagim më i plotë nga tregjet që do të mundësonte disiplinime të deficiteve buxhetore të paqëndrueshme të çdo vendi anëtar. Në fushën ekonomike, ky fenomen përshkruhet me konceptin

e "*rrezikut moral*"[3]. Në këtë këndvështrim, nëse një vend rrit deficitin buxhetor, atëherë ai kontribuon në përkeqësimin e raporteve makroekonomike të të gjithë Eurozonës, por mbart vetëm pjesërisht impaktet e tejkalimit të treguesve përtej normave ekuilibër, dhe e anasjellta. Kjo çështje njihet me termin "*problemi i përfituesit të lirë*[4]" dhe ndërsa ishte problematik në Eurozonën pesëmbëdhjetëanëtarëshe, do të mbetet për disa kohë shqetësues edhe pas hyrjes së dhjetë anëtarëve të rinj. Në fakt, impaktet anësore të kësaj çështjeje vlerësohet të jenë adresuar në marrëveshjen për kufizimin e deficitit (*Feldstein, 2005*).

Megjithatë, pranohet një kundërargument se deficitet janë më të ndjeshme ndaj normave të interesit në ekonomitë me nivele të larta të borxhit, gjë që i detyrohet shërbimit të borxhit. Për më tepër, vendet që kanë borxh të lartë detyrohen të shtojnë taksat, duke ulur fleksibilitetin e të ardhuarave fiskale ndaj ndryshimeve në taksat bazë. Këta faktorë, çojnë në kosto të mirëqenies. *Collignon* (2003) llogarit që një familje, në një vend me borxh të lartë, do të ishte e gatshme të hiqte dorë nga 1,3 për qind e konsumit në çdo periudhë për të jetuar në një ekonomi mesatare, duke nënkuptuar një ekonomi pa probleme që lidhen me borxhin e lartë. Disa analistë të tjerë të SGP, argumentojnë se kriteret e paktit duhet të shoqërohen me pavarësi të bankave qendrore (*Cari etj., 2004*). Kjo çështje ngrihet në sajë të problemit të inkonsistencës kohore të politikave ekonomike. Rëndësia e kushteve fiskale në një bashkim monetar, lidhet me mundësinë e angazhimit të Bankës Qendrore të Eurozonës në ndjekjen e politikave të veta.

IV. VLERËSIME TË PËRGJITHSHME

Hyrja e monedhës euro është pjesë e një procesi të gjatë konvergjence makroekonomike, dhe ekzistojnë hapësira për përpjekje të mëtejshme bashkëpunimi midis vendeve anëtare, në terma të politikave ekonomike për konsolidimin e plotë të një bashkimi monetar.

Kombinimi i politikës monetare të përbashkët dhe politikave fiskale të decentralizuara, rrit nevojën dhe rëndësinë e politikave ekonomike në përshtatje të ecurisë makroekonomike.

Një model statik si SGP, mund të mos jetë optimal për të gjitha vendet anëtare të BE, dhe politikat ekonomike nën këtë model duket të kenë nevojë për masa specifike për vendet anëtare, në përputhje me nivelin rajonal të zhvillimit.

SHËNIME

* Bledar Hoda: Specialist, Departamenti i Politikës Monetare.

[1] Strategji me një "përfundim neto zero", nënkupton një lojë ku njëra palë fiton atë çka humbet pala tjetër por që në total nuk gjenerohet ose prodhohet, duke e çuar shoqërinë drejt rrënimit.

[2] Kjo nënkupton zgjerim të "kufirit të mundësisë së prodhimit" në ekonominë evropiane në tërësi.

[3] Koncepti i "rrezikut moral" (ang. "*moral hazard*"), shpjegon mungesën e motiveve për të ndrequr një problem, në rastet kur pasojat janë shmangur *apriori*.

[4] Termi "problemi i përfituesit të lirë" është përshtatje e termit të njohur ekonomik në gjuhën angleze "*free rider problem*".

LITERATURA

1. *Buiter, W. H. dhe Clemens, G. (2002), "Reformimi i rregullave të politikës fiskale të EMU- Disa sugjerime për promovimin e qëndrueshmërisë fiskale dhe stabilitetit makroekonomik në Bashkimin Evropian pas zgjerimit (Reforming EMU's Fiscal Policy Rules- Some Suggestions for Enhancing Fiscal Sustainability and Macroeconomic Stability in an Enlarged European Union)", EBRD, JEL Classification System E61.*
2. *Buiter, W. H. (2005), "Sensi dhe nonsensi i Mahstritit- rishikim: Çfarë kemi mësuar rreth stabilizimit të EMU? (The 'Sense and Nonsense of Maastricht' revisited: What have we learned about stabilization in EMU?)", Presented Seminal Contributions to the Political Economy of European Integration Seminar Series, Monday, 24 October, Hong Kong Theatre, London School of Economics.*
3. *Calmfors, L. (1998), "Politika makroekonomike- Vendosja e pagave dhe punësimi:Çfarë diference bën EMU? (Macroeconomic Policy – Wage Setting and Employment: What Differenc does the EMU Make", Institute for International Economic Studies, Seminar Paper No. 657.*
4. *Canzoneri, M.B., Robert E.C. dhe Behzad, T.D. (2004), "Politika makroekonomike në EMU (Macroeconomic Policy in the European Monetary Union)", Prepared for the NBER's ISOM in Reykjavik, Iceland, June 18-19, 2004.*
5. *Cari, V.V., dhe Kehoe, P.J. (2004), "Mbi pëlqimin e kufizimeve fiskale në një bashkim monetar (On The Desirability Of Fiscal Constraints in a Monetary Union)", NBER Working Paper Series No. 10232.*
6. *Collignon, S. (2003), "A është Europa duke shkuar mjaft larg? Reflektime mbi qeverisjen ekonomike të BE-së (Is Europe going far enough? Reflections on the EU's Economic Governance)", London School of Economics and CEP.*
7. *Danthine, J.P., Giavazzi, F. dhe Erns-Ludvig von Thadden (2000), "Tregjet financiare evropiane pas EMU: Një vlerësim i parë (European Financial Markets after EMU: A First Assessment", NBER Working Paper No. 8044.*
8. *Feldstein, M. (2005), "Euro dhe Pakti i Stabilitetit (The Euro and the Stability Pact)", NBER Working Paper Series No. 11249.*
9. *Gali, J. (2002), "Politika monetare në vitet e para të EMU (Monetary Policy in the Early Years of EMU)", Centre de Recerca en Economia Internacional (CREI) dhe "Universitat Pompeu Fabra".*
10. *Mongelli, F.P. dhe Juan, L.V. (2006), "Çfarë efekte ka EMU në*

Eurozonë dhe vendet anëtare?- Një përmbledhje" (What Effects is EMU Having on the Euro Area and its Member Countries? – An Overview), Seria e Materialeve Studimore të BQE, Nr. 599.

11. *Wenzel, H.D., Lackenbauer, J. dhe Brösamle, K.J. (2004), "Borxhi publik dhe e ardhmja e Paktit SGP të BE (Public Debt and the Future of the EU's Stability and Growth Pact)", BERG Working Paper No. 50.*
12. *Wyplosz, C. (1999), "Koordinimi i politikës ekonomike në EMU: Strategjitë dhe institucionet (Economic Policy Coordination in EMU: Strategies and Institutions)", Graduate Institute of International Studies, Geneva and CEPR, London – Presented in German-French Economic Forum in Bonn, January 12, 1999.*

MBI GJETJET E MISIONIT ROSC PËR SHPËRNDARJEN E TË DHËNAVE STATISTIKORE MARS – PRILL 2006

*Hilda Shijaku**
Kliti Ceca

Fjalë kyçe
- Shpërndarje të dhënash - Misioni ROSC - Statistika makroekonomike - DQAF -

SHKURTIME:

BB – Banka Botërore.
BPM5 – Manuali i Bilancit të Pagesave, Edicioni i pestë.
COICOP – Klasifikimi i Konsumit Individual Sipas Qëllimit.
DQAF – Kuadri për Vlerësimin e Cilësisë së të Dhënave.
DMFAS (Debt Management and Financial Analysis System) – Sistemi i administrimit të borxhit dhe i analizave financiare. Përdoret nga Ministria e Financave.
FMN – Fondi Monetar Ndërkombëtar.
FSAP – Programi për Vlerësimin e Sektorit Financiar.
GDDS – Sistemi i Përgjithshëm i Shpërndarjes së të Dhënave.
GFS 1986 – Statistikat fiskale të Qeverisë, FMN, 1986.
GFSM 2001 – Manuali i Statistikave Fiskale të Qeverisë, FMN, 2001.
HBS (Households budget Survey) – Anketa e Buxhetit të Familjeve.
IÇK – Indeksi i Çmimit të Konsumatorit.
IÇP – Indeksi i Çmimit të Prodhuesit.
ISWGNA – Intersekretariati i Grupit të Punës për Llogaritë Kombëtare.
ITRS (International Transaction Reporting System) – Sistemi Raportues i Transaksioneve Ndërkombëtare.
MFSM 2000 – Manuali i Statistikave Monetare dhe Financiare, FMN, 2000.
NACE Rev. 1 – Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike, Rishikimi 1.
PBB – Produkti i Brendshëm Bruto.
PNI – Pozicioni Ndërkombëtar i Investimeve.

ROSC – Raporti mbi Përmbushjen e Standardeve dhe Kodeve.
SDDS – Standardi Special për Shpërndarjen e të Dhënave.
SNA 93 – Sistemi i Llogarive Kombëtare, 1993.
SBS (Structural Bussines Survey) – Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve.
DMFAS (Debt Management and Financial Analysis System) – Sistemi i administrimit të borxhit dhe i analizave financiare. Përdoret nga Ministria e Financave.

ABSTRAKT

Materiali në vijim jep në mënyrë të përmbledhur gjetjet e Misionit ROSC për shpërndarjen e të dhënave statistikore, i cili vizitoi Shqipërinë gjatë periudhës mars – prill 2006. Misioni vlerësoi pozitivisht progresin e bërë në prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave kombëtare që prej vitit 2000. Gjetjet e misionit dhe rekomandimet e lëna për përmirësimin e kuadrit statistikor në Shqipëri, përbëjnë tashmë pjesën kryesore të planeve të ardhshme për zhvillim të tre agjencive statistikore kryesore në vend: INSTAT, Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave.

HYRJE

Misioni ROSC për shpërndarjen e të dhënave vizitoi për herë të dytë Shqipërinë gjatë periudhës mars – prill 2006. Vlerësimi i zhvillimit të proceseve statistikore në Shqipëri, identifikimi i problemeve dhe marrja e masave në kohën e duhur, i paraprinë njërit prej projekteve më të rëndësishme të statistikave kombëtare: anëtarësimit në projektin e SDDS. Ky material prezanton në mënyrë të përmbledhur gjetjet dhe rekomandimet e Misionit për 5 kategoritë kryesore të statistikave makroekonomike: statistikat e sektorit të jashtëm, llogaritë kombëtare, statistikat e çmimeve, statistikat monetare dhe statistikat fiskale të qeverisë.

Fillimisht materiali përmban një informacion mbi ROSC dhe rëndësinë e tij në zhvillimin e tregut financiar të një vendi, duke u përqendruar në ROSC për shpërndarjen e të dhënave.

Gjithashtu, në këtë pjesë jepet një shpjegim mbi metodën e vlerësimit (Kuadrin e Vlerësimit të Cilësisë së të Dhënave- DQAF) dhe kriteret që vlerësohen. Në pjesën e dytë të materialit jepen gjetjet e Misionit për secilën nga kategoritë e të dhënave sipas strukturës së DQAF. Në pjesën e tretë, jepen masat e marra nga të tre agjencitë statistikore në vend (INSTAT, Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë) për përmbushjen e rekomandimeve të Misionit.

ROSC DHE RËNDËSIA E TIJ

Roli i standardeve ndërkombëtare në forcimin e arkitekturës financiare është parë si një nevojë në rritje nga komuniteti ndërkombëtar. Në një mjedis ku tregjet e kapitalit janë të integruara, krizat financiare në vend mund të përhapen shumë shpejt dhe të rrezikojnë stabilitetin financiar ndërkombëtar. Si rrjedhim, krijimi i një minimumi standardesh ndërkombëtare shihet si një "e mirë" publike prej të cilës përfitojnë si sistemet ndërkombëtare ashtu dhe ato kombëtare. Në nivel ndërkombëtar, këto standarde rrisin transparencën dhe mundësojnë mbikëqyrjen e shumanshme të sistemeve kombëtare, krijojnë mundësinë e identifikimit të dobësive që potencialisht mund të çojnë në një destabilitet ekonomik dhe financiar, si dhe rrisin eficiencën e tregut. Në nivel kombëtar, standardet ndërkombëtare sigurojnë një kriter për identifikimin e problemeve, si dhe shërbejnë për orientimin e reformave.

Për të arritur këta objektiva, përmbushja e standardeve duhet vlerësuar në kontekstin e strategjisë së përgjithshme të zhvillimit të vendit dhe në përputhje me kushtet e tij. Në këtë kontekst, FMN dhe BB qysh prej vitit 1999, kanë ndërmarrë një iniciativë për vlerësimin e bashkësisë së rregullave në të cilët implementohen politikat ekonomike në vende të caktuara, duke i krahasuar me praktikat më të mira ndërkombëtare. Këto rregulla e praktika, të quajtura kode dhe standarde vlerësohen si të rëndësishme për zhvillimin dhe stabilitetin e sektorit financiar e të sektorit privat, dhe përmblidhen në disa module të quajtura ROSC[1] - Raporte mbi përmbushjen e standardeve dhe kodeve -, nën përgjegjësinë e

FMN, BB ose në projekte të përbashkëta të tyre. FMN përgjigjet për vlerësimin e standardeve në fushën e shpërndarjes së të dhënave dhe transparencës. Modulet për sektorin financiar (transparenca e politikës monetare dhe fiskale, mbikëqyrja bankare, rregullimi i tregjeve të letrave me vlerë, sistemi i pagesave dhe sigurimi i depozitave) ndërmerren nën përgjegjësinë e përbashkët të BB dhe FMN në programin e vlerësimit të sektorit financiar[2] (FSAP). BB ka përgjegjësinë në 3 fusha të tjera të mbuluara nga ROSC, drejtimi i korporatave, auditimi e kontabiliteti dhe të drejtat e kreditorëve.

Nëpërmjet nxitjes për adoptimin e standardeve ndërkombëtare, kjo iniciativë synon të arrijë 3 objektiva të ndërmjetëm: së pari, të ndihmojë vendet të forcojnë institucionet e tyre ekonomike; së dyti, të ndihmojë FMN dhe BB për të vlerësuar më mirë nevojat dhe rreziqet e një vendi; dhe së treti, të informojë pjesëmarrësit e tregut dhe të rrisë eficiencën e tij.

Vlerësimi nga misionet e ROSC kryesisht është aplikuar në vendet në zhvillim të tregut financiar dhe vendet e zhvilluara, ndërkohë që pjesëmarrja nga vendet në zhvillim ka qenë më e ulët. Rreth 90 për qind e vendeve të zhvilluara dhe vendeve me tregje financiare në zhvillim, kanë patur të paktën një vlerësim të misioneve ROSC. Testet empirike tregojnë që vendet pjesëmarrëse përgjithësisht, janë ato vende që synojnë të jenë më transparente dhe të forcojnë institucionet e tyre. Rreth 75 për qind e vlerësimeve ROSC të kryera janë publikuar, ndërkohë që pjesa më e madhe e vendeve që e publikojnë vlerësimin janë vendet e zhvilluara.

Për vlerësimin e efektivitetit të ROSC, ka patur disa studime empirike, kryesisht me autorësinë e specialistëve të Fondit, të cilat shtrojnë hipotezën se vlerësimi i ROSC, publikimi i ROSC dhe anëtarësimi në projektet e standardeve të të dhënave (GDDS dhe SDDS) sjellin përparësi në uljen e kostove të huamarrjes, përmirësimin e klasifikimit për vendin dhe rrisin eficiencën e tregut. Pavarësisht prej kufizimeve që këto studime kanë për arsye të vëllimit të vogël të zgjedhjes, serive kohore të shkurtra etj., ato tregojnë se në përgjithësi, pjesëmarrja në këto projekte

sjell disa avantazhe për vendet. Katër prej këtyre studimeve tregojnë që identifikimi i problemeve dhe ndjekja e reformave të propozuara, sidomos në fushën e mbikëqyrjes bankare dhe transparencës së politikave, përmirëson klasifikimin dhe treguesit e performancës së tregut.

FMN dhe BB kanë zhvilluar metodologji tepër të detajuara për vlerësimin e standardeve, të cilat janë në proces të vazhdueshëm rishikimi. Për shembull, në fushën e shpërndarjes së të dhënave FMN përdor DQAF[3], i cili në thelb është një metodologji për vlerësimin e të dhënave statistikore, që mbulon tërë ciklin e prodhimit të tyre, që lidhet drejtpërsëdrejti me lehtësinë e përdorimit dhe garantimin e integritetit të të dhënave si dhe me cilësinë e tyre. Këto metodologji mund të përdoren dhe nga vetë vendet, për të vlerësuar përmbushjen e standardeve në fusha të caktuara. Përgjithësisht, vetëvlerësimi i vendeve duke përdorur metodologjitë e ROSC, ndërmjet vendeve me tregjet financiare në zhvillim, ka patur impaktin më të madh në fushat e transparencës së politikave, infrastrukturës financiare dhe ligjeve e praktikave që sigurojnë integritetin e tregut. Një vlerësim i tillë është bërë mbi shpërndarjen e statistikave të prodhuara në Bankën e Shqipërisë në vitin 2005 nga Departamenti i Statistikës[4] dhe ka mundësuar përmirësimin e disa praktikave përpara vlerësimit të ROSC.

Në vijim të materialit do të shpjegojmë shkurtimisht metodologjinë e vlerësimit që përdor ROSC për shpërndarjen e të dhënave – DQAF, dhe në pjesën e dytë të këtij materiali do të paraqesim, në mënyrë të përmbledhur, vlerësimin e misionit ROSC për të dhënat statistikore në Shqipëri.

DQAF është një metodologji për vlerësimin e cilësisë së të dhënave që bashkon praktikat dhe metodologjitë më të mira ndërkombëtare, duke përfshirë "Parimet Kryesore të Kombeve të Bashkuara për Statistikat Zyrtare"[5] dhe projektet e SDDS dhe GDDS. Që prej vitit 1997, kjo metodologji ka qenë në një ndryshim të vazhdueshëm, si produkt i konsultimeve me statisticienë të vendeve të ndryshme, ekspertë nga organizata ndërkombëtare, ekspertë të FMN dhe përdorues të të dhënave statistikore jashtë FMN. Për të zhvilluar metodologjinë e vlerësimit

të cilësisë, fillimisht lindi nevoja e qartësimit të dimensioneve të të dhënave statistikore që lidhen me cilësinë. Edhe pse cilësia e të dhënave statistikore shpesh nënkupton saktësinë e tyre, sot ekziston një konsensus i përgjithshëm që cilësia e të dhënave është një koncept shumëdimensional. Sipas DQAF, janë pesë dimensione të cilat përkufizojnë cilësinë e të dhënave: garantimi i integritetit të të dhënave, metodologjia e përshtatshme, saktësia dhe besueshmëria, dobishmëria e të dhënave dhe e drejta e përdorimit të të dhënave. Për secilin prej këtyre pesë dimensioneve, DQAF detajohet në karakteristika të monitorueshme, që mund të përdoren në vlerësimin e cilësisë. Gjithashtu DQAF, specifikon se duhet të ekzistojnë disa parakushte të cilësisë – një mjedis mbështetës për statistikat, përputhje të burimeve me kërkesat e programeve statistikore dhe orientimi ndaj cilësisë në statistika. Për secilën nga këto karakteristika, DQAF përmban një pohim normativ, i cili përshkruan standardet ndërkombëtare dhe vlerësimi kryhet duke i krahasuar këto të fundit me praktikat e vendit. DQAF i vlerëson praktikat sipas katër "notave":

- në përputhje me standardet;
- përgjithësisht në përputhje me standardet;
- përgjithësisht në mospërputhje me standardet; dhe
- në mospërputhje me standardet.

Një gjë e tillë e bën vlerësimin të jetë lehtësisht i lexueshëm edhe nga një auditor jo teknik, evidenton më qartë prioritetet për përmirësim si dhe mundëson krahasimin e praktikave ndërmjet vendeve të ndryshme.

Në mënyrë të përmbledhur dimensionet dhe karakteristikat përbërëse jepen në tabelën 1. Në seksionin 2 të materialit paraqiten vlerësimet për secilën nga këto pika, për statistikat zyrtare të vlerësuara nga misioni ROSC. Në kolonën e parë të tabelës janë paraqitur pesë dimensionet e cilësisë së të dhënave, së bashku me parakushtet e cilësisë (në tabelë të renditura nga 0 në 5). Në kolonën e dytë të tabelës paraqiten elementet përbërëse të çdo dimensioni dhe në kolonën e tretë, kriteret sipas të cilave vlerësohet plotësimi i secilit prej tyre. Elementeve të kolonës së dytë do t'i referohemi në seksionin 2, të grupuar sipas dimensioneve përkatëse.

Tabelë 1. Dimensionet e DQAF dhe elementet përbërëse.

Dimensionet	Elementet e dimensioneve	Kriteret
0. Parakushtet e cilësisë.	0.1. Ekzistenca e një mjedisi ligjor dhe institucional që mbështet statistikat.	Ligji shprehet në mënyrë të qartë mbi përgjegjësinë për mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e një kategorie të dhënash.
		Koordinimi dhe shkëmbimi i të dhënave ndërmjet agjencive që prodhojnë të dhënat, duhet të jenë të përshtatshme.
		Të dhënat individuale të raportuara duhet të jenë konfidenciale dhe të përdoren vetëm për qëllime statistikore.
		Raportimi statistikor nga subjektet duhet mbështetur nga një mandat ligjor ose nga masa të tjera që nxisin përgjigjen.
	0.2. Burimet duhet të jenë të mjaftueshme për plotësimin e nevojave të programeve statistikore.	Burimet njerëzore duhet të jenë në nivelin e duhur për të përmbushur detyrat në përputhje me programet statistikore.
		Niveli i teknologjisë duhet të jetë i mjaftueshëm për të përmbushur detyrat në përputhje me programet statistikore.
		Financimi për kompilimin e statistikave duhet të jetë i mjaftueshëm për të përmbushur detyrat në përputhje më programet statistikore.
		Duhet të ekzistojnë mekanizma për të mundësuar një përdorim sa me eficient të burimeve.
	0.3. Monitorimi i dobishmërisë së të dhënave statistikore.	Agjencia statistikore duhet të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme dobishmërinë praktike të informacionit statistikor.
	0.4. Cilësia e informacionit statistikor në themel të procesit.	
1. Garantimi i integritetit të të dhënave.	1.1. Profesionalizmi.	Statistikat duhet të prodhohen në mënyrë të paanshme.
		Përzgjedhja e burimeve dhe e teknikave statistikore duhet të bazohet vetëm në konsiderata statistikore.
		Agjencia statistikore duhet të ketë mundësi të reagojë ndaj keqinterpretimit të të dhënave dhe keqpërdorimit të tyre.
	1.2. Transparenca e proceseve statistikore.	Kushtet dhe termat në të cilat të dhënat statistikore mblidhen, përpunohen dhe u shpërndahen përdoruesve, duhet të publikohen.
		Përdoruesit duhet të njoftohen paraprakisht nëse ka njësi qeveritare që kanë të drejta përdorimi të të dhënave para publikimit të tyre.
		Agjencia statistikore duhet të identifikojë të dhënat statistikore që prodhon dhe shpërndan, në mënyrë që publiku të ketë të qartë se për çfarë mban përgjegjësi kjo agjenci.
		Ndryshimet kryesore në metodologji, në burimin e të dhënave dhe në teknikat statistikore.
	1.3. Standardet e etikës- politikat dhe praktikat janë të udhëhequra nga standardet etike	Në agjencinë statistikore ekzistojnë standarde etike, zbatimi i të cilave monitorohet rregullisht.
		Standardet e etikës njihen nga drejtuesit dhe punonjësit e agjencisë statistikore.

2. Metodologjia.	2.1. Konceptet dhe përkufizimet.	Për çdo kategori të dhënash, FMN ka një standard reference si për shembull MSMF, 2000 për statistikat monetare dhe financiare etj.. Elementet e metodologjisë vlerësohen duke krahasuar praktikat ekzistuese me manualet e referencës.
	2.2. Mbulimi.	
	2.3. Klasifikimi/sektorizimi.	
	2.4. Bazat e regjistrimit.	
3. Besueshmëria dhe korrektësia.	3.1. Burimi i të dhënave.	Burimet e informacionit statistikor duhet të përzgjidhen mbi bazën e programeve gjithëpërfshirëse, të cilat marrin parasysh kushtet specifike të vendit.
		Burimet e të dhënave duhet të mundësojnë kompilimin e statistikave që u përgjigjen kërkesave metodologjike për mbulimin, klasifikimin, sektorizimin dhe vlerësimin e mjeteve dhe detyrimeve.
		Informacioni i kërkuar si *input* për statistikat duhet të raportohet në kohë, në mënyrë të tillë që të lejojë kompilimin në kohë të treguesve statistikorë.
	3.2. Vlerësimi i burimit të të dhënave.	Të dhënat që raportohen nga subjektet raportuese duhet të kontrollohen në mënyrë të vazhdueshme dhe rezultatet e këtij kontrolli duhet të shërbejnë për identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve.
	3.3. Teknikat statistikore.	
	3.4. Vlerësimi i të dhënave të ndërmjetme dhe produktit statistikor.	
	3.5. Studimet e rishikimit të të dhënave.	
4. Dobishmëria.	4.1. Frekuenca dhe vonesa nga data e referencës.	Frekuenca (e ndryshme për kategori të ndryshme të dhënash).
	4.2. Integriteti.	Vonesa e publikimit të statistikave nga data e referencës (e ndryshme për kategori të ndryshme të dhënash).
	4.3. Ekzistenca e një politike për rishikimin e të dhënave si dhe publikimi i saj.	Treguesit statistikorë duhet të kenë integritet ndërmjet tyre.
		Treguesit statistikorë duhet të kenë integritet si seri kohore (me një kohëzgjatje prej të paktën pesë vjetësh).
5. Lehtësia e përdorimit.	5.1. Lehtësia e përdorimit të të dhënave	Prezantimi i statstikave duhet të mundësojë përdorimin e tyre me lehtësi.
		Mjetet e shpërndarjes duhet të jenë të përshtatshme (në letër, në faqen e internetit etj.).
		Statistikat duhen shpërndarë sipas një kalendari të publikuar paraprakisht.
		Statistikat u duhen shpërndarë të gjithë përdoruesve në të njëjtën kohë.
	5.2. Lehtësia e përdorimit të metodologjisë së informacionit (metadatat).	Dokumentacioni mbi konceptet, mbulimin, klasifikimin metodat e regjistrimit, burimet e informacionit dhe teknikat statistikore duhet të publikohet. Gjithashtu dhe devijimet nga standardet e pranuara gjerësisht, duhet të evidentohen veçmas.
		Niveli i detajimit të treguesve statistikorë duhet t'i përshtatet nevojave të përdoruesve.
	5.3. Ndihma ndaj përdoruesve.	Për çdo kategori të dhënash, duhen vendosur persona kontakti përgjegjës, si dhe duhet të ekzistojnë katalogë publikimesh për përdoruesit e statistikave.

GJETJET E MISIONIT ROSC MARS- PRILL 2006 PËR STATISTIKAT SHQIPTARE

Misioni ROSC për cilësinë e të dhënave që vizitoi Shqipërinë në vitin 1999, publikuar nga Fondi në vitin 2000, përveç vlerësimeve pozitive, la një sërë detyrash duke përfshirë ndërtimin e një sistemi të llogarive kombëtare, përmirësimin e kuadrit ligjor dhe mbulimin e aktiviteteve ekonomike sidomos për statistikat e sektorit real dhe atij të jashtëm, si dhe përdorimin eficient të burimeve të informacionit. Në mars – prill 2006, një tjetër mision ROSC për të dhënat vizitoi Shqipërinë, për të vlerësuar progresin e bërë në lidhje me këto kategori të dhënash: llogaritë kombëtare, indeksin e çmimit të konsumatorit, indeksin e çmimit të prodhuesit, statistikat fiskale të qeverisë, statistikat monetare dhe statistikat e sektorit të jashtëm[6]. Agjencitë statistikore përgjegjëse për shpërndarjen e këtyre kategorive të të dhënave – Instituti i Statistikës (INSTAT), Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë, u vlerësuan gjithashtu në lidhje me parakushtet e cilësisë dhe garantimin e integritetit të të dhënave. Në vijim jepen në mënyrë të përmbledhur vlerësimet e Misionit për secilin nga dimensionet e të dhënave.

0. PARAKUSHTET E CILËSISË SË TË DHËNAVE

0.1. Përgjegjësia institucionale për kompilimin dhe shpërndarjen e kategorive të të dhënave të mbuluara nga ROSC, përkufizohet qartësisht në kuadrin ligjor dhe praktikat e punës së INSTAT, Ministrisë së Financave dhe Bankës së Shqipërisë.

- Ligji i ri "Mbi statistikat zyrtare" nr. 9180, i cili qëndron në bazë të funksionimit të INSTAT, përcakton INSTAT si një njësi qeveritare të pavarur nën mbikëqyrjen e Këshillit të Statistikave, i cili para vitit 2004 ka patur vetëm funksion këshillues. Ky ligj shprehet qartë mbi përgjegjësinë e INSTAT për mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare. Ligji gjithashtu, shprehet në mënyrë eksplicite mbi konfidencialitetin e raportimeve nga subjekte individuale si dhe për detyrimin që këto subjekte kanë ndaj INSTAT.

- Departamenti i Makroekonomisë në Ministrinë e Financave ka si detyrë kompilimin e statistikave fiskale të qeverisë dhe shpërndarjen e buletineve mujore dhe tremujore të statistikave fiskale. Ligji i Buxhetit Organik, nr. 8379, datë 29.07.1998, autorizon Ministrinë e Financave të specifikojë kërkesat raportuese për institucionet buxhetore, fondet buxhetore dhe jobuxhetore si dhe për qeverinë vendore.
- Banka e Shqipërisë, nga tradita është përgjegjëse për kompilimin dhe shpërndarjen e statistikave monetare edhe pse ligji "Për Bankën e Shqipërisë" nuk shprehet në mënyrë eksplicite për një gjë të tillë. Banka e Shqipërisë është e vetmja agjenci statistikore që kryen këtë funksion dhe ligji i jep asaj të drejtën për të formuluar kërkesat raportuese nga bankat e nivelit të dytë, personat juridikë dhe fizikë. Megjithatë, ligji nuk shprehet qartë mbi rastet e mosraportimit nga subjektet. Konfidencialiteti i të dhënave të raportuara në praktikë garantohet nga procedurat e punës, megjithatë ligji shprehet se këto të dhëna mund t'i jepen autoriteteve të taksave. Misioni vlerëson se ekzistenca e kësaj mundësie në ligj, potencialisht mund të ulë konfidencën e subjekteve raportuese në përdorimin e raportimeve nga Banka e Shqipërisë. Gjithashtu, perceptimi i kësaj mundësie të lejuar nga ligji, i ul publikut besimin në statistikat zyrtare.

Misioni vlerëson se ka vend për përmirësim përsa i përket shkëmbimit të informacionit ndërmjet agjencive dhe kushteve në të cilat raportojnë subjektet. Shkëmbimi i informacionit kryhet nëpërmjet memorandumeve të bashkëpunimit midis institucioneve, një pjesë e të cilave për momentin është në proces draftimi. Përsa i përket rregullimit të fluksit të informacionit, Misioni rekomandoi implementimin e raportimit elektronik për bankat dhe institucionet e tjera financiare, gjë që do të përshpejtonte procesin e kompilimit të statistikave monetare dhe bilancit të pagesave, dhe do të lejonte një përdorim më eficient të burimeve. Një tjetër rekomandim është konceptimi i një baze të dhënash për mbajtjen dhe kompilimin e informacionit statistikor

për statistikat monetare dhe financiare, dhe për statistikat e bilancit të pagesave.

0.2. Burimet në agjencitë statistikore janë të pamjaftueshme për të kryer me cilësi proceset ekzistuese dhe për të realizuar planet e këtyre agjencive në lidhje me projektet që ato kanë[7].

- Misioni vlerëson se në INSTAT burimet njerëzore, kushtet e punës, teknologjia e informacionit dhe burimet financiare janë të pamjaftueshme për të përmbushur objektivat e këtij institucioni.
- Në Ministrinë e Financave, burimet njerëzore janë të papërshtatshme për të vënë në funksionim programet statistikore të tashme dhe të planifikuara, të cilat janë të nevojshme për monitorimin e politikës fiskale.
- Në Bankën e Shqipërisë burimet njerëzore në Bilancin e Pagesave janë të pamjaftueshme, ndërkohë që për statistikat monetare, janë të mjaftueshme vetëm për t'iu përgjigjur përgjegjësive ekzistuese. Kështu, Misioni vlerëson se është e nevojshme të rritet numri i punonjësve të statistikës për nevoja të kompilimit të statistikave të tjera financiare, si llogaria e flukseve të fondeve, kompilimi i flukseve financiare për statistikat monetare dhe për plane të tjera afatshkurtra dhe afatmesme të sektorit. Krahas rritjes së numrit të punonjësve të statistikave, Misioni rekomandon rritjen e mbështetjes nga teknologjia e informacionit dhe zhvillimin e bazave të të dhënave të integruara, për të rritur më tej eficiencën e proceseve statistikore në Bankën e Shqipërisë.

0.3. Monitorimi i dobishmërisë së të dhënave.

Të treja institucionet monitorojnë rregullisht nevojat e përdoruesve nëpërmjet seminareve, pyetësorëve dhe takimeve periodike ndërmjet agjencive statistikore dhe organizatave ndërkombëtare. Kërkesat e veçanta të përdoruesve, përbëjnë një tjetër burim informacioni që shërben për zgjerimin apo modifikimin e treguesve statistikorë të publikuar.

0.4. Cilësia e informacionit statistikor.

Të treja agjencitë statistikore tregojnë interes për cilësinë e statistikave. Ekzistojnë praktika të rregullta për monitorimin e cilësisë, duke përfshirë vetëvlerësimin (DQAF të ndërmarrë nga Departamenti i Statistikës së Bankës së Shqipërisë), monitorimin e programeve të punës lidhur me statistikat si dhe takimet periodike me subjektet raportuese për të qartësuar kërkesat e raportimit.

1. GARANTIMI I INTEGRITETIT TË TË DHËNAVE

1.1. Profesionalizmi.

- Në INSTAT profesionalizmi dhe paanshmëria e statistikave zyrtare garantohet nga ligji "Mbi statistikat zyrtare", i cili në mënyrë specifike shprehet se nuk duhet të ketë asnjë ndërhyrje nga qeveria apo ndonjë institucion tjetër. Ligji gjithashtu, përcakton rolin dhe përgjegjësinë e Këshillit të Statistikës dhe Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT. Këshilli i Statistikës propozon emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm, i cili miratohet nga Kryeministri dhe Këshilli i Ministrave. Personeli i INSTAT, i cili gëzon statusin e nëpunësit civil, emërohet në bazë të kualifikimeve dhe INSTAT nxit pjesëmarrjen e tij në seminare dhe aktivitete kërkimore, që rrisin aftësitë profesionale. Zgjedhja e burimeve të informacionit, e teknikave statistikore dhe e praktikave të shpërndarjes së të dhënave, mbështeten vetëm në konsiderata statistikore. Organet qeveritare nuk kanë të drejta përdorimi paraprake mbi të dhënat statistikore, para publikimit të tyre. Personeli i INSTAT ka për detyrë t'i përgjigjet keqinterpretimit dhe keqpërdorimit të statistikave, si dhe organizon e nxit përdorimin e drejtë të tyre nëpërmjet seminareve me përdoruesit dhe shpjegimit të treguesve.
- Ligji "Për buxhetin organik" siguron pavarësinë e personelit të Ministrisë së Financave në kryerjen e funksioneve kontabile dhe statistikore. Ky ligj gjithashtu, i jep Ministrisë së Financave pavarësinë për të përzgjedhur burimet dhe metodat e raportimit, të cilat janë publikuar në faqen e internetit të kësaj ministrie.

Ministria e Financave monitoron rregullisht përdorimin e statistikave të saj në media. Zëdhënësi i Kryeministrit mund të komentojë interpretimin e gabuar të të dhënave kur kjo shihet e arsyeshme.

- Ligji "Për Bankën e Shqipërisë" garanton pavarësinë e Bankës së Shqipërisë. Në fushën e statistikave, ligji i jep të drejtën Bankës të përkufizojë procedurat dhe metodologjitë për kompilimin dhe shpërndarjen e statistikave monetare dhe të bilancit të pagesave, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Rekrutimi dhe ecuria e karrierës së personelit të Bankës së Shqipërisë, bëhen mbi bazën e kompetencës profesionale si dhe ofrohen mundësi trajnimi dhe zhvillimi profesional. Zgjedhja e metodologjisë statistikore bëhet vetëm bazuar mbi konsiderata statistikore. Banka e Shqipërisë komenton mbi përdorimin e statistikave të saj në publik dhe është aktive në zhvillimin e një kulture për statistikat nëpërmjet një programi trajnues për mediat.

1.2. Transparenca.

Termat dhe kushtet në të cilat kompilohen statistikat u bëhen publike përdoruesve nga të tre institucionet. Ndryshimet kryesore në metodologji publikohen paraprakisht dhe janë të disponueshme në faqet e internetit të secilës agjenci statistikore. Të gjithë përdoruesit kanë të drejta përdorimi të njëkohshme, për të gjitha kategoritë e të dhënave.

1.3. Standardet e etikës.

Sjellja e personelit në të tre agjencitë statistikore udhëhiqet nga ligji "Mbi statusin e nëpunësit civil" (INSTAT dhe Ministria e Financave) dhe kodet e etikës, të miratuara nga secila agjenci. Personeli trajnohet për njohjen e etikës së institucionit dhe në vlerësimet periodike për performancën e tij, ndjekja e etikës është një nga pikat e vlerësimit.

2. METODOLOGJIA

2.1. Konceptet dhe përkufizimet.

Elementet e vlerësimit të treguesve statistikorë për çdo

kategori të dhënash, vlerësohen duke u bazuar mbi SNA 93, NACE Rev. 1, COICOP dhe manualet përkatëse të FMN: MFSM 2000, GFSM 2001, BPM5. Për të gjitha kategoritë statistikore, përveç statistikave fiskale të qeverisë, konceptet dhe përkufizimet e përdoruara vlerësohen në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare. Për statistikat fiskale, konceptet dhe përkufizimet ndjekin GFS 1986 dhe nuk është realizuar ende kalimi në metodologjinë e re.

2.2. Mbulimi.

Misioni vlerësoi që mbulimi është në përputhje me standardet ndërkombëtare për indeksin e çmimit të prodhimit, për statistikat fiskale, për statistikat monetare dhe për statistikat e bilancit të pagesave.

Për llogaritë kombëtare, INSTAT nuk prodhon të gjitha llogaritë e duhura për të përmbushur kërkesat minimale të vendosura nga Intersekretariati i Grupit të Punës për Llogaritë Kombëtare[8]. Kështu, llogaritë kombëtare aktualisht përfshijnë vetëm llogaritjen vjetore të vlerës së shtuar, PBB-në në çmime korente dhe konstante, sipas 25 grupe aktivitetesh dhe komponentët e shpenzimeve të PBB-së me çmime korente dhe konstante.

Për indeksin e çmimit të konsumatorit mbulimi u vlerësua përgjithësisht në përputhje me standardet. Megjithatë, HBS (Anketa e Buxhetit të Familjeve) ekzistuese mbulon vetëm zonat urbane, që zënë vetëm 45 për qind të ekonomive familjare. HBS që tashmë është filluar nga INSTAT, do të përfshijë dhe zonat rurale.

2.3. Klasifikimi/ sektorizimi.

Misioni vlerëson se praktikat e klasifikimit dhe sektorizimit të të dhënave në të gjitha kategoritë, janë në përputhje me standardet ndërkombëtare (manualet përkatëse për çdo kategori të dhënash).

2.4. Bazat e regjistrimit.

Bazat e regjistrimit të statistikave vlerësohen si përgjithësisht në përputhje me standardet, megjithatë Misioni vëren se ka disa devijime në statistikat e indeksit të çmimeve të konsumit,

llogaritë kombëtare, statistikat monetare dhe statistikat e bilancit të pagesave.

- Në llogaritë kombëtare ky devijim ka të bëjë kryesisht me trajtimin e TVSH-së të pazbritshme në konsumin e ndërmjetëm dhe regjistrimin e llogarive të qeverisë mbi baza arke[9].
- Në indeksin e çmimit të konsumit shmangia nga standardi ka të bëjë me mospërfshirjen e çmimeve të mallrave të rishitur dhe peshave përkatëse.
- Në statistikat monetare devijimi ka të bëjë me kontabilizimin e llogarive të shoqërive të kursim-kreditit në baza arke (ndërkohë që kërkohet në baza rrjedhëse) dhe trajtimin e letrave me vlerë, të cilat mbahen për një afat të gjatë nga bankat. Në kërkesat ekzistuese për raportim këto instrumente raportohen me çmimin e tyre të blerjes, në përputhje me manualin e kontabilitetit bankar, ndërkohë që për efekte të statistikave monetare kërkohet regjistrimi i tyre me vlerën e tregut.
- Në statistikat e bilancit të pagesave, shmangia ka të bëjë me regjistrimin e interesave të borxhit publik mbi baza rrjedhëse.

3. BESUESHMËRIA DHE KORREKTËSIA

Ky dimension ka të bëjë me burimin e të dhënave dhe vlerësimin periodik të tyre. Ndër të gjitha dimensionet e tjera Misioni vlerëson pikërisht mungesën e burimeve, si më problematikun për statistikat shqiptare, në krahasim me dimensionet e tjera.

3.1. Burimet e të dhënave.

Misioni vlerëson si plotësisht në përputhje me standardet, burimet e të dhënave për statistikat monetare; përgjithësisht në përputhje me standardet, burimet e të dhënave për statistikat e IÇK, IÇP dhe statistikat fiskale; dhe përgjithësisht në mospërputhje me standardet, burimet e të dhënave për statistikat e bilancit të pagesave.

- Për llogaritë kombëtare, burimet e të dhënave kanë një sërë kufizimesh ndër të cilat renditen dizenjimi i papërshtatshëm i pyetësorëve (SBS), mbulimi i pjesshëm i territorit të Shqipërisë (HBS), frekuenca e ulët e vrojtimeve, mospërfshirja e ekonomisë joformale dhe vonesat në raportim.
- Për indeksin e çmimeve të konsumit, Misioni vlerëson se metodologjia e ndjekur për HBS është në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare, por subjektet që nuk përgjigjen në anketë nuk zëvendësohen. Një gjë e tillë sjell një shmangie në ulje të IÇK-së, duke qenë se përgjithësisht subjektet që i shmangen raportimit janë ato me të ardhura më të larta.
- Për IÇP-në burimet e të dhënave nuk sigurojnë raportimin në kohën e duhur të informacionit. Çmimet mblidhen një herë në tremujor për çdo muaj, duke shkaktuar vonesa në shpërndarjen e IÇP-së për muajt e parë të tremujorit. Gjithashtu, peshat e përdorura janë derivuar nga SBS e vitit 1998 dhe ndërmarrjet që kanë pushuar së ushtruari veprimtarinë nuk janë zëvendësuar.
- Problemi i burimeve të të dhënave për statistikat fiskale lidhet me të dhënat për projekte të financuara nga grante të huaja, të cilat nuk kalojnë nga Banka e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë.
- Në lidhje me statistikat e bilancit të pagesave burimet e të dhënave, ndonëse në kohën e duhur, janë të bazuara në vrojtime jo të shpeshta dhe/ose jo të plota, duke përfshirë këtu ato të kostove të transportit, të sigurimit, rregullimet e të dhënave të importeve për kontrabandën, shpenzimet e udhëtarëve të kryera brenda dhe jashtë vendit, dërgesat nga emigrantët, investimet e huaja direkte e ato të portofolit dhe kreditë tregtare. Grantet e dërguara nga jashtë për qeveritë rajonale dhe vendore gjithashtu, kanë mangësi në raportim.

3.2. Vlerësimi i burimit të të dhënave.

Vlerësimi i burimit të të dhënave ka të bëjë me vlerësimin rutinë të vrojtimeve, gabimit të zgjedhjes, mbulimin, mosraportimin

etj., dhe përdorimin e këtij informacioni për të udhëhequr më tej proceset statistikore. Misioni vlerëson si plotësisht në përputhje me standardet llogaritë kombëtare, statistikat fiskale dhe statistikat e bilancit të pagesave, ndërkohë që vlerëson përgjithësisht në përputhje me standardet IÇK, IÇP dhe statistikat monetare. Më konkretisht, problemet e identifikuara janë:

- Për IÇK, çmimet e mbledhura edhe pse kontrollohen për vlerat shumë të ndryshme nga të tjerat, por mbledhja e informacionit nga anketuesit nuk kontrollohet.
- Për IÇP vërejtjet janë të njëjta me ato të IÇK.
- Për statistikat monetare ekzistojnë procese kontrolli mbi burimin e informacionit si për shembull, kontrolli i raportimeve në bazë të "Manualit të kritereve të kontrollit", por këto zakonisht marrin kohë dhe shkaktojnë vonesa në tërë procesin e prodhimit të statistikave, meqenëse kryhen akoma kryesisht në mënyrë manuale.

3.3. Teknikat statistikore.

Në kompilimin e treguesve statistikorë, teknikat statistikore duhet t'i përshtaten burimeve të të dhënave. Gjithashtu, proceset statistikore si rregullimet dhe transformimet e të dhënave dhe analiza statistikore duhet të bazohen mbi teknika të përshtatshme. Në lidhje me këtë element, Misioni vlerëson si në përputhje me standardin, vetëm statistikat fiskale ndërkohë që vlerëson si përgjithësisht në përputhje me standardin statistikat e IÇK, IÇP, statistikat e bilancit të pagesave dhe statistikat monetare. Teknikat statistikore të përdorura në llogaritë kombëtare, vlerësohen si përgjithësisht në mospërputhje me standardin. Më konkretisht, problemet e identifikuara janë:

- Në llogaritë kombëtare vlerësimi i vlerës së shtuar nga aktivitetet e paregjistruara, sidomos për sektorin e ndërtimit, kufizohet nga të dhëna tepër të kufizuara të faktorit të punës në prodhim. Vlerësimi i komponentëve të shpenzimeve gjithashtu, bazohet në supozime të dobëta dhe rezultatet nuk kontrollohen duke përdorur burime të tjera informacioni.
- Për IÇK, peshat e përdorura janë të vitit 2000 dhe,

duke marrë në konsideratë ndryshimet e shpejta në konsumin real të familjeve, peshat e përdoruara janë larg realitetit.

- I njëjti problem është dhe për IÇP, ku peshat e përdorura janë të vitit 1998. Misioni rekomandon ndryshimin e peshave për vitin 2005 dhe hartimin e një programi për ndryshimin e bazës së indeksit, të paktën çdo gjashtë vjet.
- Për statistikat monetare, Misioni propozoi ndryshimin e praktikës kur të dhënat e një subjekti vijnë pas afatit të caktuar. Në praktikën e mëparshme nëse kishte vonesa në raportim të një banke, treguesit statistikorë nuk kompiloheshin deri në ardhjen e këtij raportimi. Misioni rekomandon shpërndarjen e treguesve paraprakë, të cilët llogariten duke përdorur raportet e periudhës që ekzistojnë dhe raportet e një periudhe më parë të subjektit që nuk ka raportuar. Treguesit paraprakë identifikohen si të tillë në publikimet e Bankës së Shqipërisë.
- Për statistikat e bilancit të pagesave, sistemi aktual i kompilimit bazohet në një bazë teknologjike, që janë skedarët e excel-it dhe mundësia e gabimit është e madhe. Të ardhurat nga emigrantët vlerësohen si pjesë e transaksioneve të paidentifikuara në bilancin e pagesave. Gjithashtu, Misioni rekomandon rivlerësimin e ndarjes së të ardhurave nga emigrantët duke dalluar të ardhurat nga puna sezonale dhe ato të emigrantëve, që kanë qendrën e tyre të rezidencës në një ekonomi tjetër.

3.4. Vlerësimi i produkteve të ndërmjetme dhe i produktit statistikor.

Ky element nënkupton vlerësimin e rezultateve të ndërmjetme, duke marrë parasysh informacione të tjera shtesë, përveç atyre që përdoren në procesin e kompilimit dhe studimin e shmangieve që mund të rezultojnë. Për këtë, kërkohet që të bëhet një analizë statistikore e rezultateve të ndërmjetme dhe produktit përfundimtar, për të parë nëse gjetjet janë në përputhje me gjetjet nga analizat statistikore të treguesve të tjerë. Misioni vlerëson se ky proces është në përputhje me standardet për statistikat e IÇK, statistikat fiskale dhe statistikat monetare, ndërkohë që llogaritë

kombëtare, IÇP dhe statistikat e bilancit të pagesave vlerësohen si përgjithësisht, në përputhje me standardet.

- Për llogaritë kombëtare rregullimet që i bëhen të dhënave për të evituar shmangiet nuk janë të detajuara mjaftueshëm (bëhen në nivel tepër të agreguar). Kjo vjen si pasojë e burimeve tepër të kufizuara të përdorura në to, por edhe nga mospërdorimi eficient i burimeve ekzistuese.
- Në lidhje me IÇP misioni rekomandon krahasimin e rezultateve me IÇK dhe indekset e tjera të çmimit që llogariten.

3.5. Studimet mbi rishikimin e të dhënave.

Sipas praktikave më të mira ndërkombëtare, rishikimi i të dhënave duhet të shoqërohet me studime në lidhje me efektin që kanë ndryshimet e metodologjive mbi vetë të dhënat, në mënyrë që përdoruesit të kuptojnë më mirë fenomenet në kohë. Këto studime duhet të jenë pjesë e punës rutinë me statistikat. Misioni vlerëson se kjo praktikë ndiqet plotësisht në statistikat e IÇK, IÇP, statistikat fiskale, statistikat monetare dhe statistikat e bilancit të pagesave. Për llogaritë kombëtare studimet mbi rishikimin kryhen *ad hoc* dhe jo sipas një programi të përcaktuar. Duke qenë se kjo kategori të dhënash është dhe më e ndjeshmja përsa i përket rishikimeve, të cilat ndodhin dhe brenda një harku kohor relativisht të madh, praktika ekzistuese vlerësohet si përgjithësisht në përputhje me standardet.

4. DOBISHMËRIA

Që të dhënat statistikore të jenë të dobishme për përdoruesit ato duhet të gëzojnë minimalisht këto kritere: të jenë të disponueshme në kohën dhe frekuencën e duhur, të jenë konsistente në kohë ose brenda serisë dhe ndërmjet njëra-tjetrës, dhe të ndjekin një politikë të parapërcaktuar rishikimi.

4.1. Vonesa nga data e referencës dhe frekuenca.

Duke qenë se Shqipëria bën pjesë në projektin GDDS, Misioni vlerësoi praktikat në lidhje me vonesën nga data e referencës dhe

frekuencën në lidhje me këtë standard. Siç tregohet në tabelën 2, praktikat nuk përputhen me standardin për llogaritë kombëtare dhe IÇP. Duke qenë se Shqipëria ka targetuar aderimin në SDDS në fund të vitit 2007, në tabelë jepen dhe kërkesat e këtij standardi. Praktikat ekzistuese nuk plotësojnë kërkesat e SDDS për llogaritë kombëtare, IÇP dhe statistikat monetare.

Tabelë 2. Krahasimi i praktikave të vonesës dhe frekuencës me standardet e SDDS dhe GDDS.

Kategoria e të dhënave	Praktika		Standardi GDDS		Standardi SDDS	
	Frekuenca	Vonesa	Frekuenca	Vonesa	Frekuenca	Vonesa
Llogaritë kombëtare	Vjetore	11 muaj	Vjetore	9 muaj	Tremujore	3 muaj
IÇK	Mujore	8 ditë	Mujore	1-2 muaj	Mujore	1 muaj
IÇP	Mujore	4 muaj	Mujore	1-2 muaj	Mujore	1 muaj
Statistikat fiskale	Mujore	1 muaj	Vjetore	6-9 muaj	Vjetore	6 muaj
Statistikat monetare	Mujore	6 javë	Mujore	2-3 muaj	Mujore	1 muaj
Statistikat e bilancit të pagesave	Tremujore	10 javë	Vjetore	6-9 muaj	Tremujore	60 ditë

4.2. Konsistenca e treguesve.

Ky element ka të bëjë me ekzistencën e procedurave që kontrollojnë konsistencën e të dhënave statistikore si brenda një grupi të dhënash (me tregues të tjerë statistikorë) ashtu dhe konsistencën si seri kohore. Misioni vlerëson si në përputhje me standardet, të gjitha kategoritë e të dhënave përveç llogarive kombëtare të cilat vlerësohen si përgjithësisht në përputhje me standardet. Kjo, për faktin se llogaritja e PBB-së sipas metodës së shpenzimeve nuk është e pavarur nga metoda e prodhimit dhe "konsistenca" sigurohet nëpërmjet zërave balancues në metodën e shpenzimeve. Misioni rekomandon vlerësimin në mënyrë të pavarur të komponentëve të PBB-së me metodën e shpenzimeve dhe kontrollin e konsistencës së treguesve.

4.3. Politikat e rishikimit të të dhënave.

Sipas standardeve, rishikimet e të dhënave duhet të ndjekin një kalendar të paracaktuar, në mënyrë që përdoruesit të dinë nëse të dhënat janë apo jo përfundimtare dhe të dinë se kur mund t'i disponojnë të dhënat përfundimtare. Studimet dhe analizat statistikore mbi rishikimet duhet të bëhen publike së bashku me të dhënat. Me përjashtim të llogarive kombëtare dhe statistikave fiskale, praktikat ekzistuese përputhen me standardet.

- Për llogaritë kombëtare, jo të gjitha publikimet e tregojnë qartë statusin e të dhënave (paraprak, të rishikuar apo përfundimtar).
- Për statistikat fiskale, rishikimet tregohen vetëm në momentin e publikimit të të dhënave dhe jo përpara këtij momenti.

5. LEHTËSIA E PËRDORIMIT

Lehtësia e përdorimit ka të bëjë me lehtësinë që kanë përdoruesit për të kuptuar dhe përdorur të dhënat. Elementet që vlerësohen nga DQAF në lidhje me këtë dimension janë lehtësia e përdorimit të të dhënave, lehtësia e përdorimit të metadatave (informacionit mbi të dhënat) dhe ndihma që i ofrohet përdoruesve nga agjencia statistikore.

5.1. Lehtësia e përdorimit të të dhënave.

Lehtësia e përdorimit të të dhënave nënkupton shpërndarjen e të dhënave në një format dhe mënyrë të tillë, që përdoruesit të kenë të lehtë t'i përdorin (si për shembull, nëpërmjet tabelave, grafikëve etj.). Gjithashtu, ajo nënkupton shpërndarjen e treguesve statistikorë sipas një kalendari të publikuar më parë nga agjencia. Misioni vlerëson në përputhje me standardet, praktikat e ndjekura nga të gjitha kategoritë e të dhënave, përveç llogarive kombëtare. Për këtë kategori të dhënash, Misioni vëren se shpërndarja e treguesve statistikorë nuk ndjek kalendarin e parapërcaktuar, të publikuar nga INSTAT.

5.2. Lehtësia e përdorimit të metadatave.

Standardet rekomandojnë publikimin e koncepteve, të mbulimit, të bazave të regjistrimit, e burimeve të të dhënave dhe e shmangieve nga standardet ndërkombëtare. Nivelet e detajimit të metadatave duhet t'i përshtaten nevojave të audiencës së synuar, pra të ketë disa mënyra për shpërndarjen e këtij informacioni. Misioni vlerëson si në përputhje me standardet llogaritë kombëtare, statistikat fiskale, statistikat monetare dhe statistikat e bilancit të pagesave, ndërkohë që rekomandon publikimin e metodologjisë për statistikat e IÇK dhe IÇP.

5.3. Ndihma ndaj përdoruesve.

Ndihma ndaj përdoruesve, sipas standardit nënkupton vendosjen e personave të kontaktit për çdo kategori të dhënash, për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe kërkesave të veçanta të përdoruesve. Gjithashtu, ky element nënkupton ekzistencën e katalogëve të publikimit të treguesve, dokumenteve mbi to dhe shërbimeve statistikore që ofrohen. Misioni vlerëson si në përputhje me standardet të gjitha kategoritë e të dhënave, përveç llogarive kombëtare. Kjo, për arsye se faqja e internetit të INSTAT nuk ka gjithnjë informacionin më të fundit mbi treguesit edhe pse format e tjera të publikimit (në letër) e kanë këtë informacion.

MASAT E MARRA NGA AGJENCITË STATISTIKORE PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË MISIONIT

Në përgjigje të rekomandimeve të lëna nga Misioni të treja agjencitë statistikore kanë marrë masat për përmirësimin e atyre praktikave, të cilat kishin shmangie nga standardet. Së bashku me vlerësimin e ROSC është publikuar dhe përgjigjja e autoriteteve shqiptare ndaj vlerësimit të ROSC, e cila përshkruan planet e institucioneve dhe mënyrën se si ato do të përmirësojnë praktikat e tyre dhe masat që tashmë janë marrë.

PËRGJIGJJA NDAJ REKOMANDIMEVE TË PËRGJITHSHME TË ROSC

- Rritja e numrit të personelit dhe mbështetjes nga teknologjia e informacionit në agjencitë statistikore, për të përballuar përmbushjen e programeve statistikore të tashme apo të planifikuara.

Struktura e Departamentit të Statistikave në Bankën e Shqipërisë do të rishikohet deri në tremujorin e parë të vitit 2007. Përveç angazhimeve në sigurimin e informacionit për nevoja të brendshme të Bankës së Shqipërisë, në funksionin e tij si shpërndarës i të dhënave statistikore, rritja e personelit në Departamentin e Statistikës do të mundësojë kompilimin e të

dhënave për flukset financiare (sektori financiar) dhe kompilimin e PNI, dhe statistikave të borxhit të jashtëm.

- Mbajtja e një personeli kompetent në agjencitë statistikore, kalimi i statusit të punonjësve të INSTAT në hierarkinë e "nëpunësit civil" dhe përmirësimi i kushteve të punës në të gjitha agjencitë statistikore. Zhvillimi dhe trajnimi i personelit në vazhdimësi.

Agjencitë statistikore po vazhdojnë të punojnë për ngritjen e nivelit të kompetencës së personelit të statistikave. Kështu, zhvillimi i burimeve njerëzore në INSTAT së fundi ka përfituar nga rritja e pagave të punonjësve. Në Bankën e Shqipërisë, për t'iu përgjigjur nevojave të politikës për të dhëna të ekonomisë reale dhe fiskale, me angazhimin e Bankës për adoptimin e inflacionit të shënjestruar, personeli i Departamentit të Statistikave është trajnuar për kuptimin dhe vlerësimin e statistikave të prodhuara nga agjencitë e tjera.

- Rritja e burimeve financiare për përmirësimin e burimeve të të dhënave. Dhënia e përparësisë për gjetjen e burimeve të të dhënave mbi ekonominë joformale dhe të ardhurat nga emigrantët, të cilat janë veçanërisht të rëndësishme për ekonominë shqiptare.

INSTAT dhe Banka e Shqipërisë po punojnë për vlerësimin e ekonomisë joformale në Shqipëri. Kuptimi më i mirë i strukturës dhe llojeve të transaksioneve do të mundësojë një vlerësim më të mirë të të ardhurave nga emigrantët.

- Nënshkrimi i memorandumeve të bashkëpunimit midis agjencive që prodhojnë të dhëna dhe përcaktimi i mënyrave të shkëmbimit të të dhënave (specifikimi i të dhënave, koha kur do të shpërndahen, përgjegjësia për këto të dhëna etj.).

INSTAT dhe Banka e Shqipërisë janë duke draftuar një memorandum bashkëpunimi midis tyre, i cili pritet të përfundojë së shpejti. Gjithashtu, me krijimin e një baze të dhënash të qendërzuar në Bankën e Shqipërisë, që do të përmbajë një

numër të madh të dhënash statistikore nga një pjesë e mirë e institucioneve që prodhojnë të dhëna, Departamenti i Statistikës në Bankën e Shqipërisë po punon për përcaktimin e modaliteteve përkatëse, që do të përfshihen në memorandumet e bashkëpunimit me këto institucione.

- Implementimi i sistemit elektronik të raportimit për bankat dhe institucionet financiare të tjera, për të rritur eficiencën e prodhimit të statistikave monetare dhe statistikave të bilancit të pagesave. Krijimi i një sistemi kompilimi automatik për statistikat monetare dhe të bilancit të pagesave.

Implementimi i këtij rekomandimi është përfshirë në planin strategjik të zhvillimit të Bankës së Shqipërisë si plan afatmesëm. Synohet që kjo detyrë të përmbushet deri në vitin 2007.

PËRGJIGJJA NDAJ REKOMANDIMEVE SEKTORIALE

Llogaritë kombëtare

- Zgjerimi dhe përmirësimi i vrojtimeve si, vrojtimi i forcës së punës dhe HBS, që të mbulojë të gjithë vendin.
  Në fillim të vitit 2007, INSTAT do të kryejë një vrojtim për forcën e punës ndërkohë që kanë filluar përgatitjet për HBS, që do të prezantohet në vitin 2007. Përmirësimi i të dhënave për fuqinë punëtore është përparësi në kontekstin e përdorimit të këtyre të dhënave si kriter kontrolli për vlerësimet e llogarive kombëtare.

- Zgjerimi i mbulimit të llogarive kombëtare për të përfshirë llogarinë e të ardhurave, llogarinë kapitale dhe llogaritë e pjesës tjetër të botës, siç është përfshirë në Planin Strategjik të Zhvillimit të INSTAT.
  Në kuadrin e projekteve të binjakëzimit, të financuara nga Komuniteti Evropian, është krijuar një plan strategjik për të vlerësuar mundësitë për përfshirjen e këtyre llogarive në statistikat e prodhuara nga INSTAT. INSTAT po zhvillon një metodologji të vlerësimit të llogarisë së të ardhurave, duke filluar nga vlerësimi i pagave.

- Racionalizimi i teknikave statistikore për përdorimin maksimal të burimeve ekzistuese të të dhënave të përdorura për metodën e shpenzimeve. Paraqitja e një zëri balancues që përfshin konsumin final të ekonomive familjare, ndryshimet e inventarëve dhe shmangiet statistikore për vitet në të cilat konsumi final i ekonomive familjare nuk mund të vlerësohet veçmas.

INSTAT po punon për përmirësimin e metodologjisë së llogaritjes së PBB-së me metodën e shpenzimeve.

- Përdorimi i më shumë burimeve të të dhënave për të kontrolluar saktësinë e rezultateve të ndërmjetme.
  Bazuar mbi rekomandimet e Misionit, INSTAT do të rishikojë metodologjinë e vlerësimit të konsumit final të familjeve për 2003-2004, bazuar në LSMS. Gjithashtu, ekzistojnë mundësi për një përdorim më të mirë të anketës strukturore të ndërmarrjeve, për të rivlerësuar aktivitetin e sektorit të ndërtimit.

- Aplikimi i politikës së rishikimit të të dhënave në mënyrë konsistente. Identifikimi i statusit të të dhënave mbi PBB (për shembull: paraprake, të rishikuara dhe përfundimtare) në të gjitha publikimet.
  Ky rekomandim është implementuar.

- Rifreskimi i kalendarit paraprak të publikimeve.
  Ky rekomandim është implementuar.

- Përmirësimi i vonesës nga data e referencës për publikimet e llogarive kombëtare nëpërmjet një përdorimi më të mirë të faqes së internetit të INSTAT.
  Ky rekomandim është implementuar.

INDEKSET E ÇMIMEVE TË KONSUMATORIT DHE PRODHUESIT

- Rifreskimi i peshave të përdorura.
  Rifreskimi i peshave të IÇK do të mundësohet nga kryerja e HBS. Versioni aktual i IÇP përdor një bazë fikse të

indeksit dhe INSTAT po punon për zëvendësimin e tij me një indeks zinxhir. Ky lloj indeksi mundëson përdorimin e peshave të ndryshme sa herë që shikohet e arsyeshme.
Rishikimi i listës së produkteve është kryer duke përdorur anketën strukturore të ndërmarrjeve të vitit 2004. Gjithashtu, INSTAT po punon për hartimin e pyetësorit të ri për kompilimin e IÇP. Ka filluar puna për përmirësimin e sistemit të hedhjes së të dhënave me ndihmën e personelit të teknologjisë së informacionit.

- Publikimi i IÇP çdo muaj.
  Publikimi i IÇP çdo muaj kërkon mbledhjen e të dhënave në bazë mujore. Deri tani, për shkak të përdorimit të numëruesve, INSTAT i mbledh të dhënat pranë ndërmarrjeve një herë në muaj. Rekomandimi do të implementohet në periudhë afatmesme.

- Kontrolli i të dhënave të raportuara nga mbledhësit e të dhënave.
  Me rishikimin e IÇP dhe IÇK, sistemi i hedhjes së çmimeve do të ketë kontrolle automatike mbi çmimet e raportuara.
- Zëvendësimi i subjekteve që nuk janë përgjigjur në HBS me subjekte të ngjashme në IÇP dhe zëvendësimi i ndërmarrjeve që dalin nga biznesi.
  Në metodologjinë e HBS nuk është parashikuar zëvendësimi i subjekteve që nuk janë përgjigjur me subjekte të tjera të ngjashme. Në indeksin e ri të IÇP, zëvendësimi i ndërmarrjeve do të bëhet çdo vit në muajin dhjetor.

- Vlerësimi i rezultateve të IÇP me indekse të tjera të çmimit.
  INSTAT po punon për gjetjen e mënyrave të krahasimit midis IÇP dhe çmimeve të import-eksportit, IÇK etj..

- Rifreskimi i metodologjisë së përdorur dhe publikimi i saj në të dyja gjuhët (në anglisht dhe në shqip).
  Hartimi i metodologjive përkatëse është në proces.

STATISTIKAT FISKALE

- Përshpejtimi i punës për adoptimin e metodologjisë së GFSM 2001 për raportimet mujore dhe tremujore.
  Sistemi i thesarit të Ministrisë së Financave (AMoFTS) është në fazë testimi dhe trajnimi deri në fund të vitit 2006. Ministria e Financave planifikon vënien në punë të këtij sistemi, në fillim të vitit 2007. Ky sistem do të sigurojë kalimin nga raportimi me bazë arke në raportimin me baza rrjedhëse, siç kërkohet nga standardet.

- Ndërtimi i një liste llogarish për nënsektorët e qeverisë sipas klasifikimeve të GFSM 2001 për subjektet raportuese.

Ministria e Financave do të hartojë dhe do të publikojë listën e detajuar të llogarive (në 7 nivele) për qeverinë e përgjithshme në vitin 2007.

STATISTIKAT MONETARE

- Forcimi i ligjit të Bankës së Shqipërisë për garantimin e plotë të konfidencës së raportimeve individuale dhe përdorimin e tyre vetëm për qëllime statistikore.
  Departamenti Juridik në Bankën e Shqipërisë ka planifikuar punën lidhur me draftin e ri të ligjit të Bankës. Kështu është planifikuar që ligji i amenduar të kalojë në Parlament në fund të vitit 2009. Ky ligj do të forcojë mbështetjen ligjore për shpërndarjen e statistikave monetare dhe financiare, duke përshkruar në mënyrë eksplicite mandatin e Bankës së Shqipërisë në shpërndarjen e statistikave. Ligji gjithashtu, do t'i përgjigjet çështjes së konfidencialitetit të të dhënave individuale dhe përdorimit të tyre vetëm për qëllime statistikore.

- Implementimi i një sistemi elektronik për raportimet e bankave të nivelit të dytë dhe institucioneve të tjera financiare, për të rritur eficiencën e kompilimit të

statistikave monetare.
Implementimi i këtij rekomandimi është përfshirë në strategjinë afatmesme të Bankës së Shqipërisë. Kjo detyrë pritet të realizohet deri në fund të vitit 2007.

- Shtimi i numrit të punonjësve, të cilët do të angazhohen në proceset statistikore nga Departamenti i Teknologjisë së Informacionit për (1) dizenjimin e bazës së të dhënave SARS për një performancë më të mirë të tij që do të përfshijë gjenerimin automatik të statistikave monetare; (2) implementimin e sistemit elektronik për raportimet e bankave të nivelit të dytë. Shtimi i punonjësve në Departamentin e Statistikës për kompilimin e statistikave për institucionet e tjera financiare dhe të dhënat mbi flukset për sektorin financiar, si rekomandohet në metodologjinë e Fondit (MFSM -2000).
  Struktura e Departamentit të Statistikës do të rishikohet deri në tremujorin e parë të vitit 2007 dhe do të zgjerohet për të përfshirë ndër të tjera kompilimin e të dhënave mbi flukset për sektorin financiar. Sektori i Statistikave Financiare po punon aktualisht për një strukturë paraprake.

Kompilimi i flukseve financiare krahas gjendjeve, do të kërkonte informacion shtesë nga bankat e nivelit të dytë në lidhje me ndarjen e transaksioneve nga ndryshimet që rrjedhin nga lëvizjet e çmimit të tregut të letrave me vlerë, të mbajtura në portofolin e bankave. Departamenti i Statistikës po shqyrton mundësinë e marrjes së këtij informacioni nga bankat e nivelit të dytë.

- Rivlerësimi i letrave me vlerë afatgjata të mbajtura për investime nga bankat e nivelit të dytë dhe përdorimi i çmimit të tregut për to.

Departamenti i Statistikës do të konsiderojë mundësinë e marrjes së këtij informacioni nga bankat e nivelit të dytë, ndërkohë që disponon informacionin e nevojshëm për këtë ndryshim nga Departamenti i Kontabilitetit dhe Pagesave të Bankës së Shqipërisë.

- Raportimi në baza rrjedhëse i ShKK-ve për të qenë plotësisht në përputhje me kërkesat e MFSM.
  Momentalisht, Departamenti i Statistikës konsideron që mjetet dhe detyrimet e ShKK-ve nuk janë materialisht aq të rëndësishme sa të justifikojnë një rritje në kërkesat për raportim. Totali i mjeteve të këtij grupi është vetëm 0.4 për qind i totalit të mjeteve të korporatave të tjera depozituese

- Marrja e masave për minimizimin e gabimeve në raportimet e bankave të nivelit të dytë dhe shpejtimi i proceseve që kontrollojnë dhe korrigjojnë raportet.
  Afatet e raportimit për bankat e nivelit të dytë janë shkurtuar në tetor të këtij viti nga 20 ditë në 15 ditë, nga fundi i muajit të referencës. Afati do të shkurtohet më tej në 10 ditë, duke filluar që nga muaji mars i vitit 2007. Kjo masë lejon më shumë kohë në dispozicion për kontrollin dhe korrigjimin e raporteve, përpara se ato të përdoren në procesin e kompilimit.

- Në rast vonese të raportimeve të një subjekti, përdorimi i raportimeve të një muaji paraardhës dhe shpjegimi i metodës së zgjedhur (për përdoruesit). Të dhënat duhet të identifikohen si paraprake.

  Ky rekomandim është zbatuar.

STATISTIKAT E BILANCIT TË PAGESAVE

- Zhvillimi i vrojtimeve më të shpeshta: në çdo tre muaj për të ardhurat nga emigrantët, rikryerja e vrojtimit të tregtisë së jashtme për rivlerësimin e koeficientëve të transportit të mallrave, kontrabandës si dhe kredisë tregtare.

Duke qenë se të ardhurat nga emigrantët janë të rëndësishme për bilancin e pagesave në Shqipëri, në vitin 2007 do të kryhen disa vrojtime tremujore mbi familjet që marrin të ardhura nga jashtë nga të afërmit e tyre.

Më pas, do të analizohet nëse duhen vendosur koeficientë të rinj mbi transportin e mallrave dhe kontrabandën që do të kryhet në kompanitë e mëdha tregtare.

- Forcimi i ligjit të Bankës së Shqipërisë në lidhje me sanksionet për subjektet, të cilat nuk plotësojnë detyrimin ligjor për të raportuar në Bankën e Shqipërisë për qëllime statistikore, përfshirja e të drejtës së Bankës për të inspektuar llogaritë financiare të firmave dhe ndalimi i përdorimit të këtyre raporteve nga autoritetet tatimore. Statusi ligjor i Bankës në lidhje me statistikat dhe të drejtën për raportim do të rishikohet në një periudhë afatmesme.

- Marrja e kalendarit të shlyerjes së borxhit të jashtëm nga Ministria e Financave dhe regjistrimi i interesit në baza rrjedhëse.
  Sistemi DMFAS, i cili aktualisht përdoret nga Ministria e Financave për monitorimin e borxhit të jashtëm publik (borxhi i lëvruar pezull), nuk e llogarit interesin rrjedhës. Me implementimin e versionit të ri të këtij sistemi do të sigurohet marrja e informacionit të nevojshëm për këtë ndryshim.

- Marrja e raportimeve tremujore për investimet direkte në kapital, borxhin dhe fitimet e riinvestuara; në investimet e portofolit të pasurisë dhe ato të borxhit; në kredinë tregtare.
  Vrojtimi vjetor i Bankës së Shqipërisë në bashkëpunim me INSTAT, praktikisht nuk mbështetet nga kërkesa ligjore e Bankës së Shqipërisë për të kërkuar informacion drejtpërdrejt nga firmat private. Ky rekomandim do të plotësohet së bashku me përmirësimin e kuadrit ligjor të Bankës së Shqipërisë.

- Vlerësimi i blerjes së tokës dhe ndërtimeve të financuara nga flukse të paidentifikuara të valutës së huaj.
  Banka e Shqipërisë aktualisht po zhvillon një vrojtim mbi kompanitë e ndërtimit dhe agjencitë e pronave

të paluajtshme, për të parë se cila pjesë e ndërtimeve financohet nga transaksionet e paraportuara midis rezidentëve dhe jorezidentëve. Ky është vrojtimi i parë i këtij lloji në Shqipëri. Rezultatet do të analizohen për të kuptuar strukturën dhe llojet e transaksioneve, gjë që është e nevojshme për të zhvilluar metoda vlerësimi për statistikat e bilancit të pagesave.

- Përmirësimi i koordinimit me INSTAT për dizenjimin e vrojtimeve, kryerjen e tyre dhe ndjekjen e rasteve të mungesës së përgjigjes.
  Departamenti i Statistikës në Bankën e Shqipërisë dhe INSTAT po bashkëpunojnë për përmirësimin e cilësisë së vrojtimeve, duke filluar me dizenjimin e pyetësorëve dhe përmirësimin e përqindjes së përgjigjeve.

- Mbështetja e teknologjisë së informacionit për krijimin e një sistemi automatik kompilimi që do të shmangte punën manuale, të përfshinte raportimet elektronike nga bankat dhe mundësisht ITRS.
  Implementimi i këtij rekomandimi është përfshirë si një plan afatmesëm në strategjinë e Bankës së Shqipërisë.

PËRMBLEDHJE

Misioni ROSC për shpërndarjen e të dhënave, vëren përmirësime të konsiderueshme në kuadrin statistikor kombëtar që prej vitit 2000. Këto arritje kanë të bëjnë kryesisht me implementimin e metodologjive të reja të Fondit, përmirësimin e bazës ligjore që mbështet statistikat, rritjen e burimeve njerëzore të angazhuara në prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave etj.. Nga vlerësimi rezulton se për pjesën më të madhe të dimensioneve të cilësisë dhe elementeve përbërëse, praktikat kombëtare janë në përputhje me standardet ndërkombëtare, siç tregohet në mënyrë të përmbledhur në tabelën 3. Në vija të përgjithshme, Misioni rekomandon rritjen e mbështetjes me burime të statistikave në të gjitha institucionet, gjë që nënkupton mbështetjen me burime financiare, me burime njerëzore të kualifikuara, mbështetjen e teknologjisë së informacionit dhe

përmirësimin e kushteve të punës. Ndër të gjitha kategoritë e të dhënave, më problematike janë statistikat e llogarive kombëtare, cilësia e të cilave vihet në dyshim nga pamjaftueshmëria e burimeve, nga teknikat e papërshtatshme etj.. Përmirësimi i tyre nëpërmjet masave të përshkruara në seksionin 3 të këtij materiali, vlerësohet si një nga sfidat kryesore për anëtarësimin e Shqipërisë në Projektin SDDS, në fund të vitit 2007. Duhet të shtojmë se krahas këtyre përmirësimeve ky standard kërkon dhe kompilimin e disa kategorive të tjera si për shembull, llogaritë kombëtare tremujore, të dhënat mbi pagat, indeksin e prodhimit industrial, PNI, borxhin e jashtëm të Shqipërisë (përfshirë të gjithë sektorët dhe instrumentet e tij), modulin e rezervës ndërkombëtare dhe likuiditetit në valutë të huaj etj.. Statistikat monetare dhe ato fiskale paraqiten më mirë se kategoritë e tjera. Ndërkohë që përmirësimet mbi strukturën e llogarive kombëtare janë më domethënëset që priten në përmirësimin e standardeve statistikore.

Tabelë 3. Korniza e vlerësimit të cilësisë së të dhënave — Rezultate përmbledhëse.

Simbolet: O = në përputhje me standardet; LO = përgjithësisht në përputhje me standardet; LNO = përgjithësisht në mospërputhje me standardet; NO = në mospërputhje me standardet; NA = nuk aplikohet

Kategoritë e të dhënave Dimensionet/Elementet	Llogaritë kombëtare	Indeksi i çmimit të konsumatorit	Indeksi i çmimit të prodhuesit	Statistikat fiskale	Statistikat monetare	Statistikat e bilancit të pagesave
0. Parakushtet e cilësisë						
0.1 Mjedisi ligjor dhe institucional	LO	O	O	O	LO	LO
0.2 Burimet	LNO	LNO	LNO	LNO	LO	LNO
0.3 Dobishmëria	O	O	O	O	O	O
0.4 Menaxhimi i cilësisë	O	O	O	O	O	O
1. Garantimi i integritetit të të dhënave						
1.1 Profesionalizmi	O	O	O	O	O	O
1.2 Transparenca	O	O	O	O	O	O
1.3 Standardet e etikës	O	O	O	O	O	O
2. Metodologjia						
2.1 Konceptet dhe përkufizimet	O	O	O	LO	O	O
2.2 Mbulimi	LNO	LO	O	O	O	O
2.3 Klasifikimi/Sektorizimi	O	O	O	O	O	O
2.4 Bazat e regjistrimit	LO	LO	O	O	LO	LO
3. Besueshmëria dhe korrektësia						
3.1 Burimi i të dhënave	LNO	LO	LO	LO	O	LNO
3.2 Vlerësimi i burimit të të dhënave	O	LO	LO	O	LO	O
3.3 Teknikat statistikore	LNO	LO	LO	O	LO	LO
3.4 Vlerësimi i rezultateve të ndërmjetme dhe produktit përfundimtar	LO	O	LO	O	O	LO
3.5 Studimet e rishikimit të të dhënave	LO	O	O	O	O	O
4. Dobishmëria						
4.1 Frekuenca dhe vonesa nga data e referencës	LO	O	LO	O	O	O
4.2 Konsistenca	O	O	O	O	O	O
4.3 Politikat dhe praktikat e rishikimit	LO	O	O	LO	O	O
5. Lehtësia e përdorimit						
5.1 Lehtësia e përdorimit të të dhënave	LO	O	O	O	O	O
5.2 Lehtësia e përdorimit të metadatave	O	LO	LO	O	O	O
5.3 Ndihma ndaj përdoruesve	LO	O	O	O	O	O

SHËNIME

* Materiali u punua nga: Hilda Shijaku, Përgjegjëse e Sektorit të Statistikave Financiare dhe Kliti Ceca, Drejtor i Departamentit të Statistikës. Bashkëpunoi: Evis Ruçi Përgjegjëse e Sektorit të Bilancit të Pagesave.

[1] Në anglisht: Report on the Observance of Standards and Codes.

[2] Në anglisht: Financial Sector Assesment Program (FSAP).

[3] Në anglisht: Data Quality Assesment Framework.

[4] Publikuar në Buletinin Ekonomik vëllimi 8, numër 1, qershor 2005.

[5] United Nations Fundamental Principles of Official Statistics.

[6] Raporti është tashmë i publikuar në faqen e internetit të FMN në lidhjen e mëposhtme: http://www.imf.org/external/pubs/cat/longres.cfm?sk=20059.0

[7] Ndër projektet afatgjata përfshihen anëtarësimi në projektin SDDS, sigurimi i informacionit të kërkuar nga vendimmarrësit në kushtet e regjimit të inflacionit të shënjestruar dhe konvergjenca e praktikave me standardet e Evropës.

[8] ISWGNA rekomandon kompilimin e këtyre llogarive si minimum: vlera e shtuar dhe PBB në çmime korente dhe konstante, sipas aktiviteteve me periodicitet vjetor; komponentët e shpenzimeve të PBB-së me çmime korente dhe konstante me periodicitet vjetor; kompilimin e llogarive për të gjithë ekonominë deri tek llogaria financiare me frekuencë vjetore; dhe llogarive të pjesës tjetër të botës.

[9] Transaksioni njihet në momentin që preken llogaritë e arkës.

REFERENCA

Ceca K., Shijaku H., Xhaferaj E., Zhvillimi i standardeve të shpërndarjes së të dhënave statistikore në Bankën e Shqipërisë. Banka e Shqipërisë, Buletini Ekonomik, vëllimi 8, numër 1, qershor 2005

Cady J (2004). Does SDDS subscription reduce borrowing costs for emerging market economies? IMF Working Paper, 04/58. Washington, DC, International Monetary Fund, 1 April.

Christofides C, Mulder CB, Tiffin AJ (2003). The link between adherence to international standards of good practice, foreign exchange spreads, and ratings. IMF Working Paper, 03/74. Washington, DC, International Monetary Fund, 1 April.

Country Report No. 06/393: Albania: Report on the Observance of Standards and Codes - Data Module, Response by the Authorities, and Detailed Assessments Using the Data Quality Assessment Framework http://www.imf.org/external/pubs/cat/longres.cfm?sk=20059.0

FMN, (2003) Review of the Fund's Experience with the Data Module ROSCs, March 7, 2003 në http://www.imf.org/external/np/rosc/2003/030703.pdf

FMN (2003) International Standards: Background Paper on Strengthening Surveillance, Domestic Institutions, and International Markets March 5, 2003, në http://www.imf.org/external/np/pdr/sac/2003/030503s1.pdf

FMN (2003), Data Quality Assessment Framework (DQAF) for National Accounts Statistics, Korrik 2003, në http://dsbb.imf.org/vgn/images/pdfs/dqrs_nag.pdf

FMN (2003), Data Quality Assessment Framework (DQAF) for the Consumer Price Index, Korrik 2003, në http://dsbb.imf.org/vgn/images/pdfs/dqrs_nag.pdf

FMN (2003), Data Quality Assessment Framework (DQAF) Producer Price Index, Korrik 2003, në http://dsbb.imf.org/vgn/images/pdfs/dqrs_ppi.pdf

FMN (2003), Data Quality Assessment Framework (DQAF) for Government Finance Statistics, Korrik 2003, në http://dsbb.imf.org/vgn/images/pdfs/dqrs_gfs.pdf

FMN (2003), Data Quality Assessment Framework (DQAF) for Monetary Statistics, Korrik 2003, në http://dsbb.imf.org/vgn/images/pdfs/dqrs_MonetaryAcc.pdf

FMN (2003), Data Quality Assessment Framework (DQAF) for Balance of Payments
Statistics, Korrik 2003, në http://dsbb.imf.org/vgn/images/pdfs/dqrs_bop.pdf

FMN, dhe BB (2005), The Standards and Codes Initiative—Is It Effective?
And How Can It Be Improved? në http://www.worldbank.org/ifa/ROSC%20review%202005.pdf

Glennerster R and Shin Y (2003). Is transparency good for you, and can the IMF help? IMF Working Paper, 03/132. Washington, DC, International Monetary Fund.

Independent Evaluation Office, (2005), Evaluation of the Technical Assistance Provided by the International Monetary Fund, Januar 31, 2005; në http://www.imf.org/external/np/ieo/2005/ta/eng/pdf/013105a.pdf

Sarr A (2001). Benefits of compliance with securities listing standards – evidence from the depository receipt markets. IMF Working Paper, 01/79. Washington, DC, International Monetary Fund, June.

Schneider, B. (2005), Do Global Standards And Codes Prevent Financial Crises? Some Proposals on Modifying The Standards-Based Approach, UN Disscussion Paper No. 177
April 2005.

United Nations Fundamental Principles of Official Statistics; në http://unstats.un.org/unsd/goodprac/bpabout.asp

VENDET NË TRANZICION DHE SHQIPËRIA

*Elvana Troqe**

Fjalë kyçe
- Ekonomi në tranzicion - Zhvillim ekonomik - Reforma strukturore -

HYRJE

Zhvillimi ekonomik i vendeve në tranzicion gjatë këtyre viteve të fundit ka qenë i kënaqshëm. Performanca pozitive, shpesh më e lartë se ajo e vendeve të zhvilluara, ka ndihmuar në ngushtimin e hendekut të zhvillimit ekonomik midis këtyre vendeve. Edhe Shqipëria si një ndër vendet e tranzicionit, gjatë viteve të fundit ka patur ritme të kënaqshme rritjeje. Ruajtja e stabilitetit makroekonomik është pasqyruar në normën e ulët të inflacionit, në rritjen e besimit të publikut për monedhën vendase dhe për sistemin bankar. Ky stabilitet nga ana tjetër, pasqyron një koordinim të mirë të politikave fiskale, monetare dhe ecurisë në reforma strukturore. Por, zhvillimi ashtu si dhe në shumë vende të tjera mund të përballet me rreziqe, të cilat mund të jenë rezultat i faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Për të përballuar sa më mirë situatat e pafavorshme, një rëndësi të veçantë marrin dhe reformat strukturore të cilat mund të shërbejnë si konstruksion për ndërtimin e një ekonomie sa më të mirë dhe të qëndrueshme. Në këtë material, analizohet pozicionimi i Shqipërisë midis vendeve më të zhvilluara të këtij rajoni, përsa i përket progresit në reforma dhe shtrohen disa nga sfidat e momentit, me të cilat përballet vendi në rrugën për ruajtjen apo zhvillimin e mëtejshëm ekonomik.

I. NJË VËSHTRIM MBI VENDET NË TRANZICION

Vendet në tranzicion[1] kanë shfaqur ritme të konsiderueshme rritjeje gjatë këtyre viteve të fundit. Rritja ekonomike në këto rajone, është nxitur kryesisht nga kërkesa e brendshme e lartë, e cila është inkurajuar nga rritja e kredive dhe e pagave. Nga ana tjetër, kërkesa e brendshme dhe çmimet e larta të energjisë po ushtrojnë presione inflacioniste kudo në rajon. Për më tepër, kursimet vendase janë të pamjaftueshme për të mbuluar investimet, duke rezultuar kështu në deficite të larta të llogarisë korente, veçanërisht në vendet që nuk janë të pasura në burime natyrore. Investimet e huaja direkte pritet të reduktohen disi nga nivelet e shënuara në vitet 2004-2005. Në vitin 2006 monedhat e disa vendeve janë vënë nën presion në tregun e kursit të këmbimit. Kjo reflekton një vlerësim më kritik të investitorëve të huaj për cënueshmërinë e ekonomive të vendeve të këtij rajoni. Veç kësaj, bankat qendrore në Shtetet e Bashkuara, në Eurozonë dhe në Japoni kohët e fundit kanë rritur normat e interesit, duke i bërë investimet në këto vende më tërheqëse.

Bankat qendrore të vendeve në tranzicion janë përpjekur të marrin masa për problemet e krijuara nga zhvillimi i shpejtë i sektorit financiar, i kombinuar me një normë në rritje të inflacionit. Shumë banka qendrore kanë vendosur të rrisin normat e interesit, të prezantojnë rregullore më strikte mbi minimumin e rezervave apo të ndërmarrin masa të tjera kundër inflacionit. Përkundrejt këtij sfondi, politikat fiskale në përgjithësi, kanë qenë tepër lehtësuese për të ndaluar kërkesën e brendshme në mënyrë efektive. Rasti i politikave fiskale më shtrënguese po bëhet më i nevojshëm në këndvështrimin e implikimeve afatgjata të plakjes së popullatës, që do të ushtrojë presion të konsiderueshëm në buxhetin fiskal në të ardhmen.

Ekonomitë e vendeve në tranzicion po përafrohen gradualisht me ekonomitë evropiane dhe tregjet e tjera të maturuara. Kështu, rritja ekonomike prej 5.7 për qind për vitin 2005 dhe rreth 6.2 për qind për vitin 2006 është disa pikë përqindjeje më lart se ajo e vendeve të Eurozonës. Gjithsesi, zhvillimi i mëtejshëm ekonomik përballet me rreziqe që vijnë nga situatat

e çekuilibrave globalë dhe nga rritja e normave të interesit në vendet e OECD-së, gjë që ndikon në zvogëlimin e interesimit për të investuar në këto vende.

Për periudhën afatmesme parashikohet që vendet në tranzicion të vazhdojnë të kenë ritme të konsiderueshme rritjeje, megjithëse disi më të ngadalësuar për vitin 2007. Këto zhvillime pritet të reflektojnë progresin në reformat strukturore dhe rritjen e integrimit me ekonominë botërore. Zhvillimi në vendet e Evropës Qendrore dhe ato Baltike[2] (Central Eastern Europe and the Baltic states) është shumë i lidhur me zhvillimet në vendet e Eurozonës, ndërsa vendet e Evropës Juglindore[3] (South Eastern Europe) dhe Federata e Shteteve të Pavarura dhe Mongolia[4] (Commonwealth of Independent States and Mongolia, CIS) përballen ende me pengesa të konsiderueshme në reforma.

Vendet në tranzicion sipas Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim grupohen në:

1-*Vendet e Evropës Qendrorelindore dhe Baltike*. Vendet e këtij rajoni patën fillimin më të mirë të tranzicionit. Shumë prej tyre e kishin përqafuar konceptin e pronës private, parimet e çmimeve të tregut dhe patën mbështetje të fuqishme popullore për ndryshime të shpejta ekonomike dhe politike, të cilat do të përshpejtonin integrimin në institucionet transatlantike dhe evropiane. Gjatë 10 viteve të para të tranzicionit ka patur shumë arritje në këto vende. Kjo është nxitur dhe nga nevoja për të harmonizuar legjislacionin me vendet e BE-së para anëtarësimit. Gjatë viteve të fundit, vendet e këtij rajoni janë përqendruar në përfundimin e reformave, të cilat do t'i mundësojnë atyre të konkurrojnë efektivisht në tregun evropian dhe në atë global. Pavarësisht kryerjes me sukses të reformave të fazës së parë, disa nga reformat e fazës së dytë në fushat si ato të ristrukturimit të qeverisjes dhe të sipërmarrjeve, politikës së konkurrencës dhe të infrastrukturës kanë mbetur pas. Shpesh, këto reforma janë të vështira për t'u hartuar dhe kërkojnë kohë për t'u implementuar. Ndër vendet e këtij rajoni, Estonia vlerësohet të ketë patur përparimin më të shpejtë.

2-*Vendet e Evropës Juglindore*. Mjaft vende të këtij rajoni e filluan procesin e tranzicionit me disa elemente bazë të ekonomisë së tregut. Gjatë viteve të fundit, ka patur një rigjallërim të ndjeshëm të forcave të tregut në të gjithë rajonin. Faktor i rëndësishëm për këtë ka qenë dhe stabiliteti relativ pas trazirave të vitit 1999. Institucione si ai i Paktit të Stabilitetit për vendet e Evropës Juglindore, kanë ndihmuar për të edukuar një atmosferë bashkëpunimi në të gjitha vendet e rajonit. Perspektiva për këto vende është vazhdueshmëria në përparimin e reformave. Vendet e këtij rajoni ndahen në dy grupime kryesore: në SEE 3, ku përfshihen Bullgaria, Rumania dhe Kroacia dhe; SEE 5, ky përfshihen vendet e tjera si Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia. Bullgaria dhe Rumania kanë zhvillimin më të shpejtë, si rrjedhojë e aspiratave për anëtarësim në BE. Suksesi i Bullgarisë dhe i Rumanisë në arritjen e objektivit për anëtarësim në BE në janar të vitit 2007, përbën një faktor motivues për rajonin. Në këtë mënyrë, Procesi i Stabilizim Asocimit në BE luan një rol të rëndësishëm në nxitjen e reformave kryesore, në fusha si ato të politikave të tregtimit dhe të standardeve të ushqimit dhe sigurisë. Si rezultat, vendet e këtij rajoni, në terma të progresit, kanë filluar të ngushtojnë diferencën me vendet në tranzicion të Evropës Qendrore dhe Baltike, dhe kanë dalë para vendeve të CIS.

3- *Federata e Shteteve të Pavarura dhe Mongolia (CIS)*. Vendet e këtij rajoni e filluan procesin e tranzicionit me kushtet më të pafavorshme ndër vendet në tranzicion, duke përfshirë këtu izolimin gjeografik nga vendet e Evropës Qendrore, mungesën e përvojës në ekonominë e tregut dhe të institucioneve demokratike si dhe kohën e gjatë të kaluar nën regjimin komunist. Megjithatë, ato hodhën hapa të mëdhenj në vitet 1995-2000. Progresi në reforma ka rënë ndjeshëm për periudhën në vazhdim dhe kjo, kryesisht në vendet e prodhimit të naftës dhe gazit. Që nga viti 1992, vendet joprodhuese të energjisë i kanë lënë pas vendet prodhuese të energjisë në të dyja fazat e reformave. Ka një lidhje të madhe midis rritjes së çmimit të naftës dhe ngadalësimit të reformave në vendet prodhuese të energjisë të CIS. Shumica e reformave në këto vende u realizua në periudhën 1992-1997, kur çmimi i naftës luhatej nga 5 në 20 usd për fuçi. Nga viti

1999, kur çmimet e naftës filluan të rriten ndjeshëm, reformat janë ngadalësuar dhe për një periudhë kanë ecur mbrapsht në disa vende. Për më tepër, klima e investimeve në vendet prodhuese të energjisë në CIS është përkeqësuar, ndërkohë që çmimet e naftës janë rritur. Në mënyrë të ngjashme, shumica e treguesve të korrupsionit, sugjerojnë që ky fenomen është një problem më shqetësues në vendet prodhuese të energjisë sesa në vendet joprodhuese të energjisë, për këtë rajon.

Për këtë zonë, zhvillimi është përqendruar në Rusi, Ukrainë dhe Kazakistan.

II. POZICIONIMI I SHQIPËRISË MIDIS VENDEVE MË TË ZHVILLUARA TË TRANZICIONIT

Në tabelën e mëposhtme jepet një zhvillim krahasues i disa prej vendeve më të zhvilluara të tre rajoneve të tranzicionit dhe Shqipërisë. Informacioni i paraqitur i referohet vlerësimeve të dhëna nga BERZH për progresin në reforma, për këto vende. BERZH ndjek zhvillimin në reforma për vendet në tranzicion nëpërmjet 9 treguesve të tranzicionit. Këta mbulojnë katër elementet kryesore të një ekonomie tregu:

- Reforma në tregje dhe tregti, është matur nga liberalizimi i çmimeve, liberalizimi tregtisë dhe mundësia për të përdorur valuta të huaja, dhe nga efektiviteti i politikave të konkurrencës.
- Reforma në sipërmarrje përfshin tregues për privatizimet e vogla dhe të mëdha, dhe një matje të ristrukturimit të qeverisjes dhe të sipërmarjeve.
- Reforma për institucionet financiare matet nga zhvillimet në sektorin bankar, duke përfshirë cilësinë e rregulloreve financiare si dhe krijimin dhe zhvillimin e tregjeve të letrave me vlerë dhe të institucioneve financiare jobanka.
- Reforma në infrastrukturë matet nga zhvillimi në pesë sektorë- energji elektrike, hekurudhë, rrugë, telekomunikacion dhe ujë e humbjet në ujë.

Treguesit e zgjedhur mbulojnë çështje si tregtueshmëria,

reforma në tarifa, cilësia e sistemit rregullator dhe përfshirja e sektorit privat. Shkalla e matjeve për këta tregues varion nga 1 në 4+, ku 1 përfaqëson ndryshim të vogël ose jo ndryshim nga një ekonomi e centralizuar dhe 4+ përfaqëson standardet e një ekonomie tregu të industrializuar.

Tabelë 1. Progresi në reforma.

Vendet	Sipërmarrje			Tregjet dhe tregtia			Institucione financiare		Infrastrukturë
	Privatizime të mëdha	Privatizime të vogla	Ristrukturimi në qeverisje dhe sipërmarrje	Liberalizimi i çmimeve	Tregtueshmëria dhe sistemi i kursit të këmbimit	Politikat e konkurrencës	Reforma bankare dhe liberalizimi i normave të interesit	Tregjet e letrave me vlerë dhe inst. financiare jobanka	Reforma në infrastrukturë
Shqipëri	3	4	2+	4+	4+	2	3-	2-	2
Estoni	4	4+	4-	4+	4+	4-	4	4-	3+
Hungari	4	4+	4-	4+	4+	3+	4	4	4-
Bullgari	4	4	3-	4+	4+	3-	4-	3-	3
Rumani	4-	4-	3-	4+	4+	3-	3	2	3+
Rusi	3	4	2+	4	3+	2+	3-	3	3-
Ukrainë	3	4	2	4	4-	2+	3	2+	2+

Burimi: BERZH.

Nga krahasimi i vlerësimeve të paraqitura në tabelën e mësipërme, duket se Shqipëria pozicionohet pas vendeve më të zhvilluara të rajonit të Evropës Qendrore dhe Evropës Juglindore, dhe pothuajse në të njëjtat nivele me vendet më të zhvilluara të rajonit të CIS.

Për të kuptuar më mirë pozicionimin e Shqipërisë midis këtyre vendeve të tranzicionit, duhet të marrim parasysh dhe kushtet në të cilat ndodhej vendi në periudhën e fillimit të tranzicionit. Shqipëria e filloi procesin e tranzicionit me mungesë eksperience në ekonominë e tregut, në institucionet demokratike dhe duke dalë nga një regjim i egër komunist. Kështu, procesi i tranzicionit për vendin filloi nga kushte mjaft të pafavorshme në krahasim me

vendet e Evropës Qendrore dhe asaj Juglindore dhe në kushte më të ngjashme me vendet e CIS. Performanca ekonomike e diktuar nga masat e ndërmarra nga politika fiskale, monetare dhe reformat strukturore gjatë këtyre viteve, ka qenë e suksesshme dhe është reflektuar në rritje të konsiderueshme ekonomike, normë të ulët inflacioni dhe kurs këmbimi të stabilizuar. Ruajtja e performancës së mirë makroekonomike gjatë këtyre viteve të fundit nga ana tjetër, përballet me rreziqe si paqëndrueshmëria nga rritja e shpejtë e kredisë dhe vazhdimi i mbulimit të deficitit tregtar nga remitancat.

Nga analizat[5] që i bëhen nivelit ekonomik të zhvillimit të Shqipërisë, rezulton se para nesh ka mjaft për të bërë. Ndër sfidat më të rëndësishme me të cilat përballet Shqipëria për të nxitur dhe ruajtur performancën makroekonomike dhe për të përafruar standardet me vendet më të zhvilluara të rajonit tonë si Rumania, Bullgaria dhe Kroacia, e më pas me ato Evropës Qendrore e vendet Baltike janë:

- Marrja e vendimeve sistematike dhe efektive në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Marrja e masave për të rritur eficiencën dhe paanësinë e administratës publike dhe të sistemit juridik, është e nevojshme për të rritur besimin e biznesit ndaj sektorit publik.

- Përmirësimi i infrastrukturës së transportit, të rrjetit rrugor dhe progresi në ristrukturimin dhe privatizimin e sistemit të energjisë janë të nevojshëm për të ndihmuar në një shërbim më të besueshëm, në përmirësimin e standardeve dhe rritjen e qëndrueshme ekonomike. Përmirësimi i sistemit të furnizimit me energji mbetet nga problemet më aktuale në vend. Siguria e furnizimit me energji është ndjeshëm nën standardet ndërkombëtare dhe ndërprerjet e energjisë elektrike përbëjnë një problem të vazhdueshëm në vend, sidomos në periudhat e thatësirave. Përmirësimi në investimet në sektorin e energjisë rrezikohet nga normat e ulëta të mbledhjes së tarifave.

- Përmirësimi në cilësinë e prodhimeve vendase nëpërmjet rritjes së investimeve dhe trainimeve të forcës së punës, do të rriste konkurrueshmërinë e eksporteve. Këto masa do të ndihmonin për të reduktuar deficitin tregtar dhe për të reduktuar varësinë e krijuar nga remitancat e shqiptarëve të punësuar jashtë vendit.

Si përfundim, mund të themi që Shqipëria ashtu si dhe shumë vende të tjera në tranzicion ka përpara mjaft rrugë për të bërë, që të arrijë parametrat më të mirë të zhvillimit ekonomik. Por, pavarësisht ecurisë së deritanishme, zhvillimi i mëtejshëm i vendit duket se është derivat i vullnetit për progres të mëtejshëm në reforma strukturore.

SHËNIME

* Punoi: Elvana Troqe, specialiste, Zyra e Çështjeve Monetare. Departamenti i Politikës Monetare.

[1] Vendet në tranzicion zakonisht quhen ato vende që kanë dalë ose janë duke dalë nga një sistem i planifikimit shtetëror drejt sistemit të ekonomisë së tregut, me pronë private mbi aktivet dhe me institucione mbështetëse të tregut të lirë.

[2] Përfshihen: Republika Çeke, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Poloni, Republika e Sllovakisë dhe Sllovenia.

[3] Përfshihen: Bullgari, Kroaci, Rumani, Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë, Republika e Maqedonisë, Mali i Zi dhe Serbi.

[4] Përfshihen: Rusi, Armeni, Azerbaixhan, Biellorusi, Gjeorgji, Moldavi, Ukrainë, Kazakistan, Republika e Kirgistanit, Mongoli, Taxhikistan, Turkmenistan dhe Uzbekistan.

[5] Edhe nga BERZH.

Informacion mbi modulin e rezervës ndërkombëtare dhe likuiditetit në valutë të huaj
Hilda Shijaku
Mars 2007

Tendenca e çmimeve në Shqipëri në krahasim me Greqinë dhe Italinë. Çfarë mund të themi për konvergjencën?
Elvana Troqe
Valentina Semi
Mars 2007

Ligji i ri "Për bankat në Republikën e Shqipërisë"dhe përputhshmëria e tij me kuadrin rregullativ mbikëqyrës. Detyrimet për ndryshime rregullative në zbatim të Direktivave të Bashkimit Evropian. Qershor 2007
Juna Bozdo
Irini Kalluci
Qershor 2007

Aktiviteti kreditues: Mungesa dhe prurjet e një faktori të rëndësishëm zhvillimi
Elona Bollano
Gerond Ziu
Qershor 2007

2007

Informacion mbi rezultatet e vrojtimit pranë familjeve
Argita Frashëri
Shtator 2007

Çmimet e pasurive të paluajtshme dhe stabiliteti financiar
Juna Bozdo
Shtator 2007

Produktiviteti i punës në Shqipëri: Procesi i konvergimit sektorial
Vasilika Kota
Dhjetor 2007

Metodat kryesore të disagregimit të përkohshëm
Elona Dushku
Dhjetor 2007

INFORMACION MBI MODULIN E REZERVËS NDËRKOMBËTARE DHE LIKUIDITETIT NË VALUTË TË HUAJ

*Hilda Shijaku**

Fjalë kyçe
- Rezervë ndërkombëtare - Likuiditetet në valutë të huaj - Standarde - Raportim i Modulit -

ABSTRAKT

Materiali në vijim jep një informacion mbi kompilimin e modulit të rezervës ndërkombëtare dhe likuiditetit në valutë të huaj si një statistikë e rëndësishme makroekonomike, e detyrueshme për t'u raportuar prej standardeve të Projektit SDDS, në të cilin Shqipëria synon të anëtarësohet në fund të vitit 2007. Kompilimi i kësaj statistike është në përputhje me "Udhëzuesin e Modulit të Rezervës Ndërkombëtare dhe Likuiditetit në Valutë të Huaj, FMN, 2001" dhe kompilohet për herë të parë në Shqipëri.

HYRJE

Moduli i të dhënave për rezervën ndërkombëtare dhe likuiditetin në valutë të huaj, vendos standardet për informimin e publikut mbi madhësinë dhe përbërjen e mjeteve të rezervës, të mbajtura nga autoritetet qendrore: banka qendrore dhe qeveria qendrore.

Ky modul gjithashtu, specifikon mënyrën e raportimit të detyrimeve afatshkurtra në valutë të huaj dhe aktiviteteve të lidhura me to si për shembull, pozicionet në derivatet financiare

dhe garancitë e dhëna nga qeveria për huamarrjen e sektorit publik dhe të atij privat. Këto aktivitete, potencialisht mund të sjellin tërheqjen e mjeteve të rezervës. Që prej 23 marsit 1999, ky standard është i përfshirë në kërkesat e Projektit SDDS dhe është i detyrueshëm për të gjitha vendet anëtare në këtë projekt. Në 29 mars 2000, Fondi Monetar Ndërkombëtar miratoi ndërtimin e një baze të dhënash të përbashkët për raportimin e këtij moduli nga të gjitha vendet pjesëmarrëse në Projektin SDDS, nëpërmjet faqes së internetit të Fondit. Kompilimi i këtij treguesi statistikor në Shqipëri bëhet për herë të parë. Krahas dobishmërisë së tij në analizën e rrezikut të likuiditetit të vendit, një tjetër arsye për plotësimin e këtij standardi është anëtarësimi i Shqipërisë në Projektin SDDS.

Materiali në vijim, jep një pamje të përgjithshme të koncepteve mbi të cilat ngrihet ky modul, si dhe synon të paraqesë lidhjet e tij me statistikat e tjera të ngjashme, si për shembull "Mjetet e huaja neto", "Rezerva ndërkombëtare" etj.. Pjesa e parë e materialit, tregon në vija të përgjithshme përmbajtjen e modulit dhe rëndësinë e tij. Pjesa e dytë e materialit, shpjegon konceptet kryesore të modulit: përkufizimet e "Rezervës ndërkombëtare" dhe "Likuiditetit në valutë të huaj" dhe lidhjet midis tyre, si dhe jep karakteristikat kryesore statistikore të kompilimit të tyre. Këto karakteristika kanë të bëjnë me mbulimin institucional, aktivitetet financiare që përfshihen në modul, parimet e vlerësimit, horizontin kohor të modulit dhe çështje të tjera të raportimit të modulit. Pjesa e tretë e materialit, përmban katër tabelat e modulit të kompiluara, duke përdorur të dhënat për Shqipërinë si dhe disa shpjegime mbi to.

1. PËRMBAJTJA E MODULIT PËR REZERVËN NDËRKOMBËTARE DHE LIKUIDITETIN NË VALUTË TË HUAJ, DHE RËNDËSIA E RAPORTIMIT TË TIJ

Krizat financiare në fund të viteve 1990, nxorën në pah nevojën e shpërndarjes së një informacioni më të plotë për rezervën ndërkombëtare të vendeve dhe likuiditetin në valutë të huaj. Mangësitë në këtë informacion që lidheshin me zhbalancimet dhe

brishtësinë e sistemeve financiare, e vështirësuan parashikimin dhe përgjigjen në kohë ndaj krizave që pasuan. Pas këtij momenti, rëndësia e këtij informacioni ka ardhur duke u rritur, si rezultat i globalizimit të tregjeve financiare dhe i zhvillimit të instrumenteve financiare.

Aktivitetet financiare ndërkombëtare të ndërmarra nga bankat qendrore dhe qeveritë qendrore të vendeve, tashmë kryhen nëpërmjet një shumëllojshmërie instrumentesh financiare, që përfshijnë njësi rezidente e jorezidente dhe vende në mbarë globin. Si rrjedhim, vlerësimi i pozicionit të likuiditetit në valutë të huaj të një vendi kërkon raportimin jo vetëm të pozicioneve të bilancit të autoriteteve me jorezidentët, tradicionalisht të raportuara si rezerva ndërkombëtare të vendit, por dhe flukset e ardhshme të rrjedhura nga pozicionet e bilancit dhe ato jashtë bilancit.

Raportimi në kohën e duhur i këtij informacioni i shërben njëkohësisht disa qëllimeve. Së pari, ai rrit përgjegjshmërinë e autoriteteve, duke i dhënë më shumë mundësi publikut të vlerësojë politikat e autoriteteve dhe ekspozimin e tyre ndaj rrezikut. Së dyti, nëpërmjet analizës së këtij informacioni autoritetet janë në gjendje të ndreqin në kohën e duhur politikat e paqëndrueshme dhe të marrin masat e duhura për të kufizuar efektet e shpërhapjes së vështirësive financiare. Së treti, kjo statistikë u paraqet pjesëmarrësve të tregut një pamje më të qartë të kushteve të një vendi, të ndjeshmërisë së një rajoni dhe pasojat në nivel ndërkombëtar, duke kufizuar kështu pasigurinë e tregut financiar dhe luhatjet që ajo shkakton në vlerën e instrumenteve financiare. Së fundi, një transparencë më e madhe për këto të dhëna financiare, gjithashtu ndihmon organizatat ndërkombëtare të parashikojnë nevojat e ardhshme të vendeve për likuiditet në valutë të huaj.

Informacioni mbi rezervën ndërkombëtare dhe likuiditetin në valutë të huaj, ka shumë vlerë në informimin e vendimmarrjes publike dhe private, nëse jepet në një kuadër koherent dhe lehtësisht të kuptueshëm nga komuniteti ndërkombëtar. Si pjesë e përpjekjeve për forcimin e arkitekturës të sistemit financiar ndërkombëtar, FMN dhe një grup pune i Komitetit për Sistemin Financiar Global, i grupit të dhjetë bankave qendrore, në vitin

1999, krijuan këtë kuadër për shpërndarjen e të dhënave nga vendet. Moduli u formulua në konsultim me autoritetet e vendeve, specialistë të statistikës, organizata ndërkombëtare, pjesëmarrës të tregut dhe përdorues të të dhënave. Procesi i konsultimit synonte të gjente një ekuilibër midis përfitimeve të pritshme nga rritja e transparencës për këtë statistikë dhe kostove potenciale të shkaktuara nga rritja e barrës raportuese të vendeve.

Ky modul është formuluar në mënyrë që të jetë gjithëpërfshirës dhe të sjellë një risi në krahasim me raportimin e deritanishëm të rezervës ndërkombëtare. Ai bashkon konceptet e rezervës ndërkombëtare dhe likuiditetit në valutë të huaj, në një kuadër të vetëm. Përveç mbulimit të informacionit mbi aktivitetet e bilancit mbi rezervën ndërkombëtare dhe mjeteve e detyrimeve të tjera të autoriteteve, moduli merr në konsideratë aktivitetet e tyre jashtë bilancit, siç janë kontratat e ardhshme, kontratat me afat dhe derivatet e tjera financiare, linjat e patërhequra të kreditit dhe garancitë mbi huatë. Moduli gjithashtu, përfshin flukset hyrëse dhe dalëse në valutë të huaj, të lidhura me pozicionet e bilancit, dhe ato jashtë bilancit. Ai përmban të dhëna që tregojnë se sa likuide janë mjetet e rezervës, nëpërmjet identifikimit të atyre mjeteve që janë vënë peng, si dhe të dhënat e nevojshme për vlerësimin e ekspozimit të vendit ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit.

Moduli përfshin jo vetëm burimet në valutë të huaj në një datë të caktuar reference, por edhe flukset hyrëse dhe dalëse të valutës së huaj, në një horizont kohor prej 12 muajsh. Horizonti njëvjeçar i përdorur është në përputhje me përkufizimin e periudhës afatshkurtër, që përdoret në standardet ndërkombëtare të statistikave të tjera ekonomike.

2. KONCEPTET MBI TË CILAT BAZOHET REZERVA NDËRKOMBËTARE DHE LIKUIDITETI NË VALUTË TË HUAJ

Në themel të këtij moduli qëndrojnë dy koncepte të lidhur me njëri - tjetrin: rezerva ndërkombëtare dhe likuiditeti në valutë të

huaj. Këto dy koncepte dhe lidhjet midis tyre do të shpjegohen në vijim.

2.1 REZERVA NDËRKOMBËTARE

Edicioni i pestë i Manualit të Bilancit të Pagesave përkufizon konceptin e rezervës ndërkombëtare. "Rezerva ndërkombëtare e një vendi i referohet atyre mjeteve të huaja, të cilat janë menjëherë të disponueshme dhe të kontrolluara nga autoriteti monetar për financimin e drejtpërdrejtë të zhbalancimit të pagesave, për rregullimin indirekt të këtyre zhbalancimeve nëpërmjet ndërhyrjes në tregjet valutore, për të ndikuar kursin e këmbimit dhe/ ose për qëllime të tjera." (BPM5, paragrafi 424.) Rrjedhimisht nga ky përkufizim, koncepti i rezervës ndërkombëtare bazohet në kuadrin e bilancit dhe është një koncept bruto. Ai nuk përfshin detyrimet e huaja të autoriteteve monetare.

Në themel të përkufizimit të rezervës ndërkombëtare është dallimi midis rezidentëve dhe jorezidentëve, ku rezerva ndërkombëtare përfaqëson mjetet e autoriteteve monetare me jorezidentët.

Gjithashtu, këto mjete duhet të jenë si "lehtësisht të disponueshme" nga autoriteti monetar si dhe "të kontrolluara" prej tij, që do të thotë se vetëm ato mjete që plotësojnë këto dy kritere, duhet të klasifikohen si pjesë e rezervës ndërkombëtare. Mjetet financiare që zakonisht përfshihen në këtë kategori, janë monedhat dhe kartëmonedhat në valutë të huaj, depozitat në valutë të huaj në bankat jorezidente, letrat me vlerë të emetuara nga jorezidentët, ari monetar, mbajtjet e sdr, pozicioni rezervë në FMN dhe mjete të tjera financiare.

2.2 LIKUIDITETI NË VALUTË TË HUAJ

Likuiditeti në valutë të huaj është një koncept më i gjerë se ai i rezervës ndërkombëtare. Në këtë modul ai i referohet (1) burimeve në valutë të huaj; (2) tërheqjeve neto nga burimet e rezervës, qofshin këto të njohura paraprakisht (skeduluara) apo të kushtëzuara nga ndodhja e ngjarjeve të caktuara. Këto

tërheqje neto rrjedhin nga detyrimet afatshkurtra të autoriteteve monetare dhe nga aktivitetet e tyre të regjistruara jashtë bilancit.

E thënë ndryshe, pozicioni i likuiditetit në valutë të huaj të autoriteteve, i referohet atyre burimeve të valutës së huaj, që janë lehtësisht të disponueshme nga autoritetet, duke marrë parasysh tërheqjet neto të paracaktuara dhe potenciale nga këto burime. Në themel të konceptit të likuiditetit është parimi që administrimi i kujdesshëm i pozicionit të likuiditetit, kërkon si administrimin e mirë të mjeteve të rezervës, ashtu dhe administrimin e detyrimeve në mënyrë të tillë, që të minimizohet ndjeshmëria e tregjeve të brendshme nga goditjet e jashtme. Koncepti i likuiditetit në valutë të huaj është më i gjerë se ai i rezervës ndërkombëtare, në të paktën tre aspekte:

- Ndërsa mjetet e rezervës i referohen mjeteve të jashtme të autoritetit monetar, likuiditeti në valutë të huaj përfshin burimet në valutë të huaj dhe tërheqjet neto nga këto burime, si të autoritetit monetar ashtu edhe të qeverisë qendrore. Likuiditeti në valutë të huaj i referohet "autoriteteve", ndryshe nga rezerva ndërkombëtare, e cila i referohet vetëm "autoriteteve monetare".
- Ndërsa mjetet e rezervës përfaqësojnë pretendimet e autoriteteve monetare ndaj jorezidentëve, likuiditeti në valutë të huaj i referohet pretendimeve dhe detyrimeve si ndaj jorezidentëve, ashtu dhe ndaj rezidentëve.
- Ndërsa koncepti i mjeteve të rezervës përfshin vetëm instrumentet e regjistruara në bilanc, koncepti i likuiditetit në valutë të huaj përfshin flukset hyrëse dhe dalëse që rrjedhin si nga aktivitetet e bilancit, ashtu dhe nga aktivitetet jashtë bilancit të autoriteteve.

Koncepti i likuiditetit në valutë të huaj është gjithashtu më i gjerë se ai i rezervës ndërkombëtare neto. Rezerva ndërkombëtare neto i referohet mjeteve të rezervës, duke i zbritur detyrimet ndaj jorezidentëve në një moment të caktuar kohe. Likuiditeti në valutë të huaj merr në konsideratë tërheqjet nga burimet në valutë të huaj, të rrjedhura nga aktivitetet financiare të autoriteteve me

rezidentët dhe jorezidentët, brenda një periudhe 12 – mujore. Informacioni nëse tërheqjet neto në valutë të huaj të një vendi i tejkalojnë burimet që ky vend ka, është shumë i dobishëm për të analizuar ndjeshmërinë e vendit nga tregjet e jashtme.

Për të rritur transparencën e të dhënave mbi rezervën ndërkombëtare dhe likuiditetin në valutë të huaj të vendeve, moduli kërkon shpërndarjen e informacionit sipas kësaj strukture:

1. Mjetet e rezervës zyrtare.
2. Mjetet e tjera në valutë të huaj.
3. Tërheqjet neto të paracaktuara nga mjetet në valutë të huaj.
4. Tërheqjet neto të kushtëzuara nga mjetet në valutë të huaj.
5. Informacione të tjera të lidhura me to.

Një paraqitje skematike e kuadrit të këtij moduli që tregon lidhjet midis koncepteve të rezervës ndërkombëtare dhe likuiditetit në valutë të huaj, jepet në figurën 1.

Figurë 1. Lidhjet midis koncepteve të rezervës ndërkombëtare dhe likuiditetit në valutë të huaj.



2.3 KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË MODULIT TË TË DHËNAVE

Ky modul specifikon ato njësi institucionale që mbulohen nga ky tregues statistikor dhe aktivitetet e tyre në një horizont kohor

të caktuar në mënyrë të tillë, që të lehtësojë analizën e pozicionit të likuiditetit të autoriteteve dhe ekspozimin e tyre ndaj rrezikut.

2.3.1 Institucionet e mbuluara

Ky modul aplikohet për të gjitha njësitë e sektorit publik, të përgjegjshme për administrimin e krizave të monedhës. Praktikisht, këtu përfshihen autoritetet monetare, të cilat administrojnë apo mbajnë rezervat ndërkombëtare dhe qeveria qendrore (duke përjashtuar fondin e sigurimeve shoqërore), që së bashku me autoritetet monetare mbajnë dhe pjesën më të madhe të detyrimeve financiare zyrtare në valutë të huaj. Nevojat për përdorimin e burimeve në valutë të huaj të autoriteteve mund të lindin dhe nga aktiviteti i njësive të tjera të sektorit publik. Këto njësi, nuk janë përfshirë në këtë modul, për shkak të vështirësisë për të mbledhur të dhënat nga ky sektor në kohën e duhur. Megjithatë, standardi rekomandon përfshirjen e këtyre njësive, nëse aktivitetet e tyre janë të rëndësishme, duke shpjeguar gjithashtu në metadatat përkatëse, nëse këto njësi janë përfshirë.

Moduli përdor përkufizimin e BPM5 (paragrafi 514) për përcaktimin e autoriteteve monetare "si një koncept i lidhur me funksionet, që përfshin bankën qendrore dhe njësi të tjera institucionale, si *currency board* dhe veprimtari të tjera që i atribuohen kryesisht bankës qendrore, por që në raste të caktuara ndërmerren nga institucione të tjera të qeverisë dhe bankat tregtare. Këto funksione përfshijnë emetimin e monedhës, mbajtjen dhe administrimin e rezervave ndërkombëtare, duke përfshirë ato që rezultojnë nga transaksione me Fondin Monetar Ndërkombëtar".

Në përputhje me udhëzuesit ndërkombëtarë ekzistues të statistikave të tjera makroekonomike, moduli përkufizon sektorin e qeverisë qendrore që të përfshijë "të gjitha departamentet, zyrat dhe njësitë që janë agjenci apo instrumente të autoriteteve qendrore të një vendi (Manuali i Statistikave Fiskale të Qeverisë, faqe 12)". "Qeveria qendrore nuk përfshin qeveritë lokale dhe fondet e sigurimeve shoqërore që veprojnë në të gjitha nivelet

e qeverisë" (Sistemi i Llogarive Kombëtare, paragrafi 4.114). Arsyeja e mospërfshirjes së këtyre institucioneve në këtë modul, është përsëri pamundësia e mbledhjes së informacionit në kohën e duhur.

2.3.2 Aktivitetet financiare të mbuluara

Për nevoja të analizës së likuiditetit në valutë të huaj, moduli specifikon që vetëm ato instrumente që janë të pagueshme në valutë të huaj, duhet të përfshihen në burimet dhe tërheqjet e seksioneve të përmbajtura në këtë modul. Arsyeja për këtë gjë është se duke qenë që detyrimet financiare të autoriteteve në valutë të huaj mund të shlyhen vetëm në valutë të huaj, si burime për tërheqjet e nevojshme do të shërbejnë vetëm ato mjete, që janë të pagueshme në valutë të huaj. Instrumente të tjera, të cilat emërohen në valutë të huaj, por që janë të pagueshme në monedhë vendase, nuk do të mund të shërbejnë drejtpërsëdrejti në plotësimin e nevojave për shlyerjen e detyrimeve në valutë të huaj. Instrumentet financiare të emëruara në valutë të huaj apo të indeksuara në valutë të huaj, por të pagueshme në monedhë vendase, raportohen veçmas në seksionin e fundit të këtij moduli nën "Zërat Memo". Këto instrumente mund të ushtrojnë presion të tërthortë mbi rezervat gjatë një periudhe krize, veçanërisht kur pritjet e një zhvlerësimi të shpejtë të monedhës vendase i nxisin mbajtësit e këtyre instrumenteve të këmbejnë instrumentet e indeksuara me valutë të huaj. Instrumente të tilla janë për shembull, borxhi i brendshëm në valutë vendase i indeksuar në valutë të huaj apo kontratat me afat të patregtueshme, të pagueshme në monedhë vendase.

2.3.3 Parimet e vlerësimit

Në modul, vlera e burimeve në valutë të huaj duhet të reflektojë vlerën, e cila do të përfitohej nga likuidimi i tyre i menjëhershëm në treg – që do të thotë vlera e tregut në datën e referencës. Në rastet kur vlera e tregut e instrumenteve nuk mund të përcaktohet, standardi parashikon llogaritjen e vlerës së përafërt të tregut.

Tërheqjet nga burimet në valutë të huaj, si ato të paracaktuara ashtu dhe ato të kushtëzuara, vlerësohen sipas vlerës së tyre nominale; që do të thotë në vlerën e flukseve të arkës kur këto flukse ndodhin. Përgjithësisht, pagesat e principalit reflektojnë "vlerën emërore" të instrumentit dhe pagesat e interesit reflektojnë shumat e rëna dakord për t'u paguar.

Flukset hyrëse dhe flukset dalëse të lidhura me derivatet financiare gjithashtu, raportohen me vlerë nominale.

2.3.4 Horizonti kohor

Duke qenë se fokusi në këtë modul është mbi likuiditetin, horizonti i mbuluar nga moduli është afatshkurtër. Për arsye praktike, periudha afatshkurtër është e përkufizuar të përfshijë 12 muaj. Moduli parashikon ndarjen e këtij horizonti në disa nënperiudha, për të mundësuar vlerësimin e pozicionit të likuiditetit përgjatë vitit. Këto nënperiudha janë specifikuar si "deri në një muaj", "mbi një muaj deri në tre muaj" dhe "deri në një vit".

Ndarja e nënperiudhave të mësipërme për raportimin e flukseve që do të ndodhin, bëhet në bazë të maturitetit të mbetur të instrumenteve dhe pagesave. Maturiteti i mbetur, i referohet periudhës së mbetur deri në ripagesën përfundimtare të instrumentit nga data e referencës.

Sipas këtij përkufizimi në modul regjistrohen flukset që rrjedhin nga:

- instrumentet afatshkurtra, maturiteti origjinal i të cilave është më i vogël se një vit;
- instrumentet me maturitet origjinal më të gjatë se një vit, por që maturiteti i mbetur i të cilave është më i vogël se një vit.
- Gjithashtu, në këtë modul raportohen flukset e ripagesave të principalit dhe interesit, të cilat duhet të kryhen gjatë vitit dhe që lidhen me instrumente, maturiteti i mbetur të cilave është më i madh se një vit.

2.3.5 Çështje të tjera të raportimit

Moduli nuk specifikon monedhën në të cilën duhet të raportohen të dhënat (në monedhë kombëtare, usd, euro etj..) Megjithatë, rekomandohet që të dhënat e raportuara në këtë modul, të raportohen në të njëjtën monedhë në të cilën raportohen mjetet e rezervës zyrtare, në mënyrë që të lehtësohet krahasimi me kategori të tjera të të dhënave. Gjithashtu, për të lehtësuar krahasimin në kohë dhe krahasimin midis vendeve, rekomandohet që monedha e përzgjedhur të jetë një mjet rezerve ose minimalisht një monedhë e qëndrueshme. Data e referencës në modul është dita e fundit e punës e një muaji të dhënë.

Të dhënat për gjendjet u referohen gjendjeve pezull të mjeteve dhe detyrimeve në datën e dhënë. Për flukset, të dhënat që raportohen janë flukset e ardhshme të valutës së huaj, të njohura paraprakisht në datën e referencës, të cilat lidhen me pozicione të paracaktuara ose të kushtëzuara pezull në datën e referencës. Në modul, mjetet dhe flukset hyrëse shënohen me shenjë pozitive (+), ndërsa detyrimet dhe flukset dalëse shënohen më shenjë negative (-). Në përcaktimin e burimeve dhe flukseve pezull në datën e referencës, rekomandohet përdorimi i datës së kryerjes së transaksionit dhe jo i datës së regjistrimit të veprimit. Data e transaksionit preferohet, sepse praktikat e vendeve në lidhje me datat e regjistrimit të transaksioneve mund të ndryshojnë. Duke qenë se moduli është i zbatueshëm për shumë vende, zërat në lidhje me instrumentet që nuk aplikohen, lihen bosh, ndërsa vlera zero tregon që vlera e instrumentit në atë datë është zero.

Për të lehtësuar kuptimin e të dhënave dhe shmangien e keqinterpretimit të tyre, politikat e veçanta të vendeve në lidhje me kursin e këmbimit, si veprimi i një "*currency board*" apo adoptimi i një monedhe të huaj si monedhë zyrtare, duhet të shpjegohen në një notë që shoqëron të dhënat. Gjithashtu, praktikat që ndryshojnë nga standardet në lidhje me sektorizimin, vlerësimin apo kohën e regjistrimit, duhet të shpjegohen.

3. STRUKTURA E MODULIT TË TË DHËNAVE

Moduli i të dhënave ka katër seksione: Tabelat 1 – 4 në vijim të materialit. Në këto tabela janë paraqitur të dhënat për Shqipërinë, duke marrë si datë reference datën 29 shtator, 2006. Seksioni i parë mbulon informacionin mbi burimet e autoriteteve në valutë të huaj, duke përfshirë mjetet e rezervës zyrtare dhe mjetet e tjera në valutë të huaj.

I. Mjetet e rezervës zyrtare dhe mjete të tjera në valutë të huaj.

Treguesi	Periudha
I. Mjetet e rezervës zyrtare dhe mjete të tjera në valutë të huaj	Shtator 2006 në milionë usd
A. Mjetet e rezervës zyrtare	1,672.73
(1) Rezervat në valutë të huaj (në monedhë të huaj të konvertueshme)	1,603.21
(a) Letra me vlerë	1,379.03
Nga të cilat: emetuesi ka qendrën në vendin raportues por kryen aktivitet jashtë tij	
(b) Monedha dhe kartëmonedha dhe depozita me:	224.18
(i) banka qendrore të huaja, BIS dhe FMN	224.18
(ii) banka me qendër në vendin raportues	
Nga të cilat: që kryejnë aktivitet jashtë tij	
(iii) banka me qendër jashtë vendit raportues	
Nga të cilat: që kryejnë aktivitet brenda tij	
(2) Pozicioni rezervë në Fond	4.96
(3) sdr	11.72
(4) Ari (duke përfshirë depozitat në ar)	52.83
Vëllimi në milionë onc	0.878
(5) Mjete të tjera të rezervës (specifiko)	
—Derivatet financiare	
—Hua jorezidentëve jobanka	
—të tjera	
B. Mjete të tjera në valutë të huaj (specifiko)	
—Letra me vlerë të papërfshira në mjetet e rezervës zyrtare	
—Depozita të papërfshira në mjetet e rezervës zyrtare	
—Hua të papërfshira në mjetet e rezervës zyrtare	
—Derivate financiare të papërfshira në mjetet e rezervës zyrtare	
—Ar i papërfshirë në mjetet e rezervës zyrtare	
—Të tjera	0

Mjetet e rezervës zyrtare paraqiten në pjesën A të tabelës. Sipas edicionit të pestë të Manualit të Bilancit të Pagesave, këtu janë përfshirë monedhat dhe kartëmonedhat në valutë të huaj, ari monetar, sdr dhe pozicioni rezervë në FMN. Këto instrumente janë regjistruar me vlerën e tyre të tregut dhe si burim informacioni kanë shërbyer të dhënat e bilancit kontabël të Bankës së Shqipërisë

dhe të dhëna shtesë për letrat me vlerë, duke qenë se praktika e tyre e regjistrimit kontabël nuk plotëson kërkesat e këtij moduli. Zërat që janë përfshirë, janë të njëjtë me ata që përfshihen në llogaritjen e NFA[1], por mënyra e regjistrimit të tyre ndryshon. Siç u shpjegua dhe më lart, këto instrumente pasqyrohen në këtë modul me vlerën e tyre të tregut ndërsa në NFA ekzistuese paraqitet çmimi i blerjes së këtyre instrumenteve.

Mjetet në valutë të huaj, të paraqitura në seksionin B të tabelës, janë mjete të emetuara në valutë të huaj dhe janë likuide (që përmbushin kriterin e të qenurit të disponueshme për përdorim nga qeveria qendrore, në periudha krize). Mjetet e mbajtura peng nuk përfshihen në këtë kategori. Këtu përfshihen vetëm mjetet e emetuara në monedhë të konvertueshme, të cilat mund të jenë mjete ndaj rezidentëve ose jorezidentëve.

Në këtë zë të modulit raportohen mjetet e qeverisë qendrore (duke përjashtuar fondet e sigurimeve shoqërore).

Shembuj të instrumenteve që përfshihen në këtë zë janë:

- Depozita të autoriteteve në monedhë të huaj në bankat rezidente (vendase), të ndara në depozita në banka rezidente dhe depozita në degë të bankave të huaja.
- Llogari rrjedhëse të qeverisë në valutë të huaj, lehtësisht të disponueshme në bankat jorezidente.

Nënhuatë e dhëna nga qeveria nuk përfshihen në këtë zë, duke qenë se ato nuk janë likuide.

Si burim për këto të dhëna shërbejnë regjistrimet kontabël të Ministrisë së Financave. Për momentin, Ministria e Financave raporton se nuk ka instrumente të cilat përmbushin këto kritere.

II. Tërheqjet neto afatshkurtra, të parapërcaktuara nga mjetet në valutë të huaj.

Tërheqjet neto afatshkurtra, të parapërcaktuara nga mjetet në valutë të huaj janë detyrime kontraktuale të njohura dhe të

njohura paraprakisht (skeduluara), në valutë të huaj. Tërheqjet afatshkurtra u referohen detyrimeve kontraktore në valutë të huaj, të cilat do të ndodhin me siguri brenda 12 muajve nga data e raportimit. Tërheqjet neto llogariten si diferencë e flukseve dalëse me flukset hyrëse.

II. Tërheqjet neto afatshkurtra të parapërcaktuara nga mjetet në valutë të huaj (vlera nominale)					
			Shtator 2006		
		Total	Ndarja e maturitetit (maturiteti i mbetur)		
			Deri në 1 muaj	1 muaj-3 muaj	3 muaj–1 vit
1. Hua, letra me vlerë dhe depozita në valutë të huaj		293.40	50.18	63.68	179.55
—flukse dalëse(–)	Principali	-38.98	-1.52	-13.60	-23.86
	Interesi	-26.05	-1.59	-6.80	-17.66
—flukse hyrëse(+)	Principali	299.92	51.92	70.85	177.14
	Interesi	70.53	1.36	14.89	54.28
2. Pozicione të gjata dhe të shkurtra në kontrata të ardhshme dhe me afat në valutë të huaj kundrejt valutës vendase					
(a) Pozicione të shkurtra (–)					
(b) Pozicione të gjata (+)					
3. Të tjera (specifiko)		0	0	0	0
—Flukse dalëse të lidhura me repot (–)					
—Flukse hyrëse të lidhura me repot (+)					
—Kredia tregtare (–)		0	0	0	0
—Kredia tregtare (+)		0	0	0	0
—Llogari të tjera të pagueshme (–)		0	0	0	0
—Llogari të tjera të pagueshme (+)		0	0	0	0

Flukset dalëse, u referohen amortizimit të skeduluar të borxheve dhe pagesave të interesit brenda 12 muajve. Flukset hyrëse kanë të bëjnë me pagesat e borxheve të dhëna brenda periudhës 12-mujore. Këtu regjistrohen vetëm hyrjet që janë të sigurta që do të merren. Pagesat e interesit dhe ato të principalit raportohen veçmas.

Nëse detyrimi është apo jo afatshkurtër, kjo përcaktohet nga maturiteti i mbetur i instrumentit. Quhen instrumente afatshkurtra ato instrumente, maturiteti i mbetur i të cilave është deri në një vit. Në modul gjithashtu përfshihen dhe amortizimi i borxhit dhe pagesat e interesit, që duhet të kryhen brenda 12 muajve. Afati kohor në tabelë paraqitet i ndarë sipas 3 periudhave: "deri në 1 muaj", "mbi 1 deri në 3 muaj" dhe "mbi 3 muaj deri në 1 vit". Kolona "Total" në pasqyrë është shuma e ndarjeve të mësipërme.

Vlera e flukseve është vlera e tyre nominale e konvertuar në usd, me kursin e ditës së fundit të periudhës raportuese.

Huatë (Seksioni II.1) përfshijnë detyrimet e lindura nga marrja e drejtpërdrejtë e fondeve nga kreditorët, të tilla si huatë për të financuar tregtinë, huatë hipotekore, përdorimi i kredive të FMN etj..

Në seksionin II.3, përfshihen llogaritë e pagueshme, të lidhura me mallra e shërbime të blera paraprakisht, pagesa e të cilave është e skeduluar, pagesat e interesave apo huave të prapambetura dhe detyrimet për paga në valutë të huaj, nëse këto të fundit janë materialisht të rëndësishme.

Si burim informacioni për këtë tabelë shërbejnë skedulat e borxhit dhe pagesave të tjera të Ministrisë së Financave dhe Bankës së Shqipërisë, si dhe të dhënat mbi flukset hyrëse, të lidhura me letrat me vlerë dhe depozitat në bankat jorezidente.

III. Tërheqjet neto afatshkurtra, të kushtëzuara nga burimet në valutë të huaj.

III. Tërheqjet neto afatshkurtra të kushtëzuara nga burimet në valutë të huaj (vlera nominale)	Total	Shtator 2006 Ndarja e maturitetit (maturiteti i mbetur)		
		Deri në 1 muaj	1-3 muaj	3 muaj-1vit
1. Detyrime të kushtëzuara në valutë të huaj	-296.09	-220.25	-18.28	-57.57
(a) Garanci të mbështetura me kolateral mbi borxhin me efekt deri në një vit				
(b) Detyrime të tjera të kushtëzuara	-296.09	-220.25	-18.28	-57.57
2. Letra me vlerë të huaja, të emetuara me opsione të lidhura me to				
3. Linja krediti të pakushtëzuara, të patërhequra të ofruara nga:	256.48	43.62	46.89	165.97
(a) banka qendrore të huaja, BIS, FMN dhe organizata ndërkombëtare të tjera				
—Banka qendrore të huaja (+)				
—BIS (+)				
—FMN (+)				
(b) me banka dhe institucione të tjera financiare me qendër në vendin raportues (+)				
(c) me banka dhe institucione të tjera financiare me qendër jashtë vendit raportues (+)	256.48	43.62	46.89	165.97
Linja krediti të pakushtëzuara të patërhequra, të ofruara për				

(a) banka qendrore të huaja, BIS, FMN dhe organizata ndërkombëtare të tjera				
—Banka qendrore të huaja (-)				
—BIS (-)				
—FMN (-)				
(b) me banka dhe institucione të tjera financiare me qendër në vendin raportues (-)				
(c) me banka dhe institucione të tjera financiare me qendër jashtë vendit raportues (-)				
4. Pozicione të gjata dhe të shkurtra në opsione në valutë të huaj kundrejt valutës vendase				
(a) Pozicione të shkurtra				
(b) Pozicione të gjata				
PRO MEMORIA: In-the-money options				
(1) Në kursin e këmbimit korent				
(a) Pozicion i shkurtër				
(b) Pozicion i gjatë				
(2) + 5% (zhvlerësim me 5%)				
(a) Pozicion i shkurtër				
(b) Pozicion i gjatë				
(3) – 5% (vlerësim me 5%)				
(a) Pozicion i shkurtër				
(b) Pozicion i gjatë				
(4) + 10% (zhvlerësim me 10%)				
(a) Pozicion i shkurtër				
(b) Pozicion i gjatë				
(5) – 10% (vlerësim me 10%)				
(a) Pozicion i shkurtër				
(b) Pozicion i gjatë				
(6) Të tjera (specifiko)				

Në këtë tabelë regjistrohen vetëm tërheqjet neto afatshkurtra, të kushtëzuara nga burimet në valutë të huaj. Flukset e kushtëzuara lidhen me detyrime kontraktore, të cilat mund të sjellin shtimin apo pakësimin e burimeve në valutë të huaj. Flukset e pasqyruara këtu mund të rrjedhin nga mjetet e detyrimet që mund të lindin në 12 muajt e ardhshëm nga periudha e referencës. Ndryshe nga flukset e tabelës II, flukset e kushtëzuara lidhen vetëm me aktivitetet jashtë bilancit dhe janë të kushtëzuara nga ndodhja e një ngjarjeje të caktuar.

Në seksionin III.1, në tabelë do të regjistrohen flukset që lidhen me garanci mbi kolaterale të lidhura me borxhe të caktuara. Këto angazhime i referohen garancive të dhëna nga autoritetet, të cilat mbështeten nga një kolateral. Vlera e regjistruar në këtë zë është detyrimi i pagesës nga autoritetet

në rast mospërmbushjeje të detyrimit nga subjekti tjetër. Vlera e regjistruar i referohet fluksit të parashikuar në garanci dhe jo vlerës së kolateralit që mbështet garancinë.

Në seksionin III.I.(b) përfshihen letërkreditë dhe angazhimet e huave në valutë të huaj të autoriteteve. Këtu përfshihen dhe detyrimet e autoritetit monetar për rezervën e detyrueshme në valutë dhe rezervën e tepërt në valutë, të bankave të nivelit të dytë.

Në seksionin III.3, regjistrohen linjat e pakushtëzuara të kreditit të papërdorura, të cilat përbëjnë potencialisht një burim të likuiditetit në valutë të huaj. Të pakushtëzuara do të thotë që janë të gatshme për t'u tërhequr nga autoritetet në çdo moment kohe, pa qenë nevoja e plotësimit të ndonjë kushti material. Marrëveshjet me FMN për huatë janë linja krediti të kushtëzuara dhe si të tilla nuk përfshihen në këtë seksion të modulit. Megjithatë, nëse vendi nuk ka tërhequr ende shuma për të cilat është rënë dakord të tërhiqen, këto shuma (të patërhequrat) duhet të përfshihen në seksionin III, deri në periudhën e datës së testit (data kur kontrollohen kriteret e performancës). Këto shuma tregohen veçmas edhe në një shpjegues që shoqëron pasqyrën.

IV. Zërat MEMO

Nën "Zërat Memo" përfshihen informacione shtesë që mbulojnë:

1. flukset dhe pozicionet e papërfshira në seksionet I-III, por të para si me rëndësi për vlerësimin e rezervave të Autoritetit, vlerësimin e likuiditetit në valutë të huaj dhe ekspozimit ndaj rrezikut të valutës;

2. të dhëna shtesë mbi flukset dhe pozicionet e dhëna në seksionet I-III; dhe pozicione e flukse sipas një shkallëzimi apo kriteri vlerësimi të ndryshëm nga ato të dhëna në seksionet I-III.

IV. Zëra Memo	Shtator 2006
(1) Për t'u raportuar me frekuencën dhe afatin standard të raportimit	
(a) Borxhi afatshkurtër në valutë vendase i indeksuar me kursin e këmbimit	
(b) Instrumente financiare të emetuara në valutë të huaj dhe të pagueshme në mënyra të tjera (për shembull, në monedhë vendase)	
(c) mjete të vëna peng	
—të përfshira në mjetet e rezervës	
—të përfshira në mjetet e tjera në valutë të huaj	
(d) Letra me vlerë të dhëna hua dhe nën marrëveshje riblerjeje	
—të dhëna hua dhe nën marrëveshje riblerjeje dhe të përfshira në seksionin I	
—të dhëna hua dhe nën marrëveshje riblerjeje dhe të papërfshira në seksionin I	
—të marra hua dhe të përfshira në seksionin I	
—të marra hua dhe të papërfshira në seksionin I	
(e) derivate financiare	
(f) derivate financiare me maturitet më të madh se një vit	
(2) Për t'u raportuar me frekuencë më të vogël:	
(a) Përbërja e rezervës sipas monedhave (ose grupeve të monedhave)	
—monedha që përfshihen në shportën e sdr	96.8%
—monedha që nuk përfshihen në shportën e sdr	3.2%
—sipas çdo monedhe (optional)	

* Materiali u punua nga: Hilda Shijaku, Përgjegjëse e Sektorit të Statistikave Financiare, Departamenti i Statistikës.

[1] *Net Foreign Assets*.

TENDENCA E ÇMIMEVE NË SHQIPËRI NË KRAHASIM ME GREQINË DHE ITALINË. ÇFARË MUND TË THEMI PËR KONVERGJENCËN?

*Elvana Troqe**
Valentina Semi

Fjalë kyçe
- Tendenca e çmimeve - Konvergjencë - Stabilitet - Indeksi i Çmimeve të Konsumit -

ABSTRAKT

Një nga kriteret kryesore për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian dhe më pas në atë Monetar (EMU) është ai i stabilitetit të çmimeve. Sipas këtij kriteri, norma e inflacionit nuk duhet të jetë më e madhe se 1.5 pikë përqindjeje nga mesatarja e tre vendeve anëtare të BE-së, që kanë performancën më të mirë në terma të ruajtjes së stabilitetit të çmimeve, gjatë vitit që paraprin ekzaminimin e situatës në atë vend. Meqenëse një nga objektivat e Shqipërisë është ai i anëtarësimit në BE, në këtë material kemi shqyrtuar tendencën e çmimeve në vend, në krahasim me çmimet e Greqisë dhe të Italisë. Këto vende janë marrë në konsideratë sepse janë anëtare të BE-së dhe nga partnerët kryesorë të Shqipërisë.

Për të krahasuar ecurinë e çmimeve midis Shqipërisë, nga njëra anë dhe Italisë e Greqisë nga ana tjetër, në mungesë të të dhënave për vlerat absolute të çmimeve, jemi bazuar në seritë e të dhënave të indekseve të çmimeve të konsumit. Këto indekse kanë ndarje të njëjtë në 12 grupe kryesore për të treja vendet, por kanë ndryshime në peshat e këtyre grupeve, në ndarjen e grupeve në nëngrupe dhe peshat përkatëse.

Megjithë këto ndryshime, mendojmë që metodologjia e aplikuar në këtë material na mundëson të dallojmë nëse seritë e 12 grupeve të indeksit të çmimeve të konsumit, kanë konverguar, janë duke konverguar apo divergojnë në çmime relative apo në norma inflacioni. Konkluzioni

më i rëndësishëm në këtë material është, se në asnjë rast nuk kemi konstatuar divergjencë në normat e inflacionit për të 12 grupet e indeksit të çmimeve të konsumit, midis Shqipërisë dhe dy vendeve të tjera, Italisë dhe Greqisë.

PARATHËNIE

Një nga objektivat më të rëndësishëm të ekonomive në tranzicion, për vendet e Evropës Juglindore, është anëtarësimi në Bashkimin Ekonomik dhe Monetar Evropian. Hyrja në Bashkimin Monetar dhe adoptimi i euros si monedhë vendase, kërkon arritjen e disa kritereve ekonomike dhe legjislative. Kriteret ekonomike janë të njohura si kriteret e konvergjencës dhe në mënyrë të përmbledhur përfshijnë: inflacion të ulët, kurs këmbimi të qëndrueshëm, financa publike të shëndetshme dhe norma interesi të ulta. Përveç këtyre, legjislacioni i bankës qendrore të secilit vend duhet të plotësojë disa kërkesa. Si një përafrim për integrimin, mendohet që tregjet më të integruara dhe më konkurruese kanë diferenca të vogla në çmime. Për të shqyrtuar këtë çështje, kemi parë zhvillimet e indeksit të çmimeve të konsumit (IÇK-së) të Shqipërisë në krahasim me ato të Greqisë dhe Italisë. Këto shtete janë anëtare të Bashkimit Evropian dhe partnere tregtare kryesore[1] për Shqipërinë. Në këtë këndvështrim, konvergjenca dhe divergjenca e çmimeve përbën një çështje të rëndësishme për t'u analizuar, duke marrë në konsideratë që e ardhmja e Shqipërisë është hyrja në BE.

Të dhënat e përdorura janë seritë mujore të indekseve të çmimeve të konsumit të publikuara nga ISTAT për Italinë, nga Sekretariati i Përgjithshëm i Shërbimeve Satistikore Kombëtare të Greqisë (SPSSKG) dhe INSTAT-i për Shqipërinë. Megjithëse shportat e IÇK-së për të treja shtetet, përbëhen nga 12 grupe të mirash dhe shërbimesh, ka ndryshime në klasifikimin e nëngrupeve të të mirave dhe të shërbimeve, dhe në peshat përkatëse. Në analizën e mëposhtme ne jemi të vetëdijshëm që këto ndryshime mund të ndikojnë në konkluzionet e këtij ushtrimi.

Krahasimi i nivelit absolut të çmimeve midis shteteve të ndryshme nuk mund të bëhet nëpërmjet përdorimit të të dhënave të IÇK-së. Indeksi i çmimeve të konsumit nuk jep informacion për ndryshimin e nivelit të çmimeve midis dy shteteve. Indeksi i çmimeve të një shteti, mat nivelin e çmimeve të këtij shteti për një periudhë kohore të përcaktuar dhe jo vlerat absolute të çmimeve. Veç kësaj, konvergjenca në ritmin e ndryshimit të çmimeve nuk nënkupton konvergjencë në nivelin e çmimeve. Në qoftë se krahasojmë indekset për dy shtete të ndryshme, mund të themi se çmimet në njërin vend po rriten ose ulen, më shpejt ose më ngadalë në krahasim me vendin tjetër. Nga vlerat e indekseve nuk mund të themi nëse çmimet ose standardi i jetesës në njërin vend, janë më të larta ose më të ulëta në krahasim me vendin tjetër.

Në pjesën e parë, jepet një pamje e përgjithshme e zhvillimeve në inflacionin e këtyre tre shteteve dhe e faktorëve kryesorë që kanë ndikuar në këto zhvillime. Në vijim, kemi analizuar zhvillimet në 12 grupet e IÇK -së dhe jemi përpjekur të identifikojmë arsyet kryesore që kanë drejtuar këto zhvillime. Të dhënat e IÇK-së janë indeksuar duke përdorur si vit bazë, vitin 1999.

Në pjesën e dytë të këtij studimi, kemi patur si objektiv konstatimin e tendencave kryesore të çmimeve dhe të normave të inflacionit midis Shqipërisë dhe dy vendeve të tjera. Në këtë pjesë, ne shqyrtojmë për konvergjencë në çmime dhe në norma inflacioni. Për të investiguar në qoftë se seritë janë duke konverguar ose kanë konverguar, janë përdorur testet e rrënjës njësi dhe të stacionaritetit në nivel dhe në diferencën e parë. Këto teste janë aplikuar në të njëjtat seri mujore të IÇK-së, por duke marrë si periudhë bazë muajin mars të vitit 2006. Seritë janë rregulluar sezonalisht dhe janë pastruar nga efekti i kursit të këmbimit. Më pas, janë llogaritur seritë e diferencave midis *logeve* të indekseve të çmimeve të konsumit dhe seritë e diferencës së inflacionit midis shteteve, dhe në vijim janë aplikuar testet në këto seri.

I. ZHVILLIMET NË IÇK-NË E SHQIPËRISË, GREQISË DHE ITALISË

Tabelë 1. Ndryshimi vjetor në përqindje për PBB-në dhe për inflacionin mesatar vjetor.

Ndryshim vjetor në përqindje për PBB dhe inflacionin mesatar vjetor.									
		1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006
Itali	Inflacion	1.7	2.6	2.3	2.6	2.8	2.3	2.3	2.4
	PBB	1.9	3.6	1.8	0.3	0.0	1.1	0.0	1.5
Greqi	Inflacion	2.1	2.9	3.7	3.9	3.4	3	3.5	3.6
	PBB	3.4	4.5	5.1	3.8	4.8	4.7	3.7	3.7
Shqipëri	Inflacion	0.4	0.0	3.1	5.2	2.3	2.9	2.4	2.2
	PBB	10.1	7.3	7	2.9	5.7	5.9	5.5	5

Burimi: Fondi Monetar Ndërkombëtar.

Inflacioni në Shqipëri është luhatur kryesisht midis nivelit 2 dhe 4 për qind, gjatë gjashtë viteve të fundit. Faktorët kryesorë që kanë ndikuar në ruajtjen e inflacionit në nivele të ulta janë[2]:

- Rritja graduale në prodhimin e produkteve bujqësore vendase.
- Rritja e konkurrencës në ofertën e tregut të veshjeve, këpucëve dhe të pajisjeve elektroshtëpiake.
- Politikat makroekonomike të orientuara drejt stabilitetit, ku politika fiskale synon në konsolidimin fiskal dhe politika monetare synon në ruajtjen në nivele pozitive të normave reale të interesit; kanë ndihmuar në ruajtjen e diferencave pozitive të normave të interesit midis lekut dhe valutave të huaja.
- Mbiçmimi i lekut kundrejt dollarit amerikan dhe euros. Ky mbiçmim mund të shpjegohet me: rritjen e produktivitetit të mallrave të tregtueshëm[3] (situata e mirë makroekonomike ndihmon zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme), remitancat dhe të ardhurat nga turizmi, të cilat justifikojnë mbiçmimin e lekut kryesisht në muajt e verës dhe në muajt e fundit të vitit. Mbiçmimi i monedhës tonë ka luajtur një rol të rëndësishëm në amortizimin e inflacionit të importuar në vend.
- Efekti modest i çmimeve të naftës në IÇK, me sa duket dhe në sajë të strukturës së ekonomisë tonë, që karakterizohet nga aktivitete me kërkesë të ulët për energji, siç janë bujqësia dhe shërbimet[4] (22.8 dhe 45.2 për qind e PBB-së, respektivisht për vitin 2005).



Greqia ka arritur me sukses të ulë normën e inflacionit nga rreth 16 për qind, në gjysmën e parë të viteve 90-të, në një mesatare vetëm mbi 3 për qind nga viti 2000 e tutje[5]. Pavarësisht këtyre zhvillimeve, Greqia ka qenë një nga vendet e BE-së me normë inflacioni të lartë. Kjo mund t'i atribuohet kryesisht faktorëve makroekonomikë si:

- Rritja më e shpejtë e kërkesës së brendshme në krahasim me ofertën. Kjo rritje është reflektuar në hendekun pozitiv të prodhimit (*positive output gap)* dhe është pjesërisht rezultat i politikës fiskale, kryesisht lehtësuese, të ndjekur në Greqi në këto vitet e fundit[6].
- Rritja e kostos së punës për njësi, e cila është më e lartë se mesatarja e Eurozonës.
- Situatat jo të kënaqshme të kushteve të konkurrencës në disa tregje, të cilat nuk funksionojnë në mënyrë eficiente (energjia, telekomunikacioni, shërbimet postare).
- Zhvillimet në çmimin botëror të naftës. Greqia është më e ekspozuar ndaj ndryshimeve të çmimit të naftës se ekonomia evropiane. Konsumi i brendshëm i energjisë, i shprehur në ekuivalenten e naftës për njësi të PBB-së është 36 për qind më i lartë në Greqi, se mesatarja e Eurozonës. Zhvillimet në tregun e kursit të këmbimit (mbiçmimi i euros kundrejt usd, gjatë këtyre viteve të fundit), kanë influencuar në impaktin që ka dhënë rritja e çmimit të naftës në Greqi.

Italia ka përjetuar një rritje të ngadaltë të PBB-së në vitet e fundit, në krahasim me shtetet e tjera të Eurozonës[7]; kjo ka ardhur në sajë të uljes së kërkesës së brendshme.

- Konsumi familjar është reduktuar, për arsye të dobësimit të pritshmërive për rritjen ekonomike. Kjo është reflektuar dhe në rritjen e kursimeve familjare.
- Inflacioni është ndikuar dhe nga zhvillimet në tregun e naftës. Luhatjet në kursin e këmbimit euro/usd,kanë kontribuar në peshën me të cilën ka ndikuar çmimi i naftës në normën e inflacionit.
- Faktorët më specifikë në Itali, të cilët vështirësojnë rregullimet më të shpeshta të çmimeve janë: ekzistenca e kontratave të përcaktuara me blerësit, ngurrimi i firmave individuale për të rivendosur çmimet, nga rreziku se mos provokojnë reagime nga konkurrenca dhe perceptimi i rreziqeve me natyrë të përkohshme[8]. Në anën tjetër, me përjashtim të firmave që zhvillojnë aktivitet me pakicë, kostot e *menuve* nuk janë konsideruar si një pengesë e rëndësishme për rregullime më të shpeshta të çmimeve. Reagimi i çmimeve të firmave ndaj rreziqeve "shock" është asimetrik. Ndryshimet pozitive në kosto, kanë një impakt më të madh se ato negative; rritjet në kërkesë japin ndryshime më të mëdha të çmimeve sesa uljet në kërkesë.

I.1 TENDENCA E 12 GRUPEVE TË IÇK-SË

Grupi 1 – Ushqime dhe pije joalkolike

Teoria ekonomike sugjeron që përmirësimi i standardit të jetesës së popullsisë, çon në ulje të peshës së shpenzimeve për të mira primare (ushqime, banesa etj.) dhe në rritje të peshës së shpenzimeve për të mira luksoze. Si rrjedhojë, popullsi relativisht të varfra, shpenzojnë një pjesë të madhe të të ardhurave të tyre në të mira primare dhe një pjesë më të vogël, në argëtim, shëndet, arsim etj.. Kjo teori qëndron edhe kur krahasojmë peshat që grupi "Ushqime dhe pije joalkolike" ka në shportën e IÇK-së për këto tre shtete. Pesha e këtij grupi për Shqipërinë është më e lartë se ajo e Greqisë dhe e Italisë.

Tabelë 2. Peshat e grupeve të IÇK-së sipas vendeve[9].

Grupet e IÇK-së	Shqipëri	Greqi	Itali
Ushqime dhe pije joalkolike	0.426	0.185	0.154
Pije alkolike dhe duhan	0.031	0.039	0.027
Veshje dhe këpucë	0.038	0.099	0.098
Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	0.244	0.117	0.095
Pajisje shtëpie	0.046	0.086	0.099
Shëndet	0.021	0.069	0.077
Transport	0.048	0.130	0.138
Komunikim	0.013	0.038	0.032
Argëtim dhe kulturë	0.026	0.049	0.080
Arsim	0.010	0.027	0.011
Hotele, kafene dhe restorante	0.073	0.097	0.106
Mallra dhe shërbime të ndryshme	0.024	0.064	0.083

Burimi: INSTAT, ISTAT, SPSSKG.

Nga grafiku 2, mund të shohim që IÇK-të e Shqipërisë dhe Greqisë paraqesin pothuajse të njëjtat luhatje, ndërkohë që IÇK-ja e Italisë është më e zbutur. Shpjegues kryesorë për këto zhvillime mund të jenë: rëndësia e sektorit bujqësor dhe kushtet e njëjta klimaterike për Shqipërinë dhe Greqinë si dhe një ekonomi më e industrializuar, në krahasim me ato të sipërpërmendura, në rastin e Italisë.



Inflacioni, relativisht i lartë, i shënuar në Greqi mund të importohet lehtësisht dhe në Shqipëri, pasi importet e ushqimeve nga Greqia zënë një peshë të konsiderueshme në totalin e importit të ushqimeve në Shqipëri[10]. Megjithatë, besojmë se mbiçmimi i lekut ka ndikuar si zbutës kundrejt rritjes së çmimeve të importuara.



Grupi 2 – Pije alkolike dhe duhan

Peshat e këtij grupi në shportën e konsumit janë më të mëdha, në rastin e Greqisë dhe të Shqipërisë dhe më të ulëta, në atë të Italisë. Ritmi më i shpejtë i rritjes së çmimeve të këtij grupi vërehet në Greqi dhe pasohet nga ritme pothuajse të njëjta në Itali, ndërkohë që çmimet në rastin e Shqipërisë duket të kenë një ritëm më të ngadaltë rritjeje. Kjo gjë mund të shpjegohet me faktin se mallrat e këtij grupi, janë më shumë mallra me natyrë luksoze sesa mallra primarë si dhe për arsye se shqiptarët konsumojnë mjaft pije alkolike, të cilat i prodhojnë vetë. Rritjet në IÇK-në e Italisë dhe të Greqisë, janë rezultat i ndryshimeve të taksave indirekte, të aplikuara mbi duhanin dhe pijet alkolike në këto vende. Fakti që Italia dhe Greqia janë vende anëtare të Eurozonës, mund të shpjegojë konvergjencën e dukshme në grafikët e këtyre shteteve, me kalimin e kohës.

Grupi 3 – Veshje dhe këpucë

Tendenca e çmimeve të produkteve të grupit të tretë "veshje dhe këpucë" është rënëse, në rastin e Shqipërisë dhe rritëse, në rastin e Greqisë dhe atë të Italisë. Ky ndryshim në ecurinë e çmimeve mund të shpjegohet me liberalizimin dhe rritjen e konkurrencës në tregun shqiptar për këta mallra, me mbiçmimin e lekut gjatë viteve të fundit si dhe me ndryshimet që ekzistojnë në cilësinë e këtyre produkteve, të tregtuara në këto vende. Peshat për këtë



grup të shportës së mallrave të konsumit, janë pothuajse të njëjta për Greqinë dhe Italinë, dhe më të ulëta për Shqipërinë. Në IÇK-në e Greqisë vihet re një sezonalitet i lartë. Ky sezonalitet mund të shpjegohet me uljen e çmimeve pas festave të fundvitit, në janar dhe në sezonin e verës, kur aktiviteti i turizmit është më i lartë. Sezonalitet vihet re dhe në IÇK-në e Shqipërisë, por jo aq i theksuar sa në rastin e Greqisë. Qëndrueshmëria në IÇK-në italiane mund të shpjegohet me reputacionin që ka Italia, si një shtet i njohur për shtëpitë e modës dhe si eksportues i këtyre mallrave.

Grupi 4 – Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji

Ecuria e çmimeve të këtij grupi, të shportës së mallrave të konsumit, pasqyron një rritje të përgjithshme të çmimeve për të



treja vendet. Një nëngrup shumë i rëndësishëm për grupin "Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji" është energjia elektrike. Tregu i energjisë elektrike në Shqipëri shfaqet si një treg me karakteristika monopolistike, me KESH-in (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare) si prodhuesin, transmetuesin, shpërndarësin dhe shitësin kryesor të energjisë elektrike. Problemet me të cilat përballet kjo kompani për të mbuluar kostot, kanë çuar drejt rritjes së çmimeve të energjisë gjatë këtyre viteve. Një faktor tjetër që ka ndikuar në rritjen e çmimeve për këtë grup është dhe rritja e vazhdueshme e çmimit të banesave. Po kështu, tendenca rritëse e çmimeve për Greqinë dhe Italinë mund të shpjegohet me rritjen e çmimit të energjisë (dhe në tregun botëror) dhe rritjen e çmimeve të qirave dhe të shtëpive.

Grupi 5 – Pajisje shtëpie

Në analizën e tendencave të çmimeve për grupin "Pajisje shtëpie", shohim të njëjtën tablo si dhe në atë të grupit të tretë të shportës së mallrave të konsumit. Tendenca rënëse e çmimeve për tregun shqiptar, mund të shpjegohet nga liberalizimi i tregut, rritja e konkurrencës e nxitur nga rritja e prodhimit vendas dhe nga mbiçmimi i lekut. Në indeksin e Greqisë shfaqet i njëjti sezonalitet, i parë për grupin "Veshje dhe këpucë". Ne mendojmë, që të njëjtët faktorë që kanë shkaktuar sezonalitet në grupin e tretë të IÇK-së, mund të qëndrojnë dhe në këtë rast.

Grafik 6. Pajisje shtëpie.



Burimi: INSTAT, ISTAT, SPSSKG.

Grupi 6 – Shëndeti

Rritja e shpejtë e çmimeve të grupit "Shëndeti", të shportës së mallrave të konsumit, në rastin e Shqipërisë në krahasim me dy vendet e tjera, mund të shpjegohet nga konkurrenca e ulët në këtë treg dhe nga rritja e vazhdueshme e çmimeve të produkteve dhe shërbimeve mjekësore. Pjesa më e madhe e produkteve dhe pajisjeve mjekësore në Shqipëri, janë të importuara[11]. Depot e barnave në përgjithësi, punojnë duke fituar ekskluzivitetin për disa artikuj nga firmat furnitore, gjë që çon në uljen e konkurrencës në këtë treg. Në Greqi importet përbëjnë 95[12] për qind të tregut, ndërsa në Itali 70 për qind e pajisjeve mjekësore janë të importuara. Sektori publik, kryesisht spitalet publike, mbulon 70 për qind të totalit të blerjeve mjekësore në Greqi.



Në Itali, spitalet publike mbulojnë rreth 75 për qind të shitjeve të pajisjeve mjekësore dhe pjesa tjetër, mbulohet nga spitalet private. Të gjitha këto, mund të na ndihmojnë për të kuptuar më mirë se përse çmimet për këtë grup po rriten më shpejt në Greqi sesa në Itali. Raporti i varësisë së moshës së vjetër është pothuajse i njëjtë për Italinë dhe Greqinë dhe ne nuk mundëm të gjenim informacion për diferenca të mëdha, në plakjen e popullsisë për këto vende. Pesha që grupi "Shëndeti" ka në shportën e IÇK-së është më e madhe në rastin e Italisë dhe atë të Greqisë, dhe më e vogël në rastin e Shqipërisë.

Grupi 7 – Transporti

Grupi i transportit në IÇK-në e Shqipërisë, zë rreth 5 për qind të shportës. Ky grup, përbëhet nga tre nëngrupe: blerje mjetesh transporti, shërbime ndaj mjeteve personale të transportit dhe shërbime transporti. Nga këta nëngrupe, më i rëndësishmi është ai i shërbimeve ndaj mjeteve personale të transportit, për arsye të peshës së tij (2 për qind). Çmimet e këtij grupi ndikohen direkt nga uljet dhe rritjet e çmimit të naftës në tregun botëror, treg i cili ka qenë shumë i luhatshëm kohët e fundit. Shqipëria demostron pothuajse të njëjtat luhatshmëri të çmimeve (rritje dhe ulje) me ato të Greqisë dhe të Italisë. Megjithatë, ka periudha kur ndryshimet në çmimet e naftës nuk kanë reflektuar plotësisht ndryshimet në çmimin e naftës të tregut ndërkombëtar. Kjo, për shkak të mbiçmimit të lekut gjatë viteve të fundit, sidomos kundrejt dollarit amerikan. Kështu, përderisa nafta tregtohet në dollarë, rënia e vlerës së tij kundrejt lekut ka ndihmuar për të zbutur efektin e rritjes së çmimit të naftës në tregjet ndërkombëtare.



Grupi 8 – Komunikimi

Tendenca në këtë grup të IÇK-së së vendit tonë, ndryshon shumë nga ajo e dy shteteve të tjera. Përballë Greqisë dhe Italisë, me konkurrencë në tregun e komunikimit, e shprehur në uljen e çmimeve (grafik 9), Shqipëria paraqitet si një treg



i kontrolluar ose me mungesë konkurrence. Në sektorin e komunikimit të Shqipërisë ka dy momente të rëndësishme, në të cilat duhet të fokusohemi: i pari është ulja e çmimeve në fillim të vitit 2003, gjë e cila i atribuohet paketës promocionale që ofroi në treg "Vodafone Albania" dhe që shkaktoi një rënie të lehtë të çmimeve në atë periudhë; momenti i dytë, është ai i ngritjes së menjëhershme të çmimeve, në fund të vitit 2003, nga "Albtelecom", kompania e vetme për telefoninë fikse në Shqipëri. Ky ndryshim, u reflektua menjëherë në treg. "Albtelecom", në mes të vitit 2004, uli çmimet, duke ndikuar tregun në përgjithësi. Pas këtij momenti, nuk janë shënuar ndryshime të tjera në çmime. Në këtë situatë, ka kontribuar struktura e tregut të komunikimit, i cili përbëhet nga një kompani telefonie fikse dhe dy kompani celularësh, duke mos nxitur konkurrencën.

Grupi 9 – Argëtim dhe kulturë

IÇK-ja e Shqipërisë së këtij grupi përbëhet nga tre nëngrupe, të cilat janë: "pajisje audio-vizuale, fotografike dhe riparimet e tyre", "shërbime argëtimi dhe kulture" dhe "gazeta, revista, libra dhe mjete shkollore". Nëngrupi më i rëndësishëm në këtë grup është ai i "pajisje audio-vizuale, fotografike dhe riparimet e tyre". Ky nëngrup përbëhet nga produkte të importuara, ndërkohë që dy nëngrupet e tjera përfshijnë produkte dhe shërbime vendase. Nga grafiku 10, mund të evidentojmë se tendenca e çmimeve për rastin e Shqipërisë është zbritëse, kryesisht deri në 2001. Ndërkohë që



Italia dhe Greqia kanë tendenca rritëse të çmimeve, gjë që mund t'i atribuohet niveleve të ndryshme të zhvillimit të vendeve dhe ndikimit që ka pasur euro, në tregjet e Eurozonës.

Grupi10 – Arsim

Në këtë grup përfshihen të gjitha shërbimet që kanë të bëjnë me arsimin. Ky grup ka një peshë 0.1 për qind në shportën e të mirave të konsumit në Shqipëri. Duke krahasuar tendencat e çmimeve të këtyre shërbimeve për Shqipërinë, me ato të Greqisë dhe të Italisë, shohim një tendencë më të shpejtë rritëse të çmimeve në Shqipëri. Kjo gjë mund t'i atribuohet momentit të hyrjes së shkollave dhe institucioneve edukative private në këtë treg, të cilat kanë tarifa më të larta në krahasim me ato



shtetërore. Në Greqi dhe në Itali shihet një rritje sezonale në muajin shtator, që është dhe fillimi i vitit akademik. Ndërkohë, në Shqipëri shihet një rritje çmimesh edhe gjatë muajit janar, që shpjegohet me fillimin e simestrit të dytë shkollor. Ecuria e çmimeve të këtij grupi në rastin e Shqipërisë, si dhe ndryshime jo të rregullta të çmimeve gjatë viteve, mund të shpjegohen me hyrjen e shërbimeve të reja dhe ndoshta, dhe me boshllëqe ose mungesa në strukturat rregullatore ose ato legjislative. Prania e këtyre të fundit, mund të ndihmonte në ruajtjen e stabilitetit të çmimeve të këtij grupi.

Grupi 11 – Hotele, kafene dhe restorante

Përsa i përket grupit hotele, kafene dhe restorante, evidentohet lehtësisht që të treja shtetet, demonstrojnë të njëjtën tendencë rritëse të çmimeve. Në të treja rastet mund të dallohet sezonalitet.



Megjithatë, e vetmja diferencë që duhet theksuar këtu, është fakti që rritja e çmimeve në Shqipëri dhe në Itali, ndodh në muajin gusht, muaj i cili karakterizohet nga turizëm i lartë. Nga ana tjetër, shohim që sezoni turistik fillon më shpejt në Greqi, që në muajt prill, maj, domethënë rreth festimit të Ditës së Pashkëve. Kjo mund të shpjegohet dhe me numrin e lartë të turistëve nordikë, të cilët i nisin pushimet para fillimit të sezonit të verës. Për Shqipërinë, mund të flasim më shumë për një kthim të emigrantëve që jetojnë

jashtë vendit sesa për një turizëm të mirëfilltë. Kështu që, gjatë kësaj periudhe, tregu shqiptar pasqyron një rritje në çmimet e këtyre shërbimeve.

Grupi 12 – Mallra dhe shërbime të ndryshme

Kjo kategori përbëhet nga mallra dhe shërbime, të tilla si produkte të higjenës personale ose produkte për pastrimin e shtëpive. Çmimet e këtyre produkteve në Shqipëri në krahasim me dy shtetet e tjera, kanë një sjellje të ndryshme. Kjo mund të shpjegohet me faktin se Greqia dhe Italia janë të dyja shtete anëtare të BE-së dhe si të tilla, kanë kritere të rrepta për cilësinë e mallrave që tregtojnë në vendet e tyre. Në të njëjtën kohë, të njëjtët mallra, të cilët në shumicën e tyre janë të importuar në tregjet shqiptare, nuk i nënshtrohen këtyre kritereve. Këta mallra, në një përqindje të madhe, importohen nga shtete jashtë BE-së ose janë të prodhuar për vende si Shqipëria, si të tilla këto produkte janë me kosto më të ulët. Hyrja në Eurozonë, ka ndikuar në çmimet e Greqisë dhe të Italisë sepse që nga momenti i prezantimit të euros, çmimet u rrumbullakosën. Gjithashtu, mallrat e këtij grupi mund të karakterizohen dhe si mallra luksi, çmimi i të cilëve ndikohet nga standardi i jetesës së popullsisë. Kjo mund të shpjegojë tendencën rënëse të çmimeve në tregjet shqiptare. Një tjetër arsye për tendencën rënëse në çmimet shqiptare, mund të jetë dhe rritja e konkurrencës në këtë treg si dhe mbiçmimi i lekut.

Grafik 13. Mallra dhe shërbime të ndryshme.



Burimi: INSTAT, ISTAT, SPSSKG.

II. TESTIMI PËR STABILITET DHE KONVERGJENCË

Në pjesën e parë të këtij materiali kemi krahasuar tendencat e IÇK-së së Shqipërisë me ato të Italisë dhe të Greqisë. Nëpërmjet këtij krahasimi, ne mund të themi se çmimet në një vend po rriten ose po ulen por, nuk mund të tregojmë nëse çmimet janë më të larta apo më të ulëta në një vend në krahasim me vendin tjetër. Indeksi i çmimeve i një vendi, mat nivelin mesatar të çmimeve gjatë një periudhe kohore të specifikuar në atë vend dhe jo nivelin absolut të çmimeve. Veç kësaj, konvergjenca në normën e ndryshimit të çmimeve nuk nënkupton konvergjencë në nivelin e çmimeve. Duke patur parasysh këtë, në materialin tonë kemi synuar të gjejmë nëse diferenca e çmimeve në normat e inflacionit ose në nivel, midis Shqipërisë dhe Italisë e Greqisë, divergojnë, janë duke konverguar apo kanë konverguar.

Në literaturën mbi konvergjencën, testet më të përdorshme për të cilësuar nëse seritë kanë konverguar ose janë duke konverguar janë: testi i rrënjës njësi *(unit root test)* dhe testi i stacionaritetit *(stationarity test)*. Testi i rrënjës njësi është më i përshtatshëm, për të përcaktuar nëse variablat janë duke konverguar ose janë në proces konvergimi. Ndërsa testet e stacionaritetit janë më të përshtatshme për të verifikuar nëse seritë kanë konverguar për shembull, nëse diferenca midis tyre mbetet e pandryshueshme.

Në këtë material, ne i referohemi të njëjtës metodologji testimi të përdorur nga Busseti, Fabiani, Harvey et al, (2006). Ata prezantojnë një metodologji për të përcaktuar nëse konvergjenca ndodh në çmimet relative ose vetëm në normat e inflacionit. Këtë metodologji, e kanë aplikuar mbi seritë mujore të indeksit të çmimeve të konsumit për rajonet kryesore të Italisë, për periudhën 1970-2003. Ata argumentojnë se aplikimi i testeve të rrënjës njësi dhe të stacionaritetit në diferencat e para dhe në nivele, mundëson dallimin nëse seritë kanë konverguar/diverguar ose janë duke konverguar, dhe tregojnë nëse konvergjenca ndodh në çmimet relative apo në normat e inflacionit. Në këtë material, është paraqitur e njëjta metodologji por, kësaj rradhe e përdorur për të shqyrtuar konvergjencën në nivel apo diferenca, për dymbëdhjetë grupet e shportës së

mallrave të konsumit midis Shqipërisë, nga njëra anë dhe Italisë e Greqisë, nga ana tjetër.

Metodologjia, testet dhe të dhënat.

Në këtë ushtrim është me interes të testohet hipoteza e stabilitetit të konvergjencës në nivel dhe në diferencat e para. Në këtë mënyrë, ne mund të kuptojmë dinamikën e diferencave në çmimet relative dhe në inflacion. Nëse P është një mesatare e ponderuar e çmimeve të një vendi *i,* në kohën *t* atëherë indekset e çmimeve janë:

$$p_{i,t}=P_{i,t} / P_{i,b}$$

ku *b* është viti bazë. Diferenca (ose kontrasti) midis (logut të) indeksit dhe vendeve është:

$$y^{i,j}_{t}=\log p_{i,t}-\log p_{j,t}$$

ku, $y^{i,j}_{t}$ është logaritmi i çmimeve relative midis dy vendeve. Me indekset e çmimeve nuk është e mundur të dallojmë midis konvergjencës relative apo absolute; ajo që mund të shqyrtohet është konvergjenca në ligjin e përpjesshëm të një çmimi. Testi i përshtatshëm për stabilitetin është ξ_1. Nga ana tjetër, testi për konvergjencën mund të bazohet në statistikat DF (Dickey- Fuller), τ, ku si periudhë bazë është marrë periudha e fundit.

Kontrasti në normën e inflacionit ose diferenca në inflacion,

$$\Delta y^{i,j}_{t}=\Delta \log p_{i,t}-\Delta \log p_{j,t}$$

janë invariante nga viti bazë sepse kjo eleminon përfundimin $\Delta y_{i,t}=\Delta \log P_{i,t}-\Delta \log P_{j,t}$. Hipoteza zero, që nuk ka influenca të përhershme ose të qëndrueshme mbi një kontrast në normën e inflacionit, testohet nëpërmjet aplikimit të testit të stacionaritetit ξ_0 mbi Δy_t. Në mënyrë të ngjashme, hipoteza zero e jokonvergjencës është testuar nëpërmjet testit τ_0, të gjeneruar nga regresioni ADF (Augmented Dickey-Fuller) pa konstante.

Duke u bazuar në rezultatet e testeve të rrënjës njësi dhe të stacionaritetit, ne mund të dallojmë midis grupeve të IÇK-së që kanë konverguar (refuzimi i testit të rrënjës njësi dhe jo refuzimi i testit të stacionaritetit) dhe grupeve të IÇK-së, që janë duke konverguar (refuzimi i të dyja testeve). Meqënëse, si niveli ashtu dhe diferencat janë të rëndësishme, renditja e testeve është gjithashtu, e rëndësishme. Dickey dhe Pantula (1987), argumentojnë se është më mirë të testohet për rrënjën njësi në diferencat e para dhe nëse kjo refuzohet, të vazhdohet të testohet për rrënjë njësi në nivel.

Nga ana tjetër, pranimi i stacionaritetit në nivel, nënkupton që spektri i diferencave të para është zero në origjinë, në këtë mënyrë zhvlerësohet testi i stacionaritetit në diferencat e para. Kjo sugjeron që rendi i testit të stabilitetit duhet të jetë i tillë që stacionariteti i Δy_t të testohet vetëm nëse stacionariteti në y_t është refuzuar.

Aplikimi i kësaj metodologjie testimi, fillon nga testi i rrënjës njësi mbi diferencat në inflacion. Nëse kjo hipotezë nuk refuzohet, atëherë kemi rastin e jokonvergjencës (divergjencë) (alternativa E në figurën e mëposhtme), ndërsa refuzimi i testit të rrënjës njësi në diferencat e para, çon në testimin e rrënjës njësi në çmimet relative. Refuzimi ose pranimi i testit të fundit, do të çojë në testimin për stacionaritet në nivel apo në diferenca. Rezultatet përfundimtare, siç përshkruhen dhe në metodologjinë e përdorur nga F. Busseti, et al, (2006) janë:



(A) Çmimet relative po konvergojnë: refuzim i testit të rrënjës njësi në diferencat e para dhe në nivel; refuzim i testit të stacionaritetit në nivel.

(B) Çmimet relative kanë konverguar: refuzim i testit të rrënjës njësi në diferencat e para dhe në nivel; jo refuzim i testit të stacionaritetit në nivel.

(C) Normat e inflacionit janë duke konverguar: refuzim i testit të rrënjës njësi në diferencat e para por jo në nivel; refuzim i testit të stacionaritetit në diferencat e para.

(D) Normat e inflacionit kanë konverguar: refuzim i testit të rrënjës njësi në diferencat e para por jo në nivel; jo refuzim i testit të stacionaritetit në diferencat e para.

(E) Jo konvergjencë: jo refuzim i testit të rrënjës njësi në diferencat e para.

Të dhënat

Të dhënat e përdorura, janë të njëjtat seri mujore të indekseve të çmimeve të konsumit, të përdorura dhe në pjesën e parë të materialit por, si periudhë bazë tashmë është marrë muaji mars 2006. Seritë janë rregulluar nga sezonaliteti dhe transformuar me indeksin e kursit të këmbimit lek/euro. Më pas, janë llogaritur seritë e diferencave-ose kontrasteve- midis *logeve* të indekseve të çmimeve, dhe seritë e diferencave të inflacioneve dhe testet, janë aplikuar mbi këto seri.

Të gjitha rezultatet e testeve janë përmbledhur në tabelat 1 dhe 2. Për të kuptuar më mirë rezultatet e paraqitura në këto tabela, po ilustrojmë rastin e kontrastit të çmimeve për grupin e parë të IÇK-së "Ushqime dhe pije joalkolike", midis Shqipërisë dhe Greqisë. Për këtë rast, hipoteza zero e jokonvergjencës refuzohet në nivelin 1 për qind nga testi ADF (Augmented Dickey-Fuller), i aplikuar mbi serinë e diferencave të inflacionit. Testi i rrënjës njësi në nivel, përsëri është refuzuar por, nuk është refuzuar testi i stacionaritetit në nivel, duke çuar kështu në konkluzionin që

çmimet relative të grupit "Ushqime dhe pije joalkolike" kanë konverguar, alternativa B. Një aspekt i këtij rezultati, i cili mund të përbëjë shqetësim është që, megjithëse çmimet duket se po konvergojnë, testi i stacionaritetit në diferencat e inflacionit refuzon hipotezën zero.

Karakteristikat e testit të stacionaritetit në diferencat e para, varen nëse kushtet fillestare janë të vogla ose të mëdha. Në rastin e parë, testi është i nënvlerësuar dhe në rastin e dytë, testi është i mbivlerësuar. Mbivlerësimi ndodh për kushte fillestare të mëdha dhe masa e mbivlerësimit rritet, me rritjen e gjerësisë së kushteve fillestare. Në mënyrë intuitive, kjo mund të shpjegohet nëse ne mendojmë për një itinerar konvergjence në nivel (duke filluar nga një vlerë fillestare e madhe): diferenca fillestare është pjerrësia e serive, e cila vazhdon të ndryshojë përgjithësisht në të njëjtin drejtim, me qëllim që të sjellë nivelin në vlerën e tij afatgjatë. Vërehet se vlera të mëdha të kushteve fillestare nga të cilat ndodh mbiçmimi, janë karakteristike në seritë që konvergojnë.

Rezultatet e testeve për 12 grupet e IÇK-së, jepen në tabelat 1 dhe 2. Për kontrastin në inflacion, jepen nivelet e rëndësishme *(significant)* të refuzimit të testit ADF, me dhe pa konstante përkatësisht τ_1 dhe τ_0. Për kontrastet në çmime, raportohen nivelet e rëndësisë së refuzimit të testit ADF me term konstant τ_1 dhe pa termin konstant τ_0, dhe testi i stacionaritetit ξ_1, sipas Kwiatkowski, Pillips, Schmidt and Shin (KPSS). Në të dyja rastet, vlera maksimale e *logeve* sipas Akaike Information Criterion, është 11.

Në të gjitha rastet, testi i rrënjës njësi mbi diferencat në inflacion, hedh poshtë hipotezën zero, duke përjashtuar kështu rastin e jokonvergjencës. Në tabelën e parë, jepen rezultatet e krahasimit të çmimeve midis Shqipërisë dhe Italisë. Në këtë rast krahasimor, kemi përfunduar në: 1 A, çmimet relative janë duke konverguar; 9 B, konvergjencë në çmimet relative dhe; 2 C, normat e inflacionit po konvergojnë. Në tabelën e dytë, janë krahasuar çmimet midis Shqipërisë dhe Greqisë. Në këtë rast kemi: 11 B, konvergjencë në çmimet relative dhe 1 C, normat e inflacionit po konvergojnë.

Tabelë 3. Rezultatet e testeve për çmimet midis Shqipërisë dhe Italisë.

Shqipëri-Itali							
	Kontrasti në inflacion			Kontrasti në CPI			Alternativat
		τ	ξ_0		τ	ξ_1	
Grupet e IÇK-së	τ_1^{13}	τ_0		τ_1	τ_0		
Ushqime dhe pije jo alkolike	1%	1%	1%	5%	1%	-	B
Pije alkolike dhe duhan	1%	1%	1%	-	-	-	C
Veshje dhe këpucë	1%	1%	1%	-	-	-	C
Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	1%	1%	1%	1%	1%	-	B
Pajisje shtëpie	1%	1%	1%	-	5%	-	B
Shëndeti	5%	1%	1%	5%	1%	10%	A
Transporti	1%	1%	1%	10%	1%	-	B
Komunikimi	1%	1%	1%	-	5%	-	B
Argëtim dhe kulturë	1%	1%	1%	-	5%	-	B
Arsim	1%	1%	1%	-	1%	-	B
Hotele, kafene dhe restorante	5%	1%	1%	10%	1%	-	B
Mallra dhe shërbime të ndryshme	1%	1%	1%	-	5%	-	B

Tabelë 4. Rezultatet e testeve për çmimet midis Shqipërisë dhe Greqisë.

Shqipëri-Greqi							
	Kontrasti në inflacion			Kontrasti në CPI			Alternativat
		τ	ξ_0		τ	ξ_1	
Grupet e IÇK-së	τ_1^{13}	τ_0		τ_1	τ_0		
Ushqime dhe pije joalkolike	1%	1%	1%	10%	1%	-	B
Pije alkolike dhe duhan	1%	1%	1%	-	5%	-	B
Veshje dhe këpucë	1%	1%	1%	-	-	-	C
Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	1%	1%	1%	1%	1%	-	B
Pajisje shtëpie	1%	1%	1%	-	1%	-	B
Shëndeti	5%	1%	1%	1%	1%	-	B
Transporti	1%	1%	1%	-	1%	-	B
Komunikimi	1%	1%	1%	-	1%	-	B
Argëtim dhe kulturë	1%	1%	1%	-	5%	-	B
Arsim	1%	1%	1%	-	1%	-	B
Hotele, kafene dhe restorante	5%	1%	1%	-	5%	-	B
Mallra dhe shërbime të ndryshme	1%	1%	1%	-	10%	-	B

Tabelë 5. Rezultatet e testeve për çmimet midis Greqisë dhe Italisë.

Greqi-Itali							
	Kontrasti në inflacion			Kontrasti në CPI			Alternativat
		τ	ξ_0		τ	ξ_1	
Grupet e IÇK-së	τ_1^{13}	τ_0		τ_1	τ_0		
Ushqime dhe pije joalkolike	1%	1%	1%	-	-	-	C
Pije alkolike dhe duhan	1%	1%	1%	-	-	-	C
Veshje dhe këpucë	-	-					E
Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	-	5%	5%	-	10%	-	B
Pajisje shtëpie	1%	1%	1%	-	-	-	C
Shëndeti	1%	1%	1%	-	5%	-	B
Transporti	1%	1%	1%	5%	1%	-	B
Komunikimi	1%	1%	1%	5%	1%	-	B
Argëtim dhe kulturë	5%	1%	1%	-	1%	-	B
Arsim	-	5%	1%	-	-	-	C
Hotele, kafene dhe restorante	1%	1%	1%	-	1%	-	B
Mallra dhe shërbime të ndryshme	1%	1%	1%	5%	1%	-	B

II. KONKLUZIONE

Në këtë material, janë analizuar tendencat e çmimeve midis Shqipërisë, nga njëra anë dhe Greqisë e Italisë, nga ana tjetër. Në përfundimet e gjetura, duhet mbajtur parasysh shkalla e ndryshme e zhvillimit ekonomik midis këtyre vendeve, ndryshimet në përbërjen e indekseve të çmimeve të konsumit dhe periudha e shkurtër kohore e serive të përdorura në këtë metodologji.

- Fillimisht, në material bëjmë një krahasim të tendencave të çmimeve të 12 grupeve të IÇK-së, midis Shqipërisë dhe Italisë e Greqisë. Nga kjo analizë, rezulton se në tregun shqiptar gjejmë dy tendenca kryesore:

1. Një tendencë rënëse në nivelin e çmimeve të grupeve "Veshje dhe këpucë", "Pajisje shtëpie", "Argëtim dhe kulturë" dhe "Mallra dhe shërbime të ndryshme" në krahasim me ato të të dyja vendeve partnere.
2. Një rritje më të shpejtë në nivelin e çmimeve të grupeve "Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji", "Shëndet", "Komunikim" dhe "Arsim", në krahasim me ato të Italisë dhe Greqisë.

Ecuria e çmimeve për rastin e parë mund të shpjegohet nga liberalizimi i tregut, nënshkrimi i Marrëveshjeve të Tregtisë së Lirë me vendet e rajonit, rritja e prodhimit vendas dhe vlerësimi i kursit të këmbimit[14]. Në rastin e dytë, ku çmimet shqiptare rriten më shpejt në krahasim me çmimet në dy vendet e tjera, duhet të kemi parasysh karakteristikat e këtyre të mirave dhe shërbimeve si dhe faktin që një pjesë e mirë e çmimeve të tyre janë të administruara.

- Më pas, në material aplikohen testet e rrënjës njësi dhe të stacionaritetit për të shqyrtuar nëse seritë kanë konverguar, janë duke konverguar apo kanë diverguar, në çmime relative apo në normat e inflacionit. Testet janë aplikuar mbi seritë mujore të indekseve të çmimeve të konsumit, të cilat kanë një ndarje të njëjtë, në 12 grupe, për të treja vendet por ndryshojnë në peshat e grupeve, në nënndarjen në nëngrupe dhe në peshat e nëngrupeve. Në pjesën më të madhe të rasteve, testet çojnë në përfundimin e konvergjencës në diferencat

e nivelit të çmimeve. Megjithatë, duke patur parasysh ndryshimet e indekseve të çmimeve të konsumit ndërmjet këtyre vendeve dhe problemin e mbivlerësimit, duam të theksojmë që përfundimi më i rëndësishëm i këtij materiali është se në të gjitha rastet, testet hedhin poshtë hipotezën e divergjencës në inflacion.

- Mendojmë që për të ardhmen do të ishte me interes aplikimi i kësaj metodologjie mbi seri më të gjata të indekseve të çmimeve të konsumit. Rezultatet që do të përfitohen mbi seritë e reja të formuara do të jenë me interes, pasi disa nga zhurmat që hasen në këtë moment, mund të eleminohen në të ardhmen.

Grafik 14. Kontrasti në inflacionin e 12 grupeve të IÇK-së midis Shqipërisë dhe Greqisë.



Burimi: INSTAT, SPSSKG, llogaritje të autorëve.

Grafik 15. Kontrasti në inflacionin e 12 grupeve të IÇK-së midis Shqipërisë dhe Italisë.



Burimi: INSTAT, ISTAT, llogaritje të autorëve.

Grafik 16. Kontrasti në çmimet relative (IÇK) midis Shqipërisë dhe Greqisë.



Burimi: INSTAT, SPSSIKG, llogaritje të autorëve.

Grafik 17. Kontrasti në çmimet relative (IÇK) midis Shqipërisë dhe Italisë.



Burimi: INSTAT, ISTAT, llogaritje të autorëve.

Grafik 18. Kontrasti në çmimet relative (IÇK) midis Italisë dhe Greqisë.



Burimi: ISTAT, SPSSIKG, llogaritje të autorëve.

Grafik 19. Kontrasti në inflacionin e 12 grupeve
të IÇK-së midis Greqisë dhe Italisë.



Burimi: ISTAT, SPSSKG, llogaritje të autorëve.

Grafik 20. Diferenca në IÇK dhe në inflacion
midis Shqipërisë dhe Italisë.



Burimi: INSTAT, ISTAT, llogaritje të autorëve.

Grafik 21. Diferenca në IÇK dhe në inflacion
midis Shqipërisë dhe Greqisë.



Burimi: INSTAT, SPSSKG, llogaritje të autorëve.

SHËNIME

* Përgatitur nga: Elvana Troqe dhe Valentina Semi, specialiste, Departamenti i Politikës Monetare. Dhjetor 2006.
Dëshirojmë të falenderojmë znj. Marga Peeters, z. Gramoz Kolasi, z. Erion Luçi, znj. Diana Shtylla dhe z. Erald Themeli për komentet dhe udhëzimet e vlefshme.
Opinionet e shprehura në këtë material janë të autorëve dhe nuk duhet të interpretohen si të Bankës së Shqipërisë.

[1] Eksportet me Italinë për vitin 2005, zinin 72.4 për qind të totalit dhe me Greqinë 10.5 për qind të totalit të eksporteve. Importet me Italinë për vitin 2005, zinin 29.3 për qind të totalit të importeve dhe me Greqinë 16.6 për qind të totalit të importeve.

[2] Burimi: Raporte periodike të Bankës së Shqipërisë.

[3] Jan Peter Olters "A është inflacioni i ulët në Shqipëri? Bazat makroekonomike dhe zhvillimet socialekonomike", Konferenca e pestë e Bankës së Shqipërisë.

[4] Nuk përfshihen shërbimet e transportit.

[5] Fjalë e z.Panayotis Thomopoulos: ''Supervision of credit and financial institutions - Structure of the Greek banking system''. Euromoney Conferences, Greece's rapidly changing banking sector, Athinë, 1-2 nëntor 2006.

[6] Burimi: Raporte periodike të politikës monetare dhe Raport Vjetor , Banka e Greqisë.

[7] Burimi: Raporti Vjetor 2005 , Banka e Italisë.

[8] S. Fabiani, A. Gattulli dhe R. Sabbatini, korrik 2004 "Sjellja e çmimeve të firmave italiane: Dëshmi të reja të analizës për qëndrueshmërinë e çmimeve".

[9] Ka ndryshime në klasifikimin dhe në peshat e nëngrupeve të shportës së mallrave të konsumit midis këtyre vendeve.

[10] Importet e ushqimeve dhe të pijeve joalkolike nga Greqia, përbëjnë 17 për qind të totalit të importeve për vitin 2005.

[11] Konkurrenca në këtë treg mund të konsiderohet edhe më e ulët, nëse marrim parasysh efektin e mbiçmimit të lekut gjatë këtyre viteve të fundit.

[12] Departamenti Amerikan i Tregtisë, Misioni i tregut të teknologjisë për kujdesin shëndetsor i Shteteve të Bashkuara. Greqi, Itali, 22-27 maj 2006.

[13] Testi i rrënjës njësi, pa konstante τ_0, testi i rrënjës njësi me konstante τ_1, testi i stacionaritetit pa konstante ξ_0, testi i stacionaritetit me konstante ξ_1.

[14] Nëngrupet e këtyre grupeve përbëhen kryesisht nga mallra të tregtueshëm.

REFERENCA

Fabeti, P. Rimer and Ad C.J. Stokman, (2004), "Price convergence in Europe from a macro prespective:Trends and determinants(1960-2003)", Working paper, De Nederlandsche Bank.

Buseti, F., Forini, I., A. Harvey, (2006), "Inflation Convergence and Divergence within the European Monetary Union", Working paper series, European Central Bank.

Buseti,F., S.Fabiani and A.Harvey (2006), "Convergence of prices and rates of inflation",Banca d'Italia.

Coleman, A and T. Daglish,"Regional Price Convergence in Australia and New Zealand, 1984-1996", New Zeland Treasury.

Gujarati,N.D.(1995), "Basic Econometrics",709-732.

Jan Peter Olters, "A është inflacioni tepër i ulët në Shqipëri?". Konferenca V e Bankës së Shqipërisë.

LIGJI I RI "PËR BANKAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË "DHE PËRPUTHSHMËRIA E TIJ ME KUADRIN RREGULLATIV MBIKËQYRËS. DETYRIMET PËR NDRYSHIME RREGULLATIVE NË ZBATIM TË DIREKTIVAVE TË BASHKIMIT EVROPIAN

*Juna Bozdo**
Irini Kalluci

Fjalë kyçe
- Kuadër ligjor - Direktiva të BE - Veprimtari bankare - Licencim Mikëqyrje -

ABSTRAKT

Materiali në vijim trajton përputhshmërinë e ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" me kuadrin rregullativ mbikëqyrës ekzistues si dhe detyrimet për ndryshime rregullative, që lindin nga zbatimi i dispozitave të Direktivës 2000/12/BE të konsoliduar me Direktivën 2006/48/BE.

Përgjatë materialit bëhet krahasimi ndërmjet ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" me ligjin nr.8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i cili ka shërbyer si bazë për hartimin e kuadrit rregullativ mbikëqyrës ekzistues. Në këtë aspekt janë analizuar në mënyrë të detajuar të gjitha nenet e ligjeve të mësipërme si dhe është bërë krahasimi i këtyre të fundit me rregulloret përkatëse në të cilat këto dispozita janë të reflektuara. Nga një analizë e tillë është arritur në përfundimin se disa prej rregulloreve ekzistuese kanë nevojë për një rikonceptim, me qëllim reflektimin e risive që lindin nga zbatimi i kuadrit të ri ligjor. Element plotësues i kësaj analize është dhe reflektimi i dispozitave të Direktivës 2000/12/BE të konsoliduar me Direktivën 2006/48/BE, për të përfshirë detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit në fushën e veprimtarive financiare.

I. Përputhshmëria e ligjit nr.9662 datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" me kuadrin rregullativ mbikëqyrës. Përcaktimi i detyrimeve për ndryshime rregullative në zbatim të Direktivave të Bashkimit Evropian.

Ligji "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" nr.9662, datë 18.12.2006 është një variant i përmirësuar i ligjit nr.8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe vjen me një trajtim ndryshe për një sërë elementesh. Ligji është konceptuar duke marrë parasysh direktivat e BE, parimet e Komitetit të Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare si dhe është hartuar në përputhje edhe me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit. Si pasojë, lind nevoja e përmirësimit dhe e përshtatjes së kuadrit rregullativ mbikëqyrës ekzistues me kërkesat e këtij ligji.

Përsa më sipër, përputhshmëria e ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" nr.9662, datë 18.12.2006[1] me kuadrin rregullativ mbikëqyrës, do të analizohet sipas krerëve përbërës të veçantë të ligjit.

I.I Kreu I: "Dispozita të Përgjithshme".

Ky kre i ligjit përbëhet nga dispozita të përgjithshme, të cilat përcaktojnë: objektin e ligjit, fushën e zbatimit të tij, strukturën dhe shtrirjen e sistemit bankar në Republikën e Shqipërisë, përkufizimin e termave të përdorur, të drejtat dhe ndalimet në ushtrimin e veprimtarisë bankare, detyrimin për informim mbi gjendjen e sistemit bankar dhe atij financiar, formën juridike të bankës si dhe mundësinë e shfrytëzimit të sistemit bankar për qëllime të pastrimit të parave ose të financimit të terrorizmit.

Në *nenin 1* (ku përshkruhet objekti i ligjit) dhe *nenin 2, pika 2* të ligjit (ku përcaktohen personat, subjekt i ligjit), termi "bankë" nënkupton si bankat me seli në territorin e RSH ashtu dhe degët e bankave të huaja, të licencuara nga Banka e Shqipërisë, duke mos bërë asnjë dallim përsa i përket krijimit, licencimit apo ushtrimit të veprimtarisë së tyre në RSH (neni 5 i ligjit). *Një trajtim i tillë, është në përputhje të plotë me lirinë e themelimit dhe të*

ofrimit të shërbimeve bankare dhe financiare (Neni 11 i ligjit) të cituara edhe në Direktivën 2000/12/BE, neni 23/5 dhe në Direktivën 2006/48/BE, nenet 38/1 dhe 38/3. Më konkretisht, Direktiva citon se: *shtetet anëtare nuk duhet t'u aplikojnë degëve të institucioneve kredituese, me seli jashtë territorit të BE, dispozita që rezultojnë në një trajtim më favorizues sesa trajtimi kundrejt degëve të institucioneve kredituese me seli brenda territorit të BE, në momentin e nisjes së aktivitetit dhe gjatë ushtrimit të tij*[2].

Ndryshe nga trajtimi i njëjtë që iu bëhet bankave dhe degëve të bankave të huaja në lidhje me krijimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së tyre në RSH, një element i rëndësishëm është *nevoja e realizimit të një mbikëqyrjeje të diferencuar ndërmjet bankave dhe degëve të bankave të huaja, në përputhje kjo me nenin 27 të Direktivës 2000/12/BE konsoliduar me nenin 41/1 të Direktivës 2006/48/BE*. Në këtë nen shprehet se: *përgjegjësia e autoritetit mbikëqyrës të vendit pritës*[3], *në bashkëpunim me autoritetin mbikëqyrës së bankës mëmë*[4], *do të përqendrohet kryesisht në mbikëqyrjen e likuiditetit të degës së bankës së huaj*[5].

Ndërsa në nenin 28 të Direktivës 2000/12/BE dhe nenin 42 të Direktivës 2006/48/BE theksohet se: ky bashkëpunim midis autoriteteve mbikëqyrëse të vendit të origjinës dhe atij pritës, për mbikëqyrjen dhe monitorimin e veprimtarisë së institucionit kredites duhet të përfshijë përveç likuiditetit edhe administrimin, strukturën e pronësisë, aftësinë paguese, kufijtë për ekspozimet e mëdha dhe mekanizmat e kontrollit të brendshëm.

Në nenin 4 të ligjit (mbi përkufizimet e terminologjisë së përdorur përgjatë ligjit në fjalë), janë bërë përmirësime në përkufizimin e disa prej termave të ligjit të vjetër, si dhe janë përkufizuar për herë të parë disa terma të rinj. Në mënyrë të përmbledhur janë rikonceptuar termat si: "bankë", "veprimtari bankare", "licencë", "depozitë monetare", "persona apo grup personash të lidhur", "kontroll", "degë e bankës së huaj", "drejtues ekzekutiv", "subjekt financiar jobankë" si dhe termat lidhur me kapitalin e bankës; është dhënë përcaktimi i termave lidhur me rrezikun, koncepti i "likuidimit vullnetar"; janë dhënë termat lidhur me mbikëqyrjen e konsoliduar etj..

Për qëllime të mbikëqyrjes së konsoliduar, janë përkufizuar edhe terma të rinj si: "kapital fillestar minimal", "kapital fillestar i paguar", "grup bankar", "shoqëri financiare zotëruese", "bankë mbizotëruese në një grup bankar ose financiar". Ndër termat e tjerë të rinj mund të përmenden edhe përkufizimet e dhëna për "Regjistri i kredive" dhe "Agjencia e Sigurimit të Depozitave". Në këtë aspekt, *lind nevoja e përditësimit të kuadrit rregullativ mbikëqyrës ekzistues, me qëllim përafrimin e legjislacionit vendas me atë të BE në fushën e shërbimeve bankare dhe financiare. (Direktiva 2000/12/BE neni 1 konsoliduar me Direktivën 2006/48/BE neni 4, citon në mënyrë të detajuar përkufizimet e termave që përdorin direktivat e sipërpërmendura.)*

I.II Kreu II "Licencimi i bankave dhe i degëve të bankave të huaja".

Ky kre i ligjit paraqet karakteristikat, fazat dhe kërkesat në lidhje me dokumentacionin e domosdoshëm për marrjen e licencës për të ushtruar veprimtarinë bankare dhe financiare në RSH; miratimin paraprak të licencës ose refuzimin e saj; komisionet e aplikuara për marrjen e licencës; rastet e revokimit të saj; publikimin e vendimit për miratimin ose revokimin e licencës; kërkesat për kapital fillestar minimal; veprimtaritë shtesë që mund të kryhen nga bankat ose degët e bankave të huaja si dhe ndryshimet në strukturën e kapitalit të tyre.

Ligji i njeh Bankës së Shqipërisë të drejtën ekskluzive për licencimin e bankave dhe degëve të bankave të huaja, me qëllim ushtrimin e veprimtarisë bankare dhe financiare në RSH (*neni 14* i ligjit), *në përputhje të plotë kjo edhe me Direktivën 2000/12/BE, neni 4 e konsoliduar me Direktivën 2006/48/BE, nenet 6 dhe 28/1*. Sipas Direktivave citohet se: *bankat dhe degët e bankave të huaja, duhet të pajisen me licencë përpara fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së tyre*.

Neni 15, pika 1 e ligjit, përcakton karakteristikat e licencës, si akt administrativ i lëshuar nga Banka e Shqipërisë. Licenca është e pakufizuar në kohë, e patransferueshme dhe një risi e ligjit të

ri, kundrejt ligjit të vjetër është elementi i patjetërsueshmërisë së saj. *Neni 15 pika 2* e ligjit, në dallim nga ligji i vjetër, zgjeron fushën e veprimtarive të lejuara për bankat dhe degët e bankave të huaja me veprimtaritë financiare, të përcaktuara së bashku me ato bankare, në aneksin që i bashkëngjitet licencës. *Kjo pikë e nenit, është në përputhje me Direktivën 2000/12/BE neni 21/1 të konsoliduar me Direktivën 2006/48/BE, Neni 28/1* e cila shpreh se: *institucionet kredituese duhet të njoftojnë paraprakisht autoritetet kompetente, në lidhje me llojin e veprimtarive që duan të ushtrojnë, të bashkëngjitura në aneksin e licencës bankare të përftuar.*

Neni 17 i ligjit sjell një *rikonceptim të ligjit të vjetër*, përsa i përket kërkesave në lidhje me dokumentacionin e kërkuar për marrjen e licencës për të ushtruar veprimtari bankare dhe financiare në RSH, *duke dalluar midis bankave dhe degëve të bankave të huaja*. Këto kërkesa, më parë të shprehura vetëm në aktet rregullative të Bankës së Shqipërisë, janë tanimë të përcaktuara në ligjin e ri, duke theksuar rëndësinë e tyre. Gjithashtu, janë shtuar edhe kërkesat në lidhje me dokumentacionin e kërkuar për marrjen e licencës, të shprehura këto tashmë në ligj, si për shembull në lidhje me pjesëmarrjet e drejtpërdrejta ose të tërthorta në kapitalin e bankës në një vlerë jo më të vogël se 5 për qind; strukturën e kapitalit; informacionin për çdo marrëveshje ose çdo formë tjetër rregullimi, nëpërmjet së cilës kontrolli apo ndikimi në vendimmarrje mund të ushtrohet në çdo mënyrë tjetër; llogaritë dhe raportin vjetor të personit juridik; llogaritë dhe raportin vjetor të konsoliduar si dhe opinionin e ekspertit kontabël të autorizuar (*neni 17/1*) si dhe në lidhje me strukturën e pronësisë së bankës së huaj; emrin e autoritetit mbikëqyrës dhe pëlqimin e tij për hapjen e degës së bankës së huaj dhe informacionin për skemën e sigurimit të depozitave monetare (*neni 17/2*).

Element tjetër i ri është dhe *heqja e kufizimit të emërimit nga banka mëmë e të paktën dy administratorëve rezidentë* për drejtimin e degës së bankës së huaj. Këto ndryshime duhen pasqyruar në rregulloren "Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë[6]".

Në lidhje me përputhshmërinë e *pikës 1* të këtij neni me Direktivat e BE mund të theksojmë se janë pasqyruar më së miri disa prej dispozitave të këtyre të fundit. Më konkretisht, informacionet mbi: kapitalin aksioner të nënshkruar dhe dokumentin vërtetues; strukturën e kapitalit; kualifikimin, reputacionin dhe përvojën e të paktën dy prej administratorëve; plan biznesin e tre viteve të para të veprimtarisë; emrin, vendbanimin e çdo personi që propozon të zotërojë pjesëmarrje influencuese, përputhen me kërkesat e dispozitave të Direktivës 2000/12/BE dhe të Direktivës 2006/48/BE[7].

Të njëjtin përfundim mund të nxjerrim edhe për përputhshmërinë e pikave 2, 3 dhe 5 të nenit në fjalë. Kështu, informacioni mbi statutin e bankës së huaj, adresën e saktë të selisë, përshkrimin e veprimtarisë, shumën e kapitalit, strukturat e drejtimit të bankës dhe administratorët e saj; shumën e dhuruar të kapitalit fillestar minimal; lejen e ushtrimit të veprimtarisë bankare të dhënë nga autoriteti përkatës në vendin ku ndodhet selia e saj, si dhe listën e veprimtarive, për të cilat është licencuar banka e huaj; strukturën e pronësisë së bankës së huaj; kushtet që duhet të plotësojë një degë e bankës së huaj që propozon të zotërojë pjesëmarrje influencuese në një bankë; të drejtën e Bankës së Shqipërisë për të kërkuar informacion shtesë, pasqyrojnë rigorozisht informacionet e kërkuara në nenet e dispozitave të Direktivës 2000/12/BE dhe të Direktivës 2006/48/BE[8].

Neni 18, pika 1 e ligjit (kërkesa për kapital fillestar minimal), përputhet me kërkesën e nenit 5/1 të Direktivës 2000/12/BE dhe nenin 9/1 të Direktivës 2006/48/BE, për derdhjen e një kapitali fillestar minimal për të përftuar licencën për të ushtruar veprimtari bankare dhe financiare. Në dispozitat e direktivave të BE, kapitali fillestar minimal vlerësohet në nivelin 5 milionë euro, ndërsa në aktet rregullative të Bankës së Shqipërisë ky kapital vlerësohet në nivelin 1 miliard lekë (afërsisht 8 milionë euro). Ky nivel më i lartë është si pasojë e faktit që në aktet rregullative të Bankës së Shqipërisë, në përcaktimin e kësaj shume është marrë parasysh edhe rreziku i vendit *(country risk)*.

Neni 19, pika 1 e ligjit, përcakton se e drejta për të dhënë miratimin apo refuzimin paraprak për licencë (brenda 3 muajve

nga data e pranimit të kërkesës për licencë nga banka apo dega e bankës së huaj) i njihet Bankës së Shqipërisë. Kjo e drejtë që i njihet autoritetit mbikëqyrës, shprehet edhe në nenet 10 dhe 13, përkatësisht të Direktivave 2000/12/BE dhe 2006/48/BE, por me një dallim, që në direktivat e mësipërme shprehet se: *afati maksimal i dhënies së miratimit apo refuzimit është 6 muaj nga data e paraqitjes së kërkesës.*

Në vijim të ligjit të vjetër (që vendos si kusht për marrjen e licencës nga banka ose dega e bankës së huaj ekzistencën e të paktën tre aksionerëve), *pika 2/ç* e nenit të mësipërm përcakton se që një bankë të marrë miratimin paraprak për ushtrimin e veprimtarisë bankare dhe financiare, duhet që aksionerët e saj të mos zotërojnë më shumë se 1/3 e kapitalit ose të aksioneve me të drejtë vote. Ky rikonceptim, duhet të pasqyrohet edhe në rregulloren "Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në RSH". *Neni 19 pika 2/d* (strukturat operacionale dhe të kontrollit, përfshirë politikat dhe procedurat e bankës dhe të degës së bankës së huaj) dhe *pika 3* (rastet e refuzimit të miratimit paraprak të licencës për bankën ose degën e bankës së huaj), vijnë si *elemente të reja* krahasuar me kërkesat e ligjit të vjetër. Në këtë mënyrë, lind nevoja e përfshirjes së tyre në rregulloren "Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në RSH" (neni 6).

Neni 20, i ligjit parashtron si një nga kushtet e domosdoshme për marrjen e licencës nga bankat apo degët e bankave të huaja, paraqitjen e kërkesës dhe të dokumentacionit të plotë pranë ASD, për marrjen e çertifikatës së sigurimit të depozitave. Po kështu, edhe në *nenin 22* të ligjit, parashtrohet si kusht i domosdoshëm për ushtrimin e veprimtarisë bankare nga bankat dhe degët e bankave të huaja, ai i sigurimit të depozitave monetare. *Për sa më sipër, lind nevoja e pasqyrimit të këtyre kushteve në rregulloren "Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në RSH" (neni 7).*

Nenet 21 dhe 29 mbi publikimin dhe botimin e vendimit për dhënien e licencës dhe revokimin e saj, mbështeten respektivisht në nenet 11 dhe 14/2 të Direktivës 2000/12/BE dhe nenet 14

dhe 17/2 të Direktivës 2006/48/BE, të cilat citojnë se: *emri i çdo institucioni kreditues, i cili ka përftuar licencën për të ushtruar veprimtari bankare dhe financiare, duhet të shënohet në një regjistër i cili publikohet në Gazetën Zyrtare të BE-së. Gjithashtu, në rast revokimi të licencës, autoritetet kompetente duhet të japin arsyet e revokimit si dhe të bëjnë publikimin e këtij vendimi.*

Neni 24, paraqet të gjitha rastet kur një bankë apo degë e bankës së huaj, duhet të kërkojë miratimin paraprak të Bankës së Shqipërisë, mbi çështje që lidhen me veprimtarinë e kryer prej saj. Në dallim nga ligji i vjetër, shtohen rastet e kërkesës për miratim paraprak, duke i përcaktuar tashmë me ligj (jo vetëm me aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë), si për shembull: hapja e degëve, filialeve ose zyrave të përfaqësimit brenda dhe/ose jashtë territorit të RSH apo dhe transferimi i pronësisë së aksionerëve me pjesëmarrje influencuese ose të kontrollit të bankës tek një palë e tretë.

Për më tepër, janë shtuar edhe kërkesa të reja si: ndryshimi i statutit, shpërndarja e kapitalit dhe rritja e përqindjes së një aksioneri me pjesëmarrje influencuese, duke tejkaluar 20, 33 ose 50 për qind të kapitalit të bankës ose të të drejtave të votës apo në një masë të tillë që banka të bëhet filial i tij. Kërkesa e fundit, është në përputhje të plotë me nenin 16/1 të Direktivës 2000/12/BE dhe nenin 19/1 të Direktivës 2006/48/BE.

Këto direktiva parashikojnë edhe *dy raste të veçanta* të cilat mund të konsiderohen të rëndësishme edhe për realitetin shqiptar. *Së pari*, parashtrohen detyrimet e personave fizikë ose juridikë (neni 16, Direktiva 2000/12/BE dhe neni 20, Direktiva 2006/48/BE) për të informuar autoritetet kompetente në rast se propozojnë të zvogëlojnë pjesëmarrjen influencuese në institucionet krediduese, të cilën e zotërojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në mënyrë që kjo e fundit ose të drejtat e votës të bien nën 20 për qind, 33 për qind ose 50 për qind. *Së dyti*, detyrimi për informim në favor të autoriteteve kompetente, lind jo vetëm tek personat fizikë apo juridikë që propozojnë të zotërojnë një pjesëmarrje influencuese në

institucionet krediduese, por edhe tek vetë institucionet krediduese që propozohen të zotërohen (neni 21, Direktiva 2006/48/BE).

Pikat 1/c dhe *1/dh* të nenit *24*, janë zgjeruar me informacion shtesë. *Gërma c* është zgjeruar me faktin se Banka e Shqipërisë përcakton me akt nënligjor dhe jep miratimin paraprak mbi kriteret për lidhjen e marrëveshjeve[9] me të tretët, për ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësive për administrimin dhe drejtimin e bankës. *Gërma dh* specifikon se duhet miratimi paraprak i Bankës së Shqipërisë në rastet e riblerjes së aksioneve të bankës ose personave të lidhur me të, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet një personi tjetër, duke dhënë kredi ose duke lëshuar garanci.

Neni 24, pika 3 që shpreh se: *Banka e Shqipërisë jep ose refuzon miratimin paraprak, brenda tre muajve nga paraqitja e plotë e kërkesës, mbështetur kjo në dokumentacionin e përcaktuar me akt nënligjor,* është në përputhje me nenin 16, të Direktivës 2000/12/BE dhe nenin 19/1, të Direktivës 2006/48/BE.

Neni 25 specifikon rastet kur një person duhet t'i drejtohet Bankës së Shqipërisë për të marrë miratimin paraprak nëse kërkon të ndryshojë pjesëmarrjen influencuese në një bankë. *Pika 6* e nenit *25*, mbi pavlefshmërinë ligjore të zotërimit të një pjesëmarrjeje influencuese në bankë nga një person, pa miratimin paraprak me shkrim të Bankës së Shqipërisë, përmbush kërkesat e nenit 16/5 të Direktivës 2000/12/BE dhe nenit 21/2 të Direktivës 2006/48/BE.

Një element i rëndësishëm është dhe dallimi me ligjin e vjetër, në të cilin specifikohet se në rast të zotërimit të një pjesëmarrjeje influencuese në bankë nga një person, pa miratimin paraprak me shkrim të Bankës së Shqipërisë, revokohej licenca (neni 13); në ligjin e ri, aksionerit në fjalë nuk i njihet e drejta e votës.

Neni 26 është një përmbledhje e rasteve të shpërndara në dispozita të ndryshme të ligjit të vjetër, duke shtuar edhe raste të tjera në të cilat bankat dhe degët e bankave të huaja duhet

të njoftojnë Bankën e Shqipërisë, për ekzistencën e fakteve apo vërtetimin e situatave me rrezik për vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e aktivitetit të tyre. Mund të përmenden rastet kur: arrihen kufijtë maksimalë të lejuar të ekspozimit, kërcënohet likuiditeti ose aftësia paguese e bankës dhe degës së bankës së huaj, pozicioni financiar i bankës ndryshon në atë masë sa banka nuk zotëron më kapitalin rregullator ose nuk zotëron më minimumin e raportit të mjaftueshmërisë të kapitalit, kapitali rregullator i bankës bie nën nivelin e kapitalit fillestar minimal të kërkuar për fillimin e veprimtarisë etj..

Pika 2 e këtij neni, mbi detyrimin e bankës ose degës së bankës së huaj për të informuar Bankën e Shqipërisë, në rastet kur ka ndryshime në strukturën organizative apo në selinë dhe adresën e saj si dhe në rastin e largimit të administratorëve, reflekton kërkesat e nenit 20/6 të Direktivës 2000/12/BE dhe nenit 26/3 të Direktivës 2006/48/BE.

Ndryshimi i vetëm i dispozitave të këtij neni me direktivat e sipërpërmendura, qëndron në afatin kohor. *Detyrimi për njoftim ndaj Bankës së Shqipërisë lind brenda 30 ditëve nga momenti i verifikimit të rasteve të mësipërme. Ndërsa në Direktivat e BE ky detyrim lind të paktën 30 ditë përpara marrjes së vendimit për ndryshimet e sipërpërmendura, me qëllim që t'i jepet autoriteteve kompetente koha e nevojshme për miratimin e tyre.*

Neni 27 sjell një risi në krahasim me ligjin e vjetër, përsa i përket detyrimit të bankës apo degës së bankës së huaj të licencuar, për të paguar komision të përvitshëm për vlefshmërinë dhe shfrytëzimin e licencës pranë Bankës së Shqipërisë. Shuma e këtij komisioni, mbetet për t'u përcaktuar në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë, çka sjell nevojën e rishikimit të rregullores "Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në RSH" (neni 14).

Neni 28, shton rastet, vërtetimi i të cilave përbën motiv për revokimin e licencës së bankave dhe degëve të bankave të huaja. Këtu mund të përmenden: shkelja e akteve ligjore dhe nënligjore që kanë shkaktuar një humbje të ndjeshme financiare,

shkelja e standardeve ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare për mbajtjen e kontabilitetit, ushtrimi i veprimtarive të cilat rrezikojnë likuiditetin dhe aftësinë paguese të bankës, pamundësia për të siguruar fonde të mjaftueshme dhe pamundësia për të përmbushur detyrimet ndaj kreditorëve, sidomos kur banka nuk jep më siguri për mjetet që i janë besuar asaj.

Pika 4 e nenit 28, në dallim nga ligji i vjetër, shton detyrimin për njoftim (në rast të revokimit të licencës) edhe për Agjencinë e Sigurimit të Depozitave. Kjo gjë duhet të pasqyrohet edhe në rregulloren "Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në RSH" (neni 10, pika 3). Rastet e revokimit të licencës (pika 1) dhe komunikimi i revokimit të licencës (pika 4), janë përgjithësisht në përputhje me nenet 14 dhe 17 përkatësisht të Direktivës 2000/12/BE dhe 2006/48/BE. Edhe *pika 1, gërma dh,* mbi mosfillimin e veprimtarisë nga banka ose dega e bankës së huaj, përkon (përsa i përket masës ndëshkuese) me nenet 14 dhe 17 të Direktivës 2000/12/BE dhe të Direktivës 2006/48/BE, por me dallimin se afati kohor i specifikuar në këto të fundit është 12 muaj nga marrja e licencës dhe jo 6 muaj, siç specifikohet në ligj.

I.III Kreu III "Organizimi, drejtimi dhe kontrolli i bankës dhe i degës së bankës së huaj".

Kreu III përcakton rregulla të qartë për mënyrën e organizimit, të drejtimit dhe të kontrollit të veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja, me qëllim krijimin e një sistemi bankar të shëndoshë dhe të sigurtë.

Neni 31 i ligjit, flet për pavarësinë e bankës dhe degës së bankës së huaj dhe vjen i përmirësuar dhe më i plotë, krahasuar me nenin përkatës të ligjit të vjetër (neni 16), pasi citon se: *Banka dhe dega e bankës së huaj, administrohen dhe drejtohen mbështetur në parimet e tregut të lirë dhe të konkurrencës së ndershme. Asnjë subjekt apo person publik nuk duhet të ndërhyjë në mënyrë të paautorizuar, për të ndikuar në administrimin dhe drejtimin e bankës ose degës së bankës së huaj, përveç rasteve të zbatimit të akteve nënligjore të Bankës së*

Shqipërisë, ekzekutimit të urdhrave të organeve gjyqësore ose kur një gjë e tillë parashikohet me ligj. Ky nen i njeh bankës të drejtën e operimit në treg bazuar në parimet e konkurrencës së ndershme. Në *nenin 32*, përcaktohen organet drejtuese të bankës dhe degës së bankës së huaj. Ndryshe nga dispozitat e ligjit të vjetër (neni 17), i cili shpreh se banka drejtohet vetëm nga këshilli drejtues, citohet se banka drejtohet jo vetëm nga ky i fundit, por edhe nga drejtoria, duke bërë edhe dallimin midis organeve drejtuese të bankës dhe atyre të degës së bankës së huaj (pika 4).

Neni 33 mbi aktet e brendshme që rregullojnë veprimtarinë e bankës dhe degës së bankës së huaj, në pikën 1/ç (kufijtë e kompetencave) vjen i zgjeruar, duke përfshirë jo vetëm administratorët dhe punonjësit e tjerë të bankës, por edhe çdo person që kryen veprime në emër dhe për llogari të saj. Gjithashtu, ky nen sjell edhe një risi, duke lejuar që aktet e brendshme të degës së bankës së huaj të përcaktohen në përputhje me aktet rregullative të mëmës, me kusht që të mos cënojnë legjislacionin shqiptar në fuqi.

Mendojmë se, një rëndësi të veçantë do të kishte hartimi i një rregulloreje mbi Qeverisjen e Korporatave, në të cilën të përcaktohen saktë proceset nëpërmjet të cilave institucionet krediduese drejtohen dhe kontrollohen si dhe të gjitha marrëdhëniet, jo vetëm raportuese por edhe ato kontrolluese, që ekzistojnë mes grupeve të interesit: aksionerëve, bordit drejtues, administratorëve si dhe të punësuarve apo personave të tjerë me të cilët institucioni ka marrëdhënie të ndryshme.

Neni 35 mbi përbërjen e këshillit drejtues, sjell një element të ri në pikën 2 të tij. Kështu, numri i anëtarëve, ndryshe nga ligji i vjetër (neni 19), i cili përcaktonte vetëm numrin minimal të tyre (pesë anëtarë), vendos edhe një numër maksimal prej nëntë anëtarësh. Gjithashtu, shton se anëtarët e parë të këshillit drejtues përcaktohen në statut (pika 3), në dallim nga ligji i vjetër që nuk e përmend një gjë të tillë. Elemente të reja që sjell ligji janë edhe kriteret për zgjedhjen apo rastet e shkarkimit të anëtarëve, duke përfshirë edhe procedurat që duhet të ndiqen në rastet e

vendeve bosh të krijuara nga vdekja apo dorëheqja e një ose disa anëtarëve të këshillit drejtues. Mund të përmendim *pikën 4*, ku citohet se*: të paktën një e treta e anëtarëve të këshillit drejtues duhet të zgjidhet nga individë, të cilët në çastin e zgjedhjes dhe gjatë gjithë kohëzgjatjes së mandatit, nuk janë të lidhur me marrëdhënie interesash privatë me bankën, me aksionerët që ushtrojnë kontroll mbi bankën ose me drejtuesit e saj ekzekutivë*. Për pasojë, këto elemente duhet të pasqyrohen në rregulloren "Për administratorët e bankave dhe degëve të bankave të huaja". *Neni 36* (mbledhjet e këshillit drejtues) dhe disa prej pikave të *nenit 37* (kompetencat kryesore të anëtarëve të këshillit drejtues) vijnë si elemente të reja në këtë ligj. Kështu, *neni 37, pika 1* përcakton në mënyrë të qartë kriteret dhe motivet prej të cilave anëtarët e këshillit drejtues duhet të udhëhiqen gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre. *Pika 2* përcakton përgjegjësitë e këshillit drejtues ndërsa *pika 3*, parashtron të drejtën që gëzojnë anëtarët e këshillit drejtues, për të kërkuar informacion "të përshtatshëm, të plotë dhe në kohë", me qëllim përmbushjen e përgjegjësive të tyre gjatë procesit vendimmarrës. Rrjedhimisht, këto risi duhet të pasqyrohen në rregulloren "Për administratorët e bankave dhe degëve të bankave të huaja".

Neni 38, pika 1 mbi komitetin e kontrollit përmban dispozita më të detajuara në krahasim me ligjin e vjetër përsa i përket rizgjedhjes, pasi një gjë e tillë nuk parashikohej në këtë të fundit. *Neni 38, pika 3* mbi kompetencat e anëtarëve të këtij komiteti, sjell elemente të reja në lidhje me: shqyrtimin e raporteve të kontrollit të brendshëm dhe monitorimin e trajtimit të përfundimeve të dala nga këto raporte; vlerësimin e situatës financiare të bankës, bazuar në raportin e ekspertit kontabël të autorizuar; dhe miratimin e raporteve dhe deklaratave financiare të përgatitura nga banka, me qëllim publikimin e tyre. *Këto ndryshime duhet të pasqyrohen edhe në rregulloren "Për kontrollin e brendshëm në banka dhe degët e bankave të huaja" (pika 6.4)*. Gjithashtu, në *nenin 38* janë shtuar edhe kufizime për anëtarët e komitetit të kontrollit (*pika 5*) si dhe detyrimi i komitetit të kontrollit për të raportuar përpara këshillit drejtues (*pika 8*). *Pika 6* i njeh komitetit të kontrollit të drejtën e zgjedhjes

të ekspertëve të jashtëm, ndryshe nga neni 20/3 i ligjit të vjetër, ku kjo kompetencë i takonte këshillit drejtues.

Neni 41, sjell më të zgjeruara kushtet skualifikuese për administratorët e bankave dhe degëve të bankave të huaja ku më konkretisht përmenden rastet në lidhje me: personat, të cilët zotërojnë më shumë se 5 për qind të aksioneve të një banke ose personi të lidhur me të; personat e punësuar pranë Bankës së Shqipërisë; personat e ndëshkuar nga Banka e Shqipërisë gjatë 5 vjetëve të fundit për shkelje të rëndë të këtij ligji ose për zhvillim të veprimtarisë pa licencën përkatëse të lëshuar nga Banka e Shqipërisë etj.. Gjithashtu, përjashtohen nga kryerja e detyrës së administratorit të një banke apo dege të bankës së huaj, personat të cilët shërbejnë ose kanë shërbyer në çdo kohë gjatë periudhës 5-vjeçare paraardhëse, si administrator i një banke apo dege të bankës së huaj, subjekt i procedurave të likuidimit të detyruar. Periudha e sipërpërmendur, ndryshon nga afati kohor prej 12-muajsh i përcaktuar në nenin 21 të ligjit të vjetër. *Të gjitha ndryshimet dhe risitë e sjella në nenin 41 mund të pasqyrohen edhe në rregulloren "Për administratorët e bankave dhe degëve të bankave të huaja" (neni 4).*

Neni 44, mbi parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave, përkufizon në mënyrë të saktë në *pikën 2* të tij, burimet e interesave privatë të administratorëve duke e shtuar numrin e tyre krahasuar me ligjin e vjetër me: dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale; negocime të mundshme për punësim apo për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat për administratorin në të ardhmen, pas lënies së detyrës si administrator, të kryer nga ai gjatë ushtrimit të detyrës si administrator në bankë; dhe angazhime në veprimtari të tjera private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie që krijon të ardhura. *Pika 5*, sjell si element të ri përgjegjësinë e këshillit drejtues për miratimin e akteve të brendshme mbi parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave, duke pasur të drejtën edhe të autorizimit të komiteteve *ad hoc* (të përbërë nga anëtarë joekzekutivë të këtij këshilli) për trajtimin e konfliktit të interesave në bankë. *Neni 46,* i cili flet për njësinë e kontrollit të brendshëm, vjen me elemente të reja përsa i përket kompetencave të këshillit drejtues për

përcaktimin e rregullave të funksionimit dhe ushtrimit të sistemit të kontrollit të brendshëm (pika 2), emërimit të anëtarëve të njësisë së kontrollit të brendshëm të degës së bankës së huaj nga organet vendimmarrëse të bankës mëmë (*pika 4*) dhe ndalimit të punonjësve të njësisë së kontrollit të brendshëm për të pasur funksione të tjera në bankë apo në degën e bankës së huaj (*pika 5*). Këto të fundit mund të pasqyrohen edhe në udhëzimin "Për kontrollin e brendshëm në banka dhe degët e bankave të huaja" (pika 6.3). *Neni 47* mbi detyrimin e bankës apo degës së bankës së huaj për raportim financiar, në pikat 1 dhe 2 të tij, thekson se banka apo dega e bankës së huaj duhet të mbajë llogaritë kontabël dhe të përgatisë raportet financiare mbi baza individuale ose të konsoliduara (në dallim nga ligji i vjetër, ku një gjë e tillë nuk përmendet) si dhe në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit. Këto kërkesa reflektojnë më së miri dhe dispozitat e Direktivës 2000/12/BE neni 22/1 dhe të Direktivës 2006/48/BE neni 29/1.

Pika 3 (çdo bankë dhe degë e bankës të huaj duhet të ketë procedura drejtimi, kontabiliteti dhe mekanizma të mjaftueshëm të kontrollit të brendshëm, mbi baza individuale ose të konsoliduara) dhe *pika 4* (mbi të drejtën e Bankës së Shqipërisë për të përcaktuar formën, tipin, metodologjinë, përmbajtjen e raporteve dhe kohën e raportimit të bankave ose degëve të bankave të huaja në Bankën e Shqipërisë) vijnë si elemente të reja në dallim nga ligji i vjetër.

Neni 48 për ekspertët kontabël të autorizuar, sjell për herë të parë të shprehur në ligj, faktin se dega e bankës së huaj mund t'i nënshtrohet kontrollit të ekspertit kontabël të autorizuar të bankës mëmë ose të një eksperti kontabël të autorizuar, të miratuar nga Banka e Shqipërisë (*pika 3*). *Pikat 6* dhe *7* të nenit, sjellin rishtas kufizime në lidhje me ortakun kryesor në një shoqëri auditimi, që është ekspert kontabël i autorizuar dhe për shoqërinë e auditimit të përzgjedhur si ekspert kontabël i autorizuar. Rastet e mësipërme përcaktohen tashmë në tekstin e ligjit dhe jo nëpërmjet akteve nënligjore, duke theksuar në këtë mënyrë rëndësinë e tyre. *Pika 5* e nenit në fjalë, përcakton se eksperti kontabël i autorizuar ose ortaku kryesor në një

shoqëri auditimi, duhet të zëvendësohet nga kryerja e auditimit brenda një periudhe maksimale prej 7 vjetësh dhe mund të rimarrë pjesë në auditimin e bankës apo degës së bankës së huaj, pas mbarimit të një afati kohor prej të paktën dy vjetësh. Këto elemente të reja duhet të pasqyrohen në rregulloren "Për ekspertët kontabël të autorizuar të bankave" neni 8, pika 8.1.

Në *nenin 49* mbi auditimin e ekspertit kontabël të autorizuar, zgjerohen kompetencat për kontrollin dhe vlerësimin e ekspertit kontabël të autorizuar, të cilat duhet të shtohen edhe në rregulloren "Për ekspertët kontabël të autorizuar të bankave", përkatësisht për politikat e fshirjes së zërave të bilancit; raportet e konsoliduara; regjistrimet kontabël; saktësinë dhe plotësimin e raporteve të paraqitura pranë Bankës së Shqipërisë dhe mjaftueshmërinë e procedurave kontabël e zbatimin e rregulloreve. *Neni 50 pika 1*, shton detyrimin e ekspertit kontabël të autorizuar për t'i paraqitur kopje të raportit të auditimit edhe asamblesë së aksionerëve. *Pika 2* përcakton në mënyrë më të detajuar rastet, për të cilat eksperti kontabël i autorizuar duhet të njoftojë menjëherë Bankën e Shqipërisë, për situata apo fakte të cilat vendosin në rrezik veprimtarinë e bankës. Këto raste duhet të shtohen edhe në rregulloren "Për ekspertët kontabël të autorizuar të bankave". *Pikat 4* (detyrimi për njoftim i ekspertit kontabël ndaj Bankës së Shqipërisë edhe për fakte apo vendime të një subjekti, të cilat ai i konstaton gjatë kryerjes së detyrës së tij në këtë subjekt, i cili është person i lidhur me bankën) dhe *5* (njoftimi i Bankës së Shqipërisë nga eksperti kontabël i autorizuar nuk përbën shkelje të kufizimeve të konfidencialitetit si dhe nuk ngarkon me asnjë lloj përgjegjësie ekspertin e autorizuar kontabël), *janë elemente të reja të ligjit dhe vijnë në përputhje të plotë me nenet 31, pikat 1/b; 31/2; 53/1 dhe 53/2 të Direktivave 2000/12/BE dhe 2006/48/BE*.

Neni 53 i ligjit (mbi transparencën), përcakton se banka ose dega e bankës së huaj duhet të publikojë raporte periodike për gjendjen e saj financiare dhe pozicionin ndaj rreziqeve, të paktën një herë në 3 muaj, si dhe faktin që banka duhet të përgatisë dhe publikojë raportin e saj mbi baza vjetore. Ky nen parashtron nevojën e rikonceptimit të udhëzimit "Mbi transparencën e

operacioneve dhe shërbimeve bankare" ose krijimin e një rregulloreje të re mbi transparencën si dhe përputhet me kërkesat e neneve 145/1 dhe 147/1 të Direktivës 2006/48/BE (ku afati kohor i përcaktuar është mbi baza minimalisht njëvjeçare).

I.IV Kreu IV "Veprimtaritë e lejueshme për bankat dhe degët e bankave të huaja".

Në këtë kre renditen veprimtaritë bankare dhe financiare të lejueshme për bankat dhe degët e bankave të huaja, dokumentacioni i kërkuar për t'u mbajtur nga këto të fundit si dhe dokumentacioni lidhur me transaksionet e kredisë.

Neni 54 bën një dallim midis veprimtarive bankare dhe financiare, që mund të kryhen nga bankat dhe degët e bankave të huaja si dhe veprimtarive financiare, që mund të kryhen jo vetëm nga këto të fundit por edhe nga subjektet financiare jobanka *(neni 126)*. Pikërisht një ndarje e tillë jepet në pikën 2 të këtij neni, i cili në dallim nga neni 26 i ligjit të vjetër sjell një konceptim të ri lidhur me ushtrimin e këtyre veprimtarive. Pika 2 e nenit 54, nuk kushtëzon ushtrimin e këtyre veprimtarive me pajisjen, domosdoshmërisht, me një nivel të caktuar kapitali, por zgjeron kompetencën e njësive organizative brenda Bankës së Shqipërisë[10] për të gjykuar nëse subjektet e këtij ligji duhet të lejohen për të ushtruar veprimtari të caktuara financiare që në momentin e licencimit apo qoftë edhe më pas, me kërkesë të vetë subjektit.

Në dallim nga ligji i vjetër (neni 26), neni 54 i ligjit të ri zgjeron gamën e veprimtarive financiare që mund të ushtrohen nga bankat dhe degët e bankave të huaja. Këtu mund të përmendim: kredinë konsumatore, kredinë hipotekore, *factoring*-un, financimin e transaksioneve tregtare, si dhe shërbimet e pagesave ku përveç kartave të kreditit dhe të debitit përfshihen edhe kartat e pagesave.

Veprimtaritë financiare të renditura në nenin 54 pika 2, janë në përputhje të plotë me veprimtaritë e listuara në Aneksin I të Direktivës 2000/12/BE dhe Aneksin I pikat 2-14 të Direktivës 2006/48/BE.

I.V Kreu V "Administrimi i rrezikut".

Qëllimi i Kreut V është përcaktimi i rregullave të qartë për administrimin e rreziqeve që ndesh dhe ndërmerr banka apo dega e bankës së huaj, gjatë kryerjes së veprimtarisë së saj. Ky kre është konceptuar si kre më vete dhe përmban rregullime më të detajuara krahasuar me ligjin e vjetër.

Neni 59 mbi kapitalin rregullator, mjaftueshmërinë e kapitalit dhe garancitë, përbën një rikonceptim të nenit 30 të ligjit të vjetër. Në *pikën 3,* shprehet se raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit rregullator përcaktohet në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë, por sidoqoftë ai është jo më pak se 8 për qind, duke e përcaktuar tashmë në ligj një vlerë të tillë [11.] Gjithashtu, *pika 6* e nenit shprehet se raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit llogaritet mbi baza individuale ose të konsoliduara, në përputhje kjo edhe me nenet 40/2 dhe 40/3 të Direktivës 2000/12/BE, në të cilat po ashtu shprehet një fakt i tillë. *Pika 4* (shprehet se në raste të veçanta, Banka e Shqipërisë, me akte nënligjore, ka të drejtë të përcaktojë një raport të mjaftueshmërisë së kapitalit më të lartë, nëse konstaton se banka ushtron ose përfshihet në veprimtari me rrezik të lartë) *përputhet me nenet 47/1 dhe 47/2 të Direktivës 2000/12/BE, e cila citon se: institucionet krediturese duhet të mbajnë në mënyrë të vazhdueshme një raport të mjaftueshmërisë së kapitalit prej të paktën 8 për qind. Pavarësisht nga sa më sipër, autoritetet kompetente, mund të caktojnë një raport minimal më të lartë nëse e gjykojnë të arsyeshme.*

Pika 7 (mbi detyrimin e degës së bankës së huaj për të investuar një pjesë të kapitalit të saj fillestar minimal të dhuruar në disa aktive si depozita në Bankën e Shqipërisë, letra me vlerë të emetuara nga Këshilli i Ministrave ose Banka e Shqipërisë dhe aktive me rrezik të vogël), *pika 8* (mbi kriteret e investimit të kapitalit të saj fillestar minimal të dhuruar) dhe *pika 9* (mbi garancitë për shlyerjen e detyrimeve të degës së bankës së huaj ndaj të tretëve në Republikën e Shqipërisë), janë *elemente të reja* të shtuara në këtë ligj. Si rrjedhim, lind nevoja e trajtimit më specifik të tyre në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

Neni 60 në pikën 2 shprehet se llogaritja e aktiveve të ponderuara me rrezikun, duhet të kryhet sipas koeficientëve të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë. Por ndryshe nga ligji i vjetër, parashikon të drejtën e bankave, që me miratimin e Bankës së Shqipërisë të mund të përdorin modele apo metoda të brendshme për vlerësimin e rrezikut të kredisë. Pikërisht, *pika 3* e këtij neni (mbi të drejtën e bankës, kundrejt miratimit nga Banka e Shqipërisë, për të zbatuar metoda dhe modele të tjera për vlerësimin e rrezikut të kredisë, tregut dhe rreziqeve të tjera) përputhet me nenin 84/1 të Direktivës 2006/48/BE.

Neni 64 mbi ekspozimin maksimal të lejueshëm, sjell një risi në *pikën 2* të tij sepse ul ekspozimin maksimal ndaj personit ose grupit të personave të lidhur me bankën nga 30 për qind në 25 për qind (në rastin kur personi ose grupi i personave të lidhur është shoqëria mëmë, filial i bankës apo një ose më shumë filiale të shoqërisë mëmë). Gjithashtu, përcaktohet tashmë me ligj edhe fakti se ekspozimi i bankës ndaj personave të lidhur me të nuk mund të tejkalojë 10 për qind të kapitalit të saj rregullator (pika 3). Këto elemente duhet të pasqyrohen edhe në rregulloren përkatëse. *Pika 1* (ekspozimi i bankës ndaj një personi ose personave të lidhur me të nuk mund të tejkalojë 20 për qind të kapitalit rregullator), *pika 2* (kur personi ose grupi i personave të lidhur është shoqëria mëmë, filial i bankës apo një ose më shumë filiale të shoqërisë mëmë, ekspozimi nuk mund të tejkalojë 25 për qind të kapitalit rregullator) dhe *pika 4* (banka nuk merr përsipër ekspozime të mëdha, të cilat, të marra së bashku, tejkalojnë 700 për qind të kapitalit rregullator) ndryshojnë nga dispozitat e direktivave të BE. *Më konkretisht, në nenin 49 të Direktivës 2000/12/BE dhe 111 të Direktivës 2006/48/BE, përqindjet e përcaktuara janë përkatësisht 25 për qind, 20 për qind dhe 800 për qind.*

Neni 68 mbi rezervat për mbulimin e humbjeve dhe *neni 70* mbi investimet në kapital, përmenden edhe në ligjin e vjetër, por tashmë paraqiten në mënyrë më të detajuar. *Pika 1* shprehet se: *banka mund të investojë në blerjen e aksioneve të shoqërive tregtare që nuk janë banka apo institucione financiare ose të marrë pjesë si ortak në këto shoqëri tregtare, por ky investim, në*

çdo rast, nuk duhet të jetë më i madh se 15 për qind e kapitalit rregullator të bankës dhe *pika 2,* e cila shprehet se: *investimi maksimal i lejuar i një banke në disa shoqëri tregtare, që nuk janë banka apo institucione financiare, ose pjesëmarrja si ortak në këto shoqëri tregtare nuk mund të jetë më i madh se 60 për qind e kapitalit rregullator të bankës,* janë në përputhje dhe me kufijtë e përcaktuar në nenet 51/1, 51/2 të Direktivës 2000/12/BE dhe nenet 120/1, 120/2 të Direktivës 2006/48/BE.

I.VI Kreu VI "Mbikëqyrja".

Kreu VI përmban dispozita të përgjithshme në lidhje me procesin e mbikëqyrjes së veprimtarisë bankare dhe financiare, që ushtrohet nga bankat dhe degët e bankave të huaja.

Neni 72 përcakton qartë dhe në mënyrë të përmbledhur mënyrat e realizimit të mbikëqyrjes, në dallim nga ligji i vjetër, në të cilin këto mënyra janë të nënkuptuara. *Neni 73* mbi mbikëqyrjen e bankës, degës së bankës së huaj dhe degës së bankës jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, ndryshe nga ligji i vjetër, në *pikën 5* iu jep të drejtën nëpunësve të autorizuar të autoritetit mbikëqyrës të një vendi tjetër, të ngarkuar për mbikëqyrjen bankare në atë vend, që në marrëveshje me Bankën e Shqipërisë, të lejohen të inspektojnë një bankë që është degë ose filial i bankës së huaj, e cila ka drejtorinë qendrore në atë vend apo që ka pjesëmarrje influencuese në bankën e huaj, selia e së cilës është në atë vend. Kjo pikë vjen në përputhje me kërkesat e neneve 43/1 dhe 139/2 të Direktivës 2006/48/BE ku shprehet parimi i bashkëpunimit reciprok me vendin e origjinës, me qëllim ushtrimin e mbikëqyrjes së institucionit kreditues. Gjithashtu, edhe *pikat 6* (mbi lejimin e kontrollit dhe bashkëpunimin me inspektorët e Bankës së Shqipërisë dhe me ekspertët kontabël të autorizuar, të miratuar nga Banka e Shqipërisë) dhe *7* (për informimin e Bankës së Shqipërisë nga dega e bankës së huaj mbi emrat e aksionerëve dhe pjesëmarrjet përkatëse në kapitalin e bankës së huaj të paktën një herë në vit) të këtij neni, vijnë në përputhje me nenet 141/1 dhe 21/1 të Direktivës 2006/48/BE. *Neni 79 dhe neni 81*, për zbatimin e rregullave për administrimin e rrezikut dhe për zbatimin e kërkesave për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit,

në dallim nga *neni 44 i ligjit të vjetër* shprehin në mënyrë të qartë dhe të detajuar masat që ndërmerr Banka e Shqipërisë, në rastet kur konstaton shkelje të rregullave të administrimit apo kur raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit është më i ulët se raporti minimal, i përcaktuar në nenin 59 të këtij ligji. Gjithashtu, përcaktohet tashmë me ligj edhe detyrimi i bankave dhe degëve të bankave të huaja, për të përmbushur detyrimet ligjore lidhur me sigurimin e depozitave monetare (neni 79, pika 1/f dhe neni 80/f). Këto elemente, së bashku me detyrimin ligjor të sipërpërmendur, mund të pasqyrohen edhe në "Manualin e veprimeve korrigjuese ndaj bankave dhe degëve të bankave të huaja në RSH".

I.VI.I Nënkreu I "Mbikëqyrja e konsoliduar".

Ligji nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" trajton për herë të parë dhe si një nënkre më vete, mbikëqyrjen e konsoliduar, në përputhje me parimet e Komitetit të Bazelit mbi Mbikëqyrjen Bankare dhe me standardet e përcaktuara në direktivat e BE, për një mbikëqyrje të sigurtë dhe të kujdesshme. Në këtë nënkre, përcaktohen në mënyrë të detajuar elementet përbërëse më të rëndësishme të procesit mbikëqyrës mbi baza të konsoliduara të bankave dhe degëve të bankave të huaja. Dispozitat e këtij nënkreu, përkufizojnë konceptet e grupit bankar, financiar, shoqërive mbizotëruese dhe të varura. Gjithashtu, janë krijuar hapësirat e nevojshme ligjore për lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me autoritetet kompetente mbikëqyrëse vendase ose të një shteti tjetër, me qëllim rritjen e cilësisë së mbikëqyrjes së konsoliduar.

Në *nenin 84* mbi administrimin e rrezikut në një grup bankar, cilësohet se: *grupi bankar duhet të organizohet në mënyrë të tillë, që një bankë mbizotëruese në këtë grup të jetë e aftë të monitorojë rreziqet ndaj të cilave grupi bankar është i ekspozuar dhe të zbatojë masat për administrimin e këtyre rreziqeve*. Një element i tillë mund të pasqyrohet në rregulloren "Për mbikëqyrjen e konsoliduar", në kuadër të rritjes së cilësisë së mbikëqyrjes së konsoliduar (neni 8). Gjithashtu edhe pika 3/d, specifikon se: *grupi bankar duhet të përcaktojë pozicionin e konsoliduar edhe të investimeve në kapitalin e institucioneve*

jofinanciare, duke sjellë nevojën e reflektimit të këtij elementi në rregulloren e mësipërme, në nenin 7 të saj.

Neni 85 mbi konsolidimin e pasqyrave financiare të një grupi bankar në *pikën 2,* shprehet se shpeshtësia e konsolidimit duhet të përcaktohet me aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë. Një kërkesë e tillë duhet të përcaktohet edhe në rregulloren "Për mbikëqyrjen e konsoliduar" (neni 10). Gjithashtu, *pika 4* shprehet se Banka e Shqipërisë urdhëron një bankë në një grup bankar, që të kryejë konsolidimin e zërave të veçantë ose të operacioneve të veçanta, apo të një grupi operacionesh brenda grupit bankar, nëse kjo është e nevojshme për paraqitjen e plotë dhe objektive të pozicionit financiar dhe rezultatit operativ të grupit bankar në tërësi ose një banke të veçantë në grupin bankar. Kjo gjë, lind nevojën e pasqyrimit të këtyre elementeve edhe në rregulloren e sipërpërmendur (neni 10). *Neni 86* (konsolidimi në rastet e tjera) dhe *neni 88* (dorëzimi i të dhënave) janë elemente të reja, të cilat mund të reflektohen edhe në rregulloren "Për mbikëqyrjen e konsoliduar".

I.VI.II Nënkreu II "Sanksionet".

Banka e Shqipërisë, në rolin e autoritetit mbikëqyrës të sistemit bankar, ka të drejtë të ndërmarrë masa ndëshkimore ndaj bankave, degëve të bankave të huaja dhe subjekteve financiare jobanka, në raste shkeljesh të ligjit dhe/ose të akteve nënligjore të nxjerra prej saj. Masat ndëshkimore, në dallim nga masat parandaluese, mbikëqyrëse, masat për zbatimin e rregullave të administrimit të rrezikut si dhe masat për zbatimin e kërkesave për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit synojnë jo vetëm korrigjimin e mangësive ose dobësive të vërejtura gjatë ushtrimit të aktivitetit bankar, por edhe përputhjen e veprimtarisë së subjektit të licencuar me standardet e një veprimtarie të sigurtë dhe të shëndoshë bankare e financiare. Subjekt i masave të sipërpërmendura mund të jenë si organet drejtuese të bankës ashtu edhe banka vetë.

Neni 89 mbi masat ndëshkimore, në dallim nga ligji i vjetër (neni 44) rendit në mënyrë të detajuar të gjitha rastet kur Banka e Shqipërisë vendos marrjen e masave ndëshkimore si: gjoba, vërejtje me paralajmërim me shkrim për administratorët e bankës

ose degës së bankës së huaj, duke arritur deri në masa ekstreme si revokimi i licencës së bankës ose degës së bankës së huaj apo vendosja e saj në kujdestari ose likuidim. Në *pikën 6*, ligji përcakton një kusht të ri përsa i përket raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit. Në nenin 44/3 të ligjit të vjetër, Banka e Shqipërisë u kërkonte aksionerëve rregullimin e situatës nëse ky raport binte nën gjysmën e raportit minimal të kërkuar. Me ligjin e ri, Banka e Shqipërisë ndërhyn me masa ndëshkimore nëse ky raport është më shumë se gjysma e raportit minimal të kërkuar, por më pak se raporti minimal i kërkuar, duke aplikuar kështu masa më prudente. Një ndryshim i tillë, mund të pasqyrohet edhe në Manualin e Veprimeve Korrigjuese, në pjesën përkatëse të Mjaftueshmërisë së Kapitalit.

Neni 91 mbi detyrimin për ruajtjen e sekretit profesional, në *pikën 1* të tij, *në dallim nga ligji i vjetër,* detyron tashmë edhe inspektorët ose nëpunësit e tjerë të Bankës së Shqipërisë për të ruajtur sekretin profesional, *në përputhje kjo edhe me nenin 30 të Direktivës 2000/12/BE dhe nenet 44/1 dhe 44/2 të Direktivës 2006/48/BE mbi ruajtjen e këtij sekreti. Por, në dallim nga direktivat e mësipërme, ligji i ri e zgjeron këtë detyrim edhe për administratorët, të punësuarit apo dhe agjentët aktualë e të mëparshëm të bankës apo degës së bankës së huaj dhe jo vetëm për punonjësit e autoritetit mbikëqyrës apo auditorët dhe ekspertët e bankës apo degës së bankës së huaj.*

Nenet 93/1 dhe 93/2, në dallim nga neni 44, pika 1 e ligjit të vjetër, i cili njeh të drejtën e ankimimit të drejtpërdrejtë në gjykatë brenda tetë ditëve nga njoftimi i vendimit, përcakton si *kusht paraprak rekursin administrativ pranë Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë*, me qëllim lindjen e së drejtës për ankimim gjyqësor. *E drejta e ankimimit gjyqësor shprehet edhe në nenet 33 të Direktivës 2000/12/BE dhe 55 të Direktivës 2006/48/BE.*

I.VII. Kreu VII "Kujdestaria dhe likuidimi".

I.VII.1Nënkreu I: Kujdestaria.

Ky nënkre përmend rastet e vendosjes së bankës në kujdestari, efektet juridike të kujdestarisë, kushtet kualifikuese dhe skualifikuese

të kujdestarit, kompetencat, detyrat dhe raportimet e tij si dhe përfundimin e procesit të kujdestarisë.

Ligji i ri në *nenin 89 pika 4/ç, në dallim nga neni 44 pika 2/f i ligjit të vjetër, nuk parashikon tashmë marrjen në administrim dhe kontroll të bankës nga Banka e Shqipërisë,* por përmend kalimin e bankës në kujdestari si një nga masat ndëshkimore të aplikuara ndaj saj prej Bankës së Shqipërisë. *Si pasojë, nevojitet rishikimi i udhëzimit "Mbi kujdestarinë dhe likuidimin e bankave" në pikat 22-27.*

Neni 96, në *pikat 3 dhe 4* në dallim nga ligji i vjetër, parashikon edhe publikimin e vendimit të kalimit të bankës në proces kujdestarie në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë, si dhe në një ose më shumë gazeta kombëtare. Banka e Shqipërisë e dërgon vendimin në bankën për të cilën është marrë vendimi si dhe në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave. Vendimi i Bankës së Shqipërisë për vendosjen e bankës në kujdestari, përfshihet edhe në regjistrin për konsultim nga publiku që mbahet në Bankën e Shqipërisë. *Neni 99* mbi kushtet kualifikuese të kujdestarit, *përcakton këto të fundit me ligj tashmë,* duke theksuar rëndësinë e tyre, dhe jo më vetëm nëpërmjet akteve nënligjore të Bankës së Shqipërisë. *Neni 100* mbi kushtet skualifikuese të kujdestarit, *risi kjo e ligjit të ri*, në *pikën 1* të tij rendit rastet kur një person nuk mund të emërohet kujdestar. *Të gjitha këto kushte skualifikuese duhet të reflektohen në udhëzimin përkatës.*

Ligji i ri parashikon në një nen të veçantë, *neni 102*, raportimet periodike që kujdestari duhet të bëjë në Bankën e Shqipërisë, gjë e cila *në ligjin e vjetër është parashikuar në mënyrë indirekte* (neni 49, pika 7).

Neni 104/1 mbi vlerësimin çdo 3 muaj të rezultateve të procesit të kujdestarisë, sjell disa *rikonceptime të ligjit të vjetër* (neni 50) *dhe udhëzimit "Mbi kujdestarinë dhe likuidimin e bankave" (pika 12), duke sjellë detyrimin për përafrimin e udhëzimit në fjalë me kërkesat e ligjit të ri.*

I.VII.II Nënkreu II: Likuidimi.

Ky nënkre trajton fazat nëpërmjet të cilave kalon banka dhe dega e bankës së huaj në rast të vendosjes së tyre në proces likuidimi (vullnetar apo i detyruar), duke filluar që nga momenti fillestar e për të arritur më pas në shitjen e bankës dhe raportimin në Bankën e Shqipërisë.

Neni 106 mbi llojet e likuidimit, për herë *të parë dallon likuidimin vullnetar nga ai i detyruar, ndryshe nga ligji i vjetër* i cili në interpretimin e tij duket sikur i referohet vetëm atij të detyruar.

Nenet 107/3 dhe 107/4, theksojnë rëndësinë e mbrojtjes së interesave të klientëve të bankës ose degës së bankës së huaj, duke u fokusuar në dy drejtime: i pari, nëpërmjet njoftimit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave në lidhje me likuidimin, për t'i dhënë kësaj të fundit mundësinë e ushtrimit të kompetencave ligjore për garantimin e depozitave të kreditorëve; i dyti nëpërmjet detyrimit të aksionerëve, të cilët në rast likuidimi të bankës ose degës së bankës së huaj, duhet të shlyejnë të gjitha pretendimet e ngritura prej kreditorëve të tyre. *Përsa më sipër, këto elemente të reja duhet të pasqyrohen në udhëzimin "Mbi kujdestarinë dhe likuidimin e bankave". Neni 108* mbi rrethanat për vendosjen e likuidimit të detyruar, saktëson dhe zgjeron kushtet që lidhen me kalimin e bankës apo degës së bankës së huaj, në likuidim të detyruar. *Neni 115* mbi pavarësinë dhe ruajtjen e konfidencialitetit nga likuidatori, *është një nen i ri i veçantë,* i cili njeh të drejtën e ushtrimit të pavarur të veprimtarisë nga ana e likuidatorit si dhe detyrimin e tij për të respektuar ruajtjen e sekretit profesional. *Neni 120* mbi detyrimet e pretenduara, *pika 3* vjen si një *element i ri* duke përcaktuar në mënyrë të qartë gjykatën e apelit, si organi kompetent ku mund të kryhet ankimimi i pretendimeve të bankës ose degës së bankës së huaj ndaj vendimit të Bankës së Shqipërisë për vendosjen e tyre në proces likuidimi, në dallim nga ligji i vjetër, i cili nuk shprehet konkretisht lidhur me organin përgjegjës. *Neni 121* mbi rradhën e shlyerjeve të detyrimeve, në *pikën 1* të tij rendit, përveç të tjerave, edhe detyrimin për të shlyer përpara detyrimeve të tjera, *pretendimet e ASD-së.*

I.VIII. Kreu VIII: Dispozita përfundimtare.

Ky kre i ligjit në dallim nga ligji i vjetër, trajton një sërë elementesh të reja si: mbrojtja e klientit dhe ruajtja e sekretit të informacionit mbi të; subjektet financiare jobanka; mbrojtja ligjore gjatë ushtrimit të detyrës dhe karakteri ekzekutiv i akteve administrative të Bankës së Shqipërisë.

Neni 125 mbi ruajtjen e sekretit të informacionit për klientin, përforcon më tej mbrojtjen e interesave të këtij të fundit, duke *përcaktuar për herë të parë me një dispozitë ligjore, parimin e ruajtjes së këtij informacioni*. Kjo bëhet nëpërmjet përfshirjes së këtij detyrimi në përmbajtjen e marrëveshjes ose kontratës të lidhur ndërmjet bankës ose degës së bankës së huaj dhe klientit *(pika 2)*. Ky nen meqënëse vjen si një element i ri i ligjit, *mund të reflektohet në udhëzimin "Mbi transparencën e operacioneve dhe shërbimeve bankare". Neni i mësipërm vjen në përputhje me nenet 30 dhe 44 përkatësisht të Direktivës 2000/12/BE dhe 2006/48/BE*.

Neni 127, në dallim nga ligji i vjetër, parashikon për herë të parë krijimin dhe mbajtjen nga Banka e Shqipërisë të *Regjistrit të Kredive*. Qëllimi i ngritjes së këtij regjistri është të ndihmojë bankat për të marrë vendime të bazuara mbi informacion të plotë dhe të saktë në rastet kur japin kredi në favor të klientëve të tyre, si dhe të forcojë mbikëqyrjen e Bankës së Shqipërisë mbi sistemin bankar në Shqipëri.

Së fundmi, në *nenin 132 pika 1 zgjerohet gama e individëve, subjekt i mbrojtjes ligjore* gjatë ushtrimit të detyrës duke përfshirë edhe punonjës të tjerë[12] të Bankës së Shqipërisë, përveç anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës dhe administratorëve.

Përsa më sipër, mund të konkludojmë se dispozitat e ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", në përgjithësi kanë reflektuar kërkesat e dispozitave të shprehura në Direktivën 2000/12/BE dhe Direktivën 2006/48/BE.

SHËNIME

* Punuan: Juna Bozdo dhe Irini Kalluci, specialiste, Zyra e Kërkimit dhe Konsistencës, Departamenti i Mbikëqyrjes.

[1] Ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" nr.9662, datë 18.12.2006, në vijim do t'i referohemi me termin "ligji".

[2] Nëse një institucion kreditues i një shteti anëtar, dëshiron të hapë një degë në një shtet tjetër anëtar, duhet të disponojë paraprakisht miratimin e autoritetit mbikëqyrës të vendit të origjinës. Ky i fundit, brenda 3 muajve duhet të njoftojë autoritetin mbikëqyrës të vendit pritës për një fakt të tillë. Pas ushtrimit të mbikëqyrjes, nga autoriteti pritës, mbi institucionin në fjalë, brenda një afati kohor dymujor jepet miratimi ose refuzimi mbi hapjen e degës (shiko nenet 4, 20/1, 20/4 të Direktivës 2000/12 dhe nenet 6, 25, 26 të Direktivës 2006/48).

[3] Host country.

[4] Home country.

[5] Rregullorja "Mbi mbikëqyrjen e degëve të bankave të huaja".

[6] Të rishikohet edhe emërtimi i kësaj rregulloreje duke përfshirë edhe termin "veprimtari financiare".

[7] Për më tepër informacion, mund t'i referoheni neneve 6, 7, 20 të Direktivës 2000/12/BE dhe neneve 11, 12, 21, 25 të Direktivës 2006/48/BE.

[8] Për më tepër informacion, mund t'i referoheni neneve 7, 21 të Direktivës 2000/12/BE dhe neneve 12, 19, 25, 28, të Direktivës 2006/48/BE.

[9] Kjo është një risi e ligjit dhe si e tillë duhet të reflektohet në hartimin e një akti të ri nënligjor, mbi kushtet e lidhjes së marrëveshjeve.

[10] Zyra e Licencimit pranë Departamentit të Mbikëqyrjes, Banka e Shqipërisë.

[11] Vlera e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit e shprehur në ligjin e ri, i referohet vetëm bankave. Përsa i përket degëve të bankave të huaja do t'i referohemi rregullores "Për mbikëqyrjen e veprimtarisë së degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë".

[12] Si për shembull, inspektorët e Bankës së Shqipërisë.

AKTIVITETI KREDITUES: MUNGESA DHE PRURJET E NJË FAKTORI TË RËNDËSISHËM ZHVILLIMI

*Elona Bollano**
Gerond Ziu

Fjalë kyçe
- Sistem bankar - Kreditim - Investime - Depozita -

ZHVILLIMET E SISTEMIT BANKAR DHE ECURIA E KREDISË

HYRJE

Roli i sistemit financiar në sektorin real të ekonomisë është një çështje e debatuar dhe e studiuar gjerësisht në literaturën ekonomike. Përfundimet e ndryshme dhe shpeshherë kontradiktore, që kanë arritur studiues të ndryshëm kanë nxitur debatet midis ekonomistëve. Një grup i madh ekonomistësh, midis tyre edhe disa ekonomistë që kanë fituar çmimin Nobel, konsiderojnë se rëndësia që i është dhënë sistemit financiar si faktor që çon në rritje ekonomike është e mbivlerësuar, ndërkohë që ky sistem ka më tepër një funksion mbështetës në ekonomi pasi "sipërmarrja drejton – financa ndjek" (Levine 2004). Ndërkohë, gjatë viteve të fundit, gjithmonë e më shumë ekonomistë po paraqesin evidenca empirike që tregojnë një lidhje të fortë dhe pozitive midis funksionimit të sistemit financiar dhe rritjes afatgjatë ekonomike, dhe se vendet që kanë sistem bankar dhe tregje që funksionojnë më mirë, rriten më shpejt. Duke vazhduar më tej, evidenca në nivel mikro qartëson se zbutja e kufizimeve për financim është një nga kanalet përmes

të cilit sistemi financiar ndikon në rritjen e firmave dhe zhvillimin ekonomik[1].

Një sistem financiar për të kryer funksionet e tij mund të bazohet në institucionet bankare dhe në tregjet e kapitalit. Në varësi të tipareve ekonomike një vend mund të jetë më i orientuar apo të ketë më të zhvilluara institucionet bankare ose tregjet e kapitalit. Në përgjithësi, në vendet në zhvillim, si institucionet bankare e jobankare ashtu edhe tregjet e kapitalit janë më pak të zhvilluara dhe sistemi financiar ka tendencën të bazohet në sistemin bankar (Demirgüç – Kunt dhe Huizinga 2000). Me zhvillimin ekonomik të vendit zhvillohen paralelisht edhe institucionet e sistemit financiar, por ka një tendencë të përgjithshme, jo pa përjashtime (për shembull, Gjermania apo Japonia), që në vendet e pasura tregjet financiare të zhvillohen me ritëm më të shpejtë (Demirgüç – Kunt dhe Levine 2001).

Në vendin tonë funksionet e sistemit financiar kryhen thuajse tërësisht me ndërmjetësinë e bankave, si i tillë sistemi financiar identifikohet me sistemin bankar. Gjatë dy viteve të fundit, aktiviteti i sistemit bankar është rritur ndjeshëm, pesha e totalit të aktiveve ndaj PBB-së, në fund të vitit 2006 është rritur me mbi 30 për qind, krahasuar me peshën në fund të vitit 2004. Rëndësia që po i japin bankat aktivitetit të kredisë ka nxitur zhvillimin dhe ka bërë më dinamik si sistemin bankar ashtu edhe ekonominë. Procesi i kreditimit nuk realizon thjesht shpërndarjen e burimeve ekonomike në projektet më fitimprurëse duke ndikuar në rritjen ekonomike, por ky është një proces i cili në vetvete mbart edhe rreziqe. Rreziqet janë të lidhura jo vetëm me institucionin që e ndërmerr këtë aktivitet, por mund të transmetohen edhe në ekonomi. Në këto kushte, ka rëndësi evidentimi i mundësive dhe i rreziqeve që paraqiten me qëllim hartimin e politikave të duhura, për të përfituar sa më shumë prej mundësive dhe për të eliminuar apo kufizuar rreziqet.

Sistemi bankar shqiptar ka një histori zhvillimi prej afro 15 vjetësh. Megjithë luhatjet e zhvillimit gjatë gjysmës së parë të këtyre viteve, hovin më të madh ky sistem e mori pas krizës ekonomike të vitit 1997 dhe rregullimit të aktivitetit bankar me

ligjin e vitit 1998. Vitet e para të tranzicionit u karakterizuan nga reforma strukturore dhe ndërtimi i kornizave ligjore e institucionale. Miratimi në vitin 1998 i ligjit mbi rregullimin e aktivitetit të sistemit bankar, finalizoi periudhën e "ndërtimit të themeleve" strukturore dhe ligjore të sistemit dhe i hapi rrugën zhvillimeve normale të aktivitetit operacional të bankave. Zhvillimet pas kësaj periudhe u karakterizuan nga hapja e bankave të reja dhe thellimi gradual i ndërmjetësimit financiar, që u arrit nëpërmjet ofrimit të produkteve të reja dhe rritjes së bazës së kreditimit. Ky i fundit, është evidentuar si një nga aktivitetet më të vrullshme të viteve të fundit dhe ushtron ndikim të madh jo vetëm në aktivitetin bankar, por në të gjithë ekonominë e vendit. Këta faktorë kanë tërhequr vëmendjen tonë për një vështrim më të thelluar.

Bazuar në literaturë dhe në përvojën e vendeve të tjera, do të përpiqemi që të analizojmë ecurinë e aktivitetit të kreditimit, duke evidentuar impulset e aktivitetit dhe disa nga arsyet që ndikuan në zhvillimin e vrullshëm në vitet e fundit përfshirë karakteristikat strukturore të këtij aktiviteti. Gjithashtu, do të përpiqemi që të identifikojmë mundësitë dhe rreziqet që mund të evidentohen, si rrjedhojë e zhvillimeve të vrullshme, pasojë e aktivitetit të kreditimit dhe të zhvillimit të sistemit bankar.

SHKAQET E RRITJES SË KREDISË DHE KARAKTERISTIKAT E PORTOFOLIT TË KREDISË

SHKAQET E RRITJES SË KREDISË

Në një studim, të Cottarelli, Dell'Ariccia, Vladkova-Hollar (2003) mbi ecurinë e kredisë në vendet e Evropës Juglindore, Shqipëria është përkufizuar si një "bukuroshe e fjetur". Ky përcaktim është bazuar mbi faktin se gjatë periudhës 1998–2002, pesha e kredisë për ekonominë në prodhimin e brendshëm bruto ka qenë më pak se 1 për qind, një ndër më të ultat e ekonomive evropiane në tranzicion. Ndërkohë, kreditimi ka pësuar ndryshim pas vitit 2002 duke patur një rritje relativisht

të kënaqshme deri në vitin 2004 dhe një rritje shumë të fortë gjatë dy viteve në vijim; 75 për qind në vitin 2005 dhe 55 për qind në vitin 2006. Aktualisht, kredia ndaj ekonomisë në fund të vitit 2006, llogaritet të zërë mbi 20 për qind të PBB-së.

Në literaturë identifikohen dy forca të cilat mund të ndikojnë në rritjen e aktivitetit të kredisë: rritja e ofertës dhe rritja e kërkesës. Një faktor i rëndësishëm që nxit kërkesën është rritja e produktivitetit (Keeton 1999). Burim i ofertës për kredi është sistemi bankar apo institucionet e tjera financiare jobanka, ndërsa nga ana e kërkesës rreshtohen individët dhe firmat e biznesit.

Rritja e kredisë nga ana e ofertës është rezultat i politikave nxitëse që mund të ndjekin institucionet financiare për aktivitetin kreditues, si ulja e normave të interesit apo zbutja e standardeve të kredisë për shembull, kërkesat për kolateral apo praktikat e vlerësimit të situatës financiare të bizneseve. Nga ana tjetër, rritja e kredisë mund të jetë rezultat i kërkesës së shtuar nga ana e huamarrësve, pra nga ana e kërkesës. Kërkesa e shtuar e huamarrësve mund të bazohet në rritjen e produktivitetit, si pasojë e projekteve më të mira apo e përmirësimeve teknologjike, apo bazuar në një sërë faktorësh të tjerë të lidhur me situatën e tyre financiare.

Për një periudhë disavjeçare, bankat tregtare kanë ndjekur një strategji konservatore biznesi. Fondet e mbledhura nga publiku, në formën e depozitave, përgjithësisht janë investuar në bono thesari apo në instrumente të ngjashme, me siguri të lartë dhe normë të ulët kthimi. Kredia për ekonominë, si për bizneset ashtu edhe për individët, ka qenë e kufizuar, normat e interesave kanë qenë të larta dhe procedurat të gjata e shumë të kujdesshme. Të dhënat në tabelën e mëposhtme tregojnë se kredia për sektorin publik ka qenë e vogël, madje ka ardhur në rënie. Ndërkohë, kredia për sektorin privat, ndonëse paraqitet në nivel të lartë ndaj totalit të portofolit të kredisë, ka qenë e ulët për shkak të nivelit të ulët të investimit të aktiveve në kredi (tabela 1).

Tabelë 1. Struktura e kredisë sipas shpërndarjes (në % ndaj portofolit të kredisë).

	2001	2002	2003	2004	2005	2006
Struktura e kredisë së brendshme						
Kredia e brendshme (% M3)			71.5	68.9	70.0	71..8
Kredia për qeverinë (% M3)			60.2	55.1	48.9	43.4
Kredia për ekonominë (% M3)			11.3	13.8	21.1	28.4
Struktura e portofolit të sistemit bankar						
Sektori publik	1.95	0.1	0.3	0.17	0.05	0.09
Sektori privat	83.31	81.4	75.2	68.82	69.41	66.91
Individë dhe të tjerë	14.75	18.5	24.5	31.01	30.54	33.00

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Privatizimi i bankës më të madhe të sistemit, në vitin 2004, i detyroi bankat që të rishikonin strategjitë e biznesit. Aktiviteti, i cili e ndjeu më shumë ndryshimin në politikat e ndjekura ishte kreditimi. Kështu, pjesa më e madhe e bankave filloi që të zbatojë një politikë më aktive kreditimi të ekonomisë. Në këtë kuadër, strategjia që u ndoq prej bankave në përgjithësi, përfshinte lehtësimin e procedurave, uljen e normave të interesit dhe shtimin e shërbimeve të ofruara. Të gjitha këto kishin si synim rritjen e portofolit të kredisë dhe forcimin e pozitave në treg.

Nga ana e huamarrësve, kërkesa ka qenë më e qëndrueshme, e lartë dhe me tendencë rritëse. Pavarësisht qëndrimit konservator të mbajtur nga sistemi bankar, kostove të larta dhe gamës së vogël të shërbimeve të ofruara, bizneset dhe individët i janë drejtuar sistemit bankar për të financuar konsumin, investimet apo edhe për të rregulluar nevojat për likuiditet në periudhën afatshkurtër.

Duke u bazuar në dinamikën e ofertës dhe të kërkesës për kredi, mund të thuhet se rritja e shpejtë e kredisë gjatë viteve të fundit është një produkt i kombinimit të shtimit të ofertës në kushtet e një kërkese të lartë. Rritja e konkurrencës në një ambient të qëndrueshëm makroekonomik dhe me kërkesë të lartë për kredi, krijoi forcën e nevojshme shtytëse për sistemin bankar, që të bëhej aktiv në procesin e kreditimit të ekonomisë.

Më konkretisht, disa nga faktorët kryesorë që kanë ndikuar në rritjen e nivelit të kreditimit në Shqipëri vlerësojmë se janë:

- Stabiliteti makroekonomik. Një ambient i qëndrueshëm ekonomik me rritje të lartë të prodhimit të brendshëm bruto dhe me inflacion të ulët, krijon një mjedis të favorshëm për rritjen e kredisë (Duenwald, Gueorguiev and Schaechter, 2005). Gjatë dekadës së fundit, vlerësohet se Shqipëria ka arritur një situatë të stabilizuar makroekonomike; prodhimi i brendshëm bruto është rritur në mënyrë të qëndrueshme, gjatë periudhës 1999–2005 PBB-ja reale është rritur mesatarisht me 6.5 për qind dhe inflacioni është mbajtur brenda zonës së synuar, duke u luhatur rreth nivelit 3 për qind. Rritja ekonomike është shoqëruar me ulje të papunësisë dhe me rritjen e të ardhurave për frymë të popullsisë. Duke qenë se Shqipëria është një ekonomi në trazicion dhe synon të bëhet pjesë e Bashkimit Evropian, ekonomia dhe të ardhurat do të vazhdojnë të rriten për të konverguar drejt standardeve perëndimore. Siguria që sjell ky proces dhe ambienti i qëndrueshëm makroekonomik, kanë bërë që zhvillimet e ardhshme të jenë më lehtë të parashikueshme. Rritja e sigurisë ka ndikuar si vendimet e individëve dhe firmave për të financuar konsumin, dhe investimet me anë të kredisë ashtu edhe vendimet e bankave për të akorduar më shumë kredi dhe për të ulur interesat (tabela 1).

Tabelë 2. Disa tregues makroekonomikë.

	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006
Rritja reale e PBB-së (%)	8.9	7.7	6.5	4.7	6	6	5.5	5.0
PBB për frymë (usd)		1086	1329	1,438	1,807	2,329	2,620	2,855
Inflacioni mesatar (v/v)	-1	4.2	3.5	1.7	3.3	2.2	20.	2.5
Norma e papunësisë		16.9	14.6	15.8	15.0	14.6	14.2	13.8
Deficiti buxhetor (% PBB-së)	12.3	9.4	8.0	6.2	4.6	4.5	3.3	3.2
Llogaria korrente (% PBB-së)		- 7.0	- 6.1	-10.0	- 7.9	- 4.8	- 7.3	- 7.6
Kredi / PBB (në %)	8.4	5.31	4.7	5.9	6.8	8.5	15.3	22.0
Rritja e kredisë (%)	12.7	-31.05	0.22	37.72	31.1	38.1	74.3	56.8
Norma interesit të kredisë (%)	25.5	25.5	25.5	25.5	25.5	25.5	25.5	25.5

Burimi: Banka e Shqipërisë.

- Rivendosja e besimit të publikut ndaj sistemit bankar. Niveli aktual i marrëdhënieve midis bankave dhe publikut është rezultat i një sërë faktorësh dhe ngjarjesh, pozitive

e negative, të ndodhura që nga krijimi i sistemit bankar. Ndër elementet me kah negativ mund të përmendim disa. Ajo që është komentuar shpesh për klientët e bankave, ka qenë baza e ulët e kulturës bankare. Kjo kulturë ka gjetur shprehjen në mosnjohjen e shërbimeve bazë bankare si dhe në shmangien e shlyerjes së detyrimeve të kredive. Kjo e fundit është nxitur edhe nga mënyra klienteliste e akordimit të kredive nga ana e ish-bankave në pronësi shtetërore. Ndërkohë që për bankat private ka qenë karakteristikë dhënia e kufizuar me kosto të lartë të kredive, duke krijuar përshtypjen për një trajtim jo të barabartë e preferencial të klientëve. Gjithashtu, gjatë viteve të tranzicionit, sistemi bankar është përballur me dy momente kritike, kriza e vitit 1997 dhe paniku i vitit 2002, të cilat lëkundën besimin e publikut ndaj sistemit bankar. Ngjarje të tilla kanë cënuar marrëdhëniet e besimit dhe kanë frenuar publikun që ta konsideronte bankën si një partner në veprimtarinë e tij.

- Ndërkohë që elementet me kah pozitiv ndikimi, kanë qenë më të forta. Politikat e matura, të ndjekura si nga bankat ashtu edhe nga autoriteti mbikëqyrës, kanë sjellë rritje të vazhdueshme të sistemit bankar dhe qëndrueshmëri në veprimtarinë financiare, veçanërisht vitet e fundit. Zhvillimi i sistemit ka krijuar kushtet për përmirësimin e besimit të publikut ndaj bankave. Rritja e konkurrencës dhe hyrja në tregun bankar e bankave me reputacion ndërkombëtar, kanë ndikuar në konsolidimin e besimit të publikut ndaj bankave, i shprehur në formën e rritjes së depozitave dhe të përdorimit të gjerë të produkteve të ofruara. Afrimi i publikut në sportelet e bankave, ka aktivizuar ndërveprimin e faktorëve të lidhur, besim – kulturë bankare. Zhvillimet e viteve të fundit kanë treguar se mendimi i hershëm që kreditë ndaj bankave edhe mund të mos paguhen, ka ndryshuar rrënjësisht. Ndërgjegjësimi për detyrimet financiare ka sjellë kthimin e besimit reciprok dhe zgjatjen e zgjerimin e mëtejshëm të marrëdhënieve të biznesit midis bankës dhe klientit.
- Baza e ulët e kreditimit të ekonomisë, *catching-up,* hipoteza e rritjes për shkak të bazës së ulët (shih tabelën

2, raporti kredi ndaj PBB-së). Një nga arsyet e rritjes së kredisë është e lidhur edhe me vetë bazën shumë të ulët të kredisë për ekonominë në vend. Zhvillimi i ulët ekonomik, i kombinuar me ndikimin e krizave, politikave konservatore të administrimit të rrezikut, të ndjekura nga bankat e huaja, kufizimi në aktivitetin kreditues i vendosur nga Banka e Shqipërisë për disa banka si dhe sjellja / mosbesimi i publikut, ndikuan negativisht në zhvillimin e sistemit bankar, në përgjithësi dhe në aktivitetin e kreditimit për ekonominë, në veçanti. Përmirësimi apo eliminimi i këtyre pengesave, ka ndikuar natyrshëm në zhvillimin e bankave dhe në rritjen e aktivitetit.

- Efekti i pasurisë. Në literaturë është evidentuar një lidhje e ndërsjelltë empirike midis kredisë dhe çmimeve të pasurive të paluajtshme. Për një periudhë disavjeçare, çmimet e pasurive të paluajtshme në vend, janë rritur në mënyrë të vazhdueshme. Rritja e çmimeve ndikon në rritjen e kredisë nëpërmjet dy kanaleve: (i) rritjes së vlerës së kolateralit të ofruar për të siguruar kredinë. Pasuria e paluajtshme është një nga mjetet kryesore të përdorura si kolateral, kështu që ecuria e çmimeve të këtyre aktiveve është një përcaktues i rëndësishëm i kapacitetit huamarrës; (ii) pritjeve pozitive për të ardhmen, pasi pasuria e paluajtshme është një pjesë e rëndësishme e pasurisë së individëve dhe firmave. Ndryshimet në çmimet e aktiveve ndikojnë planet e shpenzimeve për konsum dhe për investime të konsumatorëve.
- Ndryshimet në strukturën e pronësisë dhe licencat e reja. Hyrja e bankave të reja në treg ka nxitur ndjeshëm konkurrencën. Bankat që kanë marrë licencat së fundmi, me synimin për të fituar sa më shumë pjesë tregu dhe për të afruar sa më shumë klientë, janë përpjekur që t'i ofrojnë publikut një gamë të gjerë shërbimesh. Por, ndikimin më të dukshëm në sistemin bankar e ka dhënë ndryshimi i pronësisë së bankës më të madhe në vend, e cila zinte një nga vendet e fundit në sistem për kredidhënien. Aktivizimi i fondeve të kësaj banke i ka dhënë një hov të rëndësishëm sasisë dhe larmisë së produkteve të ofruara. Shërbimi tipik i ofruar nga bankat

është kredia dhe, siç thamë më sipër, tregu ka qenë i etur për këtë shërbim. Megjithatë, lufta midis bankave të reja që tentojnë të rriten dhe bankave ekzistuese, të cilat përpiqen të mbajnë pozitat e tyre, ka ndikuar në rritjen e nivelit të kredisë. Aksionerët e huaj, të cilët janë zotëruesit më të mëdhenj të aksioneve të sistemit bankar, kanë sjellë në tregun shqiptar përvojën që vjen nga tregjet e konsoliduara evropiane dhe kanë nxitur konkurrencën, duke "i zgjuar nga gjumi" bankat e fjetura. Ndryshimi i pronësisë është një proces që vazhdon të zhvillohet me hyrjen në treg së fundmi të dy bankave të mëdha franceze dhe një italiane.

Tabelë 3. Numri i licencave të dhëna për banka (pas vitit 1997).

	1998	1999	2001	2002	2003	2004	2005	2006
Banka të reja	2	2	-	1	1	1	-	1
Ndryshimi i aksionerëve				1		1		2

Burimi: Banka e Shqipërisë.

- Struktura e bilancit të bankave. Siç tregohet në tabelën 4, aktivet e bankave kanë qenë të papërdorura për kreditim, prandaj rritja e kredisë pritet të jetë aktiviteti drejt të cilit bankat do të fokusohen (duhet patur parasysh se banka më e madhe e sistemit që zinte, më shumë se 50 për qind të aktiveve deri në vitin 2004, e kishte të ndaluar kreditimin e ekonomisë). Gjithashtu, bankat, gjatë viteve, kanë pasur norma të larta të mjaftueshmërisë së kapitalit[2], çka tregon mundësinë e tyre për të marrë përsipër aktivitete me rrezik. Megjithëse normat e përfitueshmërisë paraqiten të mira, burimet kryesore të të ardhurave kanë qenë të lidhura me vendosjet në bankat jashtë vendit, investimet në bonot e thesarit dhe komisionet nga shërbimet bankare.

Tabelë 4. Treguesit e ecurisë së sistemit bankar ndër vite.

	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006
Aktive sistemi/PBB		50.2	53.5	51.6	50.2	51.9	59.3	69.4
Mjaftueshmëria e kapitalit[2] (%)	8.2	42	35.3	31.6	28.5	21.6	18.6	18.1
ROA (Kthimi nga aktivet, %)	0.6	2.1	1.5	1.2	1.2	1.3	1.4	1.36
ROE (Kthimi nga kapitali, %)	16.4	20.7	21.6	19.1	19.5	21.1	22.2	20.2
Depozita / Pasive (%)			86.2	84.0	87.5	87.0	87.2	83.3
Kredi / Aktive (%)	16.4	10.4	8.9	11.5	13.6	16.4	25.7	31.5

Burimi: Banka e Shqipërisë.

KARAKTERISTIKAT E PORTOFOLIT TË KREDISË

- Struktura e kredisë sipas monedhës. Në ekonominë shqiptare, përdorimi i monedhave të huaja, veçanërisht i euros dhe dollarit amerikan, është gjerësisht i përhapur. Deri në vitin 2001, dollari amerikan konsiderohej si monedha më e rëndësishme dhe është përdorur në pjesën më të madhe të aktiviteteve tregtare si mjet për mbrojtjen nga rreziku i zhvlerësimit të monedhës vendase dhe për lehtësimin e transaksioneve me shoqëritë e huaja. Monedha amerikane e humbi gradualisht dominimin e saj me hyrjen e euros në Eurozonë, në vitin 2001. Kjo tendencë ndryshimi është reflektuar edhe në përbërjen e strukturës së depozitave, të cilat gjithashtu ishin të shumta në këto monedha. Për këtë arsye, bankat e kanë parë më të arsyeshëm përdorimin e këtyre monedhave në aktivitetin kreditues për të shmangur rrezikun e kursit të këmbimit dhe të normës së interesit. Stabiliteti i kursit të këmbimit, në njëfarë mënyre, ka qenë i lidhur me kujdesin e bankave në kryerjen e aktiviteteve me rrezik. Nga ana tjetër, bankat nuk kanë qenë të prirura për përdorimin e monedhës vendase në aktivitetin kreditues, duke qenë se të ardhurat që siguronin nga investimi në bono thesari kanë qenë të kënaqshme. Për këto arsye, monedhat e huaja kanë qenë dominuese në strukturën e stokut të kredisë. Për më tepër, publiku ka preferuar të marrë më pak hua në lekë, për shkak të normave të larta të interesit që aplikoheshin. Siç shihet edhe nga tabela e mëposhtme, tashmë kjo tendencë ka pësuar ndryshime. Qëndrueshmëria e monedhës, prania e likuiditeteve të shumta dhe rritja e konkurrencës, kanë çuar në rritjen e kreditimit në lekë.

Tabelë 5. Struktura e kredisë sipas monedhës (në % ndaj portofolit të kredisë).

	2001	2002	2003	2004	2005	2006
Portofoli i kredisë sipas valutës						
Kredi në lekë	18.3	20.9	17.9	19.5	24.5	28.1
Kredi në valutë	81.7	79.0	82.1	80.5	75.6	71.9
Portofoli i kredisë sipas maturitetit						
Kredi afatshkurtër	55.11	47.72	40.3	26.74	26.16	25.57
Kredi afatmesme	19.01	23.38	29.6	35.27	30.60	30.78

Kredi afatgjatë	5.40	7.56	9.2	15.75	23.15	19.03
Kredi për prona të patundshme	14.90	17.09	15.6	15.14	13.00	19.39
Kontrata qiraje	0.0	0.0	0.0	0.0	0.05	0.02
Të tjera	5.57	4.24	5.3	7.10	7.04	5.21

Burimi: Banka e Shqipërisë.

- Struktura e kredisë sipas maturitetit. Fillimisht, për shkak të zhvillimit të ulët ekonomik, aktiviteti kreditues ka qenë i bazuar në huatë afatshkurtra që shërbejnë si burim financimi për kapital qarkullues për bizneset. Aktiviteti tregtar me vendet e tjera është gjerësisht i përhapur në ekonomi dhe financimi afatshkurtër ka qenë mëse i pranueshëm, duke gjetur përputhje me ciklin e biznesit. Ndërkohë që më të pakta kanë qenë financimet afatgjata të kryera nga bizneset. Zhvillimet e viteve të fundit kanë treguar se tendenca ka ndryshuar ndjeshëm në strukturën e stokut të kredisë sipas maturitetit dhe shihet se kreditimi afatgjatë ka fituar terren. Rritja e investimeve në ekonomi dhe investimet e individëve në blerjen e apartamenteve të banimit, kjo e fundit ka patur edhe ndikimin më të ndjeshëm, kanë nxitur këtë proces. Fillimisht mund të merrej një kredi deri në 5 vjet, tani afati i kredisë mund të shkojë deri në 20 vjet.
- Struktura e kredisë sipas sektorëve të ekonomisë. Nga tabela e mëposhtme mund të shihet se kreditë për prona të patundshme janë rritur ndjeshëm duke patur parasysh se stoku i kredisë në vitin 2005 është rritur me 82 për qind. Megjithatë, kreditë për sektorët e ekonomisë si industria dhe shërbimet kanë rënë, pavarësisht zhvillimeve të brendshme të tyre. Kredia për sektorin e bujqësisë, pavarësisht rritjes, vazhdon të mbetet e ulët. Kredia më e përshtatshme për këtë sektor, në kushtet e sotme, do të ishte ajo mikro, të cilën bankat nuk kanë mundur ta mbështesin, për shkak të infrastrukturës dhe shpenzimeve që kërkon. Ndërkohë, të dhënat tregojnë se ndërtimi vazhdon të mbetet i rëndësishëm në ekonomi dhe aktualisht, tregu njeh rritje të kreditimit të pasuar nga rritja e çmimeve të pronave të patundshme.

Tabelë 6. Shpërndarja e kredive sipas sektorëve të ekonomisë (në % ndaj portofolit të kredisë).

Sektori i ekonomisë	2001	2002	2003	2004	2005	2006
Transport dhe Shërbime	58.4	57.7	57.8	43.8	36.8	
Industria	24.5	20.3	21.1	20.2	16.9	
Ndërtimi	12.5	8.6	10.0	9.8	13.0	
Pronat e patundshme	6.3	9.1	13.0	9.8	14.2	
Bujqësia	1.0	0.8	1.0	1.5	2.7	
Të tjera	0.8	7.7	5.1	19.3	22.1	

Burimi: Banka e Shqipërisë.

- Mbështetja e kredive nga depozitat. Bilancet e bankave tregojnë se raporti i kredive ndaj depozitave është i vogël dhe raporti i depozitave ndaj totalit të aktiveve është i lartë (tabela 4). Ky fakt përmendet për të treguar se i gjithë aktiviteti kreditues është mbështetur nga burimet e depozitave. Siç është përmendur edhe më lart, struktura e depozitave sipas maturitetit, ka ndikuar në strukturën e kredisë sipas maturitetit. Gjetja e burimeve të jashtme për të investuar në kredidhënie është përdorur rrallë nga bankat, për të mos thënë asnjëherë. Në banka të ndryshme, raportet e kredive dhe/ose depozitave ndaj totalit të aktiveve variojnë. Në bankat më të vogla, raporti i kredive ndaj aktiveve është më i madh ndërsa ai i depozitave ndaj aktiveve më i vogël, ndërkohë që e kundërta ndodh për bankat më të mëdha. Ky fakt është një tregues i pranisë së konkurrencës dhe i përpjekjeve që bëjnë bankat e vogla për të ruajtur pjesën e tyre të tregut. Këto zhvillime pritet të sjellin ndryshime në sistemin bankar si, bashkime bankash apo blerje të bankave më të vogla nga ato më të mëdha, siç është rasti i Bankës Amerikane dhe asaj Italo-Shqiptare.

Tabelë 7. Struktura e depozitave me afat sipas valutave (në % ndaj portofolit të kredisë).

	2001	2002	2003	2004	2005	2006
Depozitat pa afat në lekë	11.4	10.5	9.3	16.6	37.3	40.3
Sektori privat	7.1	6.6	4.5	6.0	8.7	11.3
Individët	1.3	1.3	1.6	6.5	24.3	23.9
Depozitat në valutë	42.6	44.0	47.3	55.4	72.7	94.0
Sektori privat	8.9	9.0	10.0	10.6	12.8	20.9
Individët	28.6	30.1	33.7	41.5	55.2	68.0

Burimi: Banka e Shqipërisë.

MUNDËSITË DHE RREZIQET

MUNDËSITË

Bankat konsiderohen si institucione të rëndësishme në vendet e zhvilluara. Zhvillimi i vrullshëm i tregjeve të kapitalit, zhvillimet teknologjike në shpërndarjen e informacionit kanë zbehur disi rëndësinë e këtyre institucioneve. Ndërkohë, në vendet në zhvillim këto institucione vazhdojnë që të konsiderohen parësore në procesin e ndërmjetësimit dhe të jenë faktor në rritjen ekonomike. Levine (2004) vlerëson se një sistem financiar zhvillohet kur instrumentet, tregjet dhe institucionet financiare përmirësojnë efektet e informacionit, rrisin zbatueshmërinë dhe zvogëlojnë kostot e transaksioneve. Shqipëria ka një sistem financiar pothuaj tërësisht të bazuar në banka dhe zhvillimi i këtij sistemi është ngushtësisht i lidhur me këto institucione. Privatizimi i bankës më të madhe në vend ka rritur ndjeshëm konkurrencën e sistemit, e cila ka nxitur një sërë reaksionesh zinxhir. Zgjerimi gjeografik, sasia dhe diversiteti i shërbimeve, publiciteti i vazhdueshëm janë pasojat e këtij fenomeni në rritje. Shtysa që i ka dhënë procesit të kanalizimit të fondeve të fjetura të bankave drejt ekonomisë është një pjesë shumë e rëndësishme e tërësisë së efekteve të gjeneruara. Kreditimi aktiv i ekonomisë i pritur prej kohësh, ndërsa përzgjedh projektet më fitimprurëse, gjeneron edhe një sërë efektesh pozitive, disa prej të cilave do të përpiqemi t'i trajtojmë më poshtë.

I parë nga një këndvështrim i ngushtë, një sistem financiar ka për qëllim kryesor të lehtësojë shpërndarjen dhe zhvillimin e burimeve ekonomike në kohë dhe në hapësirë, në një ambient të pasigurt ekonomik. Në fakt, identifikimi i sistemit financiar vetëm me procesin e shpërndarjes së kapitalit ekonomik nuk është plotësisht i saktë, pasi sistemi financiar (i) siguron sistemin e pagesave për këmbimin e të mirave; (ii) krijon mekanizma për të grumbulluar fonde, dhe (iii) për të transferuar këto fonde në kohë, në rajone dhe industri të ndryshme; (iv) siguron administrimin e pasigurisë dhe kontrollin e rrezikut; (v) siguron informacion që ndihmon koordinimin e një vendimmarrjeje të decentralizuar në sektorë të ndryshëm; dhe (vi) siguron mundësinë për të zbutur asimetrinë e informacionit dhe problemet e nxitjes, kur palët

e përfshira në një transaksion kanë informacione të ndryshme (Merton 1995).

Një nga problemet kryesore me të cilat një bankë përballet gjatë procesit të kreditimit është i lidhur me asimetrinë e informacionit. Ky si problem, ka të bëjë me pamundësinë e bankës që të disponojë të njëjtin informacion (informacionin e saktë) që ka huakërkuesi mbi kthimin e mundshëm dhe rrezikun e projektit. Kjo situatë krijon probleme në dy aspekte: fillimisht, përpara se të kryhet transaksioni, dhe quhet zgjedhja e pafavorshme apo "problemi i limonit"[3], dhe pasi është kryer transaksioni, rreziku moral (*moral hazard)*.

Situata e zgjedhjes së pafavorshme (*adverse selection*) ndodh kur huamarrësit e këqinj – të cilët kanë projekte të dobëta ekonomike dhe me rrezik të lartë – janë të prirur të pranojnë kushte jo të favorshme të kredisë. Këta kreditorë, duke pasur projekte me rrezik të lartë, janë të gatshëm që të pranojnë norma të larta interesi sepse në rast se projekti finalizohet me sukses, ata do të jenë të vetmit përfitues.

Situata e rrezikut moral mund të evidentohet pasi huamarrësi ta ketë marrë kredinë dhe lidhet me mundësinë e përfshirjes në aktivitete, që janë të papranueshme për huadhënësin, pasi rrisin rrezikun. Asimetria e informacionit midis huamarrësit dhe huadhënësit krijon kushtet për një situatë të tillë. Mungesa e njohurive nga ana e huadhënësit për të gjitha aktivitetet e huamarrësit i krijon mundësi këtij të fundit që të angazhohet në aktivitete që janë burim rreziku moral. Megjithatë, kjo situatë mund të mos jetë pasojë vetëm e asimetrisë së informacionit, por edhe e kostove të larta të zbatueshmërisë (*enforcement*), të cilat e pengojnë huadhënësin që të ndalojë huamarrësin, të përfshihet në aktivitete që përbëjnë rrezik moral edhe pse mund të jetë plotësisht i informuar mbi aktivitetet e të parit. Arsyet e rrezikut moral janë të lidhura me nxitjen që kanë huamarrësit që të investojnë në projekte me rrezik, të cilat, në rast se kanë sukses, i japin përfitimet vetëm për sipërmarrësin, por nëse dështojnë humbjet më të mëdha i kalojnë kreditorit.

Për të shmangur konfliktin e interesave që rrjedh nga zgjedhja e pafavorshme dhe nga rreziku moral, bankat/huadhënësit mund të zgjedhin që të mos akordojnë hua, duke ndikuar në uljen e kredisë dhe të investimeve në ekonomi. Megjithatë, bankat përdorin mënyra të tjera për të zvogëluar efektin e asimetrisë së informacionit, si për shembull kolaterali apo gjenerimi dhe shitja e informacionit mbi aktivitetin e individëve dhe të firmave.

Kolaterali zvogëlon pasojat e zgjedhjes së pafavorshme dhe të rrezikut moral sepse zvogëlon humbjet e bankës në rast mospagimi të huasë. Rëndësia e problemit të asimetrisë së informacionit zvogëlohet pasi huadhënësi ka të drejtën që të shesë kolateralin dhe të kompensohet për humbjet e mundshme, në rast se huamarrësi nuk e paguan huanë.

Gjenerimi dhe shitja e informacionit bëhet pasi huadhënësit kanë informacion të plotë mbi individët apo firmat që kanë nevojë për financim. Megjithatë, kjo është një zgjidhje e pjesshme pasi ekzistojnë *free-riders* – investitorë, të cilët nuk paguajnë, por përfitojnë nga informacioni që të tjerët blejnë[4]. Ekzistenca e këtyre investitorëve ul motivimin për blerjen e informacionit. Por, bankat mund të ndihmojnë në zvogëlimin e problemit të zgjidhjes së pafavorshme, pasi këto institucione mund të bëhen eksperte në gjenerimin e informacionit. Bankat kanë avantazh në mbledhjen e informacionit, pasi janë të përfshira në marrëdhënie afatgjata me klientët e tyre. Bankat si aktivitet kryesor kanë akordimin e huave dhe kanë të drejtën që të ushtrojnë kontroll e të vendosin kufizime në marrëveshjet që lidhin me kreditorët. Në këto kushte, bankat mund të monitorojnë ecurinë e projekteve dhe mënyrën e përdorimit të fondeve, duke zvogëluar efektin e rrezikut të moralit. Gjithashtu, bankat ndikojnë edhe në eliminimin e problemit të *free-rider,* pasi informacioni që ato grumbullojnë nuk mund të përdoret për qëllime fitimprurëse nga palë të treta.

Informacioni i siguruar nga bankat nuk përdoret vetëm për të eliminuar problemet e lidhura me asimetrinë e informacionit, por mund të përdoret gjatë procesit të vlerësimit të firmave, të drejtuesve dhe të situatës ekonomike. Bankat duke grumbulluar

informacion, ndihmojnë investitorët që të ulin kostot e tyre të kërkimit dhe të vlerësimit të projekteve dhe mbi të gjitha, ndikojnë në përmirësimin e procesit të shpërndarjes së burimeve ekonomike.

Në kontekstin e faktorëve që nxisin aktivitetin ekonomik të vendit, theksohet roli që kanë flukset e huaja në formën e investimeve direkte. Investimet e huaja direkte (IHD) ndikojnë në modernizimin dhe rritjen e ekonomisë duke transferuar teknologjinë, aftësitë administrative, *know-how*–n, duke rritur produktivitetin etj.. Megjithatë, vlerësohet se kontributi i IHD-ve varet nga karakteristikat e vendit pritës dhe në mënyrë të veçantë, nga niveli i zhvillimit të sistemit financiar. Sistemi financiar rrit eficiencën e shpërndarjes së burimeve, duke përmirësuar kapacitetin thithës të ekonomisë në lidhje me flukset e huaja dhe ndihmon në shpërndarjen e teknologjisë. Në kontekstin e vendit tonë, zhvillimet në sistemin bankar mund të ndikojnë në përmirësimin e ambientit ku operojnë sipërmarrjet e huaja. Praktika e veprimtarisë së bankave në vend tregon se në përgjithësi, bankat e huaja kanë prirjen të zhvillojnë biznes me klientët e vendit të tyre të origjinës. Gjithashtu, prezenca e këtyre bankave të huaja në sistem pritet të nxisë ardhjen e bizneseve prodhuese apo të shërbimeve nga vendet e origjinës, biznese të cilat janë klientë të bankës në këtë vend. Kështu, njohja që krijojnë bankat me tregun vendas, u transmetohet bizneseve të huaja në formën e konsulencës, duke iu këshilluar atyre sektorët më të zhvilluar, ata që kanë më shumë potenciale zhvillimi si dhe avantazhet konkurruese të ekonomisë vendase. Natyrshëm, kjo marrëdhënie do të shoqërohej me financimin e këtyre bizneseve nga ana e bankës.

RREZIQET

Krizat financiare shpeshherë mund të jenë pasojat negative dhe të padëshiruara të aktiviteteve me rrezik që kryejnë institucionet bankare. Bankat administrojnë aktivitetin e përditshëm, duke u përpjekur të gjejnë një nivel optimal midis fitimit dhe sigurisë. Krizat vijnë për arsye të ndryshme dhe shfaqen në forma të ndryshme. Historikisht, kreditimi, që në zanafillën e evolucionit

të bankave e deri më sot, ka qenë konsideruar si aktiviteti që mbart më shumë rrezik ndër aktivitetet që kryejnë bankat. Në të njëjtën kohë, ai siguron edhe fitimet më të larta. Kjo është arsyeja që aktivitetit të kreditimit i dedikohet shumë kohë, hapësirë, përpjekje, burime njerëzore, informacion etj.. Më poshtë, do të trajtojmë disa nga rreziqet kryesore që rrjedhin nga aktiviteti i kreditimit.

PËRCAKTUESIT E RREZIQEVE

Eksperienca e shumë vendeve ka treguar se zhvillimet e sistemit financiar janë prociklike dhe një nga arsyet kryesore të kësaj sjelljeje të institucioneve financiare është e lidhur me rritjen dhe uljen e ofertës për kredi gjatë cikleve të biznesit të ekonomisë. Gjatë fazës së ekspansionit të ekonomisë, kreditimi rritet me ritme shumë të larta, për t'u ulur ndjeshëm në fazat në vazhdim, kur ekonomia fillon të tkurret. Kreditimi mund të ulet aq shumë sa të konsiderohet si "shtypja e kredisë"[5]. Zakonisht, ndryshimet në kreditim janë proporcionalisht më të mëdha se sa ndryshimet në aktivitetin ekonomik, pra mund të thuhet se ndryshimet në ofertën për kredi kanë tendencën që të theksojnë ciklin e biznesit. Krahas uljes së nivelit të kredisë gjatë fazës së kontraktimit të ekonomisë, vihet re edhe një përkeqësim i treguesve të performancës së kredive, pasi edhe kreditë me probleme ndjekin ciklin e ekonomisë. Treguesit e kredive me probleme janë shumë të ulët gjatë ekspansionit ekonomik, ndërsa fillojnë të bëhen më të dukshëm gjatë përfundimit të fazës së ekspansionit dhe rriten në mënyrë të ndjeshme në fazën kur ekonomia kontraktohet. Pra, rreziku i lartë që marrin përsipër bankat gjatë fazës së rritjes ekonomike, shfaqet më vonë pasi duhet disa kohë që të evidentohen kreditë me probleme.

Në literaturë paraqiten disa arsye që mund të shpjegojnë një sjellje të tillë nga ana e bankave, por arsyeja kryesore është e lidhur me sjelljen njerëzore ose më saktë me sjelljen irracionale të administratorëve të bankave. Sjellja irracionale e administratorëve mund të shpjegohet në kuadrin e katër teorive: miopisë fatkeqe/shkatërruese (Guttentag and Herring, 1984, 1986), sjelljes si turmë (Rajan, 1994), problemeve të agjencisë

dhe hipotezës së memories institucionale[6] (Berger and Udell, 2003).

Situata e miopisë fatkeqe shfaqet atëherë kur është e pamundur që të vlerësohet mundësia e ndodhjes së një ngjarjeje të ardhme. Një ngjarje e tillë mund të jetë rezultat i ndryshimeve ekonomike, i ndryshimeve në kornizën ligjore e rregullatore apo i një sërë situatash të tjera. Kështu, bankat i nënvlerësojnë rreziqet që kanë mundësi të vogël ndodhjeje. Si rrjedhim, kur aktiviteti ekonomik është në ekspansion, bankat rrisin kredinë dhe e ndërpresin kredinë në mënyrë drastike sapo aktiviteti ekonomik ngadalësohet, kur edhe ngjarjet e sipërpërmendura kanë më shumë mundësi që të ndodhin.

Teoria e sjelljes si turmë, mbështetet në idenë që administratorët e bankës shqetësohen vetëm për reputacionin dhe paraqitjen e tyre, në afat të shkurtër. Kjo sjellje, në mënyrë të veçantë, vihet re tek ata administratorë që nuk janë të suksesshëm apo janë duke humbur pjesë tregu në mënyrë të vazhdueshme, prandaj përpiqen që të ndjekin veprimet e ndërmarra nga kolegët e tyrë të suksesshëm. Kështu, për shembull, nëse disa banka të suksesshme kanë prirje të financojnë një sektor apo një grupim të caktuar huamarrësish, edhe administratorët e bankave jo aq të suksesshme, duke imituar të parët, do të tentojnë drejt të njëjtit grupim. Kjo sjellje, çon në një vlerësim të ngjashëm të klientëve pa marrë në konsideratë veçoritë e burimeve dhe kthimin e projekteve. Kjo do të rezultojë fillimisht në rritje të kredisë dhe kur aktiviteti ekonomik do të ngadalësohet, do të çojë në uljen e pagimit të kredisë dhe në rritjen e kredive me probleme. Pra, duket se qëllimet afatshkurtra të administratorëve për ruajtjen e pozicionit të tyre dalin, mbi qëllimin për performancën afatgjatë të bankës.

Teoria e kreut-agjencisë *(principal-agency)* mund të ketë dy këndvështrime. Nga njëra anë, janë aksionerët ata që shtyjnë administratorët drejt rritjes së aktivitetit. Aksionerët mund të zbatojnë skema të ndryshme për të shpërblyer rezultatet e administratorëve. Si bazë për shpërblim mund të përdoren treguesit e rritjes së bankës ose treguesit e

përfitueshmërisë. Nëse matësit sasiorë të performancës (rritja) mbizotërojnë ata cilësorë, mund të pritet një sjellje joracionale e administratorëve, pasi ata kanë prirje që të ndërmarrin aktivitet me rrezik të lartë; si për shembull të rrisin me ritme shumë të shpejta portofolin e kredisë, që ndikon në rritje për një periudhë të shkurtër kohe.

Nga ana tjetër, problemi i kreut-agjencisë mund të lindë edhe ndërmjet administratorëve të hierarkive të ndryshme brenda institucionit. Delegimi i detyrave dhe i përgjegjësive, pasohet nga përcaktimi i matësve të performancës për administratorët e niveleve të ulta. Edhe në këtë rast, zgjedhja e kujdesshme e matësve të performancës bëhet e rëndësishme për bankën, në marrjen e vendimeve të duhura, në përputhje me strategjinë e përgjithshme. Të gjithë këta faktorë ndikojnë në nivelin nxitës të këtyre administratorëve për realizimin e investimeve cilësore.

Berger dhe Udell (2003) kanë përpunuar një hipotezë, të cilën e quajnë "memoria institucionale". Sipas saj, kredimarrësit apo marrëdhëniet e këqija harrohen për dy arsye. Së pari, krijohet një boshllëk profesional dhe mungesë përvoje ndërsa disa prej punonjësve dalin në pension e të tjerë merren në punë. Së dyti, oficerët e kredisë i harrojnë gabimet e kaluara, duke krijuar siguri në vetvete dhe në marrëdhëniet me klientët, gjë që sjell mosmarrjen në konsideratë të faktorëve negativë.

Ekziston edhe një faktor tjetër që nxit rrezikun. Niveli i kolateralizimit të kredisë, në shumë raste, lë në hije analizën cilësore të klientit. Jiménez dhe Saurina (2004) i kanë bërë një analizë të detajuar këtij fenomeni. Niveli i lartë i kolateralit shërben si burim sigurie për oficerët e kredisë, duke bërë që t'i kushtojnë më pak vëmendje problemeve që mund të ketë klienti. Ky fenomen luhatet në varësi të karakteristikave të huamarrësit dhe të përvojës së bankës. Ndërsa në fillimet e bashkëpunimit, oficerët e kredisë tregohen më të vëmendshëm ndaj klientëve, në periudhën afatgjatë, kur bankat rriten lokalisht, mund të lindë asimetria informative që mund të shoqërohet me kërkesa për më shumë kolateral.

Lidhur me rreziqet, ka edhe disa faktorë të tjerë institucionalë që i përcaktojnë ato. Godlevski (2004) ka listuar faktorët e mëposhtëm që çojnë në kryerjen e aktiviteteve me rrezik:

- mangësi në politikën e kreditimit;
- mangësi në procesin e administrimit të rrezikut;
- mangësi në procedurat e kontrollit të brendshëm;
- mangësi në sistemin e identifikimit të kredive me probleme;
- qeverisje e dobët korporative;
- kredi të lidhura ose huamarrës të lidhur.

Të gjithë këta faktorë, edhe individualisht, janë përcaktues shumë të rëndësishëm, të cilët evidentojnë dobësitë e institucionit dhe krijojnë hapësirën për një dështim të mundshëm.

RREZIQET MIKROEKONOMIKE

Këto janë rreziqe të lidhura me institucionet individuale ose me vetë sektorin bankar. Ka dy mënyra për analizimin e tyre. Nga njëra anë, janë vendimet e administrimit ato që sjellin rreziqe të larta ose të pakontrolluara dhe nga ana tjetër, janë situata të përkeqësuara për shkak të rreziqeve aktuale, që çojnë në marrjen e masave shtrënguese ose reduktim të aktivitetit apo performancës. Ndërsa për rastin e parë kemi folur në pjesën e parë, më poshtë do të trajtojmë fenomenin e dytë, duke patur si referencë rritjen e kredive.

I pari dhe më i prekshmi është rreziku i kredisë. Ai konsiston në mospërmbushjen e detyrimeve nga ana e huamarrësit. Mospagimi në kohë i detyrimeve shkakton përkeqësimin e portofolit të kredisë. Prandaj, bankave u duhet të krijojnë rezerva për mbulimin e humbjeve, të cilat rëndojnë mbi fitimet. Niveli i lartë i kredive me probleme sjell reduktimin e aktivitetit kreditues, si për shkak të shtysave të brendshme për reduktimin e marrjes përsipër të rreziqeve ashtu edhe për shkak të masave shtrënguese, të marra nga autoriteti mbikëqyrës.

Krijimi i kredive me probleme ul ndjeshëm fitimet, rrjedhimisht kufizon aftësinë e akumulimit të kapitalit. Nivelet e ulta të kapitalit

dëmtojnë seriozisht zhvillimin e mëtejshëm të bankës ose më e pakta, ngadalësojnë rritjen në periudhën afatshkurtër. Për shkak të rreziqeve të aktivitetit, bankat duhet të plotësojnë kërkesat e bankës qendrore për mbajtjen e një niveli të caktuar të rrezikut të kredive, në raport me kapitalin. Ky nivel i ulët i kapitalit, në pamundësi të rritjes së tij prej aksionerëve, do të tkurrte ndjeshëm aktivitetin financiar të bankës dhe aftësinë e saj konkurruese. Në raste ekstreme, niveli i humbjeve do të çonte institucionin drejt falimentimit, duke shkaktuar pasoja edhe në sistemin bankar.

Paaftësia paguese e huamarrësve ndikon në aftësinë e bankave në përmbushjen e angazhimeve financiare ndaj palëve të treta. Ky efekt pasohet nga rreziku tjetër, ai i likuiditetit. Në rastin e Shqipërisë, bankat kanë qenë kryesisht të përqendruara në investimet me fitim më të ulët, por të sigurta, si bono thesari dhe vendosje afatshkurtra në bankat e tjera jashtë vendit. Ka patur raste kur investimet jashtë janë bërë edhe në tregje kapitali, por kriter kryesor ka qenë siguria. Kjo ka krijuar likuiditete të mjaftueshme për bankat dhe ka çuar në angazhim të vogël të tyre për një administrim aktiv të fondeve. Ndërsa situata është duke pësuar një ndryshim rrënjësor, siguria e kaluar e bankave ka filluar të priret drejt rrezikut. Shqetësimet mbi likuiditetin kanë bërë që bankat, të rishikojnë politikat e tyre të vjetra dhe të zgjerojnë diapazonin e marrëdhënieve me institucionet financiare brenda dhe jashtë vendit. Përputhja e maturiteteve midis aktiveve dhe pasiveve ka qenë një nga kërkesat e kontrollit të bankës qendrore, duke qenë se kreditë afatgjata krijojnë ato që quhen GAP-e (mospërputhje) maturiteti. Megjithëse kreditë aktualisht mbështeten totalisht mbi depozitat, ekziston një mospërputhje maturiteti midis tyre, niveli i të cilit ka ardhur në rritje. Arsyeja është se pjesa më e madhe e depozitave kanë një afat maksimal maturiteti deri në 1 vit, ndërsa një pjesë e mirë e kredive maturohen për një afat më të madh se 1 vit, madje në kreditë për shtëpi ky afat shkon deri në 20 vjet. Prandaj, rreziku dhe sfida kryesore e bankave është ruajtja e likuditeteve të mjaftueshme për të respektuar në kohë detyrimet ndaj depozituesve.

Duke qenë se struktura e kredive është e përbërë nga monedha të ndryshme atëherë rreziku i kursit të këmbimit është i

pranishëm. Struktura e kredive sipas monedhave është e diktuar si nga fondet e disponueshme ashtu edhe nga kërkesat e tregut. Në këtë situatë, bankat administrojnë fondet në monedha të ndryshme nëpërmjet atyre që quhen pozicione të hapura[7]. Niveli i pozicioneve të hapura përcakton nivelin e ekspozimit ndaj vlerësimit/zhvlerësimit të monedhave. Ndryshimet negative të kurseve të këmbimit dëmtojnë strukturën e aktiveve dhe pasiveve të bankave, duke përkeqësuar aftësinë e tyre paguese, situatën e likuiditetit dhe fitimet. Humbjet që akumulohen mbulohen nga fitimet apo kapitali i bankave dhe pamjaftueshmëria e tyre krijon kështu efektin domino, të lidhur me rreziqet e përmendura më sipër.

Një fenomen i konstatuar sot në Shqipëri është se për shumë kredimarrës ka një mospërputhje midis monedhës së kredisë dhe monedhës së fluksit hyrës të parave. Për shkak të politikës së bankave, kredimarrësit janë të detyruar të marrin kredi në një monedhë të ndryshme nga ajo që sigurojnë të ardhurat. Kështu që një zhvlerësim i monedhës në të cilën ata sigurojnë të ardhurat ndaj monedhës së kredisë, do të ulë aftësinë paguese për kredimarrësit dhe do të sjellë pagimin me vonesë ose mospagimin e detyrimeve ndaj bankave. Të pakta janë rastet kur bankat ua këshillojnë këtë klientëve dhe të paktë janë ata klientë, të cilët janë të ndërgjegjshëm për këtë rrezik. Në këto kushte, përpara bankave lind një përgjegjësi më e madhe për evidentimin e rreziqeve të tilla që në burim dhe marrjen e masave për shmangien e tyre.

Për më tepër, struktura e portofolit të kredisë sipas monedhave i ekspozon bankat edhe ndaj rrezikut të normës së interesit. Bankat i ndërtojnë politikat e tyre të normës së interesit mbi interesat bazë të monedhave në përdorim[8]. Zakonisht, bankat i japin kreditë mbi interesat bazë duke shtuar një marzh përkatës. Prandaj, përputhja e maturiteteve të aktiveve dhe pasiveve të së njëjtës monedhë, është e nevojshme për t'i mbrojtur bankat nga politikat makroekonomike të vendeve të origjinës së monedhës.

Të gjitha këto rreziqe, çojnë në një mungesë të fondeve të bankave. Kështu që, për të shmangur këtë mangësi, bankat

do të kërkojnë fonde nëpër tregje financiare apo te klientët. Por, mungesa e aftësisë paguese do të ketë pasoja serioze ndaj institucionit. Nga njëra anë bankat apo institucionet e tjera financiare do të jenë më pak të prirura të bashkëpunojnë dhe nga ana tjetër, mund të krijohet një mosbesim i madh tek publiku. Ky i fundit, i cili quhet panik, sjell atë që quhet rrjedhje e depozitave. Kjo situatë nuk është e dëmshme vetëm për një apo për disa institucione. Ajo do të prekte të gjithë sektorët, me pasoja serioze në ekonomi.

RREZIQET MAKROEKONOMIKE

Shqetësimet bankare dhe përkeqësimet ekonomike janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën. Deri tani, nuk është provuar ende se cila është ajo që shkakton tjetrën, por është pranuar gjerësisht se që të dyja ndikojnë njëra-tjetrën. Në këtë rast, është e qartë se janë dy kahe ku mund të drejtohet analiza e rrezikut. Ndërsa do të hedhim një vështrim mbi situatën ekonomike në tërësi, do të përfshijmë edhe lidhjen shkak-pasojë për të dyja kahet.

Në vlerësimin e zhvillimeve ekonomike, një nga karakteristikat e lidhura është cikli ekonomik. Ndërsa ekonomia dhe sektori bankar shqiptar janë në fazat e para të zhvillimit, që të dyja ndodhen në fazën e rritjes. Në një studim të FMN-së (2005) vlerësohet se sistemi financiar në Shqipëri nuk duket i cënueshëm nga goditjet afatshkurtra. Pavarësisht kësaj, rritja e ndjeshme e kredisë në dy vitet e fundit ka tërhequr vëmendjen e këtij institucioni. Ai në mënyrë të vazhdueshme ka rekomanduar rritjen e kontrolluar të kredive. Për të patur një rritje të kontrolluar, Banka e Shqipërisë ka vendosur disa masa shtrënguese që e lidhin rritjen e kredive me nivelin e kapitalit të bankave. Më konkretisht, janë konsideruar me rrezik të lartë rritjet e kredive mbi një nivel të caktuar, kështu që një bankë mund të japë më shumë kredi në rast se ka kapital të mjaftueshëm për të mbuluar këto rreziqe.

Kaminsky, Lizondo, dhe Reinhart (1998), në një shqyrtim të literaturës mbi krizat bankare, nxjerrin se pesë nga shtatë studime, evidentojnë rritjen e kredisë si përcaktuese të rëndësishme të krizave

bankare dhe/ose atyre të monedhave. Në të njëjtin studim ata gjejnë se tre nga katër *boom*-e krediduese janë të lidhura me krizat bankare dhe shtatë nga tetë prej tyre, me krizat e monedhave. Kaminsky dhe Reinhart (1999) e quajnë këtë ndërlidhje si *kriza binjake*. Në fakt, një monedhë do të përkeqësojë gjendjen financiare të bankës për shkak të pozicioneve të hapura që krijohen (shih shënimin 7). Për më tepër, gjendja financiare e huamarrësit do të përkeqësohet me krizën e monedhës që ai gjeneron të ardhurat. Është një fakt që shumë huamarrës në Shqipëri kanë rrjedhje të fluksit të parave në një monedhë të ndryshme nga ajo e kredisë. Kështu, zhvlerësimi i monedhës me të cilën ata gjenerojnë të ardhurat do t'i vërë në vështirësi likuiditeti gjë që si pasojë, do të ketë rritjen e kredive me probleme. Me rritjen e shpejtë të kredidhënies ky efekt pritet të jetë edhe më i madh.

Ndryshimet e normave të interesit mund t'i godasin bankat. Bankat i japin kreditë mbi norma interesi të indeksuara, por opsioni për t'i ndryshuar ato është zakonisht një vit. Në periudhën afatgjatë, bankat mund të jenë të mbrojtura nga ndryshimet e normave të interesit. Në periudhën afatshkurtër, ndryshimet e politikave makroekonomike lidhur me normat e interesit i ekspozojnë bankat ndaj këtij rreziku. Administrimi i normave të interesit është një funksion, të cilin bankat e kryejnë aktualisht, por mospërputhja e maturiteteve të aktiveve dhe pasiveve i ekspozon ato ndaj këtij rreziku.

Rritja e kredisë është e shoqëruar me rritjen e konsumit dhe të investimeve. Këta komponentë janë përgjithësisht të shoqëruar me rritjen e çmimeve, pra sjellin rritjen e inflacionit. Inflacioni, nga ana tjetër, dobëson qëndrueshmërinë financiare të ekonomisë dhe tek bizneset, kjo do të shfaqet në formën e uljes së të ardhurave dhe të fitimeve. Këto të fundit ndikojnë në pagimin me vonesë ose mospagimin e kredive, rrjedhimisht në krijimin e kredive me probleme.

Rritja e kredisë shoqërohet edhe me rritjen e vlerës së pronës së paluajtshme. Ndërsa treguesi i kredive për shtëpi rritet, një kërkesë më e lartë për apartamente do ta shoqërojë atë. Në shumicën e rasteve, këto shtëpi bllokohen në formën e garancive

në emër të bankave. Zakonisht, bankat bëjnë vlerësimin e këtyre garancive dhe gjithnjë kërkojnë që vlera e tyre të jetë më e lartë se vlera e kredisë. Jo shumë kohë më parë, Banka e Shqipërisë ka paralajmëruar mundësinë e rënies së vlerës së garancive në fjalë, e cila do ta linte të pambuluar një pjesë të kredisë si dhe do të shoqërohej me pasoja të tjera si vështirësi në ekzekutimin e tyre apo shitje me një vlerë shumë më të ulët se kredia.

Në një studim të FMN-së (2004) tregohet se *boom*-et kredituese shoqërohen me tatëpjeta ekonomike në tregjet në zhvillim. Është gjetur se *boom*-i kreditues shoqërohet me rritje të normave të brendshme të interesit dhe përkeqësim të deficitit të llogarisë korente. Në periudhat me konkurrencë të lartë dhe rritje të madhe të kredisë, bankat janë në nevojë për fonde. Një nga veprimet që mund të ndërmarrin ato, është sigurimi më i madh i depozitave nga publiku nëpërmjet rritjes së normave të interesit. Kjo sjellje është më tipike për bankat më të vogla që kanë më pak fonde. Në raste krizash, ato janë edhe më të brishtat dhe burimi kryesor i panikut dhe i rrjedhjes së depozitave.

Përkeqësimi i deficitit tregtar kanalizohet nëpërmjet rritjes së kërkesës së brendshme. Siç tregojnë edhe shifrat, deficiti i bilancit tregtar në Shqipëri është aktualisht i lartë dhe vazhdimisht në rritje. Rritja e konsumit dhe e investimeve për shkak të rritjes së kredisë, shoqërohet me rritje të importeve. Ekonomia vendase është e varur së tepërmi nga importet, kështu që ky zinxhir ndodhish mund të sjellë pasoja serioze në ekonomi, në formën e çmimeve dhe pagave të larta si dhe vlerësim real të monedhës vendase. Si përfundim, përkeqësimi i deficitit tregtar i pasqyruar në deficitin e llogarisë korente, vë në rrezik rritjen makroekonomike. Nga ana tjetër, një mjedis makroekonomik i dobët përcjell pasojat e tij në gjendjen financiare të shoqërive dhe individëve, duke rritur mundësinë e paaftësisë paguese të huamarrësve dhe rritjen e kredive me probleme.

PËRFUNDIME

Në këtë material u përpoqëm që të analizonim zhvillimet më të fundit në sistemin bankar, me një fokus të veçantë në

aktivitetin e kredisë. Kreditimi, aktiviteti që qëndron në bazë të zhvillimit të sistemit bankar, ka marrë hov të madh gjatë viteve të fundit. Vlerësojmë se stabiliteti makroekonomik, vendosja e besimit të publikut në institucionet bankare nën mbikëqyrjen e kujdesshme të autoritetit përgjegjës, krijuan kushtet për një aktivitet normal në sistemin bankar. Ky fakt i ndihmoi bankat të krijonin kapacitete financiare dhe njerëzore, të cilat nën ndikimin e rritjes së konkurrencës u materializuan në rritjen e aktivitetit kreditues për ekonominë. Rritja e konkurrencës dhe e kredisë nga ana tjetër, është shoqëruar edhe me thellimin e aktivitetit të ndërmjetësit të bankave, që vihet re në numrin produkteve të ofruara, në shtrirjen gjeografike etj..

Zhvillimet në sistemin bankar pritet që të transmetohen edhe në sektorin real të ekonomisë. Duke ofruar më shumë produkte dhe shërbime, bankat i ndihmojnë klientët e tyre në procesin e kursimit dhe të investimit duke nxitur kështu rritjen ekonomike. Gjithashtu, sistemi bankar mund të përmirësojë ambientin ku operojnë firmat vendase dhe të huaja si dhe të nxisë ardhjen e kapitalit të huaj në vend. Por, nga ana tjetër, rritja e madhe e kredisë rrit shkallën e rrezikut. Trendi i kredisë, në përgjithësi, ndjek trendin e ekonomisë, i lartë në ekspansion dhe i ulët në recension, ndërkohë, matësit e performancës kanë të njëjtën sjellje po me kah të kundërt. Pra, rreziqet që bankat janë duke marrë në këtë fazë, e cila konsiderohet si faza e rritjes ekonomike, do të evidentohen plotësisht në momentin që aktiviteti ekonomik do të ngadalësohet. Krahas këtij efekti, rritja e pakontrolluar e kredisë, mund të rrisë presionet inflacioniste, të përkeqësojë bilancin tregtar dhe të rrisë ekspozimin e ekonomisë ndaj goditjeve që mund të vijnë nga zhvillimet në tregjet e huaja, të lidhura me luhatjet e pafavorshme të kursit të këmbimit dhe me rritjen e normave të interesit.

Vetë institucionet bankare janë subjekt i krizave individuale, si pasojë e zgjedhjeve të pafavorshme apo edhe e vetë situatës me rrezik, ku janë përfshirë. Në këto kushte, bëhet e domosdoshme ndërhyrja në kohë dhe me maturi e autoriteteve monetare e mbikëqyrëse, në drejtim të mbajtjes nën kontroll të pasojave negative dhe kanalizimit të zhvillimeve drejt rritjes së qëndrueshme.

SHËNIME

* Elona Bollano, Departamenti i Politikës Monetare; Gerond Ziu, Departamenti i Mbikëqyrjes, Banka e Shqipërisë.

[1] Për një analizë më të plotë të studimeve mbi lidhjen e financës me rritjen ekonomike mund t'i referoheni Ross Levine, 2004, "Finance and growth: Theory and evidence", JEL Numbers: G0, O0.

[2] Kjo normë përdoret për qëllimet e mbikëqyrjes. Llogaritet si norma midis kapitalit rregullator të bankës dhe aktiveve të ponderuara me rrezikun. Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri mbi bankat, kërkohet që ky raport të jetë minimalisht 8 për qind, nga 12 për qind që ka qenë më parë.

[3] Zgjedhja e pafavorshme, shpesh e konsideruar me emrin "problemi i limonit", fillimisht është trajtuar nga ekonomisti amerikan George Arthur Akerlof, rreth viteve 70-të. Ky problem është i lidhur me paaftësinë që kanë tregtarët/blerësit për të dalluar / diferencuar midis cilësive të ndryshme që kanë disa produkte. Shembulli tipik që përdoret është rasti i tregtisë së makinave të përdorura. Për një analizë më të zgjeruar mbi problemin e zgjedhjes së pafavorshme në sistemin financiar shih Myers and Majluf (1983) dhe Mishkin (1991).

[4] Problemi i *free-riders* shfaqet kur disa investitorë përfitojnë (free ride off) duke ndjekur veprimet që kryejnë investitorët që paguajnë, për të pasur informacion mbi instrumente financiare që shiten me vlerë të ulur.

[5] *Credit crunch* janë situata ekonomike kur është shumë e vështirët që të sigurohet kapital për investime. Bankat apo investitorët e ulin shumë sasinë e ofruar për kreditim, duke ndikuar në rritjen e interesave. Këto situata konsiderohen si zgjatje të periudhave të rënies ekonomike.

[6] Përkatësisht: *disaster myopia, herd behavior, agency problem* dhe *institutional memory hypothesis*.

[7] Pozicioni i hapur në një monedhë është diferenca midis aktiveve dhe pasiveve në atë monedhë. Ky pozicion quhet "long" kur aktivet tejkalojnë pasivet dhe "short" në situatën e kundërt. Kuadri rregullator i Bankës së Shqipërisë kërkon që vlera absolute e këtij pozicioni të mos jetë më i madh se 20 për qind e kapitalit rregullator për çdo monedhë dhe jo më i madh se 30 për qind për të gjitha monedhat.

[8] Aktualisht janë tre monedha kryesore që përdoren në sistemin bankar dollari amerikan, euro dhe leku. Libori dhe euribori merren si referenca për dollarin amerikan dhe euron, dhe norma bazë e Bankës së Shqipërisë për lekun.

LITERATURË

Berger, A., and G. UDELL (2003). "The institutional memory hypothesis and the procyclicality of bank lending behaviour", BIS Working Paper, n.° 125, January, Basel.

Bank of Albania Annual Reports, www.bankofalbania.org.

Cottarelli C., Dell'Ariccia G., Vladkova-Hollar I., 2003, "Early Birds, Late Risers, and Sleeping Beauties: Bank Credit Growth to the Private Sector in Central and Eastern Europe and the Balkans", IMF Working Papers, WP/03/213

Demirguc, Asli & Huizinga, H, 2000, "Determinants of Commercial Bank Interest Margins and Profitability: Some International Evidence", World Bank Economic Review, Oxford University Press, vol. 13(2), pages 379-408, May.

Demirgüç-Kunt A., and R. Levine (2001), "Bank-Based and Market-Based Financial Systems: Cross-Country Comparisons", In: Financial Structure and Economic Growth: A Cross- Country Comparison of Banks, Markets, and Development, Eds: A. Demirguc-Kunt and R. Levine. Cambridge, MA: MIT Press: 81-140.

Duenwald C., Gueorguiev N., Schaechter A., 2005, "Too Much of a Good Thing? Credit Booms in Transition Economies: The Cases of Bulgaria, Romania, and Ukraine", IMF Working Papers, WP/05/128

Godlewski L. C., 2004, "Execess credit risk & bank's default risk, an application of default prediction's models to banks from Emerging Market Economies", Université Robert Schuman

Gourinchas, Pierre-Olivier, Rodrigo Valdes and Oscar Landerretsche, 1999, "Lending Booms: Some Stylized Facts," unpublished manuscript, Princeton University and Central Bank of Chile (August).

Guttentag, J., and R. Herring, 1984, "Credit rationing and financial disorder", The Journal of Finance, 39, pp. 1359-1382.

International Monetary Fund, 2004, "Are Credit Booms in Emerging

Markets a Concern?", World Economic Outlook, April 2004, Chapter IV International Monetary Fund, 2005, "Albania: Financial System Stability Assessment, including Reports on the Observance of Standards and Codes on the following topics: Banking Supervision and Payment Systems", IMF Country Report No. 05/274, August 2005

Jiménez G., and Saurina J., 2005, "Credit Cycles, Credit Risk and Prudential Regulation", Banco de España, Documento de Trabajo nº 0531

Kaminsky G., and C. M. Reinhart, 1998, "The twin crises: The causes of banking and balance of payments problems" International Finance Discussion Paper No.544 (Washington Board of Governors of the Federal System, March). /American Economic Review, 89(3), 473-500

Kaminsky G., and Reinhart C. M., 1999, "The Twin Crises: The Causes of Banking and Balance of Payments Problems," American Economic Review, Vol. 89, pp. 473–500.

Keeton W. R., 1999, "Does Faster Loan Growth Lead to Higher Loan Losses?", Federal Reserve Bank of Kansas City, Economic Review - Second Quarter 1999

Levine R., 2004, "Finance and Growth: Theory and Evidence", NBER Working Paper No. W10766

Merton, R. C. (1995), "A Functional Perspective of Financial Intermediation", Financial Management, 24: 23-41.

Mishkin F. S., 1996, "Understanding Financial Crises: A Developing Country Perspective", NBER Working Paper Series, Working Paper 5600.

Mishkin F. S., 1991, "Anatomy of a Financial Crises ", NBER Working Paper Series, Working Paper 3934.

Myers, S. C., and N. Majluf, 1984, "Corporate Financing and Investment Decisions when Firms Have Information that Investors Do Not Have", Journal of Financial Economics, 13: 187-221.

Rajan, R. (1994). "Why bank credit policies fluctuate: a theory and some

INFORMACION MBI REZULTATET E VROJTIMIT PRANË FAMILJEVE

*Argita Frashëri**

Fjalë kyçe
- Remitanca - Emigrim - Flukëse hyrëse - Familje pritëse - Të ardhura -

ABSTRAKT

Materiali në vijim jep informacion mbi karakteristikat kryesore të dërgesave në para të emigrantëve në Shqipëri, parë nga këndvështrimi i familjeve pritëse. Pavarësisht nga studimet e shumta për ndikimin social, demografik dhe ekonomik të emigracionit, ende ka një njohje pjesore të kësaj dukurie tek ne. Pak dihet rreth karakteristikave, dinamikës, ecurisë dhe ndikimit të këtyre dërgesave në nivele personale, familjare dhe komuniteti. Ky material, sjell një kontribut shtesë në njohjen e zhvillimit të kësaj dukurie, parë nga këndvështrimi i familjeve pritëse të remitancave.

HYRJE

Dukuria social-ekonomike e emigrimit të punës është tashmë fakt në jetën e përditshme të shqiptarëve. Gjithkush nga ne ka një të afërm ose të njohur që punon dhe jeton jashtë vendit.

Duke marrë parasysh informalitetin, që ka shoqëruar në masë këtë dukuri në Shqipëri, pra një numër të madh të emigrantëve shqiptarë të padokumentuar, vlerësimi i saktë i numrit të tyre është i pamundur. Megjithatë, sipas studiuesve të ndryshëm

vlerësohet se nga Shqipëria, me një popullatë prej rreth 3.2 milionë banorësh, gati 1 milion kanë emigruar, kryesisht në Greqi dhe Itali (Lianos and Glystos, 2004).

Ngushtësisht të lidhura me emigracionin janë remitancat[1] – transaksionet monetare ndërmjet emigrantëve, në vendet pritëse dhe të afërmve të tyre, në vendet e origjinës.

Remitancat përbëjnë një mekanizëm të rëndësishëm për transferimin e burimeve (rezervave) nga vendet e zhvilluara në vendet në zhvillim (Russell 1992) si dhe janë ndër flukset më të mëdha të financimit të jashtëm për vendet në zhvillim (Ratha 2003).

Vëmendja për ndikimin e remitancave në Shqipëri, vjen nga madhësia, frekuencat dhe prirjet që së bashku kanë karakterizuar këto flukse në vite. Për periudhën 2000-2006, në nivel makroekonomik, këto flukse zënë mesatarisht 13.8 për qind të PBB-së, duke luajtur rol të rëndësishëm në mbështetje të bilancit të pagesave. Remitancat janë gjithnjë e më të rëndësishme krahasuar me flukset e tjera valutore, të lidhura me aktivitetet ekonomike, duke qëndruar në 65 për qind të të ardhurave nga aktiviteti tregtar dhe duke u përllogaritur mesatarisht 133 për qind më të larta se të ardhurat nga turizmi. Remitancat familjare përbëjnë gati 86 për qind të transfertave korente, duke eklipsuar burime të tjera mbështetëse për ekonominë. Flukset e remitancave kanë qenë zakonisht më të larta se investimet e huaja direkte, madje gati 4 herë më të mëdha.

Pra, të dhënat tregojnë se remitancat janë një burim i rëndësishëm valutor dhe likuiditeti për Shqipërinë.

Të dhënat e agreguara të remitancave, megjithatë, tregojnë pak për dobinë e tyre tek marrësit ose për mënyrën sesi marrësit i përdorin këto fonde, duke vështirësuar analizën e ndikimit të tyre në nivel mikro. Vrojtimet pranë familjeve dëshmojnë rëndësinë e këtyre flukseve në nivelin e të ardhurave të familjeve pritëse. Remitancat kontribuojnë në: përmirësimin e standardit të jetesës; shëndet dhe edukim më të mirë si dhe në krijimin e vlerave humane dhe financiare.

Pavarësisht nga studimet e shumta për ndikimin social, demografik dhe ekonomik, ende ka një njohje pjesore të kësaj dukurie tek ne. Pak dihet rreth karakteristikave, dinamikës, ecurisë dhe ndikimit të këtyre flukseve në nivele personale, familjare dhe komuniteti.

Ky studim, sjell një kontribut shtesë në njohjen e zhvillimit të kësaj dukurie, parë nga këndvështrimi i familjeve pritëse të remitancave. Më poshtë, në seksionet 1 dhe 2, do të gjeni qëllimin e organizimit të këtij vrojtimi si dhe shkurtimisht metodologjinë e tij. Në seksionin 3 do të ndalemi në analizën e rezultateve të vrojtimit. Seksioni 4 përfshin gjetjet dhe rekomandimet e dala.

1. QËLLIMI I VROJTIMIT

Synimi kryesor i Bankës së Shqipërisë është vlerësimi sa më i saktë i flukseve hyrëse të remitancave, për nevoja të hartimit të bilancit të pagesave dhe analizave të ndryshme në nivel makro. Nisur nga shkalla e lartë e informalitetit që karakterizon këto flukse, hulumtimi i tyre me vrojtim merr një rëndësi të veçantë. Pra, vrojtimi me intervistim i përfituesit të fundit të këtyre fondeve (familjes pritëse) është opsioni më optimal, në këto kushte.

Vrojtimi paraqet informacion në nivel rural, urban dhe kombëtar. Zgjedhja e familjeve për vrojtim është përfaqësuese për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke e bërë këtë vrojtim të besueshëm dhe një instrument real për analiza të mëtejshme.

Informacioni i mbledhur mundëson analizën e ndikimit të remitancave në politikat social-ekonomike dhe në zonat rurale, urbane si dhe në shkallë kombëtare.

Vrojtimi pranë familjeve përqendrohet në aspekte të ndryshme, të lidhura me karakterizimin e remitancave, të dërguara nga emigrantët shqiptarë. Ai përfshin një sërë përmasash për matjen e fluksit vjetor të remitancave në vend, frekuencën, kanalizimin, përdorimin si dhe prirjet e këtyre flukseve.

1.1 Objektiva kryesorë.

Kontribuon në njohjen e familjeve shqiptare që përfitojnë remitanca nga familjarët dhe/apo të afërmit e tyre jashtë si dhe ofron informacion bazë për hartimin e politikave ekonomike dhe sociale, për maksimizimin e dobishmërisë së përdorimit të tyre në vend.

1.2 Objektiva specifikë.

(i) Sigurimi i informacionit lidhur me vëllimin, origjinën, frekuencën dhe përdorimin e remitancave në Shqipëri.
(ii) Sigurimi i informacionit lidhur me përdorimin e kanaleve zyrtare dhe jozyrtare në transferimin e remitancave, si dhe shkallën e përfshirjes së familjeve pritëse në sistemin financiar shqiptar.
(iii) Sigurimi i informacionit lidhur me përdorimin e dërgesave në Shqipëri.

2. METODOLOGJIA.

2.1 Përcaktimi i mostrës (zgjedhjes) për vrojtim.

Vrojtimi pranë familjeve u organizua në bashkëpunim me Institutin e Statistikave (INSTAT), i cili përcaktoi popullatën e familjeve për vrojtim, si dhe realizoi intervistimet, gjatë muajit nëntor të vitit 2006. Në të përfshihen familjet shqiptare të cilat kanë rezultuar të kenë dërgesa nga jashtë në formën e remitancave, nga familjarët me banim jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë. Për këtë INSTAT ka përdorur të dhënat e LSMS[2]-së, të drejtuar dhe të administruar nga Banka Botërore, në vitin 2002[3].

LSMS, pjesë e programit të studimeve të Bankës Botërore mbi Matjen e Nivelit të Jetesës, është një instrument shumë i rëndësishëm për përcaktimin e nivelit të jetesës në vendet në zhvillim. Ky vrojtim, në Shqipëri, është organizuar rreth një vit më vonë, pas Regjistrimit të Përgjithshëm të Popullsisë dhe të

Familjeve (Population and Housing Census) zhvilluar në prill të vitit 2001. Vrojtimi (LSMS), gjatë muajve prill - korrik 2002. Mostra e përcaktuar për vrojtim përshiu 450 njësi kryesore për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, me nga 8 familje për njësi. Pra, mostra për vrojtim ka përfshirë 3600 familje.

Nga studimi i mësipërm, INSTAT ofroi për Bankën e Shqipërisë një mostër vrojtimi prej rreth 1017 familjesh, të cilat rezultojnë familje shqiptare që presin dërgesa remitancash nga emigrantët.

2.2 Instrumenti për marrjen e informacionit.

Pyetësori i vrojtimit u hartua nga Banka e Shqipërisë. Renditja e shumicës së pyetjeve lehtëson dhe sistemon informacionin e mbledhur përgjatë rubrikave. Informacioni i kërkuar është sasior dhe cilësor. Pyetësori përmban 23 pyetje të përmbledhura në 5 rubrika kryesore që përfshijnë: (i) informacion të përgjithshëm për përbërjen dhe vendndodhjen e familjeve; (ii) të ardhurat familjare; (iii) remitancat dhe kursimet në Shqipëri; (iv) investimin e kursimeve; dhe (v) të tjera.

2.3 Puna në terren.

Informacioni i vrojtimit u mblodh me intervista direkte. Intervistuesit vizituan familjet e zgjedhura, më shumë se një herë, për të plotësuar intervistimin, në rastet kur informacioni nuk mundi të mblidhej në vizitën e parë apo personi nuk gjendej në shtëpi.

Ekipi i intervistuesve u përzgjodh nga INSTAT dhe përbëhej nga individë, të cilët ishin aktivizuar më parë, në intervistimet e bëra, në kuadër të LSMS-së. Intervistuesit u njohën me pyetësorin dhe njëkohësisht, ishin njohës të mirë të mostrës për vrojtim.

Për më tepër, puna në terren është mbikëqyrur nga personi përgjegjës, i caktuar nga INSTAT për këtë vrojtim, për të siguruar cilësi në informacionin e mbledhur dhe plotësimin e standardeve të besueshme.

2.4 Përpunimi i informacionit.

Hedhja e të dhënave dhe përpunimi i pyetësorëve u krye nga Banka e Shqipërisë. Për të marrë vlerësime të sakta dhe statistikisht domethënëse, të dhënat e përftuara nga vrojtimi, janë peshuar. INSTAT ka përllogaritur peshat për çdo familje të vrojtuar. Peshimi i informacionit të mbledhur ka qenë hapi i parë i punës për analizën e rezultateve të këtij vrojtimi.

3. ANALIZA E REZULTATEVE TË VROJTIMIT.

Rezultatet statistikore të vrojtimit të paraqitura në vijim, mundësojnë analizën e karakteristikave të flukseve të remitancave, përfituar nga familjet shqiptare si dhe përdorimin e tyre.

3.1 PROFILI I FAMILJEVE QË PËRFITOJNË REMITANCA.

Sipas vrojtimit rreth 189,736 nga 728,000 ose rreth 26 për qind e familjeve në territorin e Republikës së Shqipërisë, përfitojnë dërgesa nga jashtë në formën e remitancave.

Shpërndarja gjeografike e familjeve tregon se remitancat, në masën më të madhe, janë të përfituara nga popullsia e Tiranës (19 për qind), e Vlorës (12 për qind), e Shkodrës (11 për qind) dhe e Fierit (8 për qind); (tabela 1 dhe tabela 1 në aneksin bashkëngjitur).

Fluksi mesatar vjetor i remitancave për familje, vlerësohet afërsisht në 1,897 euro dhe ndryshon nga qyteti në qytet.

Tabela 1 në aneksin bashkëngjitur, paraqet rezultate përshkruese mbi numrin e familjeve përfituese si dhe mesataren vjetore (në euro) të remitancave për familje, sipas qyteteve në territorin shqiptar. Familjet në Kuçovë, Peqin dhe Pogradec shfaqin fluksin më të ulët të remitancave gjatë vitit (nën 1,000 euro), ndërkohë që, në Pukë, Tropojë, Bulqizë dhe Gramsh hasen vëllimet më të larta të remitancave për familje (në një interval nga 3,000 deri në 8,000 euro në vit).

Tabelë 1. Shpërndarja gjeografike e familjeve përfituese dhe fluksi i remitancave për vitin 2005.

Qarku	Popullsia*	Sipërfaqja (km.^{2})	Rrethi	Nr. Familje	Shuma (euro)
Berat	193,855	1,802	Berat, Kuçovë, Skrapar	11,396	13,312,843
Dibër	191,035	2,507	Bulqizë, Dibër, Mat	10,787	23,121,223
Durrës	247,345	827	Durrës, Krujë	15,622	21,442,827
Elbasan	366,137	3,278	Elbasan, Gramsh, Librazhd, Peqin	13,810	16,890,509
Fier	384,386	1,887	Fier, Lushnje, Mallakastër	29,825	40,166,439
Gjirokastër	114,293	2,883	Gjirokastër, Përmet, Tepelenë	8,423	13,763,310
Korçë	266,322	3,711	Devoll, Kolonjë, Korçë, Pogradec	15,759	14,317,155
Kukës	112,050	2,373	Has, Kukës, Tropojë	9,303	13,246,747
Lezhë	159,792	1,581	Kurbin, Lezhë, Mirditë	11,110	14,008,983
Shkodër	257,018	3,562	Malësi e Madhe, Pukë, Shkodër	17,970	57,741,055
Tiranë	601,565	1,586	Kavajë, Tiranë	26,663	63,541,383
Vlorë	193,361	2,706	Delvinë, Sarandë, Vlorë	19,068	49,704,523
TOTAL	3,087,159	28,703		189,736	341,256,998

*Regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë, viti 2001.

Remitancat janë më të shpeshta në zonat rurale. Rreth 59 për qind e familjeve pritëse banojnë në zonat rurale dhe rreth 41 për qind e tyre, në zonat urbane. Po kështu, në zonat rurale, totali i përfituar gjatë vitit përfaqëson rreth 64 për qind të totalit të përgjithshëm të remitancave vjetore.

Tabelë 2. Shpërndarja zonale e remitancave.

	Mesatarja vjetore (euro)	% ndaj shumës	% ndaj nr. të familjeve
Rurale	2029.4	63.9	58.7
Urbane	1624.8	36.0	41.3
Total		100	100

Nga analiza mbi madhësitë e familjeve pritëse të remitancave, rezulton se ato janë të madhësisë së mesme, me afërsisht 3.5 pjesëtarë për familje.

Rreth 72 për qind e tyre, rezultojnë se janë deri në 4 pjesëtarë dhe 22 për qind, deri në 6 pjesëtarë për familje.

3.2 Të ardhurat familjare.

Të ardhurat mujore për familje nuk janë të shpërndara normalisht. Grafiku 2, paraqet histogramën e frekuencave të të ardhurave mujore për familje. Mesatarisht, ato vlerësohen në nivelin 39,382 lekë. Në përqindëshin e 25-të vëllimi i të ardhurave mujore vlerësohet rreth 22,000 lekë dhe në përqindëshin e 75-të arrin nivelin 49,500 lekë (tabelë 3 në aneksin bashkëngjitur).

Për familjet e zonave urbane, të ardhurat mesatare mujore vlerësohen në intervale më të larta se ato në zonat rurale.

Të ardhurat mujore për familjet që jetojnë në zona rurale, vlerësohen mesatarisht në 34,787 lekë (grafik 1 dhe tabelë 4 në aneksin bashkëngjitur).



Në zonat urbane, mesatarja e të ardhurave mujore për familje vlerësohet 46,038 lekë (grafik 2 dhe tabelë 4 në aneksin bashkëngjitur).

Rreth 51 për qind e familjeve raportojnë të jenë të përfshira në sipërmarrje të vogla biznesi apo aktivitete bujqësore. Kontributi i këtyre kategorive në të ardhurat mujore të familjeve vlerësohet mesatarisht në rreth 19 për qind të buxhetit mujor familjar (tabelë 3.).



Normalisht, për familjet e zonave rurale, të ardhurat nga aktivitetet bujqësore zënë mesatarisht 21 për qind të të ardhurave totale mujore dhe të ardhurat nga përfshirja në sipërmarrje biznesi, zënë 4 për qind. Po kështu, në zonat urbane përfitimet nga sipërmarrje biznesi, vlerësohen mesatarisht në 11 për qind të të ardhurave mujore.

Tabelë 3. Të ardhurat familjare mujore sipas burimeve kryesore.

Burimet e të ardhurave	Kontributi mesatar mujor (%)	Frekuenca
Aktivitete bujqësore	11.6	84,209
Aktivitete biznesi	6.6	16,967
Rroga (shtet ose privat)	19.6	55,035
Pension	15.7	107,821
Ndihmë sociale	0.6	11,404
Punë e rastësishme	3.3	17,888
Remitanca	40.7	168,703
Të tjera	1.8	8,902
TOTAL	100.0	186,844

Të dhënat e vrojtimit tregojnë se remitancat përfaqësojnë një burim kritik të ardhurash për familjet, duke zënë mesatarisht 40.7 për qind të të ardhurave mesatare mujore.

Në zonat rurale, ndikimi është më i theksuar dhe mesatarisht, vlerësohet në 45.7 për qind. Ndërkohë që, në zonat urbane kontributi i remitancave në të ardhurat mujore për familje, arrin në 36.7 për qind (tabelë 4.).

Tabelë 4. Kontributi i remitancave sipas zonave rurale dhe urbane në buxhetin familjar mujor (në përqindje).

		Zona rurale	Zona urbane
Mesatare		45.7	36.7
Përqindëshi	25	25	16
	50	42	33
	75	67	51

Vlerësimet empirike tregojnë gjithashtu, se niveli dhe ashpërsia e varfërisë reduktohen ndjeshëm, përmes familjeve pritëse të remitancave.

Stastistikat përshkruese të të ardhurat ditore për frymë (tabelë 5.) tregojnë se, përjashtuar kontributin e remitancave, familjet në pothuajse 40 për qind të rasteve, do të rezultonin nën kufirin e varfërisë[4].

Tabelë 5. Statistika përshkruese, të ardhurat ditore për frymë (në lekë).

		Me remitanca	Pa remitanca
Mesatarja		457	283
Devijimi standard		408	286
Minimumi		33	7
Maksimumi		4,093	3,333
Përqindëshi	10	148	67
	20	208	108
	25	228	123
	30	253	138
	40	300	176
	50	350	222
	60	417	270
	70	500	308
	75	533	333
	80	604	387
	90	836	525

Perceptimi i familjeve lidhur me ndikimin e remitancave në situatën e tyre financiare, tregon se remitancat, përgjithësisht vlerësohen me ndikim pozitiv. Vetëm në 21 për qind të rasteve, familjet shfaqen pesimiste për impaktin e remitancave në përmirësimin e situatës së përgjithshme financiare (tabelë 6.).

Tabelë 6. Ndikimi i remitancave në situatën e përgjithshme financiare.

	Frekuenca	(%)
Asnjë përmirësim	39,132	20.9
Një përmirësim i vogël	91,278	48.9
Një përmirësim i rëndësishëm	56,434	30.2
Total	186,844	100.0

Rreth 53 për qind e familjeve ia dalin të kursejnë gjatë vitit, me frekuencë më të lartë në zonat rurale (62 për qind). Kursimi mesatar vjetor, për totalin e familjeve që kanë raportuar kursime, vlerësohet në 63,115 lekë (ose 508 euro).

Tabelë 7. Kursimi mesatar vjetor i familjeve (në lekë).

Nr. familjesh		186,844
Mesatarja		63,115
Përqindëshi	10	-
	20	-
	25	-
	30	-
	40	-
	50	10,000
	60	30,000
	70	50,000
	75	60,000
	80	100,000
	90	200,000

Ndërkohë që, rreth 30 për qind e familjeve pritëse të remitancave zotërojnë një llogari bankare, në masën më të madhe kursimet mbahen në *cash*.

Të pyetur për preferencat mbi ku dëshirojnë t'i mbajnë kursimet, sipas shkallës së rëndësisë nga 1 (më pak e rëndësishme) në 5 (më shumë e rëndësishme) me mundësitë: në bankë, në shtëpi dhe investime, rezulton se familjet parapëlqejnë t'i mbajnë kursimet në bankë (me shkallë rëndësie 3.87). Ndërkohë që, akoma një numër i konsiderueshëm familjesh parapëlqejnë t'i mbajnë kursimet në shtëpi (me shkallë rëndësie 3.39). Mundësia e investimeve është konsideruar më pak e dëshirueshme (shkalla e rëndësisë 2.37).

3.3 Remitancat.

Pjesa e të ardhurave që emigranti dërgon në vendin e origjinës, varet nga një sërë faktorësh si profili i emigrantit[5], niveli i pagës, kostoja e jetesës në vendin pritës, luhatshmëria e monedhës në vendin e origjinës, diferenca në interesa për kursime, mes vendit të origjinës dhe atij pritës etj..

Rezultatet e vrojtimit tregojnë se numri i emigrantëve shqiptarë, të cilët i dërgojnë remitanca familjeve në Shqipëri, të paktën

1 herë në vit, përllogaritet afërsisht në 242,517. Emigrantët shqiptarë kanë një tendencë të lartë për të kursyer; me një nivel mesatar vjetor kursimesh të vlerësuar në rreth 5,390 euro për familje (Nicolaas de Zwager and al., 2005).

Evidencat e shumë studimeve, sugjerojnë që dërgesa në vendet e origjinës, deri në 1/3 e të ardhurave mujore të emigrantëve, është më e shpeshtë.

Sipas përllogaritjeve tona, mesatarja e dërgesave për emigrant, përllogaritet në rreth 1,310 euro në vit (grafik 3 dhe tabelë 8).

Grafik 3. Frekuenca në dërgesa të emigrantëve (në euro).



Tabelë 8. Statistika përshkruese, dërgesat vjetore për emigrant (në euro).

Nr. emigrantësh		242,517
Mesatarja		1,310
Minimumi		20
Maksimumi		30,000
Përqindëshi	10	161
	20	290
	25	400
	30	483
	40	580
	50	900
	60	1,000
	70	1,500
	75	1,610
	80	2,000
	90	3,000

Struktura e dërgesave ndryshon, gjithashtu, sipas periudhës në emigrim. Shpesh, ndeshet shqetësimi i zvogëlimit të remitancave me kalimin e kohës, si në vëllim total ashtu edhe në nivel dërgese për emigrant, për pasojë të rënies së ritmeve migratore apo zvogëlimit të gatishmëisë së emigrantëve, për të mbështetur financiarisht familjet e tyre në origjinë.

Për më tepër, literatura sugjeron se edhe me vazhdimësinë e fenomenit të emigrimit, rënia e parashikuar e nivelit për emigrant të remitancave është mundshme të ndodhë, si pasojë e bashkimit familjar apo integrimit gjithnjë e më shumë të emigrantëve në vendet pritëse. Ky proces, redukton aftësinë dhe gatishmërinë e emigrantit për dërgesa: aftësinë për arsye të rritjes së numrit të pjesëtarëve që tashmë banojnë në familjen e emigrantit dhe gatishmërinë, për arsye të zvoglimit të lidhjeve familjare të emigrantit me vendin e origjinës.

Përllogaritjet shfaqin një prirje lakore të vëllimit total të remitancave të dërguara: emigrantët me qëndrim nga 5 deri në 10 vjet jashtë, kanë kontributin kryesor në dërgesa përgjatë vitit. Ndërsa, emigrantët e viteve të fundit dërgojnë më pak se ata që kanë mbi 10 vjet në emigrim (grafiku 3). Përfaqësimi i lartë i grupimit 5-10 vjet, në vëllimin total të remitancave është i kuptueshme pasi ky grupim shfaq, njëkohësisht, frekuencat më të larta në dërgesa (rreth 55 për qind e dërgesave në zgjedhjen tonë, vijnë nga kjo klasë emigrantësh).

Grafik 4. Fluksi mesatar vjetor i dërgesave
për emigrant dhe kohëzgjatja në emigrim.



Nga ana tjetër, nëse do të ndalemi në mesataren për emigrant sipas grupimeve kohore të sipërpërmendura, nivele më të larta të remitancave shfaqin emigrantët që kanë nga 1 në 5 vjet në emigrim (mesatarisht në vit ky grupim dërgon 1,539 euro). Me kalimin e viteve vërehet një rënie në nivelin mesatar të dërgesave për emigrant.

Të dhënat e vrojtimit tregojnë se marrëdhënia mes dërguesit dhe përfituesit të remitancave ka rëndësi përsa i përket vëllimit të dërgesave, si dhe hedh dritë mbi profilin e emigratëve shqiptarë jashtë. Mëse 85 për qind e dërguesve të remitancave janë djali ose vajza e kryefamiljarit. Kjo flet për një lidhje të fortë me bërthamën familjare në Shqipëri (grafiku 5).

Grafik 5. Shpërndarja e remitancave sipas marrëdhënies së dërguesit me përfituesin e tyre (përqindje ndaj vëllimit të dërguar).



Si në frekuencë ashtu edhe në vëllim, vërehet se djemtë mbështesin financiarisht familjet në Shqipëri (tabelë 9). Megjithëse, në thuajse 20 për qind të rasteve emigrantët janë femra (vajza), mesatarja vjetore e dërgesave të tyre rezulton e ulët. Lidhjet patriarkale autoritare, të cilat janë ende të ndjeshme në familjet shqiptare, kushtëzojnë përfshirjen e femrave në emigracion (Germenji, 2005). Bashkimi familjar, ka qenë një nga arsyet kryesore për emigracionin e grave nga Shqipëria (Misja, 1998; Carletto et al, 2004).

Ndërkohë që, bashkëshortët shfaqin mesataren më të lartë të hasur (2,448) në dërgesa. Kjo, pasi familja pritëse është

drejtpërdrejt e varur financiarisht nga këto dërgesa. Prania jo e madhe në numër mund të shpjegohet me faktin, që cikli i emigrimit për këtë kategori emigrantësh mund të gjykohet më i vogël, krahasimisht me grupimet e tjera, pasi bashkëshorti ose kthehet ose bashkon familjen në vendin pritës.

Tabelë 9. Raport përmbledhës, dërgesat vjetore për emigrant (në euro), sipas marrëdhënies me përfituesin.

Marrëdhënia	Nr.	% ndaj numrit	Mesatare (euro)	% ndaj shumës
Djali	175,223	72.3	1,380	76
Vajza	45,704	18.9	624	9
Bashkëshorti	15,925	6.6	2,448	12
Të tjerë	4,331	1.8	853	1
Vëllai	575	0.2	5,775	1
Nusja	595	0.2	1,856	0
Total	242,354	100.0	1,310	100

Lidhur me shpeshtësinë e remitancave, rezulton se në frekuencë të lartë ato kryhen një deri në dy herë në vit (69 për qind). Në vetëm 3 për qind të rasteve, emigantët dërgojnë remitanca çdo muaj (tabelë 10).

Ky rezultat është i kuptueshëm nëse kryqëzojmë të dhënat mbi frekuencën në dërgesa me ato të kanaleve të dërgimit të remitancave. Kështu, në 59 për qind të rasteve, remitancat janë sjellë nga vetë emigranti (grafik 6). Afërsia gjeografike e Shqipërisë me vendet ku jeton pjesa më e madhe e emigrantëve (Greqi dhe Itali), mundëson vizitat e emigrantëve, të cilat janë më të ndjeshme gjatë sezonit turistik në Shqipëri apo në periudhat e fundvitit.

Tabelë 10. Frekuenca në dërgesa.

	Frekuenca	Nr.emigrantësh	%
Të vlefshme	1 deri në 2 herë në vit	163.884	69
	3 deri në 4 herë në vit	49.515	21
	5 deri në 6 herë në vit	15.389	7
	cdo muaj	7.164	3
	Total	235.952	100
Mungojnë		6.565	3
	TOTAL	242.517	100

Rezultatet tregojnë preferenca të larta për kanale joformale të transferimit të remitancave. Rreth 89 për qind e emigrantëve shqiptarë, përdorin rrugë joformale për të transferuar paratë (grafik 6). Emigrantët nga Greqia dhe Italia mbizotërojnë

mënyrën e transferimit të dërgesave nga vetë emigranti (në 83 për qind të rasteve), duke theksuar edhe një herë faktin që afërsia gjeografike mundëson transferimin e parave në rrugë joformale.

Grafik 6. Kanalet e transferimit të remitancave.



Shkalla e përdorimit të rrugëve formale të transferimit të parave është shumë e ulët, rreth 11 për qind. Ndonëse, në vendet pritëse emigrantët shqiptarë janë në masë të madhe të njohur me sistemin bankar (74.4 për qind e tyre i mbajnë kursimet e tyre në banka, në vendet ku ata jetojnë –sipas gjetjeve të Nicolaas de Zwager et.al 2005), pjesa më e madhe e remitancave shkon në zonat rurale, ku shtrirja e sistemit bankar shqiptar është e kufizuar. Transfertat nëpërmjet bankave, përbëjnë vetëm 6 për qind në totalin e transferuar.

Vendet kryesore nga burojnë remitancat janë Italia dhe Greqia, në të cilat ndodhet pjesa më e madhe e emigrantëve shqiptarë.

Ndonëse, përsa i përket numrit të emigrantëve Greqia kryeson sipas vendeve të origjinës (tabelë 2, në aneksin bashkëngjitur), për vëllimin e dërgesave vendin e parë e zë Italia, me rreth 45.8 për qind të totalit (grafik 7.).

Gjithashtu, mesatarja për dërgesat vjetore të emigrantëve në Itali, rezulton më e lartë se ajo e emigrantëve që jetojnë

Grafik 7. Shpërndarja e vëllimit të remitancave sipas vendeve të origjinës.



në Greqi. Këto rezultate, përkojnë me gjetjet e studimit më të fundëm, të ndërmarrë mbi çështje të emigracionit shqiptar[6], sipas të cilit masa e kursimeve të emigrantëve shqiptarë në Itali është më e lartë se ajo e emigrantëve shqiptarë në Greqi.

Përveç mbështetjes financiare nëpërmjet dërgesave në para, një formë jetër dërgese është ajo në të mira materiale. Këto dërgesa, vlerësohen mesatarisht 202 euro në vit dhe kanë qenë shtesë e flukseve monetare në rreth 36 për qind të rasteve.

Shkalla e kursimeve të remitancave është shumë e ulët. Mëse 59 për qind e familjeve të intervistuara, raportojnë se kursejnë në intervalin 0-5 për qind të totalit të remitancave dhe 17 për qind, në intervalin 10-20 për qind (grafik 8.).

Grafik 8. Kursimi i remitancave.



Të pyetur lidhur me pritshmërinë e tyre mbi flukset e remitancave, gati ¾ e familjeve përfituese nuk prashikojnë rënie të remitancave, për dy deri në tre vitet e ardhshme. Ndërkohë që, 21 për qind e familjeve ka përjetuar rënie të fluksit të remitancave ndaj viteve të kaluara si dhe shpreh pesimizëm për të ardhmen (tabelë 11).

Tabelë 11. Prirjet e remitancave nga këndvështrimi i familjeve pritëse.

			Në vitet e ardhshme		Total
		Më shumë	Të njëjtat	Më pak	
Krahasimisht me vitet e kaluara	Më shumë	7,4	8,3	2,8	18,6
	Të njëjtat	5,5	40,5	8,7	54,7
	Më pak	2,3	3,7	20,8	26,7
	Total	15,2	52,4	32,4	100,0

3.4 Përdorimi i remitancave.

Është e nevojshme të theksojmë se identifikimi me saktësi i përdorimit të të ardhurave shtesë familjare në formën e remitancave, ndarë nga të ardhurat e tjera, është i vështirë. Me fjalë të tjera, remitancat rrisin të ardhurat familjare, kështu që, ndikojnë sjelljen e tyre për konsum apo kursime.

Nga analiza e përdorimit kryesor të remitancave vjetore përftojmë skenarin e mëposhtëm:

- 41.8 për qind e remitancave janë të orientuara drejt shpenzimeve për konsum, që përfshin plotësimin e nevojave të përditshme të familjes me ushqim, veshmbathje dhe tipe të tjera të shpenzimeve për konsum si orendi shtëpie etj.; 16.4 për qind e remitancave janë përdorur për edukim dhe trajtim mjekësor, që konsiderohen të dobishme për vendin si investime sociale.
- 33.9 për qind e remitancave janë me destinacion investimet, rezultat i cili flet për ndikimin ekonomik të remitancave në vend. Me fjalë të tjera, ai nënkupton se një e treta e remiancave shkon direkt për të financuar aktivitetin e biznesit (6.0 për qind), blerjen e pasurive të patundshme (5.8 për qind), ndërtimin e shtëpive (12.3

për qind) dhe kursime në bankë (9.9 për qind).

- 6.6 për qind e remitancave ka për destinacion konsumin e ndërmjetëm, i cili interpretohet si një burim për të gjeneruar vlera të shtuara. Në këtë kategori, përfshihen edhe shpenzimet për shlyerjen e borxheve.

4. KONKLUZIONE

Në këtë material sollëm disa prej karakteristikave kryesore të remitancave në Shqipëri, nga këndvështrimi i familjeve pritëse.

Nga të dhënat e vrojtimit arritëm në përfundimin se rreth 26 për qind e familjeve shqiptare janë përfituese të remitancave. Mesatarja vjetore përfituar për familje, vlerësohet në rreth 1,897 euro.

Ndikimi i remitancave në Shqipëri është i rëndësishëm sepse: remitancat përbëjnë një burim kritik të ardhurash për familjet pritëse, duke përfaqësuar mesatarisht, rreth 41 për qind të të ardhurave mujore. Vlerësimet treguan se niveli i varfërisë reduktohet ndjeshëm përmes familjeve që presin remitanca. Statistikat përshkruese të të ardhurave ditore për frymë, tregojnë se përjashtuar kontributin e remitancave, pothuajse 40 për qind e familjeve rezultojnë nën kufirin e varfërisë.

Ndikimi i remitancave nuk ndjehet vetëm në nivel familjeje. Më shumë se gjysma e tyre shkojnë në sektorë të ndjeshëm: sipas përllogaritjeve tona, 59 për qind e familjeve përfituese jetojnë në zona rurale dhe mëse 2/3 e tyre drejtojnë një aktivitet prodhues.

Gjithashtu, remitancat e shpenzuara në zonat rurale mund të kenë një efekt më të madh se ato të shpenzuara në zonat urbane, pasi ato priren më shumë drejt konsumit të mallrave dhe shërbimeve lokale.

Remitancat janë të orientuara, kryesisht, për konsum. Përpjesa e madhe e remitancave për konsum tregon qëllimin primar,

pjesë e strategjisë së emigrantëve dhe e familjeve të tyre në Shqipëri, për të dalë nga varfëria dhe për të ngritur nivelin e jetesës.

Shumë studiues të çështjes së remitancave, pranojnë që herët a vonë këto flukse monetare do të vijnë në rënie. Të dhënat tona tregojnë se me kalimin e viteve në emigrim, vërehet një rënie në nivelin mesatar të dërgesave për emigrant. Për ruajtjen e ekuilibrit makroekonomik si dhe sigurimin në vazhdimësi të financimit të deficitit korent, prioriteti qëndron në kanalizimin e tyre drejt investimeve. Përdorimi i kanaleve formale dhe joformale për transferimin e remitancave ndikon drejtpërdrejt në përdorimin potencial të tyre. Vlerësohet se pjesa më e madhe e remitancave, transferohet në rrugë jozyrtare (rreth 89 për qind). Përdorimi i rrugëve bankare nga ana e emigrantëve, mbetet i kufizuar. Një kombinim i kostove të larta të transaksionit si dhe shmangia social-ekonomike, bëhet fjalë për familjet në zona rurale dhe /ose me nivel të ulët shkollimi, mund të jenë faktorët kryesorë për vazhdimësinë e përdorimit të rrugëve joformale, për këto dërgesa.

Kapaciteti i remitancave për të gjeneruar mirëqenie është i lidhur ngushtësisht me përfshirjen e tyre në sistemin financiar. Sipas vrojtimit, gati 1/3 e familjeve pritëse ka një marrëdhënie me bankat.

Disa banka greke dhe italiane kanë zgjeruar rrjetin e aktivitetit të tyre në Shqipëri. Gjithashtu, bankat në Shqipëri kanë zgjeruar bashkëpunimin me banka partnere jashtë vendit, kryesisht me Italinë[7]. Këto shihen si zhvillime pozitive në përfshirjen gjithnjë e më shumë, të remitancave në sistem si dhe rritjen e shkallës së përdorimit të bankave nga ana e popullsisë.

Krahas këtyre përpjekjeve, vëmendja duhet të shkojë në rritjen e ndërgjegjësimit të popullsisë lidhur me shërbimet bankare dhe jobankare, inkurajimin e zgjerimit të sistemit bankar në të gjithë vendin si dhe lehtësimin e mundësive të transfertave të parave.

BIBLIOGRAFIA

Carletto, C., Davis, B., Stampini, M., Trento, S. and Zezza, A., 2004. "Internal mobility and international migration in Albania".
Fullani, A. 2006. "Remittances: An Opportunity for Growth. The Albanian Migration to Italy as a case study".
Germenji, E., Sarris, A. and Sëinnen, J. 2002. "Remittances of emigrants from rural Albania".
Germenji, E. and Swinnen, J. 2004. "Impact of remittances on household based farms in rural Albania".
Germenji, E., 2005. "Does human capital matter? Integration of Albanian immigrants in the Greek labour market".
Karafolas, S. 2005. "A note on Albanian immigrants remittances: the involvement of the financial netëork on remittances betëeen Greece and Albania".
Korovilas, J., 1999. "The Albanian economy in transition: the role of remittances and pyramid investment schemes".
Lianos, T. and Cavounidis, J. 2004. "Immigrant remittances, stability of employment and relative deprivation".
Misja, V., 1998. "International emigration in Albania over transition period".
Orozco, M., 2003. "Workers remittances: the human face of globalization".
Orozco, M., 2004. "Remittances to latin America and Caribbean: Issues and Prespectives on Development".
Piperno, F., 2003. "Remittance enhancement for the local development in Albania: constraints and opportunities".
Russell, S., 1992. "Migrant remittances and development".
Ratha, D. 2004. "Enhancing the developmental effect of workers' remittances to developing countries".
Sorensen, Ninna Nyberg., 2004. "Migrant Remittances as a Development Tool: The Case of Marocco".
Albanian Institute of Statistics, 2002. "The Population in Albania in 2001. Main Results of the Population and Housing Census".
National Strategy on Migration, 2004. A project of the Albanian Government managed in cooperation ëith the international Organisation for Migration (IOM), funded by the Cards programme of the European Union.
World Bank, Albanian Institute of Statistics, 2002. "Albanian Living Standard Measurement Survey".

Tabelë 1. Raport përmbledhës.

Qytete	Nr. familje	Mesatarja vjetore (euro)	Shuma (euro)	% ndaj nr.	% ndaj shumës
Tropojë	638	3,894	2,484,219	0.3	0.7
Bulqizë	2,860	3,428	9,803,246	1.5	2.9
Berat	8,249	1,250	10,309,007	4.3	3.0
Dibër	2,637	2,902	7,652,487	1.4	2.2
Durrës	15,007	1,381	20,728,520	7.9	6.1
Devoll	2,957	1,124	3,323,668	1.6	1.0
Elbasan	9,483	578	5,480,192	5.0	1.6
Fier	17,667	1,493	26,373,341	9.3	7.7
Gjirokastër	3,509	1,309	4,594,439	1.8	1.3
Gramsh	1,429	3,316	4,737,995	0.8	1.4
Has	1,053	1,907	2,007,691	0.6	0.6
Krujë	615	1,161	714,307	0.3	0.2
Korçë	4,546	720	3,275,068	2.4	1.0
Kolonje	5,171	1,030	5,328,341	2.7	1.6
Kukës	7,612	1,150	8,754,837	4.0	2.6
Kuçovë	1,593	578	921,323	0.8	0.3
Kurbin	4,666	1,250	5,830,494	2.5	1.7
Librazhd	2,353	2,699	6,351,297	1.2	1.9
Lezhë	6,444	1,269	8,178,490	3.4	2.4
Lushnje	9,249	1,113	10,293,734	4.9	3.0
Mallakastër	2,909	1,203	3,499,365	1.5	1.0
Malësi e Madhe	4,037	1,168	4,715,722	2.1	1.4
Mat	5,290	1,071	5,665,490	2.8	1.7
Peqin	545	589	321,026	0.3	0.1
Pogradec	3,085	775	2,390,078	1.6	0.7
Përmet	2,131	2,691	5,733,873	1.1	1.7
Pukë	1,822	8,353	15,218,331	1.0	4.5
Shkodër	12,111	3,122	37,807,002	6.4	11.1
Skrapar	1,554	1,340	2,082,513	0.8	0.6
Sarandë	3,572	2,478	8,850,982	1.9	2.6
Tepelenë	2,783	1,234	3,434,998	1.5	1.0
Tiranë	26,663	2,383	63,541,383	14.1	18.6
Vlorë	15,496	2,636	40,853,541	8.2	12.0
Total	189,736	1,897	341,256,998	100	100

Tabelë 2. Raport përmbledhës mbi dërgesat e emigrantëve sipas shteteve të origjinës.

	% ndaj nr.	mesatarja (euro)	% ndaj shumës
Argjentinë	0.1	563	0.0
Austri	0.3	189	0.0
Aaustrali	0.1	1,855	0.1
Belgjikë	0.8	3,706	2.2
Kanada	0.6	812	0.4
Zvicër	0.2	2,416	0.3
Çeki	0.0	1,933	0.1
Gjermani	1.8	1,483	2.1
Francë	0.6	681	0.3
Britani e Madhe	5.1	1,812	7.1
Greqi	45.1	1,094	37.7
Kroaci	0.0	1,500	0.1

Hungari	0.1	3,479	0.2
Itali	40.0	1,498	45.8
Kosovë	0.1	786	0.1
Maqedoni	0.1	50	0.0
Hollandë	0.1	743	0.1
Norvegji	0.1	805	0.0
Arabi Saudite	0.1	403	0.0
Mali i Zi	0.1	966	0.1
Suedi	0.0	2,013	0.0
Shtetet e Bashkuara të Amerikës	4.3	964	3.2
n.a.	0.2	888	0.1
Total	100.0	1,310	100.0

Tabelë 3. Statistika përshkruese të të ardhurave mujore familjare.

Mesatarja		39,382
Devijimi standard		25,862
Minimumi		3,000
Maksimumi		212,000
Përqindëshi	10	15,000
	20	20,000
	25	22,000
	30	24,000
	40	28,600
	50	32,500
	60	38,000
	70	45,000
	75	49,500
	80	55,000
	90	72,500

Tabelë 4. Statistika përshkruese të të ardhurave mujore familjare, sipas shpërndarjes zonale.

		Zona rurale	Zona urbane
Mesatarja		34,787	46,038
Devijimi standard		21,598	29,783
Minimumi		4,000	3,000
Maksimumi		138,300	212,000
Përqindëshi	10	14,000	17,500
	20	19,000	23,000
	25	20,000	27,844
	30	22,000	30,000
	40	25,200	33,500
	50	29,000	39,000
	60	33,500	45,000
	70	40,000	54,140
	75	44,000	60,000
	80	47,000	65,000
	90	62,800	79,349

Grafik 1. Të ardhurat mesatare mujore në zonat rurale.



Grafik 2. Të ardhurat mesatare mujore në zonat urbane.



Grafik 3. Të ardhurat ditore për frymë.



Grafik 4. Të ardhurat ditore për frymë në zonat urbane.



Grafik 5. Të ardhurat ditore për frymë në zonat rurale.



Grafik 6. Të ardhurat ditore për frymë përpjesëtuar kontributin e remitancave, zona rurale.



Grafik 7. Të ardhura ditore për frymë përpjesëtuar kontributin e remitancave, zona urbane.



SHËNIME

* Materiali u punua nga: Argita Frashëri, Përgjegjëse e Zyrës së Bilancit të Pagesave, Departamenti i Statistikës, Banka e Shqipërisë.
Mendimet e shprehura në këtë artikull janë të autorit dhe nuk përputhen domosdoshmërisht me opinionin zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

[1] Shënim: Në materialin në vazhdim termi remitancë do të kuptojë dërgesat në para të emigrantëve shqiptarë për familjet e tyre në Shqipëri.

[2] Living Standard Measurement Survey.

[3] Për më tepër informacion, drejtohuni hhtp:\\www.worldbank.org\lsms.

[4] Duke iu referuar nivelit të varfërisë prej 2 usd në ditë, të përcaktuar nga Banka Botërore.

[5] Për më tepër mbi karakteristikat e emigrantëve shqiptarë shiko "Konkurrenca për dërgesat në para të emigrantëve", me grup autorësh Nicolaas de Zwager, Ilir Gëdeshi, Etleva Gërmenji dhe Christos Nikas, 2005.

[6] "Konkurrenca për dërgesat në para të emigrantëve", 2005.

[7] Në vazhdimësi të iniciativës së Bankës Botërore mbi studimin dhe zhvillimin e korridorit të remitancave Itali-Shqipëri (finalizuar në konferencën "Remittances: An Opportunity for Growth. The Albanian Migration to Italy as a case study", Bari, mars 3-4, 2006) Shoqata e Bankierëve Shqiptarë dhe Shoqata e Bankierëve Italianë, prej vitit 2006, kanë filluar një bashkëpunim të ngushtë, me idenë e zhvillimit të mëtejshëm të korridorit të remitancave Itali-Shqipëri, si dhe gjetjen e mundësive të reja për zgjerimin e përdorimit të kanaleve bankare për remitanca.

ÇMIMET E PASURIVE TË PALUAJTSHME DHE STABILITETI FINANCIAR

*Juna Bozdo**

Fjalë kyçe
- Pasuri e paluajtshme - Kredidhënie bankare - Kolateral - Ecuria e çmimeve -

1. HYRJE

Huadhënia bankare është burimi kryesor i financimit të pasurive të paluajtshme. Dekadën e fundit përputhshmëria midis cikleve në kredidhënie dhe ecurisë së tregjeve të pasurive të paluajtshme, që dëshmojnë për një lidhje të ngushtë ndërmjet tyre, kanë qenë gjerësisht të dokumentuara nga literatura (FMN, 2000, BIS, 2001). Sidoqoftë, ndërvarësia midis kredidhënies bankare dhe çmimit të pasurive të paluajtshme mbetet ende një çështje e diskutueshme. Nga një këndvështrim teorik, varësia midis këtyre dy variablave mund të jetë e dykahshme.

Më konkretisht, nga njëra anë çmimet e pasurive të paluajtshme mund të ndikojnë në kredidhënien bankare nëpërmjet efekteve të ndryshme që mund të kenë mbi mirëqenien e huamarrësit.

Së pari, falë imperfeksioneve që ekzistojnë në tregjet financiare, individët dhe sektori privat mund të ndihen të detyruar t'i drejtohen huadhënies bankare për të financuar blerjen e pasurive të paluajtshme. Për rrjedhojë, si individët ashtu dhe sektori privat mund të kenë akses në huadhënie vetëm nëse ofrojnë kolateral. Meqënëse, pasuritë e paluajtshme përdoren gjerësisht si kolateral, atëherë çmimet e pasurive të paluajtshme

janë një përcaktues tepër i rëndësishëm i aftësisë huamarrëse të individëve dhe të sektorit privat. *Së dyti*, një ndryshim i mundshëm i çmimit të pasurive të paluajtshme mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e përgjithshëm të mirëqenies të konsumatorit, duke e shtyrë atë të ndryshojë zakonet e tij mbi mënyrën e shpenzimeve dhe planet e tij huamarrëse, rrjedhimisht edhe kërkesën për kredi. *Së fundmi,* çmimet e pasurive të paluajtshme ndikojnë dhe mbi vlerën e kapitalit të bankave, si në mënyrë të drejtpërdrejtë ashtu dhe jo të drejtpërdrejtë. Në mënyrë të drejtpërdrejtë për faktin se edhe vetë bankat zotërojnë asete, ndërsa në mënyrë jo të drejtpërdrejtë duke ndikuar mbi vlerën e kredive të kolateralizuara me pasuri të paluajtshme.

Nga ana tjetër, huadhënia bankare mund të ndikojë në mënyrë jo të drejtpërdrejtë mbi çmimet e pasurive të paluajtshme, duke rritur fondet në dispozicion të kredimarrësve. Një rritje e nivelit të huadhënies mund të çojë në një rënie të normave të interesit të kredisë e për rrjedhojë, në një rritje të kërkesës për kredidhënie nga vetë individët dhe sektori privat. Kjo rritje e kërkesës, kundrejt një oferte për pasuri të paluajtshme përkohësisht fikse (për arsye të kohës që nevojitet për të ndërtuar njësi të reja banimi) mund të reflektohet në një rritje akoma edhe më të madhe të çmimit të pasurive të paluajtshme.

Pra mund të themi se, luhatjet e çmimeve të pasurive të paluajtshme influencojnë jo vetëm nivelin e rrezikut që bankat ndërmarrin gjatë procesit kredidhënës por edhe politikat e tyre për ta zgjeruar këtë të fundit.

2. HUADHËNIA BANKARE PËR PASURI TË PALUAJTSHME DHE TRAJTIMI I TYRE NGA PIKËPAMJA MBIKËQYRËSE

Huadhënia për pasuri të paluajtshme është një nga elementet përbërëse më të rëndësishme të kredisë bankare në tërësi[1].Për këtë arsye, si për drejtuesit e bankave ashtu dhe për mbikëqyrësit bankarë, thelbësore është matja e ekspozimit të bankave ndaj rrezikut të kredisë në mënyrën më të saktë të mundshme. Sidoqoftë, rreziku i kredisë nuk buron vetëm prej huadhënies për pasuri të paluajtshme. Meqënëse, pasuritë e paluajtshme përdoren

gjerësisht si kolateral edhe për llojet e tjera të kredive bankare, luhatjet në çmimet e tyre mund të influencojnë bilancin e bankave të sistemit, duke patur kështu një impakt akoma më të gjerë mbi vetë rentabilitetin dhe vlerën e kolateralit të industrisë bankare.

Përpara se të konsiderojmë impaktin e luhatjeve të çmimit të pasurive të paluajtshme mbi cilësinë e aktiveve, mbi ekspozimin, mbi mjaftueshmërinë e kapitalit dhe për pasojë, mbi vetë kapacitetin huadhënës të sistemit bankar në tërësi, do të shqyrtojmë llojet e ndryshme të kredisë për pasuri të paluajtshme dhe trajtimin e tyre nga pikëpamja mbikëqyrëse mbështetur jo vetëm në standardet ndërkombëtare[2], por edhe në ato të sistemit bankar shqiptar.

2.1 Llojet e kredive për pasuri të paluajtshme dhe standardet mbikëqyrëse sipas Bazel I

Kreditë për pasuri të paluajtshme kategorizohen sipas klasave të mëposhtme:

- Kredi për investime në pasuri të paluajtshme për strehim.
- Kredi për investime në pasuri të paluajtshme tregtare.

Kreditë për investime në pasuri të paluajtshme për strehim i akordohen individëve. Qëllimi i kësaj kredie është financimi i blerjes së një prone rezidenciale, objekt i kredisë. Këto kredi kolateralizohen në mënyrë të plotë me anë të një hipoteke mbi një pronë rezidenciale. Përsa i përket afateve dhe kushteve të akordimit të kredisë nuk ekziston ndonjë kufizim, duke bërë që këto të fundit të variojnë ndjeshëm në vende të ndryshme[3].

Kreditë për investime në pasuri të paluajtshme tregtare i akordohen bizneseve për qëllime investimi në pasuri të paluajtshme. Qëllimi i kësaj kredie mund të jetë blerja, ndërtimi dhe përmirësimi i një pasurie të paluajtshme. Kreditë për pasuri të paluajtshme tregtare kolateralizohen me hipotekë mbi:

- ndërtesa tregtare si dyqan, magazinë, qendër tregtare, hotel etj.;

- ndërtesa industriale;
- ndërtesa me një funksion të caktuar si fabrikë;
- godina për zyra.

Një rast më vete janë kreditë për ndërtim *(construction loans)*. Këto janë një lloj i veçantë i kredive për pasuri të paluajtshme dhe akordohen për financimin e ndërtimit dhe të kostos së përmirësimit të një pasurie të paluajtshme për strehim apo të një pasurie të paluajtshme tregtare. Financimi kryhet në mënyrë progresive, në varësi të fazave specifike të ecurisë së ndërtimit. Nëpërmjet këtij mekanizmi, vlera e kredisë së padisbursuar ecën krahas vlerës gjithnjë në rritje të pasurisë së paluajtshme (kolateralit). Këto kredi i akordohen vetëm bizneseve dhe klasifikohen si më poshtë:

- kredi për zhvillimin dhe përmirësimin e truallit;
- kredi për ndërtesa tregtare;
- kredi për ndërtesa rezidenciale.

Kreditë për zhvillimin dhe përmirësimin e truallit, janë kredi që kanë për qëllim blerjen dhe përmirësimin e truallit paraprakisht ngritjes së një ndërtese mbi të, e shoqëruar më pas me shitjen e pronës si një e tërë. Përmirësimi i truallit mund të përfshijë instalimin e utiliteteve të ndryshme, ndërtimin e një rruge etj..

Kreditë për ndërtesa tregtare, përmbledhin një gamë të gjerë ndërtimesh si: ngritjen e një fabrike; të një ndërtese, ku një firmë e caktuar do të zhvillojë aktivitetin e saj; të një godine për zyra; të qendrave tregtare; të hoteleve etj.. Kjo kërkon aftësi dhe njohuri të veçanta të kredimarrësit në mënyrë që të ndërtojë, të administrojë apo të shesë këtë ndërtesë.

Kreditë për ndërtesa për strehim, i jepen ose kredimarrësve që kanë qëllime "spekullimi" (ndërtesat ngrihen për t'ua shitur më pas blerësve anonimë), ose atyre që mbështeten mbi një marrëveshje me blerësit paraprakë (njësitë e reja të ndërtuara janë paraprakisht të shitura, blerësit e kanë kryer tashmë financimin e paravendosur, pra nuk janë anonimë). Situata financiare e ndërtuesit, përvoja dhe reputacioni i tij së

bashku me ekzistencën e një marrëdhënieje më të hershme me huadhënësin, janë faktorët kryesorë në përcaktimin e kushteve dhe të afateve të kredisë.

Nën kuadrin e Bazel I, kreditë për pasuri të paluajtshme konsiderohen si aktive me rrezik të lartë dhe ponderohen me koeficient 100 për qind. Bëjnë përjashtim kreditë për pasuri të paluajtshme për strehim, të kolateralizuara në mënyrë të plotë me anë të një hipoteke mbi një pronë rezidenciale, në pronësi të kredimarrësit që është në përdorim ose jepet me qira prej tij. Këto të fundit konsiderohen si aktive me rrezik të mesëm dhe kanë një koeficient ponderimi 50 për qind. Nën kuadrin e Akordit të Ri të Kapitalit (Bazel II), kreditë për pasuri të paluajtshme për strehim ponderohen me një koeficient preferencial prej 35 për qind, me kusht aplikimin e disa kritereve strikte prudenciale. Një koeficient ponderimi preferencial prej 50 për qind mund të aplikohet edhe për kreditë tregtare (vetëm për një pjesë të kredisë), me kusht plotësimin e disa kritereve operacionale specifike.

2.2 Sistemi bankar shqiptar dhe tregu i pasurive të paluajtshme

2.2.1 Kredia e akorduar nga sistemi bankar shqiptar për pasuri të paluajtshme

Viti 2006 dëshmoi për një shtrirje të konsiderueshme të sistemit bankar në kredidhënie. Kështu, gjatë vitit 2006, teprica e kredisë së sistemit bankar shënoi një rritje me 70.2 miliardë lekë[4] kundrejt 57.6 miliardë lekë në fund të vitit 2005. Ritmi i konsiderueshëm rritës i tepricës së kredisë, në krahasim me fundvitin 2005, është reflektuar edhe në ndryshimin e strukturës së kredisë sipas afatit: kredia afatshkurtër shënoi një rënie prej 0.7 për qind (25.6% në fund të vitit 2006 kundrejt 26.2% në fund të vitit 2005) duke u zhvendosur drejt asaj afatmesme, e cila shënoi një ritëm të lehtë rritjeje me rreth 0.18 për qind. Ndërsa, vihet re një rritje e kredisë afatgjatë, sidomos në krahasim me fundin e vitit 2005[5]. Raporti kredi për pasuri të paluajtshme ndaj totalit të tepricës së kredisë, shënon kulmin e tij në periudhën dhjetor 2005 - dhjetor 2006 (nga 13% në dhjetor 2005, në 19.39% në dhjetor 2006). Rrjedhojë kjo edhe

e një agresiviteti më të madh të treguar nga bankat e sistemit nëpërmjet ofertave promocionale "joshëse" për kredi për pasuri të paluajtshme. Zhvillimet strukturore sipas afatit në portofolin e kredive, reflektojnë një rritje të kërkesave për investime në pasuri të paluajtshme të individëve, por edhe të orientimit të bizneseve drejt investimeve në mjete të qëndrueshme, të nevojshme për përmirësimin e teknologjisë apo zhvillimin e mëtejshëm të aktivitetit.



Vëllimi i kredisë për pasuri të paluajtshme gjatë vitit 2006 është rritur me rreth 21.77 miliardë lekë, ose 131 për qind në krahasim me vitin paraardhës, ku peshën kryesore e zë sektori i individëve (prej 80.62%)[6] dhe monedha e huaj (me rreth 86%). Të njëjtin konstatim mund të bëjmë edhe përsa i përket gjashtëmujorit



të parë të vitit 2007, ku pavarësisht rritjes së vëllimit të kredisë për pasuri të paluajtshme me rreth 6.72 miliardë lekë, pesha e saj ndaj tepricës totale të kredisë prezanton tendencë në rënie gjatë periudhës në fjalë. Më konkretisht, raporti kredi për pasuri të paluajtshme ndaj totalit të tepricës së kredisë shënon vlerën 18.85 për qind në qershor 2007, kundrejt 19.39 për qind që shënonte në fund të dhjetor 2006[7]. Kjo situatë shpjegohet me ritmin më të lartë rritës të totalit të tepricës së kredisë kundrejt kredisë së akorduar për pasuri të paluajtshme gjatë periudhës në fjalë dhe respektivisht, 41.3 miliardë lekë kundrejt 6.71 miliardë lekë (shih grafikun nr.1).

Tiparet kryesore të procesit kredidhënës për pasuri të paluajtshme, të evidentuara gjatë viteve janë:

- *mbizotërimi i kredisë për pasuri të paluajtshme akorduar individëve* (grafiku 2). Kjo kredi zë peshën kryesore ndaj totalit të kredisë për pasuri të paluajtshme me 80.62 për qind, ndërkohë që pesha e kredisë akorduar bizneseve dhe jorezidentëve, llogaritet respektivisht prej 18.53 dhe 0.85 për qind; si dhe
- *mbizotërimi i kredisë për pasuri të paluajtshme akorduar në monedhë të huaj* (grafiku 3).



Megjithë mbizotërimin e kredisë për pasuri të paluajtshme në monedhë të huaj, vihet re një rritje e lehtë e peshës së kredisë

në monedhën vendase për periudhën dhjetor'01-dhjetor'06, nga 12.92 për qind në 13.42 për qind. Ndërkohë që viti 2006 shënon një ritëm rënës të saj prej 29 për qind ndaj dhjetor'05 (shih tabelën nr.1).

Tabelë 1. Kredia për pasuri të paluajtshme sipas monedhës në miliardë lekë.

	Dhjetor 2001	Dhjetor 2002	Dhjetor 2003	Dhjetor 2004	Dhjetor 2005	Dhjetor 2006
Kredia për pasuri të paluajtshme	4.21	6.66	7.92	10.62	16.61	12.062
Lekë	0.54	0.59	0.76	0.97	2.28	1.62
Valutë	3.67	6.07	7.16	9.65	14.33	10.44

Burimi: të dhënat janë marrë nga baza e të dhënave të Departamentit të Mbikëqyrjes.

2.2.2 Prezantimi i opinionit të bankave që operojnë në Shqipëri

Për identifikimin e llojeve të kredisë për pasuri të paluajtshme dhe rreziqet që procesi kredidhënës për pasuri të paluajtshme mbart, u hartua një pyetësor[8] për njohjen e opinionit të bankave të sistemit[9].

Mbështetur në rezultatet e pyetësorit, kredia për pasuri të paluajtshme klasifikohet në kategoritë e mëposhtme:

- *Kredi për investime në pasuri të paluajtshme për strehim*: janë kredi që i akordohen individëve me qëllim financimin e blerjes së një prone rezidenciale, objekt i kredisë. Kreditë për investime në pasuri të paluajtshme për strehim kolateralizohen në mënyrë të plotë me anë të një hipoteke mbi një pronë rezidenciale. Në varësi të faktit nëse pronësia e kolateralit përkon ose jo me kredimarrësin, këto kredi konsiderohen ose si aktive me rrezik të mesëm të ponderuara me një koeficient 50 për qind ose si aktive me rrezik të lartë, të ponderuara me një koeficient 100 për qind.
- *Kredi për investime në pasuri të paluajtshme tregtare:* janë kredi që i akordohen bizneseve, me qëllim financimin e blerjes ose të restaurimit të ambienteve për

ushtrimin e aktivitetit të tyre. Këtu mund të përmendim: i) blerjen e një ndërtesë të re jocivile, ii) restaurimin e një ndërtese ekzistuese ose iii) blerjen e një godine ekzistuese dhe/ose të tokës etj.. Kreditë për investime në pasuri të paluajtshme komerciale, kolateralizohen në mënyrë të plotë me anë të një hipoteke mbi një pasuri të paluajtshme, që mund të jetë ose jo në pronësi të kredimarrësit. Ndryshe nga kreditë rezidenciale, kreditë komerciale konsiderohen gjithmonë si aktive me rrezik të lartë me koeficient ponderimi 100 për qind.

- *Kreditë e kolateralizuara me pasuri të paluajtshme*: janë kredi që i akordohen si individëve, ashtu edhe bizneseve për qëllime të ndryshme, të kolateralizuara me pasuri të paluajtshme. Më konkretisht, evidentohen rastet e mëposhtme:

1. *individët, që kanë për qëllim ushtrimin e një aktiviteti,* financohen nga banka për blerjen e pasurive të paluajtshme, ku këta të fundit do të ushtrojnë veprimtarinë e tyre.
2. *Sektori privat*, në varësi të qëllimit:

i) *për zhvillim biznesi* financohet për blerjen e pajisjeve dhe të makinerive të ndryshme;

ii) *për tregti* financohet nëpërmjet kredive kufi (overdrafteve) ose kredive për kapital qarkullues, për të plotësuar nevojat afatshkurtra për likuiditet.

Edhe ky grup kredish, që kolateralizohet me anë të një hipoteke mbi një pasuri të paluajtshme[10] që mund të jetë ose jo në pronësi të kredimarrësit, konsiderohet me rrezik të lartë dhe me koeficient ponderimi 100 për qind.

2.2.3 Rreziqet që mbart huadhënia bankare për pasuri të paluajtshme

Huadhënia bankare për pasuri të paluajtshme ekspozon bankën kundrejt dy rreziqeve specifike:

- rreziku i lidhur me huamarrësin;
- rreziku i lidhur me pasurinë e paluajtshme që garanton kredinë.

A. Rreziqet e lidhura me huamarrësin

Ekzistojnë dy kategori të ndryshme huamarrësish, individët dhe bizneset. Huamarrësit individë kanë një nxitje të fortë për të paguar kreditë e tyre, kjo për të mos humbur titullin e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme (apartamentin apo shtëpinë). Sidoqoftë, disa huamarrës individë mund të dështojnë në përmbushjen e detyrimeve që lindin nga kontrata e kredisë, falë disa faktorëve si:

- borxhi ndaj bankës rrit kostot që individi duhet të përballojë;
- situatë ekonomike jo e favorshme, përfshirë edhe rritjen e kostos së jetesës dhe të normave të interesit;
- një rënie e të ardhurave për shembull në rastin e ndryshimit të vendit të punës apo humbjes së tij;
- një ndryshim i statusit civil (divorc) apo një ndryshim (rritje) në bërthamën familiare.

Ndërsa në rastin kur huamarrës janë bizneset, aftësia e tyre paguese mund të ndikohet nga:

- kushtet ekonomike, si lëvizje jo të favorshme të kërkesës;
- rritja e konkurrencës dhe e normave të interesit;
- përkeqësim i administrimit të firmës apo biznesit në tërësi.

B. Rreziqet e lidhura me pasurinë e paluajtshme që garanton kredinë

Huadhënësi duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë situatave dhe rrethanave që mund të ndikojnë në vlerën e pasurisë së paluajtshme. Për këtë arsye, rivlerësimi i vlerës së pasurisë së paluajtshme (kolateralit) nga ana e bankës mbi baza të rregullta kohore, është tepër i rëndësishëm. Rreziqet e lidhura me pasurinë e paluajtshme që garanton kredinë, mund të lindin nga:

- *Natyra e tregut të pasurive të paluajtshme:* pasuritë e paluajtshme janë të prirura ndaj luhatjes së çmimeve. Tregjet e pasurive të paluajtshme mund të preken nga faktorë të ndryshëm dhe një ulje e çmimeve mund të

gërryejë në mënyrë të përshpejtuar marzhin mbrojtës të huadhënësit[11]. Si rezultat, huadhënia e kolateralizuar me pasuri të paluajtshme mbart rreziqe që duhet të monitorohen dhe kontrollohen rregullisht.

- *Ngjarje katastrofike:* pasuritë e paluajtshme mund të pësojnë dëme të konsiderueshme apo dhe të shkatërrohen plotësisht, në raste ngjarjesh katastrofike si për shembull: zjarre, përmbytje, akte terroriste dhe luftra. Në këto raste, huadhënësi kushtëzon akordimin e kredisë me siguracion mbi pasurinë e paluajtshme në favor të tij, duke zvogëluar rrezikun e ndërmarrë nga banka gjatë procesit kredidhënës.
- *Ndryshime në kushtet ekonomike të vendit:* përkeqësimet ekonomike mund të ndikojnë në mënyrë jo të favorshme mbi aftësinë paguese të klientelës. Në të njëjtën kohë, mund të zvogëlojnë mbulimin e kredisë me kolateral, duke rritur në këtë mënyrë ekspozimin e bankës për shumën e kredisë të pambuluar me kolateral.
- *Çështje ligjore:* ligjet, zbatimi i tyre dhe vonesa të ndryshme burokratike mund të ndikojnë drejtpërdrejt mbi aftësinë e huadhënësit për të fituar titullin e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme[12]. Gjatë këtyre vonesave, vlera e kolateralit mund të përkeqësohet sepse huamarrësi mund të mos jetë në gjendje të kryejë financime shtesë për të mirëmbajtur pasurinë e paluajtshme. Kështu, ekzekutimi i kolateralit në mënyrë jo të duhur, jo me shpejtësi dhe mbi të gjitha me kosto për bankën, potencialisht rrit ekspozimin e bankës ndaj një zhvlerësimi të mundshëm të vlerës së këtij të fundit.

Llojet e mësipërme të rreziqeve, duhet të vlerësohen në mënyrën më të saktë të mundshme nga banka. Megjithatë, bankat duhet të shmangin akordimin e kredive duke u bazuar vetëm mbi vlerën e kolateralit të ofruar për të mbuluar kredinë, sepse në rast falimentimi të kredimarrësit, pasuritë e paluajtshme që ofrohen si kolaterali fizik shpesh janë të vështira për t'u likuiduar. Pra, element parësor gjatë procesit kredidhënës mbetet vlerësimi i aftësisë paguese të kredimarrësit. Kjo do të thotë që bankat duhet të fokusohen më shumë mbi analizën e të ardhurave,

të aseteve likuide, të historikut të punësimit të kredimarrësit, të historikut të marrëdhënieve me bankën dhe mbi detyrimet e ndryshme që kredimarrësi mund të ketë, për arsye se *kolaterali luan rolin e një burimi mbrojtës dytësor për bankën*.

Teprica totale e kredisë me probleme në sistemin bankar shqiptar është rritur ndjeshëm, duke arritur vlerën 7334.86 milionë lekë në qershor'07, nga 6047.24 milionë lekë që shënonte në fund të vitit 2006 dhe 2981.36 milionë lekë, në fund të vitit 2005. Edhe kredia me probleme për pasuri të paluajtshme shënon një rritje të konsiderueshme për periudhën dhjetor'05 - dhjetor'06, duke arritur në 604.7 milionë lekë ndaj 214.01 milionë lekëve, gjatë vitit 2005 ose e thënë ndryshe, është rritur me 182.56 për qind. Këtë prirje rritëse, e vërejmë edhe për periudhën dhjetor'06-qershor'07, kur kjo e fundit është rritur me 249.3 milionë lekë. Megjithatë, vëllimi i kredisë me probleme për pasuri të paluajtshme krahasuar me vëllimin e tepricës totale të kredisë me probleme, mbetet ende në nivele të ulta; respektivisht 604.7 milionë lekë kundrejt 6047.24 milionë lekë në fund të dhjetor'06 dhe 854.02 milionë lekë kundrejt 7334.86 milionë lekëve në qershor'07. Të njëjtin përfundim mund të nxjerrim edhe për peshën e kredisë me probleme për pasuri të paluajtshme kundrejt tepricës totale të kredisë me probleme. Kjo peshë, ndonëse ka ardhur duke u rritur gjatë trevjeçarit të fundit, zë ende një përqindje relativisht të vogël, prej 10 për qind ndaj tepricës totale të kredisë me probleme,

Grafik 4. Raporti i kredive me probleme (milionë lekë).

në fund të dhjetor'06 dhe 11.64 për qind në qershor'07; por sidoqoftë duhet monitoruar në vazhdimësi (shih grafikun 4).

Ecuria e cilësisë së portofolit të kredisë për pasuri të paluajtshme gjatë periudhës dhjetor'01-qershor'07 është karakterizuar nga një prirje rritëse e totalit të kredisë për pasuri të paluajtshme. Kjo prirje nga ana e saj, është karakterizuar nga vlera gjithnjë në rritje të vëllimit të kredisë cilësore[13]. Këto vlera kanë qenë disa herë më të larta krahasuar me vlerat e arritura të vëllimit të kredisë me probleme (shih grafikun 5).



Kredia me probleme shënon një rritje të lehtë për periudhën dhjetor'01-dhjetor'02, thuajse përgjysmohet gjatë dhjetor'03 për t'u rritur sërish gjatë periudhës dhjetor'04-dhjetor'05 (shih tabelën 2).

Tabelë 2. Kredia për pasuri të paluajtshme sipas cilësisë.

	Dhjetor' 01	Dhjetor '02	Dhjetor '03	Dhjetor '04	Dhjetor '05	Dhjetor '06	Qershor '07
Kredi për pasuri të paluajtshme total (mln lekë)	4,214.57	6,656.42	7,923.10	10,622.29	16,612.65	38,378.94	45,098.57
Kredi për pasuri të paluajtshme me probleme (mln lekë)	259.99	262.12	132.74	186.05	214.01	604.70	854.02
Kredi për pasuri të paluajtshme cilësore (mln lekë)	3,954.58	6,394.30	7,790.36	10,436.24	16,398.64	37,774.24	44,244.56

Burimi: të dhënat janë marrë nga baza e të dhënave të Departamentit të Mbikëqyrjes.

Bazuar në tabelën e mësipërme mund të themi se cilësia e portofolit të kredisë për pasuri të paluajtshme aktualisht mbetet e mirë. Vlera të ulta të kredisë me probleme për pasuri të paluajtshme, shpjegohen me faktin se kredia e re për pasuri të paluajtshme ka shënuar një rritje të shpejtë gjatë periudhës dhjetor'05-qershor'07 dhe sepse përvoja ndërkombëtare sugjeron që një rritje e shpejtë e portofolit të kredisë shoqërohet me një përkeqësim të tij në periudha të mëvonshme.

3. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

3.1. Konkluzione

- Viti 2006 dëshmoi për një shtrirje të konsiderueshme të sistemit bankar në kredidhënie. Kështu, gjatë vitit 2006, teprica e kredisë së sistemit bankar shënoi një rritje me 70.2 miliardë lekë[14] kundrejt 57.6 miliardë lekë, në fund të vitit 2005. Vëllimi i kredisë për pasuri të paluajtshme është rritur me rreth 21.77 miliardë lekë, gjatë vitit 2006 (ose 131 për qind në krahasim me vitin paraardhës), duke zënë tashmë një peshë prej 19.39 për qind ndaj tepricës totale të kredisë.
- Kredia me probleme për pasuri të paluajtshme shënon një rritje të konsiderueshme për periudhën dhjetor'05 -dhjetor'06 me rreth 182.56 për qind (604.7milionë lekë ndaj 214.01 milionë lekëve, gjatë vitit 2004) dhe kontributi i saj në rritjen e tepricës totale të kredisë me probleme të sistemit bankar shqiptar për vitin 2006, llogaritet në 10 për qind.
- Pesha e kredisë me probleme për pasuri të paluajtshme kundrejt tepricës totale të kredisë me probleme, ka ardhur duke u rritur gjatë trevjeçarit të fundit, nga 6.29 për qind gjatë vitit 2004, në 7.18 për qind gjatë vitit 2005 dhe shënon një vlerë prej 10 për qind në fund të vitit 2006, duke parashtruar nevojën e monitorimit të kujdesshëm të këtij fenomeni në vazhdimësi.
- Ecuria e cilësisë së portofolit të kredisë për pasuri të paluajtshme gjatë periudhës dhjetor'01-qershor'07

(respektivisht 45,098.57 milionë lekë kundrejt 4,214.57 milionë lekëve) është karakterizuar nga një prirje rritëse e totalit të kredisë për pasuri të paluajtshme. Kjo prirje, evidenton vlera në rritje të vëllimit të kredisë cilësore dhe vlera krahasimisht më të ulta të vëllimit të kredisë me probleme, duke dëshmuar për një cilësi aktualisht të mirë të këtij portofoli. Megjithatë, ende nuk mund të nxjerrim ndonjë konkluzion mbi ecurinë e pritshme të portofolit për pasuri të paluajtshme, sepse vlerat e ulta të kredisë me probleme për pasuri të paluajtshme me probleme, mund të shpjegohen jo vetëm me faktin që kredia e re për pasuri të paluajtshme është rritur shpejt gjatë periudhës në fjalë, por edhe sepse përvoja ndërkombëtare sugjeron, që një rritje e shpejtë e portofolit të kredisë shoqërohet me një përkeqësim të tij, në periudha të mëvonshme.

- Tiparet kryesore të procesit kredidhënës për pasuri të paluajtshme janë mbizotërimi i kredisë për pasuri të paluajtshme akorduar individëve dhe mbizotërimi i kredisë për pasuri të paluajtshme, në monedhë të huaj. Kredia për pasuri të paluajtshme për individë, zë peshën kryesore ndaj totalit të kredisë për pasuri të paluajtshme me 80.62 për qind, ndërkohë që pesha e kredisë së akorduar bizneseve dhe jorezidentëve llogaritet respektivisht me 18.53 dhe 0.85 për qind. Kredia për pasuri të paluajtshme në monedhë të huaj, zë 86.58 për qind të portofolit të kredisë për pasuri të paluajtshme për vitin 2006. Megjithë mbizotërimin e kredisë për pasuri të paluajtshme në monedhë të huaj, vihet re një rritje e lehtë e peshës së kredisë në monedhën vendase për periudhën dhjetor '01-dhjetor '06, nga 12.92 për qind në 13.42 për qind.
- Kredia për pasuri të paluajtshme në sistemin bankar shqiptar ndahet në klasat: i) kredi për investime në pasuri të paluajtshme për strehim; ii) kredi për investime në pasuri të paluajtshme tregtare; iii) kredi të kolateralizuara me pasuri të paluajtshme. Nga intervistat e kryera në disa prej bankave të sistemit rreth 90 për qind e kolateralit të pranuar nga bankat, për kredi të

ndryshme nga ato për pasuri të paluajtshme, përbëhet nga pasuri të paluajtshme.

- Dy janë llojet e rreziqeve që shoqërojnë kredinë për pasuri të paluajtshme: i) rreziqet e lidhura me huamarrësin; ii) rreziqet e lidhura me pasurinë e paluajtshme që garanton kredinë.
- Ndër faktorët kryesorë që shpjegojnë situatën aktuale të nivelit të kredisë për pasuri të paluajtshme, bankat e sistemit evidentojnë si faktorë nxitës ashtu edhe pengues për zhvillimin e mëtejshëm të procesit kredidhënës. Përsa i përket faktorëve nxitës, bankat evidentojnë rritjen e kërkesës për kredi për pasuri të paluajtshme dhe rritjen e konkurrencialitetit në sistemin bankar, ndërsa si faktor pengues mungesën e tregut dytësor të kolateralit.
- Pritshmëria e sistemit bankar për portofolin e kredisë për pasuri të paluajtshme është pozitive, domethënë nga pjesa më e madhe e bankave të sistemit pritet një rritje e portofolit si për individët, ashtu dhe për sektorin privat. Bankat shprehen për një rritje të mëtejshme të çmimit të truallit dhe të ambienteve të biznesit, ndërsa janë më të lëkundura mbi ecurinë e çmimit të apartamenteve.

3.2 Rekomandime

- Pjesa më e madhe e bankave të sistemit rivlerësojnë si gjendjen financiare të kredimarrësit ashtu dhe vlerën e kolateralit, në një hark kohor mbi një vit ose në rastet e një kërkese të re apo paralele për kredi të klientelës. Një ndryshim i mundshëm i çmimit të pasurive të paluajtshme mund të ketë një ndikim domethënës jo vetëm në nivelin e përgjithshëm të mirëqenies të konsumatorit, por dhe mbi vlerën e kredive të kolateralizuara me pasuri të paluajtshme, sepse potencialisht ndikojnë si mbi ekspozimin e bankave ashtu dhe mbi cilësinë e portofolit të kredisë. Për këtë arsye, bankat duhet të jenë më të kujdesshme dhe të vlerësojnë mbi baza të rregullta kohore gjendjen financiare të kredimarrësit dhe kolateralin.
- Një rritje e vlerës së kolateralit si rrjedhojë e rritjes së

çmimit të pasurive të paluajtshme, mund të çojë në një rritje akoma dhe më të madhe të kërkesës për kredi. Kjo rritje e kërkesës për kredi, mund të ndikojë mbi konservatorizmin e bankave të sistemit[15] në përmbushjen e kërkesave specifike për të pasur akses në kredimarrje, duke rritur fleksibilitetin e tyre dhe duke ndikuar rrjedhimisht, në shfaqjen e problemeve në periudha të mëvonshme. Prandaj, bankat duhet të jenë tepër rigoroze në zbatimin e rregulloreve dhe politikave të brendshme të kredidhënies.

ANEKS

1. Sipas opinionit tuaj, sa për qind e kolateralit aktual të bankës për kredi hipotekore (për pasuri të paluajtshme) zë secili nga llojet mëposhtme?

Truall	____%	Ambiente për biznes	____%
Apartamente	____%	Të tjera	____%

Në grafikun 1 jepen rezultatet e përbërjes së kolateralit të bankave të sistemit për kredinë hipotekore (për pasuri të paluajtshme), ku peshën kryesore e zënë apartamentet me 50.4 për qind.

Karakteristikë e përbashkët e gjitha bankave të intervistuara është se si për kredinë hipotekore ashtu dhe për kredinë për pasuri të paluajtshme, kolaterali i pranuar nga bankat mund të jetë ose jo në pronësi të kredimarrësit. Pasuritë e paluajtshme të pranuara si kolateral, preferohet të kenë një vendndodhje në qytetet kryesore të Shqipërisë, kryesisht Tiranë dhe Durrës dhe, në rastet kur pronësia e kolateralit nuk përputhet me kredimarrësin, titullari i kolateralit duhet të ketë një lidhje të ngushtë me kredimarrësin dhe mundësisht marrëdhënie me vetë bankën huadhënëse.

Tjetër karakteristikë është dhe fakti se mbi 90 për qind e kolateralit total të pranuar nga bankat e intervistuara, për kredi të ndryshme nga ato për pasuri të paluajtshme, përbëhet nga pasuri të paluajtshme.

2. Cila është metoda që përdor banka juaj për vlerësimin e kolateralit?

Metoda e kostos aktuale	!_!
Vlera e tregut	!X!
Metoda e çmimit të blerjes	!_!
Metoda e aktualizimit të fluksit të të ardhurave të pritshme	!_!

Të gjitha bankat e sistemit për vlerësimin e kolateralit përdorin metodën e vlerës së tregut.

3. Cila është shpeshtësia e rivlerësimit të kolateralit?

Një herë në vit !_! Mbi një vit !_!

Në lidhje me shpeshtësinë e vlerësimit të kolateralit, vetëm pesë nga bankat e sistemit (ose 31 % e tyre) e rivlerësojnë çdo vit, ndërsa njëmbëdhjetë bankat e tjera (ose pjesa mbizotëruese e tyre prej 69%), e rivlerësojnë kolateralin në periudha kohore kryesisht mbi një vit apo në rastet kur ka një kërkesë të re ose paralele për kredi, të klientelës.

4. Banka në vlerësimin e kolateralit mbështetet në:

1. Vlerësues të brendshëm !_!
2. Vlerësues të jashtëm !_!

Dymbëdhjetë prej bankave të sistemit (ose 75% e tyre), mbështeten vetëm mbi vlerësues të jashtëm, kurse katër prej bankave të sistemit (ose 25% e tyre), kanë si vlerësues të jashtëm ashtu edhe vlerësues të brendshëm për vlerësimin e kolateralit. Për t'u vlerësuar është rasti i Bankës Kombëtare Tregtare, e cila ka ngritur një strukturë *ad hoc* "Departamenti i vlerësimit dhe mirëmbajtjes së godinave". Kjo strukturë, mbi baza të rregullta kohore, rivlerëson mirëmbajtjen e pasurisë së paluajtshme nga klienti kredimarrës, si një masë më e fortë mbrojtëse për bankën në fjalë.

5. Ju lutem specifikoni cili është raporti "vëllimi i kredisë" / të ardhurat vjetore për secilin grup:

1. Individë !_!
2. Biznes !_!
N.A.

6. Cilat janë normat vjetore të interesit (bazë+*spread*) sipas monedhës, për kredinë hipotekore për:

	Lekë	Euro	Usd
1. Individë	!_!	!_!	!_!
2. Biznes	!_!	!_!	!_!

Në lidhje me këtë pyetje konkludojmë se bankat e sistemit aplikojnë si norma interesi fikse ashtu dhe norma interesi të luhatshme për monedhën vendase dhe për ato të huaja (kryesisht euro dhe usd). Në tabelën nr.1, jepen vlerat minimale dhe maksimale të normave fikse të interesit që aplikohen nga bankat e sistemit për kredinë hipotekore në monedhën vendase dhe të huaj. Norma fikse e interesit që aplikohet për monedhën vendase, si për individët ashtu edhe për bizneset, luhatet kryesisht përgjatë vlerave më të vogla se 10 për qind dhe më të mëdha se 13 për qind, ku peshën kryesore e zënë normat e interesit më të mëdha se 13 për qind (19% e bankave të sistemit aplikojnë këto norma interesi respektivisht për individët dhe bizneset). Ndërsa normat fikse të interesit për monedhën euro dhe dollar amerikan, variojnë nga minimalisht më të vogla se 9 për qind deri maksimalisht 9-13 për qind, si për individët dhe për bizneset. Peshën kryesore për monedhën euro e zënë normat e interesit më të vogla se 9 për qind për individët dhe bizneset (respektivisht 21% dhe 23% e bankave të sistemit), ndërsa për monedhën dollar amerikan e zënë normat e interesit që variojnë në intervalin 9-13 për qind për individët dhe bizneset (respektivisht 25% e bankave të sistemit). Pra, mund të themi se si për individët ashtu dhe për bizneset normat fikse të interesit në monedhën vendase janë më të larta krahasuar me normat fikse të interesit, që aplikohen për monedhat e huaja.

Tabelë 1. Normat e interesit sipas monedhës.

	Individë		Biznese	
	Vlera minimale	Vlera maksimale	Vlera minimale	Vlera maksimale
Norma interesi fikse në ALL (%)	<10%	>13%	<10%	>13%
Norma interesi fikse në euro dhe usd (%)	<9%	9-13%	<9%	9-13%

Në tabelën 2 jepet një përmbledhje e normave të luhatshme të interesit për monedhën vendase, euron dhe dollarin amerikan. Norma e luhatshme e interesit që aplikohet për

monedhën vendase, si për individët ashtu edhe për bizneset, luhatet kryesisht përgjatë vlerave minimale BTh+3/+5 për qind dhe maksimale BTh+5/+7 për qind, ku peshën kryesore si për individët dhe për bizneset e zënë normat e interesit BTh+3/+5 për qind (respektivisht 38% dhe 31% e sistemit bankar aplikojnë këto norma interesi). Në lidhje me monedhën euro këto norma interesi variojnë minimalisht euribor+2.5/+3.5 për qind deri në maksimalisht euribor+>7për qind, si për individët dhe për bizneset. Peshën kryesore e zënë normat e interesit euribor+5.5/+7.5 për qind (për individët e aplikojnë 29% e bankave dhe për bizneset 31% e tyre).

Për monedhën dollar amerikan, këto norma variojnë minimalisht libor+2.5/+3.5 për qind deri maksimalisht libor+>7për qind si për individët dhe për bizneset. Peshën kryesore e zënë normat e interesit libor+3.5/+5.5 për qind (për individët e aplikojnë 25% e bankave dhe për bizneset 19% e tyre). Pra, edhe në këtë rast normat e luhatshme të interesit në monedhën vendase janë më të larta, si për individët ashtu edhe për bizneset, krahasuar me normat e interesit që aplikohen nga bankat për monedhat e huaja.

Tabelë 2. Normat e interesit sipas monedhës.

	Individë		Biznese	
	Vlera minimale	Vlera maksimale	Vlera minimale	Vlera maksimale
Norma interesi të luhatshme në ALL (%)	BTh+3-5%	BTh+7-9%	BTh+3-5%	BTh+7-9%
Norma interesi të luhatshme në euro (%)	Euribor+2.5-3.5%	Euribor+>7%	Euribor+2.5-3.5%	Eur+>7%
Norma interesi të luhatshme në usd (%)	Libor+2.5-3.5%	Libor+>7%	Libor+2.5-3.5%	Libor+>7%

7. Cilat janë afatet e maturimit sipas monedhës, të kredisë hipotekore për:

	Lekë		Euro		Usd	
	Min	Max	Min	Max	Min	Max
1. Individë						
2. Biznes						

Afatet kohore të maturimit të monedhës vendase, të monedhës euro dhe dollar amerikan për individët variojnë nga minimalisht 5 vjet deri maksimalisht 20 vjet (shih tabelën 3). Për sektorin privat afatet kohore janë maksimalisht deri në 20 vjet për monedhën vendase, kurse për monedhat e huaja janë më afatshkurtra, maksimalisht deri në pesëmbëdhjetë vjet. Peshën më të madhe për individët në monedhën vendase e zë afati i maturimit 15-20 vjet dhe për sektorin privat afati i maturimit 5-10 vjet. Për monedhën euro dhe monedhën usd, peshën kryesore për individët e zë afati i maturimit 15-20 vjet dhe për bizneset afati i maturimit 5-10 vjet. Pra, shohim një linearitet përsa i përket afateve të maturimit për të treja monedhat, si për individët dhe për bizneset.

Tabelë 3. Afatet e maturimit sipas monedhës.

	Individë		Biznese	
	Vlera minimale	Vlera maksimale	Vlera minimale	Vlera maksimale
Afatet e maturimit për ALL (në vite)	<=5vjet	15-20 vjet	<=5vjet	15-20 vjet
Afatet e maturimit për euro (në vite)	<=5vjet	15-20 vjet	<=5vjet	10-15 vjet
Afatet e maturimit për usd (në vite)	<=5vjet	15-20 vjet	<=5vjet	10-15 vjet

8. Ju lutem vlerësoni sipas rëndësisë kriteret që përdor banka juaj në gjykimin e saj mbi aftësinë paguese të klientelës (ku 1 faktori më pak i rëndësishëm dhe 5 ai më i rëndësishëm):

1. Kolateral i fuqishëm
1 2 3 4 5
2. Kapacitet dhe aftësi në administrimin e biznesit
1 2 3 4 5
3. Biznesi i kredimarrësit është i mirëkapitalizuar
1 2 3 4 5
4. Emri i mirë dhe reputacioni i kredimarrësit
1 2 3 4 5
5. Historiku i kredimarrësit në pagesën e principalit dhe të interesit
1 2 3 4 5
6. Gjendja financiare
1 2 3 4 5
7. Të tjera (specifiko)
1 2 3 4 5

Më poshtë renditen kriteret e përzgjedhura, sipas rëndësisë, nga bankat e sistemit në lidhje me gjykimin e tyre mbi aftësinë paguese të klientelës:

- gjendja financiare e kredimarrësit;
- kapaciteti dhe aftësia në administrimin e biznesit si dhe historiku i kredimarrësit në pagesën e principalit dhe interesit, janë vlerësuar njësoj të rëndësishme nga bankat e sistemit;
- kolaterali i fuqishëm, emri i mirë dhe reputacioni i kredimarrësit, janë vlerësuar njësoj të rëndësishëm;
- mirëkapitalizimi i biznesit të kredimarrësit;
- të tjera.

9. Nëse ka, cilët janë kufijtë që përdor banka juaj për mbulimin e kredisë hipotekore me kolateral për secilin grup?

Individë _____% Biznes_____%

Tabelë 4. Raporti i mbulimit të kredisë me kolateral.

	Individë		Biznese	
	Vlera minimale	Vlera maksimale	Vlera minimale	Vlera maksimale
Vlera kredisë/Vlera kolateralit në %	120-130%	>150%	100-120%	>150%

Në tabelën nr.4 jepen kufijtë e përdorur nga bankat e sistemit për të mbuluar vlerën e kredisë me kolateral. Kufijtë minimalë të këtij raporti janë më të lartë për individët krahasuar me bizneset, ndërsa kufijtë maksimalë ofrojnë të njëjtin mbulim të kredisë me vlerën e kolateralit. Pesha mesatare e këtij raporti si për individët ashtu dhe për bizneset luhatet në kufijtë 130-140 për qind.

10. Keni patur procedura të ekzekutimit të kolateralit në bankën tuaj?

Po !_! Jo !_!

Pjesa më e madhe e bankave të sistemit (67% e tyre) deklarojnë se kanë patur procedura të ekzekutimit të kolateralit, ndërsa vetëm një pjesë e tyre (33%) deklarojnë se nuk kanë patur raste të tilla.

11. Nëse po, sa muaj kanë zgjatur procedurat e ekzekutimit të kolaterialit për secilin grup?

Individë _____ Biznese_____

Këto procedura në shumicën e bankave, si për individët dhe për bizneset, kanë zgjatur për një periudhë kohore mbi një vit.

12. Në rast se mendoni se procedurat e ekzekutimit të kolaterialit janë të tejzgjatura, cili nga faktorët e mëposhtëm ndikon më shumë:

Problemet sociale _____
Problemet ligjore _____
Të tjera (specifiko) _____

Si pengesë kryesore për përshpejtimin e procedurave të ekzekutimit të kolateralit bankat e sistemit rendisin problemet ligjore, në 87 për qind të rasteve.

13. Sipas gjykimit tuaj, si do të ndikonte në vëllimin e kredisë për pasuri të paluajtshme një përshpejtim i procedurave të ekzekutimit të kolateralit:

	Do të rritet	E njëjtë	Do të ulet
1. individët	!_!	!_!	!_!
2. biznesi	!_!	!_!	!_!

Pyetjes se si do të ndikonte në vëllimin e kredisë një përshpejtim i këtyre procedurave, shumica e bankave iu përgjigjën se si për individët (67% e bankave të sistemit), ashtu edhe për bizneset (64% e tyre), një gjë e tillë do të ndikonte pozitivisht.

14. Vlerësoni sipas rëndësisë secilin nga faktorët e mëposhtëm, që shpjegon situatën aktuale të nivelit të kredive për pasuri të paluajtshme (ku 1 faktori më pak i rëndësishëm dhe 5 ai më i rëndësishëm):

1. Rritja e konkurrencialitetit në sistemin bankar, ka ndihmuar

në një akses më të madh të klientelës në kredinë për pasuri të paluajtshme
1 2 3 4 5

2. Rritja e kërkesës për kredi për pasuri të paluajtshme (lëvizjet demografike) ka ndikuar në rritjen e nivelit të huadhënies
1 2 3 4 5

3. Pritshmëria për rritje të çmimit të pasurive të paluajtshme
1 2 3 4 5

4. Diversifikimi më i mirë i portofolit
1 2 3 4 5

5. Mungesa e tregut dytësor të kolateralit
1 2 3 4 5

6. Të tjera (specifiko)
1 2 3 4 5

Më poshtë renditen faktorët e përzgjedhur nga bankat e sistemit sipas rëndësisë, në lidhje me gjykimin e tyre mbi situatën aktuale të kredisë për pasuri të paluajtshme:

- rritja e kërkesës për kredi për pasuri të paluajtshme;
- rritja e konkurrencialitetit në sistemin bankar;
- mungesa e tregut dytësor të kolateralit;
- pritshmëria për rritje të çmimit të pasurive të paluajtshme;
- diversifikimi më i mirë i portofolit;
- të tjera, është renditur edhe niveli i jetesës.

15. Sipas gjykimit tuaj, cila do të jetë ecuria e portofolit të pasurive të paluajtshme në të ardhmen për:

	Do të rritet	E njëjtë	Do të ulet
1. individët	!_!	!_!	!_!
2. biznesin	!_!	!_!	!_!

Pyetjes se cila do të jetë ecuria e portofolit të pasurive të paluajtshme në të ardhmen për individët dhe bizneset, shumica e bankave iu përgjigjën kryesisht se presin që të rritet, për të dyja kategoritë (75% dhe 60% e bankave të sistemit presin një rritje të kërkesës respektivisht për individët dhe sektorin privat) ndërsa vetëm pak prej tyre shprehen se nuk do të ndryshojë (25% dhe 33% e tyre).

16. Cili është gjykimi juaj mbi ecurinë e çmimit të pasurive të paluajtshme në të ardhmen:

	Truall	Apartament	Ambiente biznesi	Të tjera
Më i ulët	!_!	!_!	!_!	!_!
Më i lartë	!_!	!_!	!_!	!_!
Njësoj	!_!	!_!	!_!	!_!

Në lidhje me gjykimin mbi ecurinë e çmimit të pasurive të paluajtshme në të ardhmen, 94 për qind e bankave u shprehën se presin një rritje të çmimit të truallit, 93 për qind u shprehën për një rritje të çmimit të ambienteve të biznesit, 60 për qind për një rritje të çmimit të apartamenteve dhe 67 për zërin " të tjera". Pra, mund të nxjerrim si konkluzion se sistemi bankar ka pritshmëri për një rritje të çmimeve të pasurive të paluajtshme (shih tabelën 5).

Tabelë 5. Ecuria e çmimit të pasurive të paluajtshme.

	Më i ulët	Më i lartë	I njëjtë	N/a
Truall në%		94%	6%	0%
Apartamente në %		60%	40%	7%
Ambiente biznesi në %		93%	7%	14%
Të tjera në %		67%	33%	33%

17. Cilat do të ishin masat që do të merrte banka juaj në rast të një zhvlerësimi të vlerës së kolateralit (rënie e çmimit)?

Kësaj pyetjeje 43 për qind e bankave të sistemit iu përgjigjën që nuk do të merrnin asnjë masë sepse janë shumë mirë të mbrojtura nëpërmjet raportit të mbulimit të vlerës së kredisë/ vlerën e kolateralit; 43 për qind e bankave iu përgjigjën se do të kërkonin kolateral shtesë; ndërsa 14 për qind prej bankave thjesht do të kërkonin një monitorim dhe rivlerësim të kolateralit.

SHËNIME

* Përgatitur nga: *Juna Bozdo, specialiste, Zyra e Analizave Ekonomike*, Tetor 2007.
Mendimet e shprehura në këtë artikull janë të autorit dhe nuk përputhen domosdoshmërisht me opinionin zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
[1] Në shumicën e vendeve të industrializuara si: Portugali, Irlandë, Spanjë dhe Greqi, kredia për pasuri të paluajtshme zë një të tretën dhe në disa raste edhe më shumë të totalit të kredisë bankare. Të dhënat janë publikuar nga European Mortgage Federation.
[2] Në lidhje me standardet ndërkombëtare mbikëqyrëse do t'i referohemi kuadrit rregullator në fuqi, Bazel I.
[3] Për shembull, norma interesi të luhatshme përdoren në Britaninë e Madhe ndërsa fikse (për një periudhë nga 5-10 vjet) në Gjermani. Ndryshime ekzistojnë edhe në lidhje me shlyerjen e parakohshme të kredisë. Në Gjermani lejohet një gjë e tillë por kredimarrësi është i detyruar të paguajë një gjobë, ndërsa në SHBA, ku afatet e maturimit shkojnë deri në 30 vjet, nuk paguhet asgjë.
[4] Ndërsa teprica e kredisë në lekë është rritur me 24.44 miliardë lekë ose 78.2 për qind, ajo në valutë shënon rritje me 45.73 miliardë lekë ose 47.4 për qind.
[5] Kredia afatshkurtër zë një peshë prej 25.6% ndaj tepricës së kredisë gjatë 2006, kundrejt 26.2 për qind të vitit 2005. Kredia afatmesme zë një peshë prej 30.78 për qind (30.6 për qind gjatë 2005) ndaj tepricës së kredisë për vitin 2006, duke u zhvendosur këto të fundit drejt kredisë afatgjatë, e cila arrin në 38.4 për qind gjatë vitit 2006, krahasuar me 36.2 për qind në fundvitin 2005.
[6] Të dhënat janë marrë nga Sistemi Raportues i Unifikuar.
[7] Sidoqoftë, nuk mund të dalim në një konkluzion të saktë, pasi duhet pritur fundi i vitit 2007 për të parë vlerën që kjo kredi do të shënojë dhe në këtë mënyrë, do të mund të bëjmë krahasimet e nevojshme.
[8] Një përmbledhje e këtij pyetësori dhe e rezultateve të tij është paraqitur në fund të këtij materiali.
[9] Për këtë qëllim u kryen disa intervista me drejtues dhe punonjës të tjerë në bankat e mëposhtme: Banka Amerikane e Shqipërisë, Banka Italo-Shqiptare, Dega në Tiranë e Bankës Alpha, Banka Tirana, Banka ProCredit, Banka Raiffeisen, Banka Kombëtare Tregtare, Dega në Tiranë e Bankës Kombëtare Greke, Banka Credins, Banka Popullore dhe Banka Emporiki.
[10] Pasuria e paluajtshme me anë të të cilës kolateralizohet kredia konsiderohej si kolateral kryesor nga bankat, ndërsa si kolateral shtesë mund të kërkohej edhe peng mbi makineri dhe pajisje
[11] Për shembull, ndërtimi i një autostrade, i një kompleksi tregtar apo çdo ndryshim që lejon ndërtime të padëshiruara/dëshiruara në zonat përreth pasurisë së paluajtshme që garanton kredinë, mund të ketë një efekt negativ/pozitiv mbi vlerën e kolateralit.
[12] I referohemi rasteve kur klienti nuk është më në gjendje të shlyejë detyrimin e tij ndaj bankës.
[13] Me kredi cilësore do të kuptojmë shumën e kredive të klasifikuara si standarde

dhe në ndjekje.

[14] Ndërsa teprica e kredisë në lekë është rritur me 24.44 miliardë lekë ose 78.2 për qind, ajo në valutë shënon rritje me 45.73 miliardë lekë ose 47.4 për qind.

[15] Të gjitha bankat e intervistuara deklaruan se në rast të një rritjeje të mëtejshme të vlerës së kolateralit, si rrjedhojë e rritjes së çmimit të pasurive të paluajtshme edhe aksesi në kredimarrje do të jetë më i liberalizuar për klientelën.

PRODUKTIVITETI I PUNËS NË SHQIPËRI: PROCESI I KONVERGIMIT SEKTORIAL

*Vasilika Kota**

Fjalë kyçe
- Produktiviteti i punës - Konvergimi i sektorëve - Punësim - Konvergjencë -

ABSTRAKT

Ky punim trajton ndikimin që ka konvergimi i sektorëve në rritjen e produktivitetit të punës, gjatë periudhës 1996-2005. Për këtë qëllim është përdorur një metodologji që shpërbën këtë rritje sipas faktorëve përkatës. Rezultatet tregojnë se procesi i konvergimit është mjaft i pranishëm për sektorin e bujqësisë, ndërkohë që sektorët e tjerë tentojnë drejt një pike të lartë ekuilibri. Gjithsesi, zhvillimet sektoriale mbështesin rritjen e vazhdueshme të produktivitetit të punës në Shqipëri.

I. HYRJE

Studimet e rritjes ekonomike të një vendi, të trajtuara nga teoritë bazë të modelit Solow apo rritjes endogjene, marrin në konsideratë kapitalin fizik dhe njerëzor, si përcaktuesit e vetëm të rritjes ekonomike. Vendet jo të zhvilluara karakterizohen nga mungesa e kapitalit fizik, që do të thotë se të ardhurat nga kapitali në këto vende janë të larta. Niveli i lartë i të ardhurave marxhinale nxit lëvizjen e kapitalit nga vendet e zhvilluara drejt vendeve më pak të zhvilluara. Si rezultat, fillon procesi i

konvergimit dhe diferenca midis vendeve në faza të ndryshme zhvillimi duhet të zvogëlohet. Megjithatë, gjetjet e reja empirike në nivelin mikroekonomik tregojnë se pavarësisht fluksit të kapitalit drejt vendeve më pak të zhvilluara, nuk ka konvergim të ekonomive (Burges 2003).

Ekonomitë e vendeve me shkallë të ndryshme zhvillimi shfaqin mjaft heterogjenitet dhe dinamikë në nivelin sektorial apo të firmave. Këto vende karakterizohen nga nivele të ndryshme produktiviteti dhe rritja e tij është burimi kryesor i rritjes ekonomike afatgjatë. Ndryshimet në nivelin total të produktivitetit midis vendeve mund të shpjegohen me dy arsye kryesore (Kilvits, 2002):

- Produktiviteti i (nën)sektorëve është në nivele të ndryshme për shkak të zhvillimeve të ndryshme teknologjike, raportit kapital/prodhim, zhvillimit të kapitalit njerëzor etj..
- Punësimi është përqendruar në (nën)sektorë me nivele të ndryshme produktiviteti. Ky përqendrim punësimi mund të jetë pasojë e aktiviteteve apo investimeve të hershme të ndërmarra për shkak të karakteristikave të veçanta të vendeve.

Nëse punësimi është i përqendruar në sektorë me nivel të ndryshëm produktiviteti që shoqërohet me mungesë eficience, atëherë stimulimi i rritjes ekonomike kërkon fillimin e procesit të ristrukturimit të ekonomisë. Punësimi do të zhvendoset nga sektorët më pak produktivë te sektorët më produktivë. Procesi do të përfundojë me rishpërndarjen eficiente të punësimit që stimulon rritjen e produktivitetit sektorial, agregat dhe ekonomik të vendit. Procesi i rishpërndarjes ndërsektoriale të punësimit është me mjaft interes për ekonomitë në tranzicion të Evropës Qendrore dhe Lindore apo të ish-Bashkimit Sovjetik. Sistemi ekonomik i këtyre vendeve ka kaluar nga planifikimi qendror (pra përqendrimi i punësimit në sektorët strategjikë pavarësisht nivelit të eficiencës) drejt tregut të lirë (ku produktiviteti përcakton nivelin e punësimit sektorial). Si pasojë, këto ekonomi karakterizohen nga domosdoshmëria e ristrukturimit të aktivitetit ekonomik dhe si rrjedhojë, edhe të punësimit.

Studimi i ndërmarrë nga Estrin dhe Svejnar (1998) arrin në përfundimin se në Çeki, Republikën e Sllovakisë dhe Poloni ka patur një rishpërndarje të shpejtë të punësimit në fillimet e tranzicionit. E njëjta gjetje konfirmohet nga Brown dhe Earle (2005) për Ukrainën, të cilët pohojnë se rishpërndarja e punësimit është rritur konsiderueshëm pas liberalizimit të ekonomisë dhe kjo rishpërndarje ka qenë stimuluese për rritjen e produktivitetit. Megjithatë, studimi i drejtuar nga Loecke dhe Konings (2005) për sektorin e prodhimit në Sllloveni, arrin në përfundimin se rritja e produktivitetit total të faktorëve shpjegohet kryesisht nga rritja e eficiencës së firmave dhe hyrja në treg e firmave eficiente, se sa nga një zhvendosje e punësimit drejt firmave produktive.

Qëllimi i këtij materiali është studimi i rishpërndarjes së faktorit punë ndërmjet sektorëve të ekonomisë shqiptare dhe në këtë mënyrë, përcaktimi i ndikimit të tij në produktivitetin total të punës. Shqipëria është një histori suksesi e rritjes ekonomike, duke arritur nivelin mesatar 6 për qind në vit. Duke qenë se të dhënat agregate sugjerojnë një rritje të dukshme të produktivitetit të punës, është me interes identifikimi i faktorëve kryesorë pas këtij zhvillimi. Për këtë qëllim, metodologjia e zbatuar në material do të bëjë shpërbërjen e rritjes së produktivitetit agregat të punës, në kontributin e tre faktorëve: rritja brenda sektorit e produktivitetit të punës, rishpërndarja e punësimit midis sektorëve dhe konvergjenca e sektorëve drejt një niveli mesatar produktiviteti, i cili mund të konsiderohet si niveli ekuilibër. Përmbajtja e materialit është si më poshtë. Pjesa II, jep zhvillimet kryesore të produktivitetit të punës në Shqipëri. Pjesa III, do të diskutojë në detaje metodologjinë e ndjekur, ndërtimin e të dhënave dhe burimet e tyre. Pjesa IV, paraqet rezultatet e përftuara në nivelin agregat të ekonomisë dhe në nivelin sektorial. Përfundimet jepen në mbyllje të materialit.

II. ZHVILLIMET NË RRITJEN EKONOMIKE DHE NË PRODUKTIVITETIN E PUNËS NË SHQIPËRI

Gjatë fillimit të tranzicionit[1] 1990-1992, PBB reale në Shqipëri ra me një përqindje kumulative prej 39 për qind. Politikat e

zbatuara gjatë vitit 1993 me qëllim stabilizimin makroekonomik të vendit, ndihmuan në ripërtëritjen dhe rritjen e qëndrueshme ekonomike. Ndërmjet viteve 1993 deri 1996 rritja mesatare vjetore arriti në 9.3 për qind. Kriza e skemave piramidale gjatë vitit 1997, shkaktoi një rënie ekonomike prej 11 për qind. Megjithatë, ekonomia u ripërtëri shpejt dhe norma e rritjes së PBB-së reale për vitin 1998 arriti 8.6 për qind. Kjo rritje ishte edhe më e lartë për vitet në vazhdim dhe u stabilizua gjatë viteve 2001-2002, me një normë mesatare 6.5 për qind. Gjatë krizës ekonomike të vitit 2002, ekonomia u rrit vetëm me 4.3 për qind. Ndërkohë duke filluar nga viti 2003 rritja mesatare vjetore ka qenë 6 për qind.

Shqipëria trashëgoi një strukturë joeficiente të organizimit të ekonomisë dhe pa dyshim, procesi i tranzicionit u shoqërua me ristrukturimin e aktiviteteve ekonomike. Duke filluar nga viti 1990, pesha e sektorit të industrisë është zvogëluar nga 39 për qind, në rreth 25 për qind në vitin 2005. Megjithatë brenda sektorit të industrisë, sektori i ndërtimit pësoi një zgjerim të dukshëm nga rreth 3 për qind të PBB-së për vitin 1990, në 14 për qind në vitin 2005. Ngushtimi i sektorit të industrisë lejoi përdorimin e faktorëve të prodhimit nga sektorët e tjerë. Një zgjerim të konsiderueshëm pësoi sektori i shërbimeve, pesha e të cilit në PBB u rrit nga 33 për qind në 55 për qind. Sektori i bujqësisë pësoi fillimisht një rritje nga 23 në 32 për qind deri në vitin 1997 dhe më pas, u rikthye sërish në nivelin e 21 për qind të PBB-së në vitin 2005.

Ristrukturimi thelbësor i përbërjes së ekonomisë shqiptare sugjeron se tranzicioni shkaktoi rishpërndarjen e faktorëve të prodhimit nga aktivitetet më pak produktive drejt atyre produktive. Më poshtë paraqitet ecuria e produktivitetit të punës për katër sektorët kryesorë, ndryshimet në peshën e punësimit për secilin prej tyre dhe zhvillimet në pagat reale.

Në grafikun 1 paraqitet produktiviteti i punës për sektorët e bujqësisë, prodhimit, ndërtimit dhe shërbimeve. Produktiviteti është përcaktuar si raporti i vlerës reale të shtuar ndaj punësimit për çdo sektor. Grafiku 1 sugjeron se konvergimi i produktivitetit të sektorëve drejt një niveli mesatar agregat mungon ose

është zhvilluar në nivele të papërfillshme. Përgjithësisht, ecuria sektoriale e produktivitetit shfaq ngjashmëri vetëm për periudhën 2002-2005, kur pjesa më e madhe e sektorëve karakterizohen nga rritja e produktivitetit. Në material do të trajtojmë më gjerësisht rastin kur të gjithë sektorët konvergojnë bashkë dhe shkojnë drejt një pike ekuilibri që nuk është mesatarja e ekonomisë. Më poshtë, analizojmë ecurinë individuale të treguesit të produktivitetit sipas sektorëve.

Grafik 1. Produktiviteti i punës sipas sektorëve, 1996-2005.



Burimi: Llogaritjet e autorit duke përdorur të dhënat e INSTAT.

Për periudhën 1996 deri 2000, sektori i ndërtimit ka nivelin më të lartë të produktivitetit ndërkohë që gjatë viteve 2001-2005, renditet i dyti pas sektorit të shërbimeve. Kjo diferencë e lartë në nivelin e produktivitetit për periudhën 2000-2001, mund të shkaktohet nga një ndryshim strukturor në të dhënat për shkak të metodologjisë së re mbi punësimin, të ndjekur nga INSTAT[2]. Klasifikimi i ri i punësimit sipas sektorëve gjatë kësaj periudhe, reflektohet në zhvillimet e produktivitetit të punës. Ky ndryshim është pasqyruar dukshëm në sektorin e ndërtimit, pesha e punësimit të të cilit pas vitit 2000 është rritur ndjeshëm.

Sektori i bujqësisë ka nivelin më të ulët të produktivitetit për të gjithë periudhën. Kjo ecuri nënkupton zhvillimin e pritshëm të dy proceseve të mundshme:

a) Niveli i ulët i produktivitetit bujqësor duhet të shoqërohet me një rishpërndarje të faktorit punë nga ky sektor drejt

sektorëve me produktivitet më të lartë.

b) Në rast se zhvillohet procesi i konvergimit ndërsektorial, atëherë sektori i bujqësisë duhet të reflektojë norma më të larta rritjeje të produktivitetit të brendshëm, në mënyrë që të arrijë mesataren agregate të produktivitetit për të gjithë sektorët.



Analiza që do të ndërmarrim në këtë material teston se cili nga këto procese është zhvilluar realisht në ekonominë shqiptare. Grafiku 2 jep peshën e punësimit sipas sektorëve në punësimin total. Sektori i bujqësisë ka pjesën më të madhe të të punësuarve edhe pse është zvogëluar nga 74 për qind, në 64 për qind. Pesha e sektorit të shërbimeve është rritur në rreth 20 për qind të punësimit total. Sektori i ndërtimit shfaq normën më të lartë të rritjes së peshës së punësimit; në vitin 1998 ky sektor kishte vetëm 1 për qind të numrit total të të punësuarve por në vitin 2005 zë më shumë se 6 për qind. Pesha e sektorit të prodhimit në punësim shfaqet e qëndrueshme, me një nivel mesatar 8 për qind.

Zhvillimet e paraqitura në grafikun 2, tregojnë se nuk ka pasur një rishpërndarje të theksuar të punësimit midis sektorëve. Vetëm pas vitit 2000 vërehet një zgjerim i dukshëm i punësimit në sektorin e shërbimeve, që karakterizohet nga një nivel i lartë i produktivitetit dhe një zvogëlim i punësimit në bujqësi, i cili

shfaq nivel të ulët produktiviteti. Gjatë periudhës 2000-2001 (që përkon me ristrukturimin e bazës së të dhënave për klasifikimin e punësimit), procesi i rishpërndarjes së punësimit midis sektorëve është mjaft i theksuar.

Në grafikun 3 paraqitet ecuria e pagave reale për sektorët e prodhimit, shërbimeve dhe ndërtimit. Paraqitja e ecurisë së tyre ndihmon në vlerësimin e nivelit të konvergjencës midis sektorëve. Në rast se ka konvergjencë të nivelit të produktivitetit sektorial, ky proces pritet të shoqërohet edhe me konvergjencë të nivelit të pagave.

Grafik 3. Pagat reale sipas sektorëve.



Burimi: INSTAT[3].

Sektori i prodhimit ka nivelin më të lartë të pagave reale ndërkohë që sektori i ndërtimit ka nivelin më të ulët, duke mos u kombinuar me nivelin e lartë të produktivitetit të punës që shfaq ky sektor. Një përfundim paraprak që rezulton nga zhvillimet e paraqitura në grafikun 3, është mungesa e konvergjencës së pagave midis sektorëve. Duke filluar nga viti 1997 vërehet një prirje e divergimit të pagave, sidomos për sektorin e prodhimit. Me supozimin teorik se konvergjenca e produktivitetit përkthehet në konvergjencë të pagave sektoriale, mungesa e këtij procesi mund të nënkuptojë mungesë të konvergimit drejt një niveli ekuilibër produktiviteti.

III. RISHPËRNDARJA E FAKTORIT PUNË DHE NDIKIMI I SAJ NË PRODUKTIVITETIN E PUNËS

III.1 METODOLOGJIA

Kjo pjesë studion kontributin e lëvizjes së faktorit punë midis sektorëve me nivele të ndryshme të produktivitetit në produktivitetin agregat. Për këtë qëllim, është përdorur metodologjia e shpërbërjes së normës së rritjes të produktivitetit agregat, e prezantuar nga Maliranta dhe Ilmakunnas (2005). Kjo metodë është përdorur gjerësisht për të analizuar ndikimin e rishpërndarjes së punësimit mbi produktivitetin e punës (për shembull, Fagerberg, 2000; Timmer dhe Szirmai, 2000; Jalava dhe të tjerë, 2002; Van Ark dhe Timmer, 2003).

Produktiviteti agregat i punës mund të shpërbëhet sipas sektorëve si më poshtë:

$$LP_t = \frac{Q_t}{L_t} = \sum_i \frac{Q_{it}}{L_{it}} \cdot \frac{L_{it}}{L_t} \qquad (1)$$

ku LP_t është produktiviteti agregat i punës, Q_t është prodhimi total, L_t është punësimi total, Q_{it} prodhimi total në sektorin *i* për vitin *t* dhe L_{it} është punësimi përkatës. Ekuacioni (1) jep produktivitetin total të punës si një shumë e ponderuar e produktiviteteve sektoriale, ku peshat janë pjesa e punësimit të secilit sektor ndaj punësimit total. Termat që nuk referohen me *i* janë tregues për nivelin agregat të ekonomisë. Termi L_{it}/ L_t në ekuacionin (1), i referohet peshës së punësimit për sektorin *i* dhe termi Q_{it}/L_{it} i referohet produktivitetit të të njëjtit sektor. Duke e riemëruar të parin si LSH_i dhe të fundit si LP_i, ekuacioni (1) mund të rishkruhet si më poshtë:

$$LP_t = \sum_i LP_i \,.\, LSH_i \qquad (2)$$

Më tej marrim në konsideratë ndryshimin e produktivitetit të punës nga njëri vit në tjetrin. Ky ndryshim mund të shprehet thjesht duke i zbritur nivelit të produktivitetit në periudhën (1), nivelin e tij në periudhën (0):

$$LP_1 - LP_0 = \sum_i LP_{i,1} \cdot LSH_{i,1} - \sum_i LP_{i,0} \cdot LSH_{i,0} \qquad (3)$$

Nëpërmjet disa manipulimeve algjebrike[4], përfitohet ekuacioni më poshtë:

$$LP_1 - LP_0 = \sum_i \overline{LSH_i} \cdot \Delta LP_i + \sum_i \overline{LP_i} \cdot \Delta LSH_i \qquad (4)$$

ku $\overline{LSH_i}$, është pesha mesatare e punësimit për sektorin *i* për periudhat 1 dhe 0 dhe ΔLP_i, është diferenca e produktivitetit të punës për sektorin *i* për të njëjtat periudha, $\overline{LP_i}$ është niveli mesatar i produktivitetit përkatës dhe ΔLSH_i është diferenca në peshën e punësimit për sektorin *i*, për periudhat 1 dhe 0. Kjo formulë shpërbërjeje është zbatuar për periudhën 1996 deri 2005, duke përfituar 9 vlera të ndryshimit të produktivitetit ($LP_1 - LP_0$). Duke riemëruar ndryshimin në nivelin e produktivitetit të punës si ΔLP_t dhe duke pjesëtuar secilën anë të ekuacionit me mesataren e produktivitetit të të dy viteve përkatëse ($\overline{LP_t}$) për ta shprehur ekuacionin (4) në normë rritjeje[5], përfitohet ekuacioni i mëposhtëm:

$$\frac{\Delta LP_t}{\overline{LP_t}} = \sum_i \overline{LSH_i} \cdot \frac{\Delta LP_i}{\overline{LP_t}} + \sum_i \frac{\overline{LP_i}}{\overline{LP_t}} \cdot \Delta LSH_i \qquad (5)$$

Termi i parë në anën e djathtë të ekuacionit (5), domethënë pesha mesatare e punësimit në sektorin *i*, për vitin 1 dhe atë 0 shumëzuar me ndryshimin në produktivitetin e punës gjatë kësaj periudhe, përshkruan rritjen e brendshme të produktivitetit në sektorët individualë dhe mat atë efekt që do ta quajmë " rritja brenda sektorit e produktivitetit". Pra, rritja brenda sektorit mat ndryshimin në rritjen e produktivitetit total të punës, pa kontributin e rishpërndarjes së punësimit midis sektorëve. Termi i dytë në të djathtë të ekuacionit (5), mat rritjen në produktivitetin agregat të punës, që vjen për shkak të ndryshimeve në peshën e punësimit të sektorit (pra, rishpërndarje e punësimit), pa kontributin e rritjes së produktivitetit sektorial. I shprehur ndryshe, ky efekt mat rritjen në produktivitetin total të punës, që rezulton nga lëvizja e faktorit punë midis sektorëve me nivele të ndryshme produktiviteti. Kur pesha e punësimit të një sektori me nivel të lartë produktiviteti rritet, nënkupton se punësimi po rishpërndahet nga sektorët me produktivitet të ulët drejt sektorëve më eficientë.

Megjithatë, emëruesi i përdorur në shumën në anën e djathtë të ekuacionit (5) është niveli mesatar i produktivitetit total të punës, $\overline{LP_t}$, jo niveli mesatar i produktivitetit përkatës për sektorin *i*, $\overline{LP_i}$. Për të përfituar një efekt të pastër të rritjes brenda sektorit, niveli mesatar i produktivitetit të sektorit *i*, duhet të përdoret si vlerë bazë për matjen e saktë të normës së rritjes të produktivitetit. Maliranta (2003) e shpërbën më tej faktorin e rritjes brenda sektorit të produktivitetit si më poshtë:

$$\sum_i \overline{LSH_i} \cdot \frac{\Delta LP_i}{\overline{LP_t}} = \sum_i \overline{LSH_i} \frac{\Delta LP_i}{\overline{LP_i}} + \sum_i \overline{LSH_i} \cdot \left\{ \frac{\overline{LP_i}}{\overline{LP_t}} - 1 \right\} \cdot \frac{\Delta LP_i}{\overline{LP_i}} \qquad (6)$$

ku termi i parë në të djathtë mund të quhet efekti i pastër brendasektorial, pra rritja e produktivitetit të sektorit i ponderuar me peshën e punësimit të këtij sektori. Termi i dytë mund të konsiderohet si termi i konvergjencës. Ky term duhet të jetë negativ, në rast se procesi i konvergjencës po ndodh. Nëse sektori *i* ka një nivel më të lartë produktiviteti mesatar se mesatarja e produktivitetit agregat, atëherë që të konvergojë drejt mesatares agregate, duhet të ketë rritje negative produktiviteti. Në rast se mesatarja sektoriale e produktivitetit është më e ulët se ajo agregate ($\overline{LP_i} / \overline{LP_t} - 1 < 0$), sektori duhet të ketë norma pozitive të rritjes së produktiviteti ($\Delta LP_i / \overline{LP_i} > 0$). Në këto raste, sektorët janë duke konverguar drejt një niveli ekuilibër produktiviteti.

Si përfundim rishkruajmë ekuacionin (5), duke përfshirë shpërbërjen e re të paraqitur në ekuacionin (6):

$$\frac{\Delta LP_t}{\overline{LP_t}} = \underbrace{\sum_i \overline{LSH_i} \cdot \frac{\Delta LP_i}{\overline{LP_i}}}_{\text{Efekti-brenda-sektoral}} + \underbrace{\sum_i \overline{LSH_i} \cdot \left\{ \frac{\overline{LP_i}}{\overline{LP_t}} - 1 \right\} \cdot \frac{\Delta LP_i}{LP_i}}_{\text{Termi-i-konvergjencës}} + \underbrace{\sum_i \frac{\overline{LP_i}}{\overline{LP_t}} \cdot \Delta LSH_i}_{\text{Efekti-i-rishpërndarjes-së-punësimit}} \qquad (7)$$

Rritja e produktivitetit agregat të punës është shpërbërë në 3 efekte kryesore: në efektin e rritjes brenda sektorit të produktivitetit, në termin e konvergjencës dhe në efektin e rishpërndarjes së punësimit midis sektorëve me nivele të ndryshme produktiviteti. Në pjesën në vazhdim, do të zbatohet metodologjia e mësipërme për të dhënat e Shqipërisë dhe do të studiohet cili efekt ka kontribuar më shumë në rritjen e produktivitetit.

III.2 NDËRTIMI I TË DHËNAVE

Si e paraqitëm më lart, produktiviteti i punës gjatë një periudhe *t*, (LP_t), është matur si raporti i prodhimit (Q_t) ndaj faktorit punë (L_t):

$$LP_t = Q_t / L_t \qquad (8)$$

Prodhimi mund të matet nëpërmjet dy treguesve: vlera e shtuar ose PBB. Mundësia e disponimit të të dhënave për vendet në zhvillim përcakton se cili nga treguesit do të përdoret. Gjithsesi, për ndërtimin e produktivitetit sektorial preferohet përdorimi i vlerës së shtuar si një vlerësues i prodhimit. Në rast se produktiviteti sektorial matet duke përdorur PBB, normat e ndryshimit të tij mund të mos reflektojnë një ndryshim në teknologji apo eficiencë, por një zëvendësim midis punës dhe faktorëve të ndërmjetëm (Cobbold, 2003).

Duke marrë në konsideratë të dyja arsyet, prodhimi në këtë material përfaqësohet nga vlera reale e shtuar për katër sektorët kryesorë: bujqësi, prodhim, ndërtim dhe shërbime. Të dhënat mbi vlerën e shtuar sektoriale janë marrë nga Instituti i Statistikave (INSTAT). Të dhënat nominale janë deflatuar me indeksin përkatës të çmimeve me vitin 1996 si vitin bazë, duke përfituar vlerën reale të shtuar.

Metoda më e përshtatshme për vlerësimin e vlerës reale të shtuar është përdorimi i deflatimit të dyfishtë, ku produkti i ndërmjetëm i deflatuar me indeksin e tij të çmimeve, zbritet nga prodhimi real total (Cobbold, 2003). Mungesa e të dhënave mbi indeksin e çmimeve për prodhimin e ndërmjetëm në Shqipëri nuk lejon përdorimin e kësaj metode. Faktori punë përfaqësohet nga numri i të punësuarve sipas sektorëve për sa kohë nuk ka të dhëna mbi orët e punës. Burimi i të dhënave për punësimin është INSTAT.

Cilësia e të dhënave është thelbësore për trajtimin e analizave të mira ekonomike. Të dhënat për punësimin në sektorin e

bujqësisë janë problematike, pasi ndërtohen me supozimin se të gjithë personat që zotërojnë tokë (dhe anëtarët e tyre të familjes) janë të punësuar. Rritja e nivelit të punësimit në këtë sektor, për shkak të metodologjisë së përdorur në matjen e tij, mund të jetë shkak i nivelit të ulët të produktivitetit. Sektori i bujqësisë në vendet në tranzicion është shoqëruar me nivel të ulët produktiviteti ndaj edhe në rast se të dhënat për punësimin janë realisht më të ulëta, pritet një zhvendosje lart e nivelit të produktivitetit, duke qëndruar sërish poshtë nivelit të sektorëve të tjerë.

Të dhënat mbi punësimin në sektorin jobujqësor përfitohen, pasi shifrave zyrtare i shtohen të dhënat për tregun informal matur nëpërmjet Vrojtimit Statistikor pranë Familjeve (LMSI). Gjithsesi, kjo nuk garanton se shifrat zyrtare paraqesin zhvillimet reale në tregun e punës; sektori informal i punësimit mund të jetë edhe më i madh se sa matet nëpërmjet anketimit LMSI.

Përfshirja e sektorit informal në të dhënat e përdorura në material edhe nëse nuk do të kishte ndikim në nivelin e produktivitetit, do të paraqiste një efekt të pastër të lëvizjes së punësimit midis sektorëve. Matja e informalitetit në tregun e punës bëhet nëpërmjet anketave në shkallë kombëtare të konsumatorëve dhe kjo shkon përtej hapësirës së këtij materiali apo mundësisë për kryerjen e matjeve. Përfundimet që do të paraqesim më poshtë do të trajtohen duke patur parasysh kufizimin e të dhënave zyrtare.

IV. REZULTATET E ZBËRTHIMIT TË RRITJES SË PRODUKTIVITETIT AGREGAT SIPAS EFEKTEVE PËRCAKTUESE TË TIJ

Rezultatet e analizës për të gjithë ekonominë jepen në tabelën 1. Rritja mesatare e produktivitetit agregat të punës, për periudhën 1996-2005 është rreth 7.6 për qind. Efekti i rritjes brendasektoriale, pra rritja e brendshme e produktivitetit për çdo sektor, është kontribuesi kryesor i rritjes së produktivitetit

agregat për periudhën 1996-2004, duke përjashtuar vitin 2001. Mesatarisht, ai kontribuon me 105 për qind të rritjes së produktivitetit mesatar për të gjithë periudhën. Gjatë vitit 2001 kontributi i efektit brendasektorial kalohet nga ai i rishpërndarjes së punësimit. Ky rezultat është i pritshëm, pasi ndryshimi i metodologjisë për klasifikimin e punësimit sipas aktiviteteve ekonomike nga INSTAT, në thelb do të thotë një rishpërndarje e punësimit midis sektorëve. Rezultati që marrim nga zbatimi i metodologjisë për periudhën 2000-2001 është tërësisht reflektim i ndryshimeve në bazën e të dhënave. Për këtë arsye, analiza do të ndërtohet për 2 periudha, 1996-2000 dhe 2001-2005.

Tabelë 1. Shpërbërja e rritjes së produktivitetit agregat të punës.

Ekonomia	Viti	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005
	Rritja e produktivitetit agregat (%)	-8.1	7.6	12.9	5.5	22.9	3.5	4.2	7.8	11.8
	Efekti brenda sektorial (%)	169.9	122	61.7	116.7	87.9	83.9	105.4	97.5	76.6
	Rishpërndarja e punësimit(%)	45.2	-59.4	9.6	50.9	119.3	-3.1	-10.6	-27.8	-9.6
	Termi i konvergjencës (%)	-115.1	37.4	28.7	-67.6	-107.2	19.2	5.2	30.3	33

Burimi: Llogaritjet e autorit.
* tregon efektin me kontributin më të lartë.

Për periudhën 1997 deri 2000, rritja mesatare e produktivitetit të punës është rreth 4.46 për qind. Kontributi më i madh në rritjen e produktivitetit agregat (mesatarisht mbi 100 për qind), vjen nga efekti brendasektorial. Mesatarisht, vetëm 12 për qind e rritjes së produktivitetit vjen nga rishpërndarja e punësimit midis sektorëve, ndërkohë që termi negativ i konvergjencës nënkupton praninë e këtij procesi, duke përjashtuar vitin 1997. Gjatë vitit 1997 pati një rënie të produktivitetit agregat dhe si rrjedhim, termi negativ i konvergjencës nënkupton divergjencë të sektorëve nga mesatarja agregate e produktivitetit.

Për periudhën 2001-2005, duke përjashtuar vitin e parë, kontributi më i madh në rritjen e produktivitetit të punës vjen nga efekti brendasektorial. Megjithatë, krahasuar me periudhën e parë, kontributi i këtij efekti është zvogëluar. Siç pritej,

rishpërndarja e punësimit ka dhënë ndikimin më të madh në vitin 2001 me një impakt mbi 100 për qind. Duke filluar nga viti 2002, lëvizja e punësimit nga njëri sektor tek tjetri ushtron një ndikim negativ në produktivitetin agregat. Nga ana tjetër, termi i konvergjencës ka një ndikim pozitiv në rritjen e produktivitetit me një mesatare 22 për qind. Ndikimi i madh i rishpërndarjes së punësimit për vitin 2001 është reflektuar edhe në termin e lartë të konvergjencës për këtë vit dhe kryesisht, ky efekt ka ardhur si pasojë e statistikave.

Pra, viti 2001 është pika e kthesës për kontributet e efekteve në normën e rritjes së produktivitetit agregat të punës. Para vitit 2001, efekti i rishpërndarjes së punësimit midis sektorëve mbështet efektin brendasektorial duke nxitur rritjen e produktivitetit në vend. Pas vitit 2001, efekti brendasektorial mbështetet nga termi pozitiv i konvergjencës, që realisht përkthehet në një proces të vazhdueshëm divergimi nga mesatarja e ekonomisë.

Më poshtë do ta zgjerojmë analizën e efekteve në nivelin sektorial. Tabela 2, jep kontributin e sektorëve në secilin prej faktorëve të rritjes së produktivitetit agregat të punës. Rezultatet tregojnë se kontributi kryesor në efektin brendasektoral vjen nga bujqësia, me një mesatare prej 65 për qind për të gjithë periudhën. Ky sektor ka kontribuar vazhdimisht në rritjen e produktivitetit të punës, ndërkohë që sektorë të tjerë kanë kontribuar edhe negativisht.

Një ndër arsyet e kontributit të lartë të sektorit të bujqësisë është edhe pesha e madhe që ka në totalin e punësimit. Shuma e ponderuar e peshës së punësimit me rritjen brendasektoriale të produktivitetit, jep kontributin e sektorit në rritjen totale. Një sektor me një peshë të madhe në punësim si ai i bujqësisë, pavarësisht rritjes së vogël të produktivitetit të brendshëm, ka një ndikim të madh në produktivitetin agregat. Ndërkohë, rritja e konsiderueshme e produktivitetit të brendshëm në sektorin e ndërtimeve nuk jep një ndikim të madh në produktivitetin agregat, për shkak të peshës së vogël të këtij sektori në punësimin total.

Kontribuesi më i madh në efektin e rishpërndarjes së punësimit është sektori i shërbimeve. Niveli i lartë i produktivitetit në

këtë sektor është shoqëruar me rritjen e nivelit të punësimit në të. Sektori i ndërtimit tregon gjithashtu një efekt pozitiv të rishpërndarjes së punësimit, sidomos para vitit 2001. Për shkak të rritjes së produktivitetit në këtë sektor, pesha e tij në punësim është rritur konsiderueshëm duke kontribuar pozitivisht në rritjen totale të produktivitetit.

Tabelë 2. Shpërbërja e rritjes së produktivitetit agregat sipas sektorëve dhe efekteve.

			1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	Mes.
1.	Norma e rritjes së produktivitetit agregat (%)		-8	8	13	5	23	4	4	8	12	8
2. Përqindja e produktivitetit agregat që shpjegohet nga:												
2.1	Efekti brenda sektorial	Bujqësi	155	63	31	91	118	34	26	40	29	65
		Prodhim	33	32	15	45	-4	-11	57	15	13	22
		Ndërtim	-4	3	1	5	-18	35	33	10	6	8
		Shërbime	-14	25	15	-24	-8	26	-12	32	29	8
		Totali (a)	170	122	62	117	88	84	105	98	77	102
2.2	Rishpërndarja e punësimit	Bujqësi	-6	10	-1	4	-28	1	6	7	2	-1
		Prodhim	-7	-3	-2	-68	17	-1	-13	20	0	-7
		Ndërtim	22	-16	0	16	59	1	-2	-9	1	8
		Shërbime	37	-50	13	99	72	-4	-1	-45	-12	12
		Totali (b)	45	-59	10	51	119	-3	-11	-28	-10	13
2.3	Termi i konvergjencës	Bujqësi	-81	-34	-17	-53	-63	-17	-13	-21	-16	-35
		Prodhim	4	3	4	27	-2	-2	19	9	9	8
		Ndërtim	-8	7	4	15	-29	7	13	6	3	2
		Shërbime	-30	62	38	-56	-13	32	-14	37	37	10
		Totali (c)	-115	37	29	-68	-107	19	5	30	33	-15
3	Efektet totale	Totali (a) +(b) +(c)	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100

Burimi: Llogaritjet e autorit.

Mesatarisht, sektori i prodhimit ka kontribuar negativisht në rishpërndarjen e punësimit, që do të thotë se pesha e punësimit të këtij sektori është ulur. Ky rezultat është i pritshëm. Sektori i prodhimit dhe ai i bujqësisë karakterizohen nga një nivel i ulët i produktivitetit të punës. Si rrjedhim, pritet lëvizja e punësimit nga këta sektorë drejt sektorëve të shërbimeve dhe ndërtimit, të cilët kanë një nivel të lartë produktiviteti. Gjithsesi, efekti negativ i rishpërndarjes duhej të ishte më i lartë për sektorin e bujqësisë sesa për atë të prodhimit, për shkak se bujqësia ka produktivitet mjaft të ulët.

Një ndër arsyet pse sektori i bujqësisë nuk karakterizohet nga norma të larta të lëvizjes së punësimit, mund të jetë se forca punëtore që duhet të lëvizë, nuk shfaq aftësitë e duhura të cilat kërkohen nga sektorët më produktivë. Ky problem, thekson nevojën për rritjen e aftësive të forcës punëtore, me qëllim stimulimin e produktivitetit dhe rrjedhimisht, rritjes ekonomike në Shqipëri.

Së fundi, analizojmë kontributin sipas sektorëve në termin e konvergjencës. Sektori i bujqësisë është i vetmi sektor me nivelin e produktivitetit më të ulët se niveli mesatar agregat. Pritet që termi i konvergjencës për bujqësinë të jetë negativ, duke reflektuar procesin e konvergimit të tij drejt nivelit ekuilibër. Gjatë gjithë periudhës, niveli i ulët i produktivitetit në bujqësi është ekuilibruar nga norma pozitive të rritjes, duke treguar se po konvergon vazhdimisht drejt mesatares së ekonomisë.

Sektorët e ndërtimit, prodhimit dhe shërbimeve karakterizohen nga nivele mesatare të produktivitetit, më të larta se mesatarja agregate. Në qoftë se procesi i konvergimit do të ndodhte edhe për këta sektorë, atëherë ata do të shfaqnin një rritje negative produktiviteti, duke rezultuar me një term negativ konvergjence.

Duke përjashtuar vitin 2001, gjatë të cilit rishpërndarja e punësimit midis sektorëve ka nxitur konvergjencën midis tyre, sektorët e ndërtimit, prodhimit dhe shërbimeve divergojnë sistematikisht nga niveli mesatar i produktivitetit agregat. Ky proces nënkupton se sektorët më produktivë vazhdojnë të kenë norma të larta rritjeje vjetore të eficiencës së tyre dhe pavarësisht konvergimit të sektorit të bujqësisë, ekonomia nuk ka arritur ende një nivel të qëndrueshëm produktiviteti.

Procesi i rritjes së vazhdueshme të sektorëve produktivë i shoqëruar me procesin e konvergimit të sektorit joeficient, do të rezultojë në rritje të mëtejshme të produktivitetit në Shqipëri.

Rezultatet e diskutuara më lart tregojnë se procesi i konvergimit dhe rishpërndarja e punësimit midis sektorëve të ekonomisë

shqiptare, janë në nivele të ulëta. Punësimi zyrtar sipas sektorëve vit pas viti është i qëndrueshëm dhe kjo mund të jetë ndikuar nga mospërfshirja e tregut informal të punësimit. Një mundësi tjetër që mbetet për t'u studiuar, është nëse ekonomia shqiptare ka ende fuqi të lirë punëtore, pra ajo nuk ka arritur ende nivelin ekuilibër të rritjes së qëndrueshme. Në këtë rast, fuqia e lirë punëtore mund të përmbushë kërkesat për punësim nga sektorët përkatës rrjedhimisht, nuk lind nevoja për rishpërndarje të punësimit.

Gjithashtu, konvergimi i përdorur në kontekstin e materialit nënkupton konvergimin e produktivitetit sektorial drejt nivelit mesatar të ekonomisë. Gjetjet tona, treguan se vetëm sektori i bujqësisë po konvergon drejt këtij niveli. Gjithsesi, meqë sektorët produktivë kanë norma pozitive rritjeje pavarësisht se i largohen mesatares së ekonomisë, mund të jenë duke konverguar drejt një pike të përbashkët ekuilibri. Kjo do të thotë se vetë mesatarja e ekonomisë po i drejtohet kësaj pike ekuilibri. Një proces i tillë nënkupton se ekonomia shqiptare nuk është ende në ekuilibër dhe po shkon drejt nivelit të qëndrueshëm. Pavarësisht se sipas përkufizimit të dhënë në material sektorët divergojnë, realisht mund të jenë duke konverguar drejt një pike të lartë, pra drejt një rendimenti ekuilibër.

Së fundi, materiali trajton konvergimin linear të produktivitetit sektorial por ky proces mund t'i përafrohet më mirë një forme tjetër funksionale. Përdorimi i metodologjive të tjera mund të lejojë përcaktimin e qartë të këtij procesi.

V. PËRFUNDIME

Ky material trajton zhvillimet kryesore të produktivitetit të punës në Shqipëri dhe zbërthimin e tij sipas efekteve që lidhen me punësimin dhe konvergjencën. Rezultatet tregojnë se rritja brenda sektorit e produktivitetit është nxitësja kryesore e rritjes agregate. Pavarësisht pritshmërive për një efekt të lartë të rishpërndarjes së punësimit midis sektorëve, ndikimi i saj është i ulët. Një përfundim paraprak është se ekonomia shqiptare ka

ende fuqi të lirë punëtore, duke zbutur nevojën për rishpërndarje të punësimit midis sektorëve.

Normat e larta të rritjes së produktivitetit në sektorët eficientë si dhe konvergimi i sektorit të bujqësisë drejt niveleve më të larta të produktivitetit, mbështesin rritjen e vazhdueshme të këtij treguesi në Shqipëri. Ekonomia shqiptare nuk ka arritur ende nivelin ekuilibër të rritjes së qëndrueshme, ndaj karakterizohet nga dinamizmi dhe stimulimi i vazhdueshëm për prodhim më eficient. Produktiviteti është faktori nxitës i rritjes ekonomike afatgjatë dhe norma pozitive e rritjes së tij, do të vazhdojë të jetë stimuluese e fortë e zhvillimit.

SHËNIME

* Vasilika Kota, specialiste, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë.

[1] Burimi i të dhënave për periudhën 1990 deri 1995 është World Development Indicators (2003) dhe për periudhën 1996-2005, INSTAT.

[2] Klasifikimi i të punësuarve sipas aktiviteteve ekonomike për sektorin privat jobujqësor deri në vitin 2000, është bërë duke patur si burim të dhënat nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatim-Taksave. Për vitet 2001 dhe në vazhdim klasifikimi është vlerësuar bazuar në të dhënat nga: Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, Regjistrimi i Përgjithshëm i Popullsisë dhe Banesave dhe vrojtimi statistikor pranë familjeve (LSMS) të kryera nga INSTAT.

[3] Të dhënat mbi pagat për sektorët janë marrë nga INSTAT bazuar mbi anketën strukturore të ndërmarrjeve, për periudhën 1997-2004. Për të llogaritur pagat reale, të dhënat janë normalizuar me deflatorët e vlerës së shtuar për çdo sektor.

[4] Për të verifikuar që ekuacioni (5) është i barabartë me ekuacionin (4) ndjekim këta hapa:

$$LP_1 - LP_0 = \sum_i \overline{LSH_i} \cdot \Delta LP_i + \sum_i \overline{LP_i} \cdot \Delta LSH_i$$

$$LP_1 - LP_0 = \sum_i \left\{ \frac{LSH_{i,1} + LSH_{i,0}}{2} \right\} (LP_{i,1} - LP_{i,0}) + \sum_i \left\{ \frac{LP_{i,1} + LP_{i,0}}{2} \right\} (LSH_{i,1} - LSH_{i,0})$$

$$LP_1 - LP_0 = \sum_i \frac{LSH_{i,1}}{2} \cdot LP_{i,1} - \frac{LSH_{i,1}}{2} LP_{i,0} + \frac{LSH_{i,0}}{2} \cdot LP_{i,1} - \frac{LSH_{i,0}}{2} \cdot LP_{i,0}$$

$$+ \sum_i \frac{LP_{i,1}}{2} \cdot LSH_{i,1} - \frac{LP_{i,1}}{2} \cdot LSH_{i,0} + \frac{LP_{i,0}}{2} \cdot LSH_{i,1} - \frac{LP_{i,0}}{2} \cdot LSH_{i,0}$$

$$LP_1 - LP_0 = \sum_I LSH_{I,1} \cdot LP_{I,1} + \sum_I LSH_{I,0} \cdot LP_{I,0}$$

[5] $\dfrac{\Delta LP_t}{\overline{LP_t}} \cdot \ln \dfrac{LP_{i,1}}{LP_{i,0}}$

REFERENCA

Ahmad Nadim, Lequiller François, Pascal Marianna, Pilat Dirk, Schreyer Paul, Wölfl Anita, (2003), "Comparing growth in GDP and labor productivity: measurement issues", Statistic Brief, No. 7, December

Badunenko O, Henderson D.J, Zelenyuk V. (2005), "Technological Change and Transition: Relative Contributions to Worldwide Growth during the 1990's, Technical Report Nr. 0514

Brown David, Earle John, (2005), Job Reallocation and Productivity Growth in the Ukrainian Transition, Heriot-Watt University, Upjohn Institute for Employment Research Central European University

Burgess Simon, Mawson Dan, (2003), Aggregate Growth and the Efficiency of Labour Reallocation,University of Bristol, August

Cobbold, Trevor, 2003, A comparison of gross output and value-added methods of productivity estimation, Productivity commission, Australia, November

Estrin, S. and J. Svenjar (1998), "The Effects of Output, Ownership and Legal form on Employment and wages in Central European Firms" in S. Commander, ed., Enterprise Restructuring and Unemployment in Models of Transition, Washington DC: EDI/World Bank.

Fagerberg, Jan. 2000. Technological Progress, Structural Change and Productivity Growth: A Comparative Study. Structural Change and Economic Dynamics 11: 393-411.

Jalava, Jukka, S. Heikkinen, and R. Hjerppe. 2002. Technology and Structural Change: Productivity in the Finnish Manufacturing Industries, 1925-2000. Paper presented at "XIII Economic History Congress," Buenos Aires, 28 June 2002.

Khan Faruk (2004): "Albania: Growth during Transition and Growth Prospects", Working Paper, World Bank

Kilvits Kaarel, (2002), "Convergence of Small Open Industry in Estonia", Faculty of Economics, Tallinn Technical University, November

Loecker Jan,Konings Jozef,(2005), "Job reallocation and productivity growth in a post-socialist economy: Evidence from Slovenian manufacturing", Department of Economics and LICOS, Katholieke Universiteit Leuven.

Maliranta Mika, Ilmakunnas Pekka, "Decomposing productivity and wage effects of Intra-establishment labor restructuring", Nr. 993, 2005

McGuckin Robert H, Van Ark Bart, (1999)," International comparisons of labor productivity and per capita income", Journal article, Monthly Labor Review, Vol. 122

Timmer, Marcel P. and A. Szirmai. 2000. Productivity Growth in Asian Manufacturing: The Structural Bonus Hypothesis Examined. Structural Change and Economic Dynamics 11: 371-392

Van Ark, Bart and M. Timmer. 2003. Asia's Productivity Performance and Potential: The Contribution of Sectors and Structural Change. Paper presented at the conference "Leading East Asia in the 21st Century," Tokyo, 30 May 2003.

METODAT KRYESORE TË DISAGREGIMIT TË PËRKOHSHËM

*Elona Dushku**

Fjalë kyçe
- Seri kohore - Disagregim i përkohshëm - Prodhimi i brendshëm bruto -

1. HYRJE

Shumë seri kohore janë të vëzhguara vetëm në frekuencë të ulët (për shembull vjetore), ndërkohë që pjesa më e madhe e analizave ekonomike studiojnë sjelljen e ekonomisë në periudhat afatshkurtra, duke rritur në këtë mënyrë kërkesën për të dhëna me frekuencë më të lartë. Procesi i derivimit të të dhënave me frekuencë të lartë nga të dhënat me frekuencë të ulët njihet si procesi i *disagregimit të përkohshëm*.

Në institutet statistikore, përdorimi i teknikave të ndryshme të disagregimit është bërë praktikë mjaft e njohur për shumë vende. Këto teknika luajnë një rol mjaft të rëndësishëm sidomos në ndërtimin e serive tremujore të llogarive kombëtare. Qëllimi final i disagregimit të përkohshëm është pikërisht derivimi i serive me frekuencë të lartë dhe marrja e vlerësimeve për të dhënat për shembull, ato tremujore edhe kur të dhënat vjetore nuk janë akoma të vlefshme. Teknikat e disagregimeve të përkohshme përdorin të gjithë informacionin e vlefshëm në mënyrën më të mirë të mundur, brenda një modeli të caktuar duke siguruar, që informacioni i vlefshëm me frekuencë të lartë dhe të dhënat me frekuencë të ulët të kenë një lidhje logjike midis tyre.

Vlerësimi i komponentëve të PBB-së është një fushë e rëndësishme, ku teknikat e disagregimit të përkohshëm janë përdorur në mënyrë intensive. Kështu, në ditët e sotme vende të ndryshme vlerësojnë edhe treguesit mujorë, duke u nisur nga gjithë informacioni i mundshëm, që kanë dhe njëkohësisht duke respektuar koherencën me të dhënat tremujore.

Materiali është organizuar si më poshtë: në pjesën e dytë trajtohen metodat kryesore të disagregimit të përkohshëm, në pjesën e tretë disagregimi i PBB-së në Shqipëri dhe konkluzionet.

2. METODAT ALTERNATIVE TË DISAGREGIMIT TË PËRKOHSHËM

Studime të ndryshme kanë treguar, që ekzistojnë disa teknika të disagregimit të të dhënave, të cilat i klasifikojmë si më poshtë:

- Metoda, të cilat nuk përdorin tregues me frekuencë të shpeshtë për të disagreguar të dhënat.

Në këtë grup përfshihen ato metoda, që derivojnë të dhënat tremujore nga ato vjetore, duke u bazuar thjesht në një logjikë të pastër matematikore, pa përdorur asnjë informacion tjetër shtesë nga tregues të tjerë me frekuencë më të shpeshtë. Në këtë mënyrë, sigurohet një vlerësim i zbutur i serive tremujore, në lidhje me atë vjetore. Këto metoda përdoren në ato raste, kur ka një mungesë të madhe informacioni për serinë që do të disagregojmë.

- Metoda, që përdorin tregues me frekuencë të shpeshtë për të disagreguar një seri.

Këto metoda bëjnë të mundur disagregimin e serive, duke shfrytëzuar të gjithë informacionin e mundshëm nga tregues të tjerë të lidhur me serinë e agreguar.

Pavarësisht, se cilat metoda përdoren për disagregimin e të dhënave, të gjitha metodat duhet të respektojnë disa parime kryesore:

1. Në model duhet të përfshihen ata variabla statistikorë, që konsiderohen si parashikues të mirë të variablit, i cili do të vlerësohet dhe që kanë një frekuencë më të lartë se ai.
2. Në informacionin bazë, duhet të përfshihen vetëm ata variabla që janë lidhur me ekonominë e atij vendi, për të cilat kjo seri e llogarisë kombëtare do të vlerësohet.
3. Në modelet statistikore apo matematikore, nuk duhet të përfshihet asnjë lloj lidhjeje midis agregatëve tremujorë të vendeve të ndryshme, përveç marrëdhënieve ndërkombëtare.

Ndërsa, përsa i përket vlerësimeve që merren nga disagregimi i të dhënave, ato duhet të përmbushin njëkohësisht karakteristikat e mëposhtme:

Së pari: konsistente në kohë.
Kjo do të thotë që shuma e vlerave tremujore të PBB-së, të jetë e barabartë me shumën vjetore të po atij viti.

Së dyti: koherente.
Pra, shuma e komponentëve të PBB-së të një tremujori duhet të jetë e barabartë me vlerën e PBB-së të atij tremujori.

Ndërkohë që vetë procesi i disagregimit të të dhënave vjetore mund të përshkruhet si një nga proceset e mëposhtme:

Shpërndarje: kur të dhënat vjetore shprehen si shumë ose si mesatare e të dhënave tremujore (si për shembull PBB-ja, konsumi, përgjithësisht variablat në formën e rrjedhjeve, indekset e çmimeve etj.).

Interpolim: kur vlera vjetore është e barabartë me vlerën e tremujorit të fundit (si për shembull, popullsia në fund të vitit, paraja dhe në përgjithësi, të gjithë variablat në formën e stoqeve).

Ekstrapolim: kur vlerësohen të dhënat tremujore, pa patur akoma të dhënat vjetore dhe jo domosdoshmërisht shuma e vlerave tremujore është e barabartë me vlerën vjetore të atij viti.

Duke u bazuar kryesisht tek mënyra e modelimit të mbetjeve, që përfaqësojnë diferencën midis vlerave aktuale të njohura dhe vlerave të vlerësuara të modelit, metodat kryesore të disagregimit të përkohshëm mund t`i grupojmë si më poshtë:

- metodat e zbutura;
- metodat e dy-fazave të axhustimit;
- metodat e serive kohore;
- metodat optimale;
- metodat e modeleve dinamike.

METODAT E ZBUTURA

Janë metoda, të cilat bazohen kryesisht në teknika të pastra statistikore dhe përdoren zakonisht kur ka mungesë të madhe informacioni me frekuencë të shpeshtë.

Në metodat e zbutura supozohet se prirja e vlerave të panjohura tremujore mund të përshkruhet me anë të një funksioni në kohë. Karakteristikë e këtyre teknikave është minimizimi i mospërputhjeve, që ekzistojnë midis vlerave të njohura vjetore dhe vlerave të vlerësuara tremujore. Boot, Feibes dhe Lisman (1967) janë autorët e parë të cilët teknikat e tyre të disagregimit i kanë mbështetur tek metodat e zbutura.

METODAT E DY–FAZAVE TË AXHUSTIMIT

Këto metoda marrin parasysh të gjithë informacionin e mundshëm që sigurohet nga treguesit tremujorë dhe shfrytëzohet për të patur një ide më të mirë mbi dinamikën tremujore të serisë, e cila do të disagregohet. Metodat e dy-fazave të axhustimit e ndajnë procesin e derivimit të të dhënave në dy faza.

Faza e parë: konsiston në nxjerrjen e rezultateve paraprake për serinë tremujore, që duam të vlerësojmë. Këto rezultate

mund të merren në mënyrë direkte ose indirekte. Testimet kanë treguar, që vlerësimet paraprake të fazës së parë nuk janë shumë të sakta, pasi shpeshherë nuk përmbushin karakteristikat, që duhet të kenë vlerësimet, pra të jenë njëkohësisht konsistente dhe koherente.

Faza e dytë: bën të mundur axhustimin e vlerësimeve paraprake, që realizohet duke shpërndarë diferencat (mbetjet), që ekzistojnë midis të dhënave vjetore dhe të dhënave të agreguara tremujore. Pas axhustimit të tyre, vlerësimet që merren kanë të njëjtat karakteristika me vlerat vjetore.

Një ndër metodat e axhustimit është ajo e implementuar nga Deaton më 1971. Në këtë procedurë, të dhënat përfundimtare të vlerësuara janë marrë duke minimizuar funksionin kuadratik të mbetjeve, që përfshihen tek vlerësimet paraprake. Një rregull i thjeshtë axhustimi është "pjesëtimi me katër" i mbetjeve. Megjithatë, kjo metodë nuk është shumë e kështillueshme, pasi mund të krijojë një pavazhdimësi të pashpjegueshme midis tremujorit të katërt të një viti, me tremujorin e parë të vitit në vazhdim.

METODAT E SERIVE KOHORE

Metodat e serive kohore mund të përdoren si kur ka mungesë informacioni ashtu edhe si metoda optimale axhustimi. Ato marrin parasysh strukturën e serisë kohore dhe janë bazuar kryesisht tek modelet ARIMA për interpolimin apo ekstrapolimin e të dhënave. Këto metoda përfshijnë njëkohësisht, si elementet dinamike të agregatit edhe informacionin e marrë nga treguesit me frekuencë tremujore.

Metodat e serive kohore janë veçanërisht të dobishme, kur ka mungesë informacioni me frekuencë tremujore. Ato mund të përdoren edhe për të bërë parashikime brenda vitit, në qoftë se nuk ka seri të vlefshme tremujore për treguesit e lidhur. Kjo karakteristikë, vjen kryesisht nga natyra e serive kohore gjatë procesit të vlerësimit.

Ndër autorët e parë të kësaj metode përmendim Wei dhe Stram (1989, 1990). Ata e mbështetën procedurën e tyre të disagregimit në lidhjen, që ekziston midis kovariancës në modelin e agreguar me atë të modelit të paagreguar.

Në 1989-ën AL-Osh ka përdorur një *state space model* për modelet ARIMA. Ky model bën të mundur interpolimin e të dhënave tremujore, duke marrë parasysh karakteristikat e serisë vjetore. Vektorët dhe matrica korresponduese e kovariancës merren duke përdorur teknikën e Kalman Filter.

METODAT OPTIMALE

Metodat optimale bashkojnë fazën e vlerësimit paraprak dhe atë të axhustimit në një procedurë statistikore optimale axhustimi. Këtë e bëjnë të mundur me anë të një regresi statistikor, që përfshin si informacionin vjetor, ashtu edhe informacionin e treguesve të lidhur tremujorë.

Një ndër cilësitë më të rëndësishme të kësaj teknike është mundësia e vlerësimit të matricës së kovariancës së gabimeve. Ajo jep një zgjidhje natyrale dhe koherente për problemin e interpolimit të të dhënave. Të dhënat e reja të serisë tremujore, të variablit të agreguar merren në mënyrë direkte nga regresi tremujor.

Një ndër metodat më të njohura, optimale është metoda e Chow dhe Lin (1971), e përdorur intensivisht nga institute të ndryshme statistikore, veçanërisht në Francë dhe Itali. Versione të ndryshme të kësaj teknike janë zhvilluar në bazë të hipotezave të ndryshme në lidhje me strukturën e gabimeve. Kështu kemi këto modele kryesore për gabimet:

- Modele AR(1) (Bournay dhe Laroue, 1979).
- Modele random walk (Fernandez, 1981).
- Modele random walk- Markov (Litterman, 1983, Di Fonzo, 1987).

Në rastin e parë, supozohet që gabimet ndjekin një sjellje AR (1) dhe gjenerohen nga kushti i parë i procesit Markov. Kjo

teknikë bazohet në supozimin, që nuk kemi korrelacion ndërmjet serive dhe është e përshtatshme vetëm në rastet ku gabimet janë të qëndrueshme.

Fernandez në 1981-in propozoi një tjetër metodë, e cila supozonte që mbetjet ndjekin një shpërndarje random walk si më poshtë për tremujorin *i* të vitit *t* :

$$u^*_{t,i} = u^*_{t,\,i-1} + \varepsilon^*_{t,\,i} \qquad (1)$$

ku: $u^*_{t,\,0} = u^*_{t-1,\,4}$ dhe $\varepsilon^*_{t,\,i}$ është *white noise* me varinacë σ^2 dhe si kusht fillestar, Fernandez supozon që $u^*_{0,\,4} = 0$.

Supozimi i bërë nga Fernandez, e përmirëson metodën e ndërtuar nga Chow dhe Lin, por ky është një supozim mjaft specifik për sjelljen e gabimeve, pasi nënkupton praninë e një filtri, që do të mënjanojë të gjithë korrelacionin (lidhjet reciproke) në mbetjet e serisë tremujore. Në vitin 1983 Litterman, ka gjetur që ky filtër nuk mënjanon të gjithë korrelimin që ekziston midis serive, prandaj ai ka supozuar, që mbetjet gjenerohen nga ekuacioni i mëposhtëm për tremujorin *i* dhe për vitin *t*:

$$u^*_{t,\,i} = u^*_{t,\,i-1} + \varepsilon^*_{t,\,i} \qquad (2)$$

$$\varepsilon^*_{t,\,i} = \lambda\, \varepsilon^*_{t-1,\,i} + \varepsilon^*_{t,\,i} \qquad (3)$$

ku : $/\lambda/ < 1$ dhe $u^*_{0,4} = \varepsilon^*_{0,\,4} = 0$

METODAT DINAMIKE

Metodat dinamike janë një vazhdim i metodave optimale, por që përfshijnë brenda në model edhe elemente dinamike, të cilat marrin parasysh si ndikimin e treguesve të lidhur në periudhën afatshkurtër, edhe ndikimin e tyre të kaluar tek variabli që do të vlerësojmë.

Sipas Mazzit dhe Savio-s (2005), ndryshimi kryesor midis metodave të lartpërmendura qëndron tek supozimi, që bëhet në lidhje me shpërndarjen e gabimit.

Në mënyrë të përgjithshme, metodat e disagregimit mund t`i përshkruajmë si më poshtë:

Le të jetë $y_{4(t-1),+i,}$ vlera e panjohur tremujore e agregatit në tremujorin *i* të vitit *t,* dhe le të jetë y_{at} ku t = 1 …n vlera korresponduese e njohur vjetore.

Në rastin e shpërndarjes, lidhja midis *y* dhe y_a mund të shkruhet si:

$$y_{a,t}=_{4(t-1)+\,i,} \text{ ku } t=1,\ldots,n \qquad (4)$$

Lidhja midis serisë tremujore dhe asaj vjetore mund të riformulohet në formën e matricës si më poshtë:

$$y_a=By \qquad (5)$$

ku y është vektori me përmasat *(N x1)* të vlerave të panjohura tremujore dhe y_a është vektori me përmasat *(nx1)*, që përmban vlerat vjetore të serisë, e cila do të disagregohet. *N* është zakonisht e barabartë me *4n*, megjithatë në rastin e ekstrapolimit të të dhënave kemi që $N = 4n + q$, ku $q > 0$, pasi merren vlerësime përtej sample-t me vlerat e njohura vjetore.

B-ja është një matricë me përmasat *(nxN)*, forma e së cilës varet nga tipi i disagregimit që ne marrim në konsideratë:

$$B = \begin{bmatrix} c & 0 & \ldots & 0 \\ 0 & c & \ldots & 0 \\ . & . & \ldots & . \\ 0 & 0 & \ldots & c \end{bmatrix}$$

ku:

- c = (1 1 … 1)` për variablat flow në procesin e shpërndarjes
- c = ¼(1 1 … 1)` për indekset në procesin e shpërndarjes

3. RASTI I SHQIPËRISË

Të dhënat konsiderohen si një ndër burimet kryesore të informacionit, që merret në lidhje me tregues të ndryshëm ekonomikë. Ato japin informacion në lidhje me ecurinë e një treguesi në vite, por njëkohësisht edhe për fluktuacionet e ndryshme, që ka pësuar ai. Instituti i Statistikës (INSTAT) është institucioni kryesor, i cili merret me mbledhjen dhe llogaritjen e treguesve statistikorë në Shqipëri. Treguesit kryesorë, që publikon INSTAT i ndajmë në dy grupe kryesore: në treguesit ekonomikë dhe treguesit socialë. Treguesit socialë japin informacion mbi evoluimin e jetës sociale dhe ekonomike të familjeve shqiptare, ndërsa treguesit ekonomikë japin informacion mbi performancën e ekonomisë në tërësi.

Megjithatë, duhet thënë që seritë kohore në Shqipëri janë të shkurtra dhe me frekuencë jo të shpeshtë. Më shumë probleme shfaq kryesisht sektori real i ekonomisë, ku edhe prodhimi i brendshëm bruto (PBB-ja) është me frekuencë vjetore dhe publikohet me vonesë kohore.

Teknikat e përmendura më sipër kanë treguar, që mund të bëhet disagregimi i të dhënave vjetore të llogarive kombëtare, kur kemi një informacion shtesë, si me tregues të lidhur me serinë që do të disagregojmë, ashtu edhe me tregues të tjerë që veprojnë në të njëjtin ambient ekonomik, pasi ndikohen nga të njëjtët faktorë. Në vazhdim, do të japim një përpjekje të parë për të marrë vlerat tremujore të PBB-së nga viti 1996-2006, duke përdorur metodën e dy- fazave të axhustimit të Deaton-it (1971).

Procesi i parë për disagregimin e të dhënave është pikërisht përcaktimi i atyre treguesve, që do të shërbejnë si parashikues kryesorë për serinë tonë. Dy janë mënyrat e zgjedhjes së treguesve:

1. nëpërmjet intuitës ekonomike

Për të disagreguar PBB-në, mund të nisemi nga komponentët e tij përbërës që janë: Konsumi, C; Investimet, I; Shpenzimet

qeveritare, G dhe Eksportet neto NX. Kjo mënyrë e disagregimit të PBB-së sipas komponentëve të tij, është e mirë, sepse merr parasysh karakteristikat e një ekonomie të vogël dhe të hapur si ajo e Shqipërisë, si dhe ciklet e biznesit midis vendit dhe partnerëve të huaj. Të dhënat në lidhje me eksportet, importet dhe shpenzimet qeveritare mund të sigurohen edhe me frekuencë mujore, ndërsa komponentët e tjerë shfaqin probleme, pasi jo vetëm që janë në frekuencë vjetore, por janë llogaritur edhe si mbetje. Sipas kësaj mënyre duhet të përcaktohet një tregues me frekuencë të shpeshtë për secilin komponent, i cili do të shërbejë si parashikues për sjelljen e tyre. Një mënyrë tjetër alternative është duke u nisur nga vëllimi total i shitjeve të ekonomisë në tërësi ose të sektorëve në veçanti, një tregues ky, i cili përdoret gjerësisht nga vende të tilla si Franca, Italia, Malajzia etj..

2. nëpërmjet vlerësimeve statistikore

Me anë të kësaj mënyre zgjidhet ai tregues, që shpjegon më mirë sjelljen e PBB-së duke u bazuar vetëm te karakteristikat statistikore të modelit si për shembull: koeficienti i përcaktimit, R^2 më të lartë, devijimi standard më i vogël, mungesa e autokorrelacionit, të heteroskedasticitetit etj..

Kështu për të disagreguar PBB-në jemi nisur nga dy tregues me natyrë të ndryshme nga njëri-tjetri, që janë M3-shi dhe vëllimi total i shitjeve. Zgjedhja e këtyre dy variablave është bërë për disa arsye.

Kështu agregati monetar M3, është zgjedhur sepse ndryshe nga M1 dhe M2, lidhja e tij me PBB-në ka rezultuar me koeficientin e përcaktueshmërisë R^2 më të lartë 0.98, vlerën e Durbin-Watson=1.43 dhe me vlerën më të vogël të devijimit standard. Gjithashtu dimë që: agregati monetar M3, përfshin tërësinë e parasë jashtë bankave, depozitat pa dhe me afat në monedhën vendase dhe të huaj. Fakti që norma e interesit të depozitave në monedhë të huaj nuk përcaktohet nga politika që ndjek Autoriteti Monetar, Banka e Shqipërisë, e bën këtë tregues akoma edhe më të përshtatshëm se M1 dhe M2. Një shembull i përdorimit të agregatit monetar është Kili, por ka

përdorur metodën e *space model* dhe teknikën e Kalman Filter, si një ndër metodat më të avancuara në ditët e sotme.

Ndërsa, vëllimi total i shitjeve është zgjedhur, pasi shërben si një parashikues i mirë i sasisë totale të prodhimit në një periudhë të caktuar, është me frekuencë tremujore dhe është përdorur nga shumë vende të tjera. Më poshtë po paraqesim disagregimin e PBB-së, në rastin e Shqipërisë.

Të dhënat për agregatin monetar M3, janë marrë nga Banka e Shqipërisë dhe i përkasin periudhës 1996T1-2006T4. Pasi kemi agreguar të dhënat tremujore të M3 në të dhëna vjetore, kemi gjetur se midis PBB-së dhe M3-vjetor ekziston një lidhje e fortë dhe pozitive, me koeficient korrelacioni 0.98. Regresi që jep lidhjen midis PBB-së dhe M3-it është si më poshtë:

$$PBB = c(1) + 1.15*M3 + \varepsilon t \quad (6)$$

t-stat (9.59) (31.14)

ku: $R^2 = 0.98$, D-W= 1.43, εt përfaqësojnë mbetjet dhe c(1) është një konstante.



Vlerësimet përfundimtare të PBB-së tremujore u derivuan nga vlerësimet paraprake, të korrigjuara me mbetjet dhe janë paraqitur në grafikun 1. Vlerësimet që u morën janë konsistente,

pasi shuma e tremujorëve të një viti është e barabartë me vlerën vjetore të PBB-së të vitit përkatës.

Në të njëjtën mënyrë është vepruar edhe me vëllimin e shitjeve, i cili përfaqëson vlerën absolute të shitjeve të sektorëve kryesorë të ekonomisë, për çdo tremujor. Seria është marrë nga INSTAT dhe i përket periudhës 2001T1-2006T4. Në qoftë se do të shikojmë grafikisht serinë e vëllimit total të shitjeve tremujore (Grafik 2), vëmë re se kjo seri ka mjaft të pranishëm efektin e sezonalitetit. Kështu, për të disagreguar PBB-në kemi përdorur dy seri të shitjeve, njëra që ka praninë e sezonalitetit dhe njëra, e cila është axhustuar me anë të metodës së Tramo/seats për ta eliminuar atë efekt.

Grafik 2. Vëllimi total i shitjeve (milionë lekë).

Burimi: INSTAT dhe llogaritjet e autorit.

Pasi kemi agreguar të dyja seritë e vëllimit total të shitjeve në seri vjetore, kemi gjetur një lidhje të fortë pozitive midis këtij treguesi dhe PBB-së, reflektuar në një koeficient korrelacioni të lartë (0.98). Modelet jepen si më poshtë:

Modeli me vëllimin total të shitjeve të paaxhustuar

$$PBB = c(2) + 0.92*Shitjet + \mu_t(7)$$

t-stat (9.28) (20.58)

ku: $R^2 = 0.98$, $DW = 1.59$, μ_t përfaqësojnë mbetjet dhe c(2) konstante.

Modeli me vëllimin total të shitjeve të axhustuar

PBB-sa = c (3) + 0.93*Shitjet_sa +v_t (8)
t-stat (9.39) (21.17)
ku: R^2 = 0.98, DW= 1.64, v_t përfaqësojnë mbetjet dhe c(3) një konstante.

Pas marrjes së vlerësimeve paraprake dhe axhustimit të tyre, u derivuan të dhënat tremujore përfundimtare për PBB-në, me dhe pa efektin e sezonalitetit. Edhe në këtë rast, shuma e vlerave e tremujorëve është e barabartë me shumën e vlerës vjetore të PBB-së të vitit përkatës.

Rezultatet e serisë së disagreguar të PBB-së janë dhënë në grafikun e mëposhtëm:



Në grafikun 5, janë paraqitur seritë e PBB-së tremujore, të përfituara me anë të metodës së mësipërme. Vëmë re se seria e gjeneruar nga M3 dhe vëllimi total i shitjeve, i paaxhustuar shfaqin pothuaj të njëjtën sjellje dhe prirje gjatë tremujorëve të ndryshëm, duke reflektuar edhe sjelljen ciklike që ka ekonomia në Shqipëri. Ndërsa seria e PBB-së, e disagreguar nga seria e vëllimit të shitjeve, e axhustuar me efektin sezonal ka të njëjtën prirje me dy seritë e para, por ka një ecuri më të zbutur. Duhet nënvizuar fakti që vlerësimet e marra për PBB-në janë njëkohësisht konsistente dhe koherente.





Një nga mangësitë kryesore që shfaq metoda e dy fazave të axhustimit e Deatonit është pikërisht pavazhdimësia, që ekziston midis tremujorit të katërt të një viti me tremujorin e parë të vitit në vazhdim. Kjo mangësi nuk shfaqet shumë, kur për disagregimin e serisë së PBB-së përdorim serinë e vëllimit të shitjeve, të axhustuar sezonalisht. Rezultatet e vlerësimeve të PBB-së tremujore janë paraqitur në tabelën 1.

Vlerësimet e marra të PBB-së i kemi krahasuar me vlerësimet e nxjerra nga FMN (Fondi Monetar Ndërkombëtar). Grafiku 6 tregon ecurinë e PBB-së, derivuar nga M3 dhe vëllimi total i shitjeve si dhe PBB-në, vlerësuar nga FMN.

Nga grafiku i mëposhtëm shikojmë, që seria e vlerësuar nga FMN ka pothuaj të njëjtën sjellje me serinë e PBB-së së derivuar nga vëllimi total i shitjeve, i axhustuar sezonalisht. Një fakt që vihet re dukshëm është se përveç viteve 2004-2006[1], gjatë gjithë kohës seria tremujore e FMN-së qëndron nën serinë e vlerësuar të PBB-së nga ana jonë, kjo pasi vlerat vjetore të PBB-së publikuar nga INSTAT, ndryshojnë nga vlerat vjetore raportuar nga FMN-ja. Në grafikun 6 është dhënë norma e ndryshimit midis vlerës së PBB-së vjetore vlerësuar nga FMN, krahasuar me vlerën vjetore publikuar nga INSTAT për vitet 1996-2005.

Grafik 6. Norma e ndryshimit midis PBB-vjetore të FMN-së dhe INSTAT.



Burimi: Llogaritjet e autorit.

4. KONKLUZIONET

Procesi i disagregimit të të dhënave është një proces mjaft i rëndësishëm dhe i domosdoshëm sidomos në ato raste, kur ka një mungesë të madhe informacioni. Kjo pasi ai bën të mundur shtimin e serive, vlerësimin e vlerave të panjohura dhe përmirëson analizat ekonomike afatshkurtra. Për të disagreguar seritë mund të përdoren metoda të ndryshme, të cilat varen kryesisht nga informacioni i disponueshëm, që kemi në lidhje me një variabël. Në këtë material është bërë përpjekja e parë e gjenerimit të PBB-së tremujore nga dy seri, ajo e M3-shit dhe e vëllimit total të shitjeve. Të dyja modelet e ndërtuara, karakterizohen nga një koeficient përcaktimi i lartë $R^2=0.98$,

pra 98 për qind e variacionit të PBB-së shpjegohet mjaft mirë si nga M3 ashtu edhe nga vëllimi i shitjeve, si dhe gjithashtu nga një vlerë e mirë DW. Duke marrë parasysh faktin se numri i vëzhgimeve vjetore që kemi në model, është mjaft i vogël dhe ndryshon nga modeli në model, bëhet i vështirë krahasimi midis tyre. Megjithatë rezultatet që morëm, mund të konsiderohen të kënaqshme për fazën e parë të vlerësimit të PBB-së, duke patur parasysh faktin se seritë janë të shkurtra dhe nuk të lejojnë kryerjen e testeve të ndryshme.

Kështu, si projekt për të ardhmen është pikërisht gjenerimi i të dhënave tremujore të PBB-së duke përdorur metoda të tjera disagregimi, informacion me frekuencë më të shpeshtë, seri më të gjata si dhe software si ECOTRIM, RATS etj..

ANEKS

Tabelë 1. Vlerat tremujore të PBB-së (milionë lekë) derivuar nga M3 dhe vëllimi total i shitjeve.

Vitet	PBB_M3	PBB_Shitje	PBB_Shitje_SA
1996T1	65,972		
1996T2	74,463		
1996T3	89,044		
1996T4	107,129		
1997T1	66,337		
1997T2	81,734		
1997T3	95,426		
1997T4	110,144		
1998T1	85,965		
1998T2	97,143		
1998T3	110,170		
1998T4	123,730		
1999T1	97,382		
1999T2	114,909		
1999T3	126,657		
1999T4	141,633		
2000T1	121,290		
2000T2	124,949		
2000T3	137,196		
2000T4	149,542		
2001T1	126,831	126,301	138,719
2001T2	136,396	154,925	157,028
2001T3	152,513	146,676	142,746
2001T4	174,542	162,379	151,789
2002T1	151,774	137,402	152,389
2002T2	148,961	152,492	154,561
2002T3	160,878	165,047	160,226
2002T4	169,725	176,397	164,161
2003T1	159,836	157,471	174,848
2003T2	164,076	171,148	173,006
2003T3	181,754	182,204	176,275
2003T4	191,284	186,128	172,820
2004T1	166,229	162,960	181,213
2004T2	171,817	182,496	184,984
2004T3	197,815	197,388	191,422
2004T4	216,507	209,524	194,749
2005T1	175,345	172,028	192,550
2005T2	192,220	207,565	210,702
2005T3	219,458	216,227	209,323
2005T4	235,012	226,216	209,460
2006T1	192,072	188,602	213,090
2006T2	201,567	211,511	215,028
2006T3	231,412	234,538	226,925
2006T4	271,249	261,649	241,256

SHËNIME

* Elona Dushku, specialiste, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë.

[1] Kemi përdorur vlerësimin paraprak të FMN-së për shifrën vjetore të vitit 2006.

REFERENCA

ABEYSINGHE, L: LEE, C "Best Linear Unbiased Disaggregation of Annual GDP to Quarterly Figures: The Case of Malaysia" (1998)

ANGELINI, E; HENRY, J; MARCELLINO, M "Interpolation and backdating with information set". Wp Nr 252 (2003)

CHOW, G; LIN, A "Best linear Unbiased Interpolation, Distribution, and extrapolation of time series by related series" (1971)

BRUNO, G, DI FONZO, T; GOLINELI, R; PARIGI, G "Short-run GDP forecasting in G7 countries: temporaldisaggregation techniques and bridge models" (2005).

GUJARATI, D "Basic Econometrics", Fourth edition, United States Military Academy, West Point.

KLADROBA, A "The Temporal Disaggregation of Time Series" (2005)

PROIETTI, T "Temporal disaggregation by state space methods: Dynamic regressionmethods revisited" (2005)

"A proposal to obtain a long quarterly Chiliean GDP series" CUADERNOS DE ECONOMÍA, VOL. 43 (NOVIEMBRE), PP. 285-299, 2006

LITTERMAN, R: "A random Walk, Markov Model for the distribution of the time series" (1983)

MAZZI, G; SAVIO, G "Theory and applications of univariate and multivariate models for temporal disaggregation" Eurostat (2005)

N CUCHEz, N; HESSx, M "Estimating monthly GDP in a general Kalman filter framework: Evidence from Switzerland" (1999).

Botuar nga Banka e Shqipërisë,
Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë
Tel.: 355-4-222230; 235568; 235569
Faks: 355-4-223558
public@bankofalbania.org
Tirazhi: 800 kopje